AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË
SECTION OF LINGUISTICS AND LITERATURE

STUDIMET ALBANISTIKE NË AMERIKË

KONFERENCË SHKENCORE SHTATOR 25-26, 2015

PRISHTINË
2016

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË
SECTION OF LINGUISTICS AND LITERATURE

ALBANIAN STUDIES IN AMERICA

SCHOLARLY CONFERENCE, SEPTEMBER 25-26, 2015

Editor
Academician Rexhep Ismajli

PRISHTINA
2016

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË
SECTION OF LINGUISTICS AND LITERATURE

STUDIMET ALBANISTIKE NË AMERIKË

KONFERENCË SHKENCORE SHTATOR 25-26, 2015

Redaktor
Akademik Rexhep Ismajli

PRISHTINË
2016

Këshilli organizues i konferencës:
Rexhep Ismajli
Victor Friedman
Eqrem Basha

Copyright © ASHAK

Pjesëmarrës të Konferencës

PËRMBAJTJA

Rexhep ISMAJLI, Prishtinë: STUDIMET ALBANISTIKE NË AMERIKË.....11

Victor A. FRIEDMAN, Chicago: HISTORIA E SHQIPES STANDARDE NË SHTETET E BASHKUARA.....37

Sabri HAMITI, Prishtinë: UJDHESA E SHPËTIMIT [Letërsia shqiptare në Amerikë 53

Brian D. JOSEPH, Ohio: PËRFYTYRIMI PËR GJUHËN SHQIPE NDËR GJUHËTARËT E HERSHËM AMERIKANË.....73

Shaban SINANI, Tiranë: *ALBANIAN CATHOLIC BULLETIN*, NJË DRITARE NDIHMESASH NË SHKENCAT KOMBËTARE NDËR DIJETARËT SHQIPTARO-AMERIKANË 87

Seit MANSAKU, Tiranë: HUMBJA E PASKAJORES NE GJUHËN SHQIPE, HIPOTEZA DHE TË VËRTETA SHKENCORE 103

Vesel NUHIU, Prishtinë: FONETIKA E GJUHËS SHQIPE SIPAS G. S. LOWMAN 119

Kolec TOPALLI, Tiranë: PËR NJË SHTRESIM KRONOLOGJIK-ETIMOLOGJIK TË LEKSIKUT FETAR NË POEZITË E NOLIT 129

Bardhyl DEMIRAJ, München: MBI NDRYSHIMIN E PARADIGMËS NË STUDIMIN DIAKRONIK TË SHQIPES PËR NGA PERSPEKTIVA E INDOEUROPIANISTIKËS – TEORIA E LARINGALEVE IE. DHE ZBATIMI I SAJ SI RAST STUDIMI 141

Giovanni BELLUSCIO, Cosenza: DIALEKTOLOGU ME ÇIZMET E BARDHA: ERIC P. HAMP DHE ARBËRESHËT.....163

Albert RISKA, Elbasan: PËRKIMET LEKSIKORE RUMUNO-SHQIPTARE NË KËNDVËSHTRIMIN E ERIC P. HAMP 187

Bardh RUGOVA, Prishtinë: KONTRIBUTI I BEVINGTON-IT PËR FONOLOGJINË E SHQIPES – THEKSI SI RAST STUDIMI 199

Teuta ABRASHI, Prishtinë: LIDHJA NDËRMJET KUNDËRVËNIES ASPEKTORE AORIST/ IMPERFEKT, ORGANIZIMIT TË DISKURSIT DHE NYJAVE 207

Linditë SEJDIU-RUGOVA, Prishtinë: KUNDËRVËNIET ASPEKTORE BRENDA SHQIPES NË STUDIMET E FRIEDMAN-IT DHE NË STUDIMET E SOTME TË SHQIPES 235

Blertë ISMAJLI, Prishtinë: PËRTEJ MËNYRËS? VËSHTRIME RRETH MODALITETIT NË RAPORT ME HABITOREN TE FRIEDMAN.....253

Jani THOMAI, , Tiranë: RRETH "FJALORIT SHQIP – ANGLISHT" *("OXFORD ALBANIAN – ENGLISH DICTIONARY")* TË LEONARD NEWMARK-UT.....265

Rrahman PAÇARIZI, Prishtinë: GRAMATIKA E NEWMARK-UT – STRUKTURALIZMI DHE KURTHET PRESKRIPTIVISTE.....291

Jonida XHYRA-ENTORF, Mynih: SHKOKLITJE SOCIO-KULTURORE NË „OXFORD ALBANIAN-ENGLISH DICTIONARY" (OAED) HARTUAR NGA NEWMARK.....301

Mimoza PRIKU, Shkodër: FUQIA E FJALËS NË NJË FJALOR. FJALËSI SHQIP NË FJALORIN SHQIP-ANGLISHT TË LEONARD NEWMARK-UT319

Bahri BECI, Paris: JANET BYRON PËR HISTORINË E FORMIMIT TË SHQIPES STANDARDE.....331

Imri BADALLAJ, Prishtinë: JANET BYRON MBI BAZËN DIALEKTORE TË SHQIPES STANDARDE DHE QËNDRIMI ZYRTAR NDAJ DIALEKTEVE ..353

Carrie Ann MORGAN, Ohio: HABITORJA SI VEPRIM SOCIAL NË KONTEKSTIN E IDEOLOGJIVE GJUHËSORE 359

Shkumbin MUNISHI, Prishtinë: PIKËPAMJET PËR SHQIPEN STANDARDE TË ZHVILLUARA NË SHBA 369

Julie KOLGJINI, Rochester Institute of Technology/ A.U.K.: AN EXAMINATION OF AESTHETIC TRANSGRESSIONS OF ALBANIAN STANDARD LANGUAGE IDEOLOGY: THE CASE OF MIFTAR SPAHIJA.383

Ali ALIU, Prishtinë: ROBERT ELSIE: PREZANTUES I LETËRSISË SHQIPE NË PËRMASA NDËRKOMBËTARE 407

Mehmet KRAJA, Prishtinë: "ËNDRRA AMERIKANE" E SHQIPTARËVE. NJË VËSHTRIM HISTORIK DHE POLITIK MBI DIASPORËN SHQIPTARE NË AMERIKË.....415

Bashkim KUÇUKU, Tiranë: MONOGRAFI ARGUMENTUESE, KOHERENTE 423

Kujtim M. SHALA, Prishtinë: IDEOLOGJIKA E NOLIT 429

Mehmet HALIMI, Prishtinë: FUNKSIONI SEMANTIK E ARTISTIK I KOMPOZITAVE NË VEPRIMTARINË LETRARE TË NOLIT 439

Floresha DADO, Tiranë: ARSHI PIPA, MIDIS FILOZOFISË SË JETËS DHE FILOZOFISË SË ARTIT (QASJE KONTRADIKTORE NË FILOZOFINË E INTERPRETIMIT LETRAR?) 457

Bavjola SHATRO, Durrës: STUDIMET ALBANOLOGJIKE DHE LETËRSIA E KRAHASUAR NË AKADEMINË AMERIKANO - VERIORE 465

Dhurata SHEHRI, Tiranë: ARSHI PIPA LEXON LETËRSINË BASHKËKOHORE 495

Muhamet HAMITI, Prishtinë: PAMJE E LETËRSISË SHQIPE NË STUDIMET E ARSHI PIPËS 503

Zymer Ujkan NEZIRI, Prishtinë: KONTRIBUTI I STUDIUESEVE AMERIKANË M. PERI E A. LORD PËR EPIKËN GOJORE SHQIPTARE ...521

Carly DICKERSON, Ohio: SHPREHJA GJUHËSORE E IDENTITETIT GJINOR: BURRNESHAT E SHQIPËRISË 535

Artur KARASIŃSKI, Torunj: TRASHËGIMIA GJUHËSORE DHE LETRARE SHQIPE NË BIBLIOTEKËN NEWBERRY 559

Mario de MATTEIS, Bochum, Durrës, Elbasan, Tiranë, Tetovë: MËSIMI DYGJUHËSH, INTERKULTURALITETI - A ËSHTË MËSIMI I DISIPLINAVE LËNDORE NË NJË GJUHË TË HUAJ NJË MODEL PËR ARSIMIN E ARDHSHËM KOSOVAR? 567

Shpend BENGU, Tiranë: KUNTRIBUTI I SHBA NË DOKUMENTIMIN E TRASHËGIMISË KULTURORE SHQIPTARE 579

Anton ÇEFA, New York: VEPRIMTARIA E SAMI REPISHTIT 599

Victor FRIEDMAN, Chicago: FJALA E MBYLLJES 611

Victor FRIEDMAN, Chicago: CLOSING REMARKS 613

THIRRJE E KONFERENCËS 615

CALL OF THE CONFERENCE "ALBANIAN STUDIES IN AMERICA" 617

SHTOJCË: PROGRAMI I PUNËS I KONFERENCËS DHE ABSTRAKTET ..619

INDEKSI.....647
Fotografi nga Konferenca.....659

Rexhep ISMAJLI, AShAK, Prishtinë:

STUDIMET ALBANISTIKE NË AMERIKË

I nderuar Z. Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akademik Hivzi Islami, inderuar z. Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve i Republikës së Kosovës, prof. dr. Kujtim Shala, të nderuar përfaqësues të Universitetit Amerikan të Kosovës,

Kolegë dhe miq,

më lejoni të hap punimet e Konferencës shkencore "Studimet albanistike në Amerikë" të organizuar nga Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i AShAK-ut, tematikë që shtrohet për herë të parë në këto përmasa dhe me këtë pjesëmarrje ndërkombëtare.

Në fillim dua të shpreh falënderimet për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Republikës së Kosovës për mbështetjen financiare të konferencës. Dua të falënderoj po ashtu AUK-un që u solidarizua me ne në këtë organizim.

REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PREDSEDNIK

Në bazë të nenit 84 pika 28 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 6 të Ligjit Nr. 04/L-070, për Dhënien e Dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës, si dhe në bazë të neneve 3, 4 dhe 13 të Rregullores mbi Llojet e Dekoratave që i jep Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Procedurat për Dhënien e Tyre, Presidentja e Republikës së Kosovës merr këtë:

VENDIM

Eric Pratt Hamp dekorohet me Medaljen Presidenciale të Meritave, për kontribut të jashtëzakonshëm në studimin dhe afirmimin e gjuhës shqipe.

Medalja Presidenciale e Meritave u jepet personave që me punën e tyre kanë kontribuar në fusha të veçanta si: arsim, shkencë, kulturë, rini, sport, siguri, shërbim civil.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, më 23 shtator 2015

Atifete Jahjaga
Presidentja e Republikës së Kosovës

Kam kënaqësinë e posaçme të vij me një lajm të gëzueshëm: Presidentja e Republikës së Kosovës, Zonja Atifete Jahjaga më 23 shtator ka vendosur të nderojë me çmimin e posaçëm *"Medalje Presidenciale për Merita"* me mo-

tivacionin *"për kontribut të jashtëzakonshëm në studimin dhe afirmimin e gjuhës shqipe"* profesor dr. Eric Pratt Hamp-in nga Universiteti i Chicago-s.

Studimet albanistike në SHBA kanë dhënë një ndihmesë me vlerë për njohjen e botës shqiptare, e kanë begatuar dijen dhe e kanë ushqyer miqësinë midis dy popujve. Albanistët merikanë kanë shtruar çështje themelore në studimet gjuhësore shqiptare. Përvoja e madhe në përshkrimin e gjuhëve, teknikat e metodat e zhvilluara për hulumtim në terren, kanë bërë që ata të jepnin vepra me peshë, siç janë përshkrimet e Eric P. Hamp-it, të Leonard Newmark-ut, të Gary L. Bevington-it për fonologjinë gjenerative të shqipes, të Victor Friedman-it për morfosintaksën, të Brian Joseph-it për infinitivin të parë dhe në kontekst ballkanik, të Janet Byron-it për standardizimin e shqipes, të Lukas Tsitsipiis-it për gjendjen sociolinguistike të arbërishtes së Greqisë, të Philip Hubbard-it për sistemin foljor, të Mat Curtis-it për raportet e shqipes me gjuhët sllave, të Stavro Skendit për metrikën dhe epikën apo për historinë kulturore, të Arshi Pipës për letërsinë shqipe e italiane, të Peter Priftit për historinë më të re, të Nikolla Panos po ashtu për historinë e re, të Bernd Fischer-it për historinë e Luftës së Dytë Botërore e për periudhën e Zogut, e të më të rinjve në fusha të ndryshme.

Duke qenë studimet krahasimtare në SHBA dukshëm më të avancuara, sidomos në gjysmën e dytë të sh. XX, këta studiues kanë bërë që edhe për shqipen të kemi rezultate të shquara, si ato të Hamp-it, i cili paraqet një nga kulmet e gjuhësisë së krahasuar në botën e sotme. Kjo ka bërë që edhe në fushën e studimeve etimologjike atje të bëhen përpjekje serioze, e kjo domethënë dhe në fushë të historisë së brendshme të gjuhës. Do përmendur këtu, pos Hamp-it, Martin Huld me etimologjitë e tij.

Në studimet ballkanistike dijetarët amerikanë po bëhen gjithnjë e më shumë prijës. Shqipja në këtë aspekt zë një vend qendror dhe në aportet e Hamp-it, të Friedman-it, të Joseph-it, të Kazazis-it, etj. Në fushën e mësimdhënies së shqipes e të fjalorëve rezultatet kanë qenë jo të vogla: nga hartimi i Gramatikës së referimit e deri te Fjalori i tipit Oxford i L. Newmark-ut. Në albanistikën amerikane ka pasur depërtime serioze në

zbatimin e parimeve dhe të metodave të sociolinguistikës, por kanë munguar, pos në fonologji, zbatimet e të arriturave serioze të gjuhësisë dominante amerikane të 40 vjetëve të fundit – të metodave gjenerative-transformacionale, në fushën e shqipes. Kjo mund të ketë arsye të ndryshme, ndër të cilat komunikimi ynë i një niveli të ulët me këto metoda dhe zhvillime teorike mund të jetë i rëndësishëm. Gjithsesi mungesa e një qendre të institucionalizuar studimore për shqipen në nivele të njësisë së pavarur akademike ka lënë pasoja serioze në këtë drejtim. Këto studime në përgjithësi janë rezultat jo vetëm i kërshërisë shkencore, po motivohen nga miqësia e dashuria e këtyre studiuesve ndaj shqiptarëve në tërësi. Kjo mund të dëshmohet përmes kontakteve që kanë vendosur mërgimtarët tanë kryesisht nga hapsirat jugore të botës shqiptare apo të arbëreshëve me instanca të ndryshme opinioni e vendimmarrjeje në Amerikë qysh nga fillimi i sh. XX e deri vonë. Kontaktet, gjendja e vështirë e Kosovës dhe e shqiptarëve në ish-Jugosllavi, që u bënë më aktualë në pjesën II të sh. XX, sidomos lëvizja e gjerë paqësore dhe liridashëse me kulmin në rezistencën e armatosur të mbështetur dhe nga qytetarët amerikanë me prejardhje shqiptare, po edhe nga nivele të ndryshme të shtetit, kanë luajtur një rol me peshë po ashtu.

Hamp-i në AShAK me rastin e dorëzimit të Fletëdëshmisë për anëtar të jashtëm, 2005

Gjithandej figurë qendrore në studimet albanistike në Amerikë na del Eric Pratt Hamp-i, i cili sivjet mbush 95 vjet dhe edhe kjo konferencë reflekton frymën e celebrimit të kësaj figure madhore të linguistikës amerikane, në veçanti të albanistikës së saj.

Duajeni i studimeve albanistike në ShBA, profesor emeritus i Uni-

versitetit të Chicago-s, anëtar i jashtëm i AShAK-ut, Eric Pratt Hamp (1920) albanistikën e kishte bërë objekt studimesh të veta të thelluara qysh në vitet e hershme ’50 të sh. XX, kur kishte shkuar në Vakaricë të Kalabrisë për të studiuar të folmen e atjeshme arbëreshe, ndërsa në vijim i kishte zgjeruar hulumtimet për arbërishten e Greqisë dhe skajet e botës shqiptare e tek arbëreshët e Italisë. Disertacionin e mbaruar më 1954 për të folmen arbëreshe të Vakaricës, që mbetet edhe sot studimi më i gjerë përshkrues fonetik në terren për ndonjë të folme shqipe, ai mundi ta botonte anglisht dhe në versionin italisht vetëm më 1993.

Posta e Shqipërisë emetoi serinë e pullave *Albanologë të shquar të huaj* më 2013 me portretet e tre të mëdhenjve: H. Pedersen, N. Jokl dhe E. P. Hamp

Veprimtaria shkencore e Eric P. Hamp-it është e gjerë: indoeuropeist dhe komparativist nga më të shquarit në botën e sotme, keltolog i famshëm, ballkanolog i dorës së parë, romanist dhe sllavist i rryer, ai është njëherësh nga albanologët më të shquar të kohës sonë. Kontributi i gjerë i Hamp-it në këto studime shtrihet në hulumtimet që lidhen me shqipen: *dialektologji e skajeve të shqipes*, *histori e gjuhës shqipe* me përqendrim të veçantë në raportet e saj me gjuhët e tjera indoeuropiane, *studim i raporteve të shqipes me gjuhët e tjera përreth* dhe sidomos *etimologji,* ku vjen si risimtar i rëndësishëm. Në të gjitha këto fusha Eric P. Hamp ka dhënë rezultate që nuk mund të shpërnjihen.

Duke u marrë me çështjen e pozitës së shqipes në kuadër të grupimeve të lashta dialektore indoeuropiane, Hamp-i më 1966 në *The position of Albanian* konstatonte se për këtë çështje duan kombinuar rezultatet dhe hulumtimet në tri fusha të mëdha - *ballkanistikë, linguistikë klasike (filologji e epigrafi) dhe studime indoeuropiane*, për çka, siç thoshte ai me të drejtë, askush nuk mund të jetë njësoj kompetent. Hamp-i shquhet

me kompetencat e tij të jashtëzakonshme, jo vetëm në këto fusha po dhe më gjerë dhe nga kjo pozitë i ka dhënë albanistikës një ndihmesë të dorës së parë: dijet për shqipen e studimet shqiptare i ka integruar dhe bërë të pranishme në shkallën më të lartë në forumet e diskutimeve për to.

Ai e ka bërë të pranishme shqipen dhe albanologjinë gjithandej në majat e këtyre diskutimeve nëpër forume e revista të shquara, duke afirmuar gjerësisht dhe rezultatet e studiuesve shqiptarë. Gjithë duke dhënë ndihmesa substanciale për studimet e shqipes, ai nuk la pa bërë shumë gjëra sa i përket përhapjes së vlerave të botës shqiptare, sidomos të arbëreshëve dhe të Kosovës, me të cilat kishte kontakte të drejtpërdrejta. Eriku ishte i pranishëm në Prishtinë qoftë përmes Seminarit, qoftë në vija të tjera dhe bënte përpjekje të mëdha për ta ndihmuar çështjen e Kosovës në periudha të vështira në vitet ’90 të sh. XX, duke shkruar letra mbështetëse tek autoritetet e vendit të tij, apo duke sugjeruar zgjidhje të pranueshme për çështjen, deri edhe në Konferencën e Rambujesë.

Këtu dua të sjell në vëmendje reagimin e Hamp-it me rastin e botimit të vepërs së tij shqip në Prishtinë më 2007. Me atë rast ai dërgonte disa vërejtje për plotësimin që do të donte t’u bëhej disa prej studimeve të tij të mëhershme apo shpjegime të tjera rreth tyre. Ishte i kënaqur që vërejtjet mund të jepeshin si informacion në ndonjë mënyrë, por kishte shumë dëshirë që në fund të pjesës *Historia* të studimit *Gjuha shqipe* të botuar në *Encyclopaedia britannica* e vitit 1974, ff. 422-423, që filon në f. 102 të botimit shqip dhe mbaron bashkë me klasifikimin në f. 194, para pjesës Gramatika, të vendosej shënimi që shprehte qëndrimin e tij, të cilin e kishte shtyrë afërsisht 10 vjet, për ta bërë publik në atë moment, “çdo ditë pas kësaj jave të rëndësishme”:

> “(Mund të themi) Për shkak se ***Pri-zren*** (*Recherches albanologiques* 2, 1985, f. 57-8) e ***Pri-shtinë*** (<**setin-ā* ‘gūr/ shumës gurë+kolektiv/ grumbulluar’) na mësojnë se janë ndërtuar me **prit-* nga IE **pr̥t-* (angl. *ford*, kymr. *Rhyd* ‘va’), një fjalë me vokalizmin ***ri***, që gjuhësisht mund të jetë vetëm shqip, dhe u zëvendësua nga fjala latine ***uadum*** (> sot ***va***), është e qartë se gjuha shqipe flitej në Kosovë qysh përpara seTrajani t’i sillte popullit të Dakisë latinishten dhe shoqërinë e romakëve (G. B. Pellegrini,

Avviamento alla linguistica Albanese, Rende 1998, ff. 200-201, 4, 5-9) me fjalë të atilla si (Pellegrini 1998, ff. 214-227) ***qytet, fshat, fqin, mik, mbret, gjyq, shoq, sharrë, luftë, troftë, pemë, tërmet*** e ***va***. Për rolin etnografik të emrit IE ****pr̥t-*** të shihet E. P. Hamp, *Parasession, Chicago Linguistic Society* 1982, ff. 63-65".

Pas vërejtjeve për artikuj konkretë, ai vinte me këtë përfundim dhe falënderim:

"... Artikujt e tjerë janë krejt në rregull dhe më japin shumë kënaqësi.

Duke e parë tërë përmbajtjen dhe duke e ditur se sa me kujdes dhe saktësi i bëni gjithnjë gjërat, vërtet jam shumë i kënaqur me përmbajtjen që keni zgjedhur dhe ia keni dalë të përfshini. Mendoj se paraqet në mënyrë shënueshëm të mirë atë që do të kisha zgjedhur vetë duke e ditur hapësirën në dispozicion dhe varietetin. Më vjen shumë mirë për kujdesin ndaj rumanishtes dhe botimeve të tjera që shfaqin po atë frymë kujdesi që e ka demonstruar artikulli juaj i mrekullueshëm për botimet ballkanike një duzinë vitesh më parë.[1] Do të shkruaj tani për shkak të urgjencës, por nuk e di si t'ju falënderoj në mënyrë të përshtatshme. Më thoni nëse keni nevojë për ndonjë gjë dhe do të përgjigjem menjëherë.

Të fala familjes dhe të gjithë miqve.

Përfundimisht, risia me interes në këtë vëllim të bën të ndjehesh falënderues.

Eric".


Ad faq. 88 § Historia [e gjuhës shqipe]

(Mund të themi) Pse Pri-zren (Recherches Albanologiques 2, 1985, 57-8) e Pri-shtinë (< *stein-ā 'gur/pl.-shumës.-gurë + kolektiv/grumbullnar') na mësojnë neve se janë të dërtuar me *prit- nga IE *pr̥t- (= angl. ford, kymr. rhyd 'va') një fjalë me zanor( )imin ri i cili mund të jetë gjurmë sisht vetëm shqip, edhe u ndjek prej fjalës së ltinjëvet uadum (> së sotshme va), të këthiell është se fu fol gjuhë shqipe në Kosovë [flitesh] me heret se ia pruri Trajani ltishtjen popullit të Dakisë edhe shoqërinë e Romës (G.B. Pellegrini, Avviamento alla linguistica albanese 2, Rende CS 1998, faq. 200-1, 4, 5-9) me atilla fjalë si (Pellegrini 1998, 214-27) qytet, fshat, fqin, mik, mbret, gjyq, shoq, sharrë, luftë, troftë, pemë, tërmet, e va. Për etnografinë e emrit IE *pr̥t- të shihet E.P. Hamp, Parasession, Chicago Linguistic Society 1982, 63-5.

[1] Fjala është për Ismajli 1996 në bibliografinë këtu.

Në fund do të japim dhe një shtesë të dërguar me atë rast.

Këtë fjalë për studimet albanistike në Amerikë nuk kisha si ta filloja pos me njoftimin për punën e njeriut që ka merita vërtet të mëdha për themelimin dhe zhvillimin e atyre studimeve albanistike. Puna e tij frymëgjatë ndikoi në përhapjen e studimeve për shqipen në vendin ku studimet linguistike në pjesën II të sh. XX arritën majat.

***

Në veprat përfaqësuese për shqipen në ShBA në pjesën I të sh. XX njoftimet ishin fare të pakta, më shpesh të aspakta. Për të marrë vesh njoftimet e përgjithshme për shqipen në gjuhësinë amerikane të sh. XX, iu drejtova veprave më përfaqësuese, prej të cilave edhe ne në Europë kemi mësuar shumë për gjuhësinë si shkencë. Pasi pashë se te Edward Sapir-i nuk mund të gjendej gjë për shqipen, iu drejtova veprës themelore *Language* të Leonard Bloomfield-it të vitit 1933, ku shqipja përmendej qysh në f. 19-20 (të përkthimit frëngjisht që kam përdorur) lidhur me grupimet e gjuhëve indoeuropiane dhe konkretisht me etimologjinë e fjalës **māter – motër*. Në faqen 62 të këtij versioni gjejmë këtë shënim:

> *"Në lindje të Adriatikut, në jug të serbo-kroatishtes, shtrihet zona shqipe. Shqipja e njohur me regjistrime vetëm nga sh. XVII, flitet nga 1 milion e gjysmë folës. Edhe pse shqipja ka huazuar shumë fjalë nga gjuhët fqinje, bërthama origjinale e formës së saj e bën atë degë të veçantë të trungut indoeuropian".*

Në faqen 293 jepte skicën e gjuhëve IE, ku shqipes i caktohej vendi në qendër midis greqishtes, italikishtes, keltishtes e gjermanikishtes, në një anë, dhe armenishtes, indishtes, iranishtes, sllavishtes e baltishtes, në anën tjetër. Në faqet 295-96 fliste për grupimin sipas sibilanteve në vend të velareve të gjuhëve të tjera dhe shqipen aty e vendoste në jug bashkë me armenishten (e cila mbi baza të tjera lidhet dhe me greqishten e indo-iranishten) dhe balto-sllavishten (e cila po ashtu ka lidhje të tjera të veçanta me gjermanikishten) në veri. Bloomfield-i ka edhe dy shënime të vogla për shqipen. Në f. 442:

> *"Thuhet se shqipja ka vetëm një vokabular themelor prej disa qindra fjalësh indigjene; të gjitha të tjerat janë huazime nga gjuhët dominante, nga latinishtja, nga romanishtja, nga greqishtja, nga sllavishtja e nga turqishtja",*

ndërsa në f. 444:

"Gjuhët e siujdhesës ballkanike ofrojnë ngjashmëri të shumta, edhe pse përfaqësojnë katër degë të gjuhës indoeuropiane: greqisht, shqip, sllavisht (bullgarisht e serbisht) dhe latinisht (rumanisht). Kështu, shqipja, bullgarishtja e rumanishtja kanë një nyjë shquese të vendosur prapa emrit; gjuhët e Ballkanit në përgjithësi nuk kanë infinitiv".

Në përgjithësi Bloomfield-i i jepte lexuesit amerikan një njohuri të paktë relativisht të saktë për kohën lidhur me gjuhën shqipe, gjithsesi më mirë se Sapir-i e të tjerët që nuk jepnin asgjë.

Charles Hockett në *A Course in Modern Linguistics* të vitit 1958, pasardhës i Bloomfield-it për shumëçka, i kishte kufizuar shënimet e tij për shqipen vetëm në f. 419, derisa fliste për ndikimin e huazimit në gjuhë, i cili teorikisht mund të jetë i atillë që një gjuhë të ndikojë aq shumë në një tjetër, saqë studiuesit ta kenë vështirë ta gjejnë se cila prej tyre është burimorja. Edhe pse anglishtja ka pësuar ndikime vërtet të mëdha nga frëngjishtja, kjo gjuhë atij nuk i dukej mjaftueshëm përfaqësuese për një rast të atillë teorik, sepse

"*thelbi gramatikor i ME (ang. e mesme) e NE (ang. e re) të çon prapa pandërprerë tek anglishtja e vjetër". "Një konkurrues më serioz është shqipja, në të cilën ka aq shumë huazime nga latinishtja, rumanishtja, greqishtja, sllavishtja dhe turqishtja, sa që vetëm pak qindra tema 'origjinale' shqipe janë ende në përdorim. Kjo e shtyu njohjen e statusit historik të gjuhës nga studiuesit, por u dëshmua së paku se shqipja përbën një degë të pavarur të familjes indoeuropiane".*

Me kaq (dhe jo saktë) mbaronte çdo gjë te Hockett-i.

Ronald W. Langacker në veprën *Language and its Structure*, të vitit 1967, ku pasqyroheshin dhe dijet e universiteteve të Kalifornisë (atje kishte vepruar qysh herët L. Newmark), jepte po ashtu një shënim krejt të ngjashëm me të Hockett-it lidhur me huazimet në f. 176-77:

"*Shqipja, për shembull, ka aq shumë fjalë të huazuara në leksikun e saj saqë mbeten vetëm pak qindra fjalë native. Edhe pse anglishtja ka huazuar shumë më pak se shqipja, shpesh është cituar si gjuhë që ka huazuar shumë, sepse gati mbi gjysma e leksikut anglez është me prejardhje të huaj*".

Dhe pasi bënte krahasime me gjuhët atabaskan, që huazuakan më pak, vinte me përfundimin se arsyet për huazime nuk qëndrojnë te nevo-

jat gjuhësore, po tek elementet historike e kulturore. Shqipen ai e përmendte edhe një herë me rastin e specifikimit të ndikimeve sintaksore në gjuhët e Ballkanit, të cilat kanë kufizime në përdorimin e fjalive infinitivale, disa prej tyre madje nuk kanë infinitiv fare (në këtë grup të gjuhëve ballkanike përmendte shqipen, bullgarishten, greqishten, rumanishten). Çështjen e huazimeve e rimerrte në f. 206, derisa fliste për huazimet si element me peshë për zhvillimin e gjuhëve.

"[... shqipja], meqë ka huazuar kaq skajshmërisht nga gjuhët e tjera, përfshirë greqishten dhe gjuhët sllave e romane, në të kanë mbetur vetëm disa qindra fjalë native. Më tej, mbaresat e fleksionit kanë pësuar modifikime të konsiderueshme. Si rezultat, njohja e vendit të shqipes në familjen indoeuropiane ishte mjaft e vonë".

Leonard Newmark në mes, Oda Buchholz, Rexhep Ismajli, Burimi i Drinit të Bardhë, 1978

Vetëm në f. 225 e vendoste shqipen midis gjuhëve me prejardhje indoeuropiane midis tokarishtes e armenishtes, duke konstatuar:

"Është e qartë se shqipja përbën më vete një nënfamilje dhe po kjo vlen edhe për armenishten. E para flitet në Shqipëri dhe shtrihet drejt Italisë e Greqisë".

Më duket se vlerësimet e tilla gjejnë mbështetje edhe tek ato pak shënime të lëna nga vetë Bloomfield-i, sadoqë ai ishte më i saktë, por, përsa i përket aspektit implicit (zh)vlerësues ndoshta edhe tek idetë e gjuhëtarit të shquar frëng në komparativistikën e pjesës I të sh. XX – Antoine Meillet.[2] Nëse në kohën e Bloomfield-it në Amerikë nuk kishte informa-

[2] A. Meillet, komparatisti më i shquar në botën frënge dhe nga më dominuesit në kohën e tij, edhe pse nuk ishte njohës i shqipes, siç ishte i gjuhëve të tjera dhe i armenishtes, kishte lënë ndonjë shënim lidhur me pozitën e shqipes në raport me gjuhët IE. Në ko-

cion, madje as interesim për shqipen, në kohën e dy autorëve të tjerë kjo nuk mund të thuhet.

Më duket se në këtë kohën e dytë, tek vazhduesi i gjuhësisë strukturale distribucionale H. Gleason gjejmë tashmë një raport pak më specifik për sistemin zanor të arbërishtes të marrë pikërisht te disertacioni i Hamp-it i vitit 1954. Kuptohet, e gjithë kjo nuk do të thotë shumë nga aspekti sasior, por ka rëndësi për njëfarë kthese që po vinte në botën amerikane lidhur me konsideratat për shqipen dhe ajo kthesë, gjithsesi gjithnjë kryesisht vetëm në botime të veçanta e specifike, më duket, do lidhur pikërisht me Hamp-in. Kuptohet, studimet dhe dijet për shqipen kishin shënuar tashmë disa suksese. Le të përmendim këtu fillimet fare me studimet e G. S. Lowman-it për të folmen e Shkodrës, pastaj punën me shumë interes të folkloristëve M. Parry e A. Lord (të cilët kishin theksuar më shu-

hën e tij H. Pedersen-i, po ashtu autoritet i madh në indoeuropeistikë dhe në albanistikë e armenistikë, sidomos lidhur me nyjëtimin dialektor të gjuhëve IE, i kishte shfaqur tashmë idetë për tri radhët e guturaleve IE në shqipen dhe për pozitën e saj specifike në raportet ndarjen centum/ satem, ashtu si lidhur me ndikimet latine-romane në shqipen dhe vlerësimet ekzagjeruese të G. Meyer-it, pastaj lidhur me shkallën e dallimeve dialektore të shqipes dhe shumë gjëra të tjera thelbësore për konceptimet që shfaqte Meillet lidhur me raportet gjuhë-kulturë-komb-shtet, e që për shqipen nuk ishin mbajtur parasysh. Po në atë kohë tashmë kishim një numër gramatikash të shqipes, përfshirë atë të Pekmezit (1908), që mund të flisnin edhe për zhvillime të tjera nga ato që merrte me mend Meillet në raport me gjuhën e shkruar dhe funksionet e saj qytetëruese. Meillet-ja, megjithatë, e konsideronte të nevojshme që në kuadër të vlerësimeve për gjuhët e Europës së atëhershme, në raportet midis gjuhës, kulturës, kombit e shtetit në kontekstin kompleks të krijimit të shteteve të reja kombëtare dhe të animeve gjeostrategjike të shtetit frëng të kohës, sidomos në raportet me Serbinë, të shfaqte qëndrime dukshëm zhvlerësuese për shqipen, duke mbitheksuar aspektin e huazimeve të shumta të saj nga gjuhët historikisht fqinje. Shih për këto vlerësimet si ky: *"L'albanais n'a jamais été l'organe d'une grande nation; il n'a jamais servi à exprimer une civilisation originale. On l'a écrit très tard; les premiers textes qu'on en possède sont du XVIIe siècle. Il n'a donc, à proprement parler, pas d'histoire"* [Shqipja kurrë s'ka qenë organ i një kombi të madh; ajo kurrë nuk ka shërbyer për të shpehur një qytetërim origjinal. Është shkruar shumë vonë; tekstet e para që kemi prej saj janë të sh. XVII. Ajo nuk ka, pra, në një kuptim të mirëfilltë, një histori], (Meillet 1918: 33-34; për një studim të saktë për këto aspekte shih S. Moret: 150). Herë të tjera ai kishte theksuar që shqipja kishte marrë fjalë gjithandej, ndërsa nuk u kishte dhënë gjë të tjerëve, prandaj nuk mund të ishte bartëse e një qytetërimi. Mbi bazë të konsideratave të atilla ai kishte nxjerrë madje edhe përfundime për karakterin, sipas tij, artificial të shtetit shqiptar.

më aspektet sllavistike), botimin e veprës së Pedersen-it për studimet gjuhësore të sh. XIX, ku raporti për studimet shqiptare zinte hapësirë me rëndësi, studimet e autorëve shqiptarë si S. Skendi, A. Pipa, botimet e ndryshme për mësimin e shqipes, botimin e *Gramatikës strukturale* të L. Newmark-ut, etj. Me veprimtarinë Hamp-it mund ta kenë një lidhje dhe nismat serioze të studiuesve si Martin Huld me veprën e tij *Basic Albanian Etymologies* (1984), ku në materialet e shqipes sprovoheshin dhe risimet në studimet në këtë fushë tashmë gjithandej të njohura nga Hamp-i e të tjerë, jepej informacion i gjerë dhe kritik për vendin e shqipes në kuadër të gjuhëve IE, të teorive për prejardhjen e saj, etj. Si rezultat i avancimeve të shënuara në pjesën II të sh. XX, mund të referojmë dhe informacionin e përmbledhur, por relativisht të plotë e të saktë në një vepër si ajo e Benjamin Fortson për një publik më të gjerë, jo vetëm albanistik.

Benjamin W. Fortson IV në tekstin e tij të autoritetshëm për gjuhësinë e krahasuar IE[3] jepte një pasqyrë, ku thuhej se shqipja përbën degë të veçantë të indoeuropianishtes, se lidhur me prejardhjen e saj ka diskutime, se supozimi për prejardhjen nga ilirishtja ka kuptim gjeografikisht, por është i patestueshëm (më gjerësisht shih Ismajli 2015: 79-81).

Anëtarë të Vatrës me Presidentin Woodrow Wilson më 1918.

Studimet për shqipen, mësimdhënia për të dhe interesimet për botën shqiptare në Amerikë janë të ndërlidhura me historinë e pranisë shqi-

[3] Fortson IV 2004, B. W.: *Indo-European Language and Culture. An Itroduction*, f. 390.

ptare atje qysh nga fundi i sh. XIX, që u intensifikua në fillim të sh. XX. Organizimet rreth shoqatave atdhetare e kulturore të shqiptarëve kryesisht nga krahinat jugore morën impulse të reja me praninë atje të intelektualëve si Kostë Çekrezi, Sotir Peci, Fan Noli, Faik Konica, etj., që zhvilluan veprimtari kulturore e kombëtare, studimore e tjetër me dekada. Ajo veprimtari shumë e dobishme për atdhetarinë dhe për zhvillimet e tjera shqiptare në Amerikë dhe në atdheun e largët, prodhoi dhe vepra me rëndësi: të Nolit, të Konicës, të Çekrezit , etj.

Interesimet për gjuhën, kulturën dhe historinë shqiptare në SHBA morën impuls me vendosjen dhe forcimin e komunitetit shqiptar në Amerikë. Organizimet brenda këtij komuniteti dhe lidhjet e tij me atdheun kanë bërë që studimet shqiptare në këtë vend të merrnin intensitet, cilësi e përmasa gjithnjë e më të mëdha. Ka historianë dhe publicistë shqiptarë që thonë se kjo rrjedhë pozitive mori mbështetje të re pas përkrahjes që presidenti W. Wilson do t'i ketë bërë parimit të vetëvendosjes dhe mbrojtjes së shtetit shqiptar në rrethana të vështirësive.

Vepra e K. Çekrezit e vitit 1919, e ribotuar në new York më 1971

Në qoftë se në pjesën e parë të sh. XX figurat e shquara të dijes nga komuniteti shqiptar i Amerikës, si Konica, Noli njëherësh qenë figura të shquara në atdhe, jo vetëm të dijes, po edhe të jetës publike e politike të vendit, kjo flet mjaft për peshën që kishte ai komunitet. Mërgata shqiptare në ShBA më vonë ka jetuar faza të ndryshme zhvillimi, duke e përdegëzuar veprimtarinë në fusha specifike shkencore. Pjesa e dytë e sh. XX ishte koha kur këto studime morën impulse të reja, sidomos me largimin e shumë intelektualëve nga vendi pas LDB-së.

Një brez tjetër intelektualësh veprimtarinë e vet e shihte në radhë të parë në shkencë. Le të kujtojmë me këtë rast punën shkencore-hulumtuese të Stavro Skendit, të Arshi Pipës, të Safete Sofie Jukës, të Sami

Repishtit, të Nikolla Panos, të Peter Priftit, etj. Ata dhanë ndihmesa me vlerë për studimet shqiptare gjithë duke i shkrirë ato në rrjedhat amerikane dhe ndërkombëtare.


GEORGE CASTRIOTI SCANDERBEG

(1405-1468)

by

BISHOP FAN STYLIAN NOLI, Ph.D.

INTERNATIONAL UNIVERSITIES PRESS
NEW YORK NEW YORK


TO THE LOYAL MEMBERS
OF THE PAN-ALBANIAN FEDERATION
VATRA
AND TO ALL THE ALBANIAN FRIENDS IN AMERICA
WHOSE GENEROSITY
HAS MADE THIS BOOK POSSIBLE

August, 1947 F. S. N.

Ballina dhe faqja e përkushtimit e veprës së Nolit: George Castrioti Scanderbeg (1405-1468), botim i International Universities Press, New York, 1947

Pas vendosjes së komunizmit te shqiptarët e Ballkanit pati një fazë prej disa dekadash kur kontaktet me amerikanët qenë vështirësuar, pos në rastet kur diaspora gjithnjë e më e organizuar merrte përsipër veprimtari. Në vitet ’70-’80 të sh. XX këto kontakte morën një shtysë të re, tani përmes zhvillimeve që vinin nga Kosova. Nga viti 1974 Seminari për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare qe hapësira e selitjes së kontakteve dhe të studimeve shqiptare duke u shtuar zhvillimeve të mëhershme dimensionin Kosova. Prania e Kosovës në Amerikë u shtua pas viteve ’80, ndërsa ndihma e diasporës për zhvillimet shqiptare në Ballkan dhe për mbështetjen e ShBA-së në të gjitha drejtimet u bë më e fuqishme se kurrë më parë. Le të themi se në Prishtinë u realizuan mjaft kontakte të frytshme të studiuesve amerikanë me botën kulturore shqiptare: E. P. Hamp qysh në vitet ’50 e sidomos pas viteve ‘70, J. Byron në vitet ’60, e të tjerët – L. Newmark, G. Bevington, V. Friedman, M. Huld, B. Joseph, M. Curtis e të tjerë më vonë.

Më duket se këtu është vendi të themi pak fjalë më specifike për

studimet amerikane për shqipen. Prania shqiptare në Amerikë ishte përthyer dhe në interesimin e qarqeve akademike amerikane për shqipen dhe studimet shqiptare. Por ato studime u zhvilluan gjithnjë në kuadër institutcional të studimeve të Europës Juglindore, të studimeve romanistike, sllavistike, të gjuhësisë, por asnjëherë nuk u arrit të institucionalizohej në një njësi të veçantë akademike që do të merrej vetëm me shqipen dhe botën shqiptare. Ka pasur përpjekje serioze nga diaspora, por pa sukses. Institucionet shtetërore e kulturore shqiptare në Shqipëri dhe në Kosovë nuk kanë shfaqur ndonjë interes të veçantë për të bërë diçka më serioze në këtë drejtim. As autoritetet akademike amerikane.

Studimet më të zhvilluara të gjuhësisë amerikane në sh. XX, strukturalizmi deskriptivist me përjashtimet që u përmendën më herët dhe gjenerativizmi me N. Chomsky-n pas viteve ’50 kanë lënë pak gjurmë në studimet për gjuhën shqipe. Për fat, pak para fillimeve gjenerativiste-transformacioniste, u shqua albanologu dhe linguisti E. P. Hamp. Fryma e atyre studimeve hetohej dhe në studimet gramatikore-dialektore. Mund të thuhet se orientimet e Hamp-it në studimet krahasuese indoeuropiane, prania e tij e vazhdueshme me botime, po edhe me nxitje të të rinjve në këto studime ndihmuan të krijohej një horizont tjetër për gjuhën shqipe në Amerikë dhe sollën rezultate në fushën e historisë/ parahistorisë së gjuhës dhe një numër të madh etimologjish të fjalëve shqipe nëpër organet shkencore gjithandej nëpër botë. Njëlloj vazhdimi i interesimeve të atilla janë studimet etimologjike të Martin Huld-it. Dhe nuk është e rastit që tani në veprën përfaqësuese për gjuhësinë e krahasuar indoeuropiane të B. Fortson 2004 kemi një pasqyrë më të saktë dhe relativisht përfshirëse, të matur, për shqipen.

Studimet gjenerative për shqipen në ShBA, me sa di, kanë qenë më të pakta. Shquhet vepra e G. Bevington-it *Albanian Phonology*, ndërsa për sintaksën, pos disa përpjekjeve të K. Kazazis-it, kemi pak gjë. Një sprovë më serioze në këtë drejtim erdhi nga Gjermania me O. Buchholz, e më vonë nga arbëreshët me G. Turanno, shqiptarja Kallulli, etj. në Europë. Si të shpjegohet kjo heshtje e lëvizjes më të madhe linguistike në Amerikë, pos me mungesën e njohësve të shqipes së gjallë? Do thënë po ashtu se izoli-

mi i botës shqiptare e kishte ulur interesin për të dhe për gjuhën e saj, prandaj edhe për njohjen e gjuhësisë shqiptare, e cila më shpesh ishte larg nivelit të kohës.

Impenjime serioze në studimet e strukturës së shqipes ndeshim te gjuhëtari L. Newmark (1928) nga Universiteti i San Diegos, i cili qysh më 1957 botoi *Gramatikën strukturale të shqipes*, një përshkrim serioz i të folmes së Beratit mbi bazë të materialeve të vjela nga informatorët e mërguar. Më vonë ai do të botojë libra mësimi dhe doracakë të ndryshëm për mësimin e shqipes, për të arritur një kulm të ri më 1980 me botimin e *Standard Albanian* (bashkë me Ph. Hubbard dhe P. Prifti), që do të bëhet një nga veprat ndërkombëtarisht referenciale në këtë fushë. Profesor Newmark, mysafir i Seminarit të Prishtinës, botoi fjalorin e madh shqip-anglisht të tipit Oxford dhe tjetrin ndjeshëm më të madh. Profesor Newmark është anëtar i jashtëm i AShAK-ut nga viti 2000. Ph. Hubbard po ashtu është shquar për studimet gramatikore në fushën e foljeve.

Nëse mund të konstatohet një si heshtje e studimeve gjenerative-transformacionale për shqipen në Amerikë,[4] kjo nuk mund të thuhet për lëvizjen tjetër të madhe të viteve ’70 – të sociolinguistikës, ku hynin dhe studimet për gjuhën standarde, për kontaktet midis gjuhëve, etj. Janet Byron është një studiuese me shumë rëndësi në fushën e standardologjisë shqiptare. Me monografinë për përzgjedhjen midis alternativave në gjuhët standarde – rasti i shqipes, si dhe dy studime të mëvona për rrjedhat e standardizimit të shqipes në Kosovë në revistën *Word*, ajo ka dhënë një ndihmesë me peshë në orientimet sociolinguistike të studimit të shqipes. Duke vepruar kështu në vitet e vona ’70, ajo jo vetëm që po e sillte sociolinguistikën në studimet shqiptare pikërisht në kohën kur po niste lulëzimi i kësaj disipline, por edhe problematikën e shqipes e lanconte në majat e rrjedhave të tilla në botë. Janet Byron ka qëndruar në Prishtinë një kohë më të gjatë në vitet 1967-68.

Rezultate në këto fusha ka shënuar dhe Lukas Tsitsipiis me veprën e tij për gjendjen e arbërishtes në Greqi dhe rrezikun që e kanoste dhe va-

[4] Nuk ka mbetur pa u shënuar qëndrimi negativ i Chomsky-t lidhur me zhvillimet në Kosovë dhe proceset e çlirimit dhe të pavarësimit të saj, as afrimi i tij me qarqe të caktuara në Akademinë Serbe.

zhdon ta kanosë vdekja gjuhësore. Ndërkaq, tash vonë kemi studimin e M. Curtis për kontaktet e shqipes me serbishten, fushë në të cilën janë angazhuar edhe Pennington e të tjerë.

Rezultate të frytshme për shqipen në botën amerikane janë shënuar në kuadër të studimeve të Europës Juglindore, ku prijnë anëtari i jashtëm i AShAK-ut Victor Friedman, profesor i Universitetit të Chicago-s dhe profesor Brian Joseph nga Ohio State University, i cili shquhet po ashtu me depërtimet në fushat morfosintaksore të studimeve ballkanike. Friedman-i, specialist i maqedonishtes, njohës i të gjitha gjuhëve ballkanike dhe i gjuhëve turke e kaukaziane, shumë shpesh e ka pasur shqipen në qendër të vëmendjes së studimeve të tij, për çka dëshmon dhe vepra e rëndësishme *Studies on Albanian and ther Balkan Languages* që botuam te Dukagjini para 10 vjetësh. Specialist i sistemit foljor, ai tashmë njihet ndërkombëtarisht për interpretimet e reja të admirativit, por edhe për studime të aspekteve të tjera të shqipes, të kontakteve me gjuhët e tjera, të interpretimeve sociolinguistike, etj. Bashkë me Brian Joseph-in ata kanë krijuar një pasqyrë përmbledhëse shumë më të përshtatshme për studimet ballkanike, ku shqipja zë një vend shumë të rëndësishëm. Depërtimet e Joseph-it me studimin e thelluar për infinitivin në gjuhët e Ballkanit, e bëjnë atë aktualisht nga më këmbëngulësit në botën ballkanistike në studimet e morfosintaksës.



Në ShBA ka pasur dhe depërtime në hartimin e teksteve të mësimit të shqipes, ndër të cilat shquhen ato të Newmark-ut, të Priftit e më vonë të Zymberit, të Mënikut. Atje është botuar *Gramatika* e Camajt.

Në Amerikë ka pasur dhe zhvillime të tjera në fushën e studimeve shqiptare, sidomos në fushat e historisë dhe të kulturës. Në ato fusha janë hetuar studimet për folklorin të Parry-Lord, për historinë kulturore të Rilindjes dhe alfabetin të Skendit, për metrikën, historinë e letërsisë dhe De Radën të Pipës, për çështje të ndryshme historiko-politike të Priftit, për çështje historike për Kosovën të Safete Sofie Jukës bashkë me të shoqin Leo Freundlich, për çështje të të drejtave të njeriut dhe të të drejtave të shqiptarëve të Kosovës të Repishtit, për interpretimet politiko-historike të Panos, Biberajt, etj. Kohët e fundit në fushën e letrave, të kulturës shquhen Robert Elsie nga Kanadaja, Alexander Fox, etj. Albanologjia në ShBA nuk kufizohet vetëm në gjuhësi. Në fushat e tjera, si histori, etnologji, politologji ka pasur po ashtu rezultate me vlerë. Mjafton të përmendim këtu autorë si etnologen britanike Antonia Yung, historianin tashmë të shquar Bernd Fisher, politologun Janusz Bugajski, e të tjerë.

Ajo që bie në sy në këto zhvillime, sidomos sa i përket angazhimit të studiuesve amerikanë për gjuhën shqipe, është një paqëndrueshmëri në studimet: nëse Eric Pratt Hamp, Leonard Newmark, Victor Friedman e ndonjë tjetër nuk i janë ndarë studimit të shqipes pavarësisht nga qendra institucionale, nuk mund të mos vërejmë se, në raport me numrin e përgjithshëm të studiuesve që janë marrë me shqipen, relativisht shumë syresh i ka braktisur ato ose i ka lënë në margjina pikërisht në kohën kur

kanë dëshmuar rezultate të një niveli të lartë. Do të përmend këtu rastet si Gary Bevington që iku të merret me gjuhë gjeografikisht më afër të indianëve maja, Janet Byron që vazhdon me anglishten për mjekësi, Philip Hubbard me informatikë, Martin Huld gjuhësi krahasimtare e sllavistikë, e të tjerë. Arsyet për largime të tilla mund të jenë nga më të ndryshmet. Por unë nuk jam i sigurt nëse pikërisht mungesa e një qendre të institucionalizuar për studimet e shqipes nuk do të ketë qenë një arsye që qëndronte prapa të gjithave. Institucionet në Shqipëri, në Kosovë, po edhe diaspora nuk ia kanë dalë të gjenin mënyra për t'i mbajtur specialistët e tillë më gjatë të lidhur me studimet për shqipen. Kjo gjë ka ndodhur shpesh dhe në vendet europiane. Dikush mund të përpiqet që këtë ta shpjegojë me izolimin, çka gjithsesi qëndron, por më duket se duhet të ketë dhe mungesa të tjera (nga izolimi komunist kemi dalë tashmë një çerek shekulli). Më duket, sido që të jetë, që të gjitha këto e ritheksojnë nevojën për themelimin e një qendre të tillë institucionale për studimet e shqipes me veprimtari të përhershme, që do të shërbente dhe si një vatër për këto studime në tërë Amerikën.


DUSHKO VETMO

BUBUQE T'EGRA

BUENOS AIRES

1946

Ballina e librit me poezi të Dushko Vetmos (Francesco Solano), Buenos Aires 1946

Studiues të tjerë, që albanistikën nuk e kanë pasur fah të parë, kanë sjellë një dinamizëm në këto studime duke iu kthyer shqipes edhe nga portat e ballkanistikës, të sllavistikës, të romanistikës, si Friedman, Joseph etj., që sot i mbajmë shpesh nxitës idesh të reja në këto studime.

Diaspora shqiptare në Amerikë, sidomos me intelektualët e shquar si Sami Repishti, Arshi Pipa, Sofie Sanie Juka në pjesën e dytë të sh. XX, me angazhimet e tyre në fushën e shpjegimit të konteksteve historike, shoqërore dhe të të drejtave të njeriut e të tjera të shqiptarëve në ish-Jugosllavi (me një pikë të rëndësishme me Konferencën e vitit 1982 me botimin *Studies on Kosova*)

dhanë ndihmesë serioze për të kuptuarit e këtij konteksti për qarqet e rëndësishme amerikane. Në fushën e kulturës e të informimit ka pasur dhe vazhdon të ketë mjaft punë me vlerë, nga të cilat këtu po përmend Gjek Gjonlekajn me shtëpinë e tij botuese, Hari Bajraktarin me themelimin e gazetës *Illyria*, Ekrem Bardhën, Din Dertin e të tjerë (këtu e kam të pamundur të numëroj të gjithë) me ndërmarrjet e tyre organizuese, publicistët e gazetarët si Elez Biberaj, Vebi Bajrami, Ramadan Gashi e të tjerë. Nuk duan harruar as ndihmesat e brezit të sotëm, për çka prisnim të kishim një informacion më të plotë nga pjesëmarrës të paralajmëruara të këtij tubimi, ashtu si vazhdimi i veprimtarisë së *Këshillit Shqiptaro-Amerikan*, *Vatrës* e të gjithë mekanizmave të tjerë që veprojnë atje. Kërkoj ndjesë që nuk jam në gjendje t'i përmend të gjithë me këtë rast, por besoj se pajtohemi që ata kanë bërë punë me shumë vlerë për mbajtjen gjallë dhe nxitjen e interesimit për studimet albanistike në Amerikë.

Në këtë Konferencë, sipas informatave të përfshira në abstraktet e dërguara, presim të marrim informacione burimore lidhur me përpjekjet për institucionalizimin e këtyre studimeve në ShBA. Disa prej tyre na kanë arritur dhe botohen këtu.

Në gjendjen që jemi mund të themi se studimet albanistike në ShBA kanë dhënë ndihmesë me vlerë për njohjen e botës shqiptare në ato hapësira dhe në botë, kontribute për dijen në këto fusha në përgjithësi dhe e kanë ndihmuar miqësinë midis dy popujve. Për studimet albanologjike kjo traditë paraqet një degë të rëndësishme në rritje.

Nuk jam i sigurt, ndërkaq, se studimeve amerikane për gjuhën shqipe deri tash u kemi dhënë hapësirë të mjaftueshme ndër ne. Për një pjesë për këtë mungesë ka pasur dhe arsyetime që dalin përtej nesh, kanë qenë rrethanat e pavolitshme. Ka ardhur koha kur nuk arsyetohen më as në Kosovë as në Shqipëri mungesat e lidhjeve institucionale me të interesuarit në këto fusha në këtë vend mik. Nga bashkëpunimi më i ngushtë studimet albanistike vendëse do të përfitonin nga nivelet e larta të dijeve amerikane në gjuhësi dhe në fushat përreth, por edhe dijetarët amerikanë në këto fusha mund të kishin përfitimet e tyre nga ky bashkëpunim, do të për-

fitonte shkenca. Dhe, natyrisht, miqësia midis popujve tanë. Të shpresojmë se në këtë drejtim do ta kemi dhe mbështetjen e institucioneve vendëse dhe amerikane të pranishme në Kosovë. Këtij qëllimi duhet t'i shërbejë edhe kjo konferencë.

Shtojcë

Po sjellim këtu edhe një koment të Eric P. Hamp-it që ma kishte dërguar me rastin e botimit të veprës së tij shqip, po që arritëm ta vendosnim në libër vetëm si Shtesë (arriti vonë). Fjala është për një koment të tij lidhur me një teskt sllavisht të sh. 16, ku mund të vërehej ndikimi i shqipes.

Tipare dialektore perëndimore te Damaskini i sh. 16

P. Ilievski në analizën e tij të shkëlqyeshme dhe depërtuese (*Makedonski jazik* 11/12 1960/61) të përkthimit të Damaskin-it të viteve 1560-1580 vendos proveniencën jugperëndimore (Ohër) të këtij dokumenti dhe përmend disa tipare (f. 50), përfshirë ъ të Ohrit për *á*. Sido që të jetë, në bazë të regjistrimit të B. Vidoeski-t (*Mak. jaz*. 11/12, 21-6) të tipareve që dallojnë grupimet themelore dialektore të maqedonishtes, mund të identifikojmë disa tipare shtesë si dallueshëm perëndimore nga të tjerët që Ilievski i analizonte si modernizma (Numërimi këtu ndjek atë të Vidoeski-t, ve. e cit.).

4. Variacioni drejtshkrimor *обуъ/ е* shfaq [*е*] perëndimore.

16. Format me *-нь* dhe *-се* shfaqin zhvillimin e nyjës semantikisht treshe, edhe në qoftë se format sipërfaqësore ende nuk ishin vendosur.

33. Një shembull i mirë i formës së shkurtë përemërore që parashkon foljen është *ти* заповедую *вьстани*.

36. Një shembull i shkëlqyeshëm i objektit të dyfishuar është: *Прочес Хс҃ь ни гостить нась ‘λοιπόν ὁ Χς Φιλεύει μας’.*

Meqë tipari #22 (3 njëjës e tashme *-т*) është shkelur, është e mundshme që ky arkaizëm, tani (1960-70) vetëm në perëndim të Manastirit dhe Prilepit të ketë ndryshuar gjatë shekujve të mëvonë.

Një veçori shumë interesante e sintaksës është dhanorja posesive (*мати царю, гь мироу*). Ky ndërtim rasor sugjeron një prejardhje, ose së paku përforcim, nga një gjedhe shqipe, si rezultat i një ndërndikim dygjuhësor. Në shqipen për së paku një mijë vjet (1500 të rindërtuara) format e gjinores dhe të dhanores sipëriaqësore të emrave kanë qenë të njëjta, dhe tashmë 2000 vjet në latinishten e Danubit (& në gjuhët e atjeshme vendëse).

Nga ana tjetër, zhvillimi i më të hershmes *на* me vlerë dhanore drejt vlerës posesive (gjinore) është pjesë e një zhvillimi më të përgjithshëm pas-roman, për çka tash ka studime të përditësuara dhe të stërholluara (cito referenca) [këtu me shigjetë ka udhëzuar: pyet Victor F., Brian J.]).

Eric P Hamp ca 1975

University of Chicago

2007

DEC-04-2007 2:33PM FROM- T-786 P.004/005 F-607

Rexhep -- një copë të bakurisë.
përsëtmëshim nanë

Western Dialect Features in the 16th-century Damaskin

P. Ilievski, in his excellent and perceptive analysis (Македонски јазик 11/12, 1960/61,) of the 1560-'80 translation of Damaskin, establishes the southwestern (Ohrid) provenience of this document and mentions (p.50) certain features, including the Ohrid ъ for stressed ă.

pp.?

On the basis, however, of B. Vidoeski's listing (Мак. Јаз. 11/12, 21-6) of features which distinguish the basic dialect groupings of Makedonski, we may identify certain additional features as being distinctively Western from among the traits analyzed by Ilievski as modernisms. (The numbering here follows that of Vidoeski, op.cit.)

4. The spelling variation Обѣ/е shows Western [e].

16. The forms in -ив and -се show the development of the semantically triple article, even though the surface shapes have not yet settled down.

33. A good example of the short pronominal form preceding the verb is ти заповедуе бесѣдами.

36. An excellent example of the doubled object is Прозе Хс҃ѣ ни посѣдоуе нас 'λοιπὸν ὁ Χς φιλεῖ μας'.

Since trait #22 (3 sg. pres. -ѣ) is violated, it is possible that this archaism (now only west of Bitola and Prilep, 1960-70), has shifted over recent centuries.

A highly interesting feature of syntax is the possessive dative (Матѣи мирно, Гѣ мирноу). This case construction suggests an origin, or at least reinforcement, in an Albanian model, as a result of bilingual

interference. In Albanian for ~~perhaps~~ at least (1500 reconstructed) a thousand years the surface genitive and dative forms of nouns have been identical, and for 2000 years now in Danube Latin (& their hom languages).

On the other hand, the development of earlier на with a dative value to a possessive (genitive) value is part of a more general Balkan post-Roman development, for which there are now updated and refined studies (cetera).

Eric P. Hamp ca. 1975
University of Chicago
2007

ask Victor F.
Brian J.

Bibliografi

Berberi, Dilaver. 1964. *Phonological and Morphological Adaptation of Turkish Loanwords in Contemporary Albanian Geg Dialect of Kruja: A Synchronic Analysis*. Indiana University.

Bevington, Gary L. 1974. *Albanian Phonology*. Wiesbaden, Albanische Forschungen.

Bloomfield, Leonard 1970 (1933): *Le langage*, Avant-propos de Frédéric François, traduit par Janick Gazio, Payot, Paris.

Byron, Janet L. 1976. *Selection Among Alternates in Language Standardization: The Case of Albanian*. The Hague: Mouton.

Newmark, Leonard D. 1955. An Outline of Albanian (Tosk) Structure. Indiana University.

Hamp, Eric P. 1954. Vaccarizzo Albanese Phonology: The Sound-System of A Calabro-Albanian Dialect. Harvard University.

Wescott, Roger W. 1948. A Comparative Grammar of the Albanian Language. Part I. Phonology. Princeton University.

Sabri HAMITI, AShAK, Prishtinë

UJDHESA E SHPËTIMIT [Letërsia shqiptare në Amerikë]

1. Zbulimi i Amerikës

Shqiptarët e zbuluan (gjetën) Ujdhesën e Shpëtimit, Amerikën, dy herë në shekullin njëzet. Herën e parë në fillim të shekullit, pas lëvizjes pavarësiste të Ismail Qemalit, herën e dytë në fund të shekullit, pas lëvizjes pavarësiste të Ibrahim Rugovës. Në të dyja rastet (ashtu si gjatë gjithë shekullit) mbas lëvizjeve shqiptare për liri, në turbullimet etnike e politike të Ballkanit, të ndikuara nga interesat politike e ideologjike të vendeve evropiane, janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës që, nëpërmjet Uilsonit e Klintonit, mbrojtën të drejtën shqiptare për vetëvendosje, u bënë shpëtimtarët e drejtpërdrejtë të tyre. Kjo, tashmë është një e dhënë historike që është kthyer në perceptim popullor e ndjesi kombëtare, për një miqësi ndërmjet elitave dhe të popujve. Mbijetesa dhe veprimtaria e kampionëve të pavarësisë shqiptare është zhvilluar e varur nga vajtje e ardhjet e nga marrjet e dhëniet politike, diplomatike e kulturore ndërmjet botës shqiptare e botës amerikane.

2. Për liri e ekzistencë

Lakimi ndërmjet filozofisë së ekzistencës dhe të lirisë kombëtare e individuale është sprova e rëndë e njerëzve ilustrativë të shqipes, që si europianë kanë zënë në thua në Evropë, ngrihen në këmbë dhe pikëmbështetjen e gjejnë në Amerikë, duke gjetur shpëtimin; edhe për të provuar forcën e vullnetin e kthimit për ta kapur pikën e mbështetjes në dheun e nënës. Kjo është një aventurë e cila prodhon shndërrimet (ndryshimin)

qoftë si dije universale, qoftë si përvojë personale. Ky fenomen mund të argumentohet me disa personalitete të njohura të kombit e të kulturës shqiptare gjatë shekullit njëzet. Do të evidentojmë shembujt apo rastet e Fan S. Nolit, Faik Konicës, Arshi Pipës e Bilal Xhaferrit. Provat e gjithsecilit janë të veçanta edhe të ndryshme, edhe pse janë bërë në kohë e në rrethana të ndryshme, edhe pse kanë qenë varur nga karakteret e tyre, formimet, ideologjitë. Prej këndej edhe perceptimet e tyre për relacionet me Amerikën dhe vetëvlerësimin janë të ndryshme. Po të gjithë kanë një të përbashkët: janë nisur nga Këtu e kanë mbërritur Atje. Pra, shtrohet pyetja e rëndë: *me shkue, me shkue a do të thotë me mbetë?* A është Ujdhesa dera e Shpëtimit? A është kthyer ndokush nga Amerika? Noli e Konica, Pipa e Xhaferri, kanë ndërruar jetë në Amerikë. Eshtrat e Konicës e të Xhaferrit janë kthyer në Shqipëri, por jo të Nolit e të Pipës. Mbeten të karakterizohen puna në Shqipëri e në Amerikë, dhe relacioni me vendin duke qenë mbrenda, apo duke e parë nga jashtë. Kjo ka krijuar një tipologji të sjelljes; që nga retorika militante e mobilizuese e Fan Nolit:

Mbahu, Nëno, mos kij frikë,
Se ke djemtë n'Amerikë. [1]

që përsëritet si trimërim e lutje në rrethana; deri te kritika që kalon në rezignim e Bilal Xhaferrit, me trajtën:

Nëno, moj, të raft një pikë
I ke djemt në Amerikë.[2]

Të dy formulimet janë shkruar e botuar në Amerikë. Raporti i tyre është raport ndërmjet Odes e Parodisë, por raporti substancial tregon kalimin e modelit heroik e himnizues në modelin kritik.

3. Modeli kritik

Duhet të gjendet diku një mes ndërmjet lypsave krenarë e punëto-

[1] Vjersha: *Jepni për Nënën* (1917), në Fan S. Noli, *Albumi*, 1948.

[2] Artikulli: "Nëno, moj, të raft një pikë, i ke djemt në Amerikë" (1978), në Bilal Xhaferri, *Përtej largësive*, Tiranë, 1996, f. 317.

rëve kokulur; apo më tutje, kërkimi i shqiptarit ideal ndërmjet atij që rritet në përmasat e vendit dhe atij që njeh botën. Pastaj të kalohet në nivelin e krijimit e të botëkuptimit.

Bërja e shqiptarëve është po aq e vështirë, në mos më tepër, se bërja e Shqipërisë, rezonon brezi i Gjergj Fishtës. Dhe kjo vjen mbasi është pjekur e mbaruar poetika e retorika lavdëruese e mitizuese e rilindasve. Kështu hyhet në modelin kritik të ligjërimit shqiptar në lëmi të kulturës e të literaturës. Fishta shkruan *Lahutën e Malcís*, por edhe *Anzat e Parnasit* e *Gomarin e Babatasit*. E, para tij, Andon Zako Çajupi shkruan *Baba Tomorrin*, por edhe *Baba Musa lakuriq*. Me një dallim: Fishta shkroi në Shqipëri, Çajupi shkroi ne Egjipt. Mirëpo, kampionët e modelit kulturor kritik e të shkrimit kritik në shqip janë Faik Konica (1876-1942) e Fan S. Noli (1882-1965), duke nisur me revistën *Albania* (1897) e gazetën *Dielli* (1909), të dy shtegtarë nëpër botën shqiptare e evropiane, për të përfunduar në botën amerikane.

E para, ndryshimi i ligjërimit shqiptar ndodhi si nevojë e mbrendshme me të hyrë në modernitet; po kaq si pasojë e qarkullimit të idesë shoqërore e kulturore që i solli dhe detyroi ky modernitet. Tani që cilësia e komunikimit u kushtëzua nga krahasimi e vlerësimi: njohja e vetvetes dhe raporti me të tjerët. Tani kryqëzimi i rrethanave të mbrendshme me rrethanat e jashtme në fushë të krijimtarisë e të veprimtarisë i bën prijatarët e shkrimit kritik të dyzuar. Kritikë të rreptë për fenomenet e mbrendshme dhe mbrojtës të flaktë të shqiptarëve në botën e jashtme. Për këtë fenomen është ilustrativ rasti i Konicës në *Albaninë* e tij dhe mund të dëshmohet duke krahasuar shkrimet e tij në këtë revistë, ato të shkruara shqip me ato të shkruara frëngjisht. Sivëllau letrar i Gijom Apolinerit nuk e pëlqente lirikën e Naim Frashërit. Një moskuptim kulturor që zgjati një shekull. Të mos flasim veçan për analizat e fenomeneve ideologjike e sociale të botës shqiptare të Konicës e të Nolit, që rrinë përherë në teh të kritikës e të polemikës. Pra, veprimtaria politike e kulturore e këtyre personaliteteve në Evropë e në Amerikë, në distancë nga dheu shqiptar, tashmë nuk i bën vetëm të përmalluar (naimianë), por përkundrazi u krijon komodi-

tetin për kritikën rrënjësore që do ta krijojë ndryshimin. Madje, kjo kritikë, duke u shfaqur si qëndrim individual në fushë të ideologjisë, të kulturës e të artit, do të përfundojë edhe në polemika përmbysëse e likuiduese të njëri-tjetrit. Është çështje tjetër që ata në fazën e qetësisë, kur bien pasionet, edhe do të thonë që u ngjajnë heronjve homerikë, që mbas betejave të pakursyeshme, i japin dorën e nderin njëri-tjetrit. Në këtë vështrim, Konica e Noli, në fund, kanë artikuluar vlerësimet e komplimentet më të larta për njëri-tjetrin, madje Noli e pranon Konicën për mësues të vetin.

Arshi Pipa (1920-1997), kritiku brilant në nisje (1944), madje duke vlerësuar veprën e dy të parëve, apo të autorëve të brezit të ri (tjetër), provon rrezikun e mendimit të lirë kritik në Shqipëri, duke kaluar nëpër burgjet e komunizmit. Arratiset në Amerikë, vijon nxënien e dijeve si një pajë personale për të vijuar kritikën e mprehur nga distanca (nga larg) për fenomenet politike, sociale e kulturore në Shqipëri.

Më i fundit, Bilal Xhaferri (1935-1986), krijuesi autodidakt, poeti i nemun, një i arratisur i përhershëm; një herë nga vendlindja, mandej nga atdheu, përfundon i arratisur në Amerikë, duke marrë me vete atë që kishte dhunti personale: talentin e lindur e rebelimin, të dytë si fat e si kob. Pikërisht për të shtruar sërish pyetjen për Amerikën si ujdhesë të shpëtimit, si ëndërr apo si realitet; veçanërisht në fatin individual të krijuesit.

4. Poetë a kritikë

Kur provojmë të hyjmë në temën themelore të letërsisë shqipe në Amerikë nëpërmjet katër shkrimtarëve të përmendur, nuk mund të mos përgjigjemi në dy pyetje:

E para: një letërsi kritike, a drejtohet domosdo nga qëllime përtejletrare?

E dyta: shkrimtarët shqiptarë në Amerikë, a janë poetë (krijues) apo janë kritikë (riprodhues)?

Autorët e përmendur, Faik Konica e Fan S. Noli, me jetë e me vepër, sikur provojnë që shqiptari ideal nuk është ai që sillet në përmasat e botës

shqiptare, por është ai që vetveten e provon në raport dhe të krahasueshëm me botën e jashtme. Në këtë vështrim historia e raporteve të tyre me Evropën, e veçanërisht me Amerikën, është një histori raportesh kulturore, politike e diplomatike e, më në fund, letrare në epokën e hyrjes në modernitet.

Nëse kërkohet koha e hyrjes shqiptare në modernitet, atëherë kjo lidhet me botimin e revistës *Albania* të Faik Konicës më 1897 në Bruksel. Çështjet e shtruara në revistë, modeli kritik kulturor dhe ligjërimi kritik letrar bënë një prerje me periudhën pararendëse dhe diskursin e saj nacional e letrar. Këto karakteristika do të shfaqen në tekstin e autorëve, t'i quajmë të viteve 1900, si Andon Zako Çajupi, Gjergj Fishta, Aleksandër Drenova, Fan S. Noli e Midhat Frashëri, të cilët përcaktojnë etapën paramoderne të letërsisë shqipe. Shkrimet e këtyre autorëve u botuan te *Albania*, po ashtu te *Albania* u bë vlerësimi i këtyre autorëve nga pena e vetë Faik Konicës. Para, Konica u bë promovuesi i këtij modeli kritik, pikërisht duke vënë në krizë vlerësimin e përparshëm të autorëve romantikë-rilindës, nisur nga Jeronim de Rada e Naim Frashëri, dhe duke strukturuar vlerësimin e ri për brezin e vet letrar.

Ky proces kritik nisi si ndryshim i ligjërimit social e kulturor, për të kaluar dhe në nivelin e ligjërimit kritik letrar, gjë që nuk kaloi pa tronditje, moskuptime e keqkuptime në botën shqiptare. Po ky ligjërim kritik me bazë më të gjerë letrare, ngadalë do të prodhojë një ngjyrim kritik në krijimtarinë letrare të anëtarëve përfaqësues të brezit, për të prekur statusin e tekstit të strukturuar nga humori e satira dhe duke përfshirë format letrare nga epika në lirikë, në prozë e në poezi, madje edhe në dramë.

Sa u përket dy autorëve kritikë të modernitetit, Faik Konicës e Fan S. Nolit, krijimtaria e tyre letrare me ngjyrim të fortë kritik rreth botës shqiptare lidhet me jetën e tyre në Amerikë dhe me vitet '20 të shekullit njëzet.

Evidencat historike thonë: Fan S. Noli shkoi në Amerikë më 1906 si njëzet e katër vjeçar; Faik Konica shkoi në Amerikë më 1909, si tridhjetë e pesë vjeçar, mbasi përmbylli veprimtarinë botuese në Evropë, dhe u ta-

kuan atje për herë të parë për të vazhduar te *Dielli* e *Vatra* veprimtarinë botuese.

Faik Konica e botoi te *Dielli* tregimin alegorik-satirik *Një ambasadë e Zulluve në Paris*, më 1922; duke thumbuar realitetin social të shqiptarëve në një ballafaqim me botën. Po te *Dielli*, më 1924, botoi romanin e pambaruar *Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit*, një provë e parë e romanit satirik në letërsinë shqipe, duke bërë kirurgjinë e botës shqiptare, tani të situuar në Shqipëri, kryesisht në Tiranë, duke tallur e duke përmbysur mentalitetin sidomos të shtresave pushtetore. Më 1929, Konica botoi te *Dielli* esenë *Shqipëria si m'u duk*; një kritikë edhe më e hapur e shoqërisë shqiptare, me një vështrim të veçantë për *levantinizmin*, si sëmundje të rrezikshme të tjetërsimit. *Shqipëria kopshti shkëmbor i Evropës juglindore* doli si vepër postume e Konicës, më 1957, përgatitur nga Qerim Panariti; një vepër që mëton të paraqesë shqiptarët si janë e si duken para vetvetes e para të tjerëve. Në të gjitha këto vepra Konica u shfaq një stilist brilant në shqip, madje u klasifikua si themelues i prozës së dialektit toskë, mandej edhe themelues i prozës moderne shqipe.

Fan S. Noli e botoi në Boston, më 1907, dramën *Israilitë e Filistinë*, me gjasë të shkruar pesë vjet më parë kur ishte në Greqi. Autori e quan veprën e vet 'sqelet dramë' e 'dramë foshnjë'. Mirëpo tema biblike për Samsonin në veprën e Nolit bëhet *sqelet* e *foshnjë* e dramatizimit të ideve të autorit: për kulturat si komunikim e si përjashtim, vullnetin për pushtet nëpërmjet forcës apo nëpërmjet bindjes, pësimin e racionales përpara pasionit (Samsoni verbohet nga tërheqja, joshja, dashuria e Daliles); për imtime tematike idesh që do të marrin trajta të zhvilluara në vepra të mëvonshme. Noli më 1948 botoi në Boston *Albumin* e lirikave origjinale, të cilat i kishte botuar kryesisht në vitet '20, kur vepronte i syrgjynosur në Evropë. Këto janë poezi për të ndodhurat, më shpesh okazionale, me një diskutim të fuqishëm retorik, me një kumbim të ligjëratës bindëse, qoftë kur artikulojnë dhimbje me ton elegjiak, qoftë kur mbi situatat biblike mbindërtojnë situata aktuale nëpërmjet alegorisë e simbolit, pa i fshehur aspak shenjat autobiografike. Te libri *Pesëdhjetëvjetori*, që doli më 1960 u

botua edhe *Autobiografia* e Fan S. Nolit, një prozë personale e shkruar në veten e tretë, e cila jep dëshmi për jetën e kryepersonazhit Fan S. Noli, skicon karakterin e tij, dhe në fund mund të lexohet edhe si testament kulturor, tepërt i rëndësishëm si çelës i leximit të veprave të tij pararendëse.

Atëherë, ky ligjërim letrar, satirik e polemik përballë njëmendësisë shqiptare, për disa dhjetëvjetësha, a ruajti këto cilësi edhe në komunikimin publik me shkrim ndërmjet dy kampionëve të pavarësisë? Po, madje një stil nervoz e me temperament që gati përherë kaloi në nivel të polemizimit, qoftë kur e rrokë idenë, problemin, qoftë kur e shigjeton personin e personalitetin.

Këtë relacion Faik Konica, më 1938, te shkrimi i vet *Fan Noli* e karakterizon kështu:

> *Heronjtë e Homerit shkëmbejin fjalë të ashpra, pastaj bashkoheshin, si më parë. Sado që s'jemi si ata heronj, m'u kujtuan kur u poqa me një fytyrë me të cilën kam luftuar aq shumë kohë si shok, edhe pak kohë si kundërshtar*.[3]

Po këtu Konica shpreh vlerësimin për Nolin, "... Më kujton shpesh kishtarët e Përlindjes italiane"[4], kurse tek eseja *Gjuha dhe letërsia* shkruan: "Pa mëdyshje, shkrimtari më modern shqiptar është hirësia e tij, Peshkop Fan S. Noli"[5]; duke njohur shumë talente të tij, e duke vlerësuar sidomos *Historinë e Skënderbeut*, të vitit 1921.

Nga ana e tij, Fan S. Noli, më 1957, veprën e pakryer të Faik Konicës e krahason me veprat e pakryera të Shubertit e të Mikelanxhelos, si krye-vepra, e vijon:

> *As që hamendemi të zëmë në gojë Konicën tok me këta mjeshtër të mëdhenj, nga që ai ishte një stilist i përkryer, shkollar i shkelqyer dhe patriot i madh shqiptar*.[6]

---

[3] Faik Konica, *Fan Noli* (1938) te Vepra 1, Prishtinë, 1995, f. 232.

[4] Po aty, f. 233

[5] Faik Konica, *Gjuha dhe letërsia*, te Vepra 2, Prishtinë, 1995, f. 261.

[6] Fan S. Noli, *Hyrje* (për *Shqipërinë* e Konicës), te Faik Konica, *Vepra* 2, Prishtinë, 1995, f. 119.

Po këtu Fan S. Noli vlerëson Konicën: "Konica mund të konsiderohet krijues i prozës moderne shqipe". Noli thekson se mungesën e veprave letrare me meritë artistike e kishte kaluar Konica me letërsinë e vet të botuar te revista *Albania*; shenjon që me këshilla të tij kishte përkthyer Shekspirin, Ibsenin, Poe-n, e Servantesin; për të përfunduar:

Të gjithë shkrimtarët shqiptarë që erdhën pas Konicës janë nxënës të tij – duke përfshirë këtu edhe këtë shkrimtar.[7]

Pra edhe Nolin.

Konica e Noli shkruan *letërsi kritike* e *kritikë letrare* duke shfaqur e diferencuar letërsinë qëllimore. Ata u nisën të jenë poetë (krijues), porse u realizuan si kritikë (riprodhues). Letërsia e tyre kritike mori trajta të humorit e të satirës, të ironisë e të sarkazmës, kurse kritika e tyre letrare mori trajtën e diskutimit e të karakterizimit. Dallimi është se Konica këtë diskutim e bëri në kuadrin e letërsisë shqipe, kurse Noli në kuadër të letërsisë së përbotshme (kryesisht të asaj që e përktheu). Në krye të herës pranuan: Konica më herët e Noli më vonë, që kritika letrare është bijë e letërsisë dhe nuk mund të ketë pamje tjetër nga letërsia me të cilën merret. Duheshin kërkuar kryeveprat, si pika mbështetëse për krahasim; kur nuk janë në letërsinë shqipe, atëherë në letërsinë e huaj. Pra, shtrohet pyetja: pse Konica u mor me autorë shqiptarë e Noli me autorë të huaj? Ndoshta një përgjigje indirekte do të jepte një kritik i brezit tjetër, Arshi Pipa.

Arshi Pipa, i diplomuar në filozofi në Firencë më 1942, në vitet 40-44 u artikulua fuqishëm si autor në Shqipëri. Ai shkroi njëkohësisht poezi e kritikë. Të gjithë librat e tij poetikë: *Lundërtarë* (1944), *Libri i burgut* (1959), *Rusha* (1968) e *Meridiana* (1969), janë shkruar në Shqipëri, ndërsa tre të fundit janë botuar jashtë saj (në Romë e në Mynih). Në anën tjetër, në fushën e kritikës letrare (ku shkëlqen) shkrimet e veta i botoi në revistën *Kritika* (1944), të cilën e themeloi dhe e drejtoi, dhe në revistat *Shkëndija* të Koliqit, *Fryma* të Myzafer Pipës e në *Bota e re* të Lidhjes së shkrimtarëve.

[7] Po aty, f. 125.

Pipa fillimisht teorizon kritikën letrare shqipe, duke e parë si *estetike e historike*, me synim për të interpretuar e vlerësuar veprat e autorët e të kaluarës dhe autorët bashkëkohorë. Po, nivelin e kritikës e sheh të kushtëzuar nga niveli i letërsisë. Në këtë aspekt, Pipa është në hulli të Konicës e të Nolit kur ripërsërit:

Të gjithë e dijmë sa e vorfën asht letërsija e jonë. Na mungojnë kryeveprat që do të na trajtojnë. E vorfën poezija e jonë, ma e vorfën proza: i palindun romani, foshnje drama. Ku me i marrë shembujt? Nuk ka tjetër zgjidhje: ndër letërsitë e hueja.[8]

Tek eseja *Shpirti kritik* (1944) autori këtë teori e shquan duke portretuar fatin e pararendësve:

Po të kishte pasë poezi shqipe të dêjë para vehtes, Noli nuk do të kishte komentue vetëm vepra të hueja. Dhe mendojmë me keqardhje at potencialitet kritik të dorës së parë që shkoi pa fryt te Konica.[9]

Mirëpo, Arshi Pipa nis aventurën për të komentuar pikërisht me autorët shqiptarë: Gjergj Fishtën, Fan S. Nolin, Faik Konicën e Migjenin. Fishtën si njeri e njeh të trupëzuar në veprën e tij letrare, për të shenjuar se ishte i lindur lirik, po u shndërrua në epik e satirik. Fan S. Nolin më parë e portreton si Bari të Popullit, pastaj shenjon që nuk është poet, po riprodhues dhe se gjenialiteti i tij shenjohet në idetë njerëzore në dramë. Faik Konicën e portreton si autor të veprës së përkryer. Migjenin, autorin e brezit tjetër, e trajton si histori të dhimbshme të shpirtit të ri, duke identifikuar autorin me veprën e tij; e mandej duke e përkujtuar si shpërthim të ideve e të ideologjisë së shkrimeve të tij. Pra, Pipa i sheh më tepër riprodhues sesa krijues pararendësit e tij ilustrativë, duke e mbrendashkruar edhe veten në këtë kuadër, qoftë edhe pa dashur. Kështu shkruan Pipa në Shqipëri në vitet 1941-1944.

Tjetër do të dalë trajtimi i letërsisë arbëreshe, për të cilën saktëson: "poezija arbreshe asht nji përjashtim qi mbetë ende sot nji ishull gati i panjohtun". Po ashtu, trajtimi i letërsisë italiane, po kjo është punë e Arshi

[8] Arshi Pipa, *Mbi përkthimet* (1944), te Arshi Pipa, Kritika (1940-1944), Tiranë, 2006, f. 33.
[9] Arshi Pipa, *Shpirti kritik* (1944), te Arshi Pipa, Kritika (1940-1944), Tiranë, 2006, f. 30.

Pipës të fazës "amerikane".

Mbas dhjetë vjetësh të kaluara në burgje e kampe pune, Arshi Pipa arratiset nga Shqipëria për në Jugosllavi (më 1957) e në Amerikë (më 1958), një gjysmë shekulli mbas Nolit e Konicës. Në Amerikë nuk shkroi më letërsi. Gjithë jeta e tij iu kushtua punës në universitete, studimeve letrare shqipe, arbëreshe e italiane, madje çështjeve ideologjike në fushë të jetës kulturore e politike, duke ndjekur zhvillimet në Shqipëri e në Kosovë.

Kurora e studimeve letrare shqipe të Arshi Pipës në Amerikë është *Trilogjia Albanika*[10], që u botua në Mynih më 1978 dhe që përbëhet nga monografitë: *Vargu folklorik shqip: Ndërtimi dhe Gjinitë*, *Jeronim de Rada* dhe *Letërsia shqipe: perspektiva shoqërore.* Në veprën e parë autori përshkruan e studion vargun folklorik shqip në aspektin formal, ashtu dhe funksionin domethënës e estetik të formave të tij. Në librin e dytë kurorëzon monografinë më të mirë letrare për Jeronim de Radën, deri më sot, duke u përqendruar në kryeveprën *Këngët e Milosaos* (1836), me një thellim në gjenezën dhe në strukturën, në domethënien e në stilin e veprës, të vënë në kontekst letrar e historik. Në veprën e tretë e sheh tërësinë e letërsisë shqipe nëpërmjet perspektivës sociale (të veprave e të autorëve) me një pikëvështrim në dy kryevepra poetike të larguara një shekull nga njëra-tjetra: *Milosaon* (1836) e De Radës e *Vargjet e lira* (1936) të Migjenit. Në mbarim të veprës Pipa propozon një *Sociologji* të letërsisë shqipe dhe një *Periodizim* të letërsisë shqipe. Në fakt, monografia është sprovë e një *Historie* të letërsisë shqipe.

Metoda hulumtuese, argumentimi historik, kulturor e letrar përcaktojnë përgjithmonë nivelin e vlerën e studimeve të autorit në këtë trilogji, ndoshta si nivel i pjekurisë së ideve të tij gjysmë shekulli më parë për kritikën. Vetëmse, tani diskutimi i hapur i politikës e letërsisë e shpie autorin kah një nivel (sado i kultivuar) i ideologjisë. Prova të interpretimit Pipa

[10] Veprat u botuan në anglisht, në Mynih, më 1978. Botimi i kësaj Trilogjie në shqip (me përkthim të Abdurrahim Muftiut, Primo Shllakut e Myftar Gjanës) u bë nga Princi, Tiranë, 2013.

ka dhënë në ballafaqim me poezinë e Martin Camajt, kurse libri i tij më i mirë për letërsinë italiane është monografia *Montale e Dante* (1974).

Shkrimtari Bilal Xhaferri u arratis nga Shqipëria (nëpërmjet Greqisë) në Amerikë më 1969, mbasi kishte botuar dy vepra: *Njerëz të rinj, tokë e lashtë* (tregime), *Lirishta e kuqe* (poezi) dhe kishte në dorëshkrim romanin *Krastakraus*. I trajtuar keq nga diktatura, për shkak të biografisë së familjes, çami i arratisur dyfish, në Amerikë kërkoi lirinë e shpëtimin. Xhaferri në Amerikë nga poeti u bë riprodhues. Qetësinë nuk e gjeti assesi, as si krijues as si person. Shkrimet letrare që i botoi te revista *Krahu i Shqiponjës* nuk kanë tejkaluar vlerën e veprave të tij në Shqipëri, ani që biografët e tij thonë që ai u sulmua jo një herë dhe me djegien e studios së tij kanë mbaruar dorëshkrimet e tij. Xhaferri atje rigjallëronte diskursin politik panshqiptar (me jo shumë mirëkuptim të komunitetit) dhe përqendrohej në lirinë e Kosovës e të Çamërisë. Në shkrimet e tij të kësaj natyre kryqëzoheshin shpresat e dëshpërimi.

5. Shkrimtari pa atdhe

Shpresat e dëshpërimet janë gjendje alternative shpirtërore të shkrimtarëve shqiptarë që lypën *ujdhesën e shpëtimit*, po ashtu gjendje alternative në raport me shoqërinë shqiptare e Shqipërinë në shekullin njëzet. Ata nuk u kthyen. (Asnjë shkrimtar i madh pa atdhé). Edhe më i ndërlikuar raporti i tyre me udhëheqësit e parë të Shqipërisë.

Faik Konica nuk e duroi Ismail Qemalin. Ironizoi e satirizoi Ahmet Zogun te *Dr. Gjilpëra…*, por u bë përfaqësues i Shqipërisë në Shtetet e Bashkuara.

Fan S. Noli nuk e duroi Ahmet Zogun; e luftoi dhe e mundi e u bë kryeministër, mandej u mund prej tij. Poezinë e vet ua dedikoi këtyre dhembjeve e *çlirimtarëve*, kurse teksti i fundit që la në dorëshkrim është *Vdekja e Sulltanit.*

Arshi Pipa nuk e duroi Enver Hoxhën, vuajti burgun e tij, e këtë vuajtje provoi ta bënte dëshmi në letërsi me *Librin e burgut*. Shkroi e punoi

kundër diktaturës. Kur ajo ra, erdhi në Shqipëri për të parë se ishte vonë dhe pasojat e diktaturës ishin të mëdha tek ai e më të mëdha në Shqipëri.

Bilal Xhaferri nuk e duroi Enver Hoxhën. U rrit në frikën e diktaturën e tij, pastaj iku, u arratis. Jehonën e dhembjes artistike të *Baladës çame* nuk ia mundi asnjëherë diskursi i tij kritik për Shqipërinë, as ëndrra etnike shqiptare.

Në fakt: ligjërimi kritik shqiptar i shekullit XXI për ligjërimin kritik shqiptar të shekullit njëzet vetëm evidenton pasojat letrare dhe ushqen riprodhimin e tyre. Për të mos mbetur në rreth, do të kërkohet dera e dal-jes: në krijimin letrar gjenuin e pjellor, të ushqyer nga *daimonia* plato-niane, të cilën e kishte për dëshirë kritiku Krist Maloki.

Literatura

1. Faik Konica, *Vepra 1-2*, Rilindja, Prishtinë, 1995
2. Sabri Hamiti, *Faik Konica: jam unë*, Rilindja, Prishtinë, 1991
3. Fan S. Noli, *Vepra 1-7*, Rilindja, Prishtinë, 1988
4. Arshi Pipa, *Poezi*, Dukagjini, Pejë, 1998
5. Arshi Pipa, *Kritika (1940-1944)*, Princi, Tiranë, 2006
6. Arshi Pipa, *Për Migjenin*, Princi, Tiranë, 2006
7. Arshi Pipa, *Trilogjia Albanika*, Princi, Tiranë, 2013
8. Bilal Xhaferri, *Eja trishtim*, Rilindja, Prishtinë, 1995
9. Bilal Xhaferri, *Njerëz të rinj, tokë e lashtë*, Rilindja, Prishtinë, 1995
10. Bilal Xhaferri, *Ra Berati*, Rilindja, Prishtinë, 1995
11. Bilal Xhaferri, *Përtej largësive*, Toena, Tiranë, 1996
12. Sabri Hamiti, *Poeti i nemun Bilal Xhaferri*, Rilindja, Prishtinë, 1996
13. Sabri Hamiti, *Letërsia moderne*, Faik Konica, Prishtinë, 2002
14. Krist Maloki, *Refleksione*, Faik Konica, Prishtinë, 2005

Sabri HAMITI, Prishtina

ISLAND OF SALVATION

Summary

This paper discusses the Albanian literature produced in the United States in the 20th century, with the main focus on authors Faik Konica, Fan S. Noli, Arshi Pipa, and Bilall Xhaferi, who belong to different generations of literature. Their oeuvre before they went to America and the literature they produced in the United States is treated specifically, by analyzing the relationship between the interpretive cultural model, which is viewed as critical social writing, and the critical literary writing. A common destiny connects these four authors -- they all died in America and their literary work created and published there is more a critical literature than creative oeuvre. This literary phenomenon, which involves different individuals and biographies, is seen as conditioned by the social context and the literary context in both Albania and America.

SHTOJCA

1. KONICA: FAN NOLI*

Me rastin e kremtimit të Ditës së Flamurit, u poqa me shokun e vjetër, peshkop Fan Nolin, të cilin nuk e kisha parë disa vjet. Fan Noli, (një njeriu që ka lojtur një rol aq të madh në lëvizjen tonë dhe është aq i njohur, mund t'i përmendet emri pa nonjë titull si një fytyrë historike, pa hyrë në nonjë pakësim nderimi në këtë mungesë-titulli), Fan-Noli, thom s'ka ndërruar shumë. Heronjtë e Homerit shkëmbejin fjalë të ashpra, pastaj bashkoheshin, si më parë. Sado që s'jemi si ata heronj, m'u kujtuan kur u poqa me një fytyrë me të cilën kam luftuar aq shumë kohë si shok, edhe pak kohë si kundërshtar. Me Fan Nolin merrem kurdoherë vesh më lehtë se flasim një gjuhë: kuptohemi kur themi se njeriu që shkruajti muzikën e Don Giovanni-t bëri një punë më të madhe se njeriu që shpiku telefonin, ose kur themi se Parthenon-i edhe Tarxh Mahal-i janë monumente më të larta se kulla e Eifelit, e cila është një mijë këmbë e lartë. Fan Noli është edhe i ri, prova më e mirë është se është i zoti të qeshë. Në bëfshi mundimin të këndoni një letër time te botuar në numër të Janarit të së përkohshmes "Judge" në Nju-Jork, do të shihni se ç'kuptim të thellë i jep zotërisë për qeshje.

Fan Noli jo vetëm është i ditur në muzikë, po ka zotësinë e rrallë të stërvitë të tjerë në atë mjeshtëri të bukur, dhe t'i stërvitë në pak kohë. Ç'humbje për Shqipërinë, që një njeriu të atillë nuk i jepet rasti të organizojë stërvitjen muzikale të popullit në shkolla të vendit! Ç'humbje që nuk i jepet rast të organizojë një universitet popullor në Shqipëri, ku njerëz të pjekur të vënë një a dy orë ditën të stërviten! Fan Noli është hequr nga politika edhe më tepër sesa jam hequr unë. Kuptohet se një njeri i mëndjes ka nevojë për siguri dhe për dinjitet: po t'i jepeshin këto, do të ish një fitim për Shqipërinë.

...Atë Noli do të mbetet në histori të Shqipërisë si burri që arriu i pari, me hir të vullnetit dhe të hollësisë së tij, të këllasi zyrtarisht gjuhën shqip në meshë. Dita që meshoi për të parën herë është një ogur i bardhë në udhë të përparimit tonë. Dhe as e harrojmë, as mund të lëmë të tjerët të harrojnë.

Leshzi, me sy të mprehtë, një fizionomi të qeshur, gati të presë një shaka dhe ta kthejë me uzurë, mendje-hapur, njohës i gjuhëve romane dhe skandinave, atë Noli nga kultura, nga mendësia dhe nga karakteri i tij më kujton shpesh kishtarët e Përlindjes italiane.

2. KONICA: GJUHA DHE LETËRSIA*

(për Fan S. Nolin)

Pa mëdyshje, shkrimtari më modern shqiptar është Hirësia e tij, Peshkop Fan S. Noli, reformator i kishës, orator, lider politik, kompozitor i muzikës dhe njeri me shumë talente, i cili ka botuar përkthimet në shqipe të disa dramave të Shekspirit, një shqipërim të mrekullueshëm të *Korbit* të Posë, pa humbur ritmin e origjinalitetit, si dhe *Rubairat* e

* Faik Konica: *Fan S. Noli*, (1938), te Faik Konica, Vepra 1, Prishtinë, 1995, ff. 232-233.

* Faik Konica: *Gjuha dhe letërsia*, (për Nolin) te Faik Konica, Vepra 2, Prishtinë, 1995, f. 261.

Omar Khajamit. Pos këtyre, ai gjithashtu shqipëroi dy drama të Ibsenit*, Armiku i popullit* dhe *Zonja Ingra e Ostrotit,* si dhe *Don Kishotin* e Servantesit. Vepra e tij shkencore *Historia e Skënderbeut,* e botuar më 1921, është vepra e tij më e rëndësishme.

Kam lënë pa përmendur shumë emra, ngaqë llomotitjet dhe dërdëlitjet nuk kanë të bëjnë asgjë me artin. Për kontributin tim në lëvizjen letrare të Shqipërisë, s'do mend nuk mund të them asgjë.

3. FAN S. NOLI: FAIK KONICA*

Tash, disa fjalë për vendin e Konicës në historinë e Shqipërisë modeme. Si mysliman dhe si bir i një familjeje të vjetër aristokrate nga Shqipëria e Jugut, Konica kishte çdo mundësi të arrinte pozitën më të lartë në Perandorinë turke, pjesë e së cilës kishte qenë Shqipëria që nga vdekja e Skënderbeut. Në të vërtetë, shumë shqiptarë të tjerë shekuj me radhë kanë zënë postet më të larta të Perandorisë turke. Për shembull, në rininë e Konicës, Veziri i Madh, ose kryeministri i Perandorisë Turke, Ferid Pasha ishte shqiptar nga Vlora.

Por, karriera e tillë nuk e ka tërhequr asnjëherë Konicën. Ai mendonte se misioni i tij ishte që të luftonte për pavarësinë e Shqipërisë. Nga viti 1897 deri më 1912, dy nga pionierët më të mëdhenj të pavarësisë shqiptare ishin Faik Konica dhe Shahin Kolonja, botues të dy revistave shqipe që botoheshin jashtë atdheut, *Albania* dhe *Drita.*

Gjatë pushtimit turk, shqiptarët kishin harruar për lavdinë e dikurshme nën udhëheqjen e Skënderbeut. Konica qe ai që rizbuloi dhe popullarizoi Skënderbeun dhe flamurin e tij, shqiponjën e zezë dykrenare mbi një fushë të kuqe. Ky flamur u bë simbol i pavarësisë kombëtare dhe më në fund u ngrit në Vlorë më 1912 nga Ismail Qemali kur Shqipëria u shpall shtet i pavarur.

Konica mund të konsiderohet krijues i prozës moderne shqipe. Kur pata vendosur t'i bashkohesha kryqëzatës për pavarësinë shqiptare gjëja e parë që më ra në sy ishte mungesa e plotë e veprave letrare me meritë artistike. Por, kur shkova në Egjipt më 1903, Spiro Dine, një patriot shqiptar, m'i solli vëllimet e revistës së Konicës *Albania* prej 1897 deri më 1903. I lexova të gjitha nga fillimi në mbarim dhe pastaj u binda se në shkrimet e Konicës ishte ajo që na duhej - letërsi e mirë shqipe. Pastaj, Konica zbuloi dhe bëri të njohur shkrimtarët shqiptarë si Kristoforidhin, Mitkon, Fishtën dhe Zakon. Me këshillat dhe nën udhëheqjen e tij, unë përktheva disa vepra të Shekspirit, Ibsenit, Edgar Alan Poes dh*e Don Kishotin* e Servantesit. Të gjithë shkrimtarët shqiptarë që erdhën pas Konicës janë nxënës të tij – duke përfshirë këtu edhe këtë shkrimtar.

* Fan S. Noli, *Hyrje*, në Shqipëria kopshti shkëmbor…, (1957) te Faik Konica, Vepra 2, Prishtinë, 1995, ff. 124-125.

4. LETRA E KRIST MALOKIT PËR NOLIN*

Interesat e mija të veçanta rreth personit t'Uej datojn qysh nga vjeti 1923, qysh atëherë kur ishe i angazhuem për disa muej (Gusht - Tetor) në ministrinë e Arësimit dhe në Bibliothekën Nacjonale në Tiranë dhe kur pata rast t'U shof e t'U studjoj ma afërsisht mbrenda lëvizjeve të ndryshme kulturore dhe politike dhe sidomos mbrendi dallgavé aq dramatike, per mos me thanë: tragjike, të parlamentit t'atëherëshëm. Vazhdimisht i kam njekë dhe studjue mandej botimet e ndryshme të veprave t'Ueja deri të parathanëja e Juej në botimin e Q. M. Panaritit "Konitza /Albania". Mjerisht, nepër një taksirat të përvajtueshëm i kam humbë pothue të gjithë dorëshkrimet e mija shqipe në një dislokacjon kundra bombave të luftës së dytë botënore, ner ato shkrime edhe studjimet e mija mbi Naim Frashërin, mbi Faik Konitzen dhe mbi Ju. Kësodore jam i nevojitun të ja hyj punës përsëri dhe pothue "Ab nono".

Por shka më mungon dhe shka me nevojitet si një conditio sine qua non asht biografija e Juej e imët, e gjallë dhe vertetë, një jetëshkrim a jetë-përshkrim që duhet të jetë ma fort një "confessio" se sa një kohëshkroje e thatë. Si psikolog dhe pedagog i zanatit preferoj vet ma fort studjime dhe paraqitje kritike-letrare si mbas methodash genetike, ku mund të nxirren kuptime dhe spjegime të veprave artistike qysh nga lëvizjet e para shpirtnore t'autorit mbrenda kohës së fëminisë dhe djalërisë. E pra shka më mungon rreth paraqitjes se kompleksit fan-noljan asht njajo biografi qysh nga lindja dhe deri në Vjetin 1906 a 1908, deri sa keni shkelë per të paren herë në tokën egjypcjane. Kemi do paralele të jetës, të evolucjonit shpirtënor e mendor, po aq edhe të botëkuptimit dhe të qëndrimit nacjonal e kombëtar te do shqiptar tjerë dhe sidomos te dy vjershëtorë tjerë - Naim Frasheri dhe Migjeni - sa mundet me shumë hamendje, me shumë siguri rikonstruktive me i kuptue do çfaqje në jetën t'Uejë dhe me to bashkë do shfaqje karakteristike nër vepra t'Ueja; sa për Beethoven-in që permenda ma nalt mjaftojn fjalët e fundit të vepërs s'Uej si penj i Ariadnes mbrenda labirinithit të "kompleksit" fan-noljan. Porse ma fort e ma tepër se të gjitha do të na vyente një jetëshkrim nga penda e Juejë, një "Aus meinem Leben" si të Goethe-s, ku duhet të kishte ma tepër "Wahrheit" se "Dichtung". Ju, Eminencë, ndoshta do të keni marrë vesht se jam mundue tash e sa vjetë, së paku terthorazi (sidomos nepër ata të Vatrës) t'i siguroj vedit një biografi t'atillë. Por tani, mbasi e hapem bisedën, shpresoj se do të dali dishka në dritë dhe do të perplotet një mungesë e ndijshme në historinë e literaturës shqiptare.

E me këtë shpresë në zemër, po marr lejen me U çfaqë Juve, Eminencë, urimet ma të perzemertat për Krishtlindje dhe per Motin e Ri dhe po jesë me nderime të plota dhe me pervujtní

i Jueji

K. Maloki

Graz, 19/XII/58

* Krist Maloki, *Letër Nolit*, (19. 12. 1958), te Refleksione, Prishtinë, 2005, ff. 268-269

5. LETRA E KRIST MALOKIT PËR ARSHI PIPËN*

Me të marrmen e librit t'Uej i kam hy me njëherje - si e kam zakon perherë kundrejt një vepre serjoze e të vlefëshme - e me vemendje këndimit e shijimit të tij. Mjerisht që nuk pata rast e mjet per t'i botue mendimet e mija aty për aty që i fitova rreth njatij këndimi e studjimi. Sot, po deshta me shkrue gja mbi 'të dhe me e dhanë kritiken t'ime si bje fiala rreth veprës lasgushjane, do t'ishte nevoja t'ulesha mbi tryezë shkencëtare dhe t'i permbledhësha mendimet dhe kritikat e mija me formulime dhe figuracjone të pershtatëshme. Nuk kam nevojë t'U ap nasihat mbi këto sende sepse Ju vet e ushtroni misjonin e kritikës ndoshta ma me zotsi e ma me mëprehtësì se une. Porse as nuk po due me mundue me do kujtime e kundrime që mund t'U sherbejn si fjalë, si këshille, si nasihate shoku shokut a miku mikut: Ju nuk duhet të harroni se jeni ma fort filozof se artist, ma fort intelektual se intuituv, ma fort formalist se organik, ma fort reproduktiv se pjellor-natyror... ka edhe mâ. Po kuptohemi! Në literaturen shqiptare shënohet me çudi të madhe problemi i Fan Nolit. Ka shkrue sa ka shkrue, në prozë e në vjershë, gjithëkund margaritarë të pashoqë... porse fort pak, në mos aspak, ndonjë gja thjesht origjinale. Dhe me qenë që i mungon njajo "daimonia" (si thotë Platoni) i pjellsìsë, vepra e Fan Nolit mbetet gjithmonë copë-copë, vende-vende e plotë, e perendijshme, vende-vende-pleh, shumë herë pleh i qelbun, poetik: sepse i perdhunuem nga intelekti o nga ndonjë forcë magjore e perjashtme. Vepra e Juejë i ka pothue të gjithë njato karakteristika si ajo e Nolit.

Juve Ju mungon ma tepër muzikaliteti, njajo afshì tonalitetesh të shumëngjyrshme dhe e "vagëlluarë" që e karakterizon veprën lasgushjane. Prej Jush bj. fj. do t'ishte pritë që të jipshi pershkrime të gjalla e impresjonuese të situatave të ndryshme që keni perkalue neper burgje në Shqipnì intanto. Ju bani pergjasime ndermjet botës së jashtme dhe gjendjës s'Uejë shpirtnore, hiedheni ner meditacjone ma fort intelektuale e kerkoni me i futë impresjonet t'Ueja nër kallepë të vjetra e të literaturave të hueja. Shka më ka vra veshin e synin sidomos asht njajo pjesë e librit t'Uej (f. 62 ff.) ku i shterngoni Ju të gjithë dëshiret, brengat dhe vuejtjet e Jueja ner forma e kallëpe - këtu fare të papërshtatshme - të sonetave. Lene një herë që sonetet kan dalë dikur nga muzika absolute dhe e pamende e të 13. shekull italjan, si e kam pershkrue vet në kritikën t'ime rreth Lasgushit, lene që njato sonetet e kerkojn me doemos muzikalitetin e vet, porse hiedhet dhe perdriedhet si fluturat neper ajrì, porse perzija shqiptare dhe shpirtsija artistike e Kombit t'onë zor qi mund të perputhen dhe të pajtohen me njaso formash së jashtme e të shtërnueta. Mb'anen tjetër - si per çudi - keni Ju shumë prirje per forma e kallëpe ma fort klasiciste, ku mund t'i paraqitni mendimet filozofike e pedagogjike (si vjerrsha SAFO): këtu jeni reproduktiv, poezidashës i kulturuem dhe mund t'i vyeni literaturës shqiptare me shumë kontribute. Po në këtë drejtim shkon edhe prirja e Juejë e veçantë per riprodukcjone rreth tingullimesh popullore: vjersha e Juejë Kupe Danja asht një capo-lavoro që nuk len asgja me dishrue ma tepër në 'atë. E dijtun që sa e sa hollësina të ndryshme që çfaqen dhe fanojn

* Krist Maloki, *Letër Arshi Pipës*, (11 dhjetor 1960), te Refleksione, Prishtinë, 2005, ff. 271-272

ndermjet këtyne tri pikëpamjeve, të paraqituna këtu ma fort epërsisht, do ta e permëlledhëshin e do ta e plotsojshin argumentin t'im, porse sot per sot po mjaftohemi me kaq: po m'u dha rasti njëherë dhe po ma e lejojshi forcat magjore të jetesës së ngushtë do t'i shtrohem muhabetit dhe do të ja paraqes publikut të gjanë kritikën t'ime.... per ndér t'Uejin dhe per të mirën e Kombit t'onë. Sigurisht që kritika e ime ka per të dalë ma e gjallë e ma shpirtplote se njajo gjoja-kritikë simahore e miqëve t'Uejë ner "Shejzat" e Romës. Me shkrueni një herë se çfarë jehone ka gjetë botimi i Juej dhe se si jeni nda me shitjen e librit.

I Jueji

Graz, 11 dhetor 1960

6. BILAL XHAFERRI

Nëno, moj, të raft një pikë
i ke djemt në Amerikë*

Ata s'merren me politikë. Ata hodhën lumin dhe i nxorrën sytë kalit. Ata kanë harruar që kanë një atdhe që i pret. Duke përdorur një instikt dhe një logjikë prej bagëtie, ata e kanë konsideruar atdheun si një kullotë ku u tha bari, dhe, për të shpëtuar nga çatallet e ujqëve e për të gjetur diku gjetkë ndonjë kullotë tjetër dolën në livadhet e Botës së Lirë, në perëndim, prapa diellit, nga ku ëndërrojnë që të kthehen përsëri, dikur, në atë tokë të mallkuar ku u ra koka e ku panë diellin për herë të parë, jo nga malli për të, jo nga dëshira për të vdekur atje, po vetëm si turistë apo si “biznesmenë” me xhepin plot e me kafkat bosh.

Përveç kësaj kategorie njerëzish, në këtë artikull, që do të botohet së shpejti, bëhet fjalë edhe për ata njerëz të tjerë, që të këpusin në politikë, për ata pseudopolitikanë që kanë luajtur harush në kurriz të emigracionit për një kohë kaq të gjatë dhe e kanë lënë emigracionin të përçarë e të armiqësuar në periudhën më të vështirë të historisë së popullit tonë, kur ai popull i ka mbajtur gjithmonë sytë me shpresë tek emigracioni.

"Krahu i Shqiponjës", nr.2, 1978

* Bilal Xhaferri, *Nëno, moj, të raft një pikë i ke djemt në Amerikë,* Krahu i Shqiponjës, 1978, te Bilal Xhaferri, Përtej largësive, Tiranë, 1996, f. 317.

Brian D. JOSEPH, The Ohio State University

PËRFYTYRIMI PËR GJUHËN SHQIPE NDËR GJUHËTARËT E HERSHËM AMERIKANË*

Gjuhëtarët në Europë që studiuan gjuhët indoeuropiane filluan të kuptonin vendin e gjuhës shqipe në gjysmën e parë të shekullit të nëntëmbëdhjetë, domethënë, relativisht afër fillimit të studimeve indoeuropiane në përgjithësi. Në vitin 1835, Josef Xylander-i në librin e tij *Die Sprache der Albanesen* konsideroi se gjuha shqipe ishte anëtare e familjes indoeuropiane. Më vonë, afër fundit të shekullit të nëntëmbëdhjetë, gjejmë punën e dijetarëve si Holger Pedersen, Gustav Meyer dhe Norbert Jokl dhe me siguri mund të shënojmë të tjerë.

Gjithashtu, në shekullin e nëntëmbëdhjetë dhe në gjysmën e parë të shekullit të njëzet në Amerikën Veriore gjuha shqipe pothuaj nuk ekzistonte. Për shembull, kur Linguistic Society of America ("*Shoqëria Gjuhësore Amerikane*") më 1926 bëri një "Survey of Linguistic Studies" ("*Studim i programeve gjuhësore*") në Shtetet e Bashkuara (nga Roland Kent-i dhe Edgar Sturtevant-i, botuar në *Linguistic Society of America Bulletin* No. 1), gjeti se kishte mundësi të studioheshin nga dikush gjuhët e çdo dege indoeuropiane, duke përfshirë armenishten dhe letonishten, por me përjashtim të shqipes; shihni tabelën ("*Tabela 1. Gjuhësi e përgjithshme dhe gjuhë të ndryshme indo-europiane*"):

---

* Dua të falendëroj dy kolegë gjermanë, Erhard Hinrichs dhe Detmar Meurers, për ndihmën e tyre me të dhënat rreth Albanisch/ Albanesisch në gjermanisht, dhe Carly Dickerson për ndihmën në përkthimin shqip.

TABLE I: GENERAL LINGUISTICS AND MISCELLANEOUS INDO-EUROPEAN

	GEN. LINGUISTICS	GEN. PHONETICS	EXPER. PHONETICS	LING. PSYCHOLOGY	COMP. IE	SANSKRIT	PALI AND PRAKRIT	MODERN INDIC DIAL.	AVESTAN	OLD PERSIAN	PAHLAVI	MODERN PERSIAN	ARMENIAN	OLD CHURCH SLAV.	COMP. SLAVIC	RUSSIAN	OTHER SLAVIC	LITHUANIAN	LETTISH	CELTIC
California	..	..	..	..	1	2	2	..	..	..	..	..	..	3	..	4	5	..	..	..
Catholic	1	1	..	..	1	2	..	..	..	..	..	..	3	..	..	..	..	..	..	4
Chicago	1	2	3	..	4	5	5	..	4	4	..	6	..	4	..	7	..	4	..	8
Columbia	1	2	..	..	1	3	4	..	3	3	3	5	6	7	7	8	9	..	29	10
Cornell	..	1	..	..	2	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..
Harvard	1	2	..	..	1	3	4	..	..	..	..	..	..	5	5	5	5	..	..	6
Illinois	..	..	..	1	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..
Indiana	..	..	..	1	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..
Iowa	..	1	2	3	..	4	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..
Johns Hopkins	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..
Michigan	1	1	2	3	4	5	..	..	..	..	..	..	..	..	..	5	6	..	..	..
Minnesota	1	2	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..
Missouri	..	..	..	..	..	1	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..
Nebraska	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	1	..	..	..	..	2
North Carolina	1	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..
Northwestern	..	1	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	2
Ohio State	1	2	3	..	1	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..
Pennsylvania	..	1	..	..	1	2	2	2	1	1	..	..	..	..	..	..	..	1	..	..
Princeton	1	..	..	..	1	2	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	1	..	..
Stanford	..	..	..	1	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	2	..	..	..	..
Virginia	1	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..
Wisconsin	..	1	..	1	..	2	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..	..
Yale	1	1	..	..	1	2	2	..	2	3	..	4	..	..	..	..	..	3	..	..

Domethënë, gjuha shqipe nuk ishte e dukshme për gjuhëtarët amerikanë të kësaj periudhe.

Në këtë artikull dua të hetoj përfytyrimet të shqipes ndër gjuhëtarët e hershëm amerikanë, në veprat të tyre në shekullin e nëntëmbëdhjetë dhe në gjysmën e parë të shekullit të njëzet. Do të përpiqem të vendos njohjet në Amerikë rreth gjuhës shqipe dhe burimet e kësaj njohjeje.

Ky hetim ndërlidhet me zhvillimin e studimeve indo-europiane në Amerikën Veriore. Megjithëse kishte shumë dijetarë në Amerikë që studionin gjuhët indoeuropiane, shumica e tyre u koncentrua në gjuhët klasike, greqisht dhe latinisht, ose në gjuhët gjermanike ose në sanskritishten.

Në këtë periudhë përfshihen këta dijetarë të njohur, të grupuar sipas kronologjisë dhe trashëgimisë akademike:

Brezi i Parë në ShBA (fillimi i karrierës në shekullin e 19të):

William D. *Whitney* (Universiteti Yale)

Maurice *Bloomfield* (Universiteti i Johns Hopkins-it)
George M. *Bolling* (Universiteti Catholic/ Universiteti Shtetëror i Ohio-s)
Carl D. *Buck* (Universiteti i Chicago-s)
Herman *Collitz* (Universiteti i Johns Hopkins-it)
Eduard *Prokosch* (Universiteti i Wisconsin-it)
Louis *Gray* (Universiteti Columbia)

Brezi i Dytë në ShBA (fillimi i karrierës në shekullin XX):

Edgar *Sturtevant* (Universiteti Columbia/ Universiteti Yale)
Roland *Kent* (Universiteti i Pennsylvania-s)
Leonard *Bloomfield* (Universiteti i Illinois-it/Universiteti Shtetëror i Ohio-s/ Universiteti i Chicago-s)
Edward *Sapir* (Universiteti i Chicago-s/ Universiteti Yale)

Megjithatë, edhe me arritjet e këtyre dijetarëve në temën e specializuar brenda studimeve indo-europiane, vetëm më vonë, pas vitit 1950, hulumtimi amerikan në studimet indo-europiane filloi të kishte një ndikim në Europë në pikëpamjë të zhvillimit dhe të rindërtimit të gjuhës proto-indoeuropiane. Në të vërtetë, dëri në dekadën 1950, qendra e botës së gjuhësisë indoeuropiane ishte Europa, dhe hulumtimi amerikan në këtë temë nuk ndikonte shumë idetë e dijetarëve në Europë, me përjashtim të hipotezës së Sturtevant-it rreth indo-hetitishtes.

Megjithëse kishte atëherë shumë hulumtime të shkëlqyera rreth gjuhëve indo-europiane me origjinë amerikane dhe nga dijetarë amerikanë, nuk kishte asnjeri në Amerikë me gjerësinë e Karl Brugmann-it ose të Hermann Hirt-it apo të August Pott-it, të gjithë europianë, ose me madhështinë e Ferdinand de Saussure-it, ose me praninë komanduese e Antoine Meillet-së.

Edhe më me rëndësish në këtë rast, nuk kishte asnjeri në Amerikë me njohuritë e specializuara të gjuhës shqipes që e kishin Gustav Meyer-i ose Holger Pedersen-i ose Norbert Jokl-i në Europë.

Në të vërtetë, indo-europianistët amerikanë filluan të tërhiqnin vëmendjen ndërkombetare nga Europa dhe tjetërkund vetëm në mes të shekullit të njëzetë, kur filluan të bënin hulumtime e tyre në studime indo-europiane dijetarë si Calvert Watkins-i në Universitetin Harvard, Warren

Cowgill-i në Universitetin Yale, Jaan Puhvel-i në Universitetin e Kalifornisë në Los Angeles, dhe Eric Hamp-i në Universitetin e Chicago-s.

Mund të themi se vetëm atëherë, kryesisht për arsye të punës së Eric Hamp-it, gjuha shqipe nisi të luante një rol serioz në studimet indo-europiane amerikane.

Në këtë mënyrë, dijetarët me ndikim më të fortë në rritjen e gjuhësisë amerikane ndër indo-europianistë të Europës ishin Paul Tedesco-i në Universitetin Yale, sepse mësoi Warren Cowgill-in dhe Stanley Insler-in, dhe Joshua Whatmough-i në Universitetin Harvard, sepse mësoi Calvert Watkins-in dhe Eric Hamp-in, megjithëse as Tedesco-i as Whatmough-i nuk ishin indoeuropianistë të gjerë dhe nuk dinin shumë rreth shqipes.

Domethënë, mund të themi se kishte një brez të tretë që ishte shumë i rëndësishëm këtu:

Brezi i tretë (nga mesi i shekullit të njëzetë)

George S. Lane (Universiteti i Karolinës Veriore)

Paul Tedesco (Universiteti Yale, mësuesi i Warren Cowgill-it e Stanley Insler-it)

Joshua Whatmough (Universiteti Harvard, mësuesi i Calvert Watkins-it e Eric P. Hamp-it)

Le të kthehemi tani në shekullin e nëntëmbëdhjetë dhe le të shikojmë çfarë thonë gjuhëtarët amerikanë në veprat e tyre. Nuk kishte shumë vepra gjuhësore atëherë, por ndoshta vepra më e rëndësishme ishte *Language and the Study of Language* ("*Gjuha dhe studimi i gjuhës*") nga William Dwight Whitney, që u botua për herë të parë në vitin 1867 dhe u ribotua të paktën gjashtë herë deri në vitin 1901. Në këtë liber, autori Whitney përmend gjuhën shqipe tri herë:

f. 191:

> "We have thus reviewed all the languages of modern Europe, excepting, first, the Albanian, which is the living representative of the ancient Illyrian, and of which the connections are doubtful (although it is likely to be yet proved to belong with the rest, as a branch of the same stock); ..."
>
> *"Kështu ne i kemi shqyrtuar të gjitha gjuhët e Europës moderne, me përjashtim të, së pari, gjuhës shqipe, e cila është përfaqësuesja e gjallë e gju-*

hës së lashtë ilire, dhe e lidhje të cilat janë të dyshimta (edhe pse është e mundshme të provohet ende që bënte pjesë me të tjerat, si një degë e llojit të njëjtë);…"

f. 290-291:

"The Albanian, the modern representative of the ancient Illyrian, spoken by the fierce and lawless race which inhabits the mountains of/ north-western Greece, is still in the same position ["of doubtful affinity"]; linguistic scholars are divided in opinion as to whether it is yet proved to be Indo-European, though with a growing preponderance upon the affirmative side."

"Shqipja, përfaqësuesja moderne e ilirisht e lashtë, e folur nga raca e ashpër dhe pa ligje që banon në malet e Greqisë/ veri-perëndimore, është ende në pozitë të njëjtë ["të lidhjës së dyshimtë"]; dijetarët gjuhësorë janë të ndarë në mendimin nëse mund të jetë provuar që është indo-europiane, edhe pse me një mbizotërim në rritje mbi anën pozitive."

f. 355 (duke folur rreth gjuhëve që u "kanë rezistuar të gjitha përpjekjeve për klasifikim"):

"The Albanian or Skipetar, the modern representative of the ancient Illyrian, has already been spoken of as doubtfully classifiable with the Indo-European languages."

"Shqipja, përfaqësuesi modern i ilirishtes së lashtë, tashmë diskutohet *si dyshueshëm e klasifikueshme me gjuhët indo-europiane."*

Për disa gjëra që thoshte Whitney-i tani mund ta konsiderojmë të painformuar, për shembull kur thotë se gjuha shqipe ndoshta nuk ishte gjuhë indo-europiane; disa pasqyrojnë mendimin e përbashkët të kohës së tij, për shembull se shqiptarë janë "lawless race" (*racë pa ligje*); dhe disa janë edhe tani të diskutueshme, për shembull çështjet origjinës ilire të gjuhës shqipe. Megjithatë, të paktën gjuha shqipe tërhoqi vëmendjen disa herë në një vepër të rëndësishme.

Vepra tjetër i Whitney-it ishte *Century Dictionary and cyclopedia* ("*Century Fjalor dhe enciklopedi*), që u botua për herë të parë në vitin 1891. Nuk ishte një vepër gjuhësore, por ishte një enciklopedi e përgjithshme, dhe kishte ndikim në publikun e zakonshëm. Në këtë vepër (f. 129) gjejmë këtë informacion për "Albanian" me vetëm pak rreth gjuhës:

> "The language of Albania, possessing strongly marked dialects and usually classed as Aryan or Indo-European".
>
> *"Gjuha e Shqipërisë, që ka dialekte fort të shënuar dhe që zakonisht klasifikohet si ariane ose indo-europiane."*

Duket se Whitney nga kjo kohë e kishte pranuar lidhjen e gjuhës shqipe me familjen indoeuropiane.

Tani, do të avancoj disa dekada deri në shekullin e njëzetë, për t'u koncentruar te Leonard Bloomfield-i dhe një vepër e tij. Më 1914 Bloomfield-i botoi librin *An Introduction to the Study of Language* ("*Hyrje në studimin e gjuhës*"), i cili nuk e kishte ndikimin që kishte libri i tij klasik *Language* ("*Gjuha*") i vitit 1933, por në atë kohë, ishtë libër i rëndësishëm.

Bloomfield-i përmend gjuhën shqipe në këtë libër, por – diçka shumë interesante – megjithëse të gjithë gjuhëtarët përpara (për shembull Whitney-i) përdornin emrin *Albanian*, Bloomfield-i këtu përdorte emërtimin *Albanese*.

Edhe pse të gjithë gjuhëtarët pas Bloomfield-it, për shembull Edgar Sturtevant-i dhe Carl Buck-u, përdornin emërtimin *Albanian*, Bloomfield-i përdorte edhe më vonë, në librin e tij *Language*, emërtimin *Albanese*.

Duhet të pyetim pse u perdor *Albanese*. Le të dal nga për një moment tema e kësaj kumtese për të vështruar emërtimin *Albanese* të Bloomfield-it.

Sigurisht që këtë përdorim mund t'ia atribuojmë ndikimit nga gjermanishtja. Gjuha gjermane ka dy mbiemra për "Albanian": *Albanisch* dhe *Albanesisch* (*Albanesisch* bazohet në italishten). Këto dy fjalë nuk janë variante të pavarura.

Kërkimi në Arkivin Gjerman të Teksteve (DTA) tregon se emri më i hershëm për "Albanian" është *Albaner*, në vitin 1668, dhe *Albanesischer* gjendet për herë të parë më 1789. Megjithatë, në shekullin e nëntëmbëdhjetë dhe deri pjesën e hershme të shekullit njëzet, pikërisht nga 1860 dëri më 1910, *Albanesisch* është më e shpeshtë. Tani, kjo situatë ka ndryshuar. Afërsisht nga vitit 1930 *Albanisch* është më i shpeshtë dhe *Albanesisch* u zhduk dhe nuk përdoret më aspak.

Megjithatë, në periudhën në të cilën Bloomfield-i studioi gjuhësi gjermanike dhe indoeuropiane, që përfshin dy vitet që kaloi në Gjermani, *Albanesisch* në përdorimet gjermane ishte më i shpeshtë ose afërsisht aq i shpeshtë sa *Albanisch*. Ky grafik nga "n-gram viewer" i Google-it tregon këtë situatë:



Është e vërtetë se gjuhëtarë përpara dhe pas Bloomfield-it, edhe ata me përvojë me dijetarët gjermanë, nuk përdorin "Albanese", por mund të spekulojmë se Bloomfield-i është orientuar në gjuhën gjermane dhe në Gjermani më shumë se gjuhëtarët e tjerë, sepse Eduard Prokosch-i i Universitetit të Wisconsin-it, i lindur në Europë, kishte ndikim shumë të rëndësishëm në zhvillimin e Bloomfield-it si gjuhëtar, edhe sepse Bloomfield-i ishte profesor i gjuhës gjermane në departamentën e gjuhëve gjermanike në fillimin e karrierës së tij (në Universitetin e Illinois-it dhe pastaj, në Universitetin Shtetëror të Ohio-s). Është e mundur që Prokosch-i ta ketë përdorur *Albanesisch* në leksione ose duke folur me Bloomfield-in, ndoshta duke përforcuar fjalën që mësoi Bloomfield-i nga studimet e tij në Gjermani. Pa dyshim, Prokosch-i në librin e tij *A Comparative Germanic Grammar* ("*Gramatikë krahuese gjermanike*"), botuar në 1939, përdorte *Albanian*, jo *Albanese*, por kjo mund të jetë rezultat i ndërhyrjes së redaktorit, sepse Prokosch-i vdiq para botimit të librit.

Megjithë nomenklaturën e pazakontë për shqipen, Bloomfield-i në veprën e parë dha një vlerësim shumë të rëndësishëm për gjuhën shqipe brenda familjes indoeuropiane. Bloomfield-i konsideronte se shqipja ishte gjuhë "*satəm*", por mendonte se pozita gjeografike e gjuhës midis dy gju-

hëve "*centum"* (latinishtes dhe greqishtes) ishte problematike për teorinë e përhapur rreth ndarjes *centum/ satəm*. Prandaj, sugjeronte (f. 272) se kjo ndarje e famshme brenda familjes indoeuropiane në të vërtetë nuk ishte nje ndarje dialektore mes lindjes dhe perëndimit:

> "More careful observation, however, makes it probable that the cleavage into '*centum'* and '*satəm'* languages was not a dialectal cleavage of Primitive Indo-European, but that the languages have separately arrived at the historical forms."
>
> *"Një vëzhgim më i kujdesshëm, megjithatë, e bën të mundshme që ndarja në gjuhë '*centum*' dhe gjuhë '*satəm*' nuk ishte një ndarje dialektore e indoeuropianishtes së parme, por se gjuhët kanë arritur veç e veç në format historike."*

Kjo deklaratë ndoshta pasqyron ndikimin e Prokosch-it, sepse në gramatikën krahasuese gjermanike të tij, Prokosch-i (1939: 43) citonte Pedersen-in (1900) rreth faktit se në gjuhën shqipe ka rezultate të ndryshme për **k', *k,* dhe **k*^{w} nga Proto-indoeuropianishtja. Ideja e Pedersen-it në përgjithësi ishte injoruar nga Antoine Meillet dhe dijetarët në Francë dhe në Europë. Kështu, ndoshta Bloomfield-i po ndiqte çfarë kishte mësuar nga Prokosch-i rreth ndarjes *centum/satəm*.

Vepra tjetër që morëm në konsideratë është *Linguistic Change: An introduction to the historical study of language* (*"Ndryshimi gjuhësor: hyrje në studimin historik të gjuhës*") nga Edgar Sturtevant-i, që u botua në 1917. Në këtë libër ka vetëm një shënim të shkurtër për gjuhën shqipe (me emrin *Albanian*). Kur diskutonte ndryshimin leksikor, Sturtevant-i (f. 123) thoshte:

> "Albanian, although on the basis of its structure and some of its most common words it is called an independent branch of the Indo-European family, has borrowed so much Latin that it has to be included in comparative grammars of the Romance languages."
>
> *"Shqipja, edhe pse në bazë të strukturës së saj dhe të disa fjalëve më të zakonshme të saj është quajtur degë e pavarur e familjes indoeuropiane, ka huazuar aq shumë nga latinishtja sa që duhet të përfshihet në gramatikat krahasuese të gjuhëve romane."*

Veç kësaj, në f. 154, kur diskutonte klasifikimin e gjuhëve dhe të dialekteve, thoshte se anglishtja është gjuhë e përzier sepse fjalori i saj ka shumë burime. Megjithatë, vendoste që anglishtja është gjuhë gjermanike sepse përemrat, numrat, lidhëzat dhe emrat e foljet e shpeshta janë të gjitha gjermanike. Rreth shqipes shkruante:

> "It is usual to reckon Albanian as an independent member of the Indo-European family; but its Romance element is far more important than the Romance element in English."
>
> *"Shqipja konsiderohet zakonisht anëtare e pavurar e familjes indo-europiane; por, elementi roman i saj është larg më i rëndësishëm se sa është elementi roman i anglishtes."*

Nuk është qartë se çfarë përpiqej të thoshte këtu ai – përemrat, numërorët, lidhëzat dhe emrat e foljet e shpeshta të gjuhës shqipes, a nuk janë nga gjuha proto-indoeuropiane? Ndoshta mungesa e njohurisë së ekspertit këtu kishte parandaluar Sturtevant-in të thoshte diçka përfundimtare.

Tani, vazhdoj me veprën klasike *Language* ("*Gjuha*") të Edward Sapir-it, që u botua më 1921. Kjo vepër është një nga dy manifestet e përgjithshme më të rëndësishme rreth gjuhës dhe gjuhësisë në gjuhësinë amerikane në këtë periudhë (tjetra ishte *Language* ("*Gjuha*") nga Leonard Bloomfield-i). Këtshtu, është interesante se nuk ka asnjë përmendje të gjuhës shqipe, as në pjesët që diskutojnë gjuhët indoeuropiane (megjithëse, armenishtja është përmendur).

Kronologjikisht këtu duhet të diskutoj revistën *Language, Journal of the Linguistic Society of Amerca* ("*Gjuha, Revistë e Shoqërisë Gjuhësore Amerikane*"), që filloi të botohej në vitin 1925. Kjo pamje është edukative, sepse na tregon se as u harrua gjuha shqipe as u injorua atëherë. Gjuha shqipe përmendet dy herë në *Language* në kohën e hershme të saj:

a. përmbledhja e kumtesës së profesorit Paul Haupt nga Universiteti Johns Hopkins në konferencën e parë të Shoqërisë Gjuhësore Amerikane, 28 dhjetor 1924. Kumtesa e tij kishte titullin "The Influence of Caucasian Idioms on Indo-European Languages" ("Ndikimi i idiomave kauka-

ziane në gjuhët indoeuropiane") dhe përmbledhja u botua në numrin e parë e *Language*-it (1. 1. 16-18). Në këtë përmbledhje, Haupt-i diskutonte lidhjet gjenetike midis fiseve nëpër Euroazi, kryesisht në bazë të emrave të fiseve që janë të ngjashëm. Kështu sugjeronte që "the Albani of the southwestern shore of the Caspian may be identical … with the Albani of Alba Longa (the mother of Rome) and the modern Albanians (south of Montenegro)".[1] Sugjeronte gjithashtu që "Armenia and Auvergne (*Arvenia*) seem to represent the same name".[2] Edhe spekulonte se pozita e prapashtesës se shquar në shqip, bullgarisht dhe rumanisht mund të ketë lidhje me fenomenin e ngjashëm në baskisht dhe në sumerisht. Duhet të themi se tani nuk është e qartë nëse ideja e tillë mund të jetë mbështetur.

b. artikulli i Louis Gray-it nga Universiteti Columbia me titullin "The Inflection of the Present Indicative Active in Indo-European" ("Fleksioni i së tashmes dëftore veprore në *indoeuropianishte*"), që u botua në *Language*, në numër tre (1927) (3. 2. 71-86). Duke u përpjekur të rindërtonte mënyrën dëftore të tashme për proto-indoeuropianishten, Gray-i citonte të dhëna nga shqipja, por të dhënat nuk janë të vendimtare për hipotezën e tij; domethënë, gjuha shqipe luan një rol mbështetës jo të rëndësishëm. Ajo nuk është fokusi i artikullit.

Kur të vazhdojmë në dekadën 1930, gjithnjë duke vështruar revistën *Language*, ndeshim artikullin e parë botuar në Amerikë me temën kryesisht për gjuhën shqipe: "The Phonetics of Albanian" ("*Fonetika e gjuhës shqipe*") nga Guy Lowman-i në numrin tetë të *Language*, në dhjetor të vitit 1932 (8. 4. 271-293).

Duhet të thuhet se suksesi i Europës në albanologji ishte shumë përtej Amerikës. Pedersen-i, Jokl-i, dhe Meyer-i dhe të tjerët kishin botuar shumë artikuj rreth gjuhës shqipe dëri në kohën kur u shfaq artikulli i parë gjuhësor me temën albanologjike në Amerikën Veriore.

Në këtë artikull, Lowman-i deklaronte se Meyer-i është burimi i in-

---

[1] "*Albanët e bregut jugperëndimore të Kaspikut mund të jenë identikë … me Albanët nga Alba Longa (nëna e Romës) dhe shqiptarët modern (në jug të Malit të Zi).*"

[2] "*Armenia dhe Auvernia (Arvenia) duket se përfaqësojnë të njëjtin emër.*"

formacionit rreth fjalëve të huazuara në leksikun e shqipes, por thoshte se ka më shumë fjalë nga gjuha proto-indoeuropiane se sa kishte menduar Meyer-i. Mund të supozojmë se Meyer-i është burimi edhe për deklaratën e Sturtevant-it rreth shqipes dhe për atë të Buck-ut, që do ta shohim së shpejti.

Artikulli i Lowman-it është shumë i rëndësishëm sepse nuk është një vepër historike, por është përshkruese; në këtë mënyrë, ndryshon shumë nga artikulli i Gray-it, për shembull.

Tani, le ta vështrojmë veprën nga Carl Darling Buck-ut nga Universiteti i Chicago-s; në vitin 1933 u botua libri i tij *Comparative Greek and Latin Grammar* ("*Gramatika krahasuese e greqishtes dhe latinishtes*"). U bazua në leksionet që bëri Buck-u gjatë dyzet vjetëve. Buck-u përdorte emrin "Albanian" për gjuhën, por thoshte se "Except for some meager records of the 16th and 17th centuries, the language is known only from recent times".[3] Kjo deklaratë nuk mund të besohej -- *Meshari* i Gjon Buzukut nuk është aq i vjetër sa veprat e degëve të tjera të gjuhëve indoeuropiane, por nuk është "meager" ("*i vogël dhe i varfër*").

Gjithashtu, ndoshta duke marrë informacion nga Meyer-i, Buck-u thoshte këtu se "The largest element of the vocabulary is of Latin origin, and there are also great numbers of Greek, Slavic, and Turkish words".[4] Tani, jemi në pozitë të themi se, megjithëse ka shumë fjalë në shqipen nga latinishtja, fjalët nga gjuha proto-indoeuropiane janë të shumta gjithashtu, siç thoshte Lowman-i, dhe mund të pyesim nëse kishte "great numbers" (domethënë, "*shumë*") fjalë nga greqishtja në leksikun e shqipes.

Më në fund, Buck-u përmend çështjen e origjinës ilire të gjuhës shqipe, por shikonte nëse trakishtja luante një rol në këtë mes dhe nëse ishte një gjuhë *centum* ose *satəm*.

Është dhe një vepër tjetër që botoi Buck-u, domethënë *Dictionary*

---

[3] "*Me përjashtim të disa të dhënave të pakta të shekujve 16 dhe 17, gjuha njihet vetëm nga kohët e fundit.*"

[4] "*Elementi më i madh i leksikut është me origjinë latine dhe ka edhe shumë fjalë greke, sllave dhe turke.*"

of selected Synonyms of the Principal Indo-European Languages ("*Fjalor i sinonimeve të përzgjedhura të gjuhëve kryesore indoeuropiane*"), në vitin 1949. Ky libër ka fjalë nga shumë gjuhë indoeuropiane dhe organizohet mbi bazë të kuptimit jo të formës. Shumë e rëndësishme këtu është se, zakonisht, nuk përfshin fjalë nga shqipja. Buck-u thoshte (f. XI): "Some of the **minor** Indo-European languages, such as Albanian, Armenian, and all modern forms of Indic and Iranian, are excluded from the survey, except for incidental mention, since to include them systematically would increase the labor out of all proportion to the results added".[5] Ndoshta kishte të drejtë, sepse materialet rreth shqipes atëherë në Amerikë nuk ishin të shumtë, kështu që mbetet detyrë për kohën e ardhshme të shtohen të dhënat nga shqipja në katalogun e Buck-ut.

Më në fund, duhet të përmend një libër që kishte një ndikim në Amerikë në këtë kohë, megjithëse nuk u shkrua nga një gjuhëtar amerikan. Ky libër është *The Discovery of Language* ("*Zbulimi i gjuhës*"), dhe e shkroi Holger Pedersen-i, albanologu shumë i njohur europian. Pedersen-i e shkroi në vitin 1924 në danisht me titullin *Sprogvidenskaben i det Nittende Aarhundrede*, si pjesën të serisë *Det Nittende Aarhundrede*, një koleksion i veprave që studiojnë çfarë njihnin dijetarët në degë të ndryshme në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Ky libër u bë i njohur në Amerikë kur u përkthye në vitin 1930 nga John Webster Spargo-i i Universitetit Northwestern dhe u botua në vitin tjetër nga Botimet e Universitetit të Harvard-it. U ribotua në vitin 1962 nga Botimet e Universitetit të Indianës, çka tregon se kishte sukses në Amerikë.

Libri i Pedersen-it përfshin gjashtë faqe rreth gjuhës shqipe me informime të mira – shkruar nga një specialist dhe albanolog – dhe jepnin më shumë informacion se sa gjendet në të gjitha veprat që përmenda këtu, me përjashtim të artikullit të Lowman-it. Gjishtashtu, informacioni

[5] "*Disa nga gjuhët indoeuropiane të vogla, të tilla si shqipja, armenishtja dhe të gjitha format moderne të degëve indase dhe iraniane janë përjashtuar nga anketa, me përjashtim të përmendjes së rastësishme, sepse përfshirja e tyre në mënyrë sistematike do të rezultonte në më shumë punë se sa do të jetë e vlefshme.*"

është më korrekt. Pedersen-i diskutonte relacionin midis gjuhëve ilire dhe shqipe, jepte historinë jogjuhësore të shqipes, komentonte për fillimet e traditës letrare shqipe, jepte një fotografi të Gustav Meyer-it dhe diskutonte vendin e tij në albanologji, jepte disa karakteristika të strukturës së gjuhës dhe një tekst të shkurtë me shënime, të gjitha në gjashtë faqe!

Më duket e përshtatshme të mbarohet këtu, sepse, kur filloi gysma e dytë e shekullit të njëzetë, albanologjia në Amerikë, si rezultat i punës së Eric Hamp-it, filloi të lulëzonte, duke përmbysur trashëgimin e injorancës rreth gjuhës shqipe.

Brian JOSEPH, The Ohio State University:

THE IMAGE OF ALBANIAN AMONG EARLIER AMERICAN LINGUISTS

Summary

In this paper, I chronicle the early references to Albanian in American linguistics literature, focusing on just how much the American linguists knew -- or did not know -- about the language. I examine works of Whitney, Gray, Sturtevant, Sapir, Buck, and Bloomfield in particular. The fact that American linguists were somewhat behind the Europeans in their scholarship on Albanian is of course understandable, but is noteworthy nonetheless. This study not only adds to our understanding of scholarship on Albanian but also sheds some light on the development of linguistic scholarship in America.

Shaban SINANI, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë

ALBANIAN CATHOLIC BULLETIN, NJË DRITARE NDIHMESASH NË SHKENCAT KOMBËTARE NDËR DIJETARËT SHQIPTARO-AMERIKANË

Albanian Catholic Bulletin është një ra prej tribunave shkencore-kulturore shqiptaro-amerikane gati krejt në mënjanësi të studimeve të sotme albanologjike. Për rreth një dekadë e gjysmë (1980-1994), në 15 vëllimet e veta, me mbi 2200 faqe, *Buletini* paraqiti qendrime dhe rezultate të kërkimeve të intelektualëve shqiptarë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të miqve të tyre albanologë në SHBA, pikë së pari për çështje të gjendjes kishtare, të lirisë së besimit dhe të të drejtave të njeriut[1]; dhe më tej për çështje të burimit etnik, të identitetit kombëtar, të fatit historik, të traditës gojore, të trashëgimisë letrare dhe diturore të shqiptarëve në gjithë hapësirën e tyre historike ballkanike dhe kudo nëpër botë. Në vitin 1981, një vit pas daljes së numrit të parë, Francesco Altimari, në një letër drejtuar redaksisë, e vlerësonte *Buletinin* si një tribunë që provonte vitalitetin e bashkësisë së krishterë shqiptare në ekzil, thesarin e shenjtë të trashëgimisë kristiane, që ka përbërë një faktor me rëndësi për formimin e vetë identitetit kombëtar të shqiptarëve[2].

---

[1] *For the past eight years the 'Albanian Catholic Information Center' has tried to keep the public abreast of the religious situation in Albania through news letters and press releases. Now, for the first time, we present our efforts in a new format. It has been a labor of love by a volunteer group of people concerned for the respect of human rights in Albania*. Shih editorialin e Gjon Sinishtaj, në *Albanian Catholic Bulletin*, nr. 1, 1980, p. II.

[2] F. Altimari, letër redaksisë së rev. *Albanian Catholic Bulletin*, vol. II, 1981, p. 5: *Your Bulletin is proof of the vitality of the Albanian Catholic community in exile. In spite of many difficulties you are successful in keeping alive the sacred treasure of Christian faith, an inheritance from our forefathers which has helped maintain our national identity*.

Përveçse në ndonjë rast shumë të rrallë, siç është polemika e provokuar prej disa shkrimeve të bashkëpunëtorit të rregullt të kësaj reviste Stephan Schwartz për *disa shenja antisemitizmi* në prozën e I. Kadaresë, *Buletini Katolik Shqiptar* thuajse nuk është përmendur askund në studimet shqiptare[3]. Nuk ka shenja njohjeje dhe ca më pak referimi tek kjo revistë as në botimet akademike-jubilare kushtuar 2000-vjetorit të Krishterimit, si *Krishterimi ndër shqiptarë* (Shkodër 2000) dhe *2000 vjet art dhe kulturë kishtare në Shqipëri* (akte të simpoziumit ndërkombëtar, botim i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Tiranë 2003). E njëjta gjë mund të pohohet për studimet monografike kushtuar kësaj problematike, që është parësore tek *Buletini Katolik Shqiptar* (ndër të tjera tek Zef Mirdita, *Krishtenizmi ndër shqiptarë*, bot. *Drita* dhe *Misioni Katolik Shqiptar*, Prizren-Zagreb 1998 e Dhori Qiriazi, *Krishterimi në Shqipëri*, Tiranë 2000).

Shkak i mbetjes jashtë bibliografive shqiptare të kësaj reviste për një kohë prej afro dy dekadash duhet të ketë qenë mosnjohja (*Buletini* s'ka mundur të hyjë në bibliotekat shtetërore) dhe ateizmi kushtetues në Shqipëri. Në periudhën e mëvonshme nuk përjashtohet dhe paragjykimi.

Buletini u botua për 12 vjet prej *The Albanian Catholic Information Center* me rezidencë në San Francisco të shtetit California dhe më pas, nga vëllimi XIII (1992), nga *The Albanian Catholic Institute*. Kryeredaktor i saj qe gjatë gjithë kohës Gjon Sinishtaj († 1995). Revista u hap me nismën e tij dhe prej vitit 1994, pas ndarjes së tij nga jeta, nuk doli më. Gjon Sinishtaj është rregullisht autor i editorialeve të revistës dhe gjithashtu njeriu

[3] Shih tek Sh. Sinani, *Letërsia në totalitarizëm dhe Dossier K*, bot. *Naimi*, Tiranë 2011, f. 31-32. Qendrimet e veta kritike ndaj veprës së I. Kadaresë Stephen Schwartz i ka shprehur më me rreptësi në *Ismail Kadare's Prize Fight*, botuar anglisht në periodikun *The Weekly Standard* më 24 mars 1997 dhe po atë vit në artikullin *Under Empty Skies Falconers Weep*, botuar në *Contemporary Poetry Review*, një studim kushtuar poezisë moderne në ish-Jugosllavi, ku gjenden konsiderata tejet kritike për poemën *Përse mendohen këto male*, e cila cilësohet një *poemë ateiste*. Në shqip (por jo në *Albanian Catholic Bulletin*) është botuar një thirrje publike e këtij studiuesi drejtuar Akademisë Suedeze të Shkencave, nën titullin *Mos ia jepni Nobel-in një çiraku partie*. Shih nga Stephen Schwartz dhe: *Kadare si Enveri, s'merr dot Nobelin një shkrimtar që shkarravit noveleçka që lexohen për pushime*, botuar në të përditshmen *Sot*, 13 qershor 2013.

që arriti të krijojë një rreth bashkëpunëtorësh të denjë për një revistë me karakter shkencor, me një profil albanologjik të dallueshëm.

Redaksia e *Buletinit* qysh në themelim ishte ndërshqiptare, ndërkishtare, ndërfetare e ndërkombëtare. Pjesa më e madhe e anëtarëve të saj janë dijetarë prej universiteteve të njohura në SHBA dhe në Europën e Perëndimit. Bashkëpunimet nga Shqipëria e Kosova nisin pas vitit 1990.

Papa Gjon Pali II dhe kryeredaktori i *Albanian Catholic Bulletin* Gjon Sinishtaj gjatë një audience në vitin 1986.

Në pikëpamje të interesimeve, *Buletini* është një revistë *panshqiptare*, por me përparësi krejt të qartë ndaj hapësirës jashtështetërore të Shqipërisë: Kosovës, shqiptarëve në ish-Jugosllavi, më pak Çamërisë, arbëreshëve e arvanitëve, intelektualëve shqiptarë në ekzil politik në Perëndim. Kritik ndaj sistemit politik në Shqipëri dhe përzgjedhës ndaj personaliteteve të saj, sa i takon Kosovës *Buletini* nuk mban kurrfarë anësie si në pikëpamjen ideologjike, kulturore e fetare, ashtu dhe ndaj grupimeve intelektuale të saj. Studimet e I. Ajetit, I. Rugovës dhe R. Ismajlit janë në të njëjtën shkallë vëmendjeje me letërsinë e J. Gërvallës e A. Demaçit. Demonstratat e rinisë në Kosovë në vitin 1981 shndërrohen në problematikë qendrore dhe koleksioni i artikujve dhe studimeve për të drejtën e shqiptarëve për vetëvendosje botuar prej autorësh amerikanë, kanadezë, austriakë e gjermanë; si dhe fotot e rralla të tyre ilustruese të tyre; janë dhe sot një burim i rëndësisë parësore për çdo përpjekje shkencore për një

kronologji të saktë të ngjarjeve të atij viti e më pas.

Buletini pati si qëllim përparësor *historizimin e persekucionit të klerit katolik në Shqipëri*; shpalljen e interesimit publik të Selisë së Shenjtë për bashkësinë e krishterë ndër shqiptarët; të lidhjeve historike-kulturore dhe të kontributeve të tyre ndaj Krishterimit si religjion, mënyrë të menduari, qytetërim e kulturë ndër shekuj; të raporteve ndërkishtare e ndërfetare në botën shqiptare. Pavarësisht këtyre përparësive, *Buletini* ruajti vijimësisht karakterin e vet laik-shekullar, duke qendruar me profilin e saj specifik denjësisht përkrah *Shêjzave*, simotrës së vet më të hershme dhe më të shquar. Megjithëse albanologjia në kuptimin e ngushtë të fjalës dhe historia e Krishterimit në Shqipëri si pjesë e historisë së popullit në *Buletin* janë në një përpjesëtim të zhdrejtë, revista nuk u mor asnjëherë me çështje të karakterit doktrinar dogmatik të teologjisë.

Një *histori e martizimit të klerit katolik në Shqipëri*, prej fillimeve deri në periudhën e ateizmit shtetëror; prej Shën Astit të Durrësit dhe Shën Niketës së Dardanisë deri tek dom Shtjefën Kurti dhe dënimi i meshtarëve të fundmë të besimit të krishterë pas vitit 1967, do të gjente të dhëna të pazëvendësueshme tek ky koleksion. Sot për sot një histori e besimeve ndër shqiptarë nuk ekziston, por në një të ardhme ajo do të paraqitet si doemosdoshmëri shkencore për vetënjohje dhe për emancipim, duke përfshirë relativizimin e mjaft idealizimeve romantike rreth bashkëjetesës ndërfetare, dhe atëherë *Buletini Katolik Shqiptar* do të jetë një ushqim bibliografik themelor. Mund të pohohet se, me botimet dëshmuese dhe kritike, kjo revistë ka shpëtuar prej humbjes fakte dhe burime historike, që për rrethana të njohura, mund të mos gjenden më në arkiva. Bëhet fjalë për akte, dokumente dhe foto që janë botuar si ilustrime të shkrimeve, që sot zëvendësojnë burimin arkivistik. Nga një verifikim i pjesshëm, del se shumë botime me karakter polemik parashkencor të dy dekadave të fundme e kanë shfrytëzuar si një rezervàt të dhënash këtë koleksion, por pa përmendur emrin e tij, përveç ndonjë rasti të rrallë[4].

[4] Rasti i keqpërdorimit në botime të sotme i artikullit *Prenk Doçi (Primus Docci), the First Albanian Resident in North America*, botuar në *Albanian Catholic Bulletin*, vol. VII-VIII,

Synod of the Italo-Albanian Eparchies of Lungro, Piana degli Albanesi and Abby of Grottaferrata, October 1940. For the first time in centuries, a delegation of the Albanian Orthodox Church participated at the Synod. In the center, between Bishop Joseph Perniciaro and Isidoro Croce, is the Bishop of Berat (Albania), Agathangiel Cançe.

Në tërësinë e vet koleksioni sistemon fakte për të krijuar bindjen se hapësira shqiptare qysh prej fillimeve të Krishterimit ka qenë *tokë misioni* jo në kuptimin figurativ, por si projekt dhe qëllim i pandryshuar, për shkak të pikëtakimeve të saj me dy ortodoksitë ballkanike dhe më vonë edhe me një besim tjetër abrahamik, myslimanizmin[5]. *Buletini* pati rastin ta

viti 1986-1987, p. 59, është njëri prej më të njohurve.

[5] Lidhur me këtë mund të krahasohet pikëpamja dhe argumenti i Giovanni Cimbalo-s, në monografinë *Pluralizmi fetar dhe liria e besimit në Shqipëri*, bot. *Naimi*, Tiranë 2015, f. 42, bis f. 199: *Kisha katolike e konsideron Shqipërinë si* ***tokë misioni****, duke qenë se ndodhet shumë pranë ndikimit ortodoks, prandaj ajo varet nga kongregata Propaganda Fide. Kjo e shpjegon gjithë atë vëmendje të veçantë që tregon Selia e Shenjtë kundrejt këtij vendi, kontrollet në nivel papnor për emërimin e hierarkisë kishtare dhe rolin e veçantë që u besohet urdhrave fetarë në drejtimin e vendit dhe ungjillëzimin e tij*. Krhs gjithashtu burimet arkivore të botuara në *L'unione fra l'Albania e l'Italia* (a cura di Silvia Trani), Roma 2007, p. 72-82. Të dhëna të rëndësishme për këtë status të posaçëm të kishës katolike shqiptare gjenden dhe në librin e Francesco Jacomoni-t *La politica dell'Italia in Albania*, Cappelli Editore, 1965. Për më shumë: Matteo Mandalà, *Vepra e Nilo Borgia-s, burim i rëndësishëm për historinë e jugut të Shqipërisë*, parathënie botimit *Murgjit bazilianë të Italisë në Shqipëri: shënime për Himarën* të Nilo Borgia-s, bot. *Naimi*, Tiranë 2014, f. 14. Krhs dhe mendimin e Gjergj Fishtës në memorandumin *Questione nazionale e questione catholica*, që ruhet në AQSH. Një studim rreth këtij dokumenti, me titullin *Besimi dhe kombësia në një vepër të pabotuar të Àt Gjergj*

shqiptonte edhe drejtpërsëdrejti idenë e *uniatizmit kishtar*, përmes artikullit të Steven A. Armstrong, një nga bashkëpunëtorët e përhershëm të tij, titulluar *Arbëreshët, pararendës modernë të ekumenizmit*[6].

Për një përfytyrim bindës të rëndësisë së *Buletinit* si burim njohës për pjesën e historisë së shqiptarëve që ishte jashtë teksteve, duke përfshirë ato akademike dhe universitare; për historinë e feve dhe raportet midis tyre dhe për letërsinë e përjashtuar, mund të përmendim dy fakte.

Fakti i parë ka të bëjë me idenë e krijimit të një kishe kombëtare, të shpallur qysh në dekadën e fundme të shekullit XIX. Ky projekt pati si protagonist Fan Nolin dhe si model uniatizmin ndër arbëreshët e Italisë, një ndërthurje e ritit lindor me varësinë administrative romane. Noli pati arritur të fitonte edhe mbështetjen parimore të Fishtës, megjithëse poeti françeskan nuk kishte besim se ky projekt do të realizohej. Në koleksionin e *Buletinit*, për herë të parë e përjashtimisht, paraqiten të dhëna për pjesëmarrjen e një delegacioni të ipeshkvinjve ortodoksë shqiptarë në sinodin e eparkisë së Lungros (Piana degli Albanesi) dhe të manastirit të Grottaferrata-s, kryeqendër historike e uniatizmit në Italinë e Jugut, mbajtur në vitin 1940[7]. Të dhënat e vërtetueshme të *Buletinit* bëjnë të kuptohen lehtë disa prej pohimeve gati-gati alarmante të dekadës së fundme prej hierarkësh të lartë të KOASH, sipas të cilëve kryeepiskopi shqiptar Kristofor në atë kohë e kishte pranuar në heshtje bashkimin e dy kishave dhe më tej, se rreziku më i madh që i është shfaqur ortodoksisë në Shqipëri gjatë shekullit XX, në fillim gjatë Luftës II Botërore dhe më pas me nisjen e epokës së lirisë fetare, është pikërisht uniatizmi[8].

Fishtës, është botuar në Sh. Sinani, *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të*, bot. *QSA* dhe *Naimi*, Tiranë 2010, f. 20-35.

[6] Steven A. Armstrong, *The Arberesh, Forerunners of Modern Ecumenism*, botuar në *Albanian Catholic Bulletin*, vol. XIII, viti 1992, p. 54-59.

[7] Në *Il Giornale d'Italia*, 15-17 ottobre 1940, kjo ngjarje u cilësua si *il primo Sinodo degli orientali di rito bizzantino* e *dopo cinque secoli un Sinodo e un incontro*.

[8] Shih *Ringritja e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë* (*1991-2012*), nga Fortlumturia e Tij Anastasi, Kryeepiskop i Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë, KOASH, Tiranë 2013, f. 12: *Pas pushtimit italian të Shqipërisë ... vendi u kthye në një provincë të Italisë ... plani kryesor ishte asimilimi i orthodhoksëve nëpërmjet uniatizmit. U bë pro-*

Fakti i dytë ka të bëjë me trashëgimin letrar të Àt Gjergj Fishtës. Të dhënat e njoftuara prej *Buletinit* bëjnë të ditur se një numër veprash të Fishtës mund të jenë edhe sot të pabotuara. Ndër to përmenden këta tituj: *Ushtrimet e para poetike* (poema dhe proza), *Barnabba* (*Barabbas*), *Breshka e Ballkanit*, *Tartari i Ballkanit*, *Kur të bëhem unë Papë*, *Si i do mushka drutë*, *Në vorrimin e Frano Crispi-it, Gjashtë net hënore* (rrëfime popullore shqiptare), *Psikologjia e popullit shqiptar* (prozë), *Fitorja e virtytit ndaj vesit*, *Besimi dhe dija*, *Dashuria e besimtarit katolik është jeta dhe aktiviteti*, *Hajria* (tragjedi e papërfunduar), *Këngët e Francesco Petrarcha-s* etj. Titujt e këtyre veprave *Buletini* i shenjon në gjuhën angleze, e cila është gjuha e botimeve të saj. Ka të ngjarë që *Buletini* të ketë të drejtë për një pjesë të mirë të titujve të përmendur. Ende ka edhe vepra të tjera të pabotuara të Fishtës edhe jashtë kësaj liste, si traktati i shkruar italisht në vitet 1914-1924, *Questione nazionale e questione catholica*.

2. Unpublished: The First Poetical Exercises (prose and poems), Barabbas, Balkan Turtle, The Tartar of the Balkans, When I Became Pope, At the funeral of Frano Krispi, How does the Mule Like Her Load (all satirical poems), For the Latin Alphabet (speech at the Congress of Monastir, 1908), Six Nights Moonshining (Albanian folk stories), The Psychology of the Albanian people (prose), The Triumph of Virtues over Vices, Belief and Knowledge, Love of a Catholic is Life and Activity, Hajrija (unfinished tragedy), Cantos of Francis Petrarcha, etc.

Vepra të pabotuara të Fishtës sipas Zef Nekajt, *Remembring Father Gjergj Fishta, the Albanian National Poet, on the Occasion of his 110th Anniversary*, në *Albanian Catholic Bulletin*, vol. II, viti 1981, 73-79.

Në rrafshin problematik, tematik e sistematik, *Buletini Katolik Shqiptar* mund të pranëvihet e të bashkërenditet me *Hyllin e Dritës* dhe *Leka*-n. Mund të konsiderohet si tribuna më e vonshme e qarkut katolik verior, si për interesat njohës, shqetësimet shkencore e kulturore, raportet me të shkuarën dhe traditën në përgjithësi, ashtu dhe për lexuesin e projektuar dhe rrethin e bashkëpunëtorëve. Nisur prej sloganit, qendron më afër *Hyllit të Dritës*, ose më saktë më pranë urdhërit të françeskanëve. *Credo*-s së

pagandë sipas së cilës theksohej se bashkimi i të gjithë të krishterëve shqiptarë nën mbrojtjen e Vatikanit dhe shtetit të Italisë do të ndihmonte në zhvillimin e vendit. Kryepiskopi Kristofor, sipas disave, kishte pranuar një bashkëpunim me arbëreshët (*'uniatë' me prejardhje shqiptare*). Krhs: Roberto Morozzo dela Rocca, *Nazione e religione in Albania,* ediz. *Besa*, Milano 2001, p. 190.

urdhërit të fretënve minorë *Fe e Atme*, shpallur e ngulitur në mënyrë sovrane në vitet 1930 prej tyre, *Buletini* i shtoi dhe një përbërëse të tretë: *Fe, Atdhe e Përparim*. Ashtu si tek *Hylli i Dritës*, *credo*-ja i vendos njësitë përbërëse, gjegjësisht binomin *Fe e Atme* dhe trinomin *Fe, Atdhe e Përparim* jo në ndërvartësi përjashtuese, por në lidhje përplotësuese[9]. Nuk ka ndonjë hierarki mes tyre dhe trinia nuk është një shumë kuptimore e tre nocioneve, të cilat do të varfëroheshin duke u ndarë më vete. Duhet theksuar se me *Fe*, ashtu si françeskanët dikur, nuk kuptohet besimi i atij që shkruan, feja e autorit, Krishterimi, por feja e gjithsecilit.

Orientimi i *Buletinit Katolik Shqiptar* është konservator, si në pikëpamjen e referencave themelore, ashtu dhe të preferencave të përkohshme. Ky orientim e bën atë përparësisht të interesuar për lashtësinë, traditën, për identitetin, përgjithësisht për të shkuarën. Për të njëjtën arsye, *Buletini* hap rregullisht dritare të qendrueshme për elitat e përjashtuara, për atë pjesë të mendimit dhe veprimit shqiptar që gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX në vështrimin zyrtar të Tiranës, duke përfshirë atë shkencore, quhej *reaksionare*. Kontributet e saj për të ruajtur drejtpeshimin midis elitave tradicionale, më së shumti të ndaluara dhe të përjashtuara, krahas atyre të promovuara nga politika zyrtare në Shqipëri, janë me shumë vlerë. Qendrim ruajtës *Buletini* mbajti dhe në çështjen e raporteve ideologji-komb dhe ndaj procesit të njësimit të shqipes standarde[10].

Në pikëpamje të raporteve midis lëndës njohëse dhe asaj me karakter kërkimor, *Buletini* qendron më pranë *Shêjzave* sesa *Hyllit të Dritës*. Duket qartë se ka qenë në qëllimin e saj të certifikojë katërcipërisht prapësitë e kohës, sidomos dëmet e pariparueshme të ateizmit kushtetues.

---

[9] Në editorialin e numrit të parë, Gjon Sinishtaj e interpreton kështu zgjedhjen e motos së vet: *The combination of the red cross with the black eagle symbolizes the crucifixion in the past and particularly today, of the Albanian nation irrespective of our different religious affiliation. The inscribed words* ***Për Fe, Atdhe, Përparim*** *(****For Faith, Fatherland, Progress****) had been for centuries the motto of Albanian Catholics. As our forefathers were inspired to resist particular evils of the time, so do we feel today propelled to follow their ideals*. Shih *Albanian Catholic Bulletin*, vol. 1, viti 1980, p. II.

[10] Shih Sandalio Solsona, *An Essay in Defense of the Gegh Variant of the Albanian Language*, botuar në *Albanian Catholic Bulletin*, vol. XIII, viti 1993, 114-117.

Revista këtë qëllim kërkon ta arrijë pa hyrë në interpretime e polemika, pa tentuar të orientojë leximin, por thjesht përmes vetëshpalljes dhe vetëdemaskimit të dukurisë. Rasti më domethënës është ai i përkthimit dhe botimit të plotë e pa asnjë koment të artikullit të Hulusi Hakos *Drejt krijimit të një shoqërie tërësisht ateiste*[11]. Shumë të rralla janë rastet e refuzimeve kritike debatuese, si qëndrimi që u mbajt ndaj paraqitjes së kategorive të besimit në *Fjalorin Enciklopedik Shqiptar*[12]. *Buletini* nuk ka dashur të vihet në statusin e një tribune përgënjeshtruese.

Martin Camaj nxënës në shkollën apostolike në Shkodër më 1937. E ruajtur prej dom Prenk Ndrevashajt, botuar në *Albanian Catholic Bulletin*, vol. XIII, 1992, 176.

Ndonëse në mënyrë të pashpallur, duke iu referuar vendit që zë në revistë, figurë-mit e *Buletinit Katolik Shqiptar* është Nënë Tereza, me të cilën vetidentifikohet. Papa Klementi XI dhe papët apostullues në Selinë e Shenjtë në vitet 1980-1990, me interesimet e tyre për shqiptarët, i bashkohen figurës qendrore. Pas tyre zënë vend Gjergj Kastrioti, shenjtorët dhe martirët me origjinë proto-shqiptare e shqiptare, autorët më të hershëm të letërsisë shqipe dhe studimet kushtuar veprës së tyre; protago-

[11] Shih Hulusi Hako, *Toward the Creation of a Totally Atheistic Society*, botuar pa komente në *Albanian Catholic Bulletin*, vol. VII-VIII, viti 1986-1987, p. 24-33.

[12] Pa autor, *Religion in the new 'Albanian Encyclopedia-Dictionary'*, botuar në *Albanian Catholic Bulletin*, vol. IX, viti 1988, p. 32.

nistë të mendimit dhe veprimit shqiptar ndër shekuj, sidomos të përjashtuarit nga historia zyrtare e Shqipërisë dhe historitë e letërsisë dhe të arteve, që formojnë kështu yllësinë e *Buletinit*.

Megjithëse e mbështetur fort në kontributet e emigracionit shqiptar prej fshatrave shqiptare katolike të Malësisë në Mal të Zi dhe e vetmja me një bërthamë të tillë brenda dhe jashtë; megjithëse e lidhur po aq fort me traditën letrare, kulturore dhe shkencore të Shkodrës, revista i tejkalon në mënyrë programore kufijtë lokalë dhe paraqitet e hapur për gjithë hapësirën shqiptare. Kjo revistë bashkoi mendimtarët shqiptarë në SHBA e në Europë, pavarësisht bindjeve, orientimit dhe besimit të tyre, nga Martin Camaj tek Arshi Pipa dhe Namik Ressuli; nga Nikolla Pano e Sami Repishti tek Isuf Luzaj; nga Stavro Skëndi dhe Piter Prifti tek Daniel Gjeçaj, Jusuf Gërvalla e Adem Demaçi; nga Zef Oroshi, Anton Logoreci dhe Eleuterio Fortino tek Vinçenc Malaj e Gjergj Gjergj-Gashi, autor i një disertacioni për kriptokrishterimin në Stubëll; nga Rexhep Krasniqi e Viktor Dosti tek Sejfi Protopapa e dom Lush Gjergji. Në revistë iu kushtua vëmendje veprës së studiuesve albanologë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës e në Europë: Albert Lord-it e John Colts-it dhe kërkimeve të tyre rreth eposit legjendar të shqiptarëve; Leonard Newmarc-ut dhe Philip Hubbard-it si hartues të një gramatike universitare të shqipes; Martin E. Huld-it dhe librit të tij *Basic Albanian Etymologies*; Enzo Gatti-t dhe studimit të tij për ilirët (*The Illyrians*), Charles Ewert-it dhe historisë në formë romani *Scanderbeg-Eagle of Albania*, Odile Daniele-s dhe punimeve të saj etnofetare dhe etnogjuhësore; si dhe veprimtarisë së disa personaliteteve të lidhur në një mënyrë të tërthortë me botën shqiptare, ndër të cilët dhe Cristia Maksutovici, Odette Marquet e Aleksandër Zotos.

Sa u takon studimeve të botuara për letërsinë shqipe, të traditës dhe bashkëkohore, *Buletini* ka qenë selektiv dhe me prirje kritike. Një histori e receptimit të letërsisë shqipe gjatë gjysmës II të shekullit XX do ta kishte të domosdoshme përfilljen e mendimit kritik-letrar të studiuesve të botuar në këtë revistë. Vendin qendror, me studime rreth veprës së tyre dhe përkthime në gjuhën angleze, e zënë tre të mëdhenjtë e traditës

shkodrane: Fishta, Koliqi dhe Camaj. Poezia shqipe në Kosovë, me Ali Podrimjen dhe Azem Shkrelin, është gjithashtu e parapëlqyer. *Albanian Catholic Bulletin* ofron mundësi të dukshme studimore sidomos për poetë e shkrimtarë minorë dhe për studiues pak ose aspak të njohur; duke përfshirë albanologë amerikanë që mund të kenë bashkëpunuar me të kryesisht për shkak të njohjeve personale me Gjon Sinishtajn a anëtarë të tjerë të redaksisë. Stephen Schwartz gjithë meritën për lidhjet e tij me Shqipërinë ia njeh kryeredaktorit Sinishtaj, të cilin e cilëson *baba të dytë*[13].

Në fushë të letërsisë bashkëkohore në fundin e viteve 1980 iu kushtuan disa shkrime kritike e recensionuese sidomos romaneve të I. Kadaresë. Përveç artikujve të Stephen Schwartz-it dhe të Robert Elsiesë, dy prej bashkëpunëtorëve të rregullt të saj, për veprën e Kadaresë botoi edhe gjuhëtarja Janet Byron, autore e monografisë së hershme *Selection Among Alternates in Language Standardization: the Case of Albanian*. Në disa raste studimet janë marrë prej revistash të tjera, kryesisht për të mbitheksuar paanësinë e revistës, si studimi i Janet Byron-it *Albanian Nationalism and Socialism in the Fiction of Ismail Kadare*[14] dhe shkrimi tjetër i saj *Albanian Folklore and History in the Fiction of Ismail Kadare: A Review of Two French Translations*, një vështrim kritik për variantet frëngjisht të dy romaneve të tij *Le pont aux trois arches* dhe *Avril brisé*[15]. Për veprën e I. Kadaresë janë paraqitur dhe rezerva e dyshime, veçmas për ato raste ku shkrimtari ka mbajtur qendrim kritik, hapur a tërthorazi, ndaj letërsisë së qarkut katolik veriperëndimor. Pamja më kritike e revistës ndaj Kadaresë shpërfaqet në artikullin e Stephen Schwartz-it *The Palace of Hallucianations: Does Ismail Kadare Deserve the Nobel Prize*; kurse pamja

[13] Stephen Schwartz, *Kadare si Enveri, s'merr dot Nobelin një shkrimtar që shkarravit noveleçka që lexohen për pushime*, botuar në të përditshmen *Sot*, 13 qershor 2013.

[14] Janet Byron, *Albanian Nationalism and Socialism in the Fiction of Ismail Kadare*, botuar së pari në *World Literature Today*, vol. 53, nr. 4, 1979, pp. 614-616.

[15] Janet Byron, *Albanian Folklore and History in the Fiction of Ismail Kadare: A Review of Two French Translations*, një vështrim kritik për variantet frëngjisht të dy romaneve të tij *Le pont aux trois arches* dhe *Avril brisé*, në *World Literature Today*, vol. 58, nr. 1, winter, 1984, pp. 40-42.

më e shtendosur mund të shenjohet në artikullin e shkrimtarit të dënuar Amik Kasoruho *The Ransom of Notoriety an Albanian dissident's view of Ismail Kadare*. Midis studiuesve që përcollën me recensione e artikuj kritikë-studimorë botimet e I. Kadaresë zënë vend dhe Zef Nekaj, me artikullin *From one December to Another: Chronicles, Correspondence, Meditations* (Fayard 1990)[16], si dhe dy autorë amerikanë, Brian Curdy e James Torrent, të tre njëherësh anëtarë të redaksisë.

Kriticizmi ndaj veprës së Kadaresë nuk mund të shihet si dukuri e personalizuar, por si vijimësi parimore. Nëse në numrin e 14-të (viti 1993) *Buletini* boton njëri pas tjetrit dy artikuj kontrastues: *Gjyqtari dhe i gjykuari: Hoxha dhe Kadare* nga Stephen Schwartz dhe *Kasem Trebeshina, shkrimtari që nuk pranoi të bënte kompromis me Hoxhën*[17] prej Robert Elsie-së, kjo shkon në pajtim me konceptin editorial për përparësinë e së ndaluarës ndaj së lejuarës. Qortimet e *Buletinit* ndaj Kadaresë më së shumti kanë të bëjnë me qëndrimet publike të tij se me artin krijues, siç mund të dëshmohet dhe prej artikullit të Tom Hoopes *Ismail Kadare, një i vonuar në betejën për të drejtat e njeriut*[18]. Për të njëjtat arsye koherente, kur Kadare ka qenë nën mbikëqyrjen dhe ndëshkimin e shoqërisë së vigjilencës, si rasti i romanit *Pallati i Endrrave*, *Buletini* ka qenë qartësisht përkrah tij[19]. Pas viteve 1990 I. Kadare paraqitet edhe si i intervistuar dhe me një profil krijues analitik. Ka pasur njëfarë ekzagjerimi në lidhje me kriticizmin tendencioz të *Buletinit* ndaj Kadaresë.

Buletini ka qenë i vëmendshëm sidomos ndaj shkrimtarëve të traditës më të hershme, me ç'rast ka mundur të bashkojë kontribute studiue-

---

[16] Zef Nekaj, *From one December to Another: Chronicles, Correspondence, Meditations* (Fayard 1990), botuar në *Albanian Catholic Bulletin*, vol. XIII, viti 1993, p. 126-133.

[17] Stephen Schwartz: *The Judged and the Unjudged: Nexhmije Hoxha and Ismail Kadare*, botuar në *Albanian Catholic Bulletin*, vol. XIV, viti 1993, p. 61-61; po aty, Robert Elsie, *Kasem Trebeshina: the Writer Whon Would not Compromise with Hoxha*, p. 64-66.

[18] Tom Hoopes, *Ismail Kadare, A Late-Comer to Albania's Human Rights Struggle*, botuar në *Albanian Catholic Bulletin*, vol. XII, 1991, 88-91.

[19] Pa autor, *Communist Leaders Attach Kadare, Leading Albanian Author*, në *Albanian Catholic Bulletin*, vol. III, viti 1982, p. 110.

sish thuajse nga gjithë bota shqiptare. 300-vjetori i botimit të *Cuneus prophetarum*, bie fjala, u përkujtua me studime të Luigj Marlekajt, Ibrahim Rugovës e Engjëll Sedajt, krahas ndihmesave të vetë redaksisë së revistës.

Ernest Koliqi, Martin Camaj e Krist Maloki: Romë 1962. Botuar për herë të parë në *Albanian Catholic Bulletin*, vol. XV, viti 194, 203.

Refuzuese ndaj zhvillimeve politike dhe ideologjike në Shqipërinë shtetërore, *Buletini* ndoqi me shumë simpati dhe ofroi informacion e interpretime të besueshme për zhvillimet e reja në Kosovë që nga viti 1981; plotësoi boshësinë që linin shkencat albanologjike ndaj një pjese të letërsisë dhe të dijes që ishin shpallur jashtë objektit të tyre (ndaj letërsisë dhe dijeve të ndaluara); u ofroi hapësirë e nderim atyre albanologëve të huaj, sidomos amerikanë, por dhe të tjerë, që ishin shpallur të padëshiruar në Shqipëri; u kushtoi vëmendje përparësore ngulimeve të hershme shqiptare, arbëreshëve dhe arvanitëve, por dhe ngulimeve më të vogla e më të vonshme, thuajse jashtë qëllimeve të albanologjisë zyrtare; ndoqi me vëmendje jetën letrare dhe shkencore në gjithë hapësirën shqiptare dhe ua bëri të njohur atë botës shqiptaro-amerikane dhe lexuesit të huaj, duke mbajtur në funksion urat e domosdoshme të ndërkomunimit midis dy botësh të ndara; mori pjesë në debatet themelore për letërsinë shqipe të realizmit socialist duke përfshirë ato për veprën e I. Kadaresë, M. Camajt dhe shkrimtarët e periudhës ndërmjet dy luftërave (Gj. Fishta, E.

Koliqi, F. Konica, M. Kuteli, L. Poradeci, K. Maloki, N. Ressuli, G. Schirò).

Buletini Katolik Shqiptar deri në vitin 1990 doli vetëm në gjuhën angleze, kurse në pesë vitet e fundme pati dhe një shtojcë me shkrime të shkurtra shqip, kryesisht me karakter informues.

Koleksioni i kësaj reviste është me rëndësi për njohjen e veprimtarisë intelektuale shqiptare në SHBA, sidomos të shqiptarëve të Malit të Zi dhe të atyre që u bashkuan me ta për simpati apo për ideal shkencor. Ai është një enciklopedi e vogël e përurimit të një numri të konsiderueshëm shkrimtarësh e studiuesish shqiptarë, që janë shfaqur kryesisht ose vetëm përmes tij. Ky koleksion herët a vonë do të jetë e nevojshme t'i bashkohet bibliotekës albanologjike dhe të integrohet në studimet shqiptare. Përgatitja e një bibliografie të anotuar dhe publikimi i numerizuar i koleksionit të *Albanian Catholic Bulletin* do të kishte qenë vetëm një hap i parë për riintegrimin e tij në studimet shqiptare.

Vula historike e franceskanëve shqiptarë, ruajtur nga meshtarët në ekzil, botuar në *Albanian Catholic Bulletin*, vol. XI, 1990, p. 25.

Trinia e *Albanian Catholic Bulletin*: *Fe, Atdhe e Përparim*

Bibliografi:

ALTIMARI, Francesco, *Letër drejtuar redaksisë* së revistës *Albanian Catholic Bulletin*, vol. II, viti 1981, p. 5.

ANASTASI (Fortlumturia e Tij), *Ringritja e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë* (*1991-2012*), bot. *KOASH*, Tiranë 2013, f. 12.

ARMSTRONG, Steven A., *The Arberesh, Forerunners of Modern Ecumenism*, në *Albanian Catholic Bulletin*, vol. XIII, viti 1992, p. 54-59.

BYRON, Janet, *Albanian Folklore and History in the Fiction of Ismail Kadare: A Review of Two French Translations*, në *World Literature Today*, vol. 58, nr. 1, winter, 1984, 40-42.

BYRON, Janet, *Albanian Nationalism and Socialism in the Fiction of Ismail Kadare*, në *World Literature Today*, vol. 53, nr. 4, 1979, pp. 614-616.

CIMBALO, G., *Pluralizmi fetar dhe liria e besimit në Shqipëri*, Naimi, Tiranë 2015, 42-199.

DELLA ROCCA, Roberto Morozzo, *Nazione e religione in Albania,* ed. *Besa*, Milano 2001, 190.

ELSIE, Robert, *Kasem Trebeshina: the Writer Whon Would not Compromise with Hoxha*, në *Albanian Catholic Bulletin*, vol. XIV, viti 1993, p. 64-66.

FISHTA, Gjergj, *Questione nazionale e questione catholica*, dorëshkrim, ruhet në AQSH, Fondi *Gjergj Fishta*.

HAKO, Hulusi, *Toward the Creation of a Totally Atheistic Society*, në *Albanian Catholic Bulletin*, vol. VII-VIII, viti 1986-1987, p. 24-33.

HOOPES, Tom, *Ismail Kadare, A Late-Comer to Albania's Human Rights Struggle*, në *Albanian Catholic Bulletin*, vol. XII, 1991, 88-91.

JACOMONI, Francesco, *La politica dell'Italia in Albania*, Cappelli Editore, Firenze 1965.

MANDALÀ, Matteo, *Vepra e Nilo Borgia-s, burim i rëndësishëm për historinë e jugut të Shqipërisë*, parathënie botimit *Murgjit bazilianë të Italisë në Shqipëri: shënime për Himarën* të Nilo Borgia-s, bot. *Naimi*, Tiranë 2014, f. 14.

NEKAJ, Zef, *From one December to Another: Chronicles, Correspondence, Meditations* (Fayard 1990), në *Albanian Catholic Bulletin*, vol. XIII, viti 1993, p. 126-133.

Prenk Doçi (Primus Docci), The First Albanian Resident in North America, në *Albanian Catholic Bulletin*, vol. VII-VIII, viti 1986-1987, p. 59.

PA AUTOR, *Communist Leaders Attach Kadare, Leading Albanian Author*, në *Albanian Catholic Bulletin*, vol. III, viti 1982, p. 110.

PA AUTOR, *Religion in the new 'Albanian Encyclopedia-Dictionary'*, në *Albanian Catholic Bulletin*, vol. IX, viti 1988, p. 32.

SCHWARTZ, Stephen, *Ismail Kadare's Prize Fight*, në *The Weekly Standard*, 24 mars 1997.

SCHWARTZ, Stephen, *Kadare si Enveri, s'merr dot Nobelin një shkrimtar që shkarravit noveleçka që lexohen për pushime*, në të përditshmen *Sot*, 13 qershor 2013.

SCHWARTZ, Stephen, *The Judged and the Unjudged: Nexhmije Hoxha and Ismail Kadare*, në *Albanian Catholic Bulletin*, vol. XIV, viti 1993, p. 61-61.

SCHWARTZ, S., *Under Empty Skies Falconers Weep*, në *Contemporary Poetry Review*, 1997.

SINANI, Shaban, *Besimi dhe kombësia në një vepër të pabotuar të Àt Gjergj Fishtës*, në *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të*, bot. *QSA*, Tiranë 2010, f. 20-35.

SINANI, Shaban, *Letërsia në totalitarizëm dhe Dossier K*, bot. *Naimi*, Tiranë 2011, f. 31-32.

SINISHTAJ, Gjon, Editorial në *Albanian Catholic Bulletin*, nr. 1, 1980, p. II.

SOLSONA, Sandalio, *An Essay in Defense of the Gegh Variant of the Albanian Language*, në *Albanian Catholic Bulletin*, vol. XIII, viti 1993, 114-117.

TRANI, Silvia (a cura di) *L'unione fra l'Albania e l'Italia*, Roma 2007, p. 72-82.

Shaban SINANI, Tirana

ALBANIAN CATHOLIC BULLETIN, A WINDOW OF SUPPORT TO NATIONAL SCIENCE BY ALBANIAN-AMERICAN SCHOLARS

Summary

The *Albanian Catholic Bulletin* is a unique Albanian-American scientific-cultural outlet that dealt with the studies of the contemporary Albanian for around one and a half decades (1980-1994). In 15 volumes and over 2,200 pages it brought the viewpoints and results of the studies made by Albanian intellectuals in the United States and those of their colleagues in the United States who showed interest on ethnic background, historic destiny, oral tradition, and literary heritage of the Albanians in their historic Balkan milieu and elsewhere in the world.

The bulletin was published for 12 years by the Albanian Catholic Information Center based in San Francisco, California. Later, starting from the eighth volume (1992), it was published by the Albanian Catholic Institute. During the whole time its chief editor was Xhon Sinishta (d.1995). Since the outset, the editorial staff of the bulletin involved members of different religious, confessional, and national background.

The A*lbanian Catholic Bulletin* was critical of the political and ideological developments in Albania; it offered credible information on the developments in Kosovo since 1981; it filled the gap of treating the part of Albania literature and knowledge that was banned, and offered space for expression to foreign scholars of Albanian, those of the United States, in particular, and others, who were declared as unwanted in Albania; attached a great deal of attention to the early Albanian settlements of Arbresh and Arvanites; and it became involved in fundamental debates on the socialist realism literature, including the oeuvre of I. Kadare, M. Camaj, and authors of the period between the two world wars (Fishta, Koliqi, Konica, Kuteli, Poradeci, Maloki). Until 1990, the A*lbanian Catholic Bulletin* came out only in English, while over the last five years it also included short articles in Albanian.

The collection of this magazine is of a high importance for all those who show interest in the Albania intellectual activity in the United States, especially of the Albanians of Montenegro and those who show sympathy for them for the sake of scientific ideals. It is a small encyclopedia on a considerable number of writers, scholars of Albanian studies, who published mainly or exclusively in this magazine. Sooner or later, it will become a very valuable asset of the Albanian libraries and as such it should be integrated into the Albanian studies.

Seit MANSAKU, Tiranë

HUMBJA E PASKAJORES NE GJUHËN SHQIPE, HIPOTEZA DHE TË VËRTETA SHKENCORE

Nxitjen për të përgatitur këtë kumtesë me këtë temë ma dha vepra e studiuesit të mirënjohur amerikan Brian D. Joseph *The Synchrony and Diachrony of the Balkan Infinitive, A study in areal, general and historical lingustics*, botim i Universitetit të Kembrixhit, që pati mirësinë të ma dërgonte akademik Rexhep Ismajli, të cilin e falënderoj shumë me këtë rast. Në këtë botim autori ka bërë një vështrim të shumanshëm të kategorisë gramatikore të infinitvit në gjuhët e Ballkanit si nga pikëpamja e gjuhësisë historike, ashtu edhe nga pikëpamja e gjuhësië areale dhe e gjuhësisë së përgjithshme. Ai ka parashtruar me një qartësi të admirueshme problematikën komplekse që paraqet studimi i kësaj kategorie gjuhësore në gjuhët e ndryshme të Ballkanit, duke përcjellë rezultatet e studimeve të derisotme, duke bërë vlerësimin kritik tezave dhe hipotezave të ndryshme që janë shprehur e mbrojtur nga studiues të ndryshëm dhe duke i pasuruar ato me analizat dhe përfundimet e tij.

Autori së pari ka bërë përpjekje për të përkufizuar dhe dalluar kategorinë e foljeve vetore dhe të foljeve pavetore, trajta foljore të shtjelluara dhe të pashtjelluara, siç janë quajtur në studimet tona gramatikore (finiteness end infinitives), një çeshtje e rrahur e gjuhësisë së përgjithshme. Ai ka bërë përpjekje serioze për të gjetur disa kritere relevante sipas të cilave mund të dallohen këto dy kategori të sistemit foljor dhe për të përcaktuar vendin që zë paskajorja midis trajtave të tjera pavetore. Për këtë autori merr parasysh si kriterin morfologjik ashtu edhe kriterin sintaksor, funksionet që ajo kryen dhe gjymtyrët me të cilat ajo hyn në marrëdhënie të caktuara sintaksore. Kjo është e rendësishme edhe për shqipen që zotëron disa forma pavetore a të pashtjelluara që kanë veçoritë e

tyre morfositaksore, siç janë trajtat *me punue*, *pa punue*, *pa punuar*, *tue punue, duke punuar, për të punue për të punuar dhe punue, punuar.* Në mënyrë të veçantë për shqipen është i rendësishëm dallimi midis trajtave të paskajores dhe trajtave të pjesores, që, me sa duket, janë përzier njera me tjetrën gjatë evolucionit historik të tyre.

Sqarimi i kësaj çeshtjeje mbi bazën e përcaktimit të disa kritereve relevante, lidhet edhe me problemet e tjera që trajtohen në këtë vepër, siç janë shkaqet e humbjes së paskajores në gjuhët e Ballkanit dhe zëvendësimi i saj me trajta të tjera foljore, kryesisht me mënyrën lidhore, pasojat që ka sjellë dhe që mund të sjellë në tipologjinë e gjuhëve të Ballkanit humbja e infinitivit dhe zëvëndësimi i tij me trajta të tjera vetore të foljes, kryesisht me trajtat e mënyrës lidhore, perspektivat e zhvillimeve të mëtejshme të kësaj dukurie në këto gjuhë. Autori ka bërë dhe një histori të lindjes, zhvillimit dhe të humbjes e të zëvendësimit të infinitivit në gjuhët e Ballkanit, në greqishte, në shqipe, në sllavishten e Jugut dhe në rumanishte, duke bërë një parashtrim dhe vlerësim kritik të tezave dhe hipotezave që janë shprehur në botime të ndryshme shhkencore për këto çeshtje.

Studimi ka vlera të veçanta edhe nga pikëpamja e motodologjisë shkencore që ndiqet në trajtimin e çeshtjeve të ndryshme: shtjellohen e sqarohen probleme teorike të përgjithshme, vështohen problemet e infinitivit në secilën prej gjuhëve të Ballkanit, historia e tyre dhe gjendja aktuale, nxiren përfundime të veçanta për secilën gjuhë dhe pastaj bëhen përgjithësime e nxirren përfundime në rrafshin e gjuhësisë ballkanike dhe më gjerë.

Siç dihet, për infinitivin, për humbjen dhe zëvëndësimin e tij me trajta foljore vetore në gjuhët Ballkanit është shkruar shumë nga gjuhëtarë e studiues të mirënjohur, nga balkanologë dhe albanologë. Mund të përmenden këtu studiues të shquar si: H. Pedersen-i, N. Jokl-i, Kr. Sandfeld-i, I. Bacinschi, G. Weigand-i, M. Gabinskij, E. Çabej, S. Riza, Sh. Demiraj, B. Bokshi, K. Topalli etj. Në rrafshin sinkronik, për gjendjen e sotme të paskajores së shqipes dhe marrëdhëniet e saj me gjuhën standarde ka botuar një vepër të veçantë dr. Nuhi Veselaj, *Paskajorja dhe standardizimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë 2006. Një vepër të veçantë për format e pashtjelluara në gjuhën shqipe ka botuar edhe prof. Mehmet Çeliku, *Format e*

pashtjelluara në gjuhën shqipe, Tiranë, 2013. (U kërkoj ndjesë shumë studiuesve të tjerë që nuk arrij t'i përmend në këtë kumtim). Megjithatë në këtë litetraturë të gjerë që ka për këtë çështje, vepra e prof. Joseph-it ka vendin e vet për origjinalitetin e saj, për metodologjinë shkencore që ka përdorur në mënyrën e kapjes dhe të shtrimit të problemeve, të trajtimit dhe të zgjidhjes së tyre.

Unë në këtë kumtesë dëshiroj të ndalem në problemin mjaft të rrahur të humbjes së infinitvit dhe të zëvëndësimit të tij me trajta foljore vetore në gjuhën shqipe, që mbahet si njëri nga tiparet themelore të përbashkëta morfosintaksore të gjuhëve të Ballkanit. Është një problem i cili është trajtuar mjaft gjerë në veprën e prof. Joseph-it.

Në gjuhën shqipe, kur flitet për humbjen e paskajores dhe zëvendësimin e saj me mënyrën lidhore, shpesh here bëhet fjalë për dy periudha dhe për dy situata të ndryshme gjuhësore. Një palë studiuesish kanë parasysh humbjen e një trajte të vjetër të një paskajoreje sintetike dhe një palë tjetër me humbje të paskajores kanë parasysh mungesën e trajtës së paskajores gege të tipit *me punue* në dialektin jugor të shqipes.

Në të dyja rastet me terma realë vështirë se mund të flitet me siguri për humbje të paskajores dhe zëvendësimin e saj me lidhoren si tipar ballkanik i shqipes. Përse? Sepse, nëse kemi parasysh një paskajore të vjetër sintetike në gjuhën shqipe, nuk mund të flitet për humbje të saj për sa kohë që ekzistenca e një trajte të tillë ende nuk është dëshmuar e vërtetuar në mënyrë të pakundërshtueshme. Ekzistenca e një paskajoreje të vjetër sintetike për shqipen deduktohet nga gjuhësia krahasuese duke u nisur nga prania e një trajte të tillë në shumë gjuhë indoeuropiane. Në të vërtetë gjasat janë që edhe shqipja, në një fazë të caktuar të zhvillimit historik të saj, si shumica e gjuhëve indoeuropiane, të ketë pasur një trajtë të veçantë foljore emërore që shprehte një veprim abstrakt në përgjithësi, të pakonkretizuar në vetë, në numër dhe në kohë, por për shkak të dokumentimit të vonë me shkrim të shqipes një trajtë e tillë vetëm sa mund të supozohet, por jo të dëshmohet e të vërtetohet. Ekzistencën e një paskajorje sintetike në shqipen e lashtë e kanë pohuar një varg gjuhëtarësh të njohur si H. Pedersen-i, N. Jokl-i, Gj. Pekmezi, La Piana, A. Xhuvani, M. Domi, S. Riza, Sh. Demiraj, B. Bokshi, K. Topalli etj.

Nga ana tjetër, nuk mund të flitet për humbje të paskajores së tipit *me punue* në shqipe, për sa kohë që ajo përdoret gjërësisht sot në arealin gjuhësor gegë dhe sporadikisht në arealin jugor. Gjithashtu nuk mund të flitet për humbje të kësaj paskajoreje as në toskërishte për sa kohë që ekzistenca e saj e dikurshme në këtë dialekt ende nuk është provuar në mënyrë të pakundërshtueshme. Por edhe sikur të provohet me të dhëna të reja të mjaftueshme ekzisteca e paskajores me *me* në dialektin e Jugut, do të mund të flitnim për humbje të paskajores në toskërishte, jo për humbje të paskajores dhe zëvendësimin e saj me trajta të mënyrës lidhore në gjuhën shqipe. Dialekti i Jugut, edhe pse është në bazë të gjuhës standarde shqipe, në rrafshin e zhvillimeve historike, nuk mund të identifikohet me gjuhën shqipe në përgjithësi..

Nga ana tjetër, edhe po të marrin si pikë referimi gjuhën standarde shqipe në të cilën nuk është përfshirë paskajorja gege, nuk mund të bëhet fjalë për humbje të paskajores; ajo ka në sistemin e saj foljor një paskajore të tipit *për të punuar*, e cila dëshmohet e formuar si trajtë foljore që nga shekulli XVII në veprën e P. Bogdanit. Edhe pse kjo paskajore, si nga forma ashtu edhe nga funksionet sintaksore, nuk është e barasvlershme as me një paskajore sintetike të supozuar, as me paskajoren gege të tipit *me punue*, por jo krejt e pangjashme me këtë të fundit, ajo i ka veçoritë e një paskajoreje josintetike me funksione ende të kufizuara, por gjithnjë e më shumë përvijohet prirja për t'i zgjeruar funksionet e saj dhe për t' u përdorur ajo në disa funksione që janë karakteristike për paskajoren e mirëfilltë, ose për lidhoren, siç është p. sh. funksioni kundrinor ose kryefjalor. Në shqipen e sotme dëgjohen dhe shkruhen jo rallë ndërtime të tilla: *vendosa për të shkuar* në vend të *vendosa të shkoj* ose *vendosa me shkue*; *kam dëshirë për të studiuar* në vend të *kam dëshirë të studioj* ose *kam dëshirë me studiue*, *është e vështirë për të vendosur* në vend të *është e vështirë të vendosësh,* ose *është e vështirë me vendosë*. Këto ndërtime sigurisht që kanë dallime në nivelin e ligjërimit, por këto dallime nuk vijnë në vështrim, kur është fjala për shqyrtime tipolgjike, ose për prirje të zhvillimit të gjuhës. Pra do të thosha se, edhe duke pasur parasysh gjuhën standarde, nuk mund të flitet për humbje të paskajores në gjuhën shqipe. Pra po ta vështrojmë shqipen nga kjo pikëpamje, ajo nuk merr pjesë në tiparin ballkanik të humbjes së paskajores dhe të zëvendësimit të saj me lidhoren. Në

tërësinë e saj me këtë tipar shqipja është më afër tipologjisë së gjuhëve romane perëndimore që përdorin edhe paskajoren edhe lidhoren, sesa me gjuhët ballkanike ku paskajorja është zëvëndësuar plotësisht ose pjesërisht me lidhoren

Për sa i përket ekzistencës së një paskajoreje sintetike të trashëguar nga indoeuropianishtja, studiuesi i mirënjohur amerikan Brian D. Joseph në veprën e tij *The Synchrony and Diachrony of the Balkan Infinitive,* Cambridge University Press 1983, p. 93 parashtron me mprehtësi tri alternativa të mundshme:

a. Në prehistori shqipja nuk ka pasur kurrë një infinitiv

b. Shqipja ka trashëguar një infinitiv nga indoeuropianishtja, por e ka humbur atë në periudhën prehistorike dhe e ka zëvendësuar atë me trajta foljore vetore (finite).

c. Shqipja ka trashëguar një infinitiv nga indoeuroipanishtja dhe e ka zëvendësuar atë, ose e ka rikrijuar në njerën a më shumë prej mënyrave të formuara në dialektet e pranishme.

Supozimi i bërë në pikën *a* nënkupton domosdo që sistemi infinitivor të ketë qenë një tipar dialektor i indoeuropianishtes dhe që shqipja vijon atë dialekt të indoeuropianishtes në të cilin infinitivi nuk ishte zhvilluar në atë shkallë sa ç' kishte përparuar në vise (gjuhë) të tjera. Në parim është një supozim krejt i mundshëm, sepse, siç, kanë dëshmuar studimet etimologjike indoeuropiane, por edhe ato në fushën e gramatikës historike, shumë fjalë dhe trajta gramatikore të gjuhëve të sotme indoeuropiane nuk shpjegohen duke u nisur nga një trajtë bazë e njësishme për të gjithë truallin indoeuropian, por gjejnë shpjegim në rrafshin e dialektologjisë indoeuropiane.

Supozimi i bërë në pikën *b* nënkupton që shqipja po kalonte drejt një periudhe të prehistorisë së saj në të cilën nuk kishte infinitivë pas një periudhe në të cilën ai ishte bërë (formuar). Interpretimet e këtij lloji, mendon Brian, mbështeten nga ata studiues të cilët përpiqen të shpjegojnë humbjen e infinitivit në gjuhët e Ballkanit nga kontaktet me shqipen e hershme si një gjuhë substrate pa infinitiv.[20] Kjo hipotezë është e vësh-

[20] Brian D. Joseph, *The Synchrony and Diachrony of the Balkan Infinitive, A study in areal, general and historical, linguistics, Cambridge studies in linguistics* 18, Cambridge Universiy Press, 1983, p. 93

tirë të provohet, sepse gjuhët e vjetra substrate prej të cilave buron shqipja, nuk njihen dhe nuk dihet a kanë njohur apo jo një trajtë të paskajores. Siç ka theksuar me të drejt në veprën e tij prof. Brian[21], të dhënat gjuhësore që kemi nga ilirishtja dhe trakishtja janë të pamjaftueshme për të krijuar një ide për tipologjinë e këtyre gjuhëve. Edhe më e pamundur është të provosh se mungesa e paskajores në shqipen e vjetër, ose më saktë në parashqipen të ketë ndikuar në zhdukjen e paskajores në gjuhët e tjera të Ballkanit. Kjo hipotezë del e pambështetur edhe duke pasur parasysh situateën gjuhësore të shqipes së sotme: Shqipja ka një paskajore të tipit *me punue*, *me thanë*, e cila nuk duket të jetë shumë e vjetër, por jo shumë larg nga periudha kur shqipja u formua si gjuhë e veçantë e dalë nga ilirishtja ose trakishtja. Kështu që hipoteza e një ndikimi të substratit ilir a trak në zhdukjen e infinitivit në gjuhët ballkanike, mbrojtur nga G. Weigand dhe të tjerë, mendoj se duhet të konsiderohet e tejkaluar. Këtë tezë e ka vënë në dyshim edhe Shaban Demiraj, i cili është marrë gjerësisht me problemin e paskajores.[22] Po kështu edhe prof. Brian në veprën në fjalë. Është interesant të vihet në dukje se tezën e ndikimit të substratit trak në humbjen e infinitivit në gjuhët e Ballkanit e mbrojnë ata studiues që mbështesin tezën e prejardhjes trake të gjuhës shqipe. Me sa duket, ata nisen nga rethanat e rumanishtes, në të cilën trajta e infinitivit ka ndjekur një rrugë zhvillimi të ndryshme nga gjuhët e tjera romane perëndimore, çka jep shkas për të supozuar një ndikim nga substrati trak. Por kjo hipotezë nuk mund të vlejë për shqipen dhe për gjuhët e tjera ballkanike.

Sipas autorit, megjithëse nuk është e qartë të vendosësh, të mbash qëndrim mbi interpretimet e mundshme që u bënë më lart, të dy supozimet *a* dhe *b* paraqesin (ngrejnë, shtrojnë) një problem që ka të bëjë me zhvillimet e mëvonshme të shqipes. Në veçanti të dyja interpretimet e bëjnë të vështirë shpjegimin e lindjes së mëvonshme të një infinitivi në secilin prej dialekteve të shqipes (f.94).

Ne kemi mendimin se për çeshtjen e infinitivit dhe të humbjes së tij në gjuhën shqipe duhet të nsemi nga gjendja e shqipes në fazën e saj të dokumentuar dhe nga të dhënat e gjuhësisë historike krahasuese. Besoj

[21] Po ai, po aty, f. 197.
[22] Shaban Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë 1986, f. 1017.

se mbetemi në kuadrin e një hipoteze të mundshme po të pohojmë se shqipja e lashtë ka pasur një trajtë foljore emërore sintetike që kryente funksionin e paskajores. Një trajtë e tillë, siç kanë vënë në dukje shumë gjuhëtarë, do të ketë qenë e barabartë me një nga trajtat e pjesores: *thanë, lanë, thatë, ratë mbjellë, sjellë* etj. Trajtat e sotme foljore të pashtjelluara: *me punue*, *pa punue*, *pa punuar*, *tue punue*, *duke punuar*; *me thanë, me thënë*, *pa thane*, *pa thënë*, *tue thane*, *duke thënë* janë ndërtuar mbi bazën e një trajte më të hershme sintetike me funksione të një paskajoreje, jo mbi bazën e një pjesoreje. Për këtë dëshmon, besoj, fakti që trajtat e sapopërmendura analitike kanë trajtë dhe kuptim vepror dhe pësor, ndërsa pjesorja e shqipes ka vetëm kuptim pësor. Kohët e fundit me këtë problem është marrë edhe studiuesi dr. Erzen Koperaj në disertacionin e tij të doktorates me titull *Format e pashtjelluara në shqipen e shkruar të shekujve XVI-XVIII,* përgatitur nën drejtimin e prof. Kolec Topallit, Tiranë 2014, f.175.

Si dëshmi e ekzistencës së një paskajoreje sintetike në shqipen hershme janë sjellë edhe ndërtimet e tipit: *duhet ba*, *duhet bërë*, *do ba*, *do bërë*, që u përgjigjen ndërtimeve të rumanishtes: *trebui facut.* Pjesën e dytë të këtij ndërtimi foljor e kanë trajtuar si paskajore gjuhëtarë të tillë si H. Pedersen-i, N. Jokl-i, Aleksandër Xhuvani, Selman Riza, Kolec Topalli etj.

H. Pedersen-i në I. F, 12, *Anzeiger* 91-93 ka pohuar se paskajorja sintetike e dikurshme është përputhur formalisht me pjesoren. Ai ka shprehur mendimin se prapashtesat *-n* dhe *-m* në gjuhët indoeuropiane janë përdorur si për ndërtim paskajoresh ashtu edhe për trajta të pjesores. Edhe N. Jokl-i në *Litteris* IV. Nr3, 207 është shprehur se gjymtyra e dytë në togfjalëshat e tipit *duhet bërë*, *do bërë* në zanafillë ka qenë paskajore[23]. A. Xhuvani, *Vepra* I 320, duket se pajtohet me mendimin e H. Pedersen-it lidhur me identitetin formal të paskajores me pjesoren kur supozon se paskajorja e zhdukur e shqipes mund të ketë qenë e njejtë me ndonjë nga format e pjesores dhe mbështet gjithashtu mendimin e N. Jokl-it, i cili në gjymtyrën e dytë të togfjalëshit *duhet bërë* shihte një formë

[23] Cituar sipas Shaban Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë1986, f. 1010

me vlerë paskajoreje. Po kështu edhe S. Riza është shprehur qartë për natyrën morfologjike të elementit të dytë në ndërtimin *do thënë*. Ja si shkruan ai: "Trajta foljore *thënë* brenda konstruktit reliktor *do thënë* nuk mund të karakterizohet ndryshe nga e njëjta trajtë brenda konstruktit gjithashtu reliktor p. sh. *ai iku pa na thenë gjë neve*... në të cilin trajta *thënë* është për t'u karakterizuar domosdo jo si pjesore, por përkundrazi si paskajore"[24] Me këtë lagje dijetarësh është bashkuar edhe M. Domi, i cili, ndër të tjera ka shkruar " Trajta primare e paskajores së shqipes ka qenë pas gjithë gjasash e thjeshtë si ajo e gjuhëve motra indoeuropiane. Po si ka qenë kjo trajtë? Sot në disa raste konkordon përdorimi i paskajores me përdorimin e trajtës së pjesores: *Duhet shkue* a *shkuar atje*, *duhet me shkue atje*. Edhe disa përdorime të tjera të pjesoresh të bëjnë të mendosh për një paskajore: *Do bërë kjo punë, Pa ardhë unë mos ik.* Trajtën e paskajores së thjeshtë të lashtë duhet ta kërkojmë ndër trajtat e sotme të pjesores. Me kohë u përzien funksionet e trajtat e pjesores e të paskajores dhe u formua paskajorja analitike. Trajtat e thjeshta mbetën si trajta pjesoreje. Trajtat e tipit *me kullotunë* janë trajta të paskajores."[25] Të tjerë studiues e kanë kundërshtuar këtë mendim me argumentin se ndërtime të tilla kanë kuptim pësor dhe jo vepror, sepse emri që pason vihet në rasën emërore dhe jo në rasën kallëzore. Pra thuhet *duhet punuar toka* dhe jo *duhet punuar token, do lexuar libri* dhe jo *duhet lexuar librin*. Këtë kuptim pësor, sipas tyre, këtyre ndërtimeve ua jep pjesa e dytë e tyre *punuar, lexuar*, e cila është pjesore e shkuar dhe jo paskajore.

Ne na duket se ky argument nuk është i mjaftueshëm për të vërtetuar se në ndërtimet e këtij lloji pjesa e dytë nuk është paskajore por pjesore. Këtë e mbështesin në këto fakte: Së pari në këto ndërtime pjesa e dytë hyn në sferën e funksioneve dhe të përdorimeve të paskajores dhe jo të pjesores. Ndërtimet e tipit *duhet lexuar libri* a *do lexuar libri* janë të barazvlershëme me ndërtimet sinonimike: *duhet me lexue librin. duhet*

[24] Selman Riza, *Vepra* 2, Prishtinë 1997, f. 71; Besim Bokshi, *Pjesorja e shqipes* (vështrim diakronik), Prishtinë 1998, f.7

[25] Mahir Domi, *Morfologjia historike –konspekt leksionesh,* dispencë e botuar nga Universiteti i Tianës, 1961, f. 67.

me u lexue libri, ose *duhet të lexojmë librin* a *duhet të lexohet libri.*

Së dyti, ndërtimet e tipit *duhet thane, thënë*, *do ba*, *do bërë*, të ndjekura nga një emër në rasën kallëzore nuk janë krejt të panjohura në gjuhën shqipe. Pra thuhet *duhet ba (bërë) detyra,* por edhe *duhet ba (bërë) detyrën, duhet thane (thënë) e vërteta, por edhe duhet thane (thënë) të vërtetën. ?, duhet mësuar anglishtja* apo *duhet mësuar anglishten? duhet pyetur specialisti* apo *duhet pyetur specialistin*?, *duhet përkthyer libri* apo *duhet përkthyer librin*?. P. sh. *Mësimin plotësues duhet trajtuar me seriozitet*; *Për ta kuptuar dhe zbërthyer Enver hoxhën, duhet kuptuar dhe padronin e tij.* Ndërtimet me rasën kallëzore hasen kryesisht në të folme të shqipes verilindore. Ali Podrimja shkruan: ***Reagimin*** *ironik të akademikut serb Miqa Popoviqit* ***duhet kuptuar*** *edhe si qortim turpit nacional* (Vepra, 8, Prishtinë, 2013, f. 20), *Prandaj duhet kërkuar drejtpeshimin kombëtar, që në pazar të mos dalin partitë* (Ali Podrimja, Vepra 8, f.137). Padova 1685. S. Riza në librin e tij *Tri monografina albanologjike*, Tiranë 1944 jep shembullin: *Do gjetë shërimin kësaj sëmundjeje.*[26] Është pohuar se ndërtime të tilla me rasën kallëzore në të folmet verilindore të shqipes janë ndikime të serbishtes, por nuk janë sjellë prova për ta vërtetuar një pohim të tillë.

Një paraqitje dhe një vlerësim të tezave të ndryshme për ekzistencën e një paskajoreje sintetike në gjuhën shqipe dhe rrugët e formimit të trajtës *me punue* ka bërë akademik Besim Bokshi në veprën, *Pjesorja e shqipes* (*vështrim kritik*). Në këtë vepër trajtat e pjesores vështrohen historikisht të ndërthurura me trajtat e paskajores. Madje në këtë vepër autori shtron për diskutim e zgjidhjen si një nga problemet kryesore të diakronisë së pjesores çeshtjen: a janë unifikuar në një fazë të lashtë të protoshqipes formantet e pjesores pësore të së kryerës me formantet e paskajores?[27].

Vitet e fundit edhe prof. Kolec Topalli në punimet e tij për sistemin foljor të shqipes ka mbështetur pikëpamjen se në trajtat analitike të pashtjelluara: *me thanë*, *pa thane, pa thënë*, *tue thane*, *duke thënë* elementi

[26] Selman Riza, *Vepra* 1, Prishtinë 1996, f.124

[27] Besim Bokshi, *Pjesorja e shqipes* (Vështrim diakronik), Prishtinë 1998, f. 7

i dytë ka origjinë paskajoreje, jo pjesoreje. Ai shprehet: " Të dhënat e gjuhës shqipe na çojnë në përfundimin se forma foljore me të cilën janë ndërtuar format analitike nuk mund të ketë qenë pjesorja e shqipes, e cila ka karakter pësor në të shkuarën, por ajo ka qenë një formë foljore me karakter emëror, siç janë paskajoret e shumë gjuhëve të tjera. Nga një pjesore e shkuar pësore është e pamundur të ndërtohen forma analitike me kuptimin e përcjellores e të paskajores. Autori është përpjekur të përcaktojë edhe format konkrete që duhet të kenë pasur kuptim të tillë emëror. Sipas tij të tilla kanë qenë: Format me prapashtesën *-ë*: *dekë, veshë*, *mbathë* etj. që reflektojnë rasën kallëzore me mbaresën *-on* <*-om* që ka përfunduar në *-ë.* Format me togjet zanore: *shkue, çue, lye, ngjye* etj., reflektojnë të njëjtën mbaresë të trashëguar *-on*, që ka shkaktuar diftongimin. Format pa mbaresë: *la*, *qa*, *ba*, *hy* etj. Dhe më tej autori vijon: prej këtyre formave me kuptim emëror me anë të parafjalëve *pa*, *me*, *tu* janë krijuar format analitike: *pa veshë*, *me veshë*, *tu(e) veshë*. Kështu ndërtimi i këtyre formave analitike është i njëjtë me gjermanishten *zu machen*, me frëngjishten ά *louer*, *sans dire*, me italishten *a vedere*, *senza dire*".[28]

Ne jemi të prirur të besojmë se trajtat e mëvonshme *me punue*, *pa punue*, *pa punuar*, *tue punue*, *duke punuar* janë krijuar si rezultat i parafjalëzimit të trajtës më të vjetër sintetike të paskajores. Nga këto trajta analitike vetëm trajta gege *me punue* arriti të përgjithësohet e të marrë funksione të plota të infinitivit si në gjuhë të tjera indoeuropiane, të përdoret në funksione të fjalive kryefjalore, kundrinore, përcaktore, rethanore etj. Trajta *pa punue*, *pa punuar* ka funksione sintaksore të kufizuara dhe u përgjigjet paskajoreve të gjuhëve romane: fr. *sans travailler*, it. *senza lavorare*. Ndërsa trajtat *tue punue*, *duke punuar* kanë funksionuar si përcjellore. Pra nga një trajtë e paskajores më të vjetër sintetike *punue, thanë, lanë*, e përdorur shpesh në rrethana të caktuara sintaksore me parafjalën *me,* në kushte sintagmatike ku folja që paraprinte paskajoren sintetike kërkonte parafjalën *me*, u formua dhe u ngulit trajta e paskajores analitike *me thanë*, *me lanë* etj. Kështu, p. sh. foljet inkohative që shënojnë fillimin e një veprimi kërkojnë parafjalën *me*: *filloi me folë*, *nisi me këndue*, *filloi me thanë* etj.

[28] Kolec Topalli, *Sistemi foljor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2010, f.478, 479.

Nga përdorimi i gjatë në rrethana të tilla sintaksore parafjala *me* është ndjerë dhe ka funksionuar si pjesë përbërëse e paskajores, duke humbur kuptimin e funksionin parafjalor dhe i gjithë ndërtimi *me* + paskajore sintetike është gramatikalizuar dhe është shndërruar në një paskajore perifrastike a analitike. Me kohë kjo trajtë analitike e ka shtrirë përdorimin e saj edhe me folje të tjera që nuk kërkojnë parafjalën *me*, siç janë, ndër të tjera, foljet që shënojnë dëshirë a vullnet: *due, dëshiroj, kërkoj* etj. Me të njëjtën mënyrë, por në tjetër kontekst sintaksor duhet të jetë formuar e përgjithësuar edhe trajta *pa bërë*, *pa folë, pa thënë*, të cilave në disa gjuhë të tjera u përgjigjen trajta paskajoreje me parafjalët përkatëse. S. Riza mendon se trajta me *pa*: *pa punue* është në e vjetër se trajta me *me*: *me punue* dhe se kjo e fundit lindi si antonim i trajtës me *pa*[29]. Ky mendim del i mbështetur po të nisemi nga fakti që trajta me *pa* është e mbarë shqipes. Megjithatë na duket e vështirë të besojmë se trajta mohuese t'i ketë paraprirë trajtës pohuese. E kundërta duket më e besueshme, trajta mohuese me *pa* ka lindur si antonim i tajtës me *me*. Mbetet si problem për t'u shpjeguar: Pse trajta muhuese me *pa* arriti të shtrihet e të përgjithësohet në të gjithë shqipen, në gegërishte dhe në toskërishte, ndërsa trajta me *me* u përgjthësua vetëm në gegërishte. Arsyet mund të jenë të natyrave të ndryshme, por ne besojmë se një nga arsyet e kësaj gjendjeje është fakti se funksionet e trajtës me *me* në toskërishte i kryente mënyra lidhore, ndërsa funksionet e trajtës me *pa* nuk i mbulon kjo mënyrë. Përveç kësaj trajta me *pa* hyn në marrëdhënie antonimike jo vetëm me paskajoren me *me*, por edhe me pjesoren: *bërë*, *pa bërë* dhe me përcjelloren *duke punuar, pa punuar*. B. Bokshi[30] praninë e trajtës *pa parë* në mbarë shqipen, pra edhe në toskërishte e sjell si argument të padyshimtë se edhe infinitivi me *me* + pjesore ishte i përdorshëm edhe në dialektin e Jugut.

Nga sa u parashtrua më lart, ne na rezulton se para se të formoheshin trajtat e paskajores *me punue*, *pa puunue* ka ekzistuar një trajtë sintetike me funksionin e paskajores, që për nga forma përkonte me një a disa trajta të pjesores. Nga parafjalëzimi i saj lindën trajtat me *me* dhe me

[29] Shih më hollësisht për këtë S. Riza, *Vepra* 1, Prishtinë 1996, f.125

[30] B. Bokshi, *Vep. cit*. f. 138, 139.

pa, që janë të pranishme në shqipen e sotme, e para në gegërishte, e dyta në mbarë shqipen. Në këtë në proces zhvillimi e shndërrimi nuk kemi të bëjmë me humbjen e një trajte sintetike të paskajores së vjetër, por për shndërrimin e saj nga një trajtë sintetike në një trajtë perifrastike a analitike. Një mendim të tillë për natyrën morfologjike infinitivore të trajtave të pashtjelluara, përveç pjesores e ka shprehur shumë kohë më parë S. Riza, i cili ka pohuar: " Në kundërshtim me mendimin e përhapur se të gjitha trajtat e mënyrëve të pashtjella paskan dalë nga pjesorja, shkruesi i këtyre rradhëve (është fjala për S. Rizën-S.M.) mbron tezën se qe paskajorja e vetëmjaftueshme e shqipes së vjetër, ajo që dha si paskajoren perifrastike parabuzukjane, ashtu edhe e përcjelloren e tashme të mbarë shqipes..."[31]

Një paskajore e tillë me parafjalë vërehet edhe në gjuhë të tjera indoeuropiane: anglisht *to go,* gjermanisht*, zu machen*, rumanisht *a mergere* etj. Në periudhat më të vonshme të shqipes një proces i tillë vërehet edhe në krijimin e paskajores më të re të tipit *për të punuar* ku formësimi morfologjik i saj dhe zgjerimi i funksioneve sintaksore ndiqet pa vështirësi, sepse është një proces që ka ndodhur në periudhën e dokumentimit me shkrim të saj dhe vijon edhe në shqipen e sotme. Trajta *për të punuar*, trajtë e mbarë shqipes, siç dihet, është formuar nga një emër prejfoljor i paraprirë nga parafjala *për* që shënonte kryesisht qëllimin e kryerjes së një veprimi që më pas u shndërrua fillimisht në një paskajore qëllimore dhe më vonë i zgjeroi funksionet e saj sintaksore, por gjithsesi, më të kufizuara se paskajorja më e vjetër e gegërishtes e tipit *me punue*.

Kalimi nga një trajtë sintetike në një trajtë analitike a perifrastike është në përputhje të plotë me prirjet e shqipes mesjetare dhe të gjuhëve të tjera për një zhvillim nga ndërtimet sintetike në zhvillimet analitike, pra nga tipi i hershëm sintetik në tipin analitik. Shqipja të paktën që në periudhën mesjetare ka shfaqur prirjen për një zhvillim nga sintetizmi drejt analitizmit.[32] Kjo ka qenë një prirje e përgjithshme dhe e gjuhëve të tjera indoeuropiane. Krahaso zhvillimet nga latinishtja në gjuhët e sotme roma-

[31] Selman Riza, *Vep. cit*., f.71

[32] Për formimet analitike në gjuhën shqipe shih dhe Ethem Likaj, *Format analitike në gjuhën shqipe*, Tiranë 1997.

ne. Trajtat analitike përgjithësisht janë më konkrete dhe më të qarta për të shprehur kuptimet gramatikore dhe funksionet sintaksore. Një prirje e tillë për të konkretizuar dhe për të dalluar sa më qartë shprehjen morfologjike dhe funksionet sintaksore është vërejtur edhe në krijimin e trajtave të pashtjelluara të foljes.

Pasi u përpoqëm të shprehnim mendimin tonë lidhur me humbjen e një paskajoreje sintetike në shqipen e vjetër, le të themi dy fjalë për humbjen e paskajores së tipit *me punue* në dialektin e Jugut. Së pari dëshiroj të theksoj se në këtë rast jemi më të sigurt po të flasim për mungesë të paskajores së tipit *me punue* në toskërishte dhe jo për humbje. Nëse nund të flasim për humbje të paskajores së tipit *me punue* në toskërishte, më parë duhet të kemi provuar ekzistecën e padiskutueshme të saj në këtë dialekt. Argumentet e sjella deri më sot për të provuar një gjë të tillë, besoj, janë krejt të pamjaftueshme. Disa shprehje me paskajore që përdoren në toskërishte si: *meqenëse*, *duk me qenë se*, *domethënë, si me thënë* është shumë më e besueshme për t'i shpjeguar si depërtime të veçanta nga gegërishtja, sesa si relike të të një gjendje më të hershme kur kjo trajtë ishte pjesë e sistemit foljor të toskërishtes. Gjasat janë që edhe paskajorja e gegërishtes *me punue* si vijim i një paskajoreje sintetike nuk është shumë e vjetër. Prandaj po të ishte shtrirë në të gjithë shqipen, përfshirë edhe toskërishten, nuk mund të ishte zhdukur në këtë të fundit pa lënë gjurmë shumë më tepër se ato që përmendëm. Do të kishte lënë gjurmë edhe në formimin e së ardhmes së tipit *kam me shkrue*. Përkundrazi toskërishtja ka të ardhmen me foljen *dua* + mënyrën lidhore: *do te shkruaj* dhe relike të një të ardhmeje me mënyrën lidhore të tipit *kam të shkruaj, kam të vete*, që përdoret kryesisht në të folmet arbëreshe të Italisë, relike që flasin për mungesë të një paskajoreje me *me*.

Për ata studiues që besojnë se paskajorja e tipit *me punue* ka qenë edhe e toskërishtes, zhdukja e saj në këtë dialekt është shpjeguar kryesisht me ndikimin e greqishtes, ku, siç dihet, paskajorja është zhdukur prej kohësh. Nëse mund të flitet për ndikim të greqishtes për këtë çeshtje, unë do të pranoja një ndikim të kësaj gjuhe në mosshtrirjen e kësaj trajte gege në jug jo në zhdukjen e saj. Një mendim të tillë e ka shprehur gati një gjysëm shekulli më parë E. Çabej, i cili shkruan: "Unë e gjej krejt të mundshme që afërsia gjeografike e greqishtes ka ndaluar shqipen jugore të for-

monte një paskajore ashtu si e formoi gegërishtja veriore dhe e mesmja”[33]. Përveç kësaj, shqipja në përgjithësi dhe toskërishtja në veçanti kanë dëshmuar se janë të prirura për të krijuar trajta të reja foljore të pashtjelluara me funksione të afërta me paskajoren, prandaj është e vështirë të besohet që të ketë pasur një paskajore të tipit *me punue* dhe ta ketë humbur më vonë. Ajo ka krijuar trajta të tilla si: *për të ardhur*, *me të ardhur*, *një të ardhur* që përdoren dendur në funksionin e fjalive rrethanore, siç ka vënë në dukje edhe prof. Brian në veprën e tij. Kjo prirje për të krijuar trajta të reja të pashtjelluara bie ndesh me humbjen e trajtave më të vjetra.

Gjithsesi, edhe sikur të pranohet zhdukja e paskajores në dialektin e Jugut, në rrafshin e gjuhësisë ballkanike nuk mund të flitet për humbje të paskajores në gjuhën shqipe, sepse një paskajore e tillë është shumë e gjallë, shumë e përdorur në dialektin e Veriut. Humbje e paskajores në një dialekt, qoftë edhe në dialektin mbi të cilin është mbështetur standardi i sotëm, nuk mund të identifikohet me humbjen e paskajores në gjuhën shqipe. Shqipja bën pjesë në ato gjuhë që përdorin paskajoren dhe lidhoren, siç ndodh edhe në disa gjuhë të tjera si p. sh. në gjuhët romane perëndimore. Madje edhe toskërishtja edhe gjuha standarde përdorin gjerësisht paskajoren më të re të tipit *për të punuar* dhe trajtën *pa punuar* me funksione ende të kufizuara në krahasim me paskajoren gege të tipit *me punue*..

Për sa i përket perspektivës së zhvillimit të ndërtimeve infinitivore, së cilës M. Brian në veprën e tij i ka kushtuar një syth të veçantë, unë do të thosha se kundërvënia midis trajtave foljore vetore dhe trajtave jovetore, ose pavetore në gjuhën shqipe vijon të jetë e dalluar qartë dhe nuk ka prirje të dobësohet. Përkundrazi, në shqipe ka një prirje që emra prejfoljorë të fitojnë tipare foljore, siç janë ndërtimet e tipit *u lodh së foluri*, *u mek së qeshuri* etj. Madje vërehen ndërtime me emra foljorë me prapashtesën *-je*, të cilat marrin ndonjëherë kundrinorë dhe rrrethanorë. Si p. sh. *Dhënia hua njerëzve që s’ e mbajnë fjalën, mund të shtjerë në telashe*. Madje në shqipen e sotme ka një kokurencë të dukshme midis ndërtime-

[33] Eqrem Çabej, *Mbi disa dukuri të historiesë së gjuhës shqipe të para në lidhje me gjuhët e tjera ballkanike*, Studime filologjike, nr.4, 1979, f. 64.

ve foljore dhe ndërtimeve me emra prejfoljorë: *Më pëlqen të lexoj libra historikë, më pëlqen me lexue libra historikë, më pëlqen leximi i librave historikë*.

Në shqipen e sotme, duke përfshirë edhe shqipen standarde, vërehet një zgjerim i përdorimit dhe i fuksioneve të paskajores së përbashkët të tipit *për të punuar*, jo vetëm si paskajore qëllimore, por edhe si paskajore përcaktore, madje edhe në funksion të fjalive kundrinore dhe kryefjalore

Po kështu ka një zgjerim të përdorimeve të mënyrës lidhore si paskajore. Kjo vërehet në mosrespektimin e përshtatjes së kohëve në ndërtimet *e pakryer e dëftorees- e tashme e lidhores*, sidomos pas foljeve që shënojnë fillimin e veprimit. Thuhet dhe shkruhet shpesh: Jo *Filloi të binte shi*, por *filloi të bjerë shi* sipas modelit *filloi me ra shi*, *nisi të prishet koha*, *filluan të këndojnë, donte të krijojë.* P. sh. *Miterani donte të krijojë një pozicion antigjerman* (Ali Podrimja, Vepra, 8, Prishtinë, 2013, f. 113). *Gjumi më ishte prishur dhe fillova të gjej ngushëllim vetëm te ushqimi.* ; *Fillova të sillem keq me njerëzit e familjes.* Në këto fraza, siç shihet, nuk kemi përshtatje të kohëve. Kjo besoj ndodh në ndërtime të caktuara në të cilat lidhorja e standardit i përgjigjet një paskajoreje të gegërishtes, e cila nuk ndryshon në kohë dhe s' ka vend për të respektuar atë që quhet *consecutio temporum*, përshtatja e kohëve, sepse lidhorja kryen funksionin e një paskajoreje të tipit *me këndue* .

Për sa i përket paskajores gege të tipit *me këndue*, unë besoj se me intensifikimin gjithnjë e më shumë të komunikimeve mbarëshqiptare, me shtimin e integrimeve ekonomike, kulturore e shpirtërore në mes shqiptarëve, trajta e paskajores së gegërishtes do ta shtrijë njohjen dhe përdorimin e saj në të gjithë shqipen. Së pari do të përdoren paskajoret e atyre foljeve që nuk paraqesin probleme të rrafshit fonetik, siç janë trajtat*, me thënë, me mbjellë, me sjellë, me përmendë, me marrë, me dhënë, me lënë, me pa, me vërejtë, me zënë, me vënë, me ngrënë, me pi, me lind* etj. dhe më me vështirësi mund të përhapen edhe paskajoret e tipit *me punue, me këndue.* Kështu që shqipja nuk është dhe nuk do të jetë gjuhë pa paskajore.

Seit MANSAKU, Tirana

THE PROBLEMS RELATED TO 'INFINITIVE" OF THE ALBANIAN LANGUAGE FROM THE CONTEXT OF BALKAN LINGUISTICS ACCORDING TO THE WORK OF THE SCHOLAR BRIAN D. JOSEPH

Summary

This paper treats different aspects of the 'Infinitive' of the Albanian language from the Balkan context. After the review of Brian Joseph's numerous contributions in his work on 'Infinitive', the author deals with the review of the assertions concerning the issue of the disappearance of the 'Infinitive' in the Balkan languages in relation to Albanian and he thinks that it can be provided arguments against disappearance in its entirety. The paper also treats other aspects of the 'Infinitive'.

Vesel NUHIU, Prishtinë

FONETIKA E GJUHËS SHQIPE SIPAS G. S. LOWMAN

Titulli i kumtesës sime rrjedh nga teksti origjinal *The Phonetics of Albanian* (Fonetika e shqipes) botuar nga *Guy Sumner Lowman* në revistën Language, vëll. VIII, nr. 4, në dhjetor të vitit 1932, kur ishte me *Linguistic Atlas of the United States and Canada* (Atlasi gjuhësor i Shteteve të Bashkuara dhe i Kanadasë)

Për këtë punim autori Louman (Lowman) ishte shpërblyer me Laura Soames Prize (Shpërblimi Laura Soames) nga Kolegji Universitar i Londrës, në vitin 1930 për hulumtim origjinal në fonetikën e një gjuhe të gjallë.

Këtë kontribut të autorit Guy Sumner Lowman, Jr., të cilin po e paraqes sot, ma kishte dhuruar nja dyzet vjet më parë, kur po qëndroja në Universitetin e Çikagos me një bursë të Fondacionit amerikan të Fulbrajtit, një mik i imi amerikan, profesor i historisë, me prejardhje shqiptare, dr. Nicholas Costa. Materiali që mora ishte një kopje e një teksti prej rreth 30 faqesh.

Më ishte dukur një shkrim gjuhësor interesant dhe shpesh kisha dëshirë të shkruaja për përmbajtjen e tij, por rasti m'u dha që këtë ta bëj në këtë Konferencë të Akademisë sonë. Deri tani nuk kam hasur në ndonjë shkrim në gjuhën shqipe për këtë linguist amerikan, ndonëse mund edhe të ketë pasur.

Linguisti Lowman ishte lindur në Kolumbia, Misuri, më 1909 dhe kishte vdekur më 1941, pra kishte jetuar vetëm 32 vjet. Në moshën 20-vjeçare kishte mbaruar studimet bachelor në Universitetin e Viskonsinit, Madison dhe ishte doktoruar në Universitetin e Londrës më 1931. Kishte punuar si instruktor kryesor në terren për Atlasin Gjuhësor të Shteteve të

Bashkuara dhe të Kanadasë. Ai kishte bërë intervista me mbi një mijë informatorë përgjatë bregdetit lindor të ShBA-së dhe të Kanadasë. Ishte po ashtu anëtar i Asociacionit të Gjuhës Bashkëkohore (angleze) dhe kishte shërbyer kryesues i Sektorit Fonetik.

Pas vdekjes së tij, Universiteti i Viskonsinit kishte themeluar fondin *Guy S. Lowman* për dhënien e bursave për hulumtime të mëtejme në gjuhësi.

Kaq për autorin. Në shënimet e internetit jepet një njoftim se nuk dihej më shumë për të dhëna të tjera të biografisë së autorit dhe kërkohej nga lexuesit që të dërgonin informacionet që kishin për atë.

*

Në fillim të kontributit të tij për gjuhën shqipe, ai thekson se kjo gjuhë përbën një degë të veçantë në ndarjen Satem të gjuhëve Indo-europiane dhe se ajo ishte pasardhëse e drejtpërdrejtë e ilirishtes së vjetër, së bashku me disa ndikime të trakishtes.

Autori thekson se nuk ishte bërë ndonjë përpjekje e dukshme për standardizimin e gjuhës letrare shqipe deri në vitet e vona. Thotë ajo ka disa dialekte vendore të cilat dallojnë si në gramatikë, madje edhe në sintaksë, po edhe në strukturën fonetike. Janë dy dialekte kryesore në gjuhën shqipe, cek ai, dialekti gegë ose verior dhe ai toskë ose jugor. Folësit e këtyre dy dialekteve kuptohen mirë me njëri-tjetrin, shton autori.

Më tutje Lowman-i flet edhe për disa të dhëna statistikore. Cek se numri i shqiptarëve vlerësohet të jetë një milion brenda Shqipërisë dhe se një milion folës të tjerë të shqipes jetojnë në vendet rreth e përqark saj ose dhe përtej deteve.

Ai përmend edhe Formulën e pagëzimit të vitit 1462 si dokumentin më të vjetër të gjuhës shqipe. Tekstet e hershme në gjuhën shqipe deri në shekullin XVII kishin përmbajtje fetare, thotë autori. Deri në vitin 1890 nuk kishte pasur ndonjë letërsi të vërtetë, shënon ai. Në atë kohë kishte disa shtypshkronja në Shkodër dhe në disa qytete jashtë Shqipërisë, të cilat filluan të shtypnin me alfabet të njëtrajtshëm të mbështetur në atë latin.

Në kohën kur ai shkroi këtë punë hulumtuese, thotë se mbizotë-

ronte tendenca që shqipja qendrore të pranohej si gjuhë standarde. Ajo gjuhë flitej në Tiranë dhe në rrethinën e saj dhe i përkiste dialektit gegë.

Lowman-i thekson se gjatë historisë shqiptare shumë gjuhë të huaja kishin ndikuar në gjuhën shqipe. Megjithatë, struktura thelbësore e kësaj gjuhe dhe një pjesë e konsiderueshme e leksikut të saj që përdorej rëndom ishte me prejardhje shqipe. Por një pjesë të madhe të leksikut ajo kishte huazuar nga gjuhë të tjera, madje dhe më shumë seç kishte huazuar anglishtja.

Në vijim ai ofron disa të dhëna statistikore të nxjerra nga Fjalori etimologjik i Gustav Meyer-it i vitit 1891. Kështu, ai thotë se nga 5,140 fjalë themelore vetëm 400 ishin me prejardhje të shqipes. Më tej, 1,420 fjalë ishin me prejardhje latine, 340 me prejardhje sllave, 1,180 sosh me prejardhje nga turqishtja, 840 nga greqishtja, ndërsa mbi 700 fjalë ishin të papërcaktuara. Megjithatë, ai shton se shkollarët e mëvonshëm dëshmuan se fjalët shqipe të vërteta përbënin një përpjesëtim bukur më të madh se këto të dhëna. Ai po ashtu cek që ishte vështirë të thuhej se çfarë efekti fonetik kishte pasur përfshirja e fjalëve të huaja në gjuhën shqipe.

U ndala pak më gjatë se rëndom në shënimet për autorin, duke mbajtur parasysh se ai nuk është i njohur nga një numër gjuhëtarësh.

Vlen të thuhet që në fillim të analizës gjuhësore se autori e quante këtë kontribut *Fonetika e gjuhës shqipe*, por, siç do të shihet më poshtë, shkrimi i tij ka të bëjë kryesisht me dialektin gegë, madje të hulumtuar vetëm përmes një numri të vogël informatorësh të rrethinës së Shkodrës.

Vështrimet fonetike të Lowman-it, pra, mbështeten në të folmen dialektore të informatorit të tij, z. Rifat Tirana, i cili kishte prejardhjen nga Shkodra. Më vonë ai përfshiu në grupin e informatorëve një folës tjetër, z. Qazim Kastratin, duke theksuar se ai ishte një mysliman tjetër. Ai po ashtu kishte edhe tre folës burimorë të tjerë me prejardhje nga Shkodra dhe bënte krahasime midis tyre. Autori cek se në rrethinën e Shkodrës kishte dy herë më shumë banorë myslimanë se që kishte të fesë katolike.

Ai kishte gjetur disa dallime fonetike midis folësve të këtyre dy religjioneve. Të dhënat e folësve shqiptarë katolikë i kishte marrë nga pro-

fesori Kol Rrota nga Vjena dhe z. Simon Daragjati nga Parisi, dhe thotë se midis të parëve dhe këtyre të fundit kishte dallime të dukshme në përndarjen e fonemave, gjë që ishte e nevojshme për të bërë këtë dallim fetar, thotë ai.

Megjithatë, më poshtë ai pretendon se ato dallime nuk ishin krejtësisht në bazë fetare, as thjesht rajonale, por kishin të bënin me dallime shoqërore, meqë myslimanët jetonin në treva të rrafshëta, ndërsa katolikët në rajone malore dhe midis tyre kishte trajtime të ndryshme shoqërore dhe se ata kishin pasur jetesë të ndryshme në të kaluarën e tyre.

Bashkëtingëlloret

Duke biseduar për bashkëtingëlloret, Lowman-i thotë se shqipja ka 33 fonema bashkëtingëllore, duke i shtuar katër fonema si vijon: [ɲ], [ɱ], [ɳ], dhe [ŋ] përveç 29 bashkëtingëlloreve standarde të saj.

Në listën e bashkëtingëlloreve të shqipes autori kishte bërë një radhitje që nga këndvështrimi fonetik ishte e rëndomtë për studiuesit e gjuhës: [p, b, t, d, k, g, ʔ, ʦ (c), ʤ (x), ʧ (ç), ʤ (xh) , c (q), ɟ (gj), m, ɱ, n, ɳ, ɲ (nj), ŋ, l, ɫ, r, rr, f, v, θ (th), δ (dh), s, z, ʃ, ʒ, h, j].

Lowman-i bën një përshkrim prej disa rreshtash për secilën bashkëtingëllore. Sipas tij del se shumica e tyre kanë karakteristika të ngjashme me ato të gjuhës angleze. Ndonjë prej tyre ai e sheh të krijuar për një nuancë më përpara ose prapa të kontaktit të gjuhës me qiellzën e gojës.

Natyrisht, disa nga këto bashkëtingëllore të shqipes, që nuk mund të shënohen me shkronja të latinishtes, si ʦ, ʤ, c, ɟ, ɲ (nj), ɫ, θ (th), δ (dh), ʃ, ʒ, i kishte shënuar me shenja fonetike ndërkombëtare, madje të një periudhe më të hershme. Disa prej tyre nuk i ka gjuha angleze, prandaj autori bën përshkrim më të hollësishëm të tyre. Asosh që mungojnë në gjuhën angleze janë: ʦ, ʤ, *c*, ɟ, ɲ (nj), pastaj ato me vlerë dialektore, si ɱ dhe ɳ.

Fonemën [ɱ] e quan *hundore dybuzore e velarizuar ose 'e errët'*. Shembuj janë: *ɱret* – për *mbret* , *sheɱ* për *shemb*, *kaɱ* për *kambë/ këmbë* etj. Fonemën [ɳ] e quan *hundore dhëmbore e "errët"*. Shembuj janë: [`*ɳo:ʃta*] për *ndoshta*, [`*fu:ɳi*] për *fundi* etj.

Autori mendonte se hundorja qiellzore [ŋ], si ajo e anglishtes, ishte fonemë në dialektin gegë. Shembuj janë: *ŋaj* [ŋaj] për *ngaj, vrapoj*, *kaŋa* [‘ka:ŋa] për kanga/ *kënga*, *peŋ* [peŋ] për *peng* etj.

Glotalit [?] i kushton një përshkrim të konsiderueshëm, ndonëse ai hetohet shumë më pak në gjuhën shqipe krahasuar me gjuhën angleze. Por në asnjërën nga këto dy gjuhë glotali [?] nuk është fonemë. Autori thotë se glotali në shqipe dëgjohet vetëm në një pozitë në gjuhën shqipe. Ai paraqitet pikërisht para një zanoreje dhe menjëherë vijohet me një bashkëtingëllore. Gjendet në fjalët e përbëra, thotë ai. Si shembuj jepen: *ç’asht*, *ç’armatos*, *s’ishte*, *m’erdhi*, *t’egra* etj.

Lowman-i shpesh i krahason bashkëtingëlloret e shqipes me të njëtat bashkëtingëllore të anglishtes dhe përpiqet të spikasë dallime midis tyre. Ai kishte gjetur edhe aspirim të lehtë të disa tingujve grykorë të shqipes.

Zanoret

Autori kishte bërë një listë prej 13 zanoreve të shqipes. Tetë nga ato [i, e, ɛ, a, o, u, y, œ], sipas tij, ishin zanore themelore. Në këtë grup ai kishte shtuar zanoret [ɛ] dhe [œ], të cilat mund të dëgjohen në ndonjë fjalë të ndonjë treve nëndialektore të veriut.

Për fonemën [ɛ] thotë se është e ngjashme me zanoren angleze [æ:]. Cek se kjo fonemë gjendet në fund të fjalëve njërrokëshe si: [hɛ] për *hae*; [rɛ] për *ra*; [pɛ] për *pa*; [thɛ] për (ti) *tha* etj. Ai cek se kjo zanore me gjasë e ka prejardhjen nga dy zanore të përngjitura [a:] me [e]: hae, rae, pae. Natyrisht, kjo zanore dëgjohet në disa të folme të dialektit gegë, por ai përdorim është i kufizuar si në fjalë ashtu dhe në treva.

Siç u tha më sipër, autori kishte vërejtur të përdorej zanorja [œ], për të cilën cekte se e kishte dëgjuar vetëm në tri fjalë *voe* [vœ:] për *ve*; *oroe* [o`rœ:] për *vërejtje*, *vëmendje*; *voesë* [vœ:s] për *vesë*. Ai cek se kjo zanore është gjithnjë e gjatë. Siç dihet, edhe kjo zanore dëgjohet në treva të kufizuara të dialektit gegë.

Ka rëndësi të theksohet se Lowman-i nuk e ka shënuar fare zanoren

[ë]. Mbase ai nuk e kishte dëgjuar të përdorej nga informatorët e tij, meqë folësit gegë kanë prirje të mos e përdorin dendur këtë zanore, së paku jo shumë zëshëm.

Një grup në vete përbëjnë tek autori zanoret hundore: [î, ɛ, â, û, ŷ]. Është interesant se ai nuk shënon të ketë [o] hundore [ô]. Nuk mund të besohet që të mos e ketë dëgjuar këtë nga informatorët e tij në ndonjë fjalë si *front* [*frônt*], kont [kônt] etj. Atij nuk i ka dalë as zanorja e hundore [ê], meqë duket se këtë e ka përfshirë me zanoren [ɛ], të cilën e ka radhitur në grupin e zanoreve hundore.

Diftongjet

Sipas Lowman-it, shqipja ka katër fonema diftongje, mbështetur në të folurit e z. Tiranës. Ato janë: [iu], [eu], [ɛu] dhe [au]. Vetëm këto i kishin dalë gjatë hulumtimit të tij përmes intervistave me informatorët shqipfolës që i kishte pasur. Ai thotë se diftongjet nuk hasen shpesh në këtë gjuhë, kurse disa folës nuk i përdorin fare, por dy elementet e diftongut i shqiptojnë si rrokje të veçanta. Shembuj të tij nga një poezi janë: *veriut*, *Zeus*, *pelqeu*, *dau.*

Gjatësia e zanoreve

Lowmani thotë se ka tri shkallë të dalluara të gjatësisë së zanoreve në gjuhën shqipe: e shkurtë, e gjatë dhe tepër e gjatë, të cilat përdoren për t'i dalluar fjalët. Dy gjatësitë e fundit, thotë ai, kufizohen në rrokjet e theksuara në fjalë. Por cek se gjatësia e zanoreve është relative e jo absolute. Kur thotë se gjatësia përdoret për t'i dalluar fjalët, ai e pranon faktin se gjatësia e zanoreve ka vlerë fonematike.

Autori ka ofruar shembuj të shqiptimit të këtyre tri gjatësive të zanoreve:

- zanorja [a]: e shkurtë - *Dan* [dan] (emër njeriu), e gjatë - *danë* [da:n] (vegël), dhe tepër e gjatë – (ata) *danë* [da::n] (u pajtuan);

- zanorja [u]: e shkurtë - *huj* [huj] (shprehi, adet), e gjatë - *ujë* [u:j], dhe tepër e gjatë - *huej* [hu::j] (i huaj];

- zamorja [e]: e shkurtë - *qet* [qet] (hedh); e gjatë - *qetë* [qe:t] (ju qetë), dhe tepër e gjatë – *qetë* [qe::t] (shumësi i emrit *kau*);

- zanorja [o]: e shkurtë - *kot* [kot] (më kot), e gjatë - e *kotë* [ko:t], nuk ofron shembull për tepër e gjatë;

- zanorja [i]: e shkurtë - u *rrit* [rrit], e gjatë - *rikë* [ri:k] (shpezë) dhe tepër e gjatë - *rritë* [rri::t];

- zanorja [y]: e shkurtë - *myk* [myk], e gjatë - është *mykë* [my:k] dhe tepër e gjatë - ju *shtytë* [shty::t].

Theksi

Lowman-i mendonte se kishte tri shkallë të ndryshme të theksit në gjuhën shqipe: primar, sekondar dhe 'të patheks'. Ai thotë se theksi primar është shumë i fuqishëm dhe se ky theks mund të vihej në çdo rrokje a fjalë. Në fjalët shumërrokëshe, cek autori, theksi rëndom bie mbi rrokjen fundore. Forma të ndryshme të panyjëtuara nuk e ndryshojnë rrokjen e theksuar, shton ai. Gjatë historisë së gjuhës shqipe, thotë autori, ka pasur një tendencë që rrokjet e patheksuara të zhduken.

Theksi bie mbi zanore në mënyrë të parëndomtë për veshin e folësit të anglishtes, thotë Lowman-i, meqë ai duket të jetë i dobët në fillim të zanores dhe pastaj të ngrihet deri në pikën e prominencës, dhe në fund të bjerë, siç është në fjalën *ishte* [`i:ʃte]. Ai thotë se kjo dukuri është sikur në disa gjuhë indiane.

Më në fund autori bën një krahasim të shqiptimit të fonemave të ndryshme midis informatorëve të tij, duke hyrë në hollësira. Këtu ai orvatet të bëjë krahasime të tingujve të shqipes jo vetëm midis atyre pak informatorëve shqiptarë, por del edhe në krahasime të shqiptimit të ndonjërit nga ata me fonema në ndonjë gjuhë tjetër.

Autori thekson se z. Tirana bashkëtingëlloren [ue] gjithnjë e shqipton si u të gjatë [u:]. Dihet se kjo është një dukuri e përhapur ndër folësit e

gegërishtes. Edhe dukuria që cek Lowman-i, se bashkëtingëlloret e zëshme [b, d, g] në pozicionin fundor të fjalëve bëhen të pazëshme është karakteristikë dialektore. Ndonjëherë Lowman-i hyn në hollësi të tepruara, siç është rasti me Kol Rrotën, i cili i shqipton gati njësoj bashkëtingëlloret [dh] dhe [ll], gjë që duket të jetë një defekt ose shprehi e gabuar e folësit.

Në fund të shkrimit të tij, Lowman-i ka ofruar nja 4 faqe tekst në formë proze dhe poezie të nxjerrë nga burimet shqipe, i gjithë i transkriptuar me alfabet ndërkombëtar fonetik.

Përfundim

- Titullin *Fonetika e gjuhës shqipe* autori e kishte përdorur gabimisht, sepse në punimin e tij nuk bëhet fjalë për gjuhën shqipe në tërësi, por vetëm për një të folme të dialektit gegë, madje duke u kufizuar vetëm në disa persona të asaj të folmeje. Kjo nuk përputhet me kapacitetin e tij gjuhësor që kishte, i cili cek fare mirë se shqipja kishte shumë nëndialekte dhe dy dialekte kryesore, ndërsa rrethina e Shkodrës ishte vetëm një trevë e dialektit gegë.

- Sa i përket punës profesionale nga pikëvështrimi fonetik, autori ka treguar një mprehtësi të thellë dhe të hollësishme gjatë përshkrimit fonetik që ka bërë. Kjo del e kuptueshme kur të kihet parasysh kualifikimi i tij, që u cek në shënimet e shkurtra biografike të tij më sipër.

- Autorit i ka dalë numri më i madh i zanoreve dhe i bashkëtingëlloreve pikërisht sepse në atë të folme ai ka hetuar të përdoren aq zanore dhe bashkëtingëllore. Përshkrimin e tyre e ka bërë me mjeshtri të një fonetikani të shquar.

- Është për t'u admiruar aftësia e tij për analizë dhe përshkrim fonetik, kur dihet se ai nuk e fliste gjuhën shqipe, por materialin e krijoi nga intervistat që kishte bërë me informatorët e tij të pakët si folës të gjuhës shqipe vetëm duke i dëgjuar ata.

- Edhe pse kontributi i tij është një artikull rreth 30 faqesh të dendura të revistës ku i ishte botuar, vlerësojmë se në brendinë e tij ka përfshirë material të pasur dhe të vlefshëm për atë kohë. Këtë e dëshmon edhe fakti se për këtë hulumtim shkencor Lowman-i mori shpërblimin Laura Soames Prize nga një institucion me renome siç është Kolegji Universitar i Londrës.

- Duhet gjithashtu të dihet se ai e dha këtë kontribut për gjuhën shqipe thuaja para[9] dekadash, kur shqipja ishte fare pak e njohur si gjuhë, sidomos jashtë kontinentit të Europës. Ka rëndësi të thuhet se punimi i tij përkitazi me gjuhën shqipe ishte ndër kontributet e para në gjuhën angleze.

- Aftësinë e tij për studime fonetike e dëshmon edhe fakti se pas vdekjes së tij, Universiteti i Viskonsinit kishte themeluar fondin *Guy S. Lowman* për dhënien e bursave për hulumtime të mëtejme në gjuhësi.

Vesel NUHIU, Prishtina

GUY SUMNER LOWMAN, JR., THE PHONETICS OF ALBANIAN[1]

Summary

The author was awarded the LAURA SOAMES PRIZE for original research in the phonetics of a living language at University College, London, 1930.

Born in *Columbia, Missouri*, in 1909 and died in 1941, he was an American *linguist* who received a bachelor's degree from the *University of Wisconsin–Madison* in 1929 and a PhD in Philosophy from the *University of London* in 1931.

After his death, the University of Wisconsin–Madison established the Guy S. Lowman Scholarship to further research in linguistics.

In the first pages, Lowman wrote a brief history of the Albanian language and Albanians as a people. His phonetic observations were based on the dialectal speech of a few informants coming from the region of Scutari (Shkodra).

Discussing the consonants in Albanian, the author said that there were 33 consonant phonemes in this language, adding [ɲ, ~~m~~, ~~n~~, ŋ] to the standard 29 ones.

He made a list of 13 vowels in Albanian: eight basic ones [i, e, ə, a, o, u, y œ] and five nasal vowels [î, ê[ɛ], â, û, ŷ]. He did not register the nasal vowel [o] [ô]. He said that there were long and short vowels in this language, offering examples of both kinds. The author did not mark the phoneme [ə] at all as he probably did not hear it in his informants' speech.

Lowman thought that there were three significant degrees of stress in the Albanian language: primary, secondary and "unstressed", and explained it.

The author showed very detailed phonetic knowledge of language. He deserves admiration for his phonetic preciseness even though he did not speak Albanian. His writing is among the early contributions in English to the Albanian language.

[1] Reprinted from Language, Vol. VIII, No. 4. December, 1932, when he was with the Linguistic atlas of the United States and Canada.

Kolec TOPALLI, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë

PËR NJË SHTRESIM KRONOLOGJIK-ETIMOLOGJIK TË LEKSIKUT FETAR NË POEZITË E NOLIT

Kultura botërore njeh shumë raste kur personalitete të fuqishme arrijnë majat e shkencës a të artit; por janë të rralla rastet kur përsosmëria kap majat në disa fusha bashkë. I tillë ishte Noli, një figurë poliedrike me shumë maja: si poet, si përkthyes, si prozator-historian, si kritik, madje, edhe si politikan e klerik. Prandaj vepra e tij mbetet në çdo kohë një minierë e pashtershme, prej së cilës nxirren thesare të paçmuara.

Poezitë e Nolit janë të pakta në numër, por të shumta në vlerat e tyre ideore e artistike. Duke i vështruar në një aspekt të veçantë të historisë së gjuhës, Noli e përdori fjalorin fetar në shërbim të ideve të tij madhore, që shpalosen nga njëra poezi te tjetra me fuqinë e magjishme të vargjeve të përpunuara, me një gjuhë të gjallë e të zhdërvjelltë, të fuqishme e shungulluese.

Në përshtatje me tematikën e poezive, Noli përdori gjerësisht fjalë të leksikut fetar, të cilat, sipas moshës së tyre në gjuhën shqipe, mund t'i ndajmë në disa shtresa. Me këtë vështrim diakronik, mund të dallojmë: shtresën autoktone, me fjalë të trashëguara nga fondi indoeuropian; shtresën e huazuar, që përfshin huazimet e vjetra latine dhe huazimet mesjetare nga greqishtja e mesme dhe e re, dhe së fundi, huazimet nga turqishtja.

Shtresës më të lashtë, të trashëguar, i përkasin fjalët e mëposhtme:

Falem; *As u fal, as përshëndoshi* (nga poezia "Korbi"). Lidhet me rrënjën ie. *phol-* "bie", ku bëjnë pjesë gjerm. l. vj., saks. vj. *fallan*, isl. vj. *falla* "bie", lit., let. *půlu*, arm. *կուլ* "shembje". Kuptimi i parë i foljes ka

qenë konkret për "ulem, përulem, bie", që del në shprehjen *fali dielli* me kuptimin "perëndoi". Prandaj *falem* në thelb është "përkulem". Dëshmohet së pari te Buzuku: *Tȳ të enfalemi, o Ịilli i detit*[1].

Kremtoj; *Dhe kremtoj me miqt' e tij/ Dhe u ngrohnë me dolli* (nga poezia "Skënderbeu"). Formim nga *e kremte* "ditë feste fetare, ditë pushimi". Lidhet me rrënjën indoeuropiane *kerm-* "lodhem, pushoj, fle", ku bëjnë pjesë gjerm. l. vj. *hirmen* "prehem, pushoj", lit. *kìrmy-jù*, *kìrmýti* "fle"[2].

Lut; *Thuajmë vërtet, të lus* (nga poezia "Korbi"). Lidhet me let. *lùgt* "lutem", ose me isl. vj. *lūta* "përkulem, falem", *lotning* "nderim, adhurim" nga rrënja ie. **leỊd-*. Dëshmohet te Buzuku: *atë lutnjinë, tue thashunë*[3].

Zot; *Por ti, Zot, më ngushëllove/ Pas një tjatre më lëshove/ Dhe nga mbytja më shpëtove/ Lavdi paç, o Zot* (nga poezia "Plak topall dhe ashik"). Lidhet me rrënjën indoeuropiane *di̯ēus* "qiell", ku bëjnë pjesë gr. Ζεύς, lat. *Deus*, ind. vj. *dēva-ϰ* "Zot, Perëndi". Ka marrë prapashtesën *-t*, ashtu si emri *ditë*, me të cilën lidhet burimisht. Dëshmohet së pari në njërin prej dokumenteve më të lashta të gjuhës shqipe, në Perikopenë e Ungjillit: *gjiellthi Zot* "Zot i qiellit". E kanë edhe autorët e vjetër duke filluar me Buzukun: *Zot, ban mirë d mirëvet e zemërëdërejtëvet*[4].

Përkundrejt kësaj shtrese fjalësh të trashëguara, formimet e brendshme të gjuhës shqipe janë shumë të pakta. Një formim i tillë është ***skëterrë***; *Kërkon Parajsën, vdes në Skëterrën* (nga poezia "Moisiu në mal"). Formim me parashtesat *s- + kë-* dhe emri *terr* prej foljes *erret* duke u lidhur me *sterrë* "i zi"[5].

Përkundrejt fjalëve të shqipes, huazimet janë më të shumta. Më të lashta në këtë fushë janë huazimet latine, të lidhura me lashtësinë e krishterimit ndër shqiptarë. Kësaj shtrese i përkasin:

---

[1] Camarda I 79, Meyer EW 98, Weigand Wört. 18, Çabej SE IV 130.

[2] Bugge BB XVIII 1891, 168, Jokl Stud. 41, Çabej SE V 139.

[3] Camarda I 53, Meyer EW 251, Brugmann Gr. I^2 664, Çabej SE V 255.

[4] Meyer EW 486, Pedersen KZ 36, 1900, 324, Huld BAE 137.

[5] Orel AED 398, Çabej SE VII 16.

Bekoj; *Perëndia ç'na bekon* (nga poezia "Skënderbeu"). Huazim nga lat. *benedico,-ĕre*, e përbërë nga *bene* "mirë" e *dico* "them". Është marrë nga forma e së tashmes *benedico*, prandaj del me bashkëtingëllore grykore, ndryshe nga shumica e foljeve të huazuara nga latinishtja, që kanë hyrë nga paskajorja. Tek autorët e vjetër e deri në gegërishten e sotme del me zanore të gjatë duke u ndikuar nga emri *bē*. Dëshmohet së pari te Buzuku: *Bekuom je, o Mërī*[6].

Dëshpërohem; *S'qe veç dëshpërim i zi* (nga poezia "Korbi"). Huazim nga lat. *desperāre*, nga parafjala *dē-* dhe folja *sperāre* "shpresoj". Dëshmohet së pari te Budi: *Si një bishë dëshpëryem* (DC)[7].

Djall; *Dhe kështu më mori djalli* (nga poezia "Male, pyje plot me fletë"). Huazim nga lat. *diabolus*. Dëshmohet së pari te Matrënga: *ndë pisët me djājëshit*. Nga autorët e vjetër gegë e ka Budi: *e djājtë me një të madhe furī iknë* (DC)[8].

Dreq; *Mbylle gojën, dreq a shpendë* (nga poezia "Korbi"). Huazim nga lat. *draco* (prej gr. δράκων), që ka pësuar metafoninë e shumësit në gjuhën shqipe, si rrjedhim, një shumës i singularizuar. Dëshmohet së pari në fjalorthin e kalorësit gjerman Arnold von Harff (1497). E kanë edhe autorët e vjetër duke filluar me Buzukun: *E tue pasunë qitë jashtë dreqnë*[9].

Engjëll; *Engjejtë lart në lavdi/ Që të dyve na kishin zili* (nga poezia "Annabel Lee"). Huazim prej lat. *angelus*, me burim prej greqishtes ἄγγελος "lajmëtar". Dëshmia më e hershme është në dokumentin e parë të gjuhës shqipe (1462), ku është përdorur si patronim për autorin e Formulës së Pagëzimit, *Pal Engjëllin*, me formën e latinizuar *Paulus Angelus*[10].

Faj; *Dhe Qatipi tha: Po ç'faj paskam bërë?* (nga poezia "Skënderbeu"). Tek autorët e vjetër me gjininë asnjanëse; Buzuku: *E tash shihni fajtë taj*; Budi: *fajtë e priftënet*. Huazim nga lat. **fallium*, një ndër huazimet e moçme prej asaj gjuhe[11].

---

[6] Miklosich AF II 6, Meyer EW 31, Çabej SE II 193, Bonnet 354.

[7] Miklosich AF II 22, Meyer EW 68, Helbig 76, Weigand Wört. 173, Çabej SE III 235.

[8] Meyer EW 69, Pedersen KZ 33, 1897, 535, Çabej SE III 258, Topalli Gr. 284.

[9] Miklosich AF II 22, Meyer EW 73, Jokl IF 30, 1912, 205, Çabej SE III 316, Topalli Gr. 291.

[10] Meyer EW 95, Pededersen KZ 33, 1897, 535, Skok ER I 43, Çabej SE IV 83.

[11] Camarda I 79, Meyer EW 98, Meyer-Lübke REW 3168, Çabej SE IV 126.

Fat; *Te ky vënt më solli fati* (nga poezia "Male, pyje plot me fletë"). Huazim nga lat. *fatum*, prej foljes *fāri* "flas, them". Dëshmohet së pari te Buzuku: *E se për fat në keshë kun embë endonjë vend fëjyem*[12].

Ferr; *përmi Ferr mbretërofsh* (nga poezia "Marshi i Krishtit"). Huazim nga lat. *infernum*[13]. Zanorja e gjatë mund të ketë dalë nga një përzierje me emrin *ferrë*.

Kryq; *Ndrit me Kryqin si martir* (nga poezia "Kirenari"). Huazim i vjetër prej lat. *crucem*. Në shqipen e sotme del me gjininë mashkullore, por ka qenë i gjinisë femërore me temë në bashkëtingëllore: *kryq ~ krygjja*, ashtu si shumë huazime të tjera latine të lakimit të tretë. Me këtë gjini e kanë autorët e vjetër duke filluar me Buzukun: *O Zot, ti qi mundimnë e kryqsë për nē deshe me e përzanë*[14].

Kungoj; *Me Verë, kur t'ap shpirt, kungomëni* (nga "Rubairat"). Huazim nga lat. *communicāre*. Dëshmohet së pari te Buzuku: *en korpit sit na jemi konguom*[15].

Lavdi; *Lavdi pastë Perëndia* (nga poezia "Skënderbeu"). Huazim nga lat. *laudem*, që ka marrë brenda shqipes prapashtesën *-í* të emrave abstraktë. Dëshmohet te Buzuku: *e goja eme të thoetë lavdetë e tū*[16].

Mallkoj; *E quajn' a të marr' a të mallkuar* (nga "Rubairat"). Huazim nga lat. *maledīco,-ĕre*, e formuar nga *male* "keq" e *dico* "them". Dëshmohet së pari te Buzuku: *e kā mallëkuom Zotȳnë*[17].

Mëkat; *Kështu mëkatin e tmerruar lan* ("Nga Prometheu i mbërthyer"). Huazim nga lat. *peccātum*. Dëshmohet së pari te Buzuku: *u rae endë kat*[18].

Mëshirë; *Ah, dashuria s'paska hiç mëshirë* (nga poezia me të njëjtin emër). Huazim nga lat. *miserēre*, veta II numër njëjës e mënyrës urdhë-

---

[12] Miklosich AF II 25, Meyer-Lübke Gröbers Gr. I^2 1904-1906, 1041, Çabej SE IV 151.

[13] Schuchardt KZ XX 1872, 248, Meyer EW 101, Helbig 91, Çabej SE IV 162.

[14] Miklosich AF II 19, Meyer EW 207, Çabej SE V 149.

[15] Meyer EW 214, Weigand Wört. 41, Çabej SE V 173.

[16] Meyer-Lübke Gröbers Gr. I^2 1904-1906, 1047, Jokl LKU 89, Çabej SE V 205.

[17] Miklosich AF II 38, Pedersen KZ 33, 1897, 536, Weigand Wört. 51, Çabej SE V 277.

[18] Meyer EW 271, Weigand Wört. 54, Çabej SF 3, 1964, 29, Bonnet 288.

rore të foljes deponente *misereor*. Ka bërë pjesë në paradigmën e emrave femërorë me fundore në bashkëtingëllore: *mishërier ~ mishërierja*, sikurse dëshmohet tek autorët e vjetër; Buzuku: *o kush kā mishërier endë gazmend*; Budi: *Ndër të shtatë vepëratë e mëshëriersë*[19].

Ndjej; *Ndjemani, ju lutem shumë* (nga poezia "Korbi"). Huazim nga lat. *indulgēre*. Dëshmohet së pari te Buzuku: *tue shufryem njani tjetërinë, e tue endijyem njani tjetërinë*[20].

Ngushëlloj; *Po ti, Zot, më ngushëllove* (nga poezia "Plak topall dhe ashik"). Huazim nga lat. *consolāre*, që ka marrë parashtesën *n(ë)-*. Dëshmohet së pari te Buzuku: *Banina të engushulluom em Tenëzonë*[21].

Pendohem; *Dhe me lot i penduar e hodhi kamçikun* (nga poezia "Krishti me kamçikun"). Huazim nga lat. *poenitēre*. Dëshmohet së pari te Buzuku: *Bani bē Zotȳnë, e të mos pēndonetë*[22].

Perëndi; *Të bisedonjë me Perëndinë* (nga poezia "Moisiu në Mal"). Huazim nga lat. *imperantem*, që ka marrë brenda shqipes prapashtesën *-í*. Dëshmohet së pari te Matrënga: *artë perëndia jote*. Nga autorët gegë, e kanë Budi e Bardhi e të tjerët pas tyre, por mungon te Buzuku[23].

Rrëshajtë: *Djek si Ferr, si vdekje pret/ Ditën e Rushajevet* (nga poezia "Skënderbeu"). Huazim nga lat. *rosālia* prej *rosa* "trëndafil". Përdoret në numrin shumës, si shumë festa fetare. Dëshmohet së pari te Buzuku: *Për t ardhunit qi erdh Shpirti shenjt en Ershajsh largona neve, Zot, së keq*[24].

Shenjt; *Me Zjarr Shenjt u ndrit kjo shpellë* (nga poezia "Shpellë e Dragobisë"). Huazim nga lat. *sanctus*. Dëshmohet në dokumentet më të lashta të gjuhës shqipe, në Formulën e Pagëzimit: *Un të pagëzonj pr emënit Atit e t Birit e t Shpertit shenjt*; në Perikopenë e Ungjillit: *shintë prempte e madhe*[25].

---

[19] Miklosich AF II 42, Jokl IF 36, 1915, 146, Çabej SE V 338.

[20] Meyer EW 299, Pedersen KZ 33, 1897, 537, Çabej SE VI 29.

[21] Miklosich AF II 17, Pedersen KZ 33, 1897, 536, Çabej SE VI 80.

[22] Meyer EW 332, Weigand Wört. 67, Çabej SE VI 164.

[23] Camarda I 341, Miklosich AF II 32, Meyer EW 328, Çabej SE VI 167.

[24] Miklosich AF II 55, Meyer EW 369, Çabej SF 2, 1974, 38.

[25] Meyer EW 404, Weigand Wört. 80, Di Giovine Gruppo *CT* 62, Topalli Gr. 285.

Shpirt; *M'e shtrenjtë je se shpirti e syt e mi* (nga "Rubairat"). Huazim nga lat. *spīritus*. Dëshmohet së pari në dokumentin më të lashtë të gjuhës shqipe, në Formulën e Pagëzimit: *Un të pagëzonj pr emënit Atit e t Birit e t Shpertit shenjt*[26].

Përkundrejt kësaj shtrese të moçme latine, huazimet romane janë më të pakta dhe më të reja. Të tilla janë:

Demon; *As demonët përposh në skëterrë* (nga poezia "Annabel Lee"). Huazim nga gjuhët romane: it. *demonio*, fr. *démon*, me burim nga gr. δαίμων.

Katakomb; *Për çlirimn' e Shqipërisë/ Katakomb' e Dragobisë* (nga poezia "Shpell' e Dragobisë"). Huazim prej it. *catacomba*, nga gr. κατά "po-shtë" e lat. *cŭmba* "zgavër, shpellë".

Profet; *Krye-Profeti trimi me fletë* (nga poezia "Moisiu në mal"). Huazim prej gjuhëve romane: it. *profeta*, fr. *prophète*, me burim prej gr. προφήτης nga folja προφαίνω "parathem". Dëshmohet së pari te Buzuku: *Zgi̯edh Pistullinë e Izaisë Profetë*.

Shtresa tjetër e huazimeve në leksikun fetar është prej greqishtes së mesme e të re. Megjithëse Noli qe prift ortodoks, huazimet nga greqishtja nuk janë të shumta, çka lidhet me ngulitjen prej kohësh të terminologjisë fetare me burim prej latinishtes në të dyja besimet e krishtera. Prej greqishtes janë:

Fron; *Kur hodhi Esadin nga Froni, nga maja* (nga poezia "Thomsoni dhe kuçedra"). Huazim prej gr. θρόνος me shndërrimin *th- > f-* në një grup bashkëtingëllor.

Parajsë; *Kërkon Parajsën, vdes në Skëterrën* (nga poezia "Moisiu në mal"). Huazim nga gr. e mes. biz. παράδεισος. Dëshmohet së pari te Matrënga: *ndë parrajsit*[27].

Temjan; *Me pean dhe temjan, dhe këmban' u këndofsh* (nga poezia "Marshi i Krishtit"). Huazim nga gr. e re θυμίαμα "kem", me disimilim të

[26] Camarda I 53, Meyer EW 414, Weigand Wört. 84, Bonnet 124.

[27] Meyer EW 322, Çabej SE VI 146.

njërës prej dy *-m*-ve. Për *t*-në e shqipes në vend të *th*-së greqishtes mund të ketë ndikuar emri *tym*. Një mundësi tjetër është që fjala të ketë hyrë prej gjuhëve sllave (maq. *temjan*, bullg. *tamjan*)[28].

Për ndonjë huazim është e vështirë të ndahet preras burimi. I tillë është ***martir***; *Ndrit me Kryqin si martir* (nga poezia "Kirenari"). Mund të ketë hyrë nga it. *martire* ose nga gr. e re μάρτυρας, ose me rrugë të dyfishtë: në Veri nga italishtja, në Jug nga greqishtja. Dëshmohet së pari te Buzuku: *Ungjillë ecë e vgjaj endë Komūt të Martiret.*

Shtresa e fundit e leksikut fetar, më e reja, është me burim prej turqishtes. Prej kësaj gjuhe janë marrë:

Allah; *O Allah i math, i naltë* (nga poezia "Skënderbeu"). Huazim nga turq. *Alláh*, me burim prej arabishtes. Del së pari në Fjalorin Latinisht-Shqip të Bardhit[29].

Aman; *Jo, për Zotin, moj aman* (nga poezia "Shën Pjetri në mangall"). Huazim nga turq. *aman* me kuptimin "të lutem"[30].

Islam; *Pajton Islamn' e Krishtërimin* (nga poezia "Hymni i Flamurit"). Huazim prej turq. *islám* me burim nga arabishtja *selam* "paqe, shpëtim"[31].

Kanun; *Shtrembërojnë kanunet, i marrin në dorë* (nga poezia "Krishti me kamçikun"). Huazim nga turq. *kanun*, me burim prej gr. së re κανών "rregullore, pendesë"[32].

Lanet; *Triumfon Legaliteti/ Dhe Laneti* (nga poezia "Shën Pjetri në mangall"). Huazim nga turq. *lanét* me burim prej arabishtes[33].

Mysliman; *Sa kur të shkonjë Mysliman' i mirë* (nga "Rubairat"). Huazim nga turq. *müslüman* me burim prej arab. *muslim*, me prapa-

[28] Miklosich AF I 371, Ylli SLA I 260.

[29] Miklosich TEN I 4, Boretzky TE II 15, Dizdari Fj. 20.

[30] Meyer EW 9, Boretzky TE II 15, Çabej SE II 600, Dizdari Fj. 26.

[31] Boretzky TE II 67, Dizdari Fj. 425.

[32] Miklosich TEN I 57, Meyer EW 174, Boretzky TE II 75, Dizdari Fj. 493, Çabej SE V 36.

[33] Meyer EW 237, Boretzky TE II 84, Dizdari Fj. 580.

shtesën -*an* të persishtes[34].

Qitap; *Në Qitap të tij fakiri* (nga poezia "Skënderbeu"). Huazim nga turq. *kitap* me burim prej arabishtes[35].

Ramazan; *Se ç'na preu Ramazani* (nga poezia "Kënga e Salep-Sulltanit"). Huazim nga turq. *ramazán* me burim prej arab. *ramaddhán*, e cila ka hyrë edhe në gjuhët perëndimore prej trajtës së arabishtes[36].

Vështrimi i mësipërm, që ka për bazë historinë e fjalëve dhe burimin e tyre, ka vlera përgjithësuese për tërë fjalorin fetar të shqipes dhe i shërben historisë së vetë besimeve në Shqipëri, që është i lidhur me historinë e vetë kombit.

[34] Miklosich TE II 132, Boretzky TE II 95, Dizdari Fj. 689, Çabej SE V 385.

[35] Miklosich TE II 111, Meyer EW 224, Boretzky TE 110, Dizdari Fj. 811.

[36] Miklosich TE II 145, Boretzky TE II 112, Dizdari Fj. 832.

Bibliografia

Bonnet, Guillaume, Les mots latins de l'albanais. Paris, 1998.

Boretzky, Norbert, Der türkische Einfluss auf das Albanische. Wiesbaden, I 1975, II 1976 (TE).

Brugmann, K. – Delbrück, B., Grundriss der vergleichenden Grammatik der indogermanischen Sprachen. Strassburg. Erster Band: Einleitung und Lautlehre. Zweite Bearbeitung, 1897; Zweter Teil, 1906 (Gr. I^2, II^2).

Bugge, Sophus, *Beiträge zur etymologischen Erläuterung der albanesischen Sprache.* BB XVIII 1891, 161-201.

Camarda, Demetrio,Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese. Livorno, 1864 (Camarda I).

Çabej, Eqrem,*Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe, I-XXVIII.* BUST SSS 4, 1960 - 4, 1963; SF 1, 1964 - 3, 1968. Çabej, Eqrem, *Karakteristikat e huazimeve latine të gjuhës shqipe.* SF 2, 1974, 13 -53. Ri-botuar në SG IV 1977, 255-289.

Çabej, Eqrem, Studime etimologjike në fushë të shqipes. Tiranë, I 1982, II 1976, III 1987, IV 1996, V 2014, VI 2002, VII 2006 (SE).

Di Giovine, Paolo, Il gruppo *CT* latino in albanese. Roma, 1982 (Gruppo *CT*).

Dizdari, Tahir, Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe. Tiranë, 2005 (Fj.).

Helbig, Robert, *Die italienischen Elemente im Albanesischen.* JIRS X, Leipzig, 1903, 1-137.

Huld, Martin E., Basic Albanian Etymologies. California State University. Los Angeles, 1984 (BAE).

Jokl, Norbert, Studien zur albanesischen Etymologie und Wortbildung. Wien, 1911. Përthyer shqip: "Studime për etimologjinë dhe fjalëformimin shqip". Prishtinë, 2011 (Stud.).

Jokl, Norbert, *Beiträge zur alb. Grammatik 1. Zur Geschichte des alb.* tš *in Erbwörtern.* IF 30, 1912, 192-210.

Jokl, Norbert, *Beiträge zur alb. Grammatik 3. Der Akkusativ-Nominativ und der Geschlechtwechsel im Albanischen.* IF 36, 1915, 98-164.

Meyer, Gustav, Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache. Strassburg, 1891.

Meyer-Lübke, Wilhelm, *Die lateinischen Elemente im Albanesischen von Gustav Meyer.* Neubearbei-tet von Wilhelm Meyer-Lübke. Gröbers Gr. I^2 1904 -1906, 1038-1057.

Meyer-Lübke, Wilhelm, Romanisches etymologisches Wörterbuch. Heidelberg, 1935 (REW).

Miklosich, Franz, Albanische Forschungen. Wien; II: Die romanischen Elemente im Albanischen, 1870 (TE).

Miklosich, Franz, Die türkischen Elemente in den südostund osteuropäischen Sprachen (Grie-chisch, Albanisch, Rumunisch, Bulgarisch, Serbisch, Kleinrussisch, Grossrusisch, Polnisch). 1. Hälfte. Wien, I 1884, II 1885 (TE).

Miklosich, Franz, Die türkischen Elemente in den südost und osteuropäischen Sprachen (Grie-chisch, Albanisch, Rumunisch, Bulgarisch, Serbisch, Kleinrussisch, Grossru-sisch, Polnisch). Nachtrag 1. Hälfte, Wien, 1889; II Hälfte, Wien, 1890 (TEN).

Orel, Vladimir E., Albanian Etymological Dictionary. Leiden, 1998 (AED).

Pedersen, Holger, *Die albanesischen* l-*Laute.* KZ 33, 1897, 535-551. Përkthyer shqip: *Tingujt* l *të shqipes*. St. Pedersen 31-46.

Pedersen, Holger, *Die Gutturale im Albanesischen.* KZ 36, 1900, 277-340. Përkthyer shqip: *Guturalet në shqipen*. St. Pedersen 55-114.

Schuchardt H., *Albanisches und Romanisches zu Miklosich's albanischen Forschungen*. KZ XX 1872, 241-303.

Skok, Petar, *Etimologijski rječnik hrvatskoga ili srpskoga jezika*. I-IV. Zagreb, Institut jezika Jugoslovenske Akademije znanosti i umjetnosti, 1971-1974 (ER).

Topalli, Kolec, Gramatikë historike e gjuhës shqipe. Tiranë, 2011 (Gr.).

Ylli, Xhelal, Das slavische Lehngut im Albanischen; 1 Teil: Lehnwörter. München, 1997; 2 Teil: Ortsnamen. München, 2000 (SLA).

Kolec TOPALLI, Albanian Academy of Sciences, Tirana

TOWARDS A CHRONOLOGIC-ETYMOLOGICAL STRATIFICATION OF THE RELIGIOUS VOCABULARY IN NOLI'S POETRY

Summary

The religious vocabulary in Noli's poetry can be devided in some strata:

1) The inherited stratum: *falem*, *kremtoj*, *lut*, *Zot*;

2) Inner formations of Albanian: *skëterrë*;

3) Latin loan-words: *bekoj*, *dëshpërohem*, *djall*, *dreq*, *engjëll*, *faj*, *fat*, *ferr*, *kryq*, *kungoj*, *lavdi*, *mallkoj*, *mëkat*, *mëshirë*, *ndjej*, *ngushëlloj*, *pendohem*, *Perëndi*, *Rrëshajtë*, *shenjt*, *shpirt*;

4) Romanian loan-words: *demon*, *katakomb*, *profet*;

5) Loan-words from Middle and New Greek: *fron*, *parajsë*, *temjan*;

6) Loan-words from Turkish: *Allah*, *aman*, *Islam*, *kanun*, *lanet*, *mysliman*, *qitap*, *Ramazan*.

Bardhyl DEMIRAJ, LMU München/ BRD

MBI NDRYSHIMIN E PARADIGMËS NË STUDIMIN DIAKRONIK TË SHQIPES PËR NGA PERSPEKTIVA E INDOEUROPIANISTIKËS – TEORIA E LARINGALEVE IE. DHE ZBATIMI I SAJ SI RAST STUDIMI

Tema e kumtuar ngërthen si e tillë një qerthull problemesh, që do të mund të shtjelloheshin deri diku shterueshëm në një monografi të tërë apo në kuadrin e një cikli të plotë leksionesh universitare. Gjithsesi, në hapësirën që më lejon një tubim i kësaj natyre me karakter sa shkencor aq edhe njohës për prurjet e shkencës amerikane në albanologji do të rrekem të përcjell me stil të thukët si jehonën dhe zhbillimet që përjeton prej kohësh kjo teori në gjuhësinë historike-krahasuese indoeuropiane (= ie.) ashtu edhe ndryshimin e paradigmës që pret të përjetojë ende sot e gjithë ditën në hapësirën kompakte shqipfolëse hulumtimi diakronik i shqipes parë nga perspektiva e gjuhësisë historike-krahasimtare indoeuropiane. Lejohem të vijoj kështu një mendim të shprehur dikur në ambientet e Universitetit të Prishtinës në prag të viteve 70-të të shekullit të kaluar prej gjuhëtarit dhe eruditit shqiptar Eqrem Çabej, sipas të cilit: "Sikur të vërtetohej që laringalet kanë ekzistuar dikur, kjo do të revolucononte mbarë fonetikën historike të gjuhëve indoeuropiane."[1], e për rrjedhojë edhe atë të gjuhës shqipe.

---

[1] Këtë mendim e ndeshim në ciklin e ligjëratave me temë: "Hyrje në studimin krahasimtar të gjuhëve indoeuropiane", që Eqrem Çabej e mbajti gjatë vitit akademik 1970-1971 në auditorët e universitetit të Prishtinës, regjistrimi i të cilave pa dritën e botimit rreth dy vjet më vonë në formën e nje dispence universitare (pa vit botimi) e më pas u përfshi edhe në radhojën e veprave të tij "Studime gjuhësore" (bleu VII, Prishtinë 1986). Një lexim sado i shpejtë i tekstit lakonik të rubrikës "Laringalet" (*vep. cit*. 77v.) lejon

Meqë edhe albanologjia si shkencë komplekse rajonale nuk njeh kufij nacionalë e aq më pak sosh shtetërorë, më lejoni të bëj një parantezë të thukët lidhur me bashkëlidhjen e mundshme midis temës së kumtuar prej meje dhe vetë tematikës qendrore të tubimit tonë: "Studimet albanistike në Amerikë". Kjo bashkëlidhje bëhet më se e natyrshme në rast se përmendim sado kalimthi zanafillën e studimeve nismëtare në këtë fushë, ku feksin disa emra studiuesish amerikanë, të tillë si:

R. Minshall: „Initial voiced laryngeal plus */y/ in Albanian": *Language* 32 [1956] 627vv.

E. Hamp (sidomos në): "Evidence in Albanian", në: *Evidence for Laryngeals,* London – The Hague – Paris 1964 (bot. W. Winter).

M. Huld: *Basic Albanian Etymologies*, Los Angeles 1984.

---

për të kuptuar menjëherë karakterin e tij informativ lidhur me fillimet dhe ecurinë e zhvillimit të kësaj teorie deri në studimet indoeuropianistike bashkëkohëse. Në të mësojmë ndër të tjera, se: a) nismëtar i kësaj teorie është Ferdinand de Saussure (1878), një "... nga përfaqësuesit më të mëdhenj të gjuhësisë indoeuropiane dhe të përgjithshme moderne", i cili gjatë hulumtimit të dukurisë së apofonisë/ ablautit ie. deduktoi për periudhën e përbashkët të zhvillimit gjuhësor ie. praninë e disa elementeve me karakter sonantik (coefficientes sonantiques); b) të cilët sipas rastit duhet të kenë shkaktuar zgjatjen dhe ngjyrimin në timbër të zanores themelore ablautive paraprijëse ie. */e/ (→ */ē/, /ā/, /ō/: Möller 1906, Cuny 1912); se d) për numrin dhe tiparet e tyre artikulative nuk ka ende një qëndrim të përbashkët në radhët e gjuhëtarëve indoeuropianistë, por që mendimi më i përhapur është ai që mëton dhe tumir ekzistencën e tri fonemave, të cilat pas gjithë gjasash duhet të jenë nyjëtuar në laring, andaj përdoret edhe termi i përbashkët *laringale* përkatësisht shenjimi i tyre me simbolet h_1, h_2, h_3; dhe se e) gjithsesi numri i kundërshtarëve të kësaj teorie është po aq i madh sa edhe ai i mbrojtësve të saj. Sipas Çabejt: "Kjo tezë u pranua nga shumë dijetarë, po nuk pati efekte në atë kohë. Shumë herë ndodh që të shtrohet një tezë edhe as miratohet, as hidhet poshtë, se është një gjë e pavërtetuar. Por nganjëherë ndodh që tezat të vërtetohen pastaj nga faktet që dalin. Kështu edhe këto forma që rindërtohen, shumë herë janë të pavërtetuara, po shumë herë kanë një gjasë që mund të kenë ekzistuar. [.....] Ç'mund të thuhet për laringalet? Shpjegimi i dukurive që i kanë lidhur me praninë e hershme të këtyre tingujve, i përkasin një periudhe preetnike të gjuhëve ie. Kjo teori, dhe pranimi i këtyre laringaleve, ka të bëjë me një periudhë preetnike të gjuhëve ie. Dihet se në fushën e shkencave, sidomos të shkencave historike, sa më të lashta janë periudhat që merren në shqyrtim, aq më të errëta, sa më të reja aq më të qarta janë. Kështu, edhe teoria e laringaleve sot prej shumë linguistëve pranohet, e prej shumë të tjerëve jo, bile prej disave quhet kimerike."

Kjo punë nismëtare e sidomos rëndësia që i dha Hamp (the Great) zbatimit të kësaj teorie në studimet e tij të panumërta në fushë të shqipes, nxiti si parim domino edhe interesimin e studiuesve të tjerë të shumtë në Europën Perëndimore të fundshekullit XX, të cilët do të kemi rast t'i përmendim thukët në vijim.

I. Zhvillime të teorisë së laringaleve në indoeuropianistikën moderne

Një vështrim perspektiv i zhvillimeve të shkencës së indoeuropianistikës në këta 45 vjet e tumir plotësisht atë përsiatje të Çabejt. Teoria e laringaleve ka zënë vend tashmë përfundimisht në kanonikët shkencorë e universitarë të indoeuropianistikës[2]. Vetë emërtimi 'teori' vijon të përdoret sot thjesht e vetëm për hir të traditës mësenjëshekullore të studimit dhe parakupton zgjerimin e sistemit klasik të fonemave të rindërtuara për fazën e përbashkët të zhvillimit gjuhësor ie. me tri segmente të reja, të ashtuquajturat laringale, të cilat u deduktuan fillimisht në mënyrë hipotetike si koefiçientë sonantikë për t'u përdorur si mjet ndihmës në punën për sistematizimin e dukurisë së apofonisë në strukturat morfologgjike të rrënjëve foljore (brenda paradigmave të eptimit)[3]. Teoria e laringaleve gjëllin sot si e tillë në kuadrin e shtjellimit të statusit fonologjik, të tipareve nyjëtimore si edhe të sjelljes së tyre në mjedisin fonologjik rrethues.

1. *Tiparet fonologjike dhe nyjëtimore të fonemave laringale*

Fonemat laringale (= faringale) gëzojnë të njëjtin status sikurse edhe segmentet e tjera të sistemit fonologjik të rindërtuar ie. Materiali gjuhësor i pakët, por i sigurt, që saktësoi praninë e tyre në paradigmën e këtij sistemi, u zbulua me deshifrimin dhe njohjen e hetitishtes si gjuhë ie. Në hetitishte gjëllin një bashkëtingëllore spirante /h/ (≈ [χ]) – e pasqyruar grafi-

[2] Shih ndër të tjerë Mayrhofer 1986; Beekes 1988, 1995 101v., 142vv.; Szemerényi 1990 127vv.; Meier-Brügger 2000 98vv.; Tichy 2000 30vv.; Fortson IV 2010[2] 62vv.

[3] Saussure 1878 1vv.; Möller (1879) 1906 VI; Cuny 1912 101vv. Për rolin e Saussure-it dhe historikun e zhvillimit të teorisë së laringaleve në indoeuropianistikë shih Szemerenyi 1973 1vv.; Mayrhofer 1981 vv.

kisht me shenjën kuneiforme <ḫ̆> – e cila në shumë raste vijon pandërmjetshëm të paktën njërën ndër fonemat laringale të rindërtuara për gjuhën bazë ie., përkatësisht */h_2/[4], khs.:

ie. */h2ent-i/: het. *ḫ̆ant-i* lok. "në anën e parme, përballë", lat. *ante* "para".

ie. */$h_2$ertk̑o-s/ pranë */h_2r̥kÞo-s/ "ari": het. *ḫ̆artagga-* pranë ind. vj. *ŕkṣa-*, gr. ἄρκτος, shq. *ari* etj.

Përndryshe prania e tyre në fazat e hershme të zhvillimit gjuhësor arrin të motivohet bindshëm në bazë të analizave përqasëse të materialit gjuhësor që ofrojnë gjuhë të ndryshme ie., sidomos gjuhët ie. klasike si greqishtja, indishtja e vjetër dhe latinishtja etj.

Sa i përket tipareve nyjëtimore të fonemave laringale ie. nuk zotëron ende një mendim i përgjithshëm, andaj në literaturën indoeuropianistike bashkëkohore ato vijojnë të përcillen ende kryesisht me simbolin algjebrik h (= ie. */h_1, h_2, h_3/ ~ H[5]), më rrallë edhe me simbolin e Schwa indogermanicum *ə ose *ə̰ (= ie. */$ə_1$, $ə_2$, $ə_3$/ përkatësisht */$ə̰_1$, $ə̰_2$, $ə̰_3$/) ose me ħ (= ie. */ $ħ_1$, $ħ_2$, $ħ_3$/). Karakteri i tyre parësor bashkëtingëllor, pas gjithë gjasash, në radhën e spiranteve, shihet gjithsesi si më bindës. Me përafërsi mund të supozohen për fonemat në shqyrtim veçoritë fonetike që vijojnë:

*/h_1/ ≈ [ç] (laringale palatale: më e prapme se arb. Gr. /ç/, khs. [çé] "híe"), [h] ose [ʔ] (tinguj kërcitës: *ʾAlif*).

*/h_2/ ≈ [χ] (laringale uvulare: më e prapme se arb. Gr./x/, khs.: *xar* "hare") ose [ħ] (spirante faringale e pazëshme).

*/h_3/ ≈ [ʁ]/[$ʁ^w$] (laringale uvulare e zëshme (jo)buzore, deri diku e ngjashme me (por më e prapme se) arb. Gr. /ɣ/, khs. *ɣajður* "gomar"), ose [ʕ] (*ʿAyn*)[6].

---

[4] Kuryłowicz 1927 95vv. Në raste të veçanta edhe */h_3/, shih Beekes 1995 142; Meier-Brügger 2000 114 etj.

[5] Në rastet kur rindërtimi gjuhësor nuk mundëson përcaktimin me saktësi të llojit të fonemës laringale, përdoret simboli gjithëpërfshirës /H/ (Cover-Symbol).

[6] Meier-Brügger 2000 98.

Në një mjedis fonologjik të ngjashëm me atë të bashkëtingëlloreve sonante (ie. */n/, */m/, */r/, */l/ ~ *[n̥], *[m̥], *[r̥], *[l̥]), fonemat laringale mund të tërheqin gjithashtu majën e rrokjes mbi vete, duke u realizuar si alofone sonantike me tiparin fonologjik [+rrokjebartës]: *[h̥$_1$], [h̥$_2$], [h̥$_3$] (= *[H̥])[7].

Rregulla (1): ie. */h$_1$, h$_2$, h$_3$/ → ie. */h̥$_1$, h̥$_2$ h̥$_3$/ | ° C _ C °
# #

= ie. *H → ie. *[H̥] | ° C _ C °
# #

Shembull:

ie. */deh$_3$-/ "jap": ind. vj. *ádāt* "ka dhënë", gr. ἔδωκα "dhashë", lat. *dō* "jap" etj., pranë ie. (pj.) */dh̥$_3$-to-/: gr. δοτός, lat. *datus* "dhënë" etj.

2. *Sjellja e fonemave laringale ie. në mjedisin fonologjik rrethues*

Krahas realizimeve alofonike të segmenteve të veçantë, të kushtëzuara këto me pozicionin e tyre në sintagma të caktuara, diktohen për fazat e hershme të zhvillimit gjuhësor (faza ie. e vonë dhe ajo pasie. e zhvillimit gjuhësor) edhe një numër shndërrimesh kombinatore që kanë ndikuar kryesisht marrëdhëniet përndarëse (= distributive) brenda klasës së fonemave zanore. Në bashkëlidhje me një fonemë laringale zanorja e shkurtër ie. */e/ u është nënshtruar sipas rastit shndërrimeve në timbër dhe/ose (sikurse edhe zanoret e tjera të shkurtra) atyre në gjatësi. Ndër dukuritë[8] më kryesore përmendim:

a) *Shndërrime në timbër të zanores ie.* */e/

[7] Ky tipar realizohet kryesisht në strukturat fjalë- dhe formëformuese me shkallë apofonike zero. Në aspektin fonetik vokalizimi shpjegohet nga disa indoeuropianistë me përftimin e një zanoreje embrionale në pozicion midis laringalit /H/ dhe bashkëtingëllores prijëse (shih Mayrhofer 1986 138; Meier-Brügger 2000 106), një dukuri e ngjashme kjo me përftimin e së ashtuquajturës *Schwa secundum* (Demiraj, B. 1989 81vv.)

[8] Për një pasqyrë të hollësishme të këtyre zhvillimeve mund të kosultohet literatura e dhënë në shën. 2.

Në fqinjësi të pandërmjetme me njërën nga fonemat laringale ie. */h_1, h_2, h_3/ zanorja e shkurtër */e/ ose e ka ruajtur të pacënuar timbrin e saj (në bashkëlidhje me */h_1-/, ose është shndërruar rregullisht në */a/, përkatësisht në */o/ (në bashkëlidhje me */h_2-/, */h_3-/). Të gjitha fonemat e tjera zanore, duke përfshirë këtu dhe ie. */ē/, e kanë ruajtur timbrin e tyre në mjedisin fonologjik në fjalë. Këto shndërrime janë përftuar në fazën e përbashkët të zhvillimit gjuhësor ie.

Rregulla (2): ie. */e/ → ie. */e, a, o/ | $\underset{\#}{\circ}\ \mathrm{H}_{(1,2,3)}\ _\ \underset{\#}{\circ}$

Rregulla (3): ie. */e/ → ie. */e, a, o/ | $\underset{\#}{\circ}\ _\ \mathrm{H}_{(1,2,3)}\ \underset{\#}{\circ}$

Shembuj:

ie. */$h_1$es-mi/ "jam": ind. vj. *ásmi*, gr. (hom.) εἰμί, arm. *em* "id.", pranë (e pakr.) */$h_1$es-m̥/: shq. (Buz./ dial.) *jesh-ë* etj.

ie. */$h_2$ent-i/ "kundrejt": het. *ḫant-i* lok. "në anën e parme", ind. vj. *anti* "kundrejt", gr. ἀντί "kundrejt, para", lat. *ante* "para", shq. (vj.) *ndë* etj.

ie. */$h_3$edo-(C-)/ "erë, aromë": lat. *odor*, arm. *hot-oy*, gr. ὀδμή, shq. (g.) *ãmë(z)* "id.".

b) *Shndërrime në gjatësi*

Faza e parë e degëzimit dialektor të gjuhës bazë ie. (faza pasie. e zhvillimit gjuhësor) u shoqërua me procesin e rrëgjimit të laringaleve ie. në realizimin e tyre bashkëtingëllor, proces ky që përfshiu thuajse të gjitha degët kryesore ie. (me përjashtim të degës anatolike, shih shën. 4). Në pozicion para një bashkëtingëlloreje ose në pozicion tejfundor ky rrëgjim ndikoi në zgjatimin kompensator të të gjitha zanoreve paraprijëse të shkurtra, pavarësisht nga natyra e fonemës laringale.

Rregulla (4): ie. */e, a, o, i, u/ → pasie. */ē, ā, ō, ī, ū/ | $\underset{\#}{\circ}\ _\ \mathrm{H.C}\ \underset{\#}{\circ}$

= ie. *V → pasie. *Ṛ | $\underset{\#}{\circ}\ _\ \mathrm{H.C}\ \underset{\#}{\circ}$

Shembuj:

ie. */meh$_1$n-s/ “muaj”: ind. vj. *mā́s-*, gr. μήν, lat. *mēnsis*, shq. *muaj.*

ie. */meh$_2$tĕr/ “nënë”: ind. vj. *mātár*, lat. *māter* “id.”, shq. *motër.*

ie. */deh$_3$-no-m/ “të dhënë”: ind. vj. *dā́nam* “dhuratë”, lat. *dōnum* “id.”.

c) *Vokalizim përkatësisht bjerrje e plotë e alofoneve rrokjebartës*

Sikurse bashkëtingëlloret likuide edhe fonemat laringale ie. shfaqeshin me tiparin [+ rrokjebartës] në pozicion midis dy bashkëtingëlloreve (rregulla nr. 1; § I/1). Në periudhën drejt formëzimit të degëve të veçanta ie. alofoni laringal rrokjeformues (*[H̥]) ose i është nënshtruar vokalizimit të plotë, ose është bjerrë (në shumë gjuhë) pa lënë gjurmë[9]:

Rregulla (5): ie. *[H̥] → pasie. $V/\emptyset \;\Big|\; \begin{matrix} ° & C & _ & C & ° \\ & \# & & \# & \end{matrix}$

Shembuj:

ie. */k̑eh$_1$s-mi/ “udhëzoj, drejtoj”: ind. vj. (3. nj.) *śā́sti* “mëson; thërret”, pshq. **ϑē^{m}m* > *thom,* (e riformuar për nga tipi) lat. *cēnseō* “vlerësoj”, kundrejt:

ie. (mb. foljor) */k̑h$_1$s-no-/: pshq. (pjes.) **ϑan-* (pjes.) > T *thënë,* G *thãnë* .

ie. */b^{h}orHg̑-/: got. *baírhts* “i kthjellët, i qartë, i ndritshëm”, pshq. **barδ-* > (*i*) *bardhë*.

d) *Aspirim dhe/ose zëshmim të mbylltoreve paraprijëse*

Bjerrja e laringaleve ie. */h$_2$/, */h$_3$/ ka shkaktuar shpesh (por jo rregullisht) aspirim përkatësisht zëshmim të bashkëtingëllores mbylltore paraprijëse, khs.:

ie. (e. nj.) */ponteh$_2$-s/, (gj. nj.) */pn̥th$_2$-es/ “shteg”: av. *pantā̊, paϑō* “id.”

ie. */roth$_2$-o-s/ “rreth”: ind. vj. *rátha-* “karrocë (me rrota)”,

[9] Kushtet fonologjike të bjerrjes së laringalit në këtë pozicion mbeten gjithsesi për t’u sqaruar; shih për këtë Beekes 1995 142v.

shq. *rreth* (sh. *rrathë*), lat. *rota* "rrotë".

ie. */peh3-/ "pi", (me dyfishim; 3. nj.) */pí-ph3-ti/: ind. vj. píbati, lat. bibit "id.", ir. vj. ibit (< *pibeti) "të pini!".

II. Mundësitë e zbatimit të teorisë së laringaleve në studimin diakronik të shqipes.

Ndryshimi i paradigmës që përjeton gjuhësia historike-krahasuese ie. prej më se tridhjetë vjetësh ka përcjellë si reaksion zinxhir zbatimin e sistemit "të ri" fonologjik ie. edhe në studimin diakronik të degëve dhe gjuhëve të veçanta ie.

Hartimi i kompendiumeve të rinj mbi bazën e sistemit të risuar fonologjik ie. paraqet ndërkohë një cikël thuajse të mbyllur për gjuhët klasike ie. si indishtja e vjetër, greqishtja, latinishtja, hetitishtja etj., ndërkohë që edhe fjalorët etimologjikë të gjuhëve përkatëse janë në përpunim e sipër.[10]

Sigurisht që ky reaksion nuk bëhet thjesht për hir të premisës metodologjike, sipas së cilës është sistemi gjuhësor i rindërtuar ie. ai që përbën pikënisjen e evolucionit të mëvetësishëm të degëve dhe gjuhëve kryesore ie. Në instancë të fundit janë gjuhët ie. ato që ofrojnë materialin gjuhësor, duke mundësuar kështu vetë rindërtimin e kësaj baze fillestare. Ai është më fort rrjedhojë e shkëmbimit dhe bashkërendimit të informacionit midis indoeuropianistikës dhe filologjive të gjuhëve të ndryshme ie. në punën për rindërtimin e atyre fazave të (krye)hershme të evolucionit gjuhësor, për të cilat mungon jo vetëm dokumentimi shkrimor, por edhe siguria në saktësimin e kontakteve ndërgjuhësore.

Shkëmbimi dhe bashkërendimi i këtij informacioni midis albanologjisë historike dhe indoeuropianistikës është më se i mundshëm[11], për të

[10] Gramatika historike, fjalorë etimologjikë të rinj dhe monografi të posaçme janë botuar (ose janë në botim e sipër) për gjuhët kryesore ie.; khs. ndër të tjerë: Winter (ed.) 1965; Beekes 1969; Rix 1976; Mayrhofer EWAia; Schrijver 1991; Rasmussen (ed.) 1994; Melchert 1994; Meiser 1998; Beekes IED, De Vaan 2008 etj.

[11] Ndër gjuhëtarët indoeuropianistë që zbatojnë këtë teori në fushë të shqipes dallojmë,

mos thënë i domosdoshëm në pamjen e re që ka marrë indoeuropianistika dhjetëvjeçarët e fundit, aq më tepër kur është fjala për çështje që mbeten ende të pazgjidhura (shterueshëm) për ato faza të evolucionit historik të protoshqipes që u paraprijnë kontakteve intensive me latinishten dhe greqishten e vjetër.

Pa dashur të dal nga tema mund të sjell si shembull dysinë e fonemave vibrante /r/ ~ /r̄/ në fondin e trashëguar ie. të shqipes, kundërvënia e të cilave realizohet në çdo pozicion të fjalës. Sigurisht që nuk mund të vihet më në diskutim mendimi që vibrantja e thjeshtë /r/ vijon pandermjetshëm simotrën e saj të vetme në sistemin e rindërtuar fonologjik ie. (: ie. */r/) dhe që pendanti i saj /r̄/ në trup dhe në fund të fjalës është rezultat i asimilimit të grupit të dikurshëm (shq.) */rn/ ose për arsye ekspresive[12]. Më i ndërlikuar paraqitet shpjegimi diakronik i kësaj kundërvënieje në pozicion nistor në njësi të tilla si: rjep, regj kundrejt rreth, rrënjë, rrjedh etj., burimi ie. i të cilave është më se i sigurtë.

Një orientim të parë në zgjidhjen e këtij problemi na e jep krehja e elementit latin të shqipes, ku arrijmë të fitojmë proporcione të qarta, si p. sh.:

lat. /r-/	~	shq. /r̄-/	lat. /Vr-/	~	shq. /r-/
radia	>	rreze	arēna	>	rërë
rarus	>	rrallë	aeramen	>	rem
resina	>	rrëshirë	erīca	>	riq

Po të marrim parasysh që bjerrja e zanoreve të patheksuara nistore është një dukuri bukur e hershme e shqipes, atëhere nuk paraqet vështirësi as deduksioni, sipas të cilit një /r-/ nistore në fondin autokton të shqipes duhet të ketë qenë në zanafillë e paraprirë nga një zanore e pa-

---

përpos studiuesve amerikanë Minshall 1956 627vv.; Hamp (sidomos) 1965 123 (kundër tij Ölberg 1972 121vv.); Huld 1984 etj., edhe Kortlandt 1984 243vv.;1986 38vv.; Beekes 1995 260vv., Matzinger 2006; De Vaan 2008; Schumacher-Matzinger 2014 etj. Për qëndrimet e ndryshme ndaj saj në literaturën albanologjike shih: Demiraj (Sh.) 1996 27v., 47, 121, 123; Demiraj (B) 1997a/b; 1998 143vv.; Topalli 2000 61vv.

[12] Meyer 1892 70vv.; Literaturë thuajse shteruese te Topalli 2001 263vv. Për etimonet e njësive të cituara në tekst shih Meyer 1891, Çabej SE dhe Demiraj (B.) 1997 (pasim).

theksuar, e cila me kohë (të paktën në periudhën e ndikimit latin të shqipes) i është nënshtruar rrëgjimit të plotë. Ky deduksion që është më se bindës, hap megjithatë një problem tjetër jo pak të vështirë për t'u zgjidhur, pasi shtyhet në kohë në një periudhë të hershme të evolucionit të (proto)shqipes, për të cilën nuk sigurojmë dot material të mjaftueshëm prej fondit të kontakteve ndërgjuhësore.

Është fjala këtu për burimin e kësaj zanoreje paraprijëse, të cilën e deduktojmë fillimisht thjesht për të shpjeguar përftimin e kundërvënies së fonemave /r-/ ~ /r̄-/ në pozicion nistor. Në këtë rast, përqasja e materialit gjuhësor ie. të shqipes me atë të latinishtes (por edhe me atë të shumë gjuhëve ie. si indishtja e vjetër, gjuhët baltike etj.) nuk na ndihmon aspak, madje përcjell vetëm kundërthënie me deduktimin e mësipërm, khs.:

lat. *rapiō* ~ shq. *rjep* ~ lit. *ap-rė́piu* "mbështjell, përfshij"

lat. rota ~ shq. rreth (< *r̄aθ, sh. rrathë) ~ ind. vj. rátha- "karro"

Një situatë krejt tjetër paraqitet po të përqasim të njëjtin material të shqipes me atë të greqishtes së vjetër. Njësive shqipe me /r̄-/ të fortë nistore u përgjigjen gjegjëset e tyre me një vibrante të forcuar në greqishte (: <ῥ>), ndërsa ato me një /r-/ të thjeshtë përqasen bindshëm me gjegjëse që nisin me një zanore, e cila ndiqet pandërmjetshëm nga vibrantja e thjeshtë (: <Vρ->), khs.:

gr. <ῥ>	~	shq. /r̄-/	gr. <Vρ->	~	shq. /r-/
ῥάττω	~	*rrah*	ἐρέπτομαι	~	*rjep*
ῥᾱδιξ	~	*rrënjë*	ὀρούω	~	*ra* (kr. thj.)
ῥηχός	~	*rrodhe*	ἐρυθρός	~	(*f*)*ruth*
ῥᾴξ	≥	*rrush*	ἐρωέω	~	*resht* (f.)

Proporcioni i ri që fitojmë gjatë përqasjes së materalit të shqipes me atë të greqishtes së vjetër, e përforcon edhe më shumë deduksionin fillestar lidhur me rrugën dhe mënyrën e përftimit të dysisë fonematike /r-/ ~ /r̄-/ në pozicion nistor në gjuhën shqipe. Megjithatë çështja nuk mund të quhet ende e zgjidhur. Shfaqet një problem i ri, që shtyhet në kohë të paktën deri në periudhën e formëzimit të degëve të veçanta ie.

Është fjala këtu për vetë burimin e një zanoreje nistore në njësitë e fondit ie., për të cilën nuk ndeshen gjegjëset përkatëse në latinishte e në gjuhë të tjera ie.

Sigurisht që nuk është detyrë e mirëfilltë e albanologut të ndjekë zanafillën e kësaj dukurie në periudhat e evolucionit të përbashkët gjuhësor ie. Por në rastin konkret është më se i mjaftueshëm konsultimi i kodekseve të indoeuropianistikës moderne, të cilët na sigurojnë se një dukuri e ngjashme me atë të shqipes dhe të greqishtes shfaqet edhe në armenishte, frigishte e (pjesërisht) në hetitishte. Ështa fjala për dukurinë me karakter dialektor ie. të vokalizimit të laringaleve dhe të ruajtjes si të tillë në pozicion nistor para një bashkëtingëlloreje në këto gjuhë/degë ie., ndërkohë që në gjuhët/degët e tjera ie. ato duhet të jenë rrëgjuar qysh në statusin e tyre fillestar (= fonemë laringale)[13].

III. Përfundim si nismë paraprake

Dukuria e mësipërme dhe shtjellimi i saj i shkon përshtat dhe mundëson më së miri zbatimin e teorisë së laringaleve ie. në albanologji, e kushtëzuar kjo sigurisht me studimin e fazave të (krye)hershme të evolucionit të mëvetësishëm të shqipes si edhe me atë të pozicionit të saj po aq të mëvetësishëm në arealin gjuhësor ie. Si e tillë ajo përforcon dhe plotëson më tej rezultatet e derisotme të fonologjisë historike të shqipes, sikurse do të rrekemi t'i provojmë në vijim të këtij studimi.

IV. Zhvillime të laringaleve ie. */h_1/ */h_2/, */h_3/ (*/H/, *[H̥]) në shqipe

Zhvillimi i laringaleve ie. në shqipe rezulton të jetë shumëdrejtimësh, duke u kushtëzuar, ndër të tjera: prej pozicionit të tyre (në fillim, në trup ose në fund të fjalës), prej mjedisit fonologjik rrethues, përkatësisht prej realizimit të tyre bashkëtingëllor ose (alofonik) rrokjebartës brenda

[13] Për një paraqitje të detajuar të kësaj dukurie dhe bashkëlidhjen e saj me dysinë fonematike /l/ ~ /ł/ në shqipe shih Demiraj (B) 1994 57vv.

strukturave morfonemike të fjalë- dhe formëformimit. Shumë çështje lidhur me rrugën e zhvillimit, përkatësisht me ndikimin e tyre në evoluocionin e fonemave fqinjë mbeten ende për t'u sqaruar.

4.1. *Në pozicion nistor*

4.1.1. *Para zanoreve*

a) ie. */h_1/-: (p)shq. ø (para */i/, */u/ mungojnë shembuj të sigurt)

- ie. */$h_1$esmi/: pshq. */emm(-)/ > shq. *jam* (tash. I nj.),
- ie. */$h_1$opi-ro-/: pshq. */apir-/ > shq. *(i) epër* , lidhet etimologjikisht me gr. ὄπιθε(ν) "prapa, pas".

b) ie. */h_2/-, */h_3/-: pshq. */h/- (? – para ie. */e(i̯)/, */u/, */i/) dhe ø (para ie. */o/)

→ shq. (t., g.) /h-/, (dial.) ø:

- ie. */$h_2$ei̯d^hos/: shq. *(h)éthe* f. (pl. tant.), khs. gr. αἶθος "djegie, zjarr",
- ie. (du.) */$h_3$erg'^{h}ih_1/: pshq. */hardī/ > shq. *hérdhe* f. (sh.), lidhet etimologjikisht me gr. ὄρχεις (sh.), arm. orjik^c (sh.) "id.",
- ie. */h_2id^h-/: shq. *(i) hídhët, (h)ídhtë* (< *hidh-të*) mb., lidhet etimologjikisht me gr. ἰθαρός "i çelët",
- ie. */$h_2$uto-/: shq. hut ndf. "kot; bosh", khs. gr. αὔτως "më kot".

→ shq. ø:

- ie. */Hosk̑-/: shq. *ah* m., arm. *hac^{c}i*, gj. l. vj. *asc* "lloj frashëri",
- ie. */$h_2$ok̑-/: shq. (*i) áthët*, *áthtë* (< *ath-të*) mb., khs. lat. *acidus* "id.".

c) shq. **/h/- (: */h_2/, */h_3/) duhet të jetë bjerrë shumë herët (nëpërmjet një procesi disimilues) në pozicion para një diftongu ie. më */-u̯/. Një bjerrje e hershme e (p)shq. **/h-/ (: ie. /H/) mund të mëtohet edhe për njësi të ndryshme leksiko-gramatikore me theks burimor dytësor ose të dobësuar qysh herët (si p.sh. në pjesëza të ndryshme proklitike dhe enklitike):

- ie. */$h_2$eu̯g-/: pshq. */hau̯g-/ > shq. *ag* m., khs. gr. αὐγή "id., drita e ditës",
- ie. */$h_2$eu̯h_1-(et/s-)/: pshq. */hau̯-et/ś-/ > shq. *aft* m., *afsh* m., lidhet etimologjikisht me gr. ἀϋτμή "frymë; afsh i zjarrit",
- ie. (temë pron.) */$h_2$eu̯-/: pshq. */hau̯/ > shq. {a-} pjesëz deiktike (si gjymtyrë kompozicionale në sistemin përemëror të shqipes),
- ie. */$h_2$en/: shq. *a*? (pjesëz pyetëse), khs. gr. ἄν, lat. *an*.

4.1.2. *Para likuideve dhe hundoreve rrokjebartëse*

Ato janë vokalizuar, sikurse ne greqishte ("Lex-Rix"), duke tërhequr majën e theksit mbi vete në sekuencat ie. *(-)H_{1-3}R̥.C-, *(-)H_{1-3}N̥.C- , në të cilat HR̥, HR̥: pshq. VR, VN :

→ shq. VR:

- ie. (*/h_2r̥tk̑o-/ :) */h_2r̥k̑þo-/: pshq. */arθ-/ > shq. *arϑ > *ar (~ sh. dial./Bogdani *ár-a*), përndryshe gjithmonë e zgjeruar më {-í-}[14], khs. (t., g.) *arí* m., khs. gr. ἄρκτος "id.",
- ie. (*/h_2r̥h_3-u̯o-/ :) */h_2r̥u̯o-/: pshq. */aru̯ā/ > shq. *árë* f., khs. lat. *arvum* "tokë bujqësore".

→ shq. VN:

- ie. */h_1n̥d^he-/: pshq. */end(h)-/ > shq. *éndem* fol. (refl.), khs. gr. ἐνϑεῖν "vij",
- ie. (*/h_1n̥$h_3$men-/ :) */h_1n̥men-/: pshq. */enmen-/ > shq. */émen-/ > (t.) *émër*, (g.) *ẽmën* m., khs. gr. ὄνομα, sll. vj. k. *imę* "id.".

4.1.3. *Para gjysmëzanoreve*

ie. */Hi̯/-, */Hu̯/-: pshq. */(V)i̯/- (ndoshta [j]), */(V)u̯/- (ndoshta [υ])

→ shq. /ɟ/ <gj>:

[14] Bjerrja e fundores së temës /-θ/, që mbart gjithkund në shqipe funksion deminutiv-hipokoristik, dhe zgjerimi më pas me formantin {-í}, duan parë pas gjase si rrjedhojë e një procesi tabuizimi (sikurse edhe në gjuhë të tjera ie.), që duhet të ketë përjetuar ky emër, përkatësisht bartësi i tij në (proto)shqipe.

- ie. */(H)i̯eh$_3$s-/: pshq. (-)*/(V)i̯ōś-/ > shq. *(n)gjesh* fol. "lidh brezin, rripin", lidhet etimologjikisht me gr. ζώννυμι "id.".

→ shq. /v/-:

- ie. */h$_2$u̯er-o-/, */h$_2$u̯or-(e)i̯o-/: pshq. */Vu̯er-/, */Vu̯arei̯-/ > shq. *vjerr*, *var* fol., khs. lit. *sveĩti* "peshoj", gr. ἀείρω "ngre lart".

4.1.4. *Para bashkëtingëlloreve*

a) Sikurse shqyrtuam hollësisht më lart (§ II) vërejmë gjurmë të sigurta vokalizimi të laringaleve nistore ie. në protoshqipe, të paktën para bashkëtingëllores vibrante */r/. Kjo zanore iu nënshtrua më pas një procesi rrëgjimi të plotë, sikurse të gjitha zanoret nistore të patheksuara të shqipes që nuk mbart(n)in funksion gramatikor: ie. */Hr/-: pshq. */Vr/- (ndoshta *[aɾ-]) > shq. /r/- = <r->, në dallim me ie. */r/-, */sr/-, */u̯r/-: pshq. */r/- [ʳr] > shq. /r̄/- <rr->. Shpërndarja komplementare zanafillëse përkon plotësisht me zhvillimet fonologjike përkatëse në greqishte (ie. */Hr/-: gr. Vρ- kundrejt ie. */r/-, */sr/-, */u̯r/-: gr. ῥ-):

- ie. */h$_1$rep-o-/: pshq. */Vrep-/ > shq. *rjep* fol., khs. gr. ἐρέπτομαι "id.",
- ie. */h$_1$reu̯g-/: pshq. */Vre(u̯)g-/ > shq. *regj* fol., lidhet etimologjikisht me gr. ἐρεύγομαι "gromësij",

b) Për shkak të bjerrjes së zanoreve nistore të patheksuara qysh në fazat e hershme të zhvillimit gjuhësor bën sot për sot të pamundur sqarimin e çështjes, nëse një laringale nistore ka përshkuar në protoshqipe të njëjtën rrugë evolutive para çdo bashkëtingëlloreje.

Shënim: Lidhur me moshën e bjerrjes së zanoreve të patheksuara nistore të shqipes qofshin këto burimore apo rezultat i vokalizimit të laringaleve, mund të mëtohet me siguri si kronologji relative parakohësia ndaj procesit të bjerrjes së gjegjëseve të gjata. Këtë përfundim arrijmë gjatë hetimit të dyzimit të likuideve /l/: /ɫ/ në gjuhën shqipe, khs.:

- ie. */leh$_1$d- /: pshq. */lēd-/ > */lāð-/ > shq. *lodh* fol., khs. gr. (Hes.) ληδεῖ· κοπιᾶ,

sikurse:

- ie. */$h_2$loi̯-d-/: pshq. */Vlái̯d-/ > shq. *ledh* m., prus. vj. *laydis* "id.",

kundrejt:

- pshq. */ōlénā/ > */Vłana/ > (t.) *llërë*, (g.) *llãnë* f., khs. gr. ὠλένη "id.; bërryl".

4.2. *Në trup të fjalës*

4.2.1. *Ndërmjet zanoreve*

a) ie. -*/iH/-, -*/uH/-: (ndoshta) pshq. -*/ii̯/-, -*/uu̯/-

→ shq. /j/-, /u/-:

- ie. */d^hi$h_1$ol-i̯o-/: pshq. */d(h)ii̯all-/ > shq. *djálë* m., lidhet etimologjikisht me lat. *fīlius* "bir",
- ie. */k̑luH-eh_1-/: pshq. */kluu̯ē-/ > shq. (Buzuku) *klúonj*, (t. dial., arb. Gr./It.) *klúanj*, (t.) *qúaj*, (g.) *qú(e)j* fol., khs. lat. *clueō* "id.".

b) Zhvillimi pas ie. */e/, */o/, */a/ mbetet për t'u sqaruar.[15]

4.2.2. *Në bashkëvajtje me likuidet dhe hundoret rrokjesore*

a) Në sekuencat CR̥HC dhe u̯R̥HC grupi R̥H (= të ashtuquajturat sonante të gjata ie.) është shndërruar në pshq. */ra/, */la/[16] (për sekuencat CN̥HC, u̯N̥HC mungojnë shembuj të sigurt)[17]:

→ shq. /ra/ (sipas rastit i metafonizuar në /re/):

- ie. */b^hr̥Hg'-o-/: pshq. */b(h)rað-/ > shq. *bredh* m. "bredh, (dial.) larsh; lis", khs. ind. vj. *bhūrjá-* "lloj mështekne",

---

[15] Këtu nuk mbajmë parasysh ndryshimet në timbër të zanores */e/, të cilat janë përftuar qysh në fazën e zhvillimit të përbashkët gjuhësor ie.

[16] Ky përfundim, i arritur nga shkruesi i këtyre radhëve 18 vjet më parë (shih Demiraj 1997 51), është miratuar së fundi prej Stefan Schumacher-it (2007 229v.), veçse së fundi (shih Schumacher & Matzinger 2013 230) rezulton të ketë përvetësuar pa të drejtë autorësinë e tij.

[17] Për sekuencat HR̥(H)C dhe HN̥(H)C shih më lart § 4.1.2.

- ie. */u̯r̥Hd(V)-/: pshq. */(u̯)rad-(ni̯ā)/ > shq. (t.) *rrënjë*, (g.) *rrã(n)jë* f., lidhet etimologjikisht me lat. *rādīx* "id.".

→ shq. /la/ (sipas rastit e metafonizuar në /le/),

- ie. */pl̥h$_2$-ko-/: pshq. */plak-/ > shq. *plak* (~ sh. *pleq*) m./mb., khs. lit. *pìlkas* "gri, i thinjur",
- ie. */u̯l̥Hg-/: pshq. */(u̯)lag-/ > shq. *lag* fol., khs. lit. *vìlgyti* "id.".

b) Në sekuencën CR̥HV (~ CN̥HV) grupi R̥H shndërrohet në pshq. */aR/ pranë */uR/ (pas një labiovelareje tektale dhe */u̯/)

→ shq. /aR/ (sipas rastit e metafonizuar në /eR/):

- ie. */pr̥Hos/: pshq. */para/ > shq. *párë* ndf., khs. ind. vj. *purás* "id.", gr. πάρος "më parë; para",
- (?) ie. */dm̥h$_2$-o-/: pshq. */dam-/ > shq. (sh. i singularizuar) *dem* m., khs. ir. vj. *dam* "ka", më tej gr. δαμάλης "dem".

→ shq. /uR/:

- ie. */g^{u}r̥H-í-/: pshq. */guri/ > shq. /gur/ m., khs. ind. vj. *girí-* "mal", lit. *gìre* "pyll (në mal)",
- ie. */g^{u}l̥H-(e)i-/: shq. *ngul* (< */-n-gull-/) fol., lidhet etimologjikisht me lit. *gélti* "id.", *gìlti* "zë të dhëmbë (plaga)",
- ie. */u̯n̥H-o-/: (p)shq. */un-/ > (t.) *u, urí*, (g.) *ũ* f., lidhet etimologjikisht me ind. vj. *vánas-* "kërkesë, nevojë, dëshirë (për diçka)".

4.2.3. *Ndërmjet një zanoreje dhe një bashkëtingëlloreje*

ie. VHC: pshq. Y̯C krahas ndryshimit të mëhershëm të timbrit të ie. */e/ (shih më lart § 2.2.b):

a) ie. */eh$_2$/ > */ā/: pshq. */ā/

→ shq. /o/:

- ie. */meh$_2$tr̥/ "nënë": pshq. */mā́tri/ > shq. *mótër, mótrë* f., lat. *māter* "nënë",
- ie. */b^{h}u̯eh$_2$-t-/: pshq. */b(h)u̯āt-/ > shq. *bótë* f. "dhe, tokë; botë" lidhet etimologjikisht me ind. vj. *bhū́-, bhū́mi-* "dhe, tokë",

b) ie. */eh$_1$/ > /ē/: pshq. */ē/ (ndoshta [ę:]) > */ā/

→ shq. /o/:

- ie. */meh$_1$-t-/: pshq. */mēt-/ > */māt-/ > shq. *mot* m. "periudhë kohore (e një viti), vit; kohë", khs. lit. *mẽtas* "vit; kohë",
- ie. */d^{h}eh$_1$-teh$_2$-/: pshq. */d(h)ētia̯ā/ > shq. *dósë* f. "femra (e derrit); kafsha mëmë", lidhet etimologjikisht me ind. vj. *dh ā́trī-* "mëndeshë, nënë",

c) ie. */eh$_3$/, */oH/ > */ō/: pshq. */ō/

→ shq. /e/:

- ie. */Hok̑teh$_3$/: pshq. */aktō-(tā)/ > shq. *tétë* num., khs. gr. ὀκτώ "id.",
- ie. */bloh$_1$-ro-/: pshq. */blōr-/ > shq. *(i) blérë, blértë* mb., khs. lat. *flōrus* "blu, i verdhë".

d) ie. */ī/ (*/iH/): pshq. */ī/

→ shq. /i/:

- ie. */d^{h}iH-to-/: pshq. */d(h)īt-/ > shq. *dítë* (pranë t. *ditur(ë)*, g. *ditun*) pj. e *di* fol., khs. ind. vj. *dhītā́-* pj. "njohur",
- ie. */trih$_2$/: pshq. */trī/ > shq. *tri* num. (f.), khs. lat. *tria* "id.".

→ shq. /y/ shpesh (por jo rregullisht) në mjedis fonologjik labializues:

- ie. (du.) */(h$_3$)ok$^{\text{u̯}}$ih$_1$/: pshq. */ak$^{\text{u̯}}$ī́/ > shq. *sy* m. (nj./sh.), khs. gr. ὄσσε (du.) "sy",
- (*pih$_3$-tio̯- :) pshq. (-n-)*pītio̯- > shq. *mbys/t* fol., prejfoljor i *pi* fol.

e) ie. */ū/ (*/uH/): pshq. */ū/ (→ nd. [y])

→ shq. /i/ në pozicion fundor:

- ie. */tuh$_2$/: pshq. */tū/ > shq. *ti* pr. vet. II (n. nj.), khs. lit. *tù* "id.",
- ie. */nuH/: pshq. */nū/ > shq. *ni* ndf. "tani", khs. lit. *nù* "id.".

→ shq. /y/ në fillim ose në trup të fjalës:

- ie. */luH-mo-/: pshq. */lūm-/ > shq. *lym* m., khs. gr. λῦμα "pisllëk; pellg i përbaltur".

4.2.4. Në pozicion ndërmjet një bashkëtingëlloreje dhe një zanoreje laringalet ie. janë bjerrë në shqipe (duke ndryshuar sipas rastit timbrin e një */e/-je zanafillëse), khs.:

- ie. */mh$_2$-ent-/: pshq. */mand-/ > shq. (t.) *mënd* fol., pranë pshq. */mand-i̯-/ > shq. (t.) *mëz*, (g.) *mãz* m.,
- ie. */sth$_2$-ent-(i̯eh$_2$-)/: pshq. */śtandi̯ā/ > shq. (t.) *shtëzë*, (g.) *shtãzë* f.,
- ie. */dh$_2$-ei̯o-/: shq. *daj* fol.,
- ie. */dh$_1$-ei̯o-/: shq. *dej, deh* (< *de-h), (refl.) *déhem* fol.

4.2.5 Gjurmë të rralla të veprimit të dikurshëm të laringaleve */h$_2$/, */h$_3$/ (dhe /H/ < (?) */h$_1$/) vërehen deri diku edhe në bashkëlidhje me një mbylltore paraprijëse.

Frikatizim:

- ie. */roth$_2$-/: shq. (g. dial.) *rrath*, (me metafoni t., g.) *rreth* (e. nj) ~ *rráthë* (e. sh.) m., khs. ind. vj. *rátha-* m. "karrocë", lat. *rota* "rrotë". Vetëm duke pranuar një ndikim të laringalit ndjekës mund të shpjegohet bindshëm frikatizimi i mbylltores dhëmbore ie. */t/ → shq. /θ/.

Një proces të ngjashëm mund të përsiasim edhe për rindërtimin e paraformës së njësisë së trashëguar (t., g.) *djáth(ë)* n., m.: ie. */d^{h}ed^{h}H/ (: */d^{h}e-d^{h}h$_1$/), khs. ind. vj. *dádhi-* "qumësht i thartuar", më tej pr.vj. *dadan* "qumësht".

4.2.6. *Ndërmjet bashkëtingëlloreve*

a) ie. *[H̥] (*[h̥$_1$], *[h̥$_2$], *[h̥$_3$]): pshq. */a/ ose ø

→ shq. /a/ (sipas rastit e metafonizuar në /e/):

- ie. */mh$_1$t-i̯o-/: pshq. */mati̯-/ > shq. *mas/t* fol., lidhet etimologjikisht me lat. *mētior* "id.",
- ie. */sth$_2$t-/: pshq. */śtat-/ > shq. *shtat* m., *mbështes/t* fol. (: *mbë-shtes/t*), khs. russ. *stat ʼ*"id.", lat. *status* "gjendje",

- ie. */lh$_2$-sk̑o-/: (p)shq. */lah-/ > *leh* fol. (sidomos II-III nj.), khs. gr. λάσκω "gërthas",

→ shq. ø:

- ie. */b^{h}orHg̑-o-/: pshq. */b(h)arð-/ > shq. (*i) bárdhë* mb., khs. got. *bairhts* "i kthjellët".

4.3. *Në pozicion fundor*

a) */H/ është bjerrë pas ngjyrimit përkatësisht zgjatimit të zanores paraprijëse:

- formanti mocional (e. nj. f.) -*{eh$_2$}- :) -*{aH }: pshq. -*{ā(h)} > shq. –{ë}, khs. *plak* m. ~ *plak-ë* f.
- shenjuesi i dualit (e.) -*{ -ih$_1$}: *{-īH}: pshq. -*{ī(h)} > -*{ĭ} > shq. ø: ie. */duu̯o-ih$_1$/: (p)shq. */duĭ/ > *dy*, khs. ind. vj. *d(u)vé* n., f. „dy“, let. *divi* m. f. “dy”.

b) Zhvillimi pas bashkëtingëlloreve mbetet i pasqaruar.

V. Facit

Në mbyllje të kësaj paraqitjeje të thukët rreth zhvillimeve të mundshme në shqipe të tingujve laringalë të rindërtuar për fazën e përbashkët të zhvillimit gjuhësor ie., lejohemi të ritheksojmë shkurt, se zbatimi me akribi shkencore i teorisë së laringaleve ie. jo vetëm mundëson, por edhe nxit si kërkesë të kohës ndryshimin e paradigmës për studimet diakronike të shqipes në arealin kulturor-albanologjik shqiptar, duke i hapur kështu një perspektivë të re studimi e mundësuar kësaj gjuhe vendin që i takon e duhet t’i takojë gjithherë në indoeuropianistikën bashkëkohore. Në këtë mënyrë edhe profecia e Çabejt fiton më shumë kuptim.[18]

[18] Pjesa e parë e këtij punimi (§ I – III) paraqet një variant me pak ndryshime prej botimit të parë krejt të palexueshëm të punimit me titull *Për njohjen dhe zbatimin teorisë së laringaleve ie. në studimin diakronik të shqipes*, botuar në përmbledhjen “Eqrem Çabej dhe kultura shqiptare (Konferencë Shkencore Ndërkombëtare me rastin e 95-vjetorit të lindjes së Prof. Eqrem Çabejt)” (Gjirokastër, më 23 maj 2003), Tiranë 2004, f.

Bardhyl DEMIRAJ, LMU München

ON RECOGNITION AND IMPLEMENTATION OF THE THEORY OF LARYNGEAL SOUNDS IN THE DIACHRONIC STUDY OF ALBANIAN

Summary

The perspective overview of the development of the Indo-European science during the second half of the 20th century, including contributions of American scholars who studied Albanian (R. Minshall 1956; E. Hamp 1964, M. Huld 1984, Brian Joseph etc.) proves the efficiency of the use of the theory of laryngeal sounds ie to research the early stages of the evolution of the Proto-Albanian Language as a special branch of Indo-European family. This conclusion is, also, fully supported by the results of our study, where we have been focused exactly on the ways of development and creation of phonological duality /r/ ~ /rr/ in Albanian language, considering in this case the possibility of implementing the theory of laryngeal sounds ie. as the only option that offers satisfactory solution.

129-143. Pjesa e dytë (§ IV) është një paraqitje e përmbledhur e me ndërhyrje e rregullime të rastit në disa studime (etimologjike) të autorit, të botuara në librin "Albanische Etymologien", Leiden – Atlanta 1997, sikurse edhe në Demiraj 2006 dhe 2009.

Bibliografi

Beekes, R. 1969: The Development of the Proto-Indo-European Laryngeals in Greek, The Hague – Paris.

Beekes, R. 1988: *Laryngeal Developments: A Survey*, në: Die Laryngaltheorie und die Rekonstruktion des idg. Laut- und Formensystems, Heidelberg, f. 59-105.

Beekes, R. 1995: Comparative Indo-European Linguistics. An Introduction, Amsterdam – Philadelphia.

Beekes, R. 2009: Etymological Dictionary of Greek, Leiden.

Cuny, A. 1912: *Indo-européen et sémitique*, në: Revue de phonétique 2, f. 101vv.

Çabej, E. 1986: Hyrje në studimin krahasimtar të gjuhëve indoeuropiane, në: Studime Gjuhësore VII, Prishtinë 1986 (= SGJ).

Çabej, E. SE: Studime etimologjike në fushë të shqipes, Bleu I-IV, Tiranë 1976-.

Demira, B. 1989: *Çështje të trajtimit diakronik të numërorit* katër. *„Schwa secundum" në gjuhën shqipe*, në: SF 3, f. 91-100, Tiranë.

Demira, B. 1994: *Bemerkungen zur Entwicklung der anlautenden idg. Laryngale im Albanischen*, në: In honorem Holger Pedersen. Kolloquium der Indogermanischen Gesellschaft vom 26. bis 28. März 1993 in Kopenhagen, Wiesbaden, f. 57-76.

Demiraj, B. 1997: Albanische Etymologien, Amsterdam - Atlanta.

Demiraj, B. 1998: *Zhvillime të laringaleve nistore ie. në gjuhën shqipe. Sekuenca *HRC-*, në: SF3/4, f. 139-149, Tiranë.

Demiraj, B. 2006: *Per la conoscenza e l'applicazione della teoria delle laringali indo-europee nello studio diacronico della lingua albanese*, në: "Studime" 13, f. 73 – 83, Prishtinë.

Demiraj, B. 2009: *Zhvillime të laringaleve indovropiane në gjuhën shqipe*, in: „Studime Filologjike" 3/4, f. 33-52, Tiranë.

Demiraj, Sh. 1996: Fonetikë historike e gjuhës shqipe, Tiranë.

Fortson IV, B.W. 2010: Indo-European Language and Culture, Singapore.

Hamp, E. 1958: *Albanian arë*, në: KZ 75, f. 237-8.

Hamp, E. 1960: *Mythical Prothetic Vowels in Albanian*, në: AION II 2, f. 185-90.

Hamp, E. 1965: *Evidence in Albanian*, në: Evidence for Laryngeals, London – The Hague – Paris (shih Winter, W.).

Hamp, E. 1976: *On *HRC- in Latin*, në: Glotta 54, f. 261-3.

Hamp, E. 1977: *Varia II*, në: Eriu 28, f. 145-6.

Huld, M. 1984: Basic Albanian Etymologies, Los Angeles.

Kortlandt, F. 1984: *Albanian and Armenian*, në: KZ 94, f. 243-51.

Kortlandt, F. 1986: *rmenian and Albanian*, në: La place de l'arménien dans les langues indo-européennes. Academie Royale de Belgique, Classe des Lettres, Bleu III, f. 38-48.

Kuryłowicz, J. 1927: *ə indo-européen et h hittite*, në: Symbolae in honorem J. Rozwadowski, Bl. 1, f. 95-104.

Lindeman, F. 1986: *Eine phonologische Bemerkung zur "Vokalisierung" der Laryngale im Indogermanischen*, në: IF 91, f. 79-82.

Lindeman, F. 1990: *Is there any conlusive evidence for a triple representation of schwa in Armenian*?, në: A.Arm.L 11, f. 25-30.

Matzinger, J. 2006: Der altalbanische Text Mbsuame e Krështerë des Lekë Matranga. Eine Einführung in die albanische Sprachwissenschaft, Dettelbach.

Mayrhofer, M. 1981: *Nach hundert Jahren. F. de Saussures Frühwerk und seine Rezeption durch die heutige Indogermanistik*, në: Sitzungsberichte der Heidelberger Akkademie der Wissenschaften. Bericht 8, Heidelberg.

Mayrhofer, M. 1986: Indogermanische Grammatik, Bleu I-1/2, Heidelberg.

Mayrhofer, M. EWAia = Etymologisches Wörterbuch des Altindoarischen, Bleu I-II, Heidelberg 1986 – 1996.

Meier-Brügger, M. 2000: Indogermanische Sprachwissenschaft, Berlin – New York.

Meillet, A. 1927: *De la prothèse vocalique en grec et en arménien*, në: BSL 27, f. 129-35.

Melchert, H.C. 1994:Anatolian Historical Phonologie, Amsterdam – Atlanta.

Meyer, G. 1891: Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache, Strassburg.

Meyer, G. 1892: Albanesische Studien III. Lautlehre der indogermanischen Bestandteile des Albanesischen, Wien.

Minshall, R. 1956: *Initial voiced laryngeal plus */y/ in Albanian*, në: Language 32, f. 627vv.

Möller, H. 1906: Semitisch und Indogermanisch, Teil I (Konsonanten), Kopenhagen.

Ölberg, H. 1972: *Einige Überlegungen zur Laryngaltheorie an Hand des Albanischen*, KZ 86, f. 121-36.

Pokorny, J. 1959: Indogermanisches Etymologisches Wörterbuch, Bleu I, Bern-München.

Rasmussen, J.E. (bot.) 1994: In honorem Holger Pedersen. Kolloquium der Indogermanischen Gesellschaft vom 26. bis 28. März 1993 in Kopenhagen, Wiesbaden (përmbledhje artikujsh).

Rix, H. 1969: *Anlautender Nasal vor Liquida und Nasalis Sonans im Griechischen*, në: MSS 31, f. 79-111.

Rix, H. 1976: Historische Grammatik des Griechischen, Darmstadt.

Schrijver, P. 1991: The Reflexes of the Proto-Indo-European Laryngeals in Latin, Amsterdam – Atlanta.

Schumacher, S. 2007: Kontinuaten urindogermanischer Wurzelaoriste im Albanischen, Teil I: Wurzelaoriste mit frühuralbanischem Stamm auf Vokal oder auf *s, në: "International Journal of Diachronic Linguistics and Linguistic Reconstruction" 4, f. 207-280.

Schumacher, S. & Matzinger, J. 2013: Die Verben des Altalbanischen Belegwörterbuch, Vorgeschichte und Etymologie. Adaktylos, Anna-Maria, Wiesbaden.

Tichy, E. 2000: Indogermanistisches Grundwissen, Bremen 2000

Topalli, K. 2000: Shndërrime historike në sistemin zanor të gjuhës shqipe, Tiranë.

Topalli, K. 2001: Sonantet e gjuhës shqipe, Tiranë.

Topalli, K. 2008: Fonetika historike e gjuhës shqipe, Tiranë.

de Vaan, M. 2008: Etymological dictionary of Latin and the other Italic languages, Leiden.

Winter, W., E. (bot.) 1965: Evidence for Laryngeals 1965, London – The Hague – Paris.

Giovanni BELLUSCIO, Universiteti i Kalabrisë

DIALEKTOLOGU ME ÇIZMET E BARDHA: ERIC P. HAMP DHE ARBËRESHËT

0. Kur pas botimit të librit të vëllimshëm *Vaccarizzo Albanese Phonology*, i cili është varianti i përditësuar i disertacionit që E. P. Hamp-i mbrojti më 1954 dhe u botua më 1993, pas gati dyzet vjetësh, vendosa të shkoja në Vakaric (Vaccarizzo Albanese) për të mbledhur material në terren për një studim fonetiko-eksperimental. Atje një kolege më drejtoi rastësisht tek një informator, asokohe 66-vjeçar, i cili kishte njohur Hamp-in dhe kishte qenë njëri prej informatorëve që kishte anketuar studiuesi amerikan. Zoti Giuseppe Lamastra, sakristani i kishës bizantine të Vakaricit, përpos përgjigjeve që u dha pyetjeve të mia, më foli edhe për Hamp-in duke rikujtuar, ashtu siç ishte krejt normale për atë kohë, modën amerikane, por edhe diçka që, më shumë se të tjerat, i kishte tërhequr vëmendjen: *çizmet e bardha* që Hamp-i i vishte me një kostum tepër të gjerë në pajtim me modën e Italisë së Jugut. Fatkeqësisht kjo pjesë e bisedës nuk u regjistrua në shirit, por vazhdon të mbetet e gjallë në kujtesën time. Më duket me interes ta filloj këtë ndihmesë me një pjesë tjetër të asaj bisede, e cila tregon jo vetëm punën në terren të studiuesit, por na jep edhe përshtypjet ose reagimet që pati ky informator. Po jap këtu transkriptimin (L. është shkurtimi për z. Lamastra, me G. jap ndërhyrjet e mia):

L.: Il çinguandadhùe. Ai ng' ã' se do t' dini... e... Ai e kish pasjonen (= tekstin poetik). Ai do të dini si jam e t'... si m' pitit... si m' pini ju mua. E allura u vura ndi nj' an', kshtu e i the gjith' pasjonen. Ai kish llivrin, onji tandu runej te llivri, mos u zbalarja ndonj... ndonj asije.

G.: *Jo. Ai runej mos kish zbalartur llivri, jo ju.*

L.: Jo, jo... Ai runij mos ng' a thoja mir u!

G.: *Jo, jo, jo…*
L.: Ah! E va beni.
(…)
G.: *Ma sa mbeti këtu, mbeti shum?*
L.: Ai mbet shuuum. Mbet shum. Erdhi e m' thrriti atje… T' a thash, dhopu ç' u fërrnova… e… allura ish nj' grua se… ç' ã angora e gjall. Ajo i tha: "E be', tha, nani ng' i je faregjã?" – "Ah, tha, je je (= yes, yes). Muri kllau doren e m' dha nj' qind llir.
G.: *Eh, ma nj' qind llir ahina ishin sollde!*
L.: E ç' ish nj' qind llir?! Ish nj' mil llir'!?
G.: *Nel çinguadadue ishin…*
L.: Ish nj' mil llir', pes' mil llir'…
G.: *Nj' paket' sigareta?*
L.: Me! eko, nj' paket sigareta. Ning ish per… per at' asije… Perkè mua m' kllau te barri… di u kush kish vdekur. Erdh ai. Ma dish t' diiiini… Mbjoi diversi foli. Ka: nja, di, tre, kater… nj' zet, kater zet, pes' zet… si thojen ata, si thojim ktu, kish t' ja thoja (…)[1]

Informatori i Hamp-it dhe imi, siç duket, tregohet pak i mërzitur edhe për faktin që emri i tij nuk përmendet në botimin e 1993-shit, por duhet mbajtur parasysh se gjuhëtari gjatë kohës që kaloi në Vakaric në vitet 1950 e 1952 (Hamp 1993: xxi-xxii), mund të ketë intervistuar një numër të madh folësish të së folmes vendase, por edhe folës të fshatrave përreth Vakaricit, ashtu siç tregojnë edhe materialet e incizuara në trevën

[1] **L.:** Ishte viti pesëdhjetedy. Ai jo se do t' dinte… e… Ai e kishte tekstin e pasionës (= tekstin e Varibobës). Ai do të dinte ashtu si jam e të… si më keni pyetur ju… si më pyesni ju mua. E atëherë unë u vura në një kënd, kështu e i thashë të gjithë pasionën. Ai kishte librin, nga pak shikonte librin për të verifikuar nëse unë gaboja… ndonjë gjë. / **G.:** *Jo. Ai kontrollonte nëse kishte gabime libri dhe jo ju.* / **L.:** Jo, jo… Ai kontrollonte nëse unë nuk e thosha mirë! / **G.:** *Jo, jo, jo, jo…* / **L.:** Ah! (= kështu po thoni?) E po mirë… / (…) / **G.:** *Po sa gjatë ndenji këtu, ndenji shumë?* / **L.:** Ai mbeti shuuum. Mbeti shum. Erdhi e më thërriti atje… Ta thashë, sapo unë mbarova… e… atëherë ish nj' grua se… që edhe jeton, dhe ajo i tha: "E po mirë, tha, tani nuk i jep asgjë?" – "Ah, tha ai, je je (= yes, yes). Mori futi dorën e më dha njëqind lireta. / **G.:** *Eh, po njëqind lireta në atë kohë ishin shumë!* / **L.:** E çfarë ishin? njëqind lireta?! Ishin si një mijë lireta të sotme! / **G.:** *Më 1952 ishin…* / **L.:** Ishin si një mijë lireta, pesë mijë llireta… / **G.:** *Sa një paketë cigaresh?* / **L.:** Po! ja, një paketë cigaresh. Nuk ishte për… për atë gjë… Sepse mua më futi te kafeneja… di unë se kush kishte vdekur. Erdhi ai. Po deshi të dinte… Mbushi shumë fletë. Duke filluar nga: një, dy, tre, katër… njëzet, katërzet, pesëzet… si thoshin ata, si thoshim këtu, kisha për t'ia thënë (…)

arbërishtfolëse më 1952 (Belluscio 2010). Në kujtimet e rrëfyesit del që Hamp-i zgjidhte informatorët duke njohur aftësitë e tyre. Në këtë rast ai e interviston z. Lamastra sepse ky dinte përmendsh tekstin e 'pasjonës' së Jezuit të shkruar nga Variboba në vitin 1762, dhe e interviston atje ku e takon, duke e zgjeruar pra anketën edhe në fusha të tjera të gjuhës si te numërorët etj. Nga ana tjetër, na bën të qeshim ajo ndërhyrja e gruas e cila, me sa duket, e provokon studiuesin duke i kujtuar që puna duhet shpërblyer, ndërsa Hamp-i tregohet i gatshëm, merr një shumë liretash dhe ia jep informatorit i cili, pas gati dyzet vjetësh, aty për aty nuk kujtohet, por njëqind lireta në vitin 1952 ishin baras me dy orë pune të një muratori ose me një kilogram e gjysmë makarona[2] industriale, gjellë jo shumë e zakonshme në ekonominë fshatare dhe jo vetëm fshatare të Italisë së Jugut.

1. Por si fillon aventura e prof. Hamp-it në mes të arbëreshëve? Një pjesë e historisë shfaqet në letrën[3] që mentori i tij, prof. Joshua Whatmough (1897-1964), i dërgoi prof. Carlo Tagliavini-t (1903-1982) në mars të vitit 1950. Në atë letër zbulohet që Tagliavini i kishte shkruar tashmë kolegut të tij amerikan një "kind letter" ku i fliste për Hamp-in dhe kjo do të thotë se ai e njihte atë asokohe. Whatmough-i e përshkruan studentin e tij si një "njeri të vlefshëm" ("an extremely able young man") i cili, sapo të jetë në Itali, do ta mësojë italishten pa problem. Për Whatmough-in Tagliavini konsiderohet si "autoriteti më kompetent për shqipen në Itali ("the most competent authority on Albanian in Italy") dhe atij i kërkon që Hamp-i të kalojë sa më shumë kohë në Padovë dhe Bolonjë, të shkojë në Kalabri e Sicili vetëm për kërkimet në terren, për të hetuar mbi ndryshimet midis të folmeve arbëreshe dhe shqipes që flitet në Shqipëri. Lidhur me këtë Whatmough-i ankohet për faktin se do të kishte qenë më mirë që Hamp-i të shkonte në Shqipëri, por kjo gjë s'është e mundur për shkak të "situatës së ngatërruar të botës" ("in the present troubled state

[2] "a hod carrier earns sixty-five cents a day and the cheapest *pasta* costs twelve cents a kilo" (Hamp 1993: xvi). Këtu vlera është në dollarë që më 1952 këmbeheshin 1 me 625 llireta, pra rroga ditore e një punëtori krahu ishte 406 llireta në ditë.

[3] Dua të falënderoj prof. Elton Prifti, i cili merret që prej viteve me arkivin privat të Tagliavini-t ku ruhet kjo letër që ma dërgoi, duke më dhënë mundësinë për ta cituar këtu.

of the world”). Nga ana tjetër, profesori tregohet i kënaqur për faktin që Hamp-i pati fat të takonte në Paris katër informatorë me origjinë gege dhe të punonte me ta. Letra mbaron me katër rreshta ku mësojmë cili ishte projekti fillestar i temës së doktoratës për të cilën do të punonte Hamp-i: “një analizë strukturore e shqipes, me një përshkrim shkencor dhe me metodë moderne, të trajtave më karakteristike të fonologjisë, morfologjisë dhe të sintaksës, duke shtuar edhe referimet e duhura lidhur me zhvillimet historike të gjuhës”:


as they are spoken, in contrast with Albania proper. What he proposes to do is to make a structural analysis of Albanian, with a view to a scientific description, on modern lines, of characteristic features, phonematic, morphomatic and syntactic, with reference where appropriate to historical developments. In this latter he can, I am sure, improve upon the work of Stewart Mann.

Fig. 1. Pjesë nga letra e prof. Whatmough-it dërguar prof. C. Tagliavini-t në Itali më 1950.

Prof. Whatmough nuk mund ta merrte me mend në atë kohë se cili do të ishte ndikimi i Tagliavini-t mbi Hamp-in. Për sa më kujtohet nga bisedat e gjata me prof. Hamp-in gjatë përgatitjes për botim të disertacionit të tij më 1992, duket që vetë Tagliavini i propozoi të shkonte deri në Kalabri për të studiuar në terren diçka që ai e konsideronte me interes të madh: për të vendosur nëse ishte e vërtetë prania e një ngulimi arbërishtfolës të tipit gegë në mes të një numri të madh katundesh me të folme toske. Kjo do të thoshte pikërisht një anketë shkencore në “katundin e Vakaricit”, dhe ky qe ndryshimi rrënjësor i projektit fillestar të 1950-s, si dhe fillimi i marrëdhënieve gati gjashtëdhjetëvjeçare të Hamp-it me arbëreshët.

2. Vaccarizzo Albanese 1950 dhe 1952

Vizitën e parë në Vakaric Hamp-i e bëri në mars-prill të vitit 1950[4]. Nga ato që më tregoi personalisht, mbërriti në një mot me stuhi dhe gjeti strehë në një *locanda* në Shën Mitër Koronë. Gjatë kësaj vizite ai u sëmur rëndë me pneumoni. Shpëtoi falë penicilinës që i dërgoi prof. Tagliavini. Ky ilaç ishte ende shumë i rrallë, ngaqë në Itali sapo kishin filluar ta prodhonin në mënyrë industriale. Kur ishte ende i sëmurë Hamp-i, siç më tre-

[4] Të dhëna më të plota rreth dy anketimeve në terren jepen në Hamp (1993:xxi-xxii).

goi vite më pas, nuk e dinte nëse do të shpëtonte apo jo, prandaj duke kujtuar të ndjerin Jan Hanusz (1858-1887), pati menduar për ndonjë mallkim[5] në drejtim të kërkuesve që i qaseshin studimit të arbërishtes. Për fat të mirë ilaçi bëri efekt dhe pas dy vitesh, në verë të 1952-shit, Hamp-i u rikthye në Vakaric me gruan e tij, zonjën Margot. Kësaj radhe kishte me vete edhe një magnetofon me të cilin incizoi pesëmbëdhjetë orë materiale gojore (shih § 3). Vakarici i fillimit të viteve '50 ishte një fshat me dy mijë banorë[6], i mbyllur, megjithëse rruga automobilistike, pak më e gjerë sesa vetë autobusi që kalonte dy herë në ditë, mbërrinte deri në fshat. Ekonomia ishte ajo e pasluftës, që do të thotë mjaft e varfër, fëmijët e mësonin italishten për të parën herë në shkollë, shumica e grave të moshës 30-35 vjeç ishte analfabete dhe pjesa më e madhe e burrave lexonte me shumë vështirësi. Popullsia jepej sidomos pas bujqësisë, pak ishin zanatçinjtë por edhe më pak profesionistët e mësuesit. Atje Hamp-i u vendos në shtëpinë e vogël të Paolino Mancuso-s dhe të gruas së tij Mariantonia Caravona (Fig. 6). Kjo e fundit, me origjinë nga Shën Sofia, që kujdesej për familjen dhe për mysafirin amerikan, shërbente edhe si model krahasimi, meqë fliste një varietet tjetër të arbërishtes, i cili ndryshonte në shumë pika nga ai i Vakaricit.

2.1. Në bazë të materialeve të mbledhura, të shënimeve të tij dhe duke u mbështetur në një bibliografi albanologjike në atë kohë me të vërtetë të kufizuar[7], Hamp-i shkroi tezën e doktoratës, e cila mund të konsi-

[5] Jean Hanusz, njëzetenëntëvjeçar, vdiq në Paris nga tifoja. Ai kishte qenë më parë në katundin San Marcano të Apulisë. Skica e tij me materialet e mbledhura atje u botua një vit pas vdekjes në Mémoires de la Societé de Linguistique de Paris më 1889 nën kujdesin e L. Leger, i cili shkruan: "Une maladie cruelle a enlevé le dr. Jan Hanusz (...) Il arrivait d'un voyage chez le Slaves meridionaux et les Albanais, et il se proposait d'aller en Bretagne et en Angleterre (...)" (Hanuzs 1889:263).

[6] Kurba e popullsisë arriti në pikën më të lartë më 1921 me 2040 banorë dhe më 1951 me 2005 banorë. Në dhjetëvjeçarin 2001-11 bashkia humbi 10,7% të banorëve dhe më 2014 numri i të regjistruarve ishte 1156, d.m.th. niveli më i ulët që nga krijimi i shtetit unitar të Italisë (1861), prej të cilëve 134 (=11,6%) qytetarë janë të huaj, në pjesën më të madhe shqiptarë.

[7] Bibliografia albanologjike në dispozicion në fillim të viteve '50 mund të konsultohet për pjesën në gjuhën angleze në Hamp (1993:167-71).

derohet si përshkrimi i parë i tipit fonetiko-fonologjik me bazë shkencore strukturaliste të mirëfilltë për një varietet dialektor të shqipes. Kjo qe e mundur për faktin se autori, student në njërin prej universiteteve amerikane më në zë, kishte në dispozicion jo vetëm mjetet, por edhe bazat teorike më të përparuara dhe të përditësuara të gjuhësisë bashkëkohore. Kështu, me zbatimin e një modeli postblumfildian (që do të thotë të lidhur ngushtë me strukturën e sistemit dhe me distribucionin e elementeve, në këtë rast të fonemave të gjuhës) Hamp-i përshkruan në thellësi inventarin e fonemave me alofonët përkatës, kundërvëniet, sistemin zanor, gjysmëzanoret (glides), sistemin bashkëtingëllor, junkturat (që do të thotë pauzat midis fjalëve dhe sintagmave) dhe, për herë të parë, theksin dhe theksimin, intonacionin, gjestualitetin vokalik, që do të thotë sjelljet e veçanta kinezike të trupit (të duarve, krahëve, kokës...) që lidhen me disa shprehje të zërit (josistemore nga pikëpamja gjuhësore). Këtyre përshkrimeve të dorës së parë u shtohen edhe analiza statistikore të shpërndarjes së zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve (megjithëse jo shteruese dhe përfundimtare) si edhe njohuri dhe analiza krahasuese të tipit sinkronik dhe diakronik, duke u mbështetur në shkrimet e De Radës dhe të Varibobës.


VACCARIZZO ALBANESE PHONOLOGY:
THE SOUND-SYSTEM OF A CALABRO-ALBANIAN DIALECT

A thesis presented
by
ERIC PRATT HAMP
to
The Department of Linguistics
in partial fulfillment of the requirements
for the degree of
Doctor of Philosophy
in the subject of
Linguistics

Harvard University
Cambridge, Massachusetts
June 1954

Ballina e origjinalit (1954)

Fig. 2 – Ballina e botimit të disertacionit e vitit 1993

3. Arkivi i zërit.

Krahas analizës gjuhësore/ dialektologjike të së folmes së Vakaricit tani kemi në dispozicion edhe serinë e materialeve të incizuara në verën e vitit 1952, kështu që teksti i shkruar mund të integrohet me to, me zërat e bashkësisë ashtu siç i pati dëgjuar Hamp-i, të përjetësuara në shirit magnetik në arkivin e Universitetit të Chicago-s dhe, kohët e fundit, në formë digjitale[8] falë punës së J. J. Tothit, përgjegjës i arkivit.

Shiritat përmbajnë sidomos biseda, anketa gjuhësore (lista fjalësh, sintagma, përkthime) dhe një numër të vogël këngësh arbëreshe të tipit "vjershe" me dy a me shumë zëra të kënduara në Barill (në provincën e Potencës) dhe në Vakaric.

Në një pjesë të bisedave të lira ndërhyn edhe vetë Hamp-i, i cili, pas dy vitesh kishte tashmë përfituar një kompetencë gjuhësore të mirë të arbërishtes. Si shembull po jap një fragment[9] të një bisede të gjatë, në të cilën për herë të parë dëgjohet edhe zëri i tij (bobina 2b). Biseda zhvillohet në shtëpinë ku ai ishte mysarfir; A dhe B janë Costantino Tocci dhe Filippo Minisci, dy të rinj të vendit (Fig. 4):

	Origjinali	Shqip
A	Ti i njeh llumanxhanet ç' jan'?	Ti i njeh patëllxhanet çfarë janë?
B	I njeh?	I njeh?
Hamp	**Jo.**	**Jo.**
B	Talljan thrriten mellanxane.	Italisht quhen "melanzane".
Hamp	**Ah, sì sì sì sì sì...**	**Ah, po po po po po...**
A	In ingleze thughen eggsplant.	Anglisht quhen eggsplant.
Hamp	**Eggplant.**	**Eggplant.**
A	Plant.	Plant.
Hamp	**Sì.**	**Po.**
A	Kshtu asht', jo?	Kështu është, apo jo?
Hamp	**Kshtu asht'.**	**Kështu është.**

[8] Fondi përmban 14 bobina (= 24 CD) dhe incizimet zgjasin 15 orë dhe shtatë minuta me këtë përmbajtje: 74 biseda të lira, 39 pjesë ose fragmente të recituara, 29 pyetësorë të tipit fonetiko-fonologo- morfologjikë, 12 këngë/vjershe të kënduara vetëm nga meshkuj dhe 27 fragmente të ndryshme që nuk u përkasin këtyre kategorive.

[9] Ky është transkriptimi i parë që nxirret nga incizimet e Hamp-it. Indeksi i përmbajtjes së arkivit të zërit të Hamp-it është botuar në Belluscio (2010).

A	U i pe.	Unë i pashë.
Hamp	**Agha.**	**Po.**
A	E kshtu ti... Si je thon' ksaj lule?	E kështu ti... Si e quajnë këtë lule?
Hamp	**N' arbresh?**	**Në arbërisht?**
A	Arbresh.	Arbërisht.
B	Arbresh.	Arbërisht.
Hamp	**Ah. Lule kapp' eh...**	**Ah. Lule kapp' eh...**
B	Qapri.	Lule kaparine.
Hamp	**Qapri.**	**Kaparine, po.**
A	Qapri.	Kaparine.
Hamp	**Sì.**	**Kaparine, po.**
A	E qaprit ghaghet!...	E kaparina hahet...
Hamp	**Qaprit ghaghet!?... Jan' t' mir', a?**	**E kaparina hahet!? Janë të mira, po?**
A	Ghaghet nxallat. Jan' t' mir' shum'!	Hahet sallatë. Janë të mira shumë!
B	Ghaghen me uthull.	Hahen me uthull.
Hamp	**Me uthull.**	**Me uthull.**
B	Spinxhiren pititën.	Nxit oreksin.
Hamp	**Agha.**	**Po.**
B	Spinxhir pititën.	Nxit oreksin.
Hamp	**Ah, pititja, a?**	**Ah, oreskin, po?**
A	Baghet t' vinj pitit shum'.	Bën të të vijë shumë oreks.
Hamp	**Agha.**	**Po.**

I gjithë materiali është me cilësi të mirë. Tani përmbajtja e plotë njihet falë dëgjimit dhe indeksimit që kam bërë dhe po pret vetëm të studiohet në thellësi. Ai ka vlerë të veçantë për të analizuar në diakroni si u zhvillua në këto gjashtëdhjetë vite e folmja e Vakaricit, por paraqet edhe një fotografi të kulturës së gjallë dhe të mënyrës së jetesës të asaj kohe.

4. Ndihmesa shkencore.

Duke lexuar bibliografinë e Hamp-it vihet re që ajo fillon me një kontribut që u kushtohet ndërrimeve morfofonetike të keltishtes, i botuar më 1951, i cili ndiqet, pas dy vitesh, nga një recension kritik i monografisë së W. Cimochowski-t për të folmen gege të Dushmanit, e botuar në Toruń më 1951. Kjo tregon që prej fillimit se cilët do të ishin interesat kryesorë të studiuesit amerikan veç gjuhësisë krahasuese dhe rindërtimit etimologjik të shumanshëm që do ta zgjeronin fushën e studimeve gjatë karrierës së tij. Recensioni për Cimochowski-n, përpos të tjerave, na ndihmon

të njohim përgatitjen shkencore të recensuesit i cili, nëpërmjet një kritike ndërtuese, mundohet të organizojë sipas metodës strukturalisto-distribucionaliste të dhënat që jepen për të folmen e Dushmanit duke e plotësuar analizën edhe me materiale të dorës së parë që kishte filluar të vilte në terren dhe me informacione të tjera dialektore të nxjerra nga letërsia artistike dhe nga literatura gjuhësore albanologjike. Për ta kuptuar saktësinë dhe thellësinë e analizës hempiane në recensionin në fjalë, po jap këtu dy pjesët në tekst ku bëhet fjalë për të folmen e Vakaricit dhe për të folme të tjera të trevës arbërishtfolëse.

> Although in general /pj bj fj/ occur, occasionally the more archaic /pl bl fl/ are found in their stead. This looks like dialect mixture.
>
> Complexes that correspond to nasal plus (voiced) stop in other dialects (phonemically a unitary prenasalized stop in one Calabrian-Albanian dialect of my acquaintance, Vaccarizzo Albanese, and a unitary distinctive long emphatic nasal in some of the northern Geg dialects) are treated here as follows, as far as I can make out.

Ky fragment i parë (Hamp 1953:506) i referohet problemit të bashkëtingëlloreve të parahundorëzuara ose togjeve hundore+bashkëtingellore, problem për të i rëndësishëm edhe në të folmen e Vakaricit që ishte duke studiuar për t'i gjetur një zgjidhje fonologjike brenda sistemit dhe të cilit do t'i kushtojë një trajtim të gjerë në disertacionin e vet (Hamp 1993: 93-100).

Fragmenti i dytë (Hamp 1953:512) merret me analizën krahasuese të parashtesave derivuese shpjegimi i të cilave nga ana e Cimochowski-t që Hamp-it nuk i dukej i plotë dhe i saktë. Pra, duke konsideruar situatën më komplekse se sa duket, ai propozon një shqyrtim "cross-dialectally" d.m.th. ndërdialektore, duke u mbështetur vetëm në të dhëna të regjistruara nga ai vetë nga folës të lindur. Gjejmë këtu shfaqjen e parë të asaj metode të thelluar dhe gjithëpërfshirëse që në të ardhmen, do të bëhej metoda personale dhe dalluese e punës së gjuhëtarit tonë.

5. Comparative. Many comparative and lexical points, of great interest to students of Albanian, are raised by this book. I shall take up only one here, a point raised in a footnote (108), where derivational prefixes on verb bases are under discussion. Regarding /me-ńfët/ 'encoller', /me-u-ńfët/ 'monter', beside /me-u-ʒ́fët/, Cimochowski remarks that this base has /ʒ́-/ instead of the /gj/ that would be expected from earlier *gl-* (cf. above, §2.4 end and §2.4.2 end), and compares Greek-Albanian *glis* (1 sg.). The situation seems to be more complicated than that; it will be of advantage to inspect cross-dialectally a group of several words. From Italo-Albanian I use only forms that I have collected personally from native speakers.

	'dip, infect'	'resemble'	'stick'	'satiate'
Vaccarizzo	nĝí	ĝít, ĝásen	nĝít-iń	(ngós)
Barile		gl'ít-ən	nĝít-əm	
Piana		glít-en		
Dushmani	ńýe, ʒ́ýe		ńít	ngí
Rossi dict. (N. Geg)	zdžüej		ńit	ng'ī
Borgo Erizzo		ngięt		ngiñ
cited in Meyer, *Et. Wb.*				'Sic.' ngl'iń

On the basis of these we reconstruct the following shapes for the four words in the Albanian of about 1400 (with T for /t/ ~ /s/ and V for vocalic interchange): */n-ĝy-/, */n-glV-T-/, */n-ĝiT-/, */n-gli-n-/. In Early Albanian we find for 'resemble' *gla* (Buzuk) and *ga* (Bogdan).

4.1. Përveç sa u tha më sipër, është me interes fakti që Hamp-i rrëzoi mitin e karakterit gegë[10] të së folmes së Vakaricit ("the myth of Geg character of Vaccarizziote"), arsye për të cilën Tagliavini e kishte drejtuar atje.

Disertacioni, pra, konsiderohet nga vetë autori si hapi i parë në drejtim të një studimi më të gjerë për këtë të folme:

> "Shpresojmë që bërthama e kësaj pune të shndërrohet, me një morfofonologji, një morfologji, tekste, përkthime, bibliografi dhe me leksikon me karakter përshkrues dhe etimologjik, në një përshkrim të plotë të kësaj të folmeje arbëreshe" (Hamp 1993:ii, §1)

por ky projekt nuk pati mundësi të realizohej. Ndërkohë metoda e analizës po vjetërohej dhe tejkalohej nga zhvillimet e shpejta të gjuhësisë ba-

[10] Në paragrafin e fonetikës (Hamp 1993:2) shkruan: "shqiptimi i *ë*-së si [æ] bëri që rrethi i studiuesve të gjuhës shqipe të bindej për origjinën gege të së folmes të Vakaricit", origjina e "mitit" të origjinës gege të kësaj të folmeje e ka zanafillën në gramatikën e Jeronim de Radës (1894:10, n. 5) ku lexojmë: "përveç *a*-së që zëvendëson *ē*-në, e cila është karakteristike e të folmes së Shkodrës dhe te ne e kolonisë së Vakaricit[10]"

shkëkohore, çka bënte që autori ta konsiderojë atë gjithnjë e më shumë me pak interes për studiuesit e gjuhësisë[11]. Megjithatë Hamp-i, shkruan në *Hyrjen*, nuk e lë pas dore tekstin të cilin e shfrytëzoi për punën e tij kërkimore dhe për mësimdhënien:

> "Shpeshherë, që prej atij viti (=1954), iu ktheva këtij studimi dhe njohjes sime të së folmes së Vakaricit dhe të arbërishtes në përgjithësi (që vazhdova ta ankëtoj në pothuajse të gjitha varietetet e saj) për botimet e mia dhe për ligjërata e kumtime me temë shqipen.

Pas një viti, kontributi i Hamp-it, vlerësohet nga një profesor i Universitetit të Toronto-s dhe e folmja e Vakaricit, lidhur me aspektin e hundorësisë[12] paraqitet në një botim universitar, një manual me ushtrime për studentët.


13.D ALBANIAN (Vaccarizzo dialect) (Italy)

1 bĩɣ'uũmi	we grind	21 ñg'ãteg	I stretch out
2 čũmb'ãĩ	molar	22 ñĩmb'eẽa	a niece

Fig. 3 – Shembull me të dhënat nga e folmja e Vakaricit në botimin e Gleason-it (1955)

Që prej vitit 1955 Hamp-i vazhdoi pa ndërprerje studimin e gjuhës shqipe dhe të varieteteve të saj dialektore duke e shoqëruar vazhdimisht me kërkime të gjera në terren (shih § 5). Kjo u bë elementi që do ta dallonte nga indeuropianistët e tjerë, të cilët i mbështesin studimet e tyre sidomos në materiale të botuara. Këtu duhet të mbahet parasysh edhe fakti që në një numër të madh botimesh, edhe kur trajton tematika joalbanologjike, Hamp-i jep shpesh të dhëna që vijnë nga kërkimet e tij në fushë të shqipes.

4.2. Botimet e mirëfillta për arbërishten (lista pret të plotësohet me disa pak botime të tjera që dolën pas 1997-s) janë të disallojshme. Një

[11] "I became convinced that the field of linguistics was no longer interested in a work couched in a so-called structural post-Bloomfieldian model such as that presented here" (Hamp 1993:*Foreword*).

[12] "Me të vërtetë, analiza ime e statusit të hundoreve dhe të mbylltoreve në të folmen e Vakaricit, u konsiderua me interes dhe u përdor në nje radhua ushtrimesh për studentët në fushën e analizës gjuhësore i botuar nga H. A. Gleason më 1955".

pjesë janë dialektologjike (si ai për emrat e peshqve dhe numërorët në të folmën e Shën Kollit, ai për foljen *hedh* dhe spirantet në të folmën e Fallkunarës, ai për ruajtjen e numërorëve në përgjithësi, përpos studimit të së folmes së Vakaricit), një pjesë tjetër janë kulturologjike (si p.sh. kontributi për *kezën*, ai për vlerën kulturore të shkrimit) por ka edhe disa që janë përgjthësues siç është studimi madhështor për numërorët e gjuhës shqipe ku jepet edhe paraqitja e situatës në një numër të madh të folmesh arbëreshe. Studimi për toponomastikën paraqitet si një model (i pari të këtij tipi në fushën e albanologjisë) për trajtimin shkencor dhe historik të toponimeve të bashkësive arbëreshe në Kalabri, duke u mbështetur në një larmi të madhe materialesh.

Për ta vërtetuar këtë pohim mjafton të marrim si shembull artikullin me titull "Mbi anësoret historike të sebrokroatishtes" (*On Serbo-Croatian Historic Laterals*, Hamp 2001), i cili përbëhet prej shtatë faqesh dhe katër e gjysmë i kushtohen analizës historiko-dialektore të anësoreve të shqipes me referime të shumëllojshme të të folmeve arbëreshe dhe arvanitase. Përveç të dhënave dialektore, pothuajse të gjitha të mbledhura personalisht prej autorit në terren, Hamp-i jep edhe një shqyrtim diakronik të kërkimeve të tij në arealin arbëresh (dhe arvanitas) për studimin e bashkëtingëlloreve anësore (por jo vetëm për to): 1992 Greci; 1993-1998 Catanzaro Area; 1995 Contessa Entellina (but interview in New Orleans); 1997-2000 Barile; 2000-2001 Casalvecchio, por kjo listë, me të vërtetë, nuk tregon të gjitha vendet ku studiuesi ynë kishte bërë hulumtime, edhe pse, brenda të njëjtit artikull (faqet 245-7) ai jep të dhëna edhe për disa të folme të tjera si: Piana degli Albanesi, San Nicola dell'Alto, Plàtaci, Falconara Albanese, Santa Caterina Albanese, Villa Badessa, Portocannone, Carfizzi, San Marzano di S. Giuseppe, Lungro, Acquaformosa, Civita, San Costantino Albanese, Ururi, Chieuti, Campomarino[13]. Kjo na tregon që, përveç ndihme-

[13] Një listë të plotë me anketat e Hamp-it në terren e jep J. J. Toth në "Publications on Arbëresh Sites" (i përditësuar deri më 2003) në shtyllën e tabelës "Dialects notated in person by Eric P. Hamp": Acquaformosa, Andali, Barile, Caraffa di Catanzaro, Casalvecchio di Puglia, Contessa Entellina, Falconara Albanese, Greci, Marcedusa, Piana degli Albanesi, Plàtaci, Portocannone, San Costantino Albanese, San Giorgio Albanese,

save të cilat paraqesin trajtimin e dukurive dhe të çështjeve me tematikë të mirëfilltë arbëreshe, ka edhe materiale të tjera që janë shpërndarë jo vetëm në studime që lidhen me gjuhën shqipe dhe gjuhësinë shqiptare (gjë që është e lehtë për t'u kuptuar) por edhe në artikuj që trajtojnë dukuri ose argumente që s'kanë lidhje të drejtëpërdrejtë me arbërishten ose me shqipen. Për këtë arsye është e vështirë të kemi një tablo të qartë të situatës[14].

Duke e këqyrur bibliografinë hempiane (1951-2000) vërejmë se janë vetëm 13 kontributet e mirëfillta që i kushtohen arbërishtes, të renditura këtu sipas vitit të botimit (në kllapa katrore shënohet numri i radhës në bibliografi):

1966_A Note on the Fishes of San Nicola Dell'Alto, *Bollettino dell'Atlante Linguistico Mediterraneo* 8: 61:4. [163]

1974_On Bonaparte and the Neogrammarians as Field Workers. *Studies in the History of Linguistics: Traditions and Paradigms*, Dell Hymes, ed., Bloomington Ind.: Indiana University Press [with S. Marzano's materials].

1989_Falconara Albanese *yej* and *hjeð*, *Zjarri* 20: 148-50 [1083].

1990_Keza ed altri arcaismi, në *Le minoranze etniche e linguistiche* (Atti del 2. Congresso Internazionale), Piana degli Albanesi 7-11 sett. 1988, I: 225-28.

1990_San Nicola dell'Alto Numerals, *Zjarri* 34, 13-5 [1103].

1991_On Phonological and Morphophonemic Archaisms in Arbëresh, *Atti del Congresso Internazionale di Studi sulla Lingua, la Storia e la Cultura degli Albanesi d'Italia* (Mannheim 25-26 giugno 1987), eds. F. Altimari, G. Birken-Silverman, M. Camaj, R. Rohr, Rende, Università della Calabria, 143-6 [1100].

1992_Albanian, *Indo-European Numerals,* ed. Jadranka Gvozdanović,

San Martino di Finita, San Marzano di San Giuseppe, San Nicola dell'Alto, Santa Caterina Albanese, Vaccarizzo Albanese, Vena di Maida, Villa Badessa, Zangarona (me shënimin e botimeve përkatëse ku janë përdorur të dhënat).

[14] Një farë ndihme për të "lundruar" me siguri brenda detit të gjerë të bibliografisë hempiane, e cila përbëhet prej më shumë se dy mijë titujsh të botuar deri në vitin 2000, e jep vetë Hamp-i me shënimet e kryqëzuara në po atë bibliografi (jozyrtare) që mund të konsultohet si material shtesë në CD-në e *Festschriftit* të vitit 2010 (Belluscio, Mendicino 2010), por edhe atje jo të gjitha detajet e secilit artikull zbërthehen plotësisht.

Berlin: Moutonde Gruyter, 835-922.

1992_The Posterior Spirants of Falconara Albanese, *Beiträge zur sprachlichen literarischen und kulturellen Vielfalt in den Philologien: Festschrift für Rupprecht Rohr zum 70. _Geburtstag*, Stuttgart, Franz Steine Verlag, 156-7 [1109].

1993_*Il sistema fonologico della parlata di Vaccarizzo Albanese,* Rende, Centro Editoriale e Librario dell'Università della Calabria

1993_On the Cultural Values of Script, *Quaderni del Dipartimento di Linguistica* 7 (Serie Albanistica I: Studi in onore di Francesco Solano), Rende: Università della Calabria, 121-3 [1137, mbi Katekizmin e Shën Vasilit, 1834]

1994_Lateral Spirants by Inheritance and Contact, *Quaderni del Dipartimento di Linguistica* (Festschrift J.Trumper), Università della Calabria, Serie Linguistica 5: 9-11 [1196].

1996_An identificatory listing of the Arbëresh settlements of Calabria today, *Quaderni del Dipartimento di Linguistica*, Università della Calabria, Serie Linguistica 6: 245-51 [1218], i ribotuar në formë të zgjeruar në Trumper J., A. Mendicino (a cura), M. Maddalon, *Toponomastica calabrese* (Atti del I Congresso Internazionale di Toponomastica Calabrese, Rende, Acri, San Sosti, Castrovillari, 26-29 maggio 1997), Gangemi Editore, Roma.

1997_On the Survival of Arbëresh Numeral Forms, *Quaderni del Dipartimento di Linguistica*, Università della Calabria, 14: 199-205 [1215].

Këto studime nuk tregojnë vetëm shumëllojshmërinë e interesave të Hamp-it për arbërishten dhe për kulturën e arbëreshëve, por edhe vitet e vizitave të tij në Arbëri, vizita që u bënë gjithnjë e më të shpeshta pas vitit 1989 edhe falë marrëdhënieve me Katedrën e gjuhës shqipe të Universitetit të Kalabrisë (shih § 5)

Mendoj që nuk ka nevojë këtu për një përshkrim të përmbajtjes së botimeve të mësipërme, mjafton të përmendet që një pjesë kanë përmbajtje dialektologjike të mirëfilltë, si emërtimet e peshqve dhe numërorët e të folmes së Shën Kollit, si folja *hedh* dhe spirantet në të folmen e Fallkunarës ose si mbijetesa e numërorëve në arbërishte dhe arkaizmat fonologjikë e morfofonemikë; artikuj të tjerë janë të tipit edhe gjuhësor edhe kulturor, si ata për *kezën* dhe për vlerën kulturore të shkrimit; ka pra edhe kontribute ku arbërishtja zë një vend të gjerë si ai për numërorët e shqipes, i botuar në një vëllim themelor me përmasa europiane. Në fund,

një fjalë e veçantë duhet thënë për studimin origjinal të toponimëve të fshatrave arbëreshe të Kalabrisë, i cili përfaqëson, sipas meje, një model ku gërshetohen të dhëna historike, të nxjerra nga një larmi dokumentesh, me analizën gjuhësore të mirëfilltë nëpërmjet së cilës jepen edhe shpjegime dhe rindërtime të toponimeve.

5. Kërkimet në terren (1950-2009) dhe marrëdhëniet me Universitetin e Kalabrisë

Makina e kuqe model FIAT, që vetë Hamp-i e quante "gomari" dhe ne "bibliomobile" për një kohë të gjatë qe ndërlidhësja midis trevës shqipfolëse ballkanike (Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Greqia) dhe arkipelagut arbëresh në Italinë e Jugut. Me atë makinë të mbushur me libra, rroba dhe sende të ndryshme, Hamp-i dhe zonja Margot bëheshin në një farë mënyre ambasadorë, lajmëtarë, informues ose (ashtu siç parapëlqehet sot) operatorë të bashkëndarjes së arritjeve të reja, të botimeve, të informacioneve, të aktiviteteve kulturore dhe universitare.

Për albanologun e famshëm, të cilit i ishte ndaluar hyrja në Shqipëri, siç kishte përshkruar që më 1954

> "është një tragjedi që mbi Shqipërinë (*e shkreta lule*!) shtrihet një hije që na mban larg nga një njohuri e afërt të dialektologjise dhe, gjë shumë më e rëndësishme, që mban popullsinë në kushte jetese të urryera"

vizitat e shumta në vendet e tjera shqipfolëse, atje ku ai ka edhe sot miq të ngushtë, jo vetëm që ishin pjesë e punës së vet, por ishin ndoshta edhe një mënyrë për ta hequr mallin e së "shkretës lule". Gjatë udhëtimit për në Kalabri Hamp-i kishte ndalesa të fiksuara për të pushuar, për t'u takuar me informatorë që gjatë kohës shndërroheshin në miq, për të vazhduar punën kërkimore: Villabadessa, Kazallveqi ose Qeuti, Barilli ose Shën Marcani dhe në fund Kozenca.

Vështirë të jepet numri i vizitave tek arbëreshët. Për disa kemi dëshmi fotografike, si p.sh. për atë të vitit 1974 në Karfici (Fig. 5) ku pati edhe rast të takohej me Giuseppe Gangale-n (1908-1978), ose për një

pjesë të vizitave pas 1989-s, kur filloi marrëdhënia njëzetvjeçare me Universitetin e Kalabrisë, me rastin e hapjes së doktoraturës së parë në albanologji, çka e deshi dhe e themeloi prof. F. Altimari, i cili bëri të mundur edhe botimin e disertacionit[15].

Lista e dhënë nga vetë Hamp-i më 2001 duhet të plotësohet me anketime të tjera: më 1989 Villa Badhesë (Villa Badessa, një intervistë e bërë në Peskarë një gruaje që fliste arbërishten e fshatit), më 1992 në Firmozë, që prej vitit 1997 në Xingarona, Dandalli, Marçedhuza (Fig. 7), Gharrafa, Vina (*shih videon 2*), duke ndjekur nga afër gjurmët e Gangale-s në kërkim të shfaqjeve gjuhësore të fundit të të folmeve "defungenti" siç i kishte quajtur Gangale, d.m.th. të të folmeve në prag të zhdukjes.

Me kalmin e moshës, në vitet e fundit 2007-2009, kur ardhja në Kalabri nuk ishte më e mundur me makinën e re (që ndërkohë kishte zëvendësuar "bibliomobilen" e cila në një verë tepër të nxehtë të fillimviteve 2000 ishte përflakur për vetëkombustim) Katedra e shqipes ftoi informatorë të ndryshëm në universitet, me qëllim që profesori të vazhdonte anketat e tij gjuhësore (Fig. 9 dhe 10).

6. Vakarici 2009

Pas dhënies së titullit "Qytetar nderi" më 1992 (*shih videon 1*) Bashkia e Vakaricit, me rastin e vizitës së fundit të profesorit në Kalabri, e nderoi me një takim zyrtar për të kremtuar bashkëqytetarin që me punën e tij shkencore e bëri të njohur "katundin" në botime, konferenca e tubime gjuhësore (Fig. 11-13). Me atë rast Hamp-i u takua me miq, me ish-informatorë dhe me njërin prej fëmijëve të familjes që e pati si mysafir para gati gjashtëdhjetë vjetësh. Kjo qe vizita e fundit dhe dita e lamtumirës së gjuhëtarit amerikan për arbëreshët e Vakaricit dhe të të gjithë

[15] Ne semestrin veror të vitit 1991 Hamp-i mbajti edhe një kurs për historinë e gjuhës shqipe për studentët e doktoraturës, ndërsa në vitet e mëpasme mbajti seminare dhe ndoqi si oponent disa tema diplome. Në vitin 2000 Universiteti i Kalabrisë e nderoi edhe me titullin "honoris causa" për kontributin e rëndësishëm dhe të vazhdueshëm për studimin dhe përhapjen e njohjes së të folmeve dhe të kulturës arbëreshe (Fig. 8)

Arbërisë, të cilën e vizitoi aq shpesh dhe e njohu me pëllëmbë.

6.1. Një libër s'do të mjaftonte për të dhënë hollësirat e karrierës gjashtëdhjetëvjeçare të Hamp-it si dhe kontaktet e tji të shumta me arbëreshët, me trajtimin në thellësi të rezultateve shkencore të arritura prej tij. Dua ta përmbyll këtë ndihmesë duke vënë në dukje disa prej mësimeve që kemi përfituar nga bashkëpunimi me profesorin. Së pari, përkushtimi tërësor dhe i vazhdueshëm ndaj shkencës, vlerësimi i marrëdhënieve me informatorët dhe bashkëpunëtorët, gatishmëria për të diskutuar e për t'u ballafaquar me kolegët dhe me studentët; së dyti, trajtimi i çështjeve gjuhësore me rigorozitetin e shkencave të sakta, shumëllojshmëria e të dhënave të marra parasysh dhe kryqëzimi i tyre edhe kur problemi paraqitet jo shumë i vështirë; së treti rëndësia dhe vlerësimi i të gjitha gjurmëve/provave, edhe i atyre më të voglave, të lidhura këto me njohuri të thella teorike dhe me kërkimin, vjeljen e regjistrimin e saktë të materialeve gjuhësore.

Mendoj që problemi kryesor për ta njohur plotësisht ndihmesën e këtij gjiganti të albanologjisë është së pari mbledhja e botimeve albanologjike që janë shpërndarë në të katër anët e botës dhe shpesh në revista/libra shumë të rrallë dhe pak të njohur, së dyti ribotimi i tyre në vëllime antologjike, ashtu siç ka filluar të bëjë Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës me botimin *Studime krahasuese për shqipen* (Prishtinë 2007, Botime të veçanta LXXXIII, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Libri 37) nën kujdesin e prof. Rexhep Ismajlit, të cilin e konsideroj si një shembull të mirë që duhet marrë si model dhe duhet ndjekur në të ardhmen.

7. Ikonografia

(përveç fotografive n. 4 e dërguar nga z. J. Toth i Universitetit të Chicagos, n. 6 e marrë nga www.mondoarberesco.it dhe n. 8 e marrë nga *www.unical.it*, të gjitha fotografitë janë të autorit të këtij kontributi)

Fig. 4 - Etiketa origjinale e bobinës 2a/2b ku lexohet:
"Gigli – conversation / building a house. / impromtu callers – servants / Costantino Tocci e Filippo Minisci / e Paolo / discorso generale"

Fig. 5 - 1974 - Karfic (Carfizzi, Kalabri)

Fig. 6 – Vakaric (fund i viteve '90) Mariantonia Caravona *me E. P. Hamp*

Fig. 7 – 1997 Marçidhuzë, me folësin *e fundit*

Fig. 8 – 2000 Universiteti i Kalabrisë – Rektori dorëzon diplomën Honoris Causa

Fig. 9 - 2009 Universiteti i Kalabrisë me dy informatorë nga Vina (Vena di Maida, Kalabri)

Fig. 10 - 2009 Universiteti i Kalabrisë, me një informator nga Shën Murtiri (S. Martino di Finita, Kalabri)

Fig. 11 - 2009 Bashkia e Vakaricit feston dhe përshendet Qytetarin nderi

Fig. 12 – 2009 Vakaric, me Francuccio, të birin e Mariantonia-s

Fig. 13 – 2009 Vakaric, pritja dhe festimet për bashkëqytetarin nderi

Fig. 14 - 2009 Aeroporti i Lamezia Terme-s: nisja e fundit prej Arbërie

Fig. 15 – Vakaric 1997, Margot dhe Eric Hamp

Giovanni BELLUSCIO, University of Calabria

THE DIALECTOLOGIST WITH WHITE BOOTS: ERIC P. HAMP AND THE ARBËRESH POPULATION

Summary

It was the month of March 1950 when Professor Joshua Whatmough (1897-1964) from the University of Harvard sent a letter to Professor Carlo Tagliavini (1903-1982) from the University of Bologna to recommend him a doctorate student who showed his interest in studying the Albanian language and its dialects. It is exactly that letter and Tagliavini that mark the beginning of the Eric Pratt Hamp's (1920) relations with the Arbëresh population. Following that letter, Tagliavini met Hamp in Bologna and proposed him to go to verify something amazing on the ground, the fact that in Calabria or more concretely in the Province of Cosenca, amongst a big number of the dialects with Tosk typology, there was also a dialect which it was considered to have Gheg features, the dialect of Vaccarizzo (Vaccarizzo Albanese). The survey that lasted for about two years and the presentation of the doctorate dissertation in 1954 mark the beginning of researches, studies, editions and Hamp's relations with the Arbëresh population. It's my wish to depict these relations that lasted for sixty years and that's the content of this paper.

8. Video

1. 1992_Eric P. Hamp, qytetar nderi i Vakarici (Vaccarizzo Albanese, Kalabri)
www.youtube.com/watch?v=xSdSGvNaInc
2. 2009_Eric P. Hamp, vizitë dhe anketë në fshtatin e Vinën (Vena di Maida, Kalabri)
www.youtube.com/watch?v=PnXpnMLsoSw

9. Bibliografi

Belluscio G. (2008), De Rada dialettologo: spigolature dialettologiche in alcune sue pubblicazioni, në F. Altimari (a cura), *Atti del Convegno "I Centenario della morte di Girolamo De Rada"*, Rende, Macchia A., S. Demetrio Corone, 4 ottobre 2003), Rende: Centro Editoriale e Librario dell'Università della Calabria, 57-75.

Belluscio G. (2010), L'Archivio sonoro E. P. Hamp (1952): consistenza e edizione, në Belluscio G., A. Mendicino (a cura), *Scritti in onore di Eric Pratt Hamp in occasione del suo 90. compleanno*, Rende: Centro Editoriale e Librario dell'Università della Calabria (me një CD të bashkëngjitur).

De Rada G. (1894), *Caratteri e grammatica della lingua albanese*, Corigliano Calabro: Stabilimento tipo-litografico del Popolano.

Gleason H. A. (1955), *Workbook in Descriptive Linguistics*, NewYork: Henry Holt & Co.

Hamp E. P. (1953), Review of Cimochowski "Le dialecte de Dushmani" (1951), *Language* 29, 500-12.

Hamp E. P. (1993), *Il sistema fonologico della parlata di Vaccarizzo Albanese*, Rende: Centro Editoriale Librario dell'Università della Calabria.

Hamp E. P. (2001), On Serbo-Croatian Historic Laterals. In Friedman V. A, D. L. Dyer (eds.), *Of All the Slavs My Favourites, in Honour of Howard I. Aronson, on the Occasion of his 66th Birthday*, *Indiana Slavic Studies*, Vol. 12, Bloomington: Indiana University.

Hanusz J. (1889), L'Albanais en Apulie, në *Mémoires de la Societé de Linguistique de Paris,* Tome VI, Paris: F. Vieweg Librarie-Editeur, 263-67.

Albert RISKA, Universiteti “A. Xhuvani”, Elbasan

PËRKIMET LEKSIKORE RUMUNO-SHQIPTARE NË KËNDVËSHTRIMIN E ERIC P. HAMP

Hyrje

Është tashmë një fakt shumë i njohur që tiparet e përbashkëta gjuhësore midis shqipes dhe rumanishtes (edhe duke lënë mënjanë tiparet gjuhësore ballkanike) janë gjykuar si të një rëndësie të veçantë për historinë e këtyre dy gjuhëve, sidomos për shqipen, nga këndvështrimi ynë, duke qenë se mund të shërbejnë si bazë për njohjen e fazave të hershme të zhvillimit të saj.

Në këtë kuadër Eric Hamp shtronte një kërkesë me interes të veçantë metodik: “Besoj se detyra jonë e ardhme është të inspektohet ky korpus materialesh nga shumë afër në dritën e përparimit të bërë për të kuptuarit e historisë së gjuhës shqipe”[1]; ndërsa Stefan Schumacher, gjithashtu duke gjykuar këtë korpus, shtron pyetjen “nëse parashkalla antike e shqipes ka lënë apo jo gjurmë që mund të vërtetohen” dhe aty për aty jep përgjigjen: “përgjigjja për këtë pyetje është një “po” e qartë. Ky stad i mëparshëm i shqipes nuk mund të dëshmohet drejtpërdrejt, por duket shumë qartë prej vulës e gjurmëve që ka lënë në gjuhët romane të Ballkanit.”[2]

Nga ana tjetër, është për t’u theksuar se, përveç që paraqesin inte-

---

[1] E. P. Hamp, *Trakishtja, dakishtja dhe korrespondencat shqipe-rumune*, Studime krahasuese për shqipen, ASHAK, Prishtinë, 2007, f. 173.

[2] Stefan Schumacher, *Marrëdhëniet e huazimeve mes protoshqipes dhe latinishtes apo rumanishtes ballkanike*, Historia e shqiptarëve, Botimet Përpjekja, Tiranë, 2012, f. 41.

res shkencor, përkimet gjuhësore rumuno-shqiptare kanë implikuar dhe vazhdojnë të implikojnë edhe çështje nga më të rëndësishmet për historinë e popujve që i përdorin këto gjuhë, si origjina apo vendi e koha e formimit të tyre.

Për të mos u zgjatur me historinë e qëndrimeve të ndryshme, duhet të themi se përgjithësisht është menduar se këto përkime gjuhësore janë shpjeguar ose si një trashëgimí e përbashkët për të dyja gjuhët, çka nënkupton një origjinë të përbashkët, ose janë shpjeguar si rezultat i shkëmbimeve në kushtet e marrëdhënieve ndërgjuhësore, çka do të nënkuptonte që, në një territor e në një kohë të caktuar, këta dy popuj janë takuar apo kanë bashkëjetuar.

Kufizimi i problemit në përkimet leksikore

Duam të shënojmë për interesin tonë se në korpusin e përkimeve gjuhësore rumuno-shqiptare bëjnë pjesë, veç të tjerash, një tufë fjalësh (më saktë çifte fjalësh) shumë të afërta si në përbërjen fonematike, ashtu edhe në semantikën e tyre, që njihen në gjuhësinë tonë si "përkimet leksikore rumuno-shqiptare"[3] apo "bashkëpërkimet leksikore midis shqipes dhe rumanishtes"[4], por që, më herët, kanë qenë njohur edhe me ndonjë emërtim tjetër[5]; ndërsa "nga aspekti rumun i vështrimit këto janë ele-

[3] Këtë parapëlqen E. Çabej në *Disa mendime mbi marrëdhëniet gjuhësore rumune-shqiptare*, ligjëratë e mbajtur më 08. 10. 1964 në akademinë rumune, botuar në gjermanisht në Revue roumaine de linguistique, nr. 1-3, 1965, f. 101-115; botuar më pas në shqip në SF, nr. 1, 1975, f. 48-62 dhe përfshirë në Studime gjuhësore IV, Rilindja, Prishtinë, 1977, f. 141-152.

[4] I parapëlqyer nga Sh. Demiraj në "Gjuha shqipe dhe historia e saj", Onufri, Tiranë, 2013, f. 143.

[5] Më parë, në Hyrje në historinë e gjuhës shqipe II, Tiranë, 1976 (rishtypje e dispensës me të njëjtin titull botuar në vitin 1960), f. 170-179, Çabej ka përdorur edhe emërtime të tjera, si "konkordancat jolatine", "analogjitë rumune-shqiptare", si edhe "fjalët e përbashkëta rumune-shqiptare". Në ligjërata të ndryshme për këto çështje janë përdorur edhe emërtimet "fjalët e fondit të përbashkët rumuno-shqiptar" apo "korrespodencat leksikore rumune-shqiptare". Nuk ka të dyshuar se kjo larushí emërtimesh është përcaktuar nga fakti i thjeshtë se për shumë kohë nuk kemi pasur një qëndrim të përcak-

mentet që quhen autoktone”[6].

Duke ndjekur literaturën gjuhësore mund të shohim se problemi që ka shqetësuar më shumë dijetarët në këtë lëmë ka qenë ai i burimit të përkimeve gjuhësore dhe, në mënyrë të veçantë, problemi i burimit të fjalëve të përbashkëta midis shqipes dhe rumanishtes. Normalisht kjo është një çështje mjaft e rrahur, jo vetëm për albanistët e romanistët, por ka zgjuar interes edhe më gjerë. Çabej shkruante se “kjo afëri gjuhësore përbën një nga problemet më tërheqëse e njëkohësisht më të vështira të ballkanistikës.”[7] Dhe nuk është gjë e rastit që për këto çështje janë interesuar deri edhe për indoeuropianistët dhe, siç do të ishte e natyrshme, një fakt i tillë është përcaktuar nga rëndësia shkencore e problemit.

Pavarësisht rreshtimit të dijetarëve në kampe, vihet re se është parapëlqyer përgjithësisht mendimi që përkimet leksikore rumuno-shqiptare duhen shpjeguar si rezultat i shkëmbimeve ndërgjuhësore, çka nënkupton marrëdhënie të drejtpërdrejta midis dy gjuhëve. Është besuar, gjithashtu, se burimi i këtyre fjalëve do kërkuar përgjithësisht te shqipja, pra, në një ndikim të mundshëm të shqipes mbi rumanishten.

Kriteri që përcakton këtë qëndrim ka të bëjë me marrëdhëniet që këto fjalë shfaqin brenda njërës ose tjetrës gjuhë dhe mbështetej në analizën fjalëformuese apo etimologjike të fjalëve. “Është për të shpresuar që kërkimet e ardhme ta shpien dijen një hap përpara në këtë fushë, kur të kryhen me frymë objektive e duke shfrytëzuar për historinë gjuhësore edhe të dhënat e etimologjisë”, shkruante Çabej[8].

Perceptimi i traditës në vështrimin e Çabejt

Duke iu referuar disa studiuesve, si Jokl, Densiusianu, Weigand, Puş-

tuar mirë lidhur me statusin e këtyre fjalëve.

[6] E. P. Hamp, *Trakishtja, dakishtja dhe korrespondencat shqipe-rumune*, Studime krahasuese për shqipen, ASHAK, Prishtinë, 2007, f. 173.

[7] E. Çabej, Hyrje në historinë e gjuhës shqipe II, Tiranë, 1976 (rishtypje e dispensës me të njëjtin titull botuar në vitin 1960), f. 179.

[8] E. Çabej, Hyrje ..., f. 179.

cariu, Capidan, Rossetti etj., Çabej besonte se "shumë nga fjalët e përbashkëta të rumanishtes e të shqipes gjejnë një të tillë spiegim brenda kësaj gjuhe të fundit, që u vë atyre vulën e karakterit shqiptar". Ai përmend aty fjalë si *avull*, *flutur*, *gëlbazë*, *hamës*, *moshë* etj. të cilat na paraqiten brenda shqipes me lidhje etimologjike a fjalëformuese, respektivisht me fjalët *valë*, *fletë*, *kalb*, *ha*, *mot*.[9]

Përveç këtyre, Çabej dallon edhe një grup të dytë fjalësh nga fondi i përbashkët rumuno-shqiptar për të cilat "nuk mund të bëhet një vërtetim i tillë, veçse shumica e tyre prapëseprapë gjejnë spiegimin e tyre brenda sistemit fonetik indoeuropian të shqipes", si *baltë*, *bardhë*, *gropë*, *kurth*, *sorrë*, *shark*(*ë*), *shkrumb* e të tjera si këto.[10]

Këtë çështje Çabej e prek edhe në një rast tjetër, pak vite më vonë, dhe për këtë grup të dytë të fjalëve shkruan se "kanë një etimologji mbi bazë indoeuropiane, dhe, aty, në pajtim me fonetikën historike të gjuhës" (nënkuptohet që është fjala për gjuhën shqipe). Në këtë grup Çabej shton edhe disa njësi të tjera, si *balgë*/*bajgë*, *bashkë*, *shalë* dhe *kulpër*/*kurpër*. Për fjalën *kulpër*/*kurpër* shton se "sipas hullisë së N. Jokl, do të çohet te rrënja indoeuropiane *k^u*elh* "dredh, përdredh, kthej".[11]

Perceptimi i Eric P. Hamp-it

Nuk ka dyshim që edhe Hamp-i përfshihet në këtë hulli diskutimesh që ka në bazë trajtimin e marrëdhënieve etimologjike të fjalëve brenda njërës apo tjetrës gjuhë, madje ai shkon në një rast gjithashtu pas Joklit duke e parë fjalën *përrua* si një fjalë të trashëguar për shqipen dhe e mendon atë të ardhur nga një bazë indoeuropiane **per-rēn*[12], rrjedhimisht në rumanishte duhet të kemi të bëjmë me një huazim nga shqipja; veçse, për të, siç bëhet e qartë nga kërkesat metodologjike, më tepër se

[9] E. Çabej, Hyrje ..., f. 177.

[10] E. Çabej, Hyrje ..., f. 178.

[11] E. Çabej, *Disa mendime mbi marrëdhëniet gjuhësore rumune-shqiptare*, Studime gjuhësore IV, Rilindja, Prishtinë, 1977, f. 249.

[12] E. P. Hamp, *Vendi i shqipes*, Studime krahasuese për shqipen, ASHAK, Prishtinë, 2007, 121.

etimologjitë e fjalëve të caktuara, ka rëndësi që ato të shihen edhe në marrëdhënie me njëra-tjetrën dhe në tërësinë e tyre, si "korpus materialesh" dhe kjo do të kërkonte përfshirjen në këtë lojë edhe të disa kritereve të tjera. Për Hamp-in "kriteret që përdorim si test janë më shumë llojesh, por mjeti më i shënueshëm dhe më i mprehtë që kemi – dhe që do ta përdorim këtu – është ai i *relacionit gjenetik* dhe i *rindërtimit*".[13]

Ndërsa kriteri i relacionit gjenetik do të na siguronte për të dhënën që fjala sillet si vendase dhe ka pasur jetë të gjatë brenda njërës apo tjetrës gjuhë, rindërtimi do të zbulonte edhe veçoritë specifike të zhvillimit fonetik të saj.

Është e rëndësishme të theksohet se në perceptimin e Hampit analizat etimologjike të fjalëve, të cilat, pra, mund të siguronin relacionin gjenetik dhe veçoritë specifike të zhvillimit fonetik përmes rindërtimit, mund të sjellin në dritë edhe të dhëna për një tjetër aspekt, mjaft të rëndësishëm në këtë mes, siç është ai i *kronologjisë së zhvillimeve gjuhësore*.

Parë nga ky këndvështrim, në korpusin e përkimeve leksikore rumune-shqiptare Hampi dallon të përfaqësuara tri rrafshe kronologjike:

Në rrafshin e parë ai përfshin disa njësi që, sipas tij, kanë të përbashkët ndryshime të një natyre thelbësore për historinë e shqipes. Këtu ai përmend fjalët shqipe *vatër*, (*h*)*urdë*, *shtrungë*, *murg* dhe i konsideron këto si pjesë të një korpusi që ai e quan protoalbanoid.

Kategoria e dytë përfshin një pjesë të gjerë të elementeve "autoktone". Këto shfaqin zhvillime tipike shqipe, por mund të kronologjizohen si më të hershme se shumica e kontakteve romane në këtë zonë. Për këtë rrafsh Hamp mjaftohet me një shembull të vetëm, fjalën *sorrë*, për të cilën shprehet se "etimonin e vendos në rrjedhën kryesore të fushave leksikore indoeuropiane".

Shtresa e tretë për Hamp-in kronologjizohet në periudhën e kontakteve pasromane. "Shqipja huazoi shumë elemente latine..., shkruan Hamp-i, **por huazimet shkuan edhe në drejtim të kundërt** dhe nuk u kufizuan vetëm te termat përsëritshëm të favorizuar blegtoralë". *Moshë*

[13] E. P. Hamp, *Trakishtja, dakishtja dhe korrespondencat shqipe-rumune*, Studime krahasuese për shqipen, ASHAK, Prishtinë, 2007, f. 171.

është një ilustrim, /*sh*/ e së cilës mund të dalë vetëm nga shqipja, por që duhet të jetë më e vonë se /*s*/ latine në rumanishte.[14]

Pavarësisht faktit nëse kjo skemë i përgjigjet apo jo të vërtetës, këtu duhet të veçojmë se me këtë vërejtje të hollë për këtë grup të fundit, Hamp-i çel një shteg të ri dhe orienton studiuesit drejt një mundësie krejt të re për të shpjeguar burimin e përkimeve leksikore rumuno-shqiptare. Në qoftë se, siç nënkupton vërejtja e Hamp-it, shqipja ka lënë gjurmët e saj në latinishte, atëherë fjalët e përbashkëta duhen parë në rumanishte jo si elementë të substratit, por si elementë që i janë mbivënë gjuhës substrat, pra, si elementë të superstratit.

Mundësia e kalimit të fjalëve shqipe në rumanishte përmes latinishtes do të ndryshonte krejtësisht perceptimin tonë për marrëdhëniet e gjuhës shqipe me rumanishten, duke qenë se nuk do të duhej të kërkohej më origjina e përbashkët midis dy gjuhëve, as mundësia e kontakteve ndërgjuhësore në një kohë e në një vend të caktuar, por do të duhej të nënkuptohej një ndërmjetësе mes dy gjuhëve.

Ndihmesa e Stefan Schumacher-it

Në këtë mënyrë përkimet leksikore rumuno-shqiptare mund të shihen nën një dritë të re. Disa raste me interes, të emërtuara si *huazime të protoshqipes në latinishten apo rumanishten ballkanike* i kemi të analizuara nga S. Schumacher[15].

Schumacher gjykon këto barazime: shqip *thark* - rumanisht *ţarc*/ arumanisht *tsarcu*[16], shqip *vatër*/*votër* – rumanisht *vatrā*[17], shqip *përrua* -

[14] E. P. Hamp, *Trakishtja, dakishtja dhe korrespondencat shqipe-rumune*, Studime, 173-174.

[15] Shih: *Marrëdhëniet e huazimeve mes protoshqipes dhe latinishtes apo rumanishtes ballkanike*, Historia e shqiptarëve, Botimet Përpjekja, Tiranë, 2012, f. 41-65.

[16] Fjala shqipe *thark* është parë e lidhur etimologjikisht me fjalën *thur*, si zhvillime të ndryshme të dy shkallëve apofonike, sepse dallimi në zanoret përkatëse të rrënjëve, /*a*/-/*u*/, mund të shpjegohet si shfaqje e apofonisë së dikurshme. Duke iu referuar një ligji fonetik të shqipes, Schumacher tregon se nistorja /*ts*/ e trajtave rumune dhe arumune përbëjnë një shkallë të ndërmjetme të zhvillimit të guturalit indoeuropian deri në /*th*/-

rumanisht *pîrîu*[18], shqip *vjedull* – rumanisht *viezure*[19], shqip *kurpën/kulpër* – rumanisht *curpen*[20]. Mund të vihet re se në shpjegimet e veta Schumacher ka krijuar dhe ofron një model të përshtatshëm analize. Ai lidh rregullisht fjalën shqipe me një bazë të rindërtuar ie., kërkon dhe përmend lidhjet etimologjike me fjalë të tjera të shqipes, kërkon "tiparin specifik" të zhvillimit fonetik të fjalës dhe vendos kur është e mundur kronologjinë e huazimit.

Në ndjekje të modelit

Më poshtë do të paraqesim në një mënyrë fare të formalizuar marrëdhëniet e mundshme etimologjike të dy prej fjalëve shqipe që bëjnë pjesë në listën e përkimeve leksikore rumuno-shqiptare, pa përfshirë në skemat tona detaje të analizës etimologjike, të cilat do të kërkonin një hapësirë më të gjerë se kjo që na lejohet këtu.

Rasti *kurth* (rumanisht *cursă*)

Në fjalorët e gjuhës shqipe njihen dy njësi me përbërjen *kurth*. E para shënon "një mjet prej druri a prej metali, i ndërtuar posaçërisht për të zënë kafshë të egra, minj, zogj etj.; çark, grackë" dhe "një vend të fshehur, i rrethuar a i mbyllur, nga i cili nuk mund të shpëtojë ose e ka shumë

---

në e shqipes së re. Sipas tij, huazimi duhet të ketë ndodhur diku pas shekullit të dytë të erës sonë (f. 48-50).

[17] Në fjalën shqipe *vatër/votër* sheh një lidhje me latinishten *âtrium* dhe një ligj specifik për shqipen në rastin e paravendosjes së /v/. Hampi fjalën *vatër* e përmend si të grupit më të vjetër, pjesë të atij korpusi që ai e quan protoalbanoid (f. 50-51).

[18] Fjala *përrua* lidhet brenda shqipes me *krua*, *rend*, *runa* dhe në gjuhët gjermanike me *rinnen* (rrjedh, kullon) dhe *rennen* (rend, vrapoj) (f. 51-54).

[19] Fjala shqipe *vjedull* shihet e lidhur me bazën ie. $*ueĝ^h$ dhe konsiderohet si një huazim i hershëm, duke qenë se në rumanishte provon rotacizmin /l/>/r/ (f. 54-56).

[20] Në shqip *kulpër/kurpën* shihet si fjalë e trashëguar. *kurpën* <**kurp* si shkallë apofonike kuantitative zero e **kuerp*(*H*). Siç përmendëm më lart, Jokli kishte supozuar për ktë bazën indoeuropiane$*k^u elh$. Këtë Shumacher nuk e quan të pamundur, pavarësisht rezervave që shpreh ndaj interpretimeve të Joklit (f. 56-58).

vështirë të dalë ai që futet aty". E dyta shënon "degëzimet e kungullit, të pjeprit etj., që shtrihen e zgjaten në tokë" dhe "gropa ku mbillet kungulli, pjepri etj."[21]

Në bazë të këtyre kuptimeve këto njësi homonimike të gjuhës shqipe mund të lidhen me latinishten *cohors*, *chors*, *cors* (kopsht, rrethim) dhe *hortus* (kopsht), me sllavishten *gard*/*grad* (rrethim, qytet), si edhe me greqishten e vjetër *χορδή* (lat. *chorda*).

Le të supozojmë për të gjitha këto një bazë të përbashkët indoeuropiane * k^w*ërt* */g^w*ërd*.

Mbi këtë bazë ne mund të rindërtojmë shkallë të ndryshme apofonike të kësaj rrënje, sipas skemës CĕCC – CēCC – CŏCC – CøCC (respektivisht: shkalla e shkurtër, e zgjatur, shkalla o dhe shkalla zero) dhe do të kishim këto trajta të rindërtuara:

*k^w*ërt* /g^w*ërd* - *k^w*ērt* /g^w*ērd* - *k^w*ŏrt* /g^w*ŏrd* - *k^w*ørt* /g^w*ørd*[22]

Po të supozojmë zhvillimin e zanores së rrënjës sipas rregullave të fonetikës historike të gjuhës shqipe (*ĕ* > *e*/*ié*, *ē* > *o*, *ŏ* > *a*), do të fitojmë:

nga shkalla e shkurtër, *k^w*ërt* > **qert* > *qerth*, mund të shkojmë te fjala shqipe *qerthull*, nga shkalla o, g^w*ŏrd* > **gard*, mund të shkojmë te fjala shqipe *gardh*;

ndërsa te fjala *kurth* mund të shkojmë me dy rrugë, nga shkalla e zgjatur, *k^w*ērt* > *kort* (duke nënkuptuar zhvillimin /o/ > /u/), ose nga shkalla ø, *k^w*ørt* > *kurt*.

Konvertimi i shtegores së shqipes /*th*/ në /*s*/ në rumanishte do të thotë se kemi të bëjmë me një huazim relativisht të vonë, pas kohës kur në shqipe ka ndodhur shndërrimi i okluzives /*t*/ në shtesoren /*th*/ dhe ka një analogji në maqedonishte, siç tregon toponimi *Kafasan*, nga shqipja *Qafëthanë*.

---

[21] Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980, f. 925-926.

[22] Po lëmë mënjanë këtu diskutimin e dy çështjeve me karakter teknik: e para ka të bëjë me relacionin e zëshmërisë së bashkëtingëlloreve okluzive (/k/ - /g/, /t/ - /d/), ndërsa e dyta ka të bëjë me zhvillimin e okluziveve /t/ - /d / në shtegore (respektivisht në /th/ - /dh/).

Rasti *qafë* (rumanisht *ceafă*)

Mund të supozohet se, si në shqip, ashtu edhe në rumanisht, është vërtetuar shndërrimi fonetik /*e*/ > /*iá*/. Në këtë mënyrë, për të dyja gjuhët do të shkohej në një bazë me zanoren tematike /*e*/, e cila mund të lidhet me bazën e hershme indoeuropiane **kheph*/**ghebh* (kokë) sikurse me greqishten *κεφαλη* (kokë), latinishten *caput*, gotishten *gibla*, gjermanishten e vjetër *gebal* dhe me norvegjishten e vjetër *gafl*[23].

Si shkallë apofonike të kësaj rrënje, sipas skemës CĕC, CŏC, CēC, do të ishin:

**khĕph*/*ghĕbh*, **khēph*/*ghēbh*, **khŏph*/*ghŏbh*.

Po të supozojmë zhvillimin e zanores së rrënjës sipas rregullave të fonetikës historike të gjuhës shqipe (*ĕ* > *e*/*ié*, *ē* > *o*, *ŏ* > *a*), do të fitojmë:

**khĕph* > **kĕp*, **khēph* > **kop*, **khŏph* > **kap*

ose

**ghĕbh* > **gĕb*, **ghēbh* > **gob*, **ghŏbh* > **gab*.

Nga të cilat kemi:

**khŏph* > **kap* > *kapua*; *shkabë* (me parashtesë) > *shkabonjë*

**khēph* > **kop* > **kup* > **skup* (me parashtesë). Këtu duhet të kenë bazën fjalët *squp* dhe *shqype*/*shqipe*, nga e cila krijohet me prapashtesë fjala *shqiponjë*.

**ghŏbh* > **gab* > *gabë* > *gabonjë*/*gabec*, si edhe *zhgabë* (me parashtesë) > *zhgabua*/*zhgabonjë*.

**khĕph* > **kĕp* > **qep*. Kjo mund të jetë baza e disa fjalëve shqipe, si: *kep* = *sqepar* (Kj), *qept* "sqep" (shqipja e Maqedonisë, fjalë e huazuar edhe nga maqedonishtja *kepte*), *kift*/*qift* (edhe *skifter*/*sqifter*), *sqep* (formuar me parashtesë) > *sqepar*. Këtu mund të lidhet fjala *sqap* = *cjap*, me diftongimin e njohur /*ĕ*/ > *ja* (*kep* > *kjap* + parashtesën *s*-).

Këtu duhet ta ketë bazën edhe fjala shqipe *qafë*.

[23] J. Pokorny, Indo-European Etymological Dictionary - Indogermanisches Etymologisches Wörterbuch, Bern - München, 1959, f. 423.

Në qoftë kështu, fjala shqipe *qafë*, sikurse edhe fjala *kurth*, është fjalë me bazë indoeuropiane dhe ka lidhje etimologjike me një tufë të tërë fjalësh brenda shqipes. Ajo duhet të jetë huazuar nga shqipja në rumanishte, madje edhe në maqedonishte (*kepte*).

Për kohën e huazimit të saj në rumanishte mund të na ndihmojë zhvillimi /*p*/ > /*f*/ në fundoren e saj. Kjo duhet të ketë ndodhur pas lindjes së nyjës shquese në gjuhën shqipe, çka krijoi togun -*pt*-, i cili u zhvillua në -*ft*-[24].

[24] Për më gjatë shih A. Riska, Për etimologjinë e fjalës shqipe *qafë*, Buletini shkencor UNIEL (seria e shkencave shoqërore), nr. 3, 2013, 11-21

Albert RISKA, Universiteti “A. Xhuvani”, Elbasan

ROMANIAN-ALBANIAN LEXICAL CORRESPONDENCIES AS SEEN BY ERIC P. HAMP

Summary

In this article is discussed the position and the help of the American Indo-Europeanist Eric P. Hamp related to one of most interesting issues of the Albanian language history. This is about the source of the joint words between Albanian and Rumanian, or of these lexical elements (in order to use an expression of Hamp) from the Rumanian point of view are called “autochthonous”. The issue of the joint words between Rumanian and Albanian has been discussed by many other scholars, dealing with Albanian and Rumanian studies before Hamp. But staying on the position of the Indo-Europeanist Hamp you realize that he has found the right answer not only to give an acceptable solution but as well to open a path which is worth being followed by the others.

Bardh RUGOVA, Prishtinë

KONTRIBUTI I BEVINGTON-IT PËR FONOLOGJINË E SHQIPES – THEKSI SI RAST STUDIMI

Fille gjenerative

Studimi "Albanian Phonology" i Gary Lloyd Bevington-it është mbrojtur si punim doktoranture në Universitetin e Masaçusetsit në SHBA më 1970 dhe është rishikuar për botim më 1974 nga SHB O. Harassowitz me recension te Hans Jürgen Sasse-s. Autori ka zgjedhur ta përshkruajë sistemin tingullor të shqipes letrare, sipas shkrimeve në "Zëri i Popullit" dhe shenjat grafike pastaj t'i interpretojë sipas Anastas Dodit. Autori (1974:3) ka pasur ambicien edhe ta ndihmojë standardizimin e shqipes.

Autori amerikan e ka shtruar problemin në këndvështrimin gjenerativ, duke qenë ndër studimet e para të tilla të shqipes, menjëherë pas studimit (edhe ky punim doktoranture) të Oda Buchholz-it për rimarrjen e kundrinës në gjuhën shqipe (1969), publikuar si libër më vete më 1977.

Në studimin për fonologjinë e shqipes, Bevington-i dy përfaqësimet: sipërfaqësor dhe të thellë[1] i ofron në matrica dydimensionale, ku kolonat janë segmentet suksesive fonologjike, ndërsa radhët janë tërësia universale e tipareve fonologjike (1974: 4). Secili zë (entry) në matricë markohet me (+) nëse tipari participon në segment ose me (-) nëse nuk participon. Meqë në nivelin e thellë (apo fonologjik) tiparet kanë rol klasifikues, ndiqet sistemi binar. Në nivelin sipërfaqësor (fonetik) vlerat skalare vihen në vend të plusëve dhe të minusëve për disa tipare, te të cilët dallueshmëria

[1] Bevingtoni nuk përdor termin e Chomsky-t "Deep Structure", por "Underlying".

e tillë arsyetohet nga faktorët fonetikë, siç i quan ai: detailed rules (1974: 5).

Zgjedhja e trajtimit gjenerativ shmang këndvështrimet poststrukturale, duke mos marrë parasysh varietetet tingullore brenda shqipes, dhe me këtë rast nuk përfshihen detailed rules, por vetëm vlerat binare.

Ai këtë e "zgjidh" me mendimin se nëse një komponent fonologjik përmban dy a më shumë rregulla, specifikimi i zbatimit të rregullave në raport me njëra-tjetrën bëhet i domosdoshëm (1974:6).

Bevington-i ofron një skemë sipas tabelave të Dodit, ndërsa theksin e përkufizon (1974:24) si të shqiptuar me forcë më të madhe ekspiratore të një rrokjeje, kundrejt zanoreve të tjera.

Rregullat e formuluara

Çështja e theksit të shqipes dhe në veçanti e përshkrimit gjuhësor të strukturës prozodike të gjuhës shqipe mbetet midis çështjeve ende të pazgjidhura në kërkimet e sotme të morfonologjisë së shqipes (Bozhoviq 2012:143). Derisa Dodi e Gjinari (1983:129) me metoda tradicionale kujtojnë se vendosja e theksit në prozodinë e shqipes nuk mund të përcaktohet me rregullat gramatikore, duke mos ditur kështu të bëjnë dallimin mes derivacionit dhe fleksionit, gramatika transformative-gjenerative ofron një aparat eksplanator më të fortë.

Koncepti i tyre që nuk e dallon derivacionin nga fleksioni vë shenja barazie mes fjalëve me mbaresa si *punë, punoj, kumbull, kumb(u)llave* dhe me prapashtesa: *barazi, punëtori* e kështu me radhë. Dodi e Gjinari, njëherësh, e shprehin si tendencë theksin në rrokjen e parafundit (paroksiton). Bevington-i, së këndejmi, shënohet si i pari që ka provuar t'i formulojë rregullat e vendosjes së theksit të fjalës në gjuhën shqipe mbështetur në konceptet e Chomsky-t dhe të Halle-s dhe mund të konsiderohet si themelues i akcentologjisë shqiptare (Bozhoviq 2012). Ai (1974: 24-25) ofron këtë rregull:



Nëpërmjet këtij përkufizimi të përmbledhur në një formulë, Bevington-i mëton të gjejë rregullshmëri brenda sistemit të theksit në gjuhën shqipe dhe arrin të konstatojë se theksi realizohet vetëm brenda temës a rrënjës së fjalës, duke parë që mbaresat të jenë metrikisht të shpërfillshme, ndryshe nga prapashtesat: psh. *barazí*. Duke e trajtuar vetëm shqipen letrare, Bevington-i arrin t'i "normëzojë" edhe situatat me togjet e zanoreve (1974: 26), duke e trajtuar shembullin *díell*. Natyrisht, një studim deskriptiv i shqipes në gjithë spektrin e saj do t'i trajtonte edhe variantet me diftongëzim. Megjithatë, rregulla e Bevington-it nuk e shpjegon tërë sferën theksore të shqipes as brenda variantit që ai ka përzgjedhur ta diskutojë. Bozhoviq (2012: 144) vëren se kjo rregull nuk i referohet klasës natyrale fonologjike dhe e ndryshon vendosjen e theksit në temat emërore prej atyre në temat foljore të shqipes. Gjithashtu, nuk i përfshin ato tema emërore që mbarojnë me zanoret *e, a, o* të theksuara (*kafé, pará, byró*) si iamb, ato që e kanë zanoren *ë* në rrokjen e theksuar (*jastëk*) dhe temat njërrokëshe që nuk marrin asnjë theks (*ujk, det,* por *újku, déti*). Rregulla e tij nuk i përfshin as daktilët, si *flutura* ose *kumbulla* (Bozhoviq 2012:144) që në formën e shkruar të shqipes letrare, mbi të cilën është mbështetur Bevington-i, mund të shkojnë deri në katër rrokje larg fundit në paradigmë (*kumbullave – fluturave*).

Megjithatë, tema si domen i theksit në shqipen do të ndiqet më pas edhe nga autorë të tjerë që e kanë trajtuar theksin e shqipes edhe nga këndvështrime të tjera teorike.

Teoria e optimalitetit

Theksi i shqipes, më pas, është trajtuar edhe nga këndvështrime të tjera, përfshirë atë të teorisë së optimalitetit, e cila del nga gramatika gjenerative. Ideja qendrore e teorisë së optimalitetit është se format sipërfaqësore të gjuhës reflektojnë zgjidhjet e konflikteve ndërmjet kërkesave konkurruese ose shtrëngesave (constraints) (Kager 2004:xi). Forma sipërfaqësore është optimale, kur del në formën e një shkeljeje më pak serioze të shtrëngesave të dukshme të ranguara në hierarki të veçanta gjuhësore. Shtrëngesat janë universale dhe i enkodojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë deklarimet e shënjuesisë (markedness) dhe parimet që shtyjnë ruajtjen e kontrasteve të kuptimit (faithfullnes).

Rezultatet kryesore të kësaj teorie janë pikërisht në prozodi (Kager 2004:xii).

Supozimi themelor i teorisë së optimalitetit thotë se çdo autput gjuhësor si formë është optimal, në kuptimin që përfshin shkeljet më pak serioze të tërësisë së shtrëngesave në konflikt. Për një imput të caktuar, gramatika gjeneron dhe më pas shqyrton një tërësi infinite të kandidatëve të autputit që në fund del të jetë vetë autputi (Kager 2004:8).

Në përgjithësi, GEN – merr një input dhe gjeneron një listë të autputëve të mundshëm a të kandidatëve. CON është kriteri në formë të shtrëngesave me rend strikt, të caktuar për të vendosur në mes të kandidatëve. Këtu hyjnë në punë markedness dhe faithfulnes. WAL është zgjedhja e kandidatit optimal mes shtrëngesave dhe ky kandidat është autputi.

I pari që e ka rrahur theksin e shqipes nga ky këndvështrim ka qenë Maynard (1997) ndjekur nga Trommer (2004, 2009, 2013). Maynard-i, po si Bevington-i, nuk e trajton problemin e rrokjes, e as veçorinë e theksit në pozitë fundore të shqipes, por te fjalë që kanë prapashtesim vëren orientim të theksit në të djathtë. Peshën e rrokjes e trajton më pas Canalis (2007) në diskutimin e tij për teorinë metrike të fonologjisë. Sipas Canalisit, shqipja në morfonologjinë e saj është e ndjeshme ndaj sasisë metrike,

apo kuantitetit të rrokjeve, pra nga numri i morave të tyre (pesha) dhe jo ndaj cilësisë së zanoreve në rrokje. Rrokjet mund të jenë të rënda, kur janë të gjata ose të mbyllura, apo kur përmbajnë ndonjë diftong, e prandaj përbëhen nga dy mora. Mund të jenë të lehta, kur janë të shkurtra dhe të hapura e prandaj përbëhen nga një morë metrike (Bozhoviq 2012: 1480). Sipas kësaj, Canalis-i përkufizon se rregulla e vendosjes së theksit të fjalës në shqipen do të nënkuptojë se te çdo fjalë e shqipes, theksi vendoset në morën e parë të këmbës së djathtë dymorëshe të temës së fjalës. Pra, sipas tij, të gjitha temat e shqipes janë paroksitone.

Duke vërejtur se Canalis (2007) e sheh theksin e shqipes jo thjesht në nivelin e rrokjeve të fjalëve, por në nivelin e morave dhe të këmbëve metrike të atyre rrokjeve, Bozhoviq (2012:143) përkufizon se theksi i fjalës në gjuhën shqipe vendoset rregullisht në morën e pare të këmbës metrike dymorëshe të fundit të rrënjës së fjalës, ashtu që temat gramatikore janë trokaike apo paroksitone. Ai përbrenda teorisë së optimalitetit vëren se këmbët janë binare dhe trokaike, me strukturim në të djathtë, se çdo rrokje i përket këmbës së saj dhe se theksi ka ndjeshmëri të kuantitetit. Megjithatë, edhe ky konceptim, nuk i trajton, po e zëmë, huazimet turke, me theks oksiton: *tenxheré*.

Përmbyllje

Vlera e studimit të Bevington-it është se e ka sqaruar vënien e theksit në shqipen përtej nocioneve deskriptive tradicionale, se është përpjekur ta shpjegojë si pjesë të temës së fjalës dhe brenda kësaj të ofrojë rregullsinë, duke qenë kështu edhe themelues i akcentologjisë së shqipes.

Ajo që u mungon studimeve gjenerative dhe teorisë së optimalitetit është se e shohin një variant të caktuar të idealizuar, por jo edhe kotekstin e as kontekstin e përdorimit - nocione këto poststrukturale.

Derisa ato mund të shpjegojnë dilema standardizimi si *óper* e *kámer* kundruall *opérë* dhe *kamérë*, nuk arrijnë të shpjegojnë arsyet e përdorimit të njërës kundruall tjetrës, siç nuk arrijnë doemos të zgjidhin probleme si

tenxheré – tenxhére. Njëherësh, kjo nuk sjell shumë shpjegime për homografet *bári* dhe *barí*, sikur edhe *punëtóri* dhe *punëtorí*.

Megjithatë, një numër i madh studiuesish që janë marrë më tutje me shqipen kanë shkelur mbi gurin e vënë nga Bevington-i për të bërë tutje në studimet fonologjike të shqipes përgjithësisht.

Bardh RUGOVA, Prishtina

BEVINGTON'S CONTRIBUTION TO ALBANIAN PHO**NOLOGY**

Summary

This paper aims at examining the impact of Gary Loyd Bevington's studies of Albania phonology, with a special focus on the accent of Albanian. Bevington produced the first generative study of the Albanian phonology and the first study ever on the accent of Albanian. His study, by not taking into account the sound varieties inside Albanian language, does not provide detailed rules but only binary rules within generativism. However, the follow-up studies on the theory of optimality (Maynard 1997, Trommer, Grim 2004, Trommer 2019, 2013, Bozovic 2012) are based on Bevington's results. The study also shows that Bevington's work is limited mainly inside the systems of conjugation and flexion of nouns, without fully treating the derivational morphology.

Bibliografia:

Bevington, G. L. (1974), *Albanian Phonology*, Wiesbaden: Otto Harrassowitz.

Bozhoviq, Gj. (2012). Theksi i fjalës në morfonologji të shqipes: teoria metrike dhe e optimalitetit. Në B. Rugova (red) *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 31/1*. Prishtinë, Universiteti i Prishtinës

Buchholz O. (1977). *Zur Verdoppelung der Objekte im Albanischen*, Berlin: Akad. der Wiss. der DDR

Buchholz, O. and Fiedler, W. (1987), *Albanische Grammatik*, Leipzig: VEB Verlag Enzyklopädie.

Camaj, M. (1984), *Albanian Grammar*, Wiesbaden: Otto Harrassowitz.

Canalis, S. (2007). To What Extend is Albanian Stress Predictable. Në: A. Biseto, F. Barbieri (red.) *Procedings of the XXXIII Incontro di gramatika generativa* (fq 1 – 14). Bologna: University of Bologna

Chomsky, N., Halle, M. (1968), *The Sound Pattern of English*. New York: Harper & Row

Dodi, A. and Gjinari, J. (1983*), Fonetika dhe Gramatika e gjuhës së sotme letrare Shqipe*, Tiranë: Akademia e RPS të Shqipërisë.

Kager, R. (2001). *Optimality Theory.* Beijing: Foreign Language Teaching and Research Press.

Maynard K. L. (1997). An Optimality analysis of Albanian word stress. Në: X. Li et al (red) *Papers from the 1997 Mid-America Linguistic Conference* (fq 94 – 100)

Newmark, L., Hubbard, P. And Prifti, P. (1982), *Standard Albanian: A Reference Grammar for Students*, Stanford: Stanford University Press.

Pipa, A. (1978), *Albanian Folk Verse: Structure and Genre*, München: Rudolf Trofenik.

Trommer, J., Grim A. (2004), *Albanian word stress*. Manchester Phonology Meeting, nëhttp://home.uni-leipzig.de/jtrommer/papers/alb.pdf (15 shtator 2015)

Trommer J. (2004) Albanian Word Stress në www.unileipzig.de/~jtrommer/alb_stress.pdf. (më 15 shtator 2015).

Trommer J. (2009), *Stress Uniformity in Albanian morphological argument for ciclycity*. Leipzig: University of Leipzig

Trommer J. (2013), Stress Uniformity in Albanian morphological argument for cyclicity. Në: *Linguistic Inquiry*, MIT Press.

Teuta ABRASHI, Prishtinë

LIDHJA NDËRMJET KUNDËRVËNIES ASPEKTORE AORIST/ IMPERFEKT, ORGANIZIMIT TË DISKURSIT DHE NYJAVE

Ndër kontributet e konsiderueshme të studimeve albanistike në Amerikë janë studimet në lëmin e gjuhësisë. Kjo sidomos në përqasjen e gjuhës shqipe me gjuhët e tjera ballkanike. E pikërisht kjo përqasje ka edhe rëndësinë e vet sepse mund ta ndihmojë në shpjegimin (eventual) të dukurive gjuhësore të shqipes. Konkretisht, kjo kumtesë bazohet në krahasimin e kundërvënies aspektore aorist/ imperfekt në gjuhët bullgare, shqipe dhe turke të bërë nga Victor Friedman. Ky krahasim, që së pari u botua më 1992 dhe u rimor në 'Studies on Albanian and other Balkan languages' botuar më 2004 në Pejë, erdhi në mënyrë të natyrshme, pasi Friedman-i kishte bërë më parë një krahasim për admirativin në të tria këto gjuhë. Nga të dhënat empirike, Friedman-i konstaton se në kundërvënien aspektore aorist/ imperfekt, shqipja qëndron në mes të bullgarishtes dhe turqishtes. Lidhur me këtë, në këtë punim do të provohet për të gjetur arsyen e pozicionit të ndërmjetëm të shqipes duke e kërkuar atë në lidhjen e aspektit, sistemit të nyjave dhe organizimit të diskursit. Për të ndihmuar analizën, në pjesën e parë do të paraqiten disa njohuri themelore për aspektin, përfshirë këtu aspektin leksikor, gramatikor e relacionin ndërmjet tyre. Më tutje, do të paraqitet punimi i Friedman-it dhe porositë që dalin nga ky punim. Kurse, dy pjesët e fundit janë ruajtur për analizën e organizimit të diskursit përkatësisht lidhjes së aspektit me sistemin e nyjave. Punimi përfundon me një përmbyllje të shkurtë në gjuhën shqipe dhe angleze si dhe me shënimin e literaturës së përmendur në punim.

1. Njohuri themelore rreth aspektit

Fjalitë apo thëniet shprehin situata të caktuara, të cilat shkruesi apo folësi, nëpërmjet gjuhës, tenton t' i paraqesë mu ashtu si ndodhin në rrethana të caktuara. Në gjuhësi, koncepti situatë ka një shtrirje të gjerë[1]. Ajo përfshin situatat temporale dhe jo-temporale. Situatat temporale përveç që ndodhin në një kohë të caktuar (të së shkuarës, së tashmes apo së ardhmes), ato kanë zgjatje të caktuar (të gjatë, të shkurtë, të çastit, të përhershme etj), por edhe mund të vështrohen nga kënde të ndryshme. Situata mund të vrojtohet nga dy këndvështrime: (i) nga jashtë, duke e parë atë si një tërësi të plotë apo (ii) nga brenda, duke e parë vetëm ndonjë pjesë të saj. Në gjuhë, pozicionimi i tyre kohor bëhet nëpërmjet kohës [2], kurse kohëzgjatja[3] dhe këndvështrimi nëpërmjet aspektit[4]. Mirëpo, meqë kohëzgjatja e një situate e përcakton edhe vetë tipin e saj, në literaturë flitet për dy lloje të aspekteve: (i) aspekti i llojit të situatave dhe (ii) aspekti i pikëvrojtimit. Në literaturën aktuale rreth kësaj problematike, i pari quhet aspekti leksikor, kurse i dyti aspekti gramatikor. Një riemërtim të tillë është bërë thjesht për shkak të mjeteve gjuhësore të përdorura në realizimin e tyre. Për të parin konsiderohet se përdoren mjetet leksikore, kurse për të dytin mjetet gramatikore.

1. 1. Aspekti leksikor

Kohëzgjatja e një situate apo lloji i situatës varet nga lloji i veprimit (Aktionsart). Por, meqë natyra e llojit të veprimit karakterizohet kryesisht nga folja, atëherë shpesh thuhet se foljet e ndryshme krijojnë situata të ndryshme. Kështu në shembullin: *(Ai) troket (në derë)* bëhet fjalë për një situatë të çastit, e cila (zakonisht) mund të jetë edhe e përsëritur, prandaj

---

[1] Lehmann (1999:43)

[2] Kategori semantiko-pragmatike

[3] Në literaturën e mëhershme ky lloj aspekti është quajtur Aktionsart (llojit të veprimit) apo kohëzgjatje e veprimit të foljes.

[4] Rreth përbërjes së aspektit nga dy komponente shiko Smith (1997)

edhe quhet iterative, kurse në shembullin: *(Ai) ndërton (shtëpi)*, bëhet fjalë për një situatë që ka kohëzgjatje dukshëm më të madhe (disa muaj apo disa vjet). Pra, situatat kanë një strukturë apo një skemë kohore të implikuar nga folja. Vendler[5] dallon katër lloje të këtyre skemave:

(1) a. gjendje (do, urren, di, ka etj.)
b. aktivitet (noton, ha, ecën etj.)
c. arritje (troket, gjen, realizon, arrin pleqërinë etj.)
d. përfundim (ndërton shtëpinë, kryen maturën etj.)

Klasifikimi i skemave kohore është bazuar në kundërvënien e tri dallimeve apo tipareve të situatave të ndryshme:

(2) dinamike/statike, telike/atelike, durative/ e çastit

<table>
<tr><td colspan="5">SITUATA</td></tr>
<tr><td colspan="5">statike ◄——————————————————► dinamike</td></tr>
<tr><td colspan="3">atelike-kanë cak arbitrar</td><td colspan="2">telike-me një cak natyror</td></tr>
<tr><td colspan="2">jo-temporale</td><td>e zgjatur/durative</td><td>kufizuese</td><td>çastit</td></tr>
<tr><td>entiteti-përfaqësues i klasës (emri)</td><td>tipari (mbiemri)</td><td>gjendje</td><td>aktivitet</td><td>ngjarje</td></tr>
</table>

Tipari dinamik nënkupton ndërrim të gjendjes në raport me kohën, kurse tipari statik nënkupton gjendje të pandryshueshme, gjendje qetësie në raport me kohën. Ngjarjet dhe aktivitetet janë dinamike, ato ndodhin në një kohë të caktuar. Nga ana tjetër, gjendja është statike sepse nuk ndryshon në raport me kohën. Situatat dinamike ndodhin në stade të njëpasnjëshme. Secili stad i një ngjarjeje merr kohë, duke futur kështu një lloj ndryshimi. Ngjarjet e çastit kanë vetëm një stad, praktikisht një pikë. Kurse ngjarjet me një kohëzgjatje të caktuar kanë pikat e veta fundore, te të cilat bëhet kalimi nga situata e gjendjes në situatën e ngjarjes dhe në pikën tjetër fundore, nga situata e ngjarjes në situatën e gjendjes. Tipari durativ/ i çastit shërben për të bërë dallimin e ngjarjeve të çastit dhe ngjarjeve me kohëzgjatje të caktuar. Emërtimi i tiparit telik është bërë nga fjala

[5] Vendler (1967)

greke *telos*, që do të thotë *cak*. Rrjedhimisht, tipari telik përfshin një pikë të funtme, andaj ngjarjet telike kanë një cak apo një përfundim (të pritur) natyror (p.sh. *shkon në shkollë*). Kurse, ngjarjet atelike kanë një fund arbitrar: ato mund të përfundojnë në secilën kohë (p.sh. *shkon në park*). Në tabelën në (3) është dhënë një pasqyrë e skemave të Vendler-it të karakterizuara nëpërmjet tipareve dalluese të situatave të ndryshme:

(3)

skema e Vendlerit	dinamike	telike	durative
gjendje	-	-	+
aktivitet	+	-/+	+
përfundim	+	+	+
arritje	+	+	-

Lidhur me aktivitetet ka mendime të ndryshme: ato janë në kufi ndërmjet telikes dhe atelikes[6], ngjashëm me paraqitjen te diagrami (2). Prandaj, në (3) te tipari telik po vendosim (-/+). Mirëpo, disa studiues parapëlqejnë thjeshtësimin e situatave, fakt ky që i jep përparësi të dukshme analizës së diskursit, mirëpo nga ana tjetër shfaqet pësimi në anën cilësore gjegjësisht rënia e saktësisë së analizës së diskursit. Gjatë analizës konkrete në këtë punim do të shohim se një rënie e tillë është evidente dhe nganjëherë pengon në shpjegimin e dukurive të ndryshme. Parapëlqyesit e thjeshtëzimit konsiderojnë se arritjet janë po ashtu ngjarje, kurse aktivitetet janë gjendje (dinamike, por jo telike), prandaj propozojnë që skemat temporale të përfaqësohen nëpërmjet dy lloje të situatave: (i) gjendje dhe (ii) ngjarje[7].

Caktimi i situatave gjegjësisht aspekti leksikor nuk është një çështje që i përket vetëm foljes. Duke modifikuar fjalitë ose thëniet, situatat mund të ndryshojnë kohëzgjatjen e tyre. Krahaso p. sh. *vdes* dhe *po vdes*, me ç' rast nëpërmjet pjesëzës '*po*' situata e çastit shndërrohet në një situatë të zgjatur (*po vdes = lëngon*). Gjithashtu, duke i shtuar predikatit një plotës, situata që shënon një aktivitet, shndërrohet në një situatë që ka

[6] Lidhur me këtë çështje shiko Boogaart (2004)

[7] Smith (2003)

një përfundim: krahaso (*Ai*) *ec* dhe (*Ai*) *ec 100m*. Prandaj thuhet se aspekti është rezultat i parimit të kompozicionalitetit[8] ndërmjet foljes dhe argumenteve të saj si dhe përbërësve të tjerë (rrethanorëve, përcaktorëve apo modifikatorëve) të sintagmës verbale (VP)[9]. Por lidhur me këtë çështje ekzistojnë pikëpamje të ndryshme, sepse roli i foljes dhe kundrinës shikohet në mënyra të ndryshme. Prandaj ekzistojnë disa qasje gjegjësisht teori të cilat mund t' i grupojmë në ato që: (i) favorizojnë rolin e foljes (Vendler), (ii) nuk e favorizojnë as foljen e as kundrinën, por i mbajnë si barabar të rëndësishme (Verkuyl), dhe (iii) e favorizojnë kundrinën në procesin e realizimit të shprehjes së aspektit (Krifka[10]).

Sidoqoftë, roli dhe struktura e kundrinës për telicitetin e situatës gjegjësisht ngjarjes është i pamohueshëm. Se tiparet e saj (numri, referenca definite dhe referenca specifike) kanë një rëndësi të veçantë tregojnë edhe shembujt në vijim:

(4) Nita ha mollë.

M1 M2 M3 M4 M

Në këtë shembull numri i mollëve të ngrëna nga Nita nuk është i kufizuar, prandaj situata apo ngjarja ka një përfundim arbitrar, rrjedhimisht është atelike. Por, nëse thuhet:

(5) a. Nita ha mollë**n** apo

b. Nita ha **një** mollë.

Fillimi Fundi

[8] Parimi i kompozicionalitetit sipas Gottlob Frege thotë: kuptimi (kompozitar) i një fjalie, shprehje, sintagme është identik me kontributin apo shumën e kuptimeve të secilit përbërës plus sintaksa e tyre.

[9] Verkuyl (1993)

[10] Krifka (1989)

Atëherë, duke përdorur nyjën e caktuar në shembullin (5a) gjegjësisht nyjën e pacaktuar në shembullin (5b), situata apo ngjarja e ngrënies ka një përfundim të pritur natyror, rrjedhimisht është një situatë telike. Në përgjithësi, situatat telike lejojnë dy lexime që përqendrohen në: (i) fazën përfundimtare duke rezultuar me ndërrim të gjendjes (kur letra në shembullin (6b) është përfunduar së shkruari) apo (ii) një proces i cili ndërpritet, por s'është përfunduar (6a).

(6) a. Ai shkroi një letër për njëzet minuta. (E më pas vendosi mos ta përfundoi.)

b. Ai e shkroi një letër brenda njëzet minutave. (* E më pas vendosi mos ta përfundoi.)

Prandaj, situatat telike mund të konsiderohen si një tërësi apo si një situatë e përfunduar (si në 6b), por edhe si një proces që (ka potencë të) shpie deri tek një situatë e përfunduar (6a). Nëpërmjet shembullit (6b) ilustrohet edhe pikëvështrimi i gjerë, që u përmend më herët, kur situata mund të vrojtohej në tërësi duke përfshirë edhe fazën finale, pra kalimin nga situata e të shkruarit në një situatë (apo gjendje) të mos-shkruarit. Ky pikëvrojtim përveç që mund të bëhet nëpërmjet kompozicionalitetit, si në (6b), te disa gjuhë mund të realizohet edhe me mjete gramatikore.

1. 2. Aspekti gramatikor

Comrie (1976) i përkufizon aspektet gramatikore si mënyra alternative të vrojtimit të strukturës temporale të situatës. Kështu, në (7) të dy shembujt janë në kohën e shkuar dhe që të dy pasqyrojnë situatën e cila është telike, dinamike dhe durative, pra i përgjigjet një skeme kohore që ka një përfundim:

(7) a. Ai shkruante një letër.

b. Ai shkroi një letër.

Ata nuk dallojnë për nga koha e as për nga lloji i veprimit, por thjesht dallojnë për nga lloji i situatës: (7a) është një ngjarje në zhvillim e sipër, por që nuk tregon se shkrimi i letrës ka përfunduar, kurse (7b) është

një ngjarje e përmbyllur, tek e cila shkrimi i letrës ka përfunduar. Paraqitja e një situate si ngjarje që shkon drejt përfundimit apo si ngjarje tanimë e përfunduar, është në fakt funksioni themelor i aspektit gramatikor, i cili manifestohet te mbaresat imperfektive dhe perfektive të foljes[11]. Por, shembulli (7a) na lë të kuptojmë një çështje shumë me rëndësi: aspekti gjegjësisht perfektiviteti dhe llojet e veprimit gjegjësisht teliciteti janë koncepte të pavarura. Sidomos nëse kihet parasysh se (7a) shpreh imperfektivitetin. Prandaj, për të qenë fjalia (në rrafshin semantik) një pohim i vërtetë nuk është e domosdoshme që letra të shkruhet në tërësi, sepse folësi tanimë ka vendosur ta përdorë formën imperfektive.

Shprehur në mënyrë metaforike[12], aspekti gramatikor mund të konsiderohet si një kamerë, e cila ose përfshin tërë situatën (perfekti) ose përqendrohet vetëm te një pjesë të saj (imperfekti). Por në këtë rast, vetëm pjesa e përfshirë nga kamera përcillet për interpretim semantik.

(8)



Në (8) kamera është zëvendësuar me kohën narrative, e cila është një kohë kur folësi vlerëson karakterin aspektual të ngjarjes gjegjësisht e

[11] Shembulli (7a) na lë të kuptojmë një çështje shumë me rëndësi: aspekti dhe llojet e veprimit përkatësisht perfektiviteti dhe teliciteti janë koncepte të pavarura. Sidomos nëse kihet parasysh se (7a) shpreh imperfektivitetin, prandaj për të qenë fjalia (në rrafshin semantik) një pohim i vërtetë nuk është e domosdoshme që letra të shkruhet në tërësi. Folësi tanimë ka vendosur ta përdorë formën imperfektive. Shiko më gjerësisht Decklerck (1979), e cila i referohet konceptit të perfektivitetit si kufizim (boundedness). Lidhur me këtë çështje Lindstedt (2001:775) propozon dy lloje të kufizimeve: (a) kufizimi kohor (temporal bound) dhe (b) kufizimi material (material bound). I fundit supozon telicitetin dhe nënkupton kufizimin kohor. Ky lloj kufizimi është i pranishëm në shembullin (7b).

[12] Shiko më gjërësisht Smith (2003:68)

vështron situatën[13]. Te perfekti koha narrative e përfshin situatën gjegjësisht narratori e shikon situatën nga jashtë, kurse te imperfekti koha narrative (ose narratori) është brenda situatës.

Aspekti gramatikor nuk është i pranishëm në të gjitha gjuhët. Tipike për aspektin gramatikor konsiderohen gjuhët sllave. Në gjuhën bullgare ekziston një varg afiksash që i bashkohen foljes dhe e shndërrojnë kuptimin aspektor të saj imperfektiv në kuptim aspektor perfekttiv[14]:

(9) piša$_{impfv}$ - shkruan **na** – piša - shkruan në tërësi
četa$_{impfv}$ - lexon **pro** – četa - lexon në tërësi

Në bullgarishte shumica dërrmuese e foljeve, duke marrë afiksat, hyn në çiftin e tyre në kundërvënie aspektore, ashtu që secila folje në leksikon është e shënuar si perfektive ose imperfektive[15]. Këtu nuk po përmendim kundërvënien aspektore dytësore, si pasojë e sufiksave shtesë. Përjashtim bëjnë foljet e ashtuquajtura bi-aspektuale (siç janë: organiziram, remontuviram etj.), të cilat nuk hyjnë në kundërvënie aspektore, sepse janë huazime të vonshme dhe nuk kanë mundur të "krijojnë" çiftin e vet aspektor. Përndryshe, kur është e mundshme, kundërvënia aspektore është e pranishme në të gjitha kohët. Prandaj, e shkuara, e tashmja dhe e ardhmja, secila i ka format e perfektit dhe të imperfektit[16]. Përveç kësaj, në bullgarishte është e pranishme edhe një kundërvënie shtesë aspektore, por kjo është e pranishme vetëm në të shkuarën. Arsyeja e një dukurie të tillë është se bullgarishtja e ka trashëguar, apo më mirë të themi e ka ruajtur, aoristin (ose perfektin e zhvendosur në kohën e shkuar) nga sllavishtja e vjetër. Edhe te gjuha shqipe është e pranishme kundërvënia aspektore e zhvendosur në të shkuarën, por prejardhja e aoristit në gjuhë supozohet se është nga perfekti i indoeuropianishtes[17]. Ngjashëm me shqipen, turqishtja[18] ka vetëm kundërvënien aspektore të së shkuarës.

---

[13] Klein (1995:9) dhe referimin e tij te Timberlake

[14] Kabakčiev (2000: 127)

[15] Swart (2012)

[16] Comrie (1976:126)

[17] Hewson & Bubenik (1997: 107)

[18] Emërtimi aorist në gjuhë turke është i huazuar nga gramatika greke, që do të thotë "i

Për të dalluar kundërvëniet aspektore, Aronson[19] i quan ato: (i) aspekt i mbirenditur (*superordinate aspect*) dhe (ii) aspekt i nënrenditur (*subordinate aspect*). Të dy emërtimet janë të bazuar në pozicionin hierarkik të secilës kundërvënie aspektore në krahasim me kategorinë e kohës. Rrjedhimisht, kundërvënia aspektore që është rezultat i foljeve të afiksuara në bullgarishte është e mbirenditur, sepse të gjitha veprimet që shënojnë ato mund të (zh)vendosen në të tashmen, të shkuarën dhe të ardhmen. Kurse kundërvënia tjetër aspektore, e zhvendosur në kohën e shkuar, i nën-renditet kohës.

(10) Relacioni kohë-aspekt i foljeve aspektuale në bullgarishte



Për shkak të pranisë së dy kundërvënieve aspektore, në kohën e shkuar shfaqen dy kundërvënie aspektore dhe rrjedhimisht, ashtu siç shihet në diagramin në (10), katër forma të foljes. Kurse, për shkak se foljet bi-aspektore të bullgarishtes kanë vetëm një kundërvënie aspektore, ato, sikurse shqipja e turqishtja, kanë vetëm dy forma foljore: aoristin dhe

pakufizuar", përdoret tradicionalisht për atë që turqit e quajnë geniş Zaman 'e tashme e gjerë", e cila shënon një aktivitet të vazhdueshëm nëpërmjet të cilit p. sh. shprehen fjalitë dhe thëniet gjeneralizuese (shiko Lewis (2000: 115).

[19] Aronson (1981:199)

imperfektin (11).

(11) Relacioni kohë-aspekt i foljeve në shqipe dhe turqishte si dhe i foljeve biaspektuale në bullgarishte



1. 3. Shtresimi i aspektit

Siç pamë më lart, bullgarishtja ka tri lloje të aspektit: leksikor, të nënrenditur dhe të mbirenditur, kurse shqipja dhe turqishtja dy, aspektin: leksikor dhe të nënrenditur. Duke u bazuar në të dhënat empirike, Gvozdanović[20] dëshmon për një shtresim hierarkik të aspektit[21]. Sipas saj, secila shtresë më e lartë mund të imponojë kushte në interpretimin e shtresës më të ulët[22], p.sh. aoristi në bullgarishte dhe *passé simple* në frëngjishte.

(12) a. Tja pja $^{\text{IPF-Aorist}}$ pesen(ta) tri minuti (*za tri minuti).

Ajo këndonte këngën për tre minuta (brenda tre minutave).

b. Tja iz-pja $^{\text{PF-Aorist}}$ pesen(ta) za tri minuti (*tri minuti)

---

[20] Gvozdanović (2012: 799)

[21] Shtresimi hierarkik i aspektit është i pranishëm edhe në anglishte:

(i) I ate a piece of cake last night. Mbrëmë hëngra një copë ëmbëlsirë.

(ii) I was eating a piece of cake when she called. Isha duke ngrënë një copë ëmbëlsirë kur thirri ajo.

Në (ii) vërejmë se si aspekti i mbirenditur progresiv (-ing) i anglishtes "ia rrëmben" pikën fundore një fjalie me një përfundim të plotë, me kufizim telik dhe kohor.

[22] Gvozdanović (po aty, f. 792)

Ajo këndoi këngën brenda tre minutave (*për tre minuta)

c. Tja peeše[IPF-IMPERFECT] pesen(ta) tri minuti/za tri minuti.

Ajo e këndonte këngën për tre minuta (brenda tre minutave).

Në shembullin (12)[23] janë përdorur ndajfoljet *për tre minuta* (12a) dhe *brenda tre minutave* (12b) për të testuar situatën gjegjësisht a ka ajo pika fundore. Në (12a), ndajfolja nuk ngre ndonjë kufi të qartë për pikat fundore të situatës, sepse *kënga* mund të këndohet për tre minuta pa e nisur atë nga fillimi dhe pa e çuar deri në fund. Prandaj, ajo mund të përdoret me foljen në IPF-Aorist, sepse ajo shënon vazhdimësi të veprimit. E, është pikërisht kjo vazhdimësi që në bullgarishte nuk e lejon përdorimin e *brenda tre minutave*. Ndryshe qëndron puna me foljen në PF-Aorist, e cila shënon situatën si një tërësi. Prandaj, në këtë rast përdoret *brenda tre minutave* sepse kjo ndajfolje ngre kufizim të qartë të fillimit dhe të fundit të situatës. Mirëpo, lidhur me IPF-Aorist të themi edhe një të dhënë interesante, e cila mund të na shërbejë më vonë për të sqaruar një konstatim shumë të rëndësishëm të Friedman-it. Sipas Kabakčiev-it[24], kjo formë e foljes shënon situata, kompletimi i të cilave nuk prodhon ndonjë efekt konkret, por ato (situata) janë gjithsesi të terminuara. Kur thotë të terminuara Kabakčiev-i ka ndërmend kufizimin kohor të situatës, por pikëvështrimi i folësit nuk bëhet nga pozicioni ku situata mund të shikohet në tërësi. Pra, kufizimi kohor te aspekti gramatikor mund të konsiderohet si një lloj analogjie me telicitetin e aspektit leksikor. Të rikujtojmë, më sipër u tha se *Ai shkruante një letër*, nuk është një situatë me kufizim kohor, por ajo është gjithsesi telike, sepse ka një përfundim të pritur[25]. Kësaj situate në bullgarishte i përgjigjet IPF-Imperfekt[26] (12c), i cili është i barasvlershëm me imperfektin gjegjësisht të shkuarën e pakryer të shqipes. Kjo

[23] Marrë nga Gvozdanović (po aty)

[24] Kabakčiev (2000: 243)

[25] Krahaso në anglishte: *He wrote a letter* dhe *He was writing* the letter, sipas të dy situatat janë telike. Shiko lidhur me këtë Boogaart (2004 :1173)

[26] PRF-Aoristi dhe IPF-Imperfekti janë forma të cilat përdoren më së shpeshti, kurse IPF-Aoristi më rralë, por më shpesh se PRF-Imperfekti Kabakčiev (po aty)

është arsyeja pse në (12a) në gjuhën shqipe lejohet përdorimi i të dy ndajfoljeve.

Por, t' i kthehemi terminativitetit të Kabakčiev-it, të përdorur për të shpjeguar IPF-Aoristin. Ai mund të konsiderohet si barasvlerë e konceptit të determinativitetit kohor (temporal definiteness) të Dickey-t[27]. Lidhur me këtë, Fortuin & Kamphuis[28] pohojnë se për shkak të IPF-Aoristit bullgarishtja konsiderohet si e vetmja gjuhë sllave që dallon në mënyrë formale ndërmjet tërësisë dhe determinativitetit të situatës.

Sidoqoftë, shembulli (12), përveç që na bën të mundur të nxjerrim kuptimin e disa formave të aspektit gramatikor, gjithashtu lë të kuptojmë se ekziston një relacion hierarkik ndërmjet aspektit leksikor dhe aspektit gramatikor të paraqitur në (13).

(13)



Shtresa e parë është ndërtuar nga aspekti leksikor si rezultat i foljes, kundrinës dhe përbërësve të tjerë të sintagmës verbale. Shtresa tjetër nga aspekti gramatikor formohet ashtu që semantika e kësaj shtrese është e bazuar në relacionin ndërmjet kohës narrative dhe kohës së situatës. Ani pse, siç u tregua më sipër, kjo shtresë është e pavarur, ajo u nënshtrohet disa kufizimeve, sepse (siç do të shohim më vonë) aspekti leksikor megjithatë arrin pjesërisht të prekë shtresat e sipërme. Shtresa e aspektit

[27] Dickey (1997)

[28] Fortuin & Kampus (2015: 1985)

gramatikor mund të jetë e nënshtruar edhe ndaj kufizimeve kohore që mund të vijnë nga shtresa e kohës, e cila gjendet menjëherë sipëri saj.

2. Punimi i Friedman-it: Kundërvënia aspektore aorist/ imperfekt në bullgarishte, shqipe dhe turqishte

Meqë shqipja dhe turqishtja kanë vetëm aspektin e nënrenditur, Friedman-i kufizohet në krahasimin e këtij aspekti te tri gjuhët. Lidhur me këtë, ai merr për bazë përkufizimin e kësaj kundërvënieje aspektore nga gramatikat përkatëse për secilën gjuhë. Kështu, për gjuhën shqipe merr për bazë përkufizimet nga Buchholz/ Fiedler, Newmark, Gramatika e Akademisë dhe nga Gramatika historike e Demirajt. Si material krahasues Friedman-i zgjedh përkthimin e "Sudba čeloveka" (Fati i njeriut) të Mihail Šolohov-it, në të tri gjuhët. Përkthimi në anglishte është bërë nga ai. Përzgjedhja e gjuhës ruse është bërë për të minimizuar ndikimin e gjuhës së burimit te gjuhët në të cilat bëhet përkthimi. Foljet në rusishte kanë vetëm aspektin e mbirenditur. Thënë ndryshe, foljet në këtë gjuhë nuk kanë aorist, prandaj mospërputhjet që shfaqen në format e foljeve në secilën gjuhë pritet të jenë rezultat i dallimit të kundërvënies aspektore aorist/ imperfekt.

Për Friedman-in mospërputhjet aspektore ndërmjet gjuhëve janë parësore, prandaj ai paraqet tabelën e dallimeve të mundshme, që mund të jenë më së shumti 6 (gjashtë), nëse kihet parasysh se kemi tri gjuhë, nga dy forma[29]:

	I	II	III	IV	V	VI
bullgarisht	Imp	Imp	Imp	Aor	Aor	Aor
shqip	Aor	Imp	Aor	Aor	Imp	I
turqisht	Aor	Aor	Imp	Imp	Imp	Aor

Friedman-i konstaton se rezultatet e pritura, nëse merren parasysh përkufizimet e aoristit dhe të imperfektit në gramatikat e këtyre gjuhëve, duhej të mos tregonin ndonjë divergjencë të theksuar. Por, nëse kihet pa-

[29] Friedman nuk është specifik se cilat janë ato dy forma, nga katër të mundshme të bullgarishtes të cilat janë përfshirë në krahasim.

rasysh se gjuha turke, për dallim nga shqipja dhe bullgarishtja, nuk është gjuhë indoeuropiane, atëherë dallimet duhej të ishin të theksuara. Por, të dhënat empirike tregojnë se këto mospërputhje nuk janë dhe aq të theksuara. Sipas Friedman[30] ndikimi ndërgjuhësor më së paku ka të ngjarë të ndodh në kundërvënien aspektore të nënrenditur. Një pohim i tillë i Friedman-it nuk është i papritur nëse kihet parasysh se morfema e aspektit gramatikor gjendet bukur thellë në krahasim me morfemat e tjera (siç është p.sh. veta) të mbaresave të foljes, prandaj ajo ka "imunitet" të theksuar[31]. Por ndryshe qëndron puna me aspektin leksikor. Për shkak të natyrës së tij dhe ekspozimit të drejtpërdrejtë, meqë gjendet në sipërfaqe e jo si aspekti gramatikor në thellësi i mbrojtur nga shtresat e tjera morfologjike, ai është dukshëm më i cenuar nga ndikimet e jashtme.

Sidoqoftë, shumica e mospërputhjeve janë të llojit I dhe IV, kurse numri i mospërputhjeve të llojeve II, III, V dhe VI është papërfillshëm i ulët. Prandaj, Friedman-i analizon vetëm shembujt nga grupi IV dhe I, të cilët tregojnë se përdorimi i aoristit në shqipen qëndron ndërmjet përdorimit në turqishten dhe bullgarishten. Thënë ndryshe, kur turqishtja ose bullgarishtja përdor in imperfektin, atëherë dy gjuhët e tjera e përdorin aoristin. Sipas Friedman-it, kjo është një evidencë se imperfekti në këto dy gjuhë është më i markuar se sa aoristi, sepse format më të markuara kanë gjasa më të mëdha për mospërputhje se sa për përputhje.

(14)



Evidencën empirike të mospërputhjeve Friedman-i, në botimin e

[30] Friedman (2012:404)

[31] Lidhur me këtë shih Abrashi (2014) dhe literaturën e cituar lidhur me këtë çështje.

vitit 2004, e paraqet edhe grafikisht. Vijat paralele tregojnë izomorfizmin relativ ndërmjet gjuhëve, kurse mufatjet në formë katërkëndëshi, në anën e majtë, tregojnë mospërputhjet. Aty është shënuar edhe fakti se mospërputhjet e imperfektit janë më të mëdha se të aoristit.

3. Organizimi i diskursit

Friedman-i, për bullgarishten dhe shqipen, prek gjithashtu organizimin e diskursit gjegjësisht analizon ndikimin e kundërvënies aspektore në strukturën narrative të tekstit. Lidhur me këtë çështje, ai arrin një përfundim shumë të rëndësishëm: imperfekti i shqipes dhe bullgarishtes, për dallim nga kuptimi i tyre i dhënë në gramatikat e cekura më lart, jo domosdo shënon vetëm ngjarje kontemporale apo të njëkohshme. Sipas tij, amperfekti në gjuhët shqipe dhe bullgare mund të shënojë edhe ngjarje kryesore të një sekuence.

Mirëpo, shembujt e gjuhës shqipe në punimin e Friedman-it janë vetëm në aorist. Kështu është edhe me shembullin të cilit i drejtohet Friedman-i, kur konstaton aftësinë e imperfektit për t' u përdorur si ngjarje kryesore në një sekuencë:

(15) **u mundua** të dredhë një cigare me një copë gazetë, po letra **iu ça** dhe duhani **iu derdh** në gjunjë.

Mirëpo, ai mundet fare lehtë të kthehet në imperfekt[32]:

(16) **mundohej** të dredhë një cigare me një copë gazetë, po letra **i çahej** dhe duhani **i derdhej** në gjunjë.

Është interesant, së te përkthimi i po të njëjtit shembull, por i marrë nga përkthimi i Abdullah Karjagdiut[33], parapëlqehet imperfekti në vend të aoristit, por vetëm për fjalinë e dytë:

(17) U rropat të përdridhte nji cigare, veçse letra e gazetës i **grisej** gjithnji teksa duhani i **shkapërderdhej** mbi gjunjë.

[32] Lidhur me kthimin e aoristi në imperfekt si dhe përdorimin e të pakryerës të veprimeve të njëpasnjëshme shiko Dhrimo (2008:296)

[33] Botuar më 1966, në Prishtinë, nga Jeta e Re

Mirëpo, nëse kihet parasysh se ky tekst nuk i përket Sokolovit (personazhit kryesor), por Shohollovit, i cili nëpërmjet narracionit na tregon veprimet e personazhit, besoj që përkthyesi ka mundur ta përdorte imperfektin edhe në fjalinë e parë. Në (18) po e vendosim edhe aoristin e fjalisë së parë në imperfekt. Siç shihet, struktura dhe rrjedha e tekstit nuk prishen:

(18) Përsëri u krodh në nji heshtje të gjatë. (Ai) ***rropatej*** *të përdridhte nji cigare, veçse letra e gazetës i* ***grisej*** *gjithnji teksa duhani i* ***shkapërderdhej*** *mbi gjunjë*. Ma në fund, përdrodhi disi nji cigare, thithi disa herë tymin e saj e, tue u kollitë, vazhdoi: ...

Friedman-i i referohet gjithashtu dallimit në shembullin nr. 5, që i takon grupit I, me ç'rast bullgarishtja përdor imperfektin kurse shqipja aoristin. Këtë shembull po e paraqesim në (19) në mënyrë identike siç është te Friedman, pra edhe theksimet në tekst janë nga Friedmani:

(19) Izpărvo **raboteh** v dărvodelski artel, sled tova otidoh v zavpd, izučih se za šloser.

Në fillim **punova** në një artel të zdrukthtarëve, pastaj hyra në një uzinë dhe u bëra mekanik.

Në këtë shembull vërejmë se në fakt kemi tri folje: *raboteh*, *otidoh* dhe *izučih* në bullgarishte, kurse në shqipe: *punova*, *hyra*, *u bëra*. Në bullgarishte vetëm folja e parë është në imperfekt, kurse në gjuhën shqipe të gjitha janë në aorist. Por, besoj se edhe në gjuhën shqipe folja e parë mund të kalonte në imperfekt pa e prishur strukturën dhe rrjedhën e tekstit:

(20) Në fillim **punoja** në një artel ....

Ngjashëm është edhe me përkthimin e Karjagdiut. Edhe ky përkthim lejon kalimin e foljes së parë nga aoristi (21a) në imperfekt (21b):

(21) a. Ma parë **punova** në kooperativën e zdrukthtarëve, pastaj hyna të punoj në fabrikë dhe nxuna zanatin e mekanikut.

b. Ma parë **punojsha** në kooperativën ...

Vendosja e foljes së parë, në bullgarishte apo në shqipe, në amper-

fekt besoj është në pajtim me parimet e përgjithshme të organizimit të diskursit[34]. Funksioni i tij në këtë rast do të ishte në ndërtimin e bazës gjegjësisht prapavijës (background) për ngjarjet më shumë të spikatura (foreground) të sekuencës. Arsyeja pse përkthyesit në shqipe parapëlqejnë më shumë aoristin, e jo imperfektin, siç vepron përkthyesi në gjuhën bullgare (dhe turke), ka të ngjarë se është bërë për shkaqe stilistike, por mund të jetë që kundërvënia aspektore te bullgarishtja (dhe turqishtja) ka më shumë fleksibilitet kuptimor.

Në përgjithësi, vendosja e imperfektit në sekuencë dhe çuarja e boshtit narrativ përpara në shqipe dhe në bullgarishte është një konstatim shumë i rëndësishëm, sidomos nëse kihet parasysh se disa studiues e mohojnë një gjë të tillë[35]. Ky mohim besoj është më shumë i bazuar në përkufizimin e entiteteve të diskursit siç janë: ngjarja, aktiviteti, procesi, gjendja etj. Lidhur me këtë çështje, mund të konstatohet: (i) Friedman-i nuk e pranon shfaqjen dikotomike të situatës: ngjarje dhe gjendje, siç e pamë te Smith. Ai parapëlqen shfaqjen trikotomike: ngjarje, aktivitet dhe gjendje[36], dhe (ii) në tabelën e sipërme në (2) vërejmë se aktiviteti mund të jetë durativ plus telik, sepse mund të ketë një përfundim natyror të pritur. Kjo ishte edhe arsyeja pse në tabelën (3) tiparin telik e shënuam me [-/+]. Kurse, gjendja është vetëm durative.

(22) Në fillim **punoja** në një artel ...

Mirëpo, vendosja nga aoristi në imperfekt nuk mund të bëhet edhe për shembujt e tjerë të gjuhës shqipe. Ata i takojnë personazhit e jo narratorit. Kjo do të thotë se, ose gjuha shqipe, në krahasim me bullgarishten, ndjek strukturën *code parlé* dhe *code écrit*[37] më me përpikëri, ose gjuha bullgare ka opsione më shumë se shqipja. Sipas Söll, për shkak të redundancës dhe kushteve të tjera të komunikimit, *code parlé* merr vetëm

[34] Shiko lidhur me këtë çështje Smith (2003:34), Weinrich (2001), Hopper (1982)

[35] Descles & Guentcheva (:258)

[36] Friedman (2004: 297),

[37] Lidhur me konceptet *code parle* dhe *code écrit* dhe modelin komunikues të bazuar në këto koncepte shiko Söll (1985:17)

format e plota gjegjësisht ngjarjet e përmbyllura siç është aoristi[38]. Kjo është gjithashtu në përputhje me Weinrich[39], i cili për frëngjishten po ashtu pohon se te *code parlé* përdoret *passé simple*. Arsyeja e një fleksibiliteti më të madh të bullgarishtes në përdorimin e imperfektit mbase mund të qëndrojë tek determiniviteti kohor i Dickey-t dhe aftësia e IPF-Aoristit të bullgarishtes, i cili dallon tërësinë dhe kufizimin kohor të situatës. Nëse është kështu, atëherë besoj se edhe pohimi i Kabakčiev-it, se IPF-Aoristi nuk ka ndonjë efekt pragmatik, nëse kihet parasysh shpjegimi i sipërm dhe konstatimi i Friedman-it, bëhet i paqëndrueshëm. Padyshim se kjo nuancë shtesë kuptimore e imperfektit në bullgarishte, për shkak të pranisë së aspektit të mbirenditur, i jep bullgarishtes fleksibilitet më të avancuar, prandaj edhe parapëlqimi i dy përkthyesve të shqipes, për të përdorur aoristin në vend të imperfektit në shembullin 5. të Friedman-it nuk mund të jetë i papritshëm.

Në punim bie në sy edhe ngjashmëria e përdorimit të imperfektit në bullgarishte dhe turqishte gjatë shënimit të sekuencave. Mirëpo, sipas Friedman-it[40], ato nuk janë izomorfike dhe vija e ndërsjellë kufizuese e këtyre ngjashmërive kërkon hulumtim shtesë. Prandaj, lidhur me turqishten, në këtë punim, po veprojmë në mënyrë identike.

4. Lidhja ndërmjet nyjës dhe aspektit

Izomorfizmi relativ te përdorimi i kundërvënies aspektore të nënrenditur ndërmjet bullgarishtes, shqipes dhe turqishtes dhe pozicionimi i shqipes ndërmjet këtyre të dyjave, ngre vetvetiu pyetjen: nëse nuk është rezultat i ndikimit ndërgjuhësor, atëherë a është ky rezultat i strukturave përkatëse të gjuhëve? Një tjetër pozicionim i ndërmjetshëm dhe struktural i shqipes, mund të konsiderohet edhe sistemi i nyjave. Sepse, shqipja ka nyjën e caktuar ashtu si të pacaktuarën. Kurse, bullgarishtja ka vetëm

[38] Një dukuri e tillë ka edhe mbështetjen kognitive. Shiko Leiss (1992:151)

[39] Weinrich (2001: 31)

[40] Friedman (2004: 298)

nyjën e caktuar, ndërkaq turqishtja vetëm të pacaktuarën. Natyrisht, pohimi i mostranisë së nyjës së pacaktuar të gjuhën bullgare përkatësisht pranisë së saj në gjuhën turke nuk është një çështje që përvetësohet nga të gjithë. Një çështje e tillë kontestohet nga shumë studiues, për bullgarishten pikërisht nga Friedman-i[41], kurse për turqishten Crisma dhe Longobardi[42]. Mirëpo, tradicionalisht e sidomos në librat gramatikorë (tradicionalë) këto diskutime nuk janë marrë parasysh. Me fjalë të tjera, sipas drejtshkrimit të këtyre gjuhëve vlen konstatimi i parë. Prandaj, për këtë punim do të supozojmë kushtimisht se pozicionimi i ndërmjetshëm i shqipes lidhur me kundërvënien aspektore, është rezultat i pozicionimit të ndërmjetshëm të shqipes lidhur me sistemin e nyjave ndaj bullgarishtes dhe turqishtes. Siç do të shohim në vijim, pavarësisht se nyja e aspekti u takojnë domeneve të ndryshëm (nominal përkatësisht verbal), kjo hipotezë ka një bazë solide, sepse pikërisht aspekti (leksikor[43]) paraqet pikëtakimin ndërmjet domenit nominal dhe verbal[44]. Një evidencë e tillë u dëshmua më sipër nëpërmjet shembujve (4) dhe (5). Nëse kihet parasysh se diagrami i Friedman-it është bazuar në krahasimin aspektit të nënrenditur gramatikor, atëherë në shikim të parë mund të pandehet se futja e nyjave në këtë kontekst nuk është një veprim i qëlluar. Mirëpo, nëse kemi parasysh diagramin tjetër (13), pra diagramin e shtresimit të aspektit gjegjësisht relacionit hierarkik ndërmjet aspektit gramatikor dhe aspektit leksikor, dhe marrim parasysh ndikimin e shtresave të epërme në shtresat më të ulëta, atëherë futja e nyjave në këtë kontekst duket një veprim logjikisht i kapshëm. Një gjë e tillë mbështetet edhe nëpërmjet të dhënave të gjuhëve të ndryshme. Kështu p. sh. filandishtja përdor kombinimin e morfologjisë rasore për të shprehur referencën nominale dhe aspektin verbal[45], kurse gjuhët sllave, të cilat nuk e kanë sistemin e nyjave (p. sh.

[41] Friedman (1973) dhe Friedman (199)

[42] Crisma (1997) Longobardi (2001), të dy këta studiues pohojnë se nyja e pacaktuar (indefinite) nuk mund të shfaqet nëse nuk është e pranishme nyja e caktuar (definite).

[43] Shiko Filip (2012)

[44] Shiko Abrashi (2011)

[45] Shih Leiss (2002)

rusishtja), përcaktimin e referencës nominale e bëjnë vetëm duke përdorur kombinimin e aspektit dhe rasave[46]:

(23) a. On kolol$_{IMP}$ drova $_{ACC}$ (rusisht)
He chops wood. (anglisht)
Ai priste dru. (shqip)
b. On **ra**-skolol$_{PRF}$ drova $_{ACC}$ (rusisht)
c. On **ra**- skolol $_{PRF}$ drov $_{GEN}$
He chops **the** wood. (anglisht)
He chops wood.
Ai preu dru-**të**. (shqip)
Ai priste dru.

Nëse krahasojmë shembujt në (23a) dhe (23b), atëherë vërejmë se me anë të prefiksit aspektor -***ra*** të foljes, shprehja e pacaktuar në shembullin (23a) shndërrohet në shprehje të caktuar në shembullin (23b). Kjo mund të vërehet edhe me praninë e nyjës së shquar në përkthimin e kësaj shprehjeje në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe. Nga ana tjetër, nëse në shembullin (23b) kundrinën e gjuhës ruse e vendosim në gjenitiv, shprehja bëhet e pacaktuar (23c). Pra, ekziston një ndërlidhje evidente ndërmjet domenit verbal dhe atij nominal.

Po si realizohet ndërlidhja ndërmjet domenit verbal dhe atij nominal në gjuhën shqipe? Si në gjuhët e tjera që kanë nyja: nëpërmjet aspektit leksikor. Këtë çështje e prek edhe Cipoja në faqen 50 të sintaksës së tij ku shpjegon praninë e aspektit leksikor dhe rolin e përcaktorëve në kufizimin e kohëzgjatjes së situatave. Por, e mundshme është edhe e kundërta: aspekti i nënrenditur[47] mund të shndërrojë një shprehje gjeneralizuese në shprehje individualizuese:

(24) a. Zogu fluturon. (shprehje gjeneralizuese)
b. Zogu fluturonte. (shprehje individualizuese)

[46] Shih Leiss po aty, dhe Kramsky (1972)

[47] Lidhur me shndërrimin në shembullin (24), disa studiues pohojnë se është rezultat i të ashtuquajturave kohërave relative e jo aspektit. Lidhur me kohërat relative dhe absolute shiko Comrie (1976)

c. Zogu fluturoi. (shprehje individualizuese)

a. Nita hante mollë. (IMF)

b. Nita hëngri mollë. (AOR)

Në shembullin (25b), për dallim nga shembulli (25a), situata është e kufizuar për shkak të aoristit.

Sipas Kabakčikiev-it[48] në gjuhën bullgare aspekti mund ta përcaktojë referencën e sintagmës nominale:

(25) a. Životno-to ležeše$_{ImpIMP}$ v treva-ta bez da pornradva$_{Imp}$

Animal-the lay in grass-the without to move

The animal lay in the grass without movement'

Kafsha shtrihej e palëvizshme në bar.

b. Deca-ta zabeljazaha$_{pfvAOR}$ ptica-ta v dărvo-to, zaštoto tja napravi$_{pfvAOR}$ dviženie

Children-the noticed bird-the in tree-the, because it made movement

The children noticed the bird in the tree because it made **a** movement'

Fëmijët vërejtën zogun në bar sepse ai bëri **një** lëvizje.

Për shkak se folja *napravi* në shembullin (26b) ka aspektin e mbirenditur perfektiv dhe aspektin nënrenditur aorist vërejmë se në përkthimin përkatës, në anglishte shfaqet nyja e pacaktuar ***a*** dhe nyja e pacaktuar ***një*** në gjuhën shqipe, të cilat nuk janë të pranishme në përkthimet e shembullit (26a). Ngjashëm mund të thuhet edhe për shembullin në vijim:

(26) Momče-to hvărli$_{pvfAor}$ kamăk.

Boy-the threw stone

'The boy threw **a** stone'

Djal-i gjuajti (**një**) gurë (gur-**in**).

Një dukuri e tillë mund të vërehet edhe te shembulli (3) i Friedman-it:

(27) a. Namačkah v dlanite si žarna, podăvkah malko iv džobovete si nasipah za zapas...

[48] Kabakčikiev (2000: 221)

b. I husked **some** of the grains in my palms, chewed a little bit and put some in my pocket as reserve.

c. Çkoqa **ca** kokrra tërshërë me dorë, hëngra pak dhe pastaj i mbusha xhepat që të kem rezerva.

Në shembujt përkatës në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe vërejmë praninë e kuantorit ***some*** përkatësisht ***ca***. Një kuantor i tillë në shembullin bullgar mungon sepse folja *namačkah* është perfektive.

Në bullgarishte shfaqet edhe e kundërta: kundrina ndikon në kufizimin e ngjarjes. Një dukuri e tillë vërehet te foljet biaspektuale. Meqë këto folje, siç pamë më sipër, kanë vetëm aspektin e nënrenditur, për të kufizuar situatën, kundrina duhet të jetë e shoqëruar me nyjë. Kjo mund të ilustrohet nga shembulli i marrë nga di Scullio & Slabakova[49]:

(28) a. Mexanicite remontiraxa $_{Impf}$ koli

mechanics-DET repair-3pS/PAST cars

'The mechanics repaired cars.'

Mekanikët riparonin vetura.

b. Mexanicite remontiraxa $_{Imp}$ koli-te

mechanics-DET repair-3pS/PAST cars-DET

'The mechanics repaired the cars.'

Mekanikët riparonin veturat.

Duke vendosur nyjën shquese në (29b) situata atelike në (29a) shndërrohet në situatë telike (29b). Për Kabakčiev-in kjo mund të jetë edhe arsyeja pse në bullgarishte aoristi, për dallim nga gjuhët e tjera sllave, mbijetoi. Ndërkaq, për përdorimi jo rrallë arbitrar i nyjës kuazi të pacaktuar *edin*, siç e quan ai, ndodh për shkak të pranisë së aspektit të nënrenditur të foljes në gjuhën bullgare. Përdorimin arbitrar të nyjës indefinite të bullgarishtes e pohojnë disa studiues [50]. Është interesant se pikërisht përdorimi arbitrar i nyjës në gotishten dhe islandishten e vjetër, për

[49] Di Sculio & Slabakova (2005: 70)

[50] Shih: Gorishneva (2013), Geist (2013), Mladenova (2007)

Leiss[51], Abraham[52] dhe Philippi[53] është e dhënë për demontimin e sistemit aspektor te këto gjuhë, dhe si balancim për këtë humbje, fillon të shfaqet nyja e shquar. Arbitrariteti shpjegohet si efekt dytësor i fazës transitore: rënia e plotë e sistemit aspektor, nga njëra anë, dhe etablimi i sistemit të nyjave, në anën tjetër. Si nxitës dhe njëherësh edhe ngasës i këtij procesi, supozohet se ishte struktura informative e fjalisë dhe humbja e kundrinës së gjenitivit[54].

Sidoqoftë, si përfundim mund të themi se u konstatua lidhja e aspektit dhe nyjës në bullgarishte: përdorimi i aoristit për nevoja të domenit nominal dhe përdorimi i nyjës (së caktuar dhe të pacaktuar) për nevoja të domenit verbal. Mirëpo, fakti se këto përdorime nuk janë apostafat të lidhura me nyjën indefinite *edin,* por përfshijnë edhe përdorimin e nyjës së shquar, na lë të kuptojmë se për supozimin e shtruar kushtimisht më sipër nuk ka evidencë të mjaftueshme empirike

Edhe në gjuhën turke ekziston ndërlidhja ndërmjet domenit nominal dhe verbal, që pikë takuese kanë aspektin leksikor. Prandaj, pohimi për ndikimin e aspektit[55] në përcaktimin e referencës nominale nuk është i papritshëm edhe në këtë gjuhë. Madje, për shkak të mungesës së nyjës së caktuar, domeni nominal është i ndjeshëm ndaj dallimeve aspektore. Turqishtja ka zhvilluar një sistem interesant të përcaktimit të referencës definite dhe specifike. Lidhur me këtë ajo përdor rasat: akuzativin për referencën e kundrinës dhe gjenitivin për referencën e kryefjalës[56]. Përveç kësaj, ajo përdor edhe strukturën informative të fjalisë gjegjësisht raportin Thema-Rhema, por edhe nyjën indefinite *bir*. Në shembujt e Friedman-it nuk mund të gjendet, si në bullgarishte, ndonjë e dhënë konkrete që tregon lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet mungesës së nyjës definite në tur-

[51] Leiss (2000), (2007)

[52] Abraham (1997)

[53] Philippi (1997)

[54] Shih lidhur me këto çështje edhe Abrashi (2011)

[55] Göksel & Kerslake (2005: 334), Kornfilt (1997 :280)

[56] Johanson (2006)

qishte dhe aspektit. Meqë edhe tentimet për të gjetur ndonjë të dhënë konkrete lidhur me këtë çështje, në literaturën e bollshme[57], u treguan të pasuksesshme, mbetet të kuptojmë se përputhjet dhe mospërputhjet e përdorimit të aspektit të nënrenditur në këtë gjuhë me gjasë kanë të bëjnë me ndonjë arsye tjetër më parë se sa me mungesën e nyjës definite.

5. Përmbyllje

Duke u nisur nga pohimet e Friedman-it (2004) se shqipja qëndron ndërmjet bullgarishtes dhe turqishtes në përdorimin e aoristit/ amperfektit si dhe aftësinë e imperfektit në shqipe dhe bullgarishte për të shënuar edhe ngjarjet kryesore në sekuencën e situatave, punimi tenton të bëjë disa sqarime rreth këtyre dukurive. Në punim konfirmohet lidhja ndërmjet aspektit dhe nyjave, jo vetëm për shkak të aspektit leksikor, i cili është pikëtakim ndërmjet domenit nominal dhe verbal, por edhe për shkak të ndikimit të aspektit gramatikor në përdorimin e nyjave. Mirëpo, këto të dhëna nuk sigurojnë argumente të mjaftueshme për supozimin fillestar se mungesa (e kushtëzuar) e nyjës indefinite në bullgarishte dhe mungesa e nyjës definite në turqishte, janë arsyet e pozicionit të ndërmjetshëm të shqipes lidhur me aspektin, pasi sistemi i nyjave të kësaj të fundit i ka të dy nyjat. Punimi ka porosi edhe lidhur me organizimin e diskursit: gjuha bullgare, e cila përveç aspektit të nënrenditur ka edhe aspektin e mbirenditur, tregon fleksibilitet më të madh në krahasim me gjuhën shqipe lidhur me imperfektin për shkak të pranisë së aspektit të mbirenditur.

[57] P.sh. Aksu-Koç (1988)

Teuta ABRASHI, Philological Fac ulty of the University of Prishtina

CONNECTION BETWEEN ASPECTUAL OPPOSITION AORIST/ IMPERFEKT, DISCOURS ORGANIZARTION AND ARTICLES

Summary

Based on Friedman's (2004) claims that Albanian, towards Bulgarian and Turkish, occupies the mid position regarding the use of the subordinate aspect and the ability of Bulgarian and Albanian imperfect to be used for sequential main events, this article is trying to give some additional explanations concerning those claims. Despite the tight relation between aspect and definite/ indefinite article, which can be shown for Albanian and Bulgarian, there is no sufficient evidence which can show the direct correlation between mid aspect position for Albanian and the article systems of languages under investigation. Concerning the second of Friedman's claim, the article concludes that Bulgarian is showing more flexibility in using imperfect towards Albanian, due to the presence of super-ordinate aspect, which is not present in Albanian.



Literatura:

Abraham, Werner (1997): *The interdependence of case, aspect and referentiality in the history of German: the case of verbal genitive*, në: Ans van Kemenade & Nigel Vincent: Parameters of morphosyntactic change, Cambridge University Press

Abrashi, Teuta (2011): *Aspekt und Nominalreferenz im Deutschen*, në: Kristo, Ema et. al.: Sprachendiversität und Interkulturalität, Athena Verlag, Oberhausen, (127-144)

Abrashi, Teuta (2011): *Interplay zwischen NP und VP*, në: Nikolovska et. al.: Nomen est Omen- Name und Identität in Sprache, Literatur und Kultur, Skopje, (223-232)

Abrashi, Teuta (2014): *Lidhja kryefjalë-kallëzues: përshtatje, drejtim apo të dyja?*, Studime 21, ASHAK, Prishtinë, (325-340)

Aksu-Koç, Ayhan (1988): *The acquisition of Aspect and Modality-The case of the past reference in Turkish*, Cambridge University Press, Cambridge

Aronson, Howard (1981): *Towards a typology of aspect in the languages of the Balkan peninsula*, Folia Slavica Vol. 4, Numbers 2-3, 198-204

Boogaart, Ronny (2004):*Aspect and Aktionsart*, në: Boojis et. al.HSK-Morphologie, Vol. 2, De Gruyter, Berlin (1165-1180)

Brown & Miller (1999): *Concise encyclopedia of grammatical categories*, Elseviers Sciences, Oxford, UK

Crisma, Paola (1997): Nominals without the articles in the Germanic languages.

Declerck, Renaat (1979):Aspect and the Bounded/Unbounded (Telic/Atelic) distinction". *Linguistics* 17, 761-794

Descles & Guentcheva (1990): *Discourse Analysis of Aorist and Imperfect in Bulgarian and French*, Thelin, N.: Verbal aspect in discourse, Benjamins Publishing, Amsterdam

Di Sciullo, A.M & R. Slabakova (2005): *Quantification and Aspect*. Në van Hout, Angelik et. al.: Perspectives on Aspect., Henriëtte de Swart et Henk Verkuyl (eds), Springer, Dordrecht , (61-80)

Dickey, Stephen (1997): Parameters of Slavic Aspect, Dissertation, University of Indiana

Dhrimo, Ali (2008): *Çështje të sistemit foljor*, në: Për shqipen dhe shqiptarët 1, Infbotues, Tiranë, (234-444)

Filip, Han (2012): Lexical Aspect, në: Binnck: Handbook of Tense and Aspect, (721-750)

Fischer, Susann (2005): *Interplay between reference and aspect*, në: Klaus von Heusinger, Georg A. Kaiser & Elisabeth Stark (eds.): Specificity and the Evolution / Emergence of Nominal Determination Systems in Romance, Arbeitspapier 119, Konstanz

Fortuin, Egbert & Kamphuis, Jaap (2015): *The Typology of Slavic aspect: a review of the East- West Thory of Slavic aspect*, Russ Linguist 39, 163-208

Friedman, Victor (1973): *The question of a Bulgarian indefinite article*, Procedeengs of the First Internation Conference on Bulgarian Studies, University of Wisconsin , (334-340)

Friedman, Victor (1999): The Bulgarian indefinite article revisited in its Balkan context, Sixth joint meetingof Bulgarian and North American scholars, Blagoevgrad, (105-114)

Friedman, Victor (2004): *Aspectual opositions in Bulgarian, Albanian and Turkish*, në: Studies on Albanian and other Balkan languages, Dukagjini, Pejë

Friedman, V. (2012): *Language Contact*, në Binnick: Handbook of Tense and Aspect, (398-427)

Geist, Ludmila (2013): Bulgarian *edin*: The Rise of an Indefinite Article, në: Junghanns et.al.: Formal Description of Slavic Languages: The Ninth Conference. Proceedings of

FDSL 9, Göttingen 2011, Peter Lang, Frankfurt am Main, (25-148)
Göksel & Kerslake (2005): Turkish-A comprehensive Grammar, Routledge, New York
Gorishneva, Elena (2013): Bare vs. non-bare nouns-Two kinds of indefinites in Bulgarian, në: Kabatek, Johannes, and Wall, Albert, eds. New Perspectives on Bare Noun Phrases in Romance and Beyond, Benjamins Publishing Company, Amsterdam, (301-328)
Hewson & Bubenik (1997): *Tense and aspect in Indo-European languages: theory, typology, diachrony*, John Benjamins Publishing, Amsterdam
Hopper, Paul J. ed. (1982): *Tense-aspect: Between semantics and pragmatics.* (Typological Studies in Language, 1.), John Benjamins Publishing. Amsterdam & Philadelphia
Kabakčiev, Krasimir (2000): *Aspect in English-A "Common Sense" View of the Interplay between Verbal and Nominal Referents*, Springer, Dodrecht
Klein, W. (1995): A time-relational analysis of Russian aspect. *Language, 71/4*, 669-695
Kornfilt, Jaklin (1997): Turkish, Routledge, London & New York
Kramsky, Jiri (1972): *The Article and the Concept of Definiteness in Languages*, Mouton, The Hague
Krifka, Manfred (1989): *Nominalreferenz und Zeitkonstitution. Zur Semantik von Massentennen,. Pluraltermen und Aspektklassen.* München: Fink.
Lars, Johanson (2006): *Two approaches to specificity* , në: Kulikov, Leonid & Malchukov, Andrej & de Swart, Peter (eds.) *Case, valency and transitivity*. (Studies in Language Companion Series 77.), John Benjamins, Amsterdam, (225-247)
Lehmann, Christian (1999): *Aspectual Type(s)*, në: Brown & Miller , (43-49)
Leiss, Elisabeth (1992): *Die Verbalkategorien des Deutschen-Ein Beitrag der sprachlichen Kategorisierung*, Walter de Gryter, Berlin
Leiss, Elisabeth (2000): *Aspekt und Artikel-die grammatische Muster von Definitheit*, Walter de Gruyter, Berlin
Leiss, Elisabeth (2007: 94): *Covert patterns of definiteness/indefiniteness and aspectuality in Old Icelandic, Gothic and Old High German*; në: Stark, Elisabeth; Abraham Werner, Leiss, Elisabeth Ed.: Nominal Determination: Typology, Context Constraints, and Historical Emergence, John Benjamins Company, Amsterdam
Lewis, Geoffrey (2000): *Turkish language- Grammar*, Oxford University Press, Oxford
Lindstedt, Jouko (2001): *Tense and Aspect*, in Haspelmath et. al: HSK-Language Typology Vol. 2, 768-783, De Gryuter, Berlin
Longobardi, Giussepe (2001): The structure of DPs: some principles, parameters and problems". *The Handbook of Contemporary Syntactic Theory,* Baltin, Mark, and Chris Collins, (eds.) Blackwell Publishers, 562-601.
Mladenova, Olga (2007): *Definiteness in Bulgarian- modelling the processes of language change*, de Gruyter, Berlin
Ms., Universita Di Padova
Philipi, Julia (1997): *The rise of the article in Germanic languages*, në: Ans van Kemenade & Nigel Vincent: Parameters of morphosyntactic change, Cambridge University Press
Smith, Carlota (1997): *The Parameter of Aspect*, Springer, Dodrecht
Smith, Carlota (2003): *Modes of Discourse-The local structure of text*, Cambridge University Press, Cambridge
Söll, Ludwig (1985): *Gesprochenes und geschriebenes Französisch*, Erich Schmidt Verlag, Berlin
Swart, Henriette de (2012): *Verbal Aspect*, në: Binnick, Robert: The Oxfrord Handbook of

Tense and Aspect, OUP, Oxford, 752-780
Vendler, Z. 1967. 'Verbs and Times'. *Linguistics in Philosophy.*Ithaca: Cornell University Press
Verkuyl, Henk (1993): *A theory of aspectuality: the interaction between temporal and atemporal structure*, Cambridge University Press, Cambridge
Weinrich, Harald (2001): *Tempus*, Beck Verlag, Muenchen

Linditë SEJDIU-RUGOVA, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë

KUNDËRVËNIET ASPEKTORE BRENDA SHQIPES NË STUDIMET E FRIEDMAN-IT DHE NË STUDIMET E SOTME TË SHQIPES

Gramatikat e shqipes në përgjithësi i kushtojnë pak ose aspak hapësirë aspektit si kategori gramatikore. Në gramatikën e ASHRSH-së, aspekti nuk përaktohet si kategori foljore më vete (siç kategorizohen veta, numri, mënyra, diateza dhe koha), por flitet për "forma gramatikore foljore që, përpos kuptimeve kohore, shprehin edhe ngjyrime të ndryshme aspektore" (Gramatika I, 1995: 274). Po aty, thuhet se dallimet midis së pakryerës, së kryerës së thjeshtë dhe së kryerës kanë më fort karakter aspektor varësisht nga mënyra e paraqitjes së veprimit: si të përfunduar, si të papërfunduar ose si veprim në zhvillim e sipër në një çast të së shkuarës (Gramatika I, 1995: 274) .

Albanologu amerikan Victor Friedman është ndër të rrallët që ndalet dhe e studion më detajisht këtë kategori. Ai në punimin e tij "Aspectual Oppositions in Bulgarian, Albanian, and Turkish" të botuar në vëllimin "Studies on Albanian and other Balkan Languages" (2004: 291), i krahason disa tipare aspektore të shqipes në raport me bullgarishten dhe turqishten dhe arrin në përfundimin se sa i përket kundërvënies aspektore aorist/ imperfekt, ndryshe nga bullgarishtja dhe turqishtja, të cilat e parapëlqejnë imperfektin, shqipja e zgjedh të kryerën (aoristin) në një strukturë të varur që shpreh sekuencë ose fillim të një veprimi dhe gjatë përkthimit nga gjuhët e tjera në shqipen, aoristi përshtatet mirë me çfarëdo gjuhe që përdor aorist (Friedman 2004:299). Ky punim është një nga punimet e pakta të kësaj periudhe që merret me studimin e aspektit të

shqipes si kategori e mëvetësishme gramatikore, qoftë edhe në këndvështrim krahasimtar, me atë të gjuhëve të tjera ballkanike.

Friedman-i (2004:291) thekson se në kontekstin e gjuhësisë ballkanike aspekti është konsideruar si kategori gjuhësore që shpreh qëndrim folës drejt informacionit të dhënë nga folja ose drejt burimit të atij informacioni, të klasifikuar si mënyrë, evidencialitet apo këndvështrim. Ai merret me të shprehurit gramatikor të aspektit foljor në shqipen si pjesë e krahasimit me bullgarishten dhe turqishten. Studimi i tij mbështetet në të dhënat e nxjerra nga një korpus i përkthyer drejtpërsëdrejti nga rusishtja në bullgarishten, turqishten dhe në shqipen (Mihail Sholohov: The Fate of [a] Man) dhe objekt i studimit të Friedman-it është kundërvënia apo dallimi i mbirenditur perfektiv / joperfektiv te aoristi dhe imperfekti. Friedman-i i vëren gjashtë modele të mundshme të kombinimit të mospërputhjes imperfekt / aorist në këto tri gjuhë (Friedman, 2004: 294). Shumica e shembujve të përkthimit që ai i analizon i takojnë, sipas tij, modelit nr. IV dhe modelit nr. I (aoristi në shqipen dominon në të dy modelet, ndonëse në turqishten dhe në bullgarishten koha foljore lëviz brenda këtyre modeleve të kombinimit). Shqipen ai e sheh si gjuhë të ndërmjetme për shkak se është indoeuropiane (njëjtë si bullgarishtja), por që nuk ka kundërvënie aspektore mbirenditëse (njëjtë si turqishtja) (Friedman, 2004: 297). Friedman-i, nëpërmjet këtij hulumtimi, arrin ta mbështesë mendimin e përgjithshëm gjuhësor se sa më shumë tregues gramatikorë që ka një kategori apo formë e caktuar gramatikore në një gjuhë, aq më pak do të korrespondojë me kategorinë apo formën e njëjtë në gjuhën tjetër. Friedman-i është ndër të paktit në gjuhësinë shqiptare që e vëren se imperfektiviteti nuk shpreh domosdoshmërisht vazhdimësi të baraskohshme (*Derisa ti laje enët, unë të vështroja nga pas*.), por mund të shprehë edhe ngjarje të njëpasnjëshme (*Unë laja enët, bëja punët e shtëpisë dhe më pas shkoja në treg)*.

Një përshtatje e tillë me gjuhët e tjera gjatë përkthimit në rend të parë i hap rrugë mendimit shkencor se studimi i aspektit ndihmon edhe në përcaktimin e tipologjisë së tekstit. Një hipotezë të tillë do ta shyrtojmë në këtë studim, pra do të merremi me studimin e aspektit të shqipes si

pjesë e një teksti dhe do ta kundrojmë si kategori gramatikore që ndikon në përcaktimin e tipit apo të formës tekstore. Këtë e thonë edhe gramatikat e shumta të tekstit, por a ndikojnë gjithmonë perfektiviteti, imperfektiviteti dhe durativiteti apo iterativiteti në përcaktimin e formës së caktuar tekstore? Do të përpiqemi t'i përgjigjemi një pyetjeje të tillë duke analizuar fragmente të caktuara të nxjerra nga korpusi i përdorur gjatë përpilimit të librit Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe (2015).

Aspekti – definicione dhe studime

Në studimet e sotme, aspekti si kategori gramatikore lidhet ngushtë me qëndrimin folës dhe me mënyrën se si folësi e sheh apo e paraqet situatën e komunikimit nga aspekti kohor (këtu termi kohë ka të bëjë me kohën si temp a rrjedhë veprimi, jo si kohë foljore) - pra, mënyra se si veprimi i shprehur nga folja konsiderohet ose përjetohet në raport me kohën si koncept universal (Quirk et al, 2002: 188). Po qe se e shohim nga brenda aspektit kohor, kemi të bëjmë me aspektin progresiv (të vazhdueshëm), ndërkaq nëse e kundrojmë si një proces kohor, ku ajo si emetuese nuk mund të ndërhyjë në rrjedhën e atij procesi, atëherë kemi të bëjmë me aspektin joprogresiv.

Në terma të Huddleston-it, interpretimi i kategorisë së kohës, të mënyrës dhe të aspektit në një gjuhë do të duhej të bëhej varësisht nga lloji i situatës së komunikimit të shprehur në një fjali të caktuar të asaj gjuhe (Huddlestone 2002:118). E kjo situatë mund të jetë statike ose dinamike. Kështu, duke u mbështetur në terma të tillë, në shqipen mund të flasim për situata të komunikimit që shprehin gjendje: *Ata besojnë në Zot! Më pëlqen! Flamuri i Shqipërisë, është i kuq!* ose për një situatë dinamike që shpreh një proces aktiviteti: *Ne po luajmë futboll. Unë ia lexoja përrallën Gresës. Eca gjatë në plazh.* Një situatë të caktuar mund ta interpretojmë si telike (situatë e kryer, me një pikë përfundimi) që i përmbledh arritjet tona: *Erdha këmbë deri në shtëpi. Ajo e shkroi librin. Erdha këmbë në shtëpi. (Eca deri në shtëpi)* ose si një situatë që nxjerr në pah arritjet tona gjatë një procesi*: E gjeta portofolin! (isha duke e kërkuar), Po e mbyll*

këtë seancë... (ishim duke diskutuar) etj.

Këto situata nganjëherë mund të dalin të kombinuara dhe shpeshherë janë treguesit kohorë që e bëjnë dallimin dhe na mundësojnë një interpretim të saktë. Në këtë mënyrë fjalia: *Unë i bëra 5 km atë ditë*. do të mund të interpretohej edhe si situatë që shpreh një aktivitet në një rast të caktuar, por mund të implikojë edhe idenë se "unë e kisha zakon të ecja vazhdimisht çdo ditë".

Të gjitha këto situata kuptimore të aspektit na çojnë drejt aspektualitetit si kategori semantike, e cila mund të kategorizohet në dy kategori themelore: aspekti i kryer dhe jo i kryer. Shqipja ka shënjues gramatikorë të këtij kategorizimi dhe ndër më themelorët janë mbaresat vetore të së pakryerës dhe të së kryerës së dëftores: puno-ja (imperfekti) dhe kam punuar (perfekti) kundruall mbaresës së të kryerës së thjeshtë: punova (aoristi). Pra, shqipja, ngjashëm me disa gjuhë indoeuropiane, e ka ruajtur sistemin tretermësh, si pasojë e dallimit binar aspektor: perfektiv/ joperfektiv dhe durativ/ jodurativ.

Lyons-i (1968:315) e konsideron aspektin shpërndarje në kohë, ndryshe nga koha foljore që paraqet vendndodhje në kohë. Sipas tij, aspekti, ndryshe nga koha foljore, nuk është koncept deiktik, pra nuk kundrohet në raport me momentin kohor të të thënit.

Megjithatë, situatat e ndryshme të komunikimit na dalin shpeshherë të shumëkuptimshme edhe brenda vetë trajtës së caktuar aspektore. Po qe se i analizojmë fjalitë: *a) Punoja në fabrikë* dhe b) *Po punoja me zell* dallimi aspektor nuk është i dukshëm, derisa nuk e klasifikojmë situatën e tillë të komunikimit si gjendje (isha i punësuar në fabrikë atëbotë) dhe si aktivitet a proces dinamik (punoja me zell-akti i të punuarit).

Këtë dallim brenda aspektit jo të kryer të shqipes, e që në të vërtetë e shpreh një gjendje të papërfunduar a iteracion (punoja) në raport me aoristin, i cili shpreh situata të vetme të përfunduara ose të njëpasnjëshme e të kufizuara nga aspekti kohor (punova), Breu (2010:451) e sheh si reduktim të imperfektit të thjeshtë, meqë, sipas tij, po zëvendësohet vazhdimisht me struktura perifrazuese me këtë funksion (*isha duke punuar, jam duke punuar*). Duhet theksuar se Breu (2010:451) brenda një

dallimi të tillë aspektor e fut edhe dallimin brenda progresivitetit të së tashmes (po punoj/ jam duke punuar). Rrjedhimisht, Breu mendon se dallimi i mirëfilltë aspektor aorist/ imperfekt po zbehet, duke i lënë vend dallimit *e tashme (punoj)/ e kryer (kam punuar*) si dhe raportit aspektor të së shkuarës: *e pakryer (punoja)/ e kryer e tejshkuar (pata punuar).*

Mindak (1985:49), ndërkaq, vëren një dallim të ngjashëm brenda aoristit të shqipes (si sinonim i aspektit perfektiv) dhe thekson se edhe brenda vetë aoristit të shqipes ekziston një nuancë durative që e bën këtë kohë foljore jo plotësisht perfektive. P. sh.: *Kjo gjendje vazhdoi për një kohë të gjatë*, ku segmenti kohor për një kohë të gjatë, sipas Mindak, bën që aoristi i shqipes të mos paraqitet në boshtin kohor në formë të pikës, por në formë të një segmenti ose të disa segmenteve: *Një kohë pipëroi me kapakët e kuq, kurse pastaj ia dha gazit hareshëm*. (Mindak, 1985: 53). Sadiku (1976) opozicionin perfekt/ aorist të shqipes e lidh me kuptimin leksikor të foljes.

Për aspektin e shqipes

Ali Dhrimo e definon aspektin si "mënyrë e ndryshme e përftyrimit të ecurisë së veprimit" (Dhrimo, 2008: 238). Ai mbështetet në një ndarje dyvalente të aspektit në shqipen, duke u mbështetur kryesisht në ndarjet që i janë bërë aspektit në traditat europiane të kohës (është një nga gjuhëtarët e parë shqiptarë që merret me aspektin e shqipes më detajisht).

Para Dhrimos, për aspektin shkruan edhe Cipoja (1952: 49, 50) në Sintaksën e tij, duke e quajtur aspektin të maturit që mund t'i bëjmë një veprimi të shprehur me folje, pastaj Riza (Tiranë, 1994), i cili merret me aspektin në Gramatikën e tij të shqipes letrare e njeh aspektin dytipësh të foljeve vetëm për dy nga tri shkallët e kohës së kaluar të mënyrës dëftore, në veçanti për kohët e pakryera. Demiraj, ndërkaq, e mishëron thellë kategorinë e aspektit si veçori të kohëve të foljes dhe sipas tij janë kohët foljore si e kryera, e kryera e thjeshtë dhe e pakryera që e bëjnë dallimin aspektor ose kundërvënien aspektore, pra nuk kemi një klasifikim të aspektit si kategori më vete. Ai thekson se te koha e tashme dhe koha e pa-

kryer vërehen kundërvëniet kuptimore i caktuar – i pacaktuar dhe se këto dy kohë foljore karakterizohen nga aspekti i pakryer (Demiraj, 1988: 722). Edhe Buchholz dhe Fiedler (1987: 123,126,133) merren me këtë çështje, duke e trajtuar aspektin në terma të aspektualitetit dhe të aksionalitetit. E pakryera, sipas tyre, në kuptimin e saj jomodal kohor, është "e shkuar", ndërsa në kuptimin e saj jomdal aspektor është "e pakryer". Itirativiteti, sipas tyre, shprehet kryesisht me aksionalitet.

Ali Dhrimo fillimisht mbështetet në një ndarje dyvalente të aspektit në shqipen, duke u mbështetur kryesisht në ndarjet që i janë bërë aspektit në traditat europiane të kohës, por gjithnjë duke i shpjeguar edhe nënklasifikimet aspektore brenda binarizimit e kryer - e pakryer. Dhrimo e mbështet qëndrimin se edhe shqipja, ngjashëm me anglishten, mund të kundrohet si gjuhë me aspekt të vazhdimësisë dhe klasifikimi që ai u bën mënyrave foljore është një nga më të veçantit në gjuhësinë shqiptare. Sipas tij, aspekti është subjektiv meqë shpreh këndvështrim folës, prandaj kuptimi leksikor i foljes nuk është qenësor në përkufizimin e aspektit (Dhrimo, 2008: 252). Pra, në kuptimin e gjerë të fjalës, folësi mund ta paraqesë aspektin si rezultat apo si rrjedhje të veprimit, pra folësi mund të futet në veprim dhe të mos merret me fillimin dhe përfundimin e veprimit apo edhe të qëndrojë karshi tij, ta kundrojë nga jashtë dhe ta dijë saktësisht se kur fillon e kur përfundon veprimi i caktuar (Sosyri, 161-162). Dhrimo, duke u mbështetur në shumë autorë të shkollave të ndryshme europiane, e kundron aspektin e shqipes me shumë saktësi dhe thekson se te aspekti i kryer folësi e rrok veprimin si të tërë, ndërkaq te aspekti i pakryer folësi ndodhet brenda rrjedhës së ngjarjes (Dhrimo, 2008:257), ngjashëm me Quirk-un (2002). Dhrimo jep një nga studimet më të thelluara të teorisë së aspektit në shqipen, duke e klasifikuar atë si kategori gramatikore të veçantë (ndonëse jo klasike me tregues të drejpërdrejtë formalë), por gjithnjë duke u mbështetur në subjektivitetin që shpreh aspekti, ai përpiqet të gjejë trajta kundërvënëse kuptimore aspektore brenda së njëtës kohë foljore dhe thekson se në shqipen nuk mund të aplikohet plotësisht kundërvënia e kryer - e pakryer si te gjuhët sllave (Dhrimo, 2008: 285).

Aspekti i shqipes si kategori tekstore

Meqë studimet e tekstit e vështrojnë aspektin si pjesë të këndvështrimit apo qëndrimit folës, do ta analizojmë aspektin si pozitë folëse apo si pozicionim mendor dhe fizik i folësit, pra zgjedhje e folësit se në çfarë mënyre do t'u qaset fenomeneve, gjendjeve a veprimeve në raport me segmentet kohore, të cilave folësi u referohet. (Werlich, 1983: 133,146), por në suaza të tipit tekstor. Kundërvëniet aspektore vërehen posaçërisht te fjalitë që janë tipike për tipin tekstor deskriptiv dhe narrativ – te fjalitë që regjistrojnë fenomene (*simple phenomenon registering sentences* sipas Werlich-ut) dhe tek ato që regjistrojnë veprime (*action recording sentences,* gjithnjë sipas Werlich-ut), ndonëse nuk mungojnë as te fjalitë që i atribuohen cilësisë (tipike për tekstin argumentues): *Përfundimet e Elie Barnavit në esenë e saj të fundit "Les Religions Meurtrieres" (Religjionet vrastare) janë të titulluara "Kundër dialogut mes civilizimeve". Argumentet e saj janë këto: "Kur ke civilizim në njërën anë dhe barbari në anën tjetër, aty më nuk mund të ketë dialog". Po t'i shikosh hollë e hollë këto argumente, do të vërehen menjëherë boshllëqet. Vetë kuptimet e fjalëve civilizim dhe kulturë janë të ndryshme kur përdoren në njëjës dhe në shumës. (*marrë nga *Project Syndicate,* përkthimi Bardh Rugova), si dhe te fjalitë që i identifikojnë fenomenet (tipike për tipin shpjegues të tekstit në terma të Werlich-ut): *Nëse dy tinguj paraqiten saktësisht në të njëjtën pozitë fonike dhe nuk mund të zëvendësojnë njëri-tjetrin pa ndryshuar kuptimin e fjalëve ose pa u bërë e panjohur fjala, atëherë këta dy tinguj janë realizime të dy fonemave të ndryshme.* (N. S. Trubeckoi, *Parime të fonologjisë* [përkth. M. Bejta], Rilindja, Prishtinë, 1985)

Fjalitë që regjistrojnë fenomene në vete përmbajnë zakonisht folje joveprore a të gjendjes, si: *jam, duket, përmban*, *përbëhet,* etj. që u referohen dukurive në hapësirë, ndërkaq fjalitë që regjistrojnë veprime, përmbajnë folje veprore si: *vrapoj, lexoj, rritem, thëras*, etj., që ndryshe njihen si folje të veprimit ose të procesit dhe u referohen veprimeve që perceptohen në kohë.

Pra, tipat e ndryshëm te tekstit, si narracioni apo përshkrimi, ka-

rakterizohen me fjali dhe me idioma tekstore[1] specifike për një formë tekstore (format tekstore janë nënndarje të tipave të tekstit). Për të nxjerrë një pasqyrë reale të përdorimit aspektor në gjuhën shqipe, e sidomos për të nxjerrë në pah sa më qartë kundërvënien aspektore brenda një forme të caktuar tekstore është zgjedhur një korpus i caktuar tekstesh që në vete ngërthen tipat themelorë tekstorë me dominim të dukshëm aspektor: narracionin (shembulli b) dhe përshkrimin (shembulli a).

a) *[Nën dritare]* ***është*** *minderi i stolisur me mbulesat, dantella punëdore të nënës sime. [Nga ana e majtë]* ***gjendet i përgatitur*** *shtrati i ardhshëm i dhëndërisë për dajën dhe nusen. Shkëlqen nga çarçafët e mëndafshtë dhe jastëkët kadife me lule.* (B. Fehmiu, *E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme*, Koha, Prishtinë, 2011)

b) *E atje kah fundi* ***praptohen****…* ***Rrakadylen*** *nëpër borë.* ***Klithin*** *nga gëzimi.* ***Kacafyten, munden*** *njëri me tjetrin kapur lëmsh… Pastaj, duke tërhequr përsëri sajën "kallauz"* ***ngrihen*** *deri te maja e rrugës.* (B. Fehmiu, *E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme*, Koha, Prishtinë, 2011).

Aspekti eksplicit dhe aspekti implicit - analizë

Siç mund të shihet nga shembujt e mësipërm, tekstet për analizë janë nxjerrë kryesisht nga romani *E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme* i Bekim Fehmiut (KOHA, Prishtinë, 2011) dhe janë analizuar në një kotekst më të gjerë se ai i fjalisë – në kuadër të analizës së një paragrafi me formë dominante tekstore përshkruese ose narrative.

[1] Idioma tekstore e gjuhës ka të bëjë me strukturimin formal të elementeve tekstore të rendit më të ultë (pra, të fjalive dhe të periudhave) në një kontekst më të gjërë (në rastin më të shpeshtë brenda paragrafit). Shikuar nga aspekti i thjeshtë sintaksor, ka të bëjë me mënyrën e kombinimit të elementeve funksionale brenda fjalive, periudhave dhe të teksteve të tëra duke u mbështetur në paraqitjen strukturore të këtyre elementeve dhe në mënyrën më të rëndomtë të bashkëjetesës së tyre në një tekst. Kombinimi i brendshëm i elementeve strukturore të idiomës tekstore ndikon drejtpërsëdrejti në formën tekstore si dhe në tipin e tekstit. Pra, idioma tesktore varet nga faktorë kotekstualë të situatës së komunikimit, ndërkaq varietetet e tjera (dialekttet) edhe nga faktorët kontekstualë! (Werlich, 1983)

Werlich (1983) thekson se distribuimi apo përndarja e aspektit të caktuar tekstor varet nga tipi i tekstit që analizojmë, pra në njëfarë mënyre klasifikimi i tipave tekstorë varet shumë nga kundërvënia aspektore. Por a është kjo kundërvënie gjithmonë eksplicite dhe e ditur për emetuesin dhe marrësin apo është implicite dhe shpeshherë me më shumë se një interpretim gjuhësor varet edhe nga faktorët e tjerë kotekstualë që i marrim parasysh gjatë analizës (veta, fokusi, diateza, mënyra e prezantimit të veprimit a ngjarjes). Këtë e dëshmon hipoteza jonë se po qe se ia mveshim kundërvënies tradicionale aspektore të shqipes e kryer – e pakryer, brenda fjalive të caktuara, edhe kundërvënien aspektore të vazhdimësisë – jovazhdimësisë, të durativitetit dhe të jodurativitetit, atëherë shumë lehtë do të mund t'i klasifikonim dhe analizonim tipat e ndryshëm të tekstit në varësi nga kundërvënia aspektore e foljes.

Shembulli I – teksti përshkrues

Nëse e analizojmë paragrafin e mëposhtëm në terma aspektorë vërejmë se tipi deskriptiv i tekstit është përplot trajta aspektore të vazhdimësisë, ndonëse të shprehura me të tashmen e dëftores në kuptimin e saj të së tashmes të pacaktuar, pra joperfektive. Vazhdimësia ose iterativiteti shprehet nëpërmjet inkuadrimit të folësit në përshkrimin impresionistik të shtëpisë, kjo bën që aspekti i vazhdueshëm i shprehur me foljet ***qëndrojnë, shkëlqen, shtrihet***, etj. të shprehet si një veprim a gjendje e papërcaktuar (shtëpia në një gjendje të tillë ka ekzistuar për një kohë), por ky kufizim „për një kohë" mund të definohet si një segment kohor i kufizuar (me fillim e mbarim) në perceptimin e autorit nga një pozitë mendore dhe fizike e mëvonshme (koha kur ai e shkruan librin). Pra, gjendja e shtëpisë është një gjendje permanente që ka mbetur në kujtesën e autorit (e tashme e pacaktuar si kohë foljore), por në sytë e autorit (qëndrimi folës i autorit që e përcakton kategorinë e aspektit) prezantohet si periudhë (segmentim) që është bërë në një interval kohor të përshkrimit të kësaj pamjeje (e tashme e vazhdueshme deri në momentin e aktit të „fotografimit" mendor):

I) Menjëherë në të djathtë është dera e gdhendur bojëkafe fort e bukur e dhomës së madhe. Me të hyrë në të, në të djathtë, gjendet qymleku i lartë ngjyrë tirkizi. Pastaj, hamamxhiku prej dërrasave me dysheme prej çimentos, dollapi i gdhendur ngjyrë lajthie…

Në raftin e drunjtë, i cili shtrihet tërë gjatësisë së murit deri te dritarja, qëndrojnë rend ftonjtë e verdhë erandës në mes të pjatave të argjendta me kapak. Nën raft, në mur është e varur ora e madhe bojëkafe "alla franga". Dritaret e mëdha shikojnë nga kuzhina verore dhe mani.

Nën dritare është minderi i stolisur me mbulesat, dantella punëdore të nënës sime. Nga ana e majtë gjendet i përgatitur shtrati i ardhshëm i dhëndërisë për dajën dhe nusen. Shkëlqen nga çarçafët e mëndafshtë dhe jastëkët kadife me lule.

Tavani i dhomës është i zbukuruar me të gdhendur… Në anën e majtë të katit shtrihet dyshemeja e madhe prej dërrasash, e cila shpie në "qyshkun" e dalë mbi rrugë. Ka trajtë gjysmëhëne. Ka dritare shumë të mëdha, të mbuluara me kapakë "kafazë-parmakli". Nën dritare është minderi. Kur të rrihet mbi të, mund të shihet gjithandej: prej kalasë dhe xhamisë së Sinan Pashës, përmbi ura e deri te prefektura, te mëhalla e Tabahanes në anën e kundërt.

(B. Fehmiu, *E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme*, Koha, Prishtinë, 2011)

Natyrisht, një përshkrim i tillë i paraqitur në të tashmen imperfektive të pacaktuar do të implikonte se shtëpia do të jetë përshkruar me prezent të aktualizuar për ta bërë më evidente dhe më të afërt me lexuesin përshtypjen subjektive të autorit. Autori atëbotë ka qenë pjesë e një ambienti të tillë, ka qëndruar në këtë dhomë (Kur të rrihet mbi të, mund të shihet gjithandej:…), pra ka pasur një vazhdimësi në perceptimin e tij të pamjes së dhomës, dhe se pamja e dhomës bashkë me pamjen e shtëpisë në përgjithësi për të paraqesin një validitet apo kohësi të pacaktuar (timeless validity). Megjithatë, vërehet edhe një dozë e segmentimit kohor, të një kufizimi kohor të përfunduar meqë autori flet për dhomën dhe e përshkruan atë nga pozitë e mëvonshme, larg kontinuitetit dhe rrjedhës së ngjarjeve brenda faktorit kohë – nga pozicionimi i kujtimeve të tij.

Autori, gjithashtu, i segmenton përshkrimet e njëpasnjëshme (fotografitë që e përbëjnë pamjen si tërësi).

Pra, përshkrimi impresionistik, si formë tekstore e tipit deskriptiv të tekstit, duket në plan të parë që në vete ngërthen vazhdimësinë si kundërvënie aspektore ndaj jovazhdimësisë si pjesë e pandashme e rrëfimit (*shkoi, erdhi, u nis, u kthye*, etj.). Është pikërisht kjo vazhdimësi (*punoja, shkoja, bëja*) e kombinuar me folje që shpreh veprim të çastit që shpesh konsiderohet si një nga kriteret e përcaktimit formal të formave tekstore përshkruese (p.sh. në anglishten: *I was eating and drinking when they suddenly broke the door*., konsiderohet përshkrim për shkak të vazhdimësisë së segmentuar të ngjarjes të shprehur me *present continuous tense*). Në të vërtetë kemi të bëjmë me përshkrim dinamik të ngjarjeve brenda një kronologjie të caktuar, pra kemi të bëjmë me narracion (rrëfim).

Por, a është edhe vazhdimësia e narracionit (rrëfimit si tip tekstor) kundërvënie e vërtetë që e shpreh një pikë të caktuar në boshtin apo segmentin kohor të kohës si koncept universal? Natyrisht që jo! Këtë e dëshmon analiza e shembullit narrativ:

Shembulli II – teksti rrëfyes

Le ta analizojmë një paragraf të një forme tekstore narrative, më konkretisht, një rrëfimi *subjektiv*, ku kemi të bëjme me renditje të veprimeve, duke pasur parasysh edhe kohën e kryerjes së këtyre veprimeve. Rrëfimi subjektiv përshkohet me zgjedhje dhe theksime subjektive, siç është zgjedhja e vetës së parë. Regjistron veprime dhe ngjarje nga këndvështrimi i përshtypjeve subjektive në aspektin kohë. Nuk përjashtohet as mundësia (në letërsi) e vetës së tretë. Baza tematike e tekstit shënjohet nga fjali që regjistrojnë veprime brenda sekuencës (Rugova & Sejdiu-Rugova, 2015: 55).

"Kallauzi" i sajës, mbushur përplot me çuna e djelmosha, kalon pranë meje si furi, tatpjetë mbi sipërfaqe si qelqi.

E atje kah fundi praptohen… Rrakadylen nëpër borë. Klithin nga gëzimi. Kacafyten, munden njëri me tjetrin kapur lëmsh… Pastaj, duke tërhequr përsëri sajën "kallauz" ngrihen deri te maja e rrugës…

Rruga ime është më e hareshmja në Vratnik. Shikoj sesi djemtë dhe vajzat, mbështjellë me shalle me ngjyra të llojllojshme, me kapuça, faqeskuqur e duarmërdhirë, në kolonë ngjiten përpjetë. Ndonjë djalë rrëshqet papritmas, tjetri rrëzohet, i treti mbahet me duar për muri e me kujdes hap pas hapi i afrohet majës…

Më narthin gishtat e këmbëve dhe më rrjedhin hundët, por s'më pengon të kënaqem në tërë këtë gëzim. Do të dëshiroja të merrja pjesë, por kam frikë… Nis të ulet mbrëmja, errësohet. Prindërit thërrasin, mbledhin fëmijët e tyre dhe i përcjellin në shtëpi. Dëgjohen lutjet: "…Vetëm edhe një herë…, jo, jo, nuk lëshohem prej majës, por ja, nga gjysma e shtegut…"

(B. Fehmiu, *E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme*, Koha, Prishtinë, 2011)

E kemi momentin e "kalimit" të sajës, e cila në një kornizë tjetër ka arritur në fund të tatëpjetës. E kemi kornizën tjetër, të rrëzimit të fëmijëve. Kornizën pasuese të një klitheje nga gëzimi, e kështu me radhë. Secila nga këto korniza më vete është vendosur sipas momentit të ngjarjes dhe paraqet një rrjedhë kohore. Njeherësh, shenjues kohorë, si *pastaj*, *bie muzgu* e tregojnë rrjedhën e ngjarjes dhe e ofrojnë procesin e ndjesisë kohore që e përbën tiparin karakteristik të një teksti rrëfyes. Autori që e ka shkruar këtë tekst nuk mbetet jashtë rrjedhës së veprimit, pra është pjesë e vazhdimësisë së ngjarjeve që rrodhën njëra pas tjetrës duke iu refuar faktorit kohë. Një aspektualizim i tillë e bën tekstin më subjektiv. Brenda vazhdimësisë dhe imperfektivitetit të veprimit natyrshëm implikohet se autori flet për këtë ngjarje nga një perspektivë e atypëratyshme, pra veprimi i shprehur në roman, ndonëse i vështruar nga një periudhë e mëvonshme e jetës, për shkak të prezentit të pakufizuar me kuptim të gjithëkohësisë, por të segmentuar në sekuenca (thërasin, mbledhin,…) që shpreh veprim suksesiv si dhe për shkak të përdorimit subjektiv të vetës së parë në tabllot përshkruese, dominohet nga kundërvënia aspektore perfektive, por e vazhdueshme (me segmentim të vazhdueshëm). Në re-

alitet kemi të bëjmë me një veprim të kryer, por të rrëfyer si i vazhdueshëm (të segmentuar në pjesë që shprehin veprime imperfektive tashmë të përmbyllura), e kjo e bën rrëfimin më autentik dhe autorin pjesë të tij. Ky tipar i aspektit të kryer (perfektiv) me kuptim të vazhdimësisë, si dhe i përdorimit personal (vetor) të vetës së tretë: *Prindërit thërrasin, mbledhin fëmijët e tyre dhe i përcjellin në shtëpi.,* të kombinuar me vetën e parë përfshirëse subjektive (*Më narthin gishtat e këmbëve dhe më rrjedhin hundët, por s'më pengon të kënaqem në tërë këtë gëzim.)* e përbëjnë zgjedhjen e caktuar, mjaft komplekse të aspektit nga perspektiva folëse me qëllim të realizimit të komunikimit.

Shembulli III – teksti argumentues

Këta dualizma aspektorë vërehen edhe te tipi i tekstit argumentues e veçanërisht te forma tekstore e argumentimit subjektiv ose komentit, ku folësi i bart gjykimet, duke i lidhur konceptet e ngjarjeve, të objekteve dhe të ideve me sistemet e tij personale të vlerës, të besimeve dhe të të menduarit (Werlich 1983:107):

- Prishtina mbase është qyteti i vetëm në botë, që nuk ka autobus që të çon në stacion të autobusëve. A e keni menduar këtë ndonjëherë? Asnjë autobus lokal që qarkullon nëpër qytet, nuk të çon te stacioni i autobusëve, prej ku nisën autobusët e linjave kombëtare e ndërkombetare!

- Në mungesë të një linje të tillë, që do të ishte e logjikshme dhe e nevojshme (hej, paramendojeni, nuk ka autobus që t'çon n'stacion!) qytetarët janë të detyruar të marrin taksi, apo të arrijnë në stacion të autobusëve duke përdorur linjat ndërurbane, kryesisht atë për në Fushë Kosovë. As kjo linjë, e as ajo tjetra për në Obiliq, nuk kanë vendndalje të ligjshme afër stacionit qendror të autobusëve. Kësisoj, secila ndalje që bëhet në rrugët rreth stacionit për të lënë apo marrë udhëtarët, jo vetëm që shkakton tollovi në trafik, por edhe është e paligjshme. Autoritetet rregullative, në këtë rast Komuna e Prishtinës, si duket i kanë rregulluar punët e tyre për merak, sa që nuk iu ndodh që të shfrytëzojnë transportin publik për ta vërejtur këtë fenomen…

- Por ja që, po e zëmë, ju vjen një mysafir nga ndonjë qytetet a shtet tjetër, përmes transportit publik rrugor dhe zbret në stacionin e autobusëve në Prishtinë. Nëse nuk keni dalë ta prisni mysafirin, e me ç'rast do duhej të paguanit 1 euro për të hyrë në stacion, mysafiri ka për të qenë i detyruar të paguajë një nga taksitë shumë të shtrenjta që lejohen të futen brenda në stacion. Meqë, po e përsëris duke qeshur, nuk ka autobus që vjen prej qytetit n'stacion.

- Krejt në fund, më duhet të kthehem te fillimi: na duhet një autobus që na çon n'stacion t'autobusëve. Sa më shpejt që të jetë e mundur!

(Krenar Gashi, Një autobus që t'çon n'stacion t'autobusëve![2])

Si tërësi këtu e kemi argumentimin e një mendimi. Mendimet e autorit vihen në kundërvënie në raport me autoritetet rregullative. Koha dominuese foljore është e tashmja e pacaktuar (është, ka, nuk është, nuk ka, shkakton, zbret, nuk të çon, etj.) dhe natyrshëm nënkuptohet se përmes shembujve personalë dhe gjykimeve personale autori nxjerr përfundime të përgjithshme, pra i gjeneralizon përvojat e tij në ngjarje dhe veprime faktike: segmentet e caktuara të jetës së tij ose të miqve të tij i transformon në procese imperfektive dhe të ditëpasditshme. Kemi një implikim të aspektit iterativ dhe të vazhdimësisë në aspektin real perfektiv.

Përfundim

Pra, aspekti foljor ka filluar të kundrohet si kategori gramatikore e shqipes, dhe kontributi i Fridman-it në këtë rrafsh është i rëndësishëm. Studimet për aspektin, të botuara pas vitit 2000 e klasifikojnë me të drejtë kategori të mëvetësishme, ndryshe nga Gramatika e Akademisë dhe shumë gjuhëtarë eminentë shqiptarë të gjysmës së dytë të shekullit të kaluar. Riza, Dhrimo, Mindak, Buchholz/ Fiedler janë disa nga emrat e albanologjisë që janë marrë me aspektin nga një këndvështrim më i saktë – ai i qëndrimit dhe i subjektivitetit folës. Megjithatë, studimi i aspektit si kom-

[2] http://floripress.blogspot.com/2011/02/nje-autobus-qe-tcon-nstacion.html së fundi shikuar më 10 dhjetor 2014.

ponentë e obligueshme e kategori tekstore të qëndrimit folës dhe kombinimi i saj me komponentet e tjera të kësaj kategorie (veta, diateza, fokusi dhe prezantimi folës) do të mund të jepnin një pasqyrë më të plotë të kuptimeve sipërfaqësore (eksplicite) dhe të atyre të nënkuptuara (implicite) të kësaj kategorie gjuhësore. Për më tepër, një analizë e hollësishme pragmatike e aspektit në terma të implikaturës dhe të presupozimit (dijes së deponuar dhe kuptimit mes rreshtash) mund të ndihmojnë edhe më shumë në specifikimin e telicitetit apo jotelicitetit të veprimit. Pra, imlikaturat e mundshme të një fjalie do të mund ta shpjegonin tërësinë e kuptimeve të mundshme që i merr një kundërvënie aspektore gjatë përdorimit, ndërkaq tërësia e supozimeve të folësit do të mund të ndihmonte në përcaktimin e saktësisë ose jo të pasqyrimit formal të qëndrimit folës brenda një formeje tekstore të caktuar. Në vargun: *Unë po vdes çdo ditë nga pak, nuk jam afër, por jam larg*. (marrë nga një këngë e njohur e rok grupit kosovar Oda) aspekti imperfektiv i shprehur në mënyrë metaforike me foljen *po vdes* në mënyrë implicite shpreh telicitet të përsëritur dhe të segmentuar (*çdo ditë nga pak*) brenda boshtit të gjatë jetësor (*nuk jam afër, por jam larg* – larg nga vdekja nënkupton rrugëtim e rrugëtimi paraqet vazhdimësi në këtë rast). Pra, implikaturat e mundshme apo nënkuptimet që rrjedhin nga një varg i tillë do të ishin të shumta. Në fund të fundit, komunikimi njerëzor është qëndrim folës dhe aspekti si pjesë e pandashme e subjektivitetit të tillë duhet të kundrohet nga një rrafsh shumëkuptimor.

Linditë SEJDIU-RUGOVA, Philogical Faculty of the University of Prishtina

ASPECTUAL OPPOSITIONS WITHIN ALBANIAN IN FRIEDMAN'S AND CONTEMPORARY ALBANIAN STUDIES

Summary

The present paper aims at emphasising the impact of Victor Friedman in the studies of and about aspect as a grammatical category and it points out the importance of text description of aspect as a viewpoint category. Friedman is one of the first scholars who deals with the aspect in Albanian, being the category which represents the speaker's choice or the speaker's attitude. By comparing directly the aspectual oppositions in Albanian, Bulgarian and Turkish (out of the three languages each with the two apsectually distinguished forms that are being compared), Friedman offers six possible patterns of non-correspondence when translating a text from Russian into these three languages. He concludes that in terms of subordinate aspectual opposition aorist/imperfect, Albanian occupies a place between Bulgarian and Turkish and favors the use of aorist when two othe languages choose imperfect to denote sequential or inceptive actions (Friedman, 2004: 298). Apart from Friedman, Dhrimo and Buchholz/ Fiedler give a very detailed account on aspectual oppositions in Albanian, whereas the standard Grammar of Albanian language gives it a very inferior role among other verb categories, by not emphasising its independent status at all. However, an attempt to describe the aspect in different text types and various text forms forms has been made and one of the main recommenddations for further studies could be related to demanding more contextual-bound explanations in explaining grammatical concepts and roles.

Bibliografi:

Binnick R. 1991. *Time and the Verb – A Guide to Tense and Aspect*. Oxford: Oxford Univeristy Press

Breu W. 2010. Mood in Albanian. In: Rothstein B., Thieroff R. (red.). *Mood in the Languages of Europe*. Amsterdam, Philadelphia: John Benjamins Publishing Company (447-472)

Brown G., Yule G. 1983. *Discourse Analysis*, New York: Cambridge University Press

Buchholz O., Fiedler W. 1987. *Albanische Grammatik*, Leipzig: Verlag Enzyklopädie

Cipo K. 1952 . Sintaksa. Tiranë (49-58)

Comrie B. 1988. Aspect – An Introduction to the Study of Verbal Aspect and Related Problems. Cambridge: Cambridge University Press

Çeliku M. 2012. *Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*. Tiranë: ILAR

De Beaugrande R. Dressler H. 1981. *Introduction to Text Linguistics*, London: Longman

Demiraj Sh. 1988. Gramatikë historike e gjuhës shqipe. Prishtinë: Rilindja (708-722)

Dhrimo A. 2008. Për shqipen dhe shqiptarët. Tiranë: Infobotuesi (234-330)

Dušková L. (red.). 2003. Dictionary of the Prague School of Linguistics (Studies in Functional and Structural Linguistics), London: John Benjamin Publishing Company

Floqi S. et al. 1991. *Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*, Sintaksa e periudhës, Prishtinë: Enti i Teksteve…

Friedman V. 2004. Aspectual Oppositions in Bulgarian, Albanian, and Turkish. In: *Studies on Albanian and other Balkan Languages*, Pejë, Dukagjini (225-237)

Görlach M. 2004. *Text Types and the History of English*. Berlin, New York: Mouton de Gruyter

Gramatika. 1995. *Gramatika e gjuhës shqipe I*. Tiranë: ASHRSH

Gramatika. 1997. *Gramatika e gjuhës shqipe II*. Tiranë: ASHRSH

Higginbotham J. 2009. *Tense, Aspect, Indexicality*. Oxford: Oxford University Press

Huddleston R. Pullum G. et al. 2002. *The Cambridge Grammar of the English Language*. Cambridge: CUP

Ismajli R. 1980. *Shumësia e tekstit*, Prishtinë: Rilindja

Kelmendi T. 2006. *Kështjellat e sintaksës (kohë foljore dhe njësi tekstore)*. Prishtinë: IAP

Levinson S. 1983. *Pragmatics*. Cambridge: Cambridge University Press

Lyons J. 1995 [1968]. *Introduction to Theoretical Linguistics*. London: Cambridge University Press

Mindak J. *1985.* Mbi kategorinë e kohës dhe të aspektit në gjuhën shqipe, In: Aliu A. (red) *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 10.* Prishtinë: Universiteti i Prishtinës (49-56)

Prifti S. 1971. *Sintaksa e gjuhës shqipe*. Prishtinë: Enti i teksteve…

Riza S. 1994. Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore. Tiranë

Rugova B. 2008. Dizajni i audiencës. In: Bokshi B. et al (red.) *Studime Filologjike shqiptare*. Prishtinë: ASHAK (473-478)

Rugova B, Sejdiu L. 2011. Impluperfect and aor-pluperfect in Albanian. In: Belluscho G., Mendicino A. (red.) *Scritti in onore di Eric Hamp per il suo 90*. *Compleanno*. Rende: Universita Della Calabria (352-360)

Rugova B, Sejdiu-Rugova L. 2015. Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe, Prishtinë, KOHA

Rugova L. 2007. *Koncepti i fjalisë në gramatikën e tekstit*. In: Badallaj I. (ed.) Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 26/1. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës (171-179)

Rugova - Sejdiu L. 2012b. *Ndikimi i idiomave tekstore në format tekstore: krahasim i idiomave tekstore argumentuese dhe shpjeguese në anglishten (* International Conference preceedings). Shkodër. Universiteti Luigj Gurakuqi (163-169)

Quirk R, Greenbaum S, Leech G, Svartvik J. 1985. *A Comprehensive Grammar of the English Language*. Essex: Longman

Simpson P. 1994. *Language, Ideology and Point of View*. Longman: London, New York

van Dijk T. 1972. *Some Aspects of Text Grammar*, Paris: Mouton

Wardhaugh R. 1976. *The Contexts of Language*. Messachusets: Newbury House Publishers

Yule G. 2002. *Pragmatics*. Oxford, New York: Oxford University Press

Korpusi:

Bekim Fehmiu, *E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme*, KOHA, Prishtinë, 2011

Krenar Gashi, *Një autobus që t'çon n'stacion t'autobusëve*! Te: http://floripress.blogspot.com/2011/02/nje-autobus-qe-tcon-nstacion.html

N. S. Trubeckoi, *Parime të fonologjisë* [përkth. M. Bejta], Rilindja, Prishtinë, 1985

Tzvetan Todorov, *Bisedë e civilizuar*, Project Syndicate

Blertë ISMAJLI, Fakulteti i Filologjisë i UP-së, Prishtinë

PËRTEJ MËNYRËS? VËSHTRIME RRETH MODALITETIT NË RAPORT ME HABITOREN TE FRIEDMAN

Diskutimi për përkatësinë e habitores si mënyrë foljore është një çështje e shtruar vetëm në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar. Tradicionalisht ajo përkufizohet si mënyrë e foljes që përdoret për të shprehur habi, dyshim, ironi. Studime të thelluara për funksionet e saj që janë bërë në gjysmën e dytë të shek. XX nxjerrin në pah edhe funksionin e referativitetit – bartjen neutrale të informatës nga folësi. Krahas Rizës (1966), Fiedler-it (1966), Camajt (1969), për këtë funksion të habitores flet në studimet e tij edhe prof. Victor A. Friedman, emër i njohur sidomos në ballkanistikë, ndër të tjera për studimet e shqipes dhe të gjuhëve të Ballkanit, sidomos për studimet për kategoritë gramatikore në këto gjuhë dhe kontaktet midis tyre. Ka trajtuar edhe aspekte sociolinguistike lidhur me standardizimin, ideologjinë dhe identitetin. Në këtë punim do të përqëndrohem te qëndrimet e V. A. Friedman-it për habitoren e shqipes. Këto studime tejkalojnë përshkrimin tradicional që ka për bazë qëndrimin folës, ato kalojnë nga studimi i habitores në nivel fjalie në përdorimin e saj brenda një konteksti.

Habitorja[1] – e vërejtur së pari si kohë foljore admirativi nga Auguste Dozon-i më 1879 dhe e përshkruar si mënyrë e foljes nga Gustav Meyer-i (1888) nëntë vite më vonë në *Kurzgefasste albanesische Grammatik* – është një ndërtim i veçantë foljor i shqipes, i cili si i tillë nuk haset në gjuhët e tjera indoevropiane. Shikuar morfologjikisht, ajo paraqet një perfekt të përmbysur të gramatikalizuar, format e të cilit janë krijuar përmes për-

[1] Për mënyrën habitore krhs. edhe Ismajli B. 2006, 2009, 2012.

ngjitjes së foljes ndihmëse *kam* me pjesoren e shkurtër të foljes (*kam punuar → punuakam)*. Gramatika e AShSh-së (Agalliu et. al 2002: 318) ruan deri në botimin e fundit përshkrimin tradicional të habitores si mënyrë me anë të së cilës shprehet habi, dyshim, ironi. Por, siç do të vërehet në studimet e gjysmës së dytë të shek. XX për funksionet e habitores, shprehja e habisë (prej nga rrjedh edhe emërtimi habitore/ admirativ) është vetëm njëri nga kuptimet që mund ta kenë format e habitores. Dy funksionet tjera të saj janë kundërshtimi sarkastik ose ironik i një shprehjeje të mëparshme dhe përcjellja neutrale e informatës ose referativiteti/ komentativiteti. Funksioni i fundit, sado që i vërejtur vonë, konsiderohet si funksioni kryesor nga Camaj (1969: 67), i cili, në përkufizimin që i bën habitores, vë theksin te qëndrimi neutral i folësit ndaj informatës që përcillet:

> *"Der Admirativ ist der Modus des Ausrufs, der Überraschung. Das Subjekt drückt sich mittels des Admirativs ohne persönliche Stellungnahme zum tatsächlichen Sachverhalt aus: es kündigt einfach ein Geschehen an oder gibt eine fremde Aussage weiter".*[2]

Këtë funksion të saj e vërejnë edhe Buchholz dhe Fiedler (1987: 154) e Desnickaja (1987: 55ff) që flasin për dy veçori të habitores që janë të lidhura mes vete e këto janë *admirativiteti*, që është veçori emocionale dhe *komentativiteti* që është veçori modale, si dhe S. Riza (1997:133),[3] i cili mendon se ligjërata e drejtë zhdrejtazi do të riprodhohej më kënaqshëm me mënyrën habitore të funksionit referativ.

Habitorja brenda konteksit – jokonfirmativitet dhe evidencialitet

Friedman-i në studimet e tij sjell risi në hulumtimin e trajtave të

[2] "Habitorja është mënyra e habisë, e befasisë. Kryefjala shprehet përmes habitores për gjendjen pa shprehur qëndrim personal: ajo njofton për një ndodhi ose përcjell një mendim të huaj." (përkthimi B.I.)

[3] Riza ka një qëndrim të avancuar sa i përket mënyrave të foljes. Qëndrimi i tij kritik ndaj mënyrës tradicionale të përshkrimit të mënyrave të foljes që shkonte në linjën e njëjtë me gjuhëtarët evropianë të kohës, si dhe përshkrimi i avancuar i habitores duke vënë në pah fuksionin e referativitetit fatkeqësisht kanë mbetur të papërfillur për shkak të përndjekjes së autorit deri në vitet '90 kur u botua vepra e tij "Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore", hartuar më 1966.

habitores duke i vështruar ato brenda kontekstit në të cilin shfaqen sepse bazuar në kontekstin mund të bëhet interpretimi i saktë i tyre. Nisur nga fakti se admirativiteti është vetëm njëri nga funksionet e habitores, Friedman-i në artikullin e tij për "Admirativitetin dhe konfirmativitetin" (1981/ 2004: 214) shfaq idenë se habitorja ka kuptim **jokonfirmativiteti**. Këtë term ai e përdor nisur nga propozimi i Aronson-it (1967) që termi *confirmative* të përdoret për të përshkruar evidencialët e bullgarishtes që përdoren nga folësi për të garantuar për vërtetësinë e një shprehjeje (Friedman 2003: 190). Ndërsa jokonfirmativiteti u referohet formave të evidencialitetit që përdoren për t'iu shmangur përgjegjësisë për vërtetësinë e informatës që përcjell folësi duke shprehur dyshim, ironi ose duke ia atribuar pohimin fjalëve të dikujt tjetër, ose ai e shpreh faktin se dikur në të kaluarën nuk ka pritur që pohimi të jetë i vërtetë dhe se prandaj befasohet. Friedman-i (2004: 343-351) propozon që për mënyrën habitore të përdoret termi *jokonfirmativitet,* meqë termi *admirativ* (ose *habitore)* përshkruan vetëm njërin nga funksionet e habitores, atë të shprehjes së habisë. Krahas shprehjes së habisë, ai vëren edhe dy funksione të tjera: kundërshtimi ironik ose sarkastik i një thënieje të mëparshme *(dubitativ)* dhe bartja neutrale e informacionit për të cilin folësi nuk dëshiron të mbajë përgjegjësi *(nongarantiv)*. Termi jokonfirmativitet për habitoren është më i përgjithësuar dhe i referohet një elementi të përbashkët që kanë format e habitores në të tri funksionet e saj. Friedman-i mendon se tri funksionet e jokonfirmativitetit mund të shihen si tri funksionet e gjuhës sipas modelit organon të Karl Bühler-it (1978: 28): *funksioni emotiv, funksioni apelativ* dhe *funksioni kognitiv*.[4] Friedman-i (2003: 348-351) i sqaron tri funksionet e jokonfirmativitetit duke analizuar dy fjali të shqipes dhe

[4] Sipas Bühler-it shenja gjuhësore a) është simptomë, meqë e shpreh brendësinë e dërguesit të mesazhit (adresuesit). Ky është funksioni emotiv i gjuhës që emërton raportin mes dërguesit dhe shenjës; b) Shenja gjuhësore është sinjal meqë apelon te marrësi i mesazhit (i adresuari). Ky është funksioni apelativ i gjuhës që përshkruan raportin dhe ndikimin që ka shenja te marrësi; c) Shenja gjuhësore është simbol meqë u referohet sendeve ose situatave, gjendjeve nga realiteti. Pra shenja përfaqëson, paraqet një send ose një gjendje. Ky është funksioni kognitiv i gjuhës. (krhs. Bussman 1990: 549)

përkthimin e tyre në gjuhën angleze. Folja në fjalinë e parë është në dëftore ndërsa në të dytën në habitore:

1. a) Qumështi është i verdhë.

   b) Qumështi qenka i verdhë.

"*The milk is yellow.*" është përkthimi i fjalëpërfjalshëm i të dy fjalive, por ato dallojnë mes vete: fjalia e parë nuk është e markuar, ndërsa e dyta është jokonfirmativitet. Forma foljore *qenka* mund ta ketë njërin nga tri kuptimet e jokonfirmativitetit: 1. admirativ, 2. dubitativ ose 3. nongarantiv. Prandaj, derisa fjalia në dëftore mund të përkthehet saktë pa pasur njohuri shtesë, për të bërë interpretimin e pastaj përkthimin e saktë të fjalisë në habitore nevojitet konteksti më i gjerë. Forma *qenka* mund të ketë njërin nga tri kuptimet e habitores:

1. Në kuptimin admirativ folja merr nuancë emotive, shpreh gjendjen emocionale të folësit të parë (dërguesit) pa shfaqur reagim ose referim ndaj deklarimit të marrësit ose ndonjë pale të tretë. Pra, sipas modelit të Bühler-it shenja gjuhësore është simptomë dhe gjuha merr funksion emotiv. Këtu shprehet habia e folësit për ngjyrën e verdhë të qumështit.
2. Kuptimi i dytë që mund ta ketë folja në habitore është dubitativ. Fjalia me këtë kuptim ka funksion apelativ të gjuhës meqë përfaqëson një përgënjeshtrim ose kundërshtim drejtuar marrësit (të adresuarit). Prandaj është e domosdoshme prania e një të adresuari pohimi i të cilit refuzohet/ kundërshtohet.
3. Kuptimi i tretë që mund ta ketë fjalia në habitore është ai nongarantiv. Nongarantivi kërkon një element të tretë. Meqë nuk shpreh as habi as kundërshtim, ai duhet t'i referohet një personi të tretë (që nuk është as adresuesi as i adresuari) ose një faktori tjetër. Nongarantivi ndërmjetëson mes admirativit dhe dubitativit përmes konstatimit. Ai e trajton informatën si vlerë relative. Ky është funksioni kognitiv i gjuhës. Pra, shprehet raporti mes shenjës dhe një sendi ose një gjendjeje.

Pra, është konteksti në të cilin paraqiten format e jokonfirmativitetit ai që mundëson interpretimin e saktë të tyre. Zakonisht në gjuhët e Ballkanit admirativi[5] shfaqet në fjali të shkurta duke shprehur qëndrimin jokonfirmativ të folësit (zakonisht habinë). Por kur jepen të ndërthurura në një kontekst më të gjerë, format e admirativit mund të dalin në funksionin e raportimit neutral apo edhe të dubitativit. Pra mund të hyjnë në funksion të një lloj rrëfimi jokoherent. Në shembullin për përdorimin e habitores gjatë një udhëtimi që sjell Friedman-i (2005: 30-31) shfaqen edhe raste kur për t'u kuptuar drejt admirativi, thënia duhet plotësuar edhe me kontekstin e asaj qe shihet gjatë udhëtimit. Duke e krahasuar përdorimin e formave të admirativit në kontekstin ballkanik Friedman-i (2005: 26-37) vëren dallimet midis përdorimit narrativ të tij në nivel fjalie dhe në njësi më të mëdha diskursi. Ai sjell një shembull nga një tekst gazete lidhur me këtë. Raportimi për ngjarjen bëhet në aorist, ndërsa brenda kontekstit ndërthuren forma të habitores për të shprehur në njërin rast dubitativitet e në rastin e dytë raportim neutral. Në gjuhët që kanë zhvilluar jokonfirmativitet të markuar – siç është rasti me shqipen, admirativi mund të funksionojë si e tashme (çfarë nuk ndodh në sllavishten e Ballkanit, turqishten dhe meglenorumanishten) dhe nuk do të shfaqet në njësi të zgjeruara diskursi. Shqipja ka forma plotësisht të gramatikalizuara për të shprehur jokonfirmativitet, ndryshe nga p.sh. sllavishtja e Ballkanit dhe turqishtja që kanë vetëm përdorim të formave të caktuara foljore për ta shprehur atë.

Për shkak të ngjashmërisë në funksion me format *-l* te maqedonishtes dhe me format *mış* të turqishtes, habitorja konsiderohet si ballkanizëm. Prandaj edhe një numër studimesh të Friedman-it i kushtohet pikërisht habitores apo, sipas terminologjisë së tij, jokonfirmativitetit në shqipen dhe në gjuhët e Ballkanit. Gjurmë të saj gjenden edhe në arumanishten ku këto forma janë krijuar nën ndikimin e shqipes. Në fillim të

[5] Termi admirativ është etabluar në studimet ballkanistike. Duke qenë se me të përshkruhen fenomene të ndryshme që kanë funksion të njëjtë dhe lidhje diakronike me perfektin, po i përmbahem kësaj terminologjie.

viteve '90 të shekullit të kaluar, Friedman (2004: 304) e vërejti praninë e një forme foljore në dialektin arumun të fshatit Beala di Suprã, e cila funksionon sikur habitorja e shqipes ose sikur forma e markuar *-l* e maqedonishtes. Kjo formë e arumanishtes ka një morfologji të veçantë – nuk është perfekt i ristrukturuar ose i riinterpretuar. Friedman-i mendon se këto forma janë kombinim i huazimeve dhe kalkeve nga shqipja me ndikim të mundshëm sllav. Atje morfema *-ka* e shqipes është interpretuar si markues i habitores dhe i është shtuar pjesores së foljes në arumanishten. Për zhvillimin e admirativit në gjuhët e Ballkanit Friedman-i (2005: 26-37) është i mendimit se shtysën e ka dhënë turqishtja. Por duket se dukuritë e zhvilluara mund të përmblidhen në tri grupe: admirativi i bazuar në perfekt që përdoret në nivel diskursi (turqishtja, maqedonishtja, bullgarishtja, megleno-rumanishtja), admirativi i bazuar në perfekt që përdoret në nivel fjalie (shqipja, arumanishtja e Beala di Suprã, maqedonishtja e Kostur-Korça), admirativi i bazuar në modalët që përdoret në nivel fjalie (dakorumanishtja dhe bullgarishtja e Novo Selo). Në kontekstin ballkanik termi "admirativ" përdoret për të përshkruar fenomene të ndryshme që kuptim kryesor e kanë shprehjen e befasisë[6] dhe që kanë lidhje diakronike me perfektin. Ndryshe nga bullgarishtja dhe turqishtja, në shqipen nuk flitet për përdorim të veçantë të formave të perfektit, por për forma që dallohen morfologjikisht e që mund të identifikohen lehtë. Këto dukuri të zhvilluara në gjuhët e Ballkanit në forma të ndryshme Friedman-i i trajton si forma evidencialiteti. Termi evidencialitet në studimet e tipologjisë së gjuhës i referohet një domeni semantik-funksional që mund të shprehet përmes mjeteve leksikore dhe kategorive gramatikore. Karakteristikë e evidencialitetit është kodimi i burimit të indormatës ose njohurisë, gjë që mund të vërehet edhe në definicionet e ndryshme:

> *"Evidentials may be generally defined as markers that indicate something about the source of the information in the proposition".* (Bybee 1985: 184).[7]

---

[6] Për qëndrime kontestuese rreth befasisë si kuptim kryesor i habitores krhs. edhe Schmaus 1966, Fiedler 1966, Camaj 1969.

[7] "Evidencialët mund të përkufizohen përgjithësisht si shënues që indikojnë diçka

"Evidentiality proper is understood as stating the existence of a source of evidence for some information; this includes stating that there is some evidence, and also specifying what type of evidence there is". (Aikhenvald 2003: 1).[8]

"The basic characteristic of linguistic evidentiality is the explicit encoding of a source of information or knowledge (i.e. evidence) which the speaker claims to have made use of for producing the primary proposition of the utterance". (Diewald dhe Smirnova 2010[1]: 1).[9]

"Evidentiality is a semantic-functional domain having to do with the kinds of "proof" speakers are able to adduce in order to underpin their statements". (Diewald dhe Smirnova 2010[2]: 1).[10]

Por, siç vë re Friedman-i, ndryshe nga gjuhët ku format e evidencialitetit përdoren për të dhënë llojin e evidencës për informatën, admirativi nuk është i lidhur drejtpërdrejt me burimin e informatës, por më tepër me vlerësimin e folësit për vetë informatën. Format e shqipes Friedman-i (2003: 212) i përshkruan si "strategji e gramatikalizuar" e i vendos midis kohës/ aspektit/ mënyrës dhe evidencialëve të vërtetë. Përcaktimi i vendit të habitores në sistemin gramatikor të shqipes është i vështirë. Në studimet për të hasen qëndrime të ndryshme për dilemën: Kemi të bëjmë me një mënyrë të foljes apo me një kategori tjetër? Fiedler (1966), Buchholz dhe Fiedler (1987) dhe Desnickaja (1958, 1987) e shohin atë jashtë sistemit të mënyrave, bile Fiedler e vendos atë paralelisht me dëftoren, kjo edhe bazuar në faktin se habitorja ndryshe nga mënyrat tjera mohohet me pjesëzën *mos*, ashtu si dëftorja. Por edhe qëndrimi i Friedman-it se kemi të bëjmë me një lloj evidencialiteti që lidhet më shumë me vlerësimit e folësit për vetë informatën se sa me burimin e informatës

lidhur me burimin e informimit në thënie".

[8] "Vetë evidencialiteti kuptohet si pohim i ekzistencës së një burimi të evidencës për ndonjë informatë; kjo përfshin dhe të pohuarit se ekziston ndonjë evidencë, dhe duke specifikuar se çfarë lloji evidence ekziston".

[9] Veçoria themelore e evidencialitetit gjuhësor është inkodimi eksplicit i një burimi të informimit apo të njohjes (p.sh. evidencë) për të cilën folësi mëton ta ketë përdorur për të prodhuar fjalinë e parme të thënies së tij".

[10] "Evidencialiteti është domen semantik-funksional që ka të bëjë me llojin e 'provave' që janë në gjendje të sjellin folësit për të mbështetur pohimet e tyre".

paraqet vështirësi kur merret parasysh diskutimi për lidhjen ndërmjet evidencialitetit dhe modalitetit epistemik. Në shumë studime evidencialiteti është parë si nënkategori e modalitetit epistemik (Gunkel 2000, Palander- Collin 1999, Traugott 1997, Sumbatova 1999). Por në studimet e dy dekadave të fundit po pranohet gjithnjë e më gjerë qëndrimi se evidencialiteti është një kategori e pavarur (Bybee 1985, van der Auwera dhe Plungian 1998, Aikhenvald 2003, 2004, Diewald and Smirnova 2010, de Haan 2001) meqë i referohet vetëm evidencës që ka folësi për thëniet e tij dhe nuk e vlerëson atë. Vlerësimi i fakticitetit të një thënieje është tipar i foljeve modale dhe mënyrave të foljeve

> *[…], evidentiality, deals with the evidence the speaker has for his or her statement, while the other, epistemic modality, evaluates the speaker's statement and assigns it a commitment value. This evaluation is obviously done on the basis of evidence (which might or might not be expressed overtly, or which might or might not be expressed by means of evidentials), but there is nothing inherent in evidentials that would compel us to assign an a priori epistemic commitment to the evidence* (De Haan 1999: 98-99).[11]
>
> *The evidentials, however, signal only the way the speaker arrived at knowledge about the event* (Bybee 1985: 182).[12]

Sidoqoftë, sipas Aikhenvald (2003: 13) evidencialët mund të japin indikacion edhe për qëndrimin e folësit ndaj validitetit të informatës, por nuk mund të konsiderohen si pjesë e kodimit gjuhësor të epistemologjisë. Marrë parasysh këtë, edhe në rastin e habitores së shqipes mund të flitet për evidencialë. Evidencialët, ndryshe nga strategjitë evidenciale, janë markues të gramatikalizuar e që janë në ndërveprim me kategoritë e tjera

---

[11] […] evidencialiteti, ka të bëjë me evidencën që ka folësi për pohimin e tij apo të saj, ndërsa tjetra, modaliteti epistemik, e vlerëson thënien e folësit dhe i jep një vlerë lejimi. Ky vlerësim qartazi bëhet në bazë të evidencës (që mundet ose mund të mos jetë shprehur hapur, ose mund apo mund të mos jetë shprehur me mjete evidentcialësh), por nuk ka asgjë inherente në evidnecialët që do të na detyronte t'i japim asaj pajtim apriori me evidencën.

[12] Sido që të jetë, evidencialët sinjalizojnë vetëm rrugën përmes së cilës folësi e ka arritur njohjen lidhur me ngjarjen".

gramatikore. Strategjitë gramatikore, në anën tjetër, janë konstruksione që kanë kuptim evidencialiteti, por nuk dëshmojnë sistem të gramatikalizuar (Diewald dhe Smirnova 2010[2]: 42). Në rastin e habitores kemi të bëjmë me një sistem të gramatikalizuar e që ndërvepron me kategoritë e tjera (ka disa kohë, mund të kombinohet me mënyrën lidhore).

Përmbledhtas mund të thuhet se studimet e prof. Friedman-it për admirativin, jokonfirmativitetin e evidencialitetin na bëjnë të qartë se vetëm kjo mënyrë e vështrimit të formave të habitores brenda kontekstit në të cilin paraqiten (në rastet më ekstreme edhe kontekstit hapësinor) mundësojnë përshkrimin e plotë të një kategorie kaq komplekse foljore. Ato paraqesin një bazë të mirë për hulumtimet për përdorimin e habitores.

Blertë ISMAJLI, Faculty of Philology, Prishtina University

BEYOND CASE? A REVIEW OF MODALITY IN LIGHT OF FRIEDMAN'S ADMIRATIVE CASE

Summary

Friedman's discussions on the admirative in the frame of the verb system of Albanian and Balkan languages were intensified during the last decades of the second half of the 20th century. His in-depth studies on admirative were focused on its function. Traditionally, admirative has been described as a verb mood which is used to express surprise. But in later studies the function of referativity has been described as the main function of admirative forms. Since surprise is only one of the functions of the admirative forms, Friedman, based on Aronson (1967), suggests as more appropriate for all its functions term *nonconfirmative*. In order to correctly understand admirative he has emphasized the importance of the context. In his later work Friedman shows that admirative in Albanian is an evidential strategy, used to express the speaker's evidence about the proposition. In the discussion about evidentiality and its forms, a distinction is made between *evidentials* as grammaticalised markers interacting with other grammatical categories and *evidential strategies* which are constructions that have evidential meaning, but are not grammaticalised. Since admirative forms show a grammaticalised system and interact with other grammatical categories (tense, subjunctive mood), they can be understood as evidentials.

Bibliografia

Agalliu, F., Angoni, E., Demiraj, Sh., Dhrimo, A., Hysa, E., Lafe, E., Likaj, E. (2002). Gramatika e gjuhës shqipe 1. Morfologjia. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.

Aikhenwald A. Y. (2003). Evidentiality in typological perspective. Në Aikhenwald A.Y. dhe Dixon R. M. W. (ed.). *Studies in Evidentiality*. Amsterdam/Philadephia: John Benjamins, 1-31.

Aikhenwald A. Y. (2004). Evidentiality. Oxford: Oxford University Press.

Auwera, J., Plungian V. A. (1998). Modality's semantic map. Në Bech, G. *Linguistic Typology* 1 (1). 79-124.

Buchholz O., Fiedler W. (1987). Albanische Grammatik**.** Leipzig: VEB Verlag Enzyklopädie Leipzig.

Bybee, J. (1985). Morphology. Amsterdam/Philadephia: John Benjamins

Camaj M. (1969). Lehrbuch der albanischen Sprache. Wiesbaden: Harrassowitz.

De Haan F. (2001). The Relation Between Modality and Evidentiality. Në Müller, R. dhe Reis, M. (redaktorë). *Modalität und Modalverben im Deutschen. Linguistische Berichte, Sonderheft 9.* Hamburg: Buske.

Desnickaja A. V. (1987). Kuptimi i kategorisë së admirativit në shqipen. Në *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 12,* Prishtinë: Fakulteti i Filologjisë, 55-59.

Diewald G., Smirnova E. (editors) (2010)[1]. Linguistic realization of evidentialty in European Languages. Berlin/New York: Mouton de Gruyter.

Diewald G., Smirnova E. (2010)[2]. Evidentialty in German: Linguistic realization and regularities in grammaticalization. Berlin/New York: Mouton de Gruyter.

Fiedler W. (1966). Zu einigen Problemen des albanischen Admirativs. Në *Zeitschrift der Karl-Marx-Universität Leipzig: Gesellschafts- und Sprachwissenschaftliche Reihe, 15/3.* Leipzig: Karl-Marx-Universität Leipzig, 561-566.

Friedman V. A. (1999). Evidentiality in the Balkans. Në Hinrichs U. (redaktor). *Handbuch der Südosteuropa-Linguistik.* Wiesbaden: Otto Harrassowitz, 519-544.

Friedman V. A. (2004). Studies on Albanian and other Balkan Languages. Pejë: Dukagjini.

Friedman V. A. (2003). Evidentiality in the Balkans with special attention to Macedonian and Albanian. Në Aikhenvald A. Y. (ed.). *Studies in Evidentiality*. Amsterdam/ Philadelphia: John Benjamins, 189-218.

Friedman V. A. (2005) Admirativity: between modality and evidentiality. Në Gippert, J., Erdal, M. dhe Voßen, R. (ed.) *Sprachtypologie und Universalienforschung.* Berlin: Akademie Verlag, 26-37.

Gunkel, L. (2000). Selektion verbaler Komplemente. Zur Syntax der Halbmodal- und Phrasenverben. Në Thieroff, R. (ed.) *Deutsche Grammatik in Theorie und Praxis.* Tübingen: Niemeyer, 111-121.

Palander-Collin, M. (1999). Grammaticalization and Social Embedding: I Think and Methinks in Middle and Early Modern English. Helsinki: Société Néophilologique.

Riza S. (1997). Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore, Vepra 2. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.

Sumbatova, N. (1999). Evidentiality, transitivity and split ergativity: evidence from Svan. Në Abraham W. dhe Kulikov, L. (ed.) *Tense-Aspect, Transitivity and Causativity.* Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins, 63-95

Traugott, E. C. (1997). Subjectification and the development of epistemic meaning: the case of promise and threaten. Në Swan T. dhe Westvik O. J. (ed.) *Modality in Germanic Languages: Historical and Comparative Perspectives.* Berlin/New York: Mouton de Gruyter, 177-196.

Jani THOMAI, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë

RRETH "FJALORIT SHQIP – ANGLISHT" *("OXFORD ALBANIAN – ENGLISH DICTIONARY")* TË LEONARD NEWMARK-UT

Një shënim i shkurtër: *E njoh këtë fjalor që para botimit, në dorëshkrim, duke ndjekur procesin e hartimit dhe duke i dhënë autorit ndihmën e mundshme e mendimet e mia që atëherë, me shkrim. Kam pasur mundësinë që profesor Leonard Newmark-un ta njoh në fillim nëpërmjet "Gramatikës strukturale të shqipes" dhe më pas nëpërmjet librave të tjerë për gjuhën shqipe*[1]*, të mbrujtur me dashuri për Shqipërinë, për shqiptarët dhe për gjuhën shqipe. Por pata një rast të bukur të takohem edhe me atë vetë, më 1994, kur unë e kolegu im, profesor Xhevat Lloshi, merrnim pjesë në Kongresin VI të EURALEX-it në Amsterdam. Të nesërmen e mbërritjes, në mëngjes, na afrohet ai burrë i shëndetshëm e me trup mesatar, bashkë me profesoreshën Betyl Sue T. Atkins, me të cilën ishim njohur më herët në Kongresin III të EURALEX-it në Budapest, më 1988, atë kohë presidente e kësaj Shoqate. Ajo, mike e mëhershme e profesorit, na paraqiti te L. Newmark-u: "Ja ku i keni shqiptarët tuaj". Mbaj mend shprehjen e parë të profesorit, me buzëqeshje të çiltër e me sy gazmorë: "Po ju kërkoj. Kam ardhur i nxitur edhe për këtë, kur mora vesh se në Kongres do të ishin edhe dy shqiptarë". Ishte koha kur ai, siç na tha, po përpiqej të gjente një sponsorizues për botimin e fjalorit të tij. Koha që qëndruam e biseduam me atë ishte vërtet e frytshme dhe e këndshme.*



---

[1] *Structural Grammar of Albania,* 1957; *On outline of Albania (Tosk) Structure,* 1969; *Readings in Albanian – Albanian language* (+ Peter Prifti, Philip Hubbard), 1979; *Standard Albania – A Reference Grammar for Students* (+ Peter Prifti, Philip Hubbard), 1982, 368 faqe; *Read Standard Albania online,* 1982, 347 faqe; *Spoken Albanaian,* 1997; më pas *Albanian Handbook: With English to Albanian Glossary,* 2000, 360 faqe.

Njohja ime me natyrën e fjalorit të tij, më parë, erdhi përmes të ndjerit Vladimir Dervishi, ish-punonjës për terminologji në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë në Tiranë, por që ishte larguar e ndihmonte profesor Newmark-un në UCSan Diego (University of California San Diego) për këtë fjalor. Ai më kishte sjellë kohë pas kohe në Tiranë, në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, disa fashikuj të printuar të fjalorit, me lutjen nga profesori që t'i jepja vërejtjet e mia, si edhe disa lista fjalësh që t'i verifikonim në Kartotekën e leksikut të shqipes për trajtat, kuptimet, burimet, gjeografinë e fushat e përdorimit etj. Ia kemi plotësuar të gjitha këto kërkesa pa ngurrim, duke i dhënë informacion për saktësimin e shumë leksemave.

Prej vitit 2000 këtë fjalor e kemi të botuar edhe në Shqipëri, të renditur tashmë në literaturën tonë shkencore leksikografike. Por duhet pohuar që në Shqipëri ky fjalor nuk ka pasur përhapje të kënaqshme dhe kritika shkencore nuk është marrë shumë me atë, ashtu si e meriton, në radhë të parë për ndihmesat shkencore si dëshmi e fjalëve shqipe me të gjitha vlerat e tyre e pastaj sipas identifikimit nëpërmjet gjegjëseve anglisht.

Albanian – English Dictionary / Fjalor shqip – anglisht edited by Leonard Newmark[2]

Në paraqitjen e *"Fjalorit"* bëhet e ditur që ai përmban mbi 75.000 njësi leksikografike (fjalë, lokucione, shprehje e idioma me shpjegime shkencore) nga standardi, jostandardi, ligjërimet dhe fjalori teknik. Ai jep informacion enciklopedik e kulturor, veçanërisht për elementet kulturore specifike të terminologjisë. Është fjalor i kuptueshëm i shqipes moderne, referencë thelbësore për studentë, shkollarë, përkthyes dhe për çdo studim mbi gjuhën shqipe. *"Fjalori"* përmban edhe mijëra shembuj frazash që shqipja i ka sot në përdorim, bën trajtim të plotë të idiomave, të proverbave dhe të shprehjeve të figurshme, jep hollësi të shqiptimit, një përshkrim të alfabetit të shqipes, një *vademecum* të gramatikës themelore të shqipes dhe të varianteve dialektore, foljet e parregullta në rend alfabetik me tekste identifikuese dhe një suplement të përditësuar të sufikseve me

[2] Botimi shqip: *Albanian – English Dictionary – Edited by Leonard Newmark / Fjalor Shqip – Anglisht,* Albin, Tiranë, 2000.

formante të panjohura. *"Fjalori"* është i përshtatshëm edhe për të pasdiplomuarit[3]. Kjo është një paraqitje e përgjithshme autoriale e strukturës dhe e lëndës shqipe që përmban *"Fajlori".*

Për*"Fjalorin"* janë botuar pak shkrime, - dobësi e përgjithshme e kritikës sonë shkencore, - që kanë zbuluar vlerat e tij dhe kanë sjellë mendimet e autorëve për arritjet e zbrazëtitë në këtë vepër. Vëmendje të veçantë tërheq artikulli i profesor Hajri Shehut[4], leksikolog e leksikograf i njohur, zotërues i anglishtes dhe me gjykime shkencore të sakta për këtë fjalor. Duke shqyrtuar botimin e Oxford University Press, *"Oxford Albanian – English Dictionary",* 1998, Hajri Shehu përshkruan përmbajtjen e tij, burimet e lëndës, shtresat leksikore që pasqyron, mënyrën e paraqitjes leksikografike, mënyrat e identifikimit semantik e stilistik të njësive të shqipes me njësi të anglishtes, prurjet e mungesat e *"Fjalorit",* destinimin e tij etj. Autori i artikullit e vlerëson *"Fjalorin"* për shfrytëzimin e arsyetuar të fjalorëve shpjegues të shqipes, kryesisht të *"Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe"* (1980), të *"Fjalorit të shqipes së sotme"* (1984) dhe të fjalorëve terminologjikë, për konsultimin e Kartotekës së leksikut të shqipes, për vjeljet edhe të veprave të autorëve të diasporës etj., duke sjellë kështu "vlera pozitive potenciale për leksikun e gjuhës së sotme shqipe". *"Fjalori"* pasqyron gjerë edhe fjalët e përbëra, emërtimet e pathjeshta, frazeologgjinë etj. Aty përfshihen fjalë që shënojnë nocione e dukuri nga të gjitha fushat e veprimtarisë shoqërore, të jetës, të shkencës etj., si dhe nga të gjitha klasat leksiko-semantike. Fjalori shihet kështu si vepër që përmbush synimet e autorit dhe shërben si një libër i dobishëm referimi. Por Hajri Shehu vë në dukje edhe disa të meta të këtij fjalori në dritën e parimeve e të kritereve leksikografike bashkëkohore, lidhur me pasqyrimin e emrave të përveçëm, të ndajshtesave, të trajtave gramatikore, të varianteve fonetike krahinore (madje periferike), lidhur me mungesën e simetrisë në pasqyrimin e terminologjisë së fushave të ndryshme, të emrave të mocio-

[3] Shih edhe zërin *Leonard Newmark* në internet.

[4] Hajri Shehu, *Oxford albanian – English dictionary,* në Studime filologjike, Tiranë, 1999, 1-2, f. 187- 197.

nit, të thënieve e të frazeologjisë etj.

Natyrisht, puna e parë e studimit është përcaktimi i tipit të këtij fjalori. Sipas tipologjisë leksikografike *"Fjalori"* synon qartazi të jetë dygjuhësh, por nuk mund të shkohet më tej për ta cilësuar si të përgjithshëm a dialektor, normativ a jonormativ, leksikor (vetëm me fjalë) apo edhe me njësi të tjera (trajta fonetike, sintagma e togfjalësha, emra të përveçëm njerëzish, toponime etj.), madje thjesht dygjuhësh apo edhe me elemente shpjeguese a me referime të fjalëve shqipe te fjalë shqipe etj.

"Fjalori" mund të shqyrtohet në rrafsh lekikografik duke ndjekur dy linja kryesore: a) Çfarë sjell nga pasuria leksikore, frazeologjike, semantike e leksematike e gjuhës shqipe dhe b) si është arritur identifikimi i vlerave të tyre nëpërmjet ballafaqimit me gjegjëset të anglishtes. Këtu do të ndjekim vetëm linjën e parë. Në linjën e dytë, që kërkon studiues me njohuri të plota për të dy gjuhët, shqip e anglisht[5], po kujtojmë vetëm që çdo fjalor dygjuhësh humbet diçka nga gjuha primare, sepse nuk është e mundur që një fjalë e gjuhës së parë të jepet me të gjitha vlerat (semantike, stilistike, sintagmatike, paradigmatike etj.) me një fjalë të gjuhës së dytë, pra, me të gjitha kuptimet e nuancat kuptimore, me ngjyrimet më të holla emocionuese, shprehëse e stilistike, me leksematikën e plotë dhe me gjithë lidhjet paradigmatike të mundshme, me situatat ligjërimore të përdorimit e me të tjera veçanti që çdo fjalë i shfaq vetëm në rrjedhat ligjërimore të gjuhës së vet, madje në lëvizje, zhvillim e ndryshim të vazhdueshëm. Edhe në përkthimet më të përkryera fjalët humbasin diçka nga gjuha e përkthyer, por gjithsesi në përkthime ka hapësirë më të madhe për perifrazime e shpjegime plotësuese, të cilat nuk është e mundur të shfrytëzohen në fjalor në ato përmasa e forma të shprehjes, sipas parimit që "ndërmjet gjuhëve të ndryshme ka më shumë përputhje konceptesh sesa kuptimesh". Shija e leximit të tekstit origjinal nuk mund të jetë aq e plotë as në përkthimin më të mirë.

Ndër tiparet e dallueshme të *"Fjalorit",* dy janë më të dukshmet: a)

[5] H. Shehu në artikullin e cituar është marrë pak edhe me këtë linjë të dytë leksikografike, shih f. 193-195.

shumësia e larmia kategoriale e njësive leksikografike[6] me vlerë kryesisht informuese dhe b) sistemi jo i plotë i njësive leksikografike tipologjikisht të njëjta a të ngjashme, pra, me mungesa që mund të shpjegohen me zgjedhjet shpesh të rastit nga burimet e lëndës dhe që, me mirëkuptim, mund të shihen thjesht si njësi të njëjta a të ngjashme të nënkuptuara nga modelet si ato a nga shembujt e dhënë në *"Fjalor"*. Të dy këto tipare nuk e kanë lehtësuar punën hulumtuese të autorit, përkundrazi, tregojnë gjithsesi sa imtësore dhe e lodhshme ka qenë ajo, sado e shtrirë në një kohë relativisht të gjatë kërkimi e studimi.

Parimi kryesor i përcaktimit të njësive leksikografike, që përshkon korpusin shqip në *"Fjalorin shqip–anglisht"* të L. Newmark-ut, i përmbahet konceptit të gjuhësisë angleze për njësinë leksikografike, kryesisht në fjalorët shpjegues, por edhe në ata dygjuhësh, - koncept në pajtim me natyrën e brendshme të strukturës së anglishtes, i shprehur edhe nga M. Webster-i[7] në fjalorin e madh, sipas të cilit janë të tilla jo vetëm fjalët "kompakte", por edhe "fjalët e hapura" (*Open Word*), si *blind-man's buff, prison breaking, room-mate, school age* etj. Në gjuhësinë angleze, për shkak se në anglishte si gjuhë analitike "tema dhe fjala identifikohen, njësitë togfjalëshe merren edhe si fjalë, madje quhen edhe 'fjalë të hapura'"[8], megjithëse në anglishten, për shkak të mungesës së eptimit gramatikor, kriteri i strukturës së mbyllur a të hapur për cilësimin fjalë a jofjalë të njësive gjuhësore, nuk vepron. Prandaj në grafi janë të mundshme tri mundësi për mënyrën e interpretimit të shqiptimit: bashkë *bedroom,* me vizë *bed-room* dhe ndaras *bed room.* Por grafia nuk ndikon në semantikën e as në përdorimin e njësisë leksikografike kur struktura e brendshme e njësisë është e mbyllur, çështje që nuk shtrohet për anglishten, sepse gjymtyrët e togfjalëshit janë neutrale gramatikisht për mungesë të eptimit. Besojmë se ndikimin e këtij koncepti, të pranuar teorikisht në leksikëlogji dhe praktikisht në leksikografi, L. Newmark-u e ka shtrirë në fjalorin e

[6] Ose: *zë leksikografik, paragraf leksikografik, njësi titull në fjalor.*

[7] M. Webster, *Webster's third new international dictionary,* New York, 1961, f. 30 v.

[8] Agron Duro, *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe,* Tiranë, 2009, f. 73-74.

tij edhe në korpusin e shqipes, sikundër parimisht e propozon profesor Agron Duro, kryesisht për terminologjinë, që, në bashkëpunim me specialistët, togfjalëshat terminologjikë me lidhje të ngurosur dhe shumë të ngulitur, të jepen në fjalorët e shqipes, edhe shpjegues e dygjuhësh, veçanërisht në fjalorin e madh, si njësi më vete, pra, si njësi leksikografike, njësoj si fjalët, si p.sh. *punë dore, dhomë gjumi, bar blete, yll deti, rrënjë katrore* etj.[9]. E kësaj ideje është pjesërisht zgjidhja që është dhënë në *"Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe"* për disa emërtime të pathjeshta, kryesisht bimësh e kafshësh, duke i vënë si nënzëra leksikografikë (por përsëri si njësi leksikografike) nën gjymtyrën e parë dhe duke i shpjeguar tipologjikisht si fjalët; p.sh. te ***bar,-i*** *(bot.): bar argjendi, bar balsami, bar beronje, bar bibe, bar blete, bar brenge, bar breshke, bari i dalës, bar delli...* (107 njësi të tilla); te ***kal/ë,-i*** *(zool.): kali i detit, kali i qyqes, kalë shtrigash (shtrige);* te ***kasht/ë,-a:*** *Kashta e Kumtrit (astr.);* te ***lul/e,-ja*** *(bot.): lule akulli, lule alle, lule argjendi, lule balsami, lule blete, lule bore, lule breshke, lule bretku, lule bualli...* (83 njësi të tilla); tek ***yll,-i:*** *yll deti (zool.);* te ***zog,-u*** *(zool.): zog bari, zog blete, zog bore, zog dimri, zogu i dhenve, zog ferre, zogu i natës, zog nuseje...* etj.[10].

Nga *"Fjalori"* i L. Newmark-ut po shqyrtojmë më tutje disa njësi leksikografike, me përzgjedhje sipas kategorisë së njësive të fjalësit shqip, për të parë edhe ngjashmëritë e dallimet me *"Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe"* nëpërmjet krahasimit të njësive leksikografike te secili[11].

Lëndën e shqipes në *"Fjalor"* mund ta klasifikojmë në tri grupe njësish leksikografike:

1. Njësi leksikografike ***fjalë (njësi leksikore):*** fjalë të përgjithshme, fjalë dialektore e krahinore, fjalë terminologjike, fjalë të reja (neologjizma të pangulitur), fjalë e forma të vjetruara (arkaizma, historizma, etnogra-

[9] *Po aty,* f. 74.

[10] Shih *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe,* Tiranë, 1980, përkatësisht në faqet 96-98, 764, 796, 1021-1022, 2204, 2246.

[11] Në këtë paraqitje janë sjellë shumë shembuj në çdo grup për të dëshmuar dukurinë nga çdo shkronjë dhe nga çdo tip strukturor brenda grupit përkatës.

fizma e folklorizma), fjalë të huazuara të leksikut pasiv, emra të përveçëm, variante fjalëformuese, variante gramatikore.

2. Njësi leksikografike ***nënfjalë:*** shkronja të alfabetit, ndajshtesa, shkurtesa, onomatope, trajta gramatikore, variante fonetike dialektore e krahinore.

3. Njësi leksikografike ***mbifjalë:*** lidhje sintagmatike e leksematike, togfjalësha (të qëndrueshëm), njësi frazeologjike, fjalë të urta e proverba.

Siç shihet, këto tri grupe përbëhen nga njësi të pesë nënsistemeve të gjuhës: fonetik, leksikor, morfologjik, fjalëformues e sintaksor.

I. Njësi leksikografike të grupit të parë, ***fjalë (njësi leksikore),*** janë nëntë nëngrupe:

1) ***Fjalë të përgjithshme:*** *ai, akull, ar, baba, bëj, bie, i bukur, cekët, çaj, dardhë, darkë, dua, edhe, dhëmb, eci, erë, ëndërr, fal, fik, fisnik, fushë, gabim, gur, i gjerë, harron, im, iki, jam, ju, kam, këmbë, kuq (i), kur, kush, lart, lyej, marr, mbi, me, mirë, ndez, ngurtë (i), njomë (i), orë, për, po, praptas, qaj, i qeshur, ruaj, rrafsh, si, sot, shaj, shoh, shqip, ti, tokë, tret, trim, thaj, thartë (i), them, thyej, urtë (i), varfër (i), vete, vij, xixë, xham, ylber, ynë, zemër, ziej, zhvesh* etj. Fjalë të tilla të shtresës leksikore të përgjithshme e aktive, të të gjitha kategorive leksiko-gramatikore, janë me dhjetëra mijë e pasqyrohen natyrshëm gjerësisht në *"Fjalor",* si në çdo fjalor shpjegues a dygjuhësh. Ato përbëjnë brumin kryesor edhe të këtij fjalori e përgjithësisht janë fjalë të shqipes standarde.

2) ***Fjalë dialektore e krahinore*** (disa edhe pa shkurtesën përkatëse *Reg*): *agjapis, agjivonjë, aikugjë (arb.), ajnik, babauk, blogurë, bubëzuem (i), cabik, callangur, cerfuq, ciplidhe, curak, çuçull, dremkë, dromis, dugajë, dhëmbajkë, esh, fakurgjí, furfullacë, gjanosh, herm.on, hulluveqkë* "kukuvajkë", *etnor, ide, kâmbgjithkuri, korí, lepitkë, linjyrë, llomitun (i), mahí, mëryershëm (i), mëshil, mëshkall, mrul.et, ndoruem, piturbasë, pothue, rusica, spërk, shit.on, shkag.on, shotan, tangar, tubanik, thinisht, ukëm, vokan, zymn.en, xërxalla, xixar, xhulliorë, zgal, zhugull* etj. Autori ka qenë i kursyer për t'i kufizuar gjithë krahinorizmat me shkurtesën *Reg.*

3) ***Terma specialë:*** *afazi (Med), afoní (Med), akantore (Bot), bajamor (Med), barisferë (Geol), bukurzaní (Ling), cirkus (Elev), dikotiledone (Bot), djathaç (Etnogr), drejtshqiptimor (Ling), dubël (Cin), dhanore (Ling), eliptik (Med), enklitik (Ling), freshkull (Bot), hidroksid (Chem), imperfekt (Ling), jodur (Chem), karbit (Chem), korrekto.n (Publ), kryekrushk (Ethnogr), kukudh (Folklore), larghedhës (Mil), leshtakësí (Med), monolog (Lit), mykzë (Agr), neolit (Archeol), njilë (Ichth), oshtë (Agr), qelbës (Zool), palk (Theatr), prapagjuhore (Ling), raportor (Geom), rondelë (Tech), rrolbë (Bot), strabizëm (Med), stramastik (Bot Zool), shkakësí (Philos), tangjente (Geom), trotil (Chem), thërroke (Bot), Uranium (Chem), vanadium (Chem), vals (Mus), valutë (Fin Econ), xhaul (Phys), xhaz (Muz), zgjebor (Med), zorrë çapokore (Anat), Zorrë e prapme (Biol), zhuzhaku i misrit (Entom)* etj. Duket që autori e ka pasur në vëmendje të vaçantë këtë nëngrup dhe, siç pohon në *Parathënie,* termat i sheh si "elemente kulturore specifike".

Ndërkaq, jo të gjitha fushat konceptore pasqyrohen njësoj në këtë fjalor. Ka fusha që pasqyrohen më gjerë, pothuajse plotësisht. Këtu po sjellim disa të dhëna nga emërtimet e botës fetare (besimet, objektet, konceptet, ceremonitë, ritet, funksionet etj.), që janë terma, joterma ose emra të përveçëm, kryesisht të rendit të parë të emërtimit. Natyrisht, në pajtim me tipin e vëllimin e përcaktuar të këtij fjalori, emërtime për koncepte të rendit të dytë e më të imëta nuk përfshihen. Në *"Fjalor"* gjenden: *abdes/ avdes, Ajodhimë, Allah, ashure, autoqefal, autoqefalí, Bajram, Bajram i madh, Bajram i vogël, bektashí, bektashian, bektashizëm, bibël, biblik, blatë, blatoj, budist, budizëm, çallmë, dioqezë, dhjak, dhjakoní, fe, fetar, fetarí, gjyshatë, hoxhë, islam, islamizëm, kamillaf, katedrale, katolik, katolicizëm, kishë, kishar/ kishatar/ kishtar, kreshmë, kreshmët e gushtit, kreshmët e vogla, kreshmët e mëdha, Kreshma e Këshnellavet, kreshm.on, kreshmor, Kreshnella, kristian, kristianizëm, Krisht, Krishterë (i), krishterim, Krishtlindje, Krishtngjallje, kryegjysh, kryegjyshatë, kryepeshkop, kryeprift, kuran, kungatë, kungatës, kungë, kungore, kungim, kungoj, lumnim, luteran, lutësore/ lutjesore, medresé, meshar, meshë, mesh.on, meshtar, meshtarí, minare, muhamedan, muhamedanizëm, mysliman, myslimanizëm, naforë, ortodoks, ortodoksí, pagëzim, pagëz.on, pagëzimore, pagë-*

zimtar, pagëzor, pagëzore, pagezues, papat, papë, pashkë, Pashkët e vogla, Pashkët e mëdha, patrik, patriark, patrikanë, Pentakostë, perëndi, petrahil, peshkop, peshkopatë, përshpirtje, potina, purgator, rrufaí, rrëfehem, rrëfyes, rrëfyestore, sarëk, sinagogë, sure, syfyr, synet, synetllëk, sheh, shenjtëri, shenjtëror, shenjtëro.het, shenjtërore, shentorteolog, shëlbesë, shëlbo.het, shenjtërore, shentor, teolog, teologjí, teologjik, teqé, tropar, thimjaton, ungjill, ungjillëzim, ungjillëz.on, ungjillor, uratë, uratar, xhami, xhybe, zot etj. Kuptime terminologjike jepen edhe te fjalë me strukturë semantike më të gjerë, si: *babá* (kupt. 2), *çallmë* (kupt. 1), *rrëfe.hem* (kupt. 3), *rrëfyesa* (kupt. 2), *shëlbim* (kupt. 1), *shëlbo.n* (kupt. 1), *shërbesë* (kupt. 1 e 2), *teqé* (kupt. 1) etj., kurse disa emërtime të të njëjtit tip e të rendit të parë janë dhënë pa shënimin *Relig* në asnjërin kuptim, pra, nuk janë karakterizuar si terma mirëfilli fetarë, si: *atë, Buda, grigjë, gjakon, gjysh, kardinal, kryq, minare, motër, Muhamet, murg, murgë, murgeshë, nënë* /p.sh. ~ Tereza/, *norie, pader* /p.sh. ~ Gjergj Fishta/, *parajsë, potir, prift, qirí, rrëfenjëtar, rrëfim, sarrëk, shenjt, trisaí, vakëf, Vatikan, xhybe...;* kështu ato duket se i përkasin leksikut të përgjithshëm, por, natyrisht, duke mbartur edhe kuptimet fetare, d.m.th. kuptimet fetare janë pjesë e strukturës së tyre samantike; përveç këtyre, ka edhe disa fjalë të prejardhura prej termash fetarë, që në *"Fjalor"* janë vënë pa shënimin *Relig,* si: *bekim, besim, besimtar, blatim, blator, blatues, fale.t, ikonostas, kambanore, kuranor, lutje, meshim, priftëreshë, priftëri, priftër.on, priftëror, priftërim, rrëfim, shenjtërim, shenjtëruar (i), temjanicë, temjanis, Ujët e bekuar* etj. Kuptimi fetar te këto fjalë nënkuptohet nga temat fjalëformuese të fjalëve nga janë formuar, të cilat në *"Fjalor"* shoqërohen rregullisht me shënimin *Relig.*

4) ***Neologjizma (të pangulitur):*** *Afërlindje* "Near East", *afërmëní* "nearness; kinship", *agullor, ajërngjeshës, ajërtransportueshëm (i), ajraní / ajroanije, babasor, babësjellë, babitës, barbërës* "barnatar", *bollësisht, cungulluar (i), çndershëm (i), çlyrësues, dashatar* "admirues", *djathore* "baxho", *dorëhartuem (i)* "artificial", *dorëlëvizje* "gjest", *drejtrreshto.n, drubirues, dhëmbëtar, dhëmbëtarí, dhuratisht, efshueshëm (i), fajfalës, faqesí, grushtar* "boksier", *gjelbërisht, hanar* "hanxhi", *haliqshëm (i), hi-*

jelutës "supersticioz", *hundo.het, ishullan, jakatar, jetëngathët, këmbëtul, kokrro.n, kryepërpjetësí, lepurore, leshtakësí, malsheshe* "pllajë", *mburrësí, mbushtar, mendtarisht, mënyrësí, mjaltshëm (i), ngjetshëm (i), nisesos* "gjithnjë", *ngjyrëzezë* "karabojë", *njëmendo.n, ofertues, panomërisht, papërfundshëm (i), pemëso.n, përcepët (i)* "diagonal", *përanës* "përkrahës", *përcipje* "sipërfaqe", *përcukë* "parukë", *përçkëmbesë, përhyrje* "parathënie", *përkrejcë* "tregues, indeks", *përkrejtëm (i)* "i skajshëm, ekstrem", *qimerruar, rëndëso.n, rudëzo.n, rrebesho.n, rrumbullakur (i), sipërsí, sufro.n, shpërgo.n, shthërret, tufshak, thjeshëm (i), ullukuar (i), veshatore, vjeshto.n, zbulor, zhytore* etj.

5) ***Arkaizm, historizma, etnografizma e folklorizma.*** *"Fjalori"* ka përfshirë si njësi leksikografive një numër jo të vogël për përmasat e veta, si: *Borëbardhë (Folklore), bukëtore, buzm (Ethnog), çidikë, çifçí (His), Fruer* "shkurt", *heshtar, hobetar, kapsollaqe (His), kolendër (Ethnog), kollozhek* "janar", *mburues, pobratinë (Reg Ghedg), shëndré* "dhjetor", *shishane (His), verore (Ethnog), xhumá (e)* "e premte" etj. Sikundër neologjizmat e pangulitur, edhe fjalët e formimet e vjetruara i takojnë përgjithësisht leksikut pasiv. *"Fjalori"* ato i ka përfshirë i motivuar sipas funksionit informues, por ai nuk mund "të jetë një mjet për lexuesit e jo një arkiv historik i gjuhës", siç thuhet në *Parathënien* e tij, kur shtresa të tilla leksikore, bashkë me huazimet e vjetruara, krahinorizmat periferikë, variantet fonetike dialektore e krahinore, termat specialë të kufizuar, emrat e përveçëm etj., mbulojnë shtresën aktive të leksikut të shqipes, në numër përtej përmasave të një fjalori të këtij tipi[12].

6) ***Fjalë të huazuara (kryesisht turqizma të vjetruar),*** si: *abá, abolla, açik, arabaxhí, adyqar, aferim, afif/ hafif, ahçí/ akçí, ahçillëk/ akçillëk, ajan, avaz/ havaz, ezhdërhá, faizçí, havá, havadan, havalé, havllí, haxhillëk, hazër, hazërxhevap, iqindí, javashllëk, kollozhek, mahmur, qylyk, sevap, sevdá, shehër, xhaba, xhanan, xhanavar, xhelep, xhaphané, xherah, xhevap, xhumá (e), ymër, yshyr, zahmet, zaif, zaman, zap* etj.; nga gjuhë të tjera: *abordazh, absent/ absint, acidik, açuge, adezion, adiabatë, adonik,*

[12]Shih edhe te H. Shehu, *art. i cit.,* f. 189.

adhiqi, adhjase, aeropankë, afendikó, afel, afinitet, bluming, blum, dromedar, ezhektor, finte, sempël "thjeshtë" etj.

7) ***Emra të përveçëm.*** Një fjalor tipologjikisht leksikor i përgjithshëm, zakonisht, nuk përmban emra të përveçëm, por zgjedhja në këtë rast i mbetet autorit. Në këtë *"Fjalor"* emrat e përveçëm, të ndarë në grupe, zbulojnë edhe asimetrinë e pasqyrimit leksikografik:

7a) ***Emra njerëzish (vetjesh e patronime)*** ka disa të burimit shqip, kryesisht të ardhur nga leksiku i përgjithshëm: *Afrim, Agim, Bajame, Bekim, Besart, Besim, Bukurosh, Drita, Dhurata, Dhurime, Festim, Fitore, Flutura, Lirí, Luan, Lulash, Luli, Lulzim, Lulzime, Lumturí, Majlinda, Manushaqe, Mira, Miranda, Mirash, Rinush, Shega, Valdete, Vjosë, Yllka, Zamir, Zana* etj., ose të tjerë me prejardhje të huaj: *Aidin, Eno, Faik, Hamza, Mahmut, Qamil, Ramiz, Rustem, Sanie, Seit, Sulejman, Xhemal, Zarik* etj.

7b) ***Emra vendesh, qytetesh, krahinash, malesh e lumenjsh të botës shqiptare:*** *Berat, Burrel, Bushtricë, Butrint, Çamëri, Dardhë, Dibër, Drin, Dropull, Dukagjin, Durrës, Elbasan, Erzen, Fier, Frashër, Fushë-Krujë, Gjakovë, Gjirokastër, Ilirí / Illyrí, Kavajë, Kolonjë, Korab, Korçë, Kosovë, Krujë, Kukës, Labëri, Lezhë, Librazhd, Lushnjë, Mallakastër, Mat, Maliq, Mirbardh, Mirditë, Myzeqé, Nartë, Pejë, Peqin, Pogradec, Prizren, Pukë, Sarandë, Seman, Skrapar, Shkëlzen, Shkodër, Shkumbin, Shkup, Shpirag, Tepelenë, Tiranë, Tetovë, Tropojë, Tërbuf, Tomor, Thumanë, Ulqin, Vjosë, Vlorë, Voskopojë, Zadrimë, Zagori* etj.; por nuk janë dhënë emra të tillë, si: *Albaní, Cukal, Çikë, Dajt, Dardaní* (ka *dardan* dhe *Dardan* "mal"), *Devoll, Dumré* (ka *dumrejas*), *Enkelejdë* (ka *enkelejas*), *Ersekë, Gjilan, Ishm, Kallmet, Këlcyrë, Kir, Konispol, Laç, Manastir, Milot, Mokër, Ohër, Peshkopi, Përrenjas, Preshevë, Prishtinë, Rrëshen, Rrogozhinë, Strugë, Sheper, Shtoj, Tetovë, Tomorricë, Tropojë, Tërbuf, Thumanë, Valbonë, Vermosh* etj.

7c) ***Emra vendesh, qytetesh, krahinash, malesh e lumenjsh në botë:*** *Abisini, Adrianopojë, Afganistan, Afrikë, Aman, Anglí, Atikë, Athinë, Austerlic, Australí, Austrí, Babiloni**,** Bagdad, Bahrejn, Barbados, Barbarí, Bashkimi Sovjetik, Baskí, Belgjikë, Bengal, Benin, Beograd, Bermude, Bernë, Bjellorusí, Bosnjë, Bukuresht, Bullgarí, Çekosllovakí, Danimarkë, Egjé,*

Egjipt, Elladhë, Esthoní, Finí/ Finlandë, Francë, Gjermaní, Hagë, Havá, Hispaní, Holandë, Hungarí, Irlandë, Islandë, Italí, Japoní, Kamboxhia, Kili, Kinë, Kirkiz, Kongo, Kopenhagë, Koré, Kroací, Letoní, Lisbonë, Lituaní, Londër, Luksenburg, Malajzí, Mali i Zi, Maqedoní, Malbor, Mesdhé, Moskë, Napoli, Norvegjí, Poloní, Portogalë, Pragë, Rumaní, Rusí, Selenik/ Selanik, Serbí, Sllovení, Sofje, Spanjë, Suedí, Ukrainë, Varshavë, Vietnam, Vjenë, Zvicër etj.; por nuk ka: *Amsterdam, Ballkan, Barcelonë, Berlin, Budapest, Dublin, Katalonjë, Kiev, Kishiniev, Lubljanë, Madrid, Milano, Minsk, Moldaví, Oslo, Paris, Pekin, Pfenian, Rejkjavik, Rigë, Romë, Sarajevë, Stokholm, Seul, Talin, Tokio, Vinus, Xhakartë, Xhamajkë, Zagreb* etj. Ja dhe disa emra planetesh, yjesh e yjësish: *Jupiter, Kashta e Kumtrit/ Udha e Qumështit, marsi, planet, Shenjëza, Udha e Qumështit, Ylli i dritës...,* por nuk jepen *Afërdita, Dorëzat, Neptuni, Plutoni, Saturni, Venera (Venusi), Ylli i Mëngjesit, Ylli Polar* etj. Kështu duket qartë edhe mosbarazia ndërmjet emrave shqip e të huaj të të njëjtit rrafsh në *"Fjalor"*.

8) ***Variante fjalëformuese:*** *afër/ afërmas/ afras/ afrazi, afërsisht/ afrisht, agëzotllëk/ agzotës, ahishte/ ahishtë, babëlok/ babëlosh, balticë/ baltishtë, ballaballas/ ballaballë, ballafaqes/ ballafaqe, carrua/ camërdhok, çafkëlore/ çafkore, çapejak/ ecejak, duarzbrazët/ duarzbrazur, faqezezaj/ faqezezë, fytyrërrumbullak/ fytyrërrumbullakët, gjahtar/ gjahtor/ gjuetar, harraman/ harraq/ harrestar, jashtëm (i)/ jashtësëm (i), koc/ kockë, kryedukë/ arkidukë, lëndët (i)/ lëndor, mollamuç/ mushmollë, mushkash/ mushkët (i), ngatërrac/ ngatërrestar, ngjitas/ ngjitë/ ngjitur, pendimas/ pendueshëm, qytetarësí/ qytetarí/ qytetërí/ qytetësí, recenzent/ recensues, rrëmihës/ rrëmimtar/ rrëmitës/ rrëmojës/ rrëmues, skëterrtë (i)/ skëterrshëm (i), sharrëtar/ sharrok/ sharrues, shipfacak/ shipfaman/ shpifarak/ shpifarraq/ shpiftar/ shpifës, tanithi/ taní, tjerrës/ tjerrtar, thatik/ thatiq/ thatush/ thatanik, uthullare/ uthullicë/ uthullirë/ uthullishtë/ uthullnike, vetëti.n/ veto.n, vockaran/ vogëlosh/ vogëlush, xhampunues/ xhamtar, zgjebanik/ zgjebash/ zgjebët (i)/ zgjebarak, zhulan/ zhulanos, zhytas/ zhytthi* etj.

9) ***Variante gramatikore:*** *abetar/ abetare, alarmë/ alarm, bac/ bacë, bajam/ bajame, cakul/ cakule, djep/ djepe, koll/ kollë, mykje/ myk, mustaqe/ mustak* etj.; nuk janë shumë, madje në *"Fjaror"* nuk janë vënë

disa variante të ngjashme kategoriale në dy gjini, si: *furr,-i (furr/ë,-a), fustan,-i (fustan/e,-ja), gjë,-ri (gjë,-ja) mjalt/ë,-a (mjalt/ë,-i), gjytet,-ja (qytet,-i), uj/ë,-a/ ujë,-t (uj/ë,-i), vath,-i (vath/ë,-a)* etj.

II. Njësi leksikografike të grupit të dytë, ***nënfjalë,*** janë gjashtë nëngrupe. Janë njësi jashtë kufijve të fjalës (si njësi leksikore), njësi fonetike, leksiko-fjalëformuese ose leksiko-sintaksore, por ato lidhen me përbërjen e fjalës ose janë të ngjashme me të e mund të substantivohen:

1) ***Shkronjat e alfabetit:*** *a, b, c, ç, d, dh, e, ë..., y (ip-si-lon), z, zh* etj.

2) ***Ndajsahtesa:*** *ç-, jo-, mbi-, mos-, nën-, neo-, pa-, për-, pro-, ri-, sh-, z-, zh-, xhv- / zhv-* etj. Por mungojnë këtu edhe shumë parashtesa të tjera me gjallëri të njëjtë fjalëformuese[13].

3) ***Shkurtesa:*** *ABC* "abëcë", *ABD* "artileria bregdetare", *ADN* "Allgemeine Deutcher Nachrichtendienst", *agr.* "agronom", *AFP* "Agencie France Press", *AGERPRES, AGROEKSPORT, akad.* "akademik", *ALBKONTROLL, ALBTRANSPORT, ALBTURIZËM, BENELUX, dr.* "doktor", *d.m.th.* "domethënë", *dr. shk.* "doktor i shkencave", *FMN* "Fondi Monetar Ndërkombëtar", *KGB, Khs.* "krahaso", *KOSMET, NATO, NP, NPA, NPB, NPM, NPN, NPV, NRNMP, NRSh, NSh* (janë 39 shkurtesa të tilla me shkronjën e parë *N…* "Ndërmarrja…), *prof.* "profesor", *p.sh.* "për shembull", *RFGj, SMT, ShBA, UNÇHs* dhe disa dhjetra të tjera që, siç dihet, në shqipe shumë prej tytre mund të substantivohen (*ABDë,-ja, ADNë,-ja, AFPë,-ja* etj.); por këtu nuk janë përfshirë shumë shkurtesa të tjera, mjaft të njohura e që përdoren edhe sot gjerësisht[14].

---

[13] A. Xhuvani – E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe,* BShSh, 1956, 4, japin 68 parashtesa.

[14] Shkurtesat kanë identitet gjuhësor tashmë të formuar, me sistem strukturash tipologjike: shkurtesa shkronjore, si *BE* "Bashkimi Europian", *FMN* "Fondi Monetar Ndërkombëtar", *KLSh* "Kontrolli i Lartë i Shtetit", *MAS* "Ministria e Arsimit dhe e Sportit", *VKM* "Vendim i Këshillit të Ministrave" etj.; shkurtesa rrokjesore, si *BENELUX, KOSMET* etj.; shkurtesa njëleksemore, si *akad., agr., d.m.th., dr., p.sh., prof.* etj.; shkurtesa të përziera, si *ALBKONTROLL, ALTURIZËM* etj. Rrjedhimisht, duke pasur, shumë prej tyre, edhe mundësinë e substantivimit e të përfshirjes në kategorinë e njësive të eptueshme, shkurtesat kanë fituar edhe statusin e njësive leksikografike në fjalorë të përgjithshëm ose në fjalorë të posaçëm shkurtesash. Në fushë të shqipes e kemi një vepër të tillë, të hartuar nga profesor Valter Memisha e Manjola Bregasi: *Emërtimet e*

4) ***Onomatope:*** *bam, bum, ciu, ciu-ciu, cq (cëq), ga-ga-ga, gëk, gërrh-gërrh, hë, kri, krra-krra, kukú, mu, xëc, y* etj.

5) ***Trajta gramatikore fjalësh.*** a) Trajta të shumësit të emrave: *agallarë/ aga, ahra/ ahër, babagjyshër/ babagjysh, baballarë/ babá, babapleq/ babaplak, baça/ baçë, bahëra/ barëra/ bar, bakej/ bakall, carronj/ carrua, drapinj/ drapër, fillime/ fillim, fiq/ fik, gjerdhe/ gardh, gjarpërinj/ gjarpër, hoxhallarë/ hoxhë, lëmizhda/ lëmizhdë, njerëz/ njerí, pënj/ penj/ pe, pleq/ plak, priftërinj/ prift, qënër/ qen, trarë/ tra...;* trajta rasore për-emrash: *atyre/ ata, juve/ ju, këtyre/ këta (këto), mua/ unë, tënd/ yt, tënde/ jote...;* trajta vetvetore-pësore dhe të eptimit të foljeve: *abono.het/ abono.n, abstrakto.het/ abstrakto.n, acido.het/ acido.n, balto.het/ balto.n, ballafaqo.het/ ballafaqo.n, janë/ jam, ke/ kam, kishte/ kam, përcolla/ përcjell, shini/ shi.n, themi/ them, thëntë/ them, thënjç/ them, ujëso.het/ ujëso.n, vemi/ veni/ vete* etj. Rregullisht, sipas kritereve të njohura leksikografike, trajtat e fjalëve të eptueshme jepen në pasqyra të posaçme gramatikore ose si trajta plotësuese radhazi me temën e fjalës, jo në zë të vaçantë leksikografik.

6) ***Variante fonetike (ortoepiko-ortografike) dialektore, krahinore a ligjërimore*** (me *****), krahas varianteve normative: *â* "ënjt", *abanos/ abanoz, abdes/ abdest/ avdes, abdesanë/ abdeshanë/ avdesanë, abdhelë/ abdhellë, abrazh/ abrash, abses/ absces, acar/ acër, adhër/ adhr/ adhur, aeror/ ajror, afërmenç/ afërmënç/ afërmendsh, afjon/ afion, agrep/ akrep, agushí/ zagushí, agjosh/ agosh, ahenk/ aheng, ahere/ ahiera/ atëhere, ahër/ ahur, ajazmë/ ajasmë, aji/ ai, ajropllan/ aeroplan, ba**/** mba, bâ/ bë, bâ.het/ bë.het, babë/ babi/ babá, babazí/ babëzí, bagël/ bajgë,*

---

shkurtuara në shqipe, Vlorë, 2008, 226 faqe, me rreth 2500 shkurtesa, me një pasqyrë të njësive matëse, me një pasqyrë tjetër të shenjave horoskopike dhe me një studim në hyrje, në të cilin shkurtesat trajtohen edhe si njësi leksikore (f. 24-35). Për tipin, përmbajtjen, trajtimin leksikografik e vlerat e këtij fjalori bashkautori V. Memisha ka shkruar që para botimit të tij, më 2007 (shih Valter Memisha, *Rreth një fjalori shkurtesash në gjuhën shqipe,* në "Studime për fjalën shqipe", Tiranë, 2011, f. 198-207). Mundësia për të hartuar fjalorë shkurtesash bën që këto njësi të përfshihen në mënyrë të kufizuar në fjalorët leksemorë të mirëfilltë ose në fjalorët e përgjithshëm e normativë, kryesisht në fund të fjalorit.

bactkocë/ bretkosë, baçe/ bahçe, baçkë/ backë/ dackë, badhër/ badër, bae/ bahe, bajazë/ bajëzë/ bajzë, bajtë/ baltë, bajth/ baqth, bajtë/ mbajt, bakalá/ bakallaro/ bakalaro, bakra/ bakëre, bakti/ bagëti, ballancë/ balancë, balcam/ balsam, badakçi/ batakçi, badakçillëk/ batakçillëk, badiava/ badjava/ badihava, bajë/ banjë, cap/ cjap, cipër/ sipër, cinema/ sinema/ kinema, cingare/ cingarë/ cigare, çapí/ zhapí, digjon/ dëgjon, fambrikë/ fabrikë, fenuk/ fënduk, fyçí/ fuçí, fyshek/ fishek, harritje/ arritje, hashure/ ashure, haur/ ahur, kllasë/ klasë, javash/ avash, kajherë/ nganjëherë, majde/ madje, maqinë/ makinë, menton/ mendon, nemec/ memec, naní/ taní, nap/ jap, nëkon/ rënkon, nëmër/ numër, njelbët (i)/ njelmët (i), pamuk/ pambuk, panajir/ panagjir/ panair, penell/ penel, pso.n/ mëso.n, qëndizmë/ qëndismë, qëpallë/ qepallë, Qërshor/ qershor, qërr/ qer, qimpanzí/ shimpanzé, rrapat/ rropat, rrende/ rende, rrëmen/ rrëmben, senkser/ sekser, shambet/ shëmbet, shembëll/ shembull, shëndan/ shandan, shka/ çka, shandan/ shëndan, tapall/ topall, temel/ themel, tëmallë/ dhëmballë, theori/ teori, umbrella/ ombrellë, undyr/ yndyr, ungj/ ul, xamare/ zamare, xâ/ zë, xânës/ nxënës, xen/ nxeh, xërron/ rrëzon, xjerr/ nxjerr, xvat/ zhvat, xverk/ zverk, xhapí/ zhapí, xhygym/ gjym, yjtí/ ujtí, zanzar/ xanxar, zjarm/ zjarrm, zhgul/ shkul etj. Variantet fonetike zënë vend shumë të gjerë në këtë fjalor (me shkurtesën *Reg* ose pa atë, disa herë edhe me shënimin për dialektin a të folmen përkatëse), aq sa mbulojnë njësitë leksikografike normative dhe i japin *"Fjalorit"* ngjyrim të theksuar krahinor. Ndërkaq, autori ka kujdesin që variantet fonetike krahinore t'i japë në shqip zakonisht të lidhura me gjegjëset e tyre normative, pra, me referim te fjalët e standardit, me përjashtim të shumë fjalëve të prejardhura a të përbëra prej tyre. Kjo dukuri leksikografike e *"Fjalorit"* është tipar kryesor i tij, madje i dukshëm edhe në pasqyrimin e varianteve fonetike dialektore e krahinore kategoriale, të cilat gjithashtu nuk jepen as të gjitha e as në sistem; këtë mjafton ta dëshmojmë me shembuj edhe vetëm për dukuri që përmbajnë zhvillime fonetike të mëdha, si alternimet *â(a)/ë/(e), e/ë, n/r.* Po sjellim disa shembuj prej tyre:

Me alternimet fonetike *â(a)/ë(e): âmbël (i)/ ëmbël (i), âmë/ ëmë, ândë/ ëndë, ândërr/ ëndërr, ândshëm (i)/ ëndshëm (i), âsht/ është, bâ-*

mës/ bërës, çâshtje/ çështje, dâm/ dëm, dâmçor/ dëmtues, dâmto.n/ dëmton, dhamb/ dhëmb, dhandërr/ dhëndërr, fang/ fëng, fangishtë/ fëngishtë, gjândër/ gjëndër, gjânë (i),/ gjerë (i), gjânësí/ gjerësi, gjâní/ gjerí, gjâ/ gjë, hanë/ hënë, hanger/ hëngër, hanor/ hënor, kambanë/ këmbanë, kând/ kënd, kâng/ këng(ë?), lâ/ lë, lâmë/ lëmë, lâmje/ larje, lâmsh/ lëmsh, landë/ lëndë, lânë/ lënë, lâng/ lëng, mâ/ më, mâmë/ mëmë, man/ mënë, mândeshë/ mëndeshë, mândëz/ mender, mângë/ mëngë, mângore/ mëngore, mâno.n/ mënon, nândë/ nëntë, nanë/ nënë, nanëmadhe/ nënëmadhe, nanuris/ nënuris, njajshëm/ njëshëm, njapërnja/ njëpërnjë, qândër/ qendër, ramë/ rënë, rândë (i)/ rëndë (i), rânë/ rërë, tamth/ tëmth, shandan/ shëndan, vang/ vëng, vangët (i)/ vëngër (i), vath/ vëth, zâ(n)/ zë(r), zanë/ zërë, zamadh/ zëmadh, zamër/ zëmër etj.

Pa variante me alternime fonetike *â(a)/ë/(e): bën, dëmprurës, dëmshpërblim, dëmtar, dëmto.n, dhëmbëdalë, dhëmbëkatrosh, dhëmbës, dhëmbëzim* (mbi 40 fjalë të prejardhura e të përbëra me *dhëmbë-*), *dhëndërí, dhëndëro.n, dhënë, dhënës, ëmbëlsi, ëmbëlsirë, ëmbëlson, ëmbëltore, ëndërrim, ëndërro.n, ënjtje, gjëmë, gjëri, gjëmshëm (i), hamam, këmbë* (dhe afër 100 fjalë të prejardhura e të përbëra me *këmbë-*), *këmbje, këndshëm (i), këngëtar, lende, lëngët (i), lëngshëm (i), mângët (i), majtas, majtë (i), nëm* "mallkoj", *nëndor/ nëntor, njëra, njëri, ranishtë/-e, rrënjë, rrënjës, rrënjësisht, rrënjor, rrënjos, shembë, shëmtí, tamam, them, thanishtë, thëllëzë, thënie, zanafill, zanor/-e, zhëng* etj., d.m.th. nuk jepen variantet fonetike dialektore a jonormative *ban, damprurës, damshpërblim, damtar, damton, dhambdalë* etj.

Me alternimin fonetik *e/ë: dënd/ dend, dhemb/ dhëmb, dhëmbje/ dhembje, dhën/ dhen, dhënar/ dhenar, ënd/ end, ërgjënd/ ergjënd, ënjt/ enjt, gjëmb/ gjemb, gjêmë/ gjëmë, lendinë/ lëndinë, leng/ lëng, memelike/ mëmëligë, mënd/ mënt/ mend, mëndje* (dhe 5 fjalë të përbëra)/ *mendje* (dhe 60 fjalë të prejardhura)*, nên/ nën, pëndë/ pendë, pë(r)/ pe(r), qemton/ qëmton, qemoti/ qëmoti, qënë (pj.)/ qenë, qëndër/ qendër, qëpallë/ qepallë, rëmb/ rrëmb/ rremb, rendom/ rëndom, rrën/ rren, rrënë/ rrenë, sembim/ sëmbim, sëmbër/ sembër, shëmb/ shemb, shëmbje/ shembje,*

shëmbull/ shembull, shëmbullor/ shembullor, shenjestër/ shënjestër, shënjë/ shenjë, shënjt/ shenjt, shënjtë (i)/ shentë (i), shënjtëro.n/ shenjtëro.n, tëndë/ tendë, ve/ vë, vemend/ vëmend, vënd/ vend (dhe 47 fjalë të prejardhura e të përbëra me *vend-*), *vëndor/ vendor, zëmër* (vetëm dy fjalë të prejardhura me variantin *zëmër-*)/ *zemër* (afër 90 fjalë të prejardhura e të përngjitura me fjalën *zemër-*) etj

Pa variante me alternimin fonetik *e/ë: derr, gjendet, gjendje, lë, mençur (i), mençurí, mendërisht, qen, qenësishëm (i), qengj, qëndis, qëndisje, qëndismë, qëndistar, rëndë (i), rëndësí, rëndo.n, rremb, rrëndës, shemër, Shenjëza, tenjë, tëposhte, thembër* etj., d.m.th. nuk jepen variantet fonetike dialektore a jonormative *dërr, gjëndet, gjëndje, le, mënçur (i), mënçurí, mëndërisht, qën* etj.

Me alternimin fonetik *n/r: asnjeni/ asnjerí, burrëreshë/ burrneshë, burrëri/ burrni, burrëro.het/ burrno.het, burrëror/ burrnor, dhelpnak/ dhelparak, dhelpní/ dhelpëri, grunë/ grurë, grunishtë/ grurishtë, grunore/ grurore, gjânë (i)/ gjerë (i), gjylpânë/ gjilpërë, kanp/ kërp, llanë/ llërë, mëní/ mërí, rânë/ rërë, rrëpinë/ rrëpirë, sy(n)/ sy(r), shalqí(n)/ sharqí(r), shênjtneshë/ shenjtëreshë, shêjtní/ shenjtërí, shêjtnim/ shenjtërim, shëmtinë/ shëmtirë, tanë/ tërë, tanësi/ tërësi, tërshanë/ tërshërë, thëní/ thërijë, unor/ uror, unshëm (i)/ urshëm (i), zâ(n)/ zë(r), zanë/ zërë* etj.

Pa variante me alternimin fonetik *n/r: burrërisht, burrërishte, dhelpër, gjerazi, gjerësi, gjerësisht, ranishtë/-e, ranor, sëmurë, verë* "pije nga rrushi...", *urí* etj., d.m.th. nuk jepen variantet fonetike a jonormative *burrnisht, burrnishte, dhelpën, gjanazi, gjansí, gjansisht, rërishtë/-e, smunë, venë, uni* etj.

III. Njësi leksikografike të grupit të tretë, ***mbifjalë,*** janë katër nëngrupe. Janë njësi të leksematikës e të sintagmatikës, me strukturë më të gjerë se kufijtë e njësive leksikore (fjalë):

1) ***Lidhje leksematike e sintagmatike:*** *në ballë, ballet e arkës, ballet e dhomës, balli i krevatit, balli i oxhakut, ballë i tunelit, ballet e vozës, në është se..., në krah të..., nën armë, nën banak, nën dorë, nën dhé, nën*

gunë, nën një kulm, nën rrogoz, nën sqetull, nën thua, nën vërejtje, në mos sot nesër, prapa gardhit, xham i pastër, xham qorr, nuk zë, zog dhensh, zonë e vdekur etj.

2) ***Togfjalësha me lidhje të qëndrueshme*** (me *****): *aeroplan bombardues, aeroplan gjuajtës, aeroplan ndjekës, aeroplan reaktiv, aeroplan udhëtarësh, aeroplan vëzhgimi, babil uji, badër e bardhë, badër fyle, badër uji, bagëti e imët/ ~ e hollë, bagëti e leshtë, bagëti e trashë, bajame e egër, bajram i vogël, bar argjendi, bar balsami* (82 togfjalësha të tillë me *bar* ~ nga fusha e botanikës), *gjuha letrare (kombëtare), gjuhë dreri (bot.), lule agrepi, lule akshami, lule akulli* (140 togfjalësha të tillë me *lule* ~ nga fusha e botanikës) etj.

3) ***Njësi frazeologjike:*** *baballarët e kombit, bahçe me lule, ballë e fund, balli i kazanit, ballë për ballë, ballë qorr, fjalë ari* (40 togfjalësha me gjymtyrën *fjalë* ~), *e hedh kësulën mbi sy/ ~ mënjanë, ta hedh kopilin në prehër, e hedh lumin pa (u) lagur (këmbët)* (afër 140 njësi frazeologjike me gjymtyrën *hedh* ~), *më re* (mbi 270 togfjalësha me gjymtyrën *më* ~), *zë në gojë* (176 togfjalësha me gjymtyrën *zë* ~) etj.

4) ***Fjalë të urta e proverba (jo të gjitha si njësi mirëfilli leksikëgrafike):*** *fjala e burrit pesha e gurit, fyti është vëlla i detit, gjuha çan gurin/ ~ shkëmbin, gjuha kocka s'ka kocka thyen, kali i huaj të lë në mes të udhës, sheh fiku fikun e piqet, sheh me syze të errëta, sheh qimen në syrin e tjetrit dhe nuk shikon/sheh trarin në syrin e vet, ruaje zogun sa e ke në dorë, sheh tym e bën konak, ujku qimen ndërron, por zakonin s'e harron, nuk zi-het dielli me plisa* etj. Janë njësi të pastra sintaksore, me strukturë përtej kufijve të togfjalëshit.

Në dy grupet e fundit, sipas shenjave të përdorura shumë herë për trajtimin leksikografik, ka përzierje njësish të ndryshme ose ndarje njësish të njëjta.

Sprovë statistikore

Për përpjesëtimet e njësive sipas nënsistemeve të gjuhës ose sipas tipologjisë së njësive leksikografike, si model referues po marrim këtu shkronjën *Gj,* - një nga shkronjat më asnjanëse ndaj klasave leksikore të kufizuara ose kategoriale (dialektore e krahinore, arkaike, fjalëformuese

etj.), - e cila mund ta përfaqësojë *"Fjalorin"* në këtë përbërje, duke qenë edhe në mesataren e gjithë shkronjave për përmasat e njësive të ndryshme leksikografike. Në këtë shkronjë prej 29 faqesh ka 2320 njësi leksikografike, nga të cilat:

Fjalë dialektore e krahinore, mbi 1290 njësi leksikografike: *gaberr, gabë/ gafë/ shkabë, gaborre, gabrieç, gabrrec, gabzhar, gac, gacatore, gacë, gackavit, gackavitës, gacon, gacullinë, gacullon, gaç, gafërr, gafrruar (i), gagjarí, gagjaf, gajdher, gajdhur, gajganá, gajgë, gajretshëm, gamer, gazmend, gandall, gërgëlac, grah* etj.

Terma specialë, mbi 140 njësi leksikografike: *gabarite (Tech.), gabrrollë (Ornit), gaçkë (Bot.), galexhant (Tech), gallium (Chem), galvanizim, galvanizo.n, galvanometër, galvanoplastikë (Phys), gamile (Zool), gangrenë (Med), gangrenizim (Med), gangrenizoj (Med), gazometër, geizer (Geog.), gencianëzë (Bot.), germanium (Min.), gnoseologji (Phil), grethatel (Bot), grykore (Ling), gurthyese (Constr)* etj.

Neologjizma (të pangulitur), mbi 90 njësi leksikografike: *gabimtar, gaforre-shegë, gardhëtar, gdhentarí, gënjeshtrazi, gënjeshtro.n, gishtso.n, gojavis, gojësuer, grykzum (i), gushosh* etj.

Turqizma të vjetruar, mbi 50 njësi leksikografike: *gafil, gajle, gaxhí, gaxhorr, gazep* etj.

Variante fjalëformuese, mbi 100 njësi leksikografike: *gabimtar/ gabues, gacm/ ngacm, gangrenor/ gangrenoz, gushacak/ gushak/ gushan/ gusharak/ gusher, gëlqerebërës/ gëlqerexhi, gërgas/ gërgërat, gopçar/ gopshor/ goptar, grathatë/ grathatël, guros/ nguros* etj.

Trajta fjalësh e variante gramatikore, mbi 80 njësi leksikografike: *gabo.het/ gabo.n, gackavis/ gackavit, gafrro.het/ gafrro.n, gagaris/ gagarit, grazhdar/ grazhdare* etj.

Variante fonetike (ortoepiko-ortografike), dialektore a ligjërimore (zakonisht me shenjën *), mbi 210 njësi leksikografike: *gaçe/ kaçe, gaçëm (i)/ gatshëm (i), gadal/ ngadal, gadë/ gate, gadi/ gati, gadosh/ kodosh, garrumbull/ grumbull, geolog/ gjeolog, gëdhirë/ gdhirë, gëlbazë/ këlbazë, gërbaç/ kërbaç, gërxhep/ kërçep, gërshanë/ gërshërë, gojambël, gojëçthu-*

run/ gojështhurur, gojëdhanë/ gojëdhënë, grukë/ grykë, gthetër/ kthetër, gufomë/ kufomë, gumushë/ gëmushë, gurbet/ kurbet, gyrbetxhi/ kurbetçi, gzhep/ këthep etj.

Emra të përveçëm njerëzish e toponime, mbi 30 njësi leksikografike: *Galí/ Gallí, Gazmend, Genc, Gegërí, Gent, Gentian, Gëzim, Gërqí/ Greqí/ Grekní, Glina, Gramsh* etj.

Jashtë përllogaritjes po shtojmë edhe:

Nënfjalë, mbi 10 njësi leksikografike: ***shkronja:*** *g;* ***shkurtesa:*** *GESTAPO,* ***onomatope:*** *ga-ga-ga, gëk, gërrh-gërrh* etj.

Togfjalësha, lidhje leksematike e sintagmatike ose frazeologjike, mbi 180 njësi leksikografike: *gabim personal/ ~ vetjak, gabim i trashë, gacë e mbuluar, gacë në para, gaforre bregu, gaforre lythore, galop i thatë, galop i vogël, gaz fisnik, gaz lotsjellës, gaz mbytës, gaz i tokës, godit në shenjë, godit në zemër, gojë ari, është gojë e bark, gojë pas goje, lë me gojë hapur, në gojë të ujkut, guri i besës, gur kali, gur gur bëhet mur, gur ndezës* etj.

Të gjitha nëngrupet e njësive leksikografike të kufizuara arrijnë mbi 2180, por nga numri i përgjithshëm i njësive leksikografike mund të zbrisnim rreth 1750 njësi leksikografike nga 2320 që ka *"Fjalori"*në këtë shkronjë dhe që, sipas nesh, nuk përputhen me tipin e tij; atëherë del se vetëm 570 njësi leksikografike janë të shtresës më të përgjithshme leksikore. Përllogaritja për gjithë *"Fjalorin",* që gjithsesi është fare e përafërt dhe bëhet vetëm sa për ta theksuar tipologjinë e tij, nxjerr se ai përmban mbi 90 000 njësi leksikografike të kufizuara dhe mbi afër 30 000 njësi leksikore të përgjithshme, gjithsesi një pasuri shumë e madhe e me vlerë. Hajri Shehu thekson me të drejtë që "po të mos ishin vënë variantet fonetike dialektore e krahinore, po të mos ishte tepruar me turqizmat krejt periferikë (b.f. *gjefshek*), po edhe me njësi të tjera të leksikut pasiv, Fjalori nuk do t'i shëmbëllente në rreth gjysmën e tij një fjalori pasiv e një arkivi për t'u ruajtur dhe eksploruar si qëllim në vetvete" [15].

[15] *Art. i cit.* , f. 189.

Rreth disa kritereve teknike leksikografike

Në këtë *"Fjalor"* nuk jepen trajtat plotësuese të fjalëve të eptueshme, madje nuk ndahet me vijë të pjerrët pjesa e pandryshueshme nga pjesa e ndryshueshme (***emër*** *nm*); me pikë ndahet mbaresa e v. III e foljes veprore dhe mbaresa pësore-vetvetore e foljeve (***kullo.****n vt,* ***kullo.****het vpr*); me vizë të pjerrët ndahen gjymtyrët fjalëformuese te fjalët e prejardhura e të përbëra (***bluar/je*** *nf,* ***hop/a/kal/as*** *adv*). Kjo zgjidhje vetjake e autorit të *"Fjalorit"* e ka sjellë dhënien e disa trajtave gramatikore të fjalëve si njësi leksikografike më vete, si trajtat pësore-vetvetore, disa pjesore, trajta të vetës II, III a të shumësit të foljeve, trajta të shumësit të emrave, trajta rasore të përemrave etj. Tek emrat femërorë që mbarojnë me ***ë,*** kjo zanore jepet me shkronjë më të vogël italike (***jav****ë*), çka nënkupton një shqiptim të dobët të saj (edhe në trup të fjalës: ***pun****ë****dash****ë****s***), si dhe rënien në pozicion fundor gjatë trajtëformimit, pra, është një e dhënë për drejtshqiptimin. Te foljet e rregullta si trajtë përfaqësuese mbahet veta III (***la.****n/* ***la.****het*[16]); te foljet e parregullta jepen trajtat e para me metafoni (***marr...****<* m*e*rr); te foljet supletive trajta supletive jepet vetëm sipas rendit alfabetik (***shoh****...<* sh*e*h/ ***pash****ë Ist sg pdef* < sh*e*h; ***jap...*** < j*e*p / ***dhash****ë Ist sg pdef* j*e*p) etj. Tipi i karaktereve këtu, sikundër është *-e-* te ***merr, sheh, jep*** (italike dhe më e vogël), përdoret për të tërhequr vëmendjen mbi ndryshimin fonetik metafonik. Këto e të tjera zgjidhje praktike leksikografike dhe shënimet e posaçme, të shumta e të rregullta, për shumicën e fjalëve, që i karakterizojnë ato me përpikëri, gjithsesi bëjnë që ky fjalor të shquhet për një sistem të pasur të dhënash, deri në hollësi, për vlerat e veçanta dhe për përdorimin e tyre, çka e spikat edhe më shumë karakterin ligjërimor të *"Fjalorit"*. Por në shumë raste autori i fjalorit ia ka lënë përdoruesit që, nëpërmjet shënimeve me shkurtesa te çdo njësi leksikografike dhe me njohjen mirë të gramatikës së shqipes, t'i ndërtojë vetë trajtat paradigmore të tyre, procedurë gjuhësore disi e vështirë për një të huaj. Duhet theksuar veçanërisht që në *"Fjalor",* nëpërmjet shkurtesave e

[16] Këtë zgjidhje leksiko-gramatikore e leksikografike kanë pranuar edhe Oda Buchholz - Wilfried Fiedler - Gerda Uhlisch, në *Wörterbuch Albanisch – Deutsch,* Berlin, 1992.

shënimeve të tjera plotësuese, bëhet shtresimi edhe i leksikut nga pikëpamja e normës gjuhësore, sipas stileve të ligjërimit etj. Për këtë të fundit përdoren shumë shkurtesa, si: *Book, Fig, Folklore, Colloq, Lit, Old, Pej, Poet,* pëveç shkurtesave për termat: *Anat, Bot, Hist, Ling, Ornit, Zool* etj., ose për fusha leksikore: *Food, Reg, Relig, Prov, Spec* etj.

***

Leksiku i vështruar veçan mund të shtresëzohet, sikurse njihet deri më sot: fjalë shqipe <> fjalë të huazuara, fjalë të standardit <> fjalë dialektore e krahinore (jonormë), fjalë leksema <> variante fonetike a trajta gramatikore, fjalë të leksikut të përgjithshëm <> fjalë të leksikut terminologjik, fjalë të thjeshta <> fjalë të prejardhura e të përbëra etj. Nga të gjitha këto grupe në këtë *"Fjalor"* vend të gjerë zënë fjalët e huazuara (sidomos turqizmat), fjalët dialektore e krahinore dhe variantet fonetike (drejtshkrimore e shqiptimore), në përpjesëtim edhe me leksikun normativ, që e bëjnë fjalorin pasqyrë leksikografike të ligjërimit dhe jo të leksikut të shqipes si sistem, as edhe të një vrianti të vetëm (dialektor, krahinor). Me këtë përmbajtje e trajtim leksikografik fjalori ka mpleksur leksikun normativ me atë jonormativ, fjalët leksema me variantet shqiptimore dialektore, krahinore e ligjërimore, fjalët me togfjalëshat e lokucionet etj., pra, tipologjikisht duket që është fjalor i ligjërimit dhe jo i leksikut normative si sistem. Shënimet dhe gjegjëset në anglishte nuk ia ndërrojnë tipologjinë. Ngjyrim të fortë bisedor këtij fjalori ia japin fjalët e shumta të këtij ligjërimi, të shënuara me shkurtesën *Colloq.* Por këtë ngjyrim e përforcojnë edhe krahinorizmat, variantet e shumta fonetike krahinore, frazeologjia dhe fjalët e urta e proverbat, të gjitha në numër të lartë.

Për të gjitha njësitë leksikografike në *"Fjalor"*, që nga shkronjat e deri te fjalët e urta e proverbat, përveç mijëra njësive që jepen këtu, ka edhe mijëra njësi të tjera të të njëjtit rrafsh, madje shumë prej tyre me shtrirje më të gjerë përdorimi, të cilat *"Fjalori"* nuk i ka përfshirë e nuk mund t'i përfshinte, sado i tipit të përzier të jetë, sepse kufizohet dyfish tipologjikisht: nga vëllimi e nga natyra e lëndës, - nuk është fjalor i madh a tezaurus dhe nuk është fjalor dialektor a krahinor i mirëfilltë, as termino-

logjik, i fjalëve të vjetruara, i huazimeve, onomastik, i shkurtesave, sintagmatik, frazeologjik etj., - por edhe përfshirja e tyre në këto përmasa e ka rritur shumë vëllimin dhe ka prishur përpjesëtimin e shtresave e të klasave leksikore, ka krijuar asimetri të brendshme ndërmjet tyre dhe ndërmjet fjalorit në tërësi e realitetit gjuhësor. Ndërkaq, pikërisht për atë lëndë që ka dhe për trajtimin leksikografik ai përbën një tip të veçantë me pasuri të madhe leksikore dhe informacion të vlefshëm jo vetëm për njësi leksikore, por edhe për të dhëna fonetike-shqiptimore, fjalëformuese, morfologjike, sintaksore, frazeologjike etj. *"Fjalori",* nëse është larguar ndjeshëm nga tipologjia klasike leksikografike, ka fituar me gjerësinë tipologjike të njësive leksikografike, çka u shërben më shumë studiuesve të shqipes sesa atyre që duan të mësojnë shqipen.

Jani THOMAI, Albanian Academy of Sciences, Tirana

ABOUT NEWMARK'S "ALBANIAN-ENGLISH DICTIONARY" ("OXFORD ALBANIAN-ENGLISH DICTIONARY")

Summary

According to lexicographic typology, "*The dictionary*" aims clearly to be bilingual but we can't go further to classify it as general or dialectal, normative or non-normative, only lexical or also with other units, or even simply bilingual or with explanatory elements and references with Albanian words to the Albanian words. The "*Dictionary*" can be viewed from the lexicographic standpoint following two key lines: a) What does it bring from the lexical, phraseological,semantic and lexeme resources of the Albanian language and b) how it has been achieved identification of their values through juxtaposition with respective English ones. Here it is followed only the first line.

Among the distinctive features of the "*Dictionary*", two are more visible: a) Categorial numerousness and variety of lexicographic units, often with, mainly, information value and b)Incomplete system of typologically same or similar lexicographic units. Both of them show how fine and tiring was author's research and selective work. The main principle of determining the lexicographic units, that covers Albanian corpus in the "*Dictionary*", follows the concept of English linguistics on lexicographic unit, a concept that is in compliance with internal nature of the English structure, expressed by M. Webster in the big dictionary, according to which not only "compact" words are such but also "open words" (Open Word), such as room-mate, school age etc.

According to this concept, since in English …"the topic and the word are identified, the phraseological units are also considered as words and even are called 'open words'". Consequently, due to the lack of inflection, the criterion for closed or open structure to classify words or parts that are not words of linguistic units doesn't serve. Therefore, the writing contains three possibilities of interpreting the pronunciation: together *bedroom*, with hyphen *bed-room* and separately *bed room*. However, the writing makes no impact on semantics or the use of lexicographic units when the internal structure of the unit is, in reality, closed as in English, because the parts of the phrase are grammatically neutral. It seems that the impact of this concept, theoretically accepted in lexicology and practically in lexicography, L. Newmark has extended into his dictionary respectively into the Albanian corpus. It is known that the experts in terminology propose and use it in terminology but they also propose it for the explanatory and bilingual dictionaries, especially the big dictionary, where should be presented single units, similar to words, such as, *handwork, bee balm, starfish, square root* etc.

From the Newmark's "*Dictionary*" are considered further some lexicographic units which are selected based on the categories of the units of the Albanian vocabulary.

The Albanian content in the "Dictionary" is classified into three groups of lexicographic units:

I. To the first group belong the lexicographic units *words* (lexical units), in nine subgroups: *1) The words of general and active lexical class,* of all lexical-grammatical categories. There are tens of thousands that are presented naturally and broadly in the "*Dictionary*". They compose the key content and they are the words of the standard Albanian. *2) Dialectal and provincial words*. The author expressed the reserve to limit all provincial words with the abbreviation *Reg.3) Special terms.* However, not all conceptual fields in this dictionary have been presented in the same way. Thus, the denominations for the religious world (beliefs, objects, concepts, ceremonies, rites, functions etc) have been presented broadly by the denominations that contain the terms, non-terms or proper nouns which mainly belong to the first rank of denomination. The terminological meanings, also, have been given in the words with broader semantic structure. Also, there are other denominations of the same level for the religious world without the annotation *Relig*. or the ones that are missing. *Neologisms (not embedded). 5) Archaisms, histories, ethnographies and folklores. 6) Borrowed words (mainly old Turkish words).7) Proper nouns: 7a. People's nouns (personal and patronymic)* of the Albanian origin, mainly of general lexis or foreign origin. *7b. The names of places, cities, provinces, mountains and rivers in Albania, Kosova etc.* or *the names of places, cities, provinces, mountains and rivers in the world. 8) Word-formation variants. 9) Grammatical variants.*

II. To the second group belong the lexicographic units *sub-words*, in six subgroups. They are phonetic, lexical-word formative or lexical-syntax units, but they related to the composition of the word or can be lexicalized: *1) Alphabet letters. 2) Affixes. 3) Abbreviations (writing, syllabic or thematic). 4) Onomatopoeia. 5) Grammatical word forms: the forms of* the plural of nouns, the pronouns' case forms or verb inflection forms. *6) Phonetic, dialectal, provincial or lecturing variants.* Phonetic variants take a considerable place in this dictionary to the extent that they cover lexicographic normative units and give to the "*Dictionary*" an accentuated provincial color. A special place is taken by the phonetic dialectal categorial variants, like the ones with alternations *â (a) /ë/ (e), e/ë, n/r*.

III. To the third group belong the lexicographic units *beyond the word*, in four subgroups. They are lexical and syntagmatic but with a broder structure than the word borders: *1)Lexical and syntagmatic links. 2)Phrases with sustainable links. 3) Phraseological phrases. 4) Sayings and proverbs (not as lexicographic units)*.

Thus, these three groups are composed of the units of five language subsystems: phonetic, lexical, morphological, word-formative and syntax subsystems.

By taking a statistical test for the letter Gj, as a neutral letter in relation to classified lexical classes (provincial, borrowings, word-formation etc), it can be gained an average of the proportions in the language subsystems or the typology of lexicographic units, according to which it comes out that the entire "*Dictionary*" contains, approximately, about 30 000 general lexical units and over 90 000 limited lexicographic units,-a precious and valued resource. A more accentuated place is taken by the phonetic, dialectal, provincial and peripheral words and variants, Turkish words and other units of passive lexis.

For all lexicographic units in the "*Dictionary*", from letters up to sayings and proverbs, in addition to thousands of units that have been presented there, there are also other units of the same level and many of them even widely used which haven't been included in the "*Dictionary*" and couldn't be included even though they may belong to the mixed type, because it is,typologically, limited doubly: from the volume and nature of the content,-it is not a big or Thesaurus dictionary and it is not a genuine dialectal, provincial or a terminological dictionary or a dictionary of outdated words, borrowings, onomastics, abbreviations respectively syntagmatic, phraseological one etc.,-while their inclusion in these dimensions, also, has increased considerably the volume and spoiled the proportion of lexical levels and classes, it has created internal asymmetry amongst them and the linguistic reality itself. Meanwhile, exactly due to its content and lexicographic treatment, it composes a special type with considerable lexical resources and valuable information not only about lexical units but there are also phonetic-pronunciation, word-formation, morphological, syntax, phraseological data etc. The "*Dictionary*", if dispelled considerably from the classic lexicographic typology, has gained in its typological broadness of lexicographic units and consequently it'll benefit more the Albanian scholars than those who want to learn Albanian.

Rrahman PAÇARIZI, Fakulteti i Filologjisë i UP-së, Prishtinë

GRAMATIKA E NEWMARK-UT – STRUKTURALIZMI DHE KURTHET PRESKRIPTIVISTE

Libri *Standard Albanian: A Reference Grammar for Students* (Shqipja standarde: Gramatikë referenciale për student), është një qasje interesante e autorit kryesor Leonard Newmark dhe bashkautorëve Philip Hubbard dhe Peter Prifti, shumë e ndryshme nga Gramatika e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (1980), të cilës Newmark i referohet si libri tek i cili është mbështetur. Ndryshimi qëndron në metodologjinë, në qasjen dhe mbarështrimin e materialit të diskutuar në libër.

Ndonëse libri është marrë me gramatikën e shqipes në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke future aty madje edhe fonetikën e shqipes, tri janë momentet kryesore që e dallojnë këtë gramatikë nga ajo e Akademisë së Shkencave - Shqipja standarde, Disa çështje morfosintaksore dhe Fjalëformimi.



Fillimisht, do thënë se Newmark i ka mbetur besnik formimit të tij strukturalist dhe këtë metodë e ka aplikuar gjatë hartimit të këtij libri të Gramatikës, ndonëse vetë thotë se është mbështetur në Gramatikën e Akademisë që është një Gramatikë tradicionale e shqipes, më shumë preskriptive, sesa deskriptive.

Qëndrimi për standardin

Ndonëse Gramatika e Newmark et al. është botuar gjashtë vjet pas disertacionit të Janet Byron (Byron, 1976), e cila kishte shpjeguar me saktësi rrugën e përzgjedhjes së bazës dialektore të shqipes standarde, Newmark sikur tenton t'i shmanget diskutimit lidhur me standardin, duke u mjaftuar me disa shpjegime për arsyet e mosmarrjes së tij me bazën dialektore të shqipes standarde dhe kështu duke iu shmangur një korpusi të tërë linguistik gjatë trajtimit të fenomeneve fonetike, leksikore dhe gramatikore të shqipes. Newmark që në hyrje shpjegon se "Për shkak të kushteve të veçanta lidhur me gjuhën shqipe në këtë moment të historisë dhe të nevojave për studentët e gjuhës tash, do të ishte më e përshtatshme që në këtë libër të shmangim stërhollimet lidhur me gjuhën dhe të pretendojmë se Shqipja Standarde (Letrare) është para së gjithash gjuhë e shkruar, ndërsa në të shkuar është vetëm sekondare (f.7)" për të vazhduar se "Kur qeveria aktuale e Shqipërisë erdhi në pushtet në vitet '40 nuk mund të gjendej asnjë varietet i natyrshëm i gjuhës si zgjidhje e dukshme për të qenë standard të cilin secili përdorues i arsimuar i gjuhës do të përpiqej ta zotëronte. Nuk kishte mbizotërim të qartë të folësve të asnjërit varietet apo grupi varietetesh në jetën letrare, komerciale apo politike të shqiptarëve, që do formonte bazën e natyrshme të standardizimit" (f. 8). Sipas Newmark, "me kalimin e kohës, dialekti jugor apo toskë nisi të mbizotërojë në përdorimin zyrtar dhe gjysmëzyrtar dhe deri në vendimin formal, përdorimi de facto në publik tashmë ishte krijuar në kuptimin që standardi i ri gjuhësor të përmbante elemente individuale nga varietete të ndryshme dialektore, të mbizotëruara nga dialektet toske ku vetëm në disa raste individuale merrte pjesë dialekti gegë, kryesisht përmes fjalëve të veçanta apo morfemave. Më 1952, sipas Newmark shoqata e Shkrimtarëve vendosi ta përdorte toskërishten në botime dhe jo të vazhdonte botimet në dy standardet letrare si më parë, që sipas tij, "Përderisa kjo pati ndikim të rëndësishëm në botimet në vetë Shqipërinë, nuk u pranua nga pothuajse i njëjti numër i shqiptarëve jashtë vendit" (f.8).

Kështu shmangia e diskutimit të hollësishëm mbi standardin dhe mbështetja, së paku në punë të korpusit të analizuar, në Gramatikën e Akademisë ka bërë që plot fenomene të shqipes si gjuhë të lihen pa u trajtuar e së këndejmi edhe këndvështrimi dhe analiza morfologjike para së gjithash dhe ajo leksikore në kuptim të fjalëformimit të mbetet mjaft e kufizuar. Ndërkohë që trajtimi i gramatikës së shqipes dhe jo i vetëm një varieteti, sidomos duke pasur parasysh formimin strukturalist të Newmark-ut do të mund të kishte sjellë një Gramatikë referenciale jo vetëm për studentët, siç pretendohet në titull, por edhe për studiuesit më pastaj.

Fonetika

Pazakonshëm për një libër gramatike, Newmark i kushton një kapitull të tërë pikërisht fonetikës, fillimisht për të dhënë një pasqyrë më të qartë për shqipen, pasi që libri u dedikohet atyre që e mësojnë shqipen. Mirëpo, qasja strukturaliste shpërfaqet pikërisht në këtë pikë, meqë tiparet fonetike të fjalëve i vendos në funksione gramatikore, duke i trajtuar fonemat dhe tingujt elemente përbërëse gramatikore të fjalës, kryesisht mbështetur mbi metodat e aplikuara nga Martinet e duke shkuar më tej për të zbatuar një qasje më të avancuar që shkon paksa kah transfermacionalizimi i Chomsky-it përmes trajtimit të strukturës së thellë dhe asaj sipërfaqësore të gjuhës, ndonëse, për raste të caktuara, duke mos marrë parasysh gjithë korpusin a varieteteve të shqipes, sërish i anashkalon disa elemente qe janë bazike edhe për tipologjinë që ndërton te pjesa e foljeve sidomos.

Mirëpo, herë pas here i kthehet asaj qasjeje, sidomos kur flet për theksin në shqipen, duke e trajtuar atë në kuptim të fjalëformimit dhe të dinamikës së theksit gjatë këtij procesi.

Morfosintaksa

Pjesën e gramatikës Newmark e trajton si morfosintaksë, pa u lëshuar në gjymtyrë të fjalisë, në tipologji të fjalisë a periudhës etj. Ai e nis

me foljen dhe frazat verbale dhe jo me emrin siç bën Gramatika e Akademisë. Në këta kapituj, Newmark ndërton një qasje krejt të ndryshme nga Gramatika e Akademisë, por përdor materialet e korpusit të saj linguistik, ndonëse preskriptivizmi që e përshkon Gramatikën e Akademisë, nuk mund të jetë një burim i besueshëm dhe është në shpërputhje t plotë me qasjen deskriptiviste që metoda strukturaliste e përfill.

Trajtat e shkurtra të përemrit vetor, Newmark i përfshin te frazat verbale dhe jo veçanërisht te përemri, si në Gramatikën e Akademisë, ndërkaq, kur flet për mënyrat ai përmend dëftoren, habitoren, lidhoren, dëshiroren dhe urdhëroren. Në vazhdim pohon se në shqipen ka një kushtore, ka një lidhore-habitore dhe një "jussive", e cila në fakt është modalitet që ndërtohet mbi paradigmën e lidhores.

Ndërkaq, kur flet për zgjedhimin e tretë të foljeve, Newmark përmend se çshtja e zgjedhimit të foljeve del problematike në shqipen, por ai duket se nuk ka informacione të mjaftueshme për gegërishten, e cila pothuajse nuk e njeh fare këtë zgjedhim. Në fillim Newmark shpjegon se kriteri i klasifikimit të foljeve në zgjedhime është sinkronik, që d.m.th. merret parasysh gjendja e sotme e shqipes, e cila sipas tij ka kaluar ndryshime dramatike gramatikore.

Newmark merr si përfaqësues të zgjedhimit të tretë, klasa e parë, foljet *vë, zë* dhe *shpie*. Në gegërishten, që nuk është formacion i parëndësishëm gjuhësor brenda shqipes, këto folje nuk janë të zgjedhimit të tretë, pasi nuk dalin me forma të njëjta në të tria vetat e njëjësit. Ato dalin përkatësisht: *Unë vnoj, ti vnon, ai vnon; unë za, ti zen, ai zen*, ndërkaq *shpie* nuk është e leksikut të gegërishtes. Gjithashtu, në klasën e dytë merr foljet: *di, fle, ngre***.** Në gegërishten këto folje dalin: *unë di, ti di, ai di*, d.m.th. në vetën e parë zanorja është më e gjatë dhe ka vlerë fonologjike. Folja *fle* në gegërishten shkon me zgjedhimin e parë: *unë flej, ti flen, ai flen*, sikur *unë shkoj, ti shkon, ai shkon*. E kuptimi i foljes *ngre* në gegërishten shprehet me foljen *çoj* që gjithashtu shkon me zgjedhimin e parë. Edhe foljet ha, rri, pi, dalin si folja di.

Sa i përket kategorisë së kohës, Newmark nuk merret me forma të

tjera të kohës së shkuar, përveç atyre që janë përshkruar në Gramatikën e Akademisë. Ndërkaq, te koha e ardhme, nuk lë pa përmendur trajtën e gegërishtes *kam me shku* si të barabartë ose afërsisht të barabartë me *do të shkoj* të standardit, edhe pse këto dy trajta janë qartësisht të dallueshme në kuptim të modalitetit të obligueshmërisë së kryerjes së veprimit të pritshëm.

Te përdorimet e kohës së tashme dhe të së pakryerës, Newmark merret me atë që e quan formë momentale proklitike *po, po shkoj, po shkoja*. Këtë e ka trajtuar gjerësisht Brian Joseph në studimin "The puzzle of Albanian "po", (2011). Gjithsesi, Newmark i kushton hapësirë të veçantë dhe i bën trajtim interesant kësaj forme të kohës së tashme dhe të së pakryerës me pjesëzën aktualizuese *po***.** Së këndejmi mendoj se analiza që i bën Newmark, bashkë me studimin e hollësishëm të Brian Joseph-it, duhet të merret seriozisht nga gramatologët e e shqipes për ta vendosur edhe këtë kohë të foljes në gramatikat normative.

Përderisa modaliteti dhe aspekti i foljeve janë pikat shumë të ndritshme të Gramatikës së Newmarkut, jo vetëm të kësaj që po e diskutojmë, por edhe të disertacionit të tij, do përmendur edhe çështja e paskajores, së cilës Newmark herë i shmanget e herë e prek. Duke folur për paskajoren, fillimisht formën *"për të larë"* e cilëson "të ashtuquajtur" e më pas thotë: "Forma karakteristike e paskajores gege përbëhet nga "me" plus forma e shkurtër e pjesores, p.sh. *me punue*, por nuk do të diskutohet më tej këtu, pasi që nuk është pranuar se i takon standardit të sotëm të Shqipes letrare." (64).

Vetëm nja 30 faqe më tej, ai i kthehet paskajores duke thënë: "I ashtuquajturi infinitiv në shqipen e sotme standarde përdoret shpesh por në një numër të kufizuar funksionesh, ndryshe nga infinitivi gegë që përdoret në një rreze të gjerë funksionesh infinitivale (98)

Interesant është edhe diskutimi i tij për rasat e shqipes, me ç'rast e e nxjerr rasën gjinore si shumë heterogjene, pra me funksione të ndryshme sintaksore. Madje, genitivi ose gjinorja puqen në disa funksione me rrjedhoren apo ablativin, meqë që të dyja në funksione të caktuara kanë

të bëjnë me përkatësinë dhe kjo sidomos vërehet në rastet kur mungojnë formantët tipikë të këtyre rasave, përkatësisht nyja për gjinoren dhe parafjala për rrjedhoren. (134) Një studim interesant bazuar pikërisht mbi pohimet dhe pikëpamjet e Newmark për këtë çështje është ai i Andrew Spencer nga University Essex.

Dhe çështja e tretë, jo kaq e ndritshme te Newmark është fjalëformimi, apo marrja fragmentare e tij me fjalëformimin, duke e zhvendosur atë brenda pjesëve të ligjëratës apo klasave të fjalës ku shfaqen si dukuri, ndërkohë që fjalëformimi do trajtuar si mekanizëm, pikërisht për shkak të paradigmave përmes të cilave shprehen edhe raportet sintaksore edhe tipizimet morfologjike.

Përfundime

A është gramatika e Newmark-ut gramatikë referenciale për studentët e huaj që e mësojnë shqipen? Vështirë të thuhet, pasi i mungon komponenti teorik dhe komponentët pedagogjikë e didaktikë që do ta bënin libër të tillë. Prandaj, pavarësisht se Newmark dhe bashkautorët në fillim të librit e phojnë një gjë të tillë, kjo vështirë të pranohet, ashtu siç del tepër modest pohimi se "kjo nuk është një gramatikë linguistike, as studim shkencor i gjuhës me qëllim të avancimit të kuptimit teorik të gjuhës etj". Në të vërtetë, gramatika është linguistike, edhe pse nuk e zhvillon ndonjë teori të re shkencore as metodologji të re, siç kishte bërë Newmark me disertacionin e tij "Gramatikë strukturale e shqipes", më 1957.

Ajo që i mungon librit qasja direkte në shqipen apo në ndonjë korpus linguistik të shqipes. Gramatika e Newmarkut nuk ka një korpus – ajo mbështetet në shembujt e Gramatikës së Akademisë e cila është një Gramatikë preskriptive, e cila i zgjedh shembujt për të ilustruar teoritë dhe nuk ndërton teori mbi bazën e shembujve të përdorimit të shqipes, apo elemente të saj. Megjithatë, formimi strukturalist i Newmark-ut bën që të ndërtojë një qasje më ndryshe në kuptim të strukturimit të gramatikës, duke folur jo për morfologji e sintaksë veç e veç por për morfosin-

taksë, duke ndërtuar tipologji tjetër, pra fenomenologjike dhe funksionnale, përpara se tradicionale. Kjo qasje i ka ndihmuar atij dhe bashkautorëve që të zhvillojnë tipologji të tjera lidhur me rasat, me kohët e foljeve, më mënyrat dhe kategori të tjera leksiko-gramatikore, pasi ato i kanë trajtuar njëkohësisht si pjesë të ligjëratës, por të ndërlidhura me funksionin e tyre sintaksor që është përcaktues në masë të madhe për trajtat e ndryshme të paraqitjes së tyre. Pra morfologjia është vetëm forma, ndërkohë që funskikoni është sintaksor dhe analiza strukturale çon pikërisht në drejtim të ndërtimit të një qasjeje çfarë e ka ndërtuar kohë pas kohe Newmark, duke mbetur shpesh i lidhur për Gramatikën e Akademisë, si te fjalëformimi për shembull, ku një qasje konsistente strukturaliste do të kishte kërkuar tipologji tjetërfare nga ajo e Gramatikës së Akademisë, në të cilën për shembull konversioni dhe fjalëformimi pa ndajshtesa ngatërrohen deri në masën sa përdoren shembuj të njëjtë për mënyra që autorët i kanë konsideruar të ndryshme.

Rrahman PAÇARIZI, Faculty of Philology, Prishtina University

NEWMARK'S GRAMMAR - STRUCTURALISM AND PRESCRIPTIVE TRAPS

Standard Albanian - a Reference Grammar for Students co-authored by Leonard Newmark, Philip Hubbard, and Peter Prifti is an important book of the Albanian grammar. At the very outset of the book, Newmark notes that it is not a book on linguistics or a particular scientific work. He advises that, to a great extent, the book is an adaptation of the *Gramatika e Gjuhës Shqipe* [Albanian Language Grammar] of a group of authors, published by the Albanian Academy of Sciences and the Institute of Linguistics and Literature in 1976.

But, in point of fact, Newmark's book is written in a completely different way, by referring solely to the examples and explanations provided in the above-mentioned publication. Namely, Newmark followed a structural model of the interpretation and he used a terminology more advanced than the one he says had referred to. Newmark starts his grammar with the phonetics of the actual Albanian, but fails to divide the grammar into morphology and syntax, by treating it as a morpho-syntax, and addressing the problems one by one.

This paper also treats the reviews on this book written by Fiedler, Hamp, and others, focusing in particular on Eric Hamp's assessment of Newmark's study of the Albanian structural grammar.

Literatura

Agalliu, Fatmir, et.al, *Gramatika e gjuhës shqipe, I e II,* Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2002

Byron, Janet, *Përzgjedhje midis alternativash në standardizimin e gjuhës dhe Shkrime të tjera***,** Dituria, Tiranë, 2012, përkth. Marjana Ymeri

Joseph, Brian, *The puzzle of Albanian "po",* në: Eirik Welo (ed.) Indo-European syntax and pragmatics: contrastive approaches, Oslo Studies in Language 3(3), 2011. 27–40

Newmark, Leonard , Philip Hubbard, Peter Prifti**,** *Standard Albanian: A Reference Grammar for Students***,** Stanford University Press, 1982

Lyons, John, *Hyrje në gjuhësinë teorike***,** Dituria, Tiranë 2010, përkth. Ethem Likaj

Martinet, Andre, *Elemente të gjuhësisë së përgjithshme***,** Rilindja, Prishtinë, 1974, pwrkth. Rexhep Ismajli

Robins, Robert, *Historia e gjuhësisë*, Dituria, Tiranë 2007, përkth. Genc Lafe

Spencer, Andrew, *Does Albanian has a genitive case*, në: http://privatewww.essex.ac.uk/~spena/PossMod/poss_agr_constr1.pdf

Jonida XHYRA-ENTORF, Mynih

SHKOKLITJE SOCIO-KULTURORE NË „OXFORD ALBANIAN-ENGLISH DICTIONARY" (OAED)[1] HARTUAR NGA NEWMARK

Gjithpërfshirja dhe konteksti sociokulturor

Leksikografia është një praktikë shkencore e lashtë e cila kodifikon strukturën sintagmatike dhe paradigmatike të një gjuhe, ndërkohë që fjalori, duke u mbështetur në proceset leksikografike, shoqërohet gjithmonë me pasqyrimin e një kulture. Në këtë këndvështrim detyra e një fjalori dygjuhësh është që të vendosë në lidhje të ndërsjelltë kodifikimet leksikore të dy gjuhëve të ndryshme, në mënyrë që përdoruesi të prodhojë përgjegjëse të qarta e të njëkuptimshme.

Pas të dhënave dhe informacioneve për fjalët fshihen arsyet e një përzgjedhjeje. Formësimi i një fjalori del në pah i vendosur në një mjedis socio-kulturor dhe ky i fundit konkretizohet si i tillë duke pasur parasysh jo vetëm dimensionin kulturor të leksikografit, por edhe marrëdhënien pragmatike të përdoruesit të fjalorit.

Në fushën e leksikografisë dygjuhëshe shqip-anglisht fjalori i 1948-ës hartuar nga Stuart Mann[2] zë një vend të veçantë. Materiali tejet i gjerë leksikor me rreth 45.000 zëra kap një shtrirje kohore monumentale 1496-1938 dhe vazhdon akoma të ruajë vlerën e konsultimit përmes informacioneve shtesë që orientojnë në drejtime të ndryshme burimore letrare apo regionale. Botimi me 75.000 fjalë i *Oxford Albanian-English Dictionary*

---

[1] Në vijim do të përdoret shkurtimi OEAD.

[2] Stuart E. Man.: An Historical Albanian-English Dictionary. Published for The British Council by Longmans, Grren and Co, LTD. London, 1948.

një gjysmë shekulli më vonë vazhdon të ruajë gjithëpërfshirjen, por natyrisht në një nivel bashkëkohor dhe shkencërisht të strukturuar. Fiedler-i[3] me të drejtë e cilëson fjalorin e Newmark-ut si fjalorin më të gjerë dygjuhësh shqip, që duke u nisur nga standardi jep një pasuri shumë të madhe formash dhe fjalësh dialektore.

Qysh në titull paraqitet zgjerimi i kufijve: *includes standard and non-standard* dhe ndërmarrja leksikografike vetëvendoset kësisoj shumë natyrshëm në një kontekst konkret sociokulturor. Fjalori i Newmark-ut dhe këndvështrimi i tij gjithëpërfshirës lidhur me standardin nuk mund të kuptohen jashtë hapësirës socio-kulturore të studimeve albanistike në Amerikë. Lidhur me standardizimin e shqipes nga pikëpamja amerikane, pas një retrospektive të thuktë për lëvrimin e toskërishtes dhe gegërishtes shtrirë në të gjithë shekullin XX, Friedman-i thekson: „Në qoftë se lëmë mënjanë politikën dhe mendojmë vetëm për estetikën dhe shkencën, tradita e pasur dialektore e gjuhës shqipe ka një vend në kulturën e botës. Fjalori shqip-anglisht i Newmark-ut më 1998 e pasqyron këtë. Nga ana tjetër gjuha e njësuar është një thesar që duhet të ruhet .... Sfida për shqipen në Amerikë në shekullin XXI do të jetë të ruajë arritjet e Kongresit të Drejtshkrimit të vitit 1972 së bashku me zhvillimet moderne."[4]

Në parafjalën e kursyer të fjalorit Newmark-u rendit 10 risi[5] lidhur me ndërmarrjen e tij leksikografike:

1.përfshirjen e një numri të madh elementesh që nuk i përkasin standardit, (të markuara përmes asteriksit *) si dhe elementet e njohura të standardit[6],

[3] Fiedler, W.: Zu Problemen der zweisprachigen albanisch-deutschen Wörterbücher. Në: Kunzmann-Müller, B. & Zielinski, M. (botuese): Sprachwandel und Lexikographie. Beispiele aus slawischen Sprachen, Ungarischen und Albanischen (Berliner slawistische Arbeiten, Band 18). Peter Lang, Frankfurt am Main, 2002. f. 23.

[4] Friedman, V.: Shqipja standarde në Amerikë: Studime shkencore, pedagogjike dhe planifikimi gjuhësor. Në: Akademia e Shkencave (botues). Konferenca shkencore: "Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot". Tiranë, 11-12 nëntor 2012, f. 157.

[5] Newmark, L., f. IV: a number of innovative features.

[6] Po aty, f. IV: inclusion of large numbers of non-standard items (indicated by *) as well as all known standard items.

2.të dhënat lidhur me kufijtë e morfemave[7],

3.përfshirjen e një numri të madh kolokacionesh dhe idiomash[8],

4.përdorimin e një numri të madh përkufizimesh dypjesëshe, në të cilat përshkrimi devijues i kuptimit pasohet nga shpjegimi përmes shembujve në anglisht[9],

5.përfshirjen e një numri të madh terminologjish për barëra, lule, zogj dhe peshq (p.sh. të një liste të vecantë për elementet që fillojnë me **bar**) bashkë me përkufizimet e tyre shkencore[10],

6.përfshirjen e një numri modest informacionesh enciklopedike për të shpjeguar fjalë, kuptimi i ngushtë leksikor i të cilave në kontekstin shqip nuk do te ishte i qartë[11]

7. renditjen e formave të ndryshme bazë të leksemave si ndarje të veçanta në pozicionin e tyre korrekt alfabetik - për t'ia lehtësuar lexuesit deshifrimin e formave që ai ndesh në një tekst aktual[12],
8. përdorimin e simbolit • për të treguar mbarimin e rrënjës së foljes[13],
9. renditjen alfabetike të sufikseve në një tabelë, për t'i lehtësuar lexuesit njohjen e fjalëve të dyshimta përmes punës nga pas përpara[14],
10. kursimin e vendit për regjistrime të tjera përmes lënies jashtë të she-

---

[7] Po aty, f. IV: indications of morpheme boundaries.

[8] Po aty, f. IV: inclusion of large numbers of collocations and idioms.

[9] Aty, f. IV: use of large numbers of bipartite definitions in which of discursive description of a sens is followed by a colon and then English synonyms that exemplify that sense.

[10] Po aty, f. IV: inclusion of large numbers of terms for grasses, flowers, birds and fish (note, for example, the particularity exstensive list of items begining with **bar**) with their scientific definitions.

[11] Po aty, f. IV: inclusion of a modest amount of encyclopedik information to explain words whose strictly lexical meaning would not make their use in Albanian contexts intelligible.

[12] Po aty, f. IV: listning of the various stem forms of lexemes as separate entries in their proper alphabetical position - to enable readers to decipher otherwise mystifying forms encountered in actual texts.

[13] Po aty, f. IV: use of the symbol • to indicate the end of a verb stem.

[14] Po aty, f. IV: reverse-alphabetic listing of suffixes in an appendix, to permit readers to figure out puzzling by working from back to front.

mbujve për shumicën e kuptimeve duke u bazuar në faktin që lexuesi e përdor fjalorin për interpretimin e përmbajtjeve të veta problematike kontekstuale, në vend që të përpiqet që t'i kuptojë fjalët e veçanta në boshllëk, pa kontekst.[15]

Siç vihet re fare lehtë nuk është vetëm përfshirja e elementeve që nuk i përkasin standardit, por edhe thurima e veçantë e informacioneve gramatikore, informacionet lidhur me frazeologjinë, terminologjinë, dija enciklopedike e përfshirë, e më tej marrëdhënia e hapur me përdoruesin, duke e orientuar, por njëkohësisht edhe duke i lënë hapësirë këtij të fundit për interpretimet e përmbajtjeve të veta problematike kontekstuale. Në vijim do të synohet pikërisht „shkoklitja" socio-kulturore e këtyre risive në marrëdhënie me tipologjinë, makrostrukturën dhe mikrostrukturën e OEAD.

Tipologjia dhe profili i përdoruesve

Paraqitja e ekuivalencave për marrëdhënien gjuhë e pikënisjes - gjuhë shpjeguese në një fjalor dygjuhësh vë në dukje tre parametra të rëndësishëm që kanë të bëjnë me hartimin e tij: tipologjinë, makrostrukturën dhe mikrostrukturën[16].

Pa u futur në stërhollime teorike lidhur me tipologjinë[17] vlen të

[15] Po aty, f. IV: saving spacec for more entries by omitting sample contexts for most senses, on the grounds that the readers will be using the dictionary to interpret their own problematic contexts, rather than trying to understand particular words in vacuo.

[16] Konceptet e makrostrukrurës dhe të mikrostrukturës në aspektin leksikografik u shtjelluan dhe u përdorën për herë të parë nga Rey-Debove në fillim të viteve 70 në punimet e saj leksikografike për fjalorët njëgjuhësh të frëngjishtes. Shih më gjerë: Rey-Debove, J.: Étude linguistique et sémiotique des dictionnaires français contemporains. The Hague, Mouton, 1971.

[17] Ščerba, L. W.: Versuch einer allgemeinen Theorie der Lexikographie. Në: Wolski, W. (botues): Aspekte der sowjetischen Lexikographie. Übersetzungen, Abstracta, bibliographische Angaben (= Reihe Germanistischer Linguistik, Bd. 43) Tübingen, 1982, f. 17-62; Wiegand, H.-E.: Ansätze zu einer allgemeinen Theorie der Lexikographie. Në: Die Lexikographie von heute und das Wörterbuch von morgen. 1983, f. 92-127; Wiegand, H.-E.: Überlegungen zu einer Theorie der lexikographischen Sprachbeschreibung. Në:

përmendet fakti që vitet 80 shënuan një hop cilësor në përfshirjen e perspektivës së përdoruesit, hop i cili u përçua jo vetëm në mësimdhënien e gjuhës së huaj në përgjithësi, por dhe në qartësimin e mëtejshëm të punës me leksikun në këtë drejtim. Kësisoj profili i përdoruesit[18] apo rrethi i përdoruesve qysh nga diskutimi teorik e më tej filloi përherë e më rëndom të marrë përmasën e një kriteri tipologjik[19].

Fjalori OEAD u drejtohet të gjithë atyre që merren me shqipen bashkëkohore, qofshin këta studentë, specialistë apo përkthyes, por në të njëjtën kohë autori tërheq vëmendjen për faktin që fjalorët e gjuhëve natyrale janë një kompromis. Rrethi i përdoruesve që merren me shqipen, po të vazhdojmë të përdorim përcaktimin e përgjithësuar, filloi të konkretizojë profile të ndryshme në fund të shekullit të kaluar, duke pasur parasysh përvijimin e një konteksti të ndryshuar sociokulturor dhe lidhur me këtë edhe ripozicionimin e shqipes si gjuhë e huaj. Tashmë gati 15 vjet pas botimit të OEAD mund të vihet re që megjithë zgjerimin dhe profilizimin e mëtejshëm të rrethit të përdoruesve, ky fjalor vazhdon të ruajë aspektin gjithëpërfshirës në këshillimin dhe dhënien e përgjigjeve.

Detyrat shoqërore të një ndërmarrjeje leksikografike siç është fjalori orientohen jo vetëm sipas tipit dhe stadit të zhvillimit të një gjuhe, por edhe sipas nevojave të brendshme politike dhe kulturore të shoqërisë përkatëse, duke realizuar kësisoj komunikimin. Parë në këtë këndvështrim fjalorët përmbushin dy detyra, që nuk mund të ndahen syresh. Nga njëra

---

Symposium zur Lexikographie. September 1-2, 1982 at the University of Copenhagen. Ed. by Karl Hyldgaard-Jansen, Arne Zettersten. Hildesheim, 1983.

[18] Kromann, H.-P. & Ribach, T. & Rosbach, P.: Überlegungen zu Grundfragen der zweisprachigen Lexikographie. Në: Wiegand, H.-E. (ed.): Studien zur neuhochdeutschen Lexikographie V (=Germanistische Linguistik 3-6/1984) Hildesheim, New York; 1984, f. 161.

[19] Teoria e rrethit të përdoruesve të një fjalori: Wiegand, H.-E.: Zur handlungstheoretischen Grundlegung der Wörterbuchbenutzungsforschung. Në: Kucera, A. & Rey, A. & Wiegand, H. E. & Zgusta, L. (botues): Lexicographica. International Annual for Lexikographie 3/1987, f. 178-227. Koncepti i multifunksionalitetit të fjalorit: Bergenholtz, H.: Lemmaselektion in zweisprachigen Wörterbüchern. Në: Meder, G. & Dörner, A. (botues): Worte, Wörter, Wörterbücher: lexikographische Beiträge zum Essener Linguistischen Kolloquium (= Lexicographica, Series Maior 42). Tübingen, 1992, f. 49.

anë ata plotësojnë nevojat e atykëtushme të përdoruesve, ndërkohë që, duke qenë vepra referuese me karakter dokumentues, ata fiksojnë nga ana tjetër stadin dhe prirjen për zhvillim në drejtime të ndryshme të shoqërisë.[20] Newmark i mëshon faktit që OEAD të rroket si një instrument për lexuesit dhe jo si një arkiv historik i gjuhës[21], duke nënvizuar në këtë mënyrë pikërisht komunikimin e hapur me rrethin e përdoruesve.

Makrostruktura dhe mikrostruktura

Lidhur me makrostrukturën dhe mikrostrukturën e një fjalori digjuhësh gjatë përzgjedhjes së fjalëve merren parasysh faktorë të ndryshëm[22] si p.sh.: fleksione të parregullta, arkaizma dhe regionalizma, variante drejtshkrimore, fjalë nga fusha të caktuara, elemente të dukshme të fjalëformimit si dhe rezultate të tij, ndërkombëtarizma etj. Organizimi i të dhënave të mësipërme kushtëzon jo vetëm dijen gjuhësore, por edhe atë linguistike e më gjerë enciklopedike.

Makrostruktura nënkupton tërësinë e zërave të përfshirë, „përmbajtjen dhe ndërtimin"[23] e fjalorit. Ajo ngërthen në vetvete tipare cilësore dhe sasiore, por njëkohësisht dhe pjesën e parme e të pasme të tij. Pikërisht pjesa e parme e OEAD me informacionet, tabelat, këndvështrimet, shpjegimet për mënyrën e përdorimit, jo më pak se pasuria sasiore e zërave, i jep makrostrukturës së këtij fjalori një frymëmarrje të gjerë

[20] Shih më gjerë: Wiegand, H.-E.: Über den Nutzen von Wörterbüchern. Në: Von Mogens, D. & Jorgen, O. (botues): Festschrift für Karl Hyldgaard-Jensen. Zum 70. Geburtstag am 3. Februar 1987 (Kopenhagener Beiträge zur Germanistischen Linguistik. Sonderband 3). Kopenhagen, 1987, f. 308-318; Weinrich, U.: Die Wahrheit über die Wörterbücher. Në: Moser 1976, f. 347-371; Reichmann, O.: Historische Bedeutungswörterbücher als Forschungsinstrumente der Kulturgeschichtsschreibung. Në: Hildebrandt & Knoop. 1986. f. 242-263.

[21] Newmark, L.: This dictionary is intended as a tool for readers, not a historical archive of the language to be preserved and explored for its own sake.

[22] Nassimi, M. A.: Zweisprachige Lexikographie des Sprachenpaares Deutsch und Dari/ Persish. Essen, 2004, f. 31.

[23] Schaeder, B.: Germanistische Lexikographie. (Lexicographica, Series Maior 21) Tübingen, 1987, f. 83.

duke nxjerrë në pah kthjelltësinë shkencore. Mikrostruktura ka të bëjë me organizimin e informacioneve për zërat[24] dhe shtron drejtpërsëdrejti pyetjen se nisur nga çfarë pikëpamjesh dhe me çfarë mjetesh i ofrohen informacionet përdoruesit të fjalorit. Mikrostruktura është si të thuash: profili i zërit, ngrehina e një zëri të paraqitur në fjalor duke pasur parasysh semantikën, gramatikën dhe fonetikën."[25]

Renditjes alfabetike të zërave në OEAD i paraprin një material tepër i gjerë shpjegues dhe gramatikor, i cili jo vetëm e qartëson makrostrukturën, por i jep mundësi përdoruesit të vjelë në mënyrë optimale mikrostrukturën e çdo zëri.

Pas parathënies tepër të kursyer vijon përmbledhja e shkurtimeve të përdorura, të cilat të organizuara për çdo zë japin informacione të rëndësishme lidhur me drejtshqiptimin dhe veçanërisht me gramatikën. Duke qenë se ndër gjuhët indoeuropiane të Europës shqipja dëshmon një karakter të theksuar sintetik, përfshirjen e informacioneve gramatikore në

[24] Në literaturën leksikografike përdoren rëndom termat *lemë* dhe *lematë*. Shenjimi *lemë* vjen nga greqishtja (λημμα) dhe do të thotë temë, titull, tregues i përmbajtjes (shih më gjerë: Wolski, W.: Das Lemma und die verschiedenen Lemmatypen. Në: Hausmann F.-J.& Reichmann O.& Wiegand H.-E. & Zgusta L. (botues): Wörterbücher, Dictionaries, Dictionnaires. Ein internationales Handbuch zur Lexikographie. Teilband 1. Berlin, New York, 1989, f. 360v). Henne e analizon lemën jo vetëm nga këndvështrimi i hartuesit, por dhe nga ai i përdoruesit të fjalorit. Lidhur me të parin lema përkatëse paraqet të shenjuarin, të cilit i nënrenditet shenjuesi gjatë përshkrimit semantik. Nga këndvështrimi i përdoruesit të fjalorit lematat krijojnë një njësi të shenjuesit dhe të të shenjuarit atëherë kur janë pjesë e kompetencës së tij gjuhësore (shih më gjerë: Henne, H.: Prinzipien einsprachiger Lexikographie. Në: Moser 1976, f. 112v). Wiegand përdor në punimet e tij konzeptin *shenjë e lemës* për të përcaktuar lematën dhe kupton përmes saj atë shenjë, e cila është përpunuar nga ana leksikografike dhe përdoret për përfaqësimin e lemës (shih më gjerë: Wiegand, H., E.: Was ist eigentlich ein Lemma? Ein Beitrag zur Theorie der lexikographischen Sprachbeschreibung. Në: Germanistische Linguistik, 1-4/82, f. 429). Duke qenë se problematizimi terminologjik nuk na duket i rëndësishëm në analizën konkrete, kemi parapëlqyer të përdorim termin e përgjithshëm zë.

[25] Kromann, H.-P. & Ribach, T.& Rosbach, P. f. 161: „das Artikelprofil, die Einrichtung eines Wörterbuchartikels im Hinblick auf Semantik, Grammatik und Phonetik."

një fjalor dygjuhësh Fiedler-i[26] e cilëson si një nga detyrat më të rëndësishme.

Tabela e shkurtimeve gramatikore përmbledh një kategorizim të gjerë, veçanërisht lidhur me foljen, kohët dhe mënyrat e saj. Shkurtimet lidhur me përdorimin përfshijnë aspekte të stilit, p.sh.: *elevated style, historical, colloquial, poetic* ose bëjnë me dije përdorimin regional, p.sh.: *Reg Arb, Reg Calab, Reg Gheg, Reg Kos, Reg Mont, Reg Tosk*, madje dhe *Reg Tir*. Shkurtimet lidhur me terminologjinë, të cilat përmbledhin rreth 75 fusha, pasohen nga shpjegimet se si janë organizuar përdorimet idiomatike në fjalor.

Në rubrikën *Grammatical sketsh for readers of Albanian* jepen shpjegime të hollësishme lidhur me kategoritë gramatikore të shqipes. Informacionet shpjeguese për foljen parashtrohen gjerësisht duke nisur nga kohët, mënyrat e zgjedhimet deri tek tabelat përmbledhëse për foljet e rregullta e të parregullta. Në krahasim me këtë kategori gramatikore, emrit e më tej mbiemrit, përemrit dhe numërorit i është kushtuar më pak vëmendje. Për sistemin nominal jepet forma e pashquar e njëjësit si trajtë përfaqësuese. Si trajtë përfaqësuese për foljen merret veta e tretë e kohës së tashme me argumentimin që prej kësaj trajte janë më lehtë të shpjegueshme rregullat dhe duke qenë e pranishme tek të gjitha foljet ajo e tregon më qartë klasën së cilës i përket folja.

Në rubrikën *Finding your word in the dictionary* përmes renditjes alfabetike të sufikseve në një tabelë, synohet që t'i lehtësohet lexuesit njohja e fjalëve të dyshimta përmes punës nga pas përpara. Shpjegimeve në rubrikën *Dialectal variation & standard albanian* i paraprin një pozicionim i qartë përsa i takon markimit me asteriks të elementeve që nuk i përkasin standardit. Autori sqaron që ky i fundit nuk përmban asnjë lloj vlerësimi të tipit: „e gabuar vs e drejtë, e keqe vs e mirë apo e papranueshme vs e pranueshme"[27]. Pas kësaj rubrike vijon paraqitja e korpusit tepër të gjerë, i cili i përmbyll të gjitha shënimet shpjeguese.

[26] Fiedler, W., f. 24.

[27] Newmark, L., f. IXIX.

Analiza e makrostrukturës dhe mikrostrukturës nxjerr në pah faktin që përdoruesit i hapen shumë shtigje, përmes të cilave ai mund të marrë rrugën deri tek informacioni i kërkuar. Ky rrugëtim nuk është aspak i lehtë dhe i vetëkuptueshëm, por varet nga profili i përdoruesit e më tej nga marrëdhënia pragmatike që krijon ai me informacionin e dhënë.

Informacioni problematik dhe marrëdhënia e hapur

Gjithëpërfshirja parakupton zgjerimin e dijeve dhe është një e vërtetë e padiskutueshme që zgjerimi i tyre kushtëzon paraprakisht një nivel të caktuar jo vetëm dijesh por edhe kompetencash kur është fjala për gjuhën. Përdoruesi i fjalorit duhet të zotërojë premisa dhe njohuri të domosdoshme, të cilat t'i bëjnë me dije se fjalorët përmbajnë informacione problematike.[28] Parë nga ky aspekt *includes standard and non-standard* e bën të pashmangshëm diskutimin nga ana e përdoruesit dhe problematika qerthullon domosdoshmërisht proceset e standardizimit, madje më tej edhe të destandardizimit[29], procese të cilat në raport me leksikun formësohen përmes normës së kodifikuar nga njëra anë dhe të ashtuquajturave „forma subsistente"[30] nga ana tjetër.

„Fakti që krahas standardit gjëllijnë edhe një sërë formash të tjera, por kurrsesi jo gjithmonë të zhvlerësuara të ekzistencës së gjuhës (varietetet) si p.sh.: dialektet, terminologjitë dhe zhargonet, nuk ndryshon asgjë në funksionin e standardit përkatës. Mundësia për t'iu shmangur atij, e bën akoma më të dukshme ekzistencën e tij."[31] Ky është këndkështrimi

[28] Kühn, P. 1989: Typologie der Wörterbücher nach Benutzungsmöglichkeiten. In: HSK 5.1, f. 111-127.

[29] Prirjen e destandardizimit në realitetin gjuhësor shqiptar Breu e cilëson jo vetëm si shenjë të demokratizimit dhe shpolitizimit, por dhe si një proces politik i cili po del në pah gjithnjë e më tepër: Breu, W.: Variantenstreit und Normierung im Albanischen. Në: Matheier, J. K. & Radtke, E.: Standardisierung und Destandardisierung europäischer Nationalsprachen. VarioLingua 1. Peter Lang Verlag, Frankfurt am Main, 1997. S. 248.

[30] Polenz, P.: Deutsche Satzsemantik. Grundbegriffe des Zwischen-den-Zeilen-Lesens. Berlin, 1989, f. 229.

[31] Haß-Zumkehr, U.: Deutsche Wörterbücher - Brennpunkt von Sprach- und Kulturgeschichte. De Gruyter, Berlin - New York, 2001, f. 336: „Dass es neben der Leitvarietät

gjithëpërfshirës i leksikografit, i cili gjen shprehje në OEAD. Përdoruesi, në varësi nga profili i tij, krijon marrëdhënien pragmatike vetiake në aspektin fonetik e gramatikor dhe për më tepër në atë leksikor.

Lidhur me variacionin fonetik në OEAD parashtrohen rotacizmi dhe hundorësia: *rânë (Reg Gheg) = rërë[32], por jo asimilimi i grupeve mb>m, nd>n dhe monoftongizimi p.sh tek foljet. Nga këndvështrimi morfosintaktik një element brizant është e ardhmja, e cila në toskërisht formohet sipas mënyrës ballkanike me ndihmën e foljes modale dua, kurse në gegërisht sipas tipit të gjuhëve romane me ndihmënn e foljes kam. Brizanca që sjell ky formim ka të bëjë me praninë dhe jo praninë e infinittivit, aq shumë të diskutuar si argument kur është fjala për standardizimin. Formimi i mësipërm nuk përfshihet në OEAD, madje në shkurtimet e terminologjisë gramatikore mungon inf. për infinitivin. Të dhënat për formimin e shumësit të emrave, i cili gjithashtu përçon brizancë lidhur me standardizimin, janë të pakta.

Ndryshimet e ndjeshme në leksik përfshihen në stil të gjerë, por ato gjithsesi janë të papërshtatshme për diskutimin e normës si diferencime sistematike.[33] Në një artikull problematizues për fjalorët dygjuhësh shqip-gjermanisht me të drejtë Fiedler[34] shtron pyetjen se deri në ç'masë mund të përfshihen në një fjalor dygjuhësh dallimet leksikale të përdorimeve duke pasur parasysh këtu shqipen e folur në Shqipëri, Serbi, Kosovë, Maqedoni, dhe Mal të Zi. Newmark e përfshin këtë aspekt edhe në shkurtimet, siç e vumë re më lart, por problematika mbetet e hapur, sepse në këtë drejtim shqipja si gjuhë e pikënisjes ofron pak ose aspak gjurmime dhe hulumtime mirëfilli shkencore.

Për konkretizim po rendisim disa shembuj të vjelë jo sistematikisht

noch eine Reihe anderer und keineswegs immer abgewerteter Existenzformen von Sprache (Varietäten) gibt, z.B. die Dialekte, Fach- und Sondersprachen ändert nichts an der Funktion der jeweiligen Leitvarietät. Dass man von ihr auch abweichen kann, bestätigt vielmehr ihre Geltung."

[32] Newmark, L., f. 726.

[33] Breu, W., f. 254.

[34] Fiedler, W., f. 25.

nga OEAD lidhur me dallimin leksikal të përdorimit në Kosovë dhe Shqipëri. P.sh. *mal* (f. 486) jepet si kuptim i katërt *pyll* me markimin (Old) por pa markimin regional siç përdoret në Kosovë. *Tezak* (f. 863) jepet me shpjegimin *son of mother's sister, cousin,* pa markim për përdorim regional. *Shoqe* (f. 822) në kuptimin e dytë jepet me *wife,* por pa markim për përdorim regional. Forma e urdhërores *shuj* (f. 849) jepet me shënimin gramatikor *imper*. bashkë me trajtën përfaqësuese dhe ekuivalenten në anglisht, por pa markim tjetër. Pa markim regional jepen gjithashtu *bubrek* (Old), vetëm me përkthimin në anglisht *kidney* (f. 102), *lukthi i barkut* (f. 470) me përkthimin *pit of the stomach* dhe *bërllok* (f. 75) me markimin (Pej), por jo (Reg). *Kerr, rak, kundër* apo *sokë* p.sh. nuk janë të përfshira.

Leksiku me specifikë kulturore

Përgjithësisht kultura kuptohet si „tërësia e veprave materiale, sociale dhe ideale të krijuara nga njerëzit"[35], pra si një „realitet i ndërtuar prej njerëzve"[36], por një realitet i cili kufizohet në hapësirë dhe kohë. Koncepti i *rrethit kulturor*, parashtruar në fund të shekullit të 19-të nga etnologu Leo Frobenius[37] është në njëfarë mënyre pararendësi i *arealit kulturor*, i cili përdoret në etnografi për „kombinime të caktuara të mallrave kulturore, të përhapura në një zonë"[38], që mund të jenë të një natyre ideale, gjuhësore, shoqërore ose materiale, duke përfshirë këtu edhe të dhënat gjeografike.

Pa dashur të hyjmë në përsiatje teorike lidhur me kufijtë e *arealit kulturor* si koncept, për më tepër me përfaqësimet e ndryshme teorike të relativizmit gjuhësor e kulturor, dëshirojmë vetëm të përmendim faktin e

[35] Metzler Lexikon Sprache: Digitale Bibliothek. Berlin: Verlag J.B. Metzler, 2000 (CD-ROM-Ausgabe): „Gesamtheit der materiellen, sozialen und ideellen Schöpfungen von Menschen".

[36] Haller, D.: dtv-Atlas Ethnologie. München: Deutscher Taschenbuch Verlag, 2005, f. 29: „durch Menschen konstruierte Realität".

[37] Frobenius, L.: Ursprung der afrikanischen Kulturen. Berlin, 1898.

[38] Haller, D., f. 41.

pranuar gjerësisht, se *universaliet kulturore*[39] janë të konotueshme. Konkretisht lidhur me hartimin e një fjalori dygjuhësh, kjo dukuri fytyrëzohet përmes leksemave „të mbarsura“ me një specifikë kulturore, përfshirja e të cilave kushtëzon njëkohësisht dijen kulturore etnografike përkatëse.

Në terminologjinë leksikografike bëhet fjalë në këtë rast për leksema të klasifikuara si *realie* duke pasur parasysh këtu: „objekte ose fenomene, të cilat ndeshen vetëm në një kulturë të caktuar dhe për këtë arsye janë të panjohura ose të vështira për t'u kuptuar nga anëtarë të kulturave të tjera.“ [40] Për arsye të problematikës teorike që sjell me vete, termi i mësipërm shmanget nga shumë autorë dhe në vend të tij përdoren shenjime të tilla si leksik ose fjalë me specifikë kulturore, të cilat pasqyrojnë përvojën e veçantë historike dhe kulturore të një bashkësie gjuhësore.[41]

Duke qenë se na duket më gjithëpërfshirëse, në vijim të analizës do të përdoret terminologjia e dytë, një klasifikim i thjeshtë tematik i së cilës do të përfshinte aspektin kulturor gjeografik, etnografik dhe atë shoqëror-politik, për të cilët do të renditen shembuj të vjelë në mënyrë jo sistematike nga OEAD.

Për tematikën kulturore gjeografike janë marrë dy shembuj. Së pari *plakat* me kuptimin e periudhës së fundit dimërore në fillim të pranverës. Në OAED kjo specifikë kulturore nuk pasqyrohet, por çuditërisht jepet togfjalshi i literarizuar *plakë e jetës* me shpjegimin *very old woman: old crone* (f. 675). Shembulli tjetër *djegagur* lidhet me motin gjatë 12 ditëve të para

[39] Po aty, f. 28. Në këtë atlas etnografik renditen afërsisht 72 universalie të tilla, që përfshijnë p.sh.: arsimin, artin dekorativ, familjen, folklorin, organizimin shoqëror, kalendarin, lojërat, mënyrën e banesës etj.

[40] Nord, C.: 2002: Fertigkeit Übersetzen. Ein Selbstlernkurs zum Übersetzenlernen und Übersetzenlehren. Alicante: Editorial Club Universitario, 2002, f. 172: „Gegenstände oder Phänomene, die nur in einer bestimm-ten Kultur vorkommen und daher für Angehörige anderer Kulturen oft unbekannt oder schwer verständlich sind.“

[41] Shih më gjerë: Petelez, K.**:** Standardisierung der Lexikoneinträge für ein neues großes deutsch-polnisches und polnisch-deutsches Wörterbuch. Në: Studien zur zweisprachigen Lexikographie mit Deutsch VII. Botuar nga H. E. Wiegand. Hildesheim, New York, 2001, f. 131; Pörings, R. & Schmitz, U. (botues): Sprache und Sprachwissenschaft. Eine kognitiv orientierte Einführung. Narr, Tübingen, 1999, f. 144.

të gushtit, periudhë e cila gjithashtu ka një specifikë kulturore dhe veçanërisht në Shqipërinë e Veriut sipas Çabejt[42] lidhet me bestytni të ndryshme. Në OEAD jepet shpjegimi i përgjithshëm: *peak of summer, hottest period of the year* (f. 174).

Tematika kulturore etnografike përfshin elemente që kanë të bëjnë ndër të tjera me pijen dhe ushqimin, banesën, folklorin, ritet dhe zakonet, festat fetare dhe jo fetare etj. Veçanërisht interesant paraqitet leksiku që lidhet me festat fetare, duke pasur parasysh që më parë një pjesë e madhe e këtij leksiku për një kohë të gjatë u kufizua ideologjikisht. Përkatësia trifetare e shqiptarëve e bën këtë fushë të vështirë, por edhe interesante[43].

Po rendisim disa shembuj. *Shëngjergji* (f. 802) përveç si toponimi në kuptimin e dytë jepet me markimin (Old) *St. George* pa shpjegime të tjera. Interesant është shembulli i *nunciates* ose *Zonjës Nunciate* tek katolikët, që nuk shenjohet, por jepet përgjegjësja e ortodoksve *vangjelizmoi* (f. 908) me asteriks dhe me shpjegimin: *annunciation Day, March 25*. Kjo festë fetare kremtohet nga ortodoksët dhe myslimanët tek shqiptarët e Maqedonisë si *bllagovesti*[44], por është e papërfshirë në OEAD. Ndërsa *nevruzi*, që festohet pothuajse në të njëjtën kohë nga myslimanët, jepet i markuar si festë fetare (Relig) me shpjegimin përkatës: *march holiday celebrated by the Bektashi to mark the arrival of spring* (f. 564). *Rrëshajët* jepet me markimin (Relig) dhe me ekuivalenten në anglisht: *Whitsuntide, Pentecost* (f. 749), por është i papërfshirë përdorimi i shqipëruar *pesëdhjetorja.*

Si një ndër festat jo fetare më popullore, megjithë karakterin lokal të saj, është *Dita e Verës* që festohet më 14 mars, festë e cila përfshihet me shpjegimin *March 1 celebration of the arrival of spring* (f. 173). Ëmbël-

---

[42] Çabej, E.: ‚Albanischen Volkskunde' Në: Südost-Forschungen, München 25, 1966, f. 376.

[43] Fiedler, W., f. 32.

[44] Elsie, R.: Handbuch zur albanischen Volkskultur. Mythologie, Religion, Volksglaube, Sitten, Gebräuche und kulturelle Besonderheiten. Harrassowitz, Wiesbaden, 2002, f. 220.

sira tipike që lidhet me këtë festë *ballakumja* jepet me shpjegimin edhe pse jo tërësisht korrekt: *dessert made of eggs, flour, sugar and butter* (f. 41). Për ballakumen duhet të përdoret vetëm miell misri, i cili i jep asaj shijen karakteristike. Për ta përmbyllur me një element tjetër nga tematika kulturore etnografike si *kanuni* (f. 366), vërejmë se ai përfshihet me markimin (Hist) dhe me shpjegimin *the body of unwritten laws and traditional customs that governed former Albanian life*, por pa sqarime lidhur me emërtimin *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, ndërkohë që Lekë jepet si emër mashkulli. Duke qenë në këtë hulli, *virgjnesha e maleve* gjithashtu nuk përfshihet.

Për sa i përket tematikës shoqërore-politike së pari do të rendisim disa shembuj për historizmat, të cilat lidhen me një periudhë kohore të caktuar. Si të tilla mund të klasifikohen sovjetizmat, që sot janë të konotuara ideologjikisht. P.sh. nuk është përfshirë *hero i punës socialiste,* por çuditërisht *hero i heshtur*, që gjithashtu është i konotuar ideologjikisht dhe jepet me shpjegimin: *unsung hero* (f. 311). Interesant në këtë kënd-vështrim është shkurtimi *Hist PK: during the Communist period in Albania* që tërheq vëmendjen pikërisht për konotimin ideologjik, p.sh. tek *kopërativë e shitblerjes* (f. 401).

„Si ‚shprehje' e një bashkësie gjuhësore leksiku përfaqëson kulturën, historinë shpirtërore të saj, shenjon ndryshimet dhe transformimet e vazhdueshme të shoqërisë dhe pasqyron kësisoj zhvillimin e saj. Për këto arsye leksiku është komponentja gjuhësore me dinamikën dhe ‚variacionin' më të theksuar."[45] Për më tepër pas viteve 90 transformimet në shoqërinë shqiptare qenë rrënjësore dhe u pasqyruan më së shumti edhe në gjuhën e shtypit, nga e cila po rendisim shembujt që vijojnë. *Bllokmen/*

[45] Cantarini, S. (botuese): Wortschatz und Wortschätze im Vergleich und Wörterbücher. Methoden, Instrumente und neue Perspektiven. Peter Lang, Frankfurt am Main, 2013, f. 9: „Als ‚Ausdruck' einer Sprachgemeinschaft repräsentiert der Wortschatz deren Kultur und Geistesgeschichte, bildet die ständigen Änderungen und Wandlungen der Gesellschaft ab und spiegelt ihre Entwicklung wieder. Aus diesen Gründen ist der Wortschatz die Sprachkomponente mit dem am stärksten ausgeprägten Dynamik und ‚Variation'."

bllokist (f. 89) jepet e markuar (Hist PK) dhe me shpjegimin: *member of the Comunist elite living in a reserved residential compound*. Nuk janë të përfshirë në OEAD *Partia-shtet* dhe *terapia e shokut*. *Enver* jepet vetëm si emer mashkulli (f. 204), kurse *Enverizmi* nuk është përfshirë. *Piramidë* (f. 679) jepet me dy kuptime konkrete: *1. Pyramid 2. Low concrete or stone pillar marking an international border*, por pa përfshirë shumësin me shpjegimin përkatës.

Në vend të mbylljes

Sipas Al-Mawrid, hartuesit të *English-Arabic Dictionary,* gjithkush që harton një libër, pret një lëvdatë, hartuesit të një fjalori i mjafton t'i shpëtojë qortimit. Përdoruesi e kalon nëpër duar një fjalor, shpesh edhe fjalorin dygjuhësh, pa u menduar kurrsesi për gjithë përsiatjet e stërholluara teorike që u rreshtuan më sipër. Kjo në rastin më të mirë. Përndryshe, kur i nervozuar nuk e gjen informacionin që kërkon, ai i kthehet ballinës, i kushton më shumë vëmendje krejt librit, e mban ndër duar dhe e shfleton

Fjalorin e Newmark-ut lexuesi e mban nëpër duar edhe pasi e ka marrë informacionin e dëshirueshëm. Kureshtja e mëtejshme e përdoruesit ka të bëjë pikërisht me thurimën e informacioneve. Sprova e mësipërme për të shkoklitur disa përthyerje të kësaj thurime në një kontekst konkret socio-kulturor në rastin më të mirë e nxjerr në pah këtë gjë. Përgjithësisht qasja e disahershme këtij fjalori, siç dëshmojnë titujt e disa kumtesave të kësaj konference, bën me dije se frymëmarrja teorike është zgjeruar, po ashtu dhe ndërgjegjësimi për vlerësimin dhe kritikën

Jonida XHYRA-ENTORF, München

SUMMARY: SOCIO-CULTURAL EXTRACT IN "OXFORD ALBANIAN ENGLISH DICTIONARY, (OAED) EDITED BY NEWARK

Summary

Generation of a dictionary is always accompanied with presentation of a culture. Dictionaries give a specific answer and hold a certain function in the educational system and in the general knowledge. The Albanian-English lexigraphy outside Albania and Kosovo, presented for a long time through 'An Historical Albanian English Dictionary' from Stuart E. Mann in 1948, attains without a doubt a great achievement with publishing the Oxford Albanian-English Dictionary from Leonard Newmark almost half a century later. A two language dictionary brings about a two-way lexical codification of two different languages, so that the user can make clear answers with single meaning, but after the information and definition the reasons for selection are always listed. How to delineate the sociocultural dimension of this massive lexicographical enterprise, taking into account the typology, its macrostructure and microstructure, as well as the points of view of both the creator and the recipient in both the primary language and the targeted one?

Bibliografi

Bergenholtz, H.: Lemmaselektion in zweisprachigen Wörterbüchern. Në: Meder, G. & Dörner, A. (botues): Worte, Wörter, Wörterbücher: lexikographische Beiträge zum Essener Linguistischen Kolloquium (= Lexicographica, Series Maior 42). Tübingen, 1992.

Breu, W.: Variantenstreit und Normierung im Albanischen. Në: Matheier, J. K. & Radtke, E.: Standardisierung und Destandardisierung europäischer Nationalsprachen. VarioLingua 1. Peter Lang Verlag, Frankfurt am Main, 1997.

Cantarini, S. (botuese): Wortschatz und Wortschätze im Vergleich und Wörterbücher. Methoden, Instrumente und neue Perspektiven. Peter Lang, Frankfurt am Main, 2013.

Çabej, E.: ‚Albanischen Volkskunde' Në: Südost-Forschungen, München 25, 1966.

Elsie, R.: Handbuch zur albanischen Volkskultur. Mythologie, Religion, Volksglaube, Sitten, Gebräuche und kulturelle Besonderheiten. Harrassowitz, Wiesbaden, 2002.

Haller, D.: dtv-Atlas Ethnologie. München: Deutscher Taschenbuch Verlag, 2005.

Haß-Zumkehr, U.: Deutsche Wörterbücher - Brennpunkt von Sprach- und Kulturgeschichte. De Gruyter, Berlin - New York, 2001.

Henne, H.: Prinzipien einsprachiger Lexikographie. Në: Moser 1976.

Fiedler, W.: Zu Problemen der zweisprachigen albanisch-deutschen Wörterbücher. Në: Kunzmann-Müller, B. & Zielinski, M. (botuese): Sprachwandel und Lexikographie. Beispiele aus slawischen Sprachen, Ungarischen und Albanischen (Berliner slawistische Arbeiten, Band 18). Peter Lang, Frankfurt am Main, 2002. f. 23.

Friedman, V.: Shqipja standarde në Amerikë: Studime shkencore, pedagogjike dhe planifikimi gjuhësor. Në: Akademia e Shkencave (botues). Konferenca shkencore: "Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot". Tiranë, 11-12 nëntor 2012, f. 157.

Frobenius, L.: Ursprung der afrikanischen Kulturen. Berlin, 1898.

Kromann, H.-P. & Ribach, T. & Rosbach, P.: Überlegungen zu Grundfragen der zweisprachigen Lexikographie. Në: Wiegand, H.-E. (botues): Studien zur neuhochdeutschen Lexikographie V (=Germanistische Linguistik 3-6/1984) Hildesheim, New York; 1984.

Kühn, P. 1989: Typologie der Wörterbücher nach Benutzungsmöglichkeiten. In: HSK 5.1.

Metzler Lexikon Sprache: Digitale Bibliothek. Berlin: Verlag J.B. Metzler, 2000 (CD-ROM-Ausgabe).

Nassimi, M. A.: Zweisprachige Lexikographie des Sprachenpaares Deutsch und Dari/Persish. Essen, 2004.

Newmark, L.: Albanian-English Dictionary. Oxford University Press, 1998.

Nord, C.: Fertigkeit Übersetzen. Ein Selbstlernkurs zum Übersetzenlernen und Übersetzenlehren. Alicante: Editorial Club Universitario, 2002.

Polenz, P.: Deutsche Satzsemantik. Grundbegriffe des Zwischen-den-Zeilen-Lesens. Berlin, 1989.

Pörings, R. & Schmitz, U. (botues): Sprache und Sprachwissenschaft. Eine kognitiv orientierte Einführung. Narr, Tübingen, 1999.

Petelez, K.**:** Standardisierung der Lexikoneinträge für ein neues großes deutsch-polnisches und polnisch-deutsches Wörterbuch. Në: Studien zur zweisprachigen Lexikographie mit Deutsch VII. Botuar nga H. E. Wiegand. Hildesheim, New York, 2001.

Reichmann, O.: Historische Bedeutungswörterbücher als Forschungsinstrumente der Kulturgeschichtsschreibung. Në: Hildebrandt & Knoop. 1986.

Rey-Debove, J.: Étude linguistique et sémiotique des dictionnaires français contemporains. The Hague, Mouton, 1971.

Ščerba, L. W.: Versuch einer allgemeinen Theorie der Lexikographie. Në: Wolski, W. (botues): Aspekte der sowjetischen Lexikographie. Übersetzungen, Abstracta, bibliographische Angaben (= Reihe Germanistischer Linguistik, Bd. 43) Tübingen, 1982.

Mann, Stuart E.: An Historical Albanian-English Dictionary. Published for THE BRITISH COUNCIL by LONGMANS, GRREN AND CO, LTD. London, 1948.

Schaeder, B.: Germanistische Lexikographie. (Lexicographica, Series Maior 21) Tübingen, 1987.

Weinrich, U.: Die Wahrheit über die Wörterbücher. Në: Moser 1976.

Wiegand, H.-E.: Ansätze zu einer allgemeinen Theorie der Lexikographie. Në: Die Lexikographie von heute und das Wörterbuch von morgen. 1983.

Wiegand, H.-E.: Überlegungen zu einer Theorie der lexikographischen Sprachbeschreibung. Në: Symposium zur Lexikographie. September 1-2, 1982 at the University of Copenhagen. Ed. by Karl Hyldgaard-Jansen, Arne Zettersten. Hildesheim, 1983.

Wiegand, H.-E.: Zur handlungstheoretischen Grundlegung der Wörterbuchbenutzungsforschung. Në: Kucera, A. & Rey, A. & Wiegand, H. E. & Zgusta, L. (botues): Lexicographica. International Annual for Lexikographie 3/1987.

Wiegand, H.-E.: Über den Nutzen von Wörterbüchern. Në: Von Mogens, D. & Jorgen, O. (botues): Festschrift für Karl Hyldgaard-Jensen. Zum 70. Geburtstag am 3. Februar 1987 (Kopenhagener Beiträge zur Germanistischen Linguistik. Sonderband 3). Kopenhagen, 1987.

Wiegand, H., E.: Was ist eigentlich ein Lemma? Ein Beitrag zur Theorie der lexikographischen Sprachbeschreibung. Në: Germanistische Linguistik, 1-4/82.

Wolski, W.: Das Lemma und die verschiedenen Lemmatypen. Në: Hausmann F.-J.& Reichmann O.& Wiegand H.-E. & Zgusta L. (botues): Wörterbücher, Dictionaries, Dictionnaires. Ein internationales Handbuch zur Lexikographie. Teilband 1. Berlin, New York, 1989.

Mimoza PRIKU, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

FUQIA E FJALËS NË NJË FJALOR. FJALËSI SHQIP NË FJALORIN SHQIP-ANGLISHT TË LEONARD NEWMARK-UT

Hyrje

Është një histori e njohur në botë që tregohet zakonisht nga leksikografët. Një person i cili shkon për të marrë një libër në librari, duke menduar se ka zgjedhur një të tillë me tregime, pa dashje kishte tërhequr një fjalor dhe kur vjen per ta kthyer atë, i shprehet në këtë mënyrë librarit: “Ishte një libër krejt i pazakontë, por historitë ishin jashtëzakonisht të shkrutra”. Po brenda këtij pohimi të pafajshëm, fshihet një e vërtetë e madhe, çdo fjalë që hyn në një fjalor ka historinë e vet, por edhe të atij që e bëri pjesë të kësaj trashëgimie. Kur marrim në dorë një fjalor, çdo lemë mund të lexohet lehtë, por rruga që ka ndjekur ajo deri sa është bërë e konsultueshme nga të gjithë, është goxha e gjatë.

Leksikografia, si pjesë e asaj që po njihet sot si gjuhësi e aplikuar, në traditën e shqipes zë fill jo shumë larg në kohë me librin e parë të shkruar në gjuhën shqipe, rreth 80 vjet nga ai. Ajo nis me një fjalor latinisht-shqip, ”Dictionarum Latino-epiroticum” të Frang Bardhit, botuar më 1635. Vijimësia e kësaj trashëgimie, që në gjenezë është dygjuhëshe, ndiqet edhe nga një përvojë e pasur e përpilimit të fjalorëve dy a shumëgjuhësh, ku një vend me rëndësi zënë, padyshim, ato shqip-anglisht dhe anasjelltas. Pikërisht lidhur me këtë pasuri studiuesi J. Thomai shkruan: “Për t’u shënuar është edhe “harta gjeografike” e leksikografisë shqipe, që nga SHBA e deri në Rusi e Japoni. Hartues fjalorësh të shqipes a me shqipen, përveç trojeve të banuara nga shqiptarët, ka edhe në Gjermani, Holandë, Danimarkë, Suedi, Finlandë, Itali, Bullgari, Greqi, Hungari, Serbi, Maqedoni e

në vende të tjera. Kjo tregon se leksikografia shqipe është zhvilluar jo vetëm brenda, por edhe nga jashtë, prej shqiptarësh e prej të huajsh."[1]

Rreth trashëgimisë së fjalorëve shqip-anglisht dhe anglisht-shqip, objekt i diskutimit të sotëm, është shkruar shumë,[2] prandaj do të sjellim në kujtesë shkurtazi disa prej tyre. Kontaktet e shqipes me anglishten "datojnë nga fillimi i shekullit XIX, fjalorët e parë, që mund të cilësohen fjalorë praktikë të anglishtes, i kemi vetëm në fillim të shekullit XX".[3] Ndër të parët e këtij lloji përmendet ai i hartuar nga D. Cambury "English-Albanian Dictionary (Fjalëtar anglisht-shqip) (Jamestown, New York, 1915) megjithëse përballja e parë mes këtyre dy gjuhëve ishte disa vite më parë.[4] Fjalori i Kambury-t "është një fjalor xhepi prej 96 faqesh me rreth 6500-7000 fjalë. Në pjesën shqipe ndjehet ndikimi i të folmeve të Korçës (Bilisht-Vërnik)."[5] Një tjetër fjalor është ai i K. Çekrezit "Fjalor inglisht-shqip (Boston, 1923) me rreth 15000 fjalë, fjalori i N. Drizarit[6]. Stuart Mann publikoi në Londër "An Historical Albanian-English- Dictionary" (Published for the British Cuncil by Longmans, London, 1948), konsideruar si një fjalor *thesaurus*. Padyshim që kjo traditë është pasuruar e përsosur gjatë viteve me mjaft fjalorë të botuar brenda dhe jashtë Shqipërisë. Sot marrëdhëniet mes leksikografisë dygjuhëshe dhe fjalorëve njëgjuhësh të shqipes

---

[1] J. Thomai, Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë, në *Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë*. Konferencë shkencore (Tiranë 3 dhjetor 20004), Tiranë 2005, f. 16.

[2] Shih: Xh. Lloshi. Fjalorët shqip-anglisht e anglisht-shqip dhe Fjalori anglisht-shqip i Stuart Manit, SF, 1970, 4, f. 119-127. Sh. Gërmizaj, Rreth fjalorëve anglisht-shqip, *Dardania Sacra* 1, Prishtinë, 1999. Sh. Gërmizaj, Rreth fjalorëve shqip – anglisht, *Flilogji* 7, Prishtinë, 1999. Sh. Gërmizaj, Fjalorët anglisht-shqip e shqip-anlisht, arritje dhe sfida, në *Leksikografia shqipe –trashëgimi dhe perspektivë*. Konferencë shkencore (Tiranë 3 dhjetor 2004) , Tiranë 2005, f. 269-281.

[3] Sh. Gërmizaj, Fjalorët anglisht-shqip e shqip-anlisht, arritje dhe sfida në *Leksikografia shqipe –trashëgimi dhe perspektivë*. Konferencë shkencore (2004) , Tiranë 2005, 272.

[4] Hobhouse, J.C.; *A Journey through Albania and other Provinces of Turkey in Europe and Asia, to Constantinople, during the years 1809 and 1810*, London 1813.

[5] Xh. Lloshi, Fjalorët shqip-anglisht e anglisht-shqip dhe Fjalori anglisht-shqip i Stuart Manit, SF, 1970, 4, f. 120.

[6] N. Drizari, *Spoken and written albanian. A practical handbook,* New York, 1947.

janë të frytshme dhe komplekse. Në të shkuarën fjalorët dygjuhësh shërbënin shpesh si një nxitje për të studiuar fjalët e shqipes.[7] Një vend me rëndësi në këtë trashëgimi leksikografike zë pa dyshim Fjalori *Oxford Albanian English Dictionary* (Ed. by L. Newmark (1998), Tiranë: Albin, 2000) i Newmark-ut, emri i të cilit është mjaft i njohur në ambientet akademike amerikane, sidomos për disa kontribute të këtij studiuesi në albanologji. L. Newmark filloi mësimin e shqipes dhe arriti të mbrojë tezën e doktoraturës me temën "Structural Grammar of Albanian" pranë Universitetit të Indianës (1957). Ai ka lënë dorëshkrim "Spoken Albania" (1954).[8] Në bashkëpunim ka botuar "Readings in Albanian" (ba. Ph. Hubbard, P. Prifti, Washington, 1979); "Spoken Albanian" (ba. I. Haznedari, Ph. Hubbard, P. Prifti; Ithataca, New York, 1980); "Standard Albanian" (ba. Ph. Hubbard, P. Prifti; Standford, California, 1982). Kontributi në albanologji i Newmark-ut lidhet ngushtë edhe me mësimin e shqipes në Universitetin e Kalifornisë. R. Ismajli duke diskutuar për këtë pikë të fuqishme të studimeve albanistike në Amerikë shënon: "në fushën e mësimdhënies e të fjalorëve po ashtu ka pasur rezultate: nga hartimi i Gramatikës së referimit e deri te Fjalori i tipit Oxford të L. Neumark-ut."[9]

Në Amerikë, Universiteti i Kalifornisë për disa vite me radhë u bë qendër e rëndësishme albanologjike. Siç na informon P. R. Prifti: "Veprimtaria në fushën e gjuhës shqipe në San Diego u përqendrua kryesisht në një projekt studimesh për gjuhën shqipe. Projekti vazhdoi për tre vjet (1976-1979) dhe përfundoi me përpilimin e tri veprave për anglishtfolësit që duan të mësojnë të flasin shqip dhe interesohen të thellohen sidomos në morfologjinë e shqipes. Si pasojë e kësaj veprimtarie, Universiteti i Kalifornisë në San-Diego arriti të njihej si një qendër mjaft e rëndësishme e lëvrimit të gjuhës shqipe në Amerikë".[10]

---

[7] Xh. Lloshi, Compiling and Editing Bilingual Dictionaries in Albania, www.euralex.org/elx proceedigs/ Euralex1., 1 Nov, 2011, pg. 481.

[8] Shih: P. R. Prifti, Mësimi i gjuhës shqipe në Amerikë (II), *Gjuha jonë*, 1998, 1-4, f. 126.

[9] R. Ismajli, Studimet albanistike në SHBA, në E. P. Hamp, *Studime krahasuese për shqipen*, Prishtinë, 2007, f. 6.

[10] P. R. Prifti, "Mësimi i gjuhës shqipe në Amerikë (II), *Gjuha jonë,* 1998, 1-4, f. 119.

Një historik i shkurtër rreth fjalorit të Nermark-ut

Newmark e filloi punën për hartimin e Fjalorit të tij që në vitin 1985 dhe e kurorëzoi atë në vitin 1988. *Oxford Albanian English Dictionary* (The most comprehensive dictionary of twentieth-century Albanian. Icludes standard and non-standard Albanian, 978 fq.) me 75 000 hyrje na vjen si një botim i Oxfordit, fakt me shumë rëndësi për shqipen. Ky fjalor u botua në Shqipëri (Tiranë: Albin, 2000). Në hyrje albanologu amerikan falënderon studiues të shqipes, brenda dhe jashtë Shqipërisë, të cilët e ndihmuan me sugjerimet dhe prurjet konkrete që më vonë u bënë pjesë e këtij fjalori. "Ky fjalor monumental shqip-anglisht vjen tek ne si produkt i njëmbëdhjetë viteve kërkimesh intensive, dhe si një referencë e katërt e L. Newmark-ut mbi gjuhën",[11] e fillon kështu recensionin e tij për këtë fjalor C. Rubino, botuar revistën "Language".

Në vitin 1999 L. Newmark me një prej bashkëpunëtorëve të tij të ngushtë të Fjalorit, Vladimir Dervishin, botuan një tjetër kontribut, "Albanian handbook: with English and Albanian glossaries" (Kensington, MD, Dunwoody Press, 1999). *Oxford Albanian English Dictionary* ndër vite ka njohur disa ribotime edhe të përmirësuara. Ajo që është më e rëndësishme është se ky Fjalor pasuroi fondin leksikografisë shqipe duke i dhënë edhe në vend me rëndësi shqipes si gjuhë të parë. Në vitin 2005 ky Fjalor na vjen në formën elektronike dhe i mundshëm për t'u shfrytëzuar më gjerësisht: Online Albanian Dictionary: *Albanian - English Dictionary* by Leonard Newmark (© 2005, SEELRC) dhe mund të konsultohet në faqen http:// www.seelrc.org:8080/albdict.

Korpusi shqip i këtij Fjalori

Nëse marrim në analizë korpusin shqip të Fjalorit të Newmak-ut, gjëja e parë që vihet re janë prurjet e shumta leksikore e tij. Megjithëse autori është mbështetur në fjalorët normativë të shqipes (Fjalor i gjuhës

[11] C. Rubino, Oxford Albanian-English dictionary ed. by Leonard Newmark, *Language*, Vol. 72, Nr. 2, June, 2000, pg. 485-486.

së sotme shqipe (1980), Fjalori i shqipes së sotme" (1984), por jo vetëm, të bie në sy fakti, i paralajmëruar edhe nga vetë Newmark, se fjalësi i tij është shumë më i gjerë. Kjo ka të bëjë edhe me qëllimin parësor të hartimit të këtij fjalori. Leksikografi amerikan mëton të plotësojë nevojat e përdoruesve të tij jo vetëm në standardin e shqipes, por me disa varietete të saj. Qëllimi i autorit del qartë në hyrje ku Newmark shkruan: "In order to achieve its goal of helping foreing readers in their attempts to understand Albanian documents- literary, historical, political and linguistic- that may have been written in earlier as well as later parts of twentieth century and may have employed varieties of the language that would not be acceptable as standard today..." (Preface).

Larmia e këtij fjalësi është vënë re që kur u botua për herë të parë ky Fjalor. H. Shehu në një recension të botuar në *Studime filologjike* shkruan: "të bie në sy kujdesi i autorit për të gjurmuar e qëmtuar njësi leksikore e frazeologjike edhe nga burime të tjera, edhe nga botime dhe subjekte të diasporës shqiptare, ende të panjohura në përdorim të përgjithshëm, çka do të thotë se Fjalori sjell vlera pozitive potenciale për leksikun e gjuhës së sotme letrare shqipe."[12]

Duke ndjekur traditën e leksikografisë amerikane, korpusi shqip i Fjalorit nuk është konsideruar i ngushtë, por gjithëpërfshirës. Modeli amerikan vihet re edhe në mënyrën e organizimit të këtij fjalësi. Ndryshe nga tradita shqiptare, lemat segmentohen sipas njësive morfematike të tyre.

Korpusi shqip i Fjalorit do të vështrohet në tri pikëpamje: pjesën dërrmuese do ta zërë larmia e lemave gege; do të ndalemi në disa elemente me vlerë etnolinguistike dhe së fundi, në disa variacione leksikore.

Ky Fjalor ka përfshirë mjaft leksema të domosdoshme për të kuptuar një pjesë të mirë të pasurisë letrare të Veriut. Nuk është fjala thjesht për variantet, kryesisht me vlerë fonetike, si: *andrr/ëndërr, çkëpus/ shkëpus, çkëmb/shkëmb, baçe/bahçe* etj.,[13] por për mjaft fjalë dia-

[12] H. Shehu, L. Njumark, fjalor shqip-anglisht (1998), SF 1999, 1-2, f. 188.

[13] â~ë: *andërr/ëndërr; i bashë/ i bëshëm, dorëdhânë~dorëdhënë, dhâm~dhëmb* etj.
a~o: *tapall~topall* etj.
e~i: *levandë/livandë* etj.

lektore, edhe të brumit gegë, të cilat realizojnë pjesërisht objektivin e Fjalorit të Newmark-ut.

Kështu nëse lexojmë Koliqin, Camajn është e pamundur që të mos identifikohen dy fjalë të cilat dendur përshkojnë këtë krijimtari. U referohem fjalëve: *i përfrigueshëm* dhe *i përkënaqshëm,* të cilat nuk mungojnë tek Fjalori i Newmark-ut. Si lemë Newmark identifikon edhe ndajfoljen *përkënaqshëm,* po pa foljen gjegjëse *përkënaq,* mjaft e pranishme në krijimtarinë letrare gege. Kujtojmë nga Camaj: *"…**përkënaqeshin** të shtriheshin ma fëmijë se fëmijët"* ("Rrugnaja në mars", *Vepra 4,* Tiranë, 1996, f.168). Një lexues i huaj e ka shumë të vështirë t'i kuptojë këto fjalë pa iu drejtuar një fjalori. Një tjetër zbrazdësi po me ndajshtesën **për-** krijon në një farë mënyre edhe mungesa e foljes *përkumtoj*, e cila përdoret nga Fishta, por jo vetëm. Krahas foljeve: *përfal, përhimnon, përmjalt* etj., të pranishme në fjalorët e shqipes standarde (Shih: *Fjalor i gjuhës shqipe*, 2006), qëndrojnë edhe të tjera, si: *përavullohet, përbart, përflakon, përlag, përngjall* etj., të cilat nuk janë të pranishme në veprën leksikografike të përmendur më lart, po që qëndrojnë mirë në Fjalorin e Newmark-ut. Klasa e foljeve është ndër më të larmishmet në këtë Fjalor, si në numër, ashtu edhe në ngjyrime fonetike a kuptimore. Të bien në sy folje karakteristike gege, si: *idhtoj, veshk (*për *fishk), eraton.* Këtë folje të fundit e ka gjallëruar shumë E. Koliqi e M. Camaj. Në Fjalorin e shqipes standarde ka hyrë në formën **erët/ój** *kal.,* **-óva, -úar** mbush me erë;/ kundërmoj;/ *v. III jokal.* erëmon; kundërmon. • **erëtím,-i** *m.* veprimi sipas foljes. Për ilustrim veçojmë nga Camaj:*"…atje ku mishi i njomë në hell **eraton** qumësht, dru e voj ullini dhe hi krype…"* (Drandja, f. 59). Newmark ka veçuar si zë të veçantë emrin prejfoljor *heshtim*, por nuk ka zënë vend folja gjegjëse *heshto,*

---

ue ~ua: *duer ~duar etj.n~r: butësinë/butësirë; djathna~djathëra, vner~vrer* etj.
o~u: *kopon~kupon* etj.
l~ll: *ballsam~balsam* etj.
l~j: balgë~bajgë etj.
t~d: *gatishull~gadishull* etj.
p~b: *llampadar ~llambadar* etj.
f~th: *fëllëzë/thëllëzë* etj.

të cilën e gjejmë si në krijimtarinë e Camajt, por dhe të autorëve të tjerë, p.sh.: *"…Secili pjesëmarrës në këto lëvizje luftonte në ndërgjgejgje të vet nëse ato përjetime magjike ishin të lejueme; së fundi, mbasi ky ushtrim ishte caktue zyrtarisht,* ***heshtonte…"*** (*Karpa*, Romë, 1987, 83). Këtë folje S. Mann e pat përfshirë në fjalorin e tij si zë të veçantë (1948:158).[14]

Nëse e rikthejmë vëmendjen tek disa prej lemave të gegërishtes, mund të themi se janë pasqyruar në këtë Fjalor edhe leksema që lidhen me një mënyrë të caktuar jetese a veshjeje, si: *arkapi, degërmi* etj. Fjala e parë *arkapi* është një "deriçkë që lehet midis shpijash ose ndërmjet oborreve për të hy e dalë në mes të njani tjetrit komshitë".[15] Megjithëse turqizëm, kjo fjalë ka hyrë si në mënyrën karakteristike të ndërtimit të shtëpive në Shkodër, ashtu edhe në letërsinë e Veriut. Kujtojmë këtu një prej tregimeve të Migjenit, "Të çelen arkapijat", ku zbërthimi i gjithë mesazhit që përcjell autorit lidhet pikërisht me këtë fjalë-kyç, *arkapi*. Edhe në Fjalorin e Bashkimit është shënuar si turqizëm "derë e vogël" (it. porticina).

Leksema tjetër *degermi,*[16] është interesante dhe del që tek Fjalori i Kristoforidhit dhe më pas tek ai i Bashkimit. Ajo si pjesë veshjeje ka marrë në letërsi edhe kuptime të dyta të figurshme. Kujtojmë Koliqin: *"princesha e mërtisun në* ***degërmi*** *andrre…"* ("Tregtar flamujsh", cit. sipas M. Elezit, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007: 340).

Një tjetër fjalë që rregjistrohet edhe nga Newmark është *faculetë,* e cila në gegërisht përdoret për "shami". Nga përdorimi i saj në letërsi veçojmë: "*Një vajzuke …me fytyrë flakoshe…mbështjellë me një* ***faculetë*** *të ngjyrshme*…" (E. Koliqi, "Pasqyrta e Narçizit", cit. sipas M., Elezit, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007: 412).

Disa elemente me vlerë etnolinguistike

Fjalori është i pasur edhe me disa fjalë me vlerë etnolinguistike, si

[14] Newmark shënon: *hesht, heshtak, heshtar, heshtas, heshtazi, heshtë, heshtëmbajtës, heshtësirë, heshti, heshtje, heshtjerëndë, heshtor, heshtshëm, heshtur*.

[15] T. Dizdari, *Fjalori orientalizmave në gjuhën shqipe,* Tiranë, 2005. f. 36.

[16] *Fjaluer i Rii i Shcypes. Perbâam prei Shocniiet t'Bashkimit* (1908), Rilindja, Prishtinë, 1978, "Velo quadrato di uso delle donne albanese di Scutari", f. 81.

p.sh. *dhanti* e cila është larg fonetikisht me standardin **dhurëtí,-a** *f. sh.* **-(të)** 1. dhuratë; *etnogr.* tërësi sendesh të çmuara, para etj. që i çoheshin nuses a dhëndrit si peshqesh në dasmë. 2. dhurëti. Kjo largësi fonetike e vështirëson rrokjen e kuptimit të saj. Lemat me vlerë etnolinguistike përfshijnë mënyrën e organizimit të familjes e më gjerë, si: **bajrak,** kuptimin me vlerë etnolinguistike ajo e fiton në këtë Fjalor në kuptimin e katërt **(**red banner adorned with flowers and tassels and carried by the wedding party on their way to deliver the bride to the groom); **bark** në një prej kuptimeve të saj Newmark shënon: ” litter, brood; the offspring of a man and woman taken as a collective whole; members of a lineal kin group”. Në këtë grup hynë: *flamur, gjak, pleqësi, urtar, urti, zjarr, zjarrni,* etj. Ngjarjet e rëndësishme të jetës, ritet e emërtimet e tyre kanë zënë vend gjerësisht në këtë Falori, si: *dasmor, dasmoreshë, dollibash, krushk, krushkamash, krushkaparë, krushkohet, mbles, mblesëri, mblesërim, mblesëtar, shkes, shkues, shkuesi, pajë, pasi, parëti, nishan, thirrës, njehatore, vaj, vajtim, vajtore/ vajtojcë* etj. Të pasura janë edhe lemat që tregojnë emërtimet dhe lidhjet farefisnore, si: *motërmë, motërmëmë, motërsi, motërtatë, tatëzot, ndrikull, nun, nunë, nunëri, vëllam (*male friend who pledges fellowship to another (by drinking a drop of the other's blood): blood brother), *vëllazëri* etj. Nuk duhen lënë pa përmendur zakone e tradita që lidhen me *besën, mikpritjen, gjakun* dhe terminolgjinë që i shoqërojnë: *besë, besatar, besëkeq; mik, mikprerë, mikpritje, shkelës;gjakës, gjakësi, gjakfalur, gjakmarrje* etj.

Variacione leksikore

Fjalori është i pasur me terma, të cilët dalin edhe me variante, si: *ekujnatë (*si term i përdorur edhe tek *Fjaluer Latin-Shqyp*, Scutari, 1925) përveç *ekujnoks; ishullnajë* (për arkipelag); *i paskajuem* (i pashquar), *erbarozë* (barbarozë); *bashkzânor*e-*bashkzantore* (për bashkëtingëllore).

Variacione kryesisht leksikore paraqesin edhe emrat: *bimtar* dhe *botanist*; *buritar* dhe *borizan*; *eliptik* dhe *i përhanun fijan* dhe *famull*; *letërndarës* dhe *postier; fajdexhi* dhe *fajdedhënës* (e rregjistoi edhe S.

Man); *hekurudhë* dhe *ferratë* (këtë të fundit e përdor Gj. Fishta); *luspim* dhe *esfolim; radhore* dhe *listë; tërnagop* dhe *kazmë; vrângull* dhe *i vrenjtur; korrtar* dhe *kostar; i dielluar* dhe *i diellshëm; i gazshëm* dhe *i gëzueshëm; kryeqytetar* dhe *kryeqytetas; letrari* dhe *letërsi; kujunxhi/kujxhi* dhe *argjendar* etj. Disa krijojnë edhe varg. Kështu vetëm për fjalën *njerk* këto variante: *vitkur/ vitruk/ vitërk/.*

Po t'i vërejmë me kujdes këto fjalë, mund të shohim se disa fjalë kanë edhe dallime kuptimore. Newmark ka shënuar me dy variante emrin *fërkojcë/fërkojëse* me kuptimin e një profesioni, grua që di të bëjë masazhe, shënuar si e tillë edhe në Fjalorin e Bashkimit: "Donna che cura mediante frizione".[17] Ndërsa Fjalori edhe ai 2006 këtë fjalë e lidh me diçka thetër: fërkójës/e,-ja *f. sh.* -e(t) copë lecke, shuk teli etj. për të fërkuar diçka.

Nisur edhe nga sintaksa gjenerative Newmark veçon njësitë frazeologjike me strukturën e një sintagme parafjalore të paraprira nga parafjala *për*, si: *për t'i pirë dollinë, për t'u përpalsur pas murit, për të lëpirë me gjuhë, për t'i prerë kokën* etj.

Leksema që u përfshinë në shqipen standarde në fjalorët e mëvonshëm

Në Fjalorin e Newmark-ut mund të identifikohen lehtësisht fjalët jonormative, por disa prej tyre janë përfshirë në fjalorët e mëvonshëm të shqipes standarde. Kështu Newmark në Fjalorin e tij e pat shënuar me yllz fjalën ***artar*** si fjalë që ai nuk e kishte ndeshur në fjalorët normativë me të cilët kishte marrë për bazë. Kjo fjalë gjendet edhe tek fjalori i tij i viti 1948[18] dhe gjeti vend edhe në fjalorët e mëvonshëm. Në *Fjalorin e gjuhës shqipe* të vitit 2006 është përfshirë me kuptimin "argjendar" (2006:52). Një tjetër lemë interesante është **çmendore,* e cila del si sinonime me fjalën *çmendinë* në Fjalorin e vitit 2006. Fjalësi me **për**- është pasuruar me lemën *përfolje.* Po kështu Fjalori i 2006 ka pasqyruar e zgjeruar termat

[17] Vep. e cit., f. 108.

[18] S. Mann, Published for the British Council by Longmans, London, 1948, pg. 12.

fetarë, si: *fetarisht,iqindi,*[19] *zeqat* etj. Emra e ndajfolje nga gegërishtja si: *freskinë,* [20] *faqas.* Kanë hyrë edhe fjalët fjalët: *finalist,* folja *ndërkall* me gjithë çerdhen e vet leksikore: **ndërkáll** *kal.,* **-a, -ur** ndërfut. • **ndërkallém** *vetv.* ndërfutem. • **ndërkállj/e,-a** *f. sh.* **-e(t)** ndërfutje. • **ndërkállur (i, e)** *mb.* i ndërfutur.

Përveç lemave të mësipërme, të përfshira në fjalorët e mëvonshëm normativë të shqipes, në Fjalorin e albanologut amerikan, ka edhe të tjera që mjaft mirë mund të ishin pjesë e tyre. Fjalë, si: *përballje* a ndonjë tjetër, që ndonëse nuk kanë hyrë në fjalorin e shqipes standarde, janë mjaft të përdorura në ligjërimin e përditshëm.

Newmark ka veçuar edhe leksema të cilat kanë mbetur të ngurtësuar në disa frazelogji, siç është rasti i i leksemës *din* në sintagmën e ngurtësuar: *s'ka din e iman*

Pavarësisht anëve pozitive, sa i takon vjeljeve leksikore, Newmak-u në Fjalorin e tij ka përfshirë edhe fjalë me burim sllav të cilat nuk para përdoren shumë, si: *kukavicë, ulicë* etj.

Përmbyllje

Leksikografi e ditëve të sotme ka në fakt si parim përfshirjen e sa më shumë elemeteve leksikore, si: fjalë, shprehje, kuptime të reja, brenda fjalësit të fjalorit të një gjuhe, natyrisht duke përshirë edhe multimedian si pjesë tashmë integrale e saj. Këtë gjë është përpjekur të arrijë edhe Leonard Newmark me Fjalorin e tij. Përballë një gjuhe të rëndësishme ndërkombëtare siç është anglishtja, ai vendosi gjithë potencialin gjuhësor të shqipes.

Çdo punë e përfunduar, sado e mirë, ka hapësirë edhe për kritika. Po a zbehin ato gjithë punën e bërë? Në asnjë mënyrë. Pavarësisht kufizimeve që mund të ketë në këtë rast Fjalori i Newmark-ut, padyshim, ai zë një vend me rëndësi në pasurisë leksikografike shqipe. Ai shënon modelin e një korpusi dinamik për shqipen.

---

[19] **iqindí,-a** *f.* koha para mbrëmjes; ushqimi që hahet para darkës;/ *fet*. falja e myslimanëve në këtë kohë, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 416.

[20] **freskín/ë,-a** *f. sh.* **-a(t)** vend a mjedis i freskët: *u futëm në një freskinë.*

Mimoza PRIKU, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

THE POWE OF THE WORD IN A DICTIONNARY. ALBANAIAN LEXICON IN THE LEONARD NEWMARK’S ALBANIAN-ENGLISH DICTIONARY

Summary

The object of study in this paper is made Albanian Vocabulary of Oxford Albanian - English Dictionary of the Albanologist Leonard Newmark, as an important part of the tradition of studies in Albanology, created and crystallized in America. Of course in laying these foundations a group of well-known Albanian intellectuals have played an important role, who, with a lot of difficulties, began to publish several periodicals dealing with various problems with albanological character as: "Kombi", "Dielli", "Albania" magazine. This began and awoke the interest of the Albanian American researchers and Albanology, interest which ended with serious studies with the hard work of linguists as: E. P. Hamp, L. Newmark, G. L. Bevington, V. Friedman, J. Brian etc.

In this paper we will try to analyze some of the values and innovations in *Oxford Albanian-English Dictionary* compiled by Leonard Newmark, who had a prosperous land and tradition of bilingual dictionaries. Albanian lexicography actually begins with a Latin-English bilingual dictionary, "Dictionarum latino- epiroticum“ prepared by Frang Bardhi and published in 1635. To continue with F.M. Da Lecce "Dizionario italiano-albanese" (1702) and a number of Albanian-Italian or Albanian-Latin dictionaries. Later, in Athens K. Kristoforidhi published a "Dictionary of the Albanian language" in 1904, while members of the Union Society compiled another bilingual dictionary (1908). Among the first English-English dictionaries is "Albanian English- dictionary" compiled by Dennis J. Kambury (Boston, 1918), followed by another Albanian, Costa Çekrezi, who in 1923 published another English-Albanian dictionary.

Despite this lexicographical legacy, Leonard Newmark in one hand, has managed to use and rely on it, but, on the other hand, knew how to bring enough innovation, as well as vocabulary and the organization. Drafter of this vocabulary is trying to complete the needs of its users not only in the standard of the Albanian language, but some of its varieties, following the American tradition of compiling dictionaries. He broke the Albanian tradition in the organization of this vocabulary, which is based on the word morfematic division. After an analysis of the vocabulary, which should be evaluated especially for the renewal of many words in Albanian which remained forgotten, we believe that the drafting of a dictionary like this, with a new model, is among the first attempts a dictionary thesaurus of Albanian language.

Literaturë:

Akademia e Shkencave të Shqipërisë: *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe* (grup autorësh), Tiranë, 1980.

Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Fjalor i gjuhës shqipe* (grup autorësh), Tiranë, 2006.

DIZDARI, T., *Fjalori orientalizmave në gjuhën shqipe,* Tiranë, 2005. f. 36.

Fjaluer i Rii i Shcypes. Perbâam prei Shocniiet t'Bashkimit (1908), Rilindja, Prishtinë, 1978.

GAZULLI, N.: *Fjaroth i ri. Fjalë të rralla të përdoruna në veri të Shqipnis*, (botim anastatik), Tiranë, 2010.

GËRMIZAJ, Sh., Rreth fjalorëve anglisht-shqip, *Dardania Sacra* 1, Prishtinë, 1999.

GËRMIZAJ, Sh., Rreth fjalorëve shqip - anglisht, *Flilogji* 7, Prishtinë, 1999.

HAMP, E. P., *Studime krahasuese për shqipen*, Prishtinë, 2007.

HYSAJ, E., *Formimi i emrave me ndajshtesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004.

NEWMARK, L., *Oxford Albanian English Dictionary*/ Ed. by L. Newmark. Tiranë: Albin, 2000.

Leksikografia shqipe –trashëgimi dhe perspektivë. Konferencë shkencore (Tiranë 3 dhjetor 20004), Tiranë 2005.

LLOSHI, Xh., Fjalorët shqip-anglisht e anglisht-shqip dhe Fjalori anglisht-shqip i Stuart Manit, SF, 1970, 4, f. 119-127.

LLOSHI, Xh., Compiling and Editing Bilingual Dictionaries in Albania, www.euralex.org/elx proceedigs/ Euralex1., 1 Nov, 2011.

PRIFTI, R., Peter, Mësimi i gjuhës shqipe në Amerikë (II), *Gjuha jonë*, 1998.

SHEHU, H., L. Njumark, Fjalor shqip-anglisht (1998), SF 1999, 1-2, f. 187-197.

SHEHU, H., A duhet një fjalor shqip-gjuhë e huaj të përfshijë dialektalizma dhe krahinorizma fonetikë, SF, 1999, 3-4.

THOMAI, J.: *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë, 2001.

Bahri BECI, Paris

JANET BYRON PËR HISTORINË E FORMIMIT TË SHQIPES STANDARDE

Në vitin 1976 gjuhëtarja amerikane Janet Byron ka botuar librin Përzgjedhje midis alternativash në standardizimin e gjuhës. Rasti i shqipes (Selection Among Alternates in Language Standardization: The Case of Albanian)[1].



Libri është përgatitur fillimisht si tezë doktorate nën drejtimin e sociolinguistit të shquar amerikan Xhoshua Fishmen (Joshua Fishman) dhe në janar të vitit 1973 është mbrojtur në universitetin e Pensilvanisë (ShBA) nën titullin "Përzgjedhja dhe vlerësimi i alternantëve në standardizimin e gjuhës shqipe" (Selection and evaluation of alternates in Albanian language standardization).

Më 1979 dhe 1985 ka botuar dhe dy artikuj të tjerë për këtë problematikë "Planifikimi gjuhësor në

[1] J. Byron, *Selection Among Alternates in Language Standardization: The Case of Albanian.* Hagë: Mouton, 1976. Në vitin 2010 libri është ribotuar. Përkthimi shqip: J. Byron, *Përzgjedhje midis alternativash në standardizimin e gjuhës dhe shkrime të tjera*, Tiranë, 2012, f. 1-192.

Shqipëri dhe te shqipfolësit në Jugosllavi" ("Language planning in Albania and in Albanian-speaking Yugoslavia")[2] dhe "Një vëzhgim për arritjet e planifikimit gjuhësor te shqiptarët e Jugosllavisë" (An overvieu of language planning achivements among the Albanian of Yugoslavia)[3].

Të gjitha këto më 2012 janë përkthyer dhe botuar shqip në një libër me titullin "Përzgjedhje midis alternativash në standardizimin e gjuhës dhe Shkrime të tjera"[4].

Problemet e trajtuara

Vepra "Përzgjedhje midis alternativash në standardizimin e gjuhës. Rasti i shqipes" ka 192 faqe dhe nëntë kapituj. Në kapitullin e parë të emërtuar "Hyrje" parashtrohet objekt i studimit. Shprehimisht është shkruar se objekt i studimit do të jetë "hulumtimi rreth llojeve të *për-zgjedhjeve* dhe *vlerësimeve* që janë përdorur në procesin e standardizimit të gjuhës shqipe"[5].

Studimi përqendrohet në periudhën e pasluftës, sepse, sipas saj, kjo është "periudha në të cilën ka ndodhur *standardizimi sistematik* i shqipes, i mbështetur nga qeveria" (14)**.**

Në kapitullin e dytë shqyrtohen teoritë për *vlerësimin gjuhësor***,** në mënyrë të veçantë, roli i faktorëve të tillë si *efektshmëria* a *efiçienca, racionaliteti* dhe *përbashkësia* në procesin e vlerësimit të formave gjuhësore**.**

---

[2] J. Byron, *Language planning in Albania and in Albanian-speaking Yugoslavia*, Word, Journal of the International Linguistic Association, Mouton Publishers, vëll. 30. nr,1-2, 1979, prill-gusht, f. 15-4.

[3] J. Byron, *An overvieu of language planning achivements among the Albanian of Yugoslavia*, International Journal of the Sociology of language, nr. 52, 1985, Mouton Publishers, f. 59-92.

[4] J. Byron, *Përzgjedhje midis alternativash në standardizimin e gjuhës dhe Shkrime të tjera*, Tiranë, 2012.

[5] J. Byron, *Përzgjedhje midis alternativash në standardizimin e gjuhës dhe shkrime të tjera*, Tiranë, 2012, 13. Në vijim citimet nga ky libër do të jepet në kllapa numri i faqes së tij.

Në kapitullin e tretë me titull "Sfondi historik i shqipërisë dhe i shqiptarëve" përshkruhen shkurtë historia e Shqipërisë dhe veçoritë gjuhësore dhe kulturore të popullit shqiptar.

Në kapitullin e katër të emërtuar "Përshkrimi i dialekteve të shqipes dhe përpjekjet e paraluftës për të zgjidhur çështjet gjuhësore" parashtrohen marrëdhënien midis dialekteve të folura dhe prirjet kryesore që kanë pasur parasysh planifikuesit gjuhësorë gjatë përpunimit të shqipes standarde.

Në kapitulli V trajtohet baza dialektore e shqipes standarde dhe qëndrimi zyrtar ndaj dialekteve. Kjo e dyta për autoren e studimit "ka një peshë të konsiderueshme në standardizimin e gjuhës" (15).

Kapitujt VI, VII dhe VIII merren me probleme të standardizimit të shqipes, përkatësisht në fushën e fonetikës të morfologjisë dhe leksikut.

Në kapitullin IX sjell një përmbledhje të vlerësimeve që janë në themel të përzgjedhjes së njësive të standardit, bën një krahasim të përgjithshëm midis tyre dhe hipotezave teorike lidhur me përzgjedhjen e normave të standardit dhe, më në fund, sugjeron aspekte të këtyre hipotezave që kërkojnë rishikim**.**

Në dy artikuj e tjerë për këtë problematikë, "Planifikimi gjuhësor në Shqipëri dhe te shqipfolësit në Jugosllavi" dhe "Një vëzhgim për arritjet e planifikimit gjuhësor te shqiptarët e Jugosllavisë"[6] trajtohen arritjet e planifikimit gjuhësor në Shqipëri dhe në mënyrë më të veçantë te shqiptarët e Jugosllavisë.

Baza teorike

Për hartimin e këtij studimi Xh. Bajron është mbështetur në arritjet

[6] J. Byron, *Planifikimi gjuhësor në Shqipëri dhe te shqipfolësit në Jugosllavi,* në librin "Përzgjedhje midis alternativash në standardizimin e gjuhës dhe shkrime të tjera", Tiranë, 2012, f. 1- 192; *Një vëzhgim për arritjet e planifikimit gjuhësor te shqiptarët e Jugosllavis,* në librin *"*Përzgjedhje midis alternativash në standardizimin e gjuhës dhe shkrime të tjera", Tiranë, 2012, f. 231-274.

më te fundit të sociolonguistikës amerikane dhe konkretisht në pikëpamjet e parashtruara në vepra të tilla si: “Standardizimi gjuhësor” (Punya Sloka Ray, 1963), "Gjuhësia dhe planifikimi gjuhësor" (Einar Haugen, 1966), “Konflikti dhe planifikimi gjuhësor: rasti i gjuhës moderne norvegjeze” (Einar Haugen, 1966), “Hyrje në teorinë e planifikimit gjuhësor” (Valter Tauli, 1968), "Disa aspekte të përgjithshme të problemeve dhe të politikës ‘gjuhësore’ në shoqëritë në zhvillim" (Jiri V. Neustupny, 1968).

Edhe pse mendimet e këtyre studiuesve rreth thelbit të *standardizimit* ose *planifikimit gjuhësor* përputhen, Bajron mendon se procesi, në tërësinë e tij, nuk është hulumtuar plotësisht dhe se rreth tij dihet pak.

Lidhja e teorive të vlerësimit me çështjet e posaçme të trajtuara në punimin e saj, shkruan ajo, ka qenë e vështirë sepse shumë aspekte të hipotezave nuk lidhen drejtpërdrejt ose lidhen vetëm tërthorazi me çështjet e trajtuara (17).

Pra, autorja ishte e vetëdijshme se teoritë e *vlerësimit të gjuhës* nuk përputheshin me njëra tjetrën, se ishin të paplota ose se shpërfillnin shumë aspekte të teorive të planifikimit gjuhësor.

Në punimin e saj, analizohen llojet e përzgjedhjeve dhe të vlerësimeve që janë përdorur në procesin e standardizimit të shqipes, pra, kryesisht procesi i normëzimit (prescription) të shqipes, standardizimi i saj.

Dhe kjo është e kuptueshme po të kemi parasysh se përfaqësuesit e sociolinguistikës amerikane e vënë theksin në aspektin *teknik* të standardizimit, duke lënë disi më një anë rolin e *pushtetit* në këtë proces. Pra, ata nuk e bëjnë sa duhet dallimin ndërmjet vendimeve të pushtetit (*politikës gjuhësore*) dhe veprimeve konkrete (*planifikimit gjuhësor*). Ndryshe nga ata, përfaqësuesit e sociolinguistikës europianë, kam parasysh këtu, studiuesit francezë, spanjollë, gjermanë i kushtojnë më shumë vëmendje çështjes së rolit të *pushtetit*[7].

Gjithsesi Xh. Bajron, edhe pse vemendjen e përqendron në problemet e *planifikimit* gjuhësor të shqipes, nuk lë jashtë vemendjes trajtimin e rolit të *pushtetit* në këtë proces, pra *politikën* gjuhësore.

[7] Shih për këto më hollësisht Louis-Jean Calvet, *Les politiques linguistiques,* Paris, 1996.

Xh. Bajron për historinë e shqipes standarde, para vitit 1944

Sipas Xh. Bajron, përpara vitit 1944 gjuha ka pasur një traditë letrare *të dyzuar*, që u ka shërbyer folësve të të dy dialekteve të vendit. Secila zonë e dialektit ruante variantin e vet të shkrimit të gjuhës zyrtare; për lehtësi, këto variante mund të quhen *gegërishtja* letrare dhe *toskërishtja* letrare[8].

Sipas saj, shkrimtarët shqiptarë të periudhës së lëvizjes kombëtare ishin të shqetësuar nga mungesa e një gjuhe të vetme kulture dhe propozonin projektet e tyre për krijimin e një standardi të vetëm, i cili do të kapërcente ndryshimet dialektore. Propozimet e tyre ishin më shumë në kuadrin e sugjerimeve sesa sisteme të konceptuara mirë dhe, për pasojë, nuk mund të gjykohen shumë rigorozisht.

Arritja më e spikatur në sferën e planifikimit gjuhësor në periudhën parasocialiste ishte Kongresi i Manastirit, më 1908, në të cilin intelektualët shqiptarë filluan të unifikonin alfabetin shqiptar, që kishte ekzistuar deri në atë kohë në disa sisteme shkrimi, pa lidhje midis tyre (210).

Më 1917, Komisia Letrare, e themeluar në Shkodër, debatoi mbi çështjen e një gjuhe të përbashkët kombëtare letrare dhe arriti në përfundimin se baza e saj duhet të afrohej me të folmen e Elbasanit. Komisioni ndërmori disa përpjekje për të *kodifikuar* normën.

Varianti i Elbasanit shërbeu si një gjuhë *zyrtare* për disa vite me radhë, duke filluar nga viti 1923. Më 1943, Lambertz-i pohonte se është zhvilluar "një shqipe unike - një gjuhë e shkruar e bazuar mbi dialektet e Tiranës dhe Elbasanit" (71).

Pra, në prag të Luftës së Dytë Botërore, të gjitha dëshmitë që zo-

[8] Sipas saj, asnjëri prej varianteve letrare nuk përfaqësonte një gjuhë standarde: sepse variantet jo vetëm nuk kishin rregulla gjuhësore uniforme, por nuk kishin as përdorim të gjerë në të gjithë territorin brenda kufijve të dialekteve. *Gjuha standarde*, *dialekti standard* ose *varianti standard,* shkruan ajo, është "një variant **i** mbivendosur i një gjuhe që shërben si një mjet kombëtar i ligjërimit, në radhë të parë në arsim, administratë dhe shkencë" (J. Byron, *Përzgjedhje midis alternativash në standardizimin e gjuhës dhe Shkrime të tjera*, Tiranë, 2012, f. 11).

tërojmë tregojnë që shqiptarët ishin duke zgjeruar fushën e përdorimit të një dialekti qendror për qëllime administrative dhe arsimore, dhe që, si-pas gjasash, përfundimisht ky ishte dialekti që do të lëvrohej plotësisht si një gjuhë standarde e konsoliduar. Por qeveria e re socialiste ia *ndërroi* drejtimin kësaj alternative gjuhësore (238).

Gjatë periudhës socialiste duket se nuk ka asnjë gjurmë të interesit të shprehur rreth përcaktimit të së folmes së Elbasanit si një variant standard kombëtar, madje duket se u ndërpre përdorimi i saj i gjerë si një mjet shkrimi; *qëndrimi zyrtar* ndaj saj duhet të ketë qenë *negativ* (71-72). Ngritja e një varianti krahinor deri në nivelin e variantit zyrtar nga përfaqësuesit e gjuhësisë zyrtare të pasluftës (Kostallari 1970:74) është konsideruar si një veprim *jorealist* (71, shënimi).

Për periudhën pas vitit 1944

Pas Luftës së Dytë Botërore *toskërishtja u bë baza e shqipes standarde.* "Përzgjedhja, shkruan ajo, erdhi për shkak *të faktorëve politikë:* shumica e udhëheqësve të Lëvizjes Nacionalçlirimtare ishin nga Jugu dhe dokumentet ishin shkruar kryesisht në toskërishte. Kur udhëheqësit e kësaj lëvizjeje erdhën në pushtet, i *diktuan* vendit *dialektin e tyre* duke e kthyer në normë kombëtare (211).

"Shumica e njerëzve që ishin pjesë e hierarkisë komuniste dhe që krijuan shtetin autonom në Shqipëri nëpërmjet betejave partizane, ishin nga Jugu. Kjo udhëheqje, kryesisht jugore, promovoi toskërishten si bazë të standardit të shqipes(239).

"Në Shqipëri, shkruan ajo, udhëheqja politike që fliste toskërisht ia *imponoi* popullsisë *dialektin e saj* duke e vënë në themel të shqipes standarde" (227).

Pra, përzgjedhja e normës ishte një *vendim politik*, ndërsa zhvillimi dhe kodifikimi i saj u ndërmor nga planifikues të gjuhës (211).

Duke ju referuar S. Skendit dhe ndonjë studiuesi tjetër shkruan se lëvizja komuniste në Shqipëri filloi në Jug. Pjesa më e madhe e udhëheqësve që erdhën në pushtet, ishin toskë; gegët luajtën një rol

të parëndësishëm në këtë lëvizje. Për më tepër, zona veriore ku flitej gegërishtja ishte një trevë katolike dhe, si rrjedhim, e diskredituar. Në vitin 1952, Lidhja e Shkrimtarëve, një grup intelektualësh i kontrolluar nga Partia, vendosi që toskërishtja të ishte dialekti i vetëm që do të përdorej në botime 976).

Qeveria shqiptare, në kuadrin e synimit të saj për nivelimin e dallimeve sociale midis banorëve të Veriut e atyre të Jugut, fillimisht bëri përpjekje të mëdha për të minimizuar bazën jugore të standardit të shqipes dhe për t'i siguruar shqiptarët e Veriut se imponimi i këtij standardi mbi të gjithë popullsinë, nuk nënkuptonte shpërfillje a ulje për dialektin gegë.

Nga ana tjetër, në mes të viteve 60, gjuhëtarët kryesorë e zhyendosën vëmendjen në argumentimin me këmbëngulje të hipotezës se standardi shqip nuk ishte as gegë as toskë, por një bashkëveprim në të cilën asnjëri prej dialekteve nuk mbizotëronte. Argumentet gjuhësore që u përdorën në mbrojtje të kësaj hipoteze, ishin të çuditshme.

Duke iu referuar përfaqësuesve te gjuhësisë zyrtare që pretendonin se përcaktimi i dialektit toskë si gjuha e shkruar zyrtare nuk përfaqësonte uljen e dialektit verior, ajo citon Haugen-i, i cili shkruante se "Të zgjedhësh një variant si normë, do të thotë të favorizosh një grup njerëzish të cilët e flasin këtë variant të gjuhës. Kjo u jep atyre prestigjin si mbartës të normës dhe një përparësi në garën për pushtet dhe pozitë" (77).

Rreth pikëpamjeve për bazën dialektore të shqipes standarde

Afërsisht deri në mesin e viteve 60, pohon ajo, pikëpamja mbizotëruese për gjuhën standarde shqipe ishte se gjuha letrare ishte *toskërishtja*. Vitet e fundit (është fjala për vitet 60-70) dijetarët shqiptarë kanë filluar të flasin për gjuhën standarde shqipe si një *dialekt i përzier*, baza e së cilës nuk mund të njësohet me asnjërin prej dialekteve.

Këto pikëpamje të ndryshme për bazën dialektore të gjuhës standarde shqipe përfaqësojnë në thelb dy hipoteza konkurruese në lidhje me përzgjedhjen, nga pikëpamja tipologjike, të një norme standarde në përgjithësi. Haugen-i (1968:267) e konsideron përzgjedhjen e një norme si

"problemin fillestar të standardizimit" dhe i identifikon pikëpamjet e ndryshme konkurruese në lidhje me të si *teza unitare* (një gjuhë standarde është ose duhet të bazohet në një dialekt të vetëm) dhe teza *kompozicionale* (një gjuhë standarde bazohet, ose duhet të bazohet, në një përzierje të dialekteve) (740.

Cila është e vërteta, sipas saj, për gjuhën shqipe?

Në përgjithësi, mendohet se gjuha standarde shqipe është *toskërishtja*; ishte fjala për një variant të normëzuar të toskërishtes që përdorej në të shkruar, domethënë *toskërishtja letrare*. Studiuesit që mbronin këtë pikëpamje, e mbështesnin përzgjedhjen e toskërishtes me atë që ky dialekt *ishte përdorur më shumë* sesa gegërishtja në jetën kulturore (posaçërisht atë letrare) të kombit, veçanërisht gjatë periudha e Rilindjes kombëtare, duke theksuar gjithashtu disa karakteristika të përshtatshme të vetë toskërishtes. Sipas tyre "toskërishtja ishte më e njëtrajtshme dhe ishte unifikuar në një gjuhë të vetme letrare të bazuar në toskërishten popullore" (74-75).

Ndonjë tjetër vinte në dukje se "Lufta Nacional Çlirimtare i dha vrullin më të madh përdorimit të toskërishtes, sepse literatura për luftën botohej kryesisht në toskërisht (75).

Në mesin e viteve 60, thekson ajo, vërehet një ndryshim i madh në deklaratat e bëra për gjuhën standarde shqipe. Kishte parasysh artikujt e viteve 1966, 1969 dhe 1970 të botuara nga A. Kostallari (77). Nuk pranohej se gjuha standarde shqipe ishte toskërishtja dhe këmbëngulej se në të vërtetë ajo është një gjuhë e përzier, në të cilën nuk mbizotëron asnjëri nga dialektet. Thuhej se përderisa elementet e gegërishtes përfshihen në gjuhën standarde, dhe, për më tepër, përderisa të dy dialektet kanë më shumë pika të përbashkëta sesa të ndryshme, nuk ka kuptim të flasim për një bazë toske të gjuhës letrare; kundërshtohej veçanërisht nocioni se gjuha standarde shqipe është *toskërishtja letrare (77).*

Lidhur me këto pikëpamje të përfaqësuesve të gjuhësisë zyrtare ajo ka shkruar se është e vërtetë se elemente të gegërishtes përfshihen në gjuhën standarde (disa elemente leksikore, diftongu *ue* në disa grupe të

caktuara fjalësh dhe përemri *i vet*), po këto shpjegohen nga ajo si huazime të gegërishtes në toskërishte, të cilat e pasurojnë kodin marrës, por nuk e shtrembërojnë a gjymtojnë atë (77).

Për sa u përket çështjeve të tjera, për të cilat gegërishtja dhe toskërishtja ndryshojnë, gjuha standarde, thekson ajo, *pranon* kryesisht *veçoritë e toskërishtes*, ndërsa veçoritë e gegërishtes *nuk janë pranuar* (78).

Sipas saj, më parë, dialektet e folura të gegërishtes dhe të toskërishtes kishin lidhje përkatësisht me gegërishten letrare dhe me toskërishten letrare, kurse tani dialektet e folura, së bashku me variantin letrar të gegërishtes, formojnë një shtresë të vetme përballë së cilës gjuha standarde mund të vlerësohet dhe me të cilën mund të krahasohet. Dhe jep skemën që vijon (80):

Marrëdhëniet para vitit 1944

Gegërishtja letrare — ***Variantet e gegërishtes***

Toskërishtja letrare — ***Variantet e toskërishtes***

Marrëdhëniet pas vitit 1944

Toskërishtja letrare (--› **Gjuha standarde shqipe**)

Gegërishtja letrare — ***Variantet e gegërishtes*** — ***Variantet e toskërishtes***

Variantet në fund të çdo grafiku përfaqësojnë burimet parësore potenciale të pasurimit për variantin letrar, ose standard.

Pra, gjuha kulturore e Shqipërisë, thekson ajo, ka ndryshuar, nga një sistem *policentrik dyvariantësh* (Kloss 1967:31) në një sistem *monocentrik*. Gjatë këtij transformimi, gegërishtja letrare humbi statusin social, duke rënë nga një variant gjuhësor *i lartë* në një variant *të ulët* (810).

Shqipja standarde mund të quhet fare mirë *toskërishte standarde* sepse shumë cilësi gjuhësore të zhvillimit të saj të mëvonshëm justifikojnë përdorimin e një termi jodialektor për ta përshkruar.

Si rezultat i lëvrimit, i zgjerimit të funksioneve (veçanërisht politike dhe ideologjike), dhe i ndryshimit gramatikor e leksikor, shkruan ajo, bër-

thama letrare e toskërishtes ka fituar veçori të cilat tani, pas tre dhjetëvjeçarësh ndryshimi të planifikuar, e dallojnë por në të njëjtën kohë e bëjnë edhe vijuese të toskërishtes letrare, që ishte shkruar në prag të Çlirimit dhe gjatë viteve të para të qeverisjes revolucionare. Përderisa ne po trajtojmë një dukuri në transicion, sigurisht është e pamundur të themi se kur ndodhi ky ndryshim; por për lehtësi, mund ta quajmë toskërishten e lëvruar, para vitit 1944 *toskërishte letrare* dhe formën e saj më të zhvilluar pas vitit 1944 si *gjuha standarde shqipe,* një mjet kombëtar mjaft i zhvilluar i ligjërimit, baza e të cilit fillimisht ishte toskërishtja, por që ka ndryshuar nga përfshirja e veçorive dialektore (përfshirë të gegërishtes) (79).

Për përzgjedhjet standarde. Aspekti fonologjik

Sipas saj, përdorimi i parapriu përcaktimit të normës standarde; efekti i normëzimit të gjuhës moderne ka qenë *të racionalizojë* atë që ishte një zhvillim i vetvetishëm i *toskërishtes letrare* (115).

Standardizimi i fonologjisë mund të shihet, sipas saj, nga dy këndvështrime: *përzgjedhja* dhe *vlerësimi.*

Për sa i përket *përzgjedhjes,* është e qartë se zgjedhjet fonologjike përcaktohen nga ndërveprimi i pesë faktorëve: (1) *përdorimi i dialektit prestigjioz*; (2) praktikat *e variantit letrar para atij standard*; (3) *ndryshimet fonologjike të gjuhës*; (4) *përdorimi i përbashkët*; dhe (5) *ndërhyrja e autoriteteve gjuhësore*.

Shumë zgjedhje pasqyrojnë praktikat fonologjike të përbashkëta. Këtë e vëmë re veçanërisht në inventarin e bashkëtingëlloreve

Disa zgjedhje të tjera të inventarit pasqyrojnë përgjithësisht përdorimin e përbashkët të toskërishtes. Këto janë të ashtuquajturat vetëpërzgjedhje, të cilat janë tipike për toskërishten në tërësi. Vetëpërzgjedhjet kryesore janë: rotacizmi i *n*-së; *va-* në vend të *vo- (< *o);* mosshkurtimi i njësive tingullore, i ilustruar kryesisht me ruajtjen e shqiptimit të diftongjeve; denduria më e lartë e *ë*-së dhe ruajtja e grupeve të bashkëtingëlloreve.

Nga ana tjetër, aty ku përdorimi i toskërishtes është i ndryshueshëm

*ose i çrregullt, faktorë të tjerë përcaktojnë zgjedhjet standarde***.**

Diftongjet e gjuhës standarde janë një përzierje që përmban kryesisht fonemat e përbashkëta, së bashku me dy grupe jo të përbashkëta, *ua* dhe *ue.* Ky i fundit u fut në toskërishten letrare *nëpërmjet dy grupeve të huazimeve leksikore të gegërishtes*. Huazimet riparuan disa *mangësi të toskërishtes* dhe vijojnë ta bëjnë këtë në gjuhën standarde. Klasa e mbiemrave prejpjesorë të gegërishtes përmirëson diferencimin semantik dhe, për këtë arsye, *janë sanksionuar pasi kishin hyrë në toskërishte.*

*Pabarazitë e përndarjes paraqesin problemet më të ndërlikuara të standardizimit fonologjik të shqipes***.**

Përndarja e *nj:j* vijon praktikën e toskërishtes letrare të kohëve të fundit. Kodifikimi eksplicit i disa normave të caktuara duket se orientohet nga përdorimi i përgjithshëm, por ky argument, shkruan ajo, shpesh duket i dobët.

Nga ana tjetër, në dy raste *(r: rr* dhe *e: ë* para hundoreve), praktika standarde është drejtpërdrejt në kundërshtim me përdorimin e toskërishtes letrare. Dallimi ndërmjet *r:rr* mbështetet mbi bazën e *qartësisë*, ndërsa kodifikimi i *e*-së para hundoreve justifikohet duke iu referuar *përdorimit të përgjithshëm* (127-128).

Veçoritë e njëtrajtshme të toskërishtes bëjnë pjesë në *klasën e vetëpërzgjedhjeve*, kurse veçoritë e ndryshueshme kërkonin zgjidhje gjatë ecurisë së standardizimit të gjuhës. Tradita letrare ka përcaktuar disa praktika të standardit; në të vërtetë, shumë praktika të standardit do të mbeteshin të pashpjeguara, nëse nuk do të analizoheshin nga këndkështrimi i traditave më të hershme letrare (129).

Për sa i përket *vlerësimit* të varianteve të përzgjedhura janë sjellë dy arsye**:** *përgjithësimi* i përdorimit dhe rritja e *qartësisë*. Edhe pse roli i qartësisë është minimal në fonologjinë e shqipes, prapëseprapë ajo vepron. Përgjithësimi i përdorimit mund të konsiderohet si një kriter më pragmatik, por nuk është faktori i vetëm që përcakton zgjedhjet standarde në gjuhën shqipe (130).

Aspekti morfologjik

Ka shumë norma gramatikore standarde që mund të quhen *të vetë-përzgjedhura***,** sepse pasqyrojnë *dialektin e udhëheqjes* (kupto toskërishten BB) dhe për pasojë nuk janë vlerësuar mbi baza *të pavarura*.

Ndër këto norma janë paskajorja e toskërishtes, një kohë e kryer, një kohë më se e kryer dhe format e plota të pjesores (132).

Mbetjet e gjinisë asnjanëse folësit këshillohen t'i kthejnë ato në gjininë mashkullore (135). Tauli (1968: 51) beson se planifikimi gjuhësor duhet të favorizojë rrudhjen e gjinisë gramatikore; ky qëllim pa dyshim është realizuar në gjuhën shqipe - megjithëse prirja për rrudhjen e gjinisë këtu është shfaqur në mënyrë të *vetvetishme*, në rrjedhën e natyrshme të evolucionit të gjuhës. Tauli mendon se humbja e gjinisë favorizon ekonominë gjuhësore (1968: 51). Megjithatë, ekonomia, nuk është motivi për mbështetjen e një gjinie më pak në gjuhën shqipe. *Gjinia asnjanëse* e gjuhës shqipe thjesht *shihet* si *arkaike*. Nëse do të specifikonim një parim që do ta shpjegonte, ose do ta mbështeste, këtë qëndrim, do ta quanim atë preferencë për përdorim *novator* (135).

Historia e gjuhës shqipe ka prirjen për të rrëgjuar numrin e rasave dhe të formave rasore. Në gjuhën shqipe ky zhvillim shfaqet në katër raste: 1. humbja e rrjedhores së shquar shumës në *-shit,* e zëvendëssuar nga dhanorja e shquar në *-vet*; rrëgjimi i mbaresave të gjinores dhe të dhanores shumës nga dy variante të kushtëzuara *(-e, -ve)* në një të vetëm; 3. humbja e rasës vendore më *-t;* 4. rrëgjimi i formave të njëjësit të rasës kallëzore; 5. Kallëzorja e shquar e emrave mashkullorë dhe femërorë merr nyjën e shquar të prapavendosur *-n(ë)* (137-139).

Në zgjedhimin e foljeve, pjesa më e madhe e kategorive në gjuhën standarde janë ose *të vetëpërzgjedhura* ose të përcaktuara në mënyrë të vetvetishme nga *standardizimi i fonologjisë* (142).

Një sërë zhvillimesh në sistemin përemëror të gjuhës standarde përcaktohen nga *fonologjia standarde*.

Zhvillimi më i rëndësishëm në përdorimin e përemrave, i cili nuk lidhet me *zgjedhjet fonologjike standarde*, është përshtatja në gjuhën standarde e përemrit pronor vetvetor *i vet*, që është një kategori e gegërishtes (145).

Kjo formë, me sa duket, është futur fillimisht në toskërishten letrare të shek. XIX sepse përemri pronor i vetës së tretë i toskërishtes është i dykuptimtë (145-146). Sipas A. Kostallari (1969:25; 1970:84) format gramatikore në tërësi pasqyrojnë zgjedhjen e përdorimit të përbashkët. Ky pohim, shkruan Xh. Bajron, vlen për format e përbashkëta, të cilat janë imponuar në gjuhën standarde; ato nuk janë kërkuar. Ekzistenca e tyre është marrë si e mirëqenë.

Veprimi i kritereve të zgjedhjes duhet kërkuar në fushat ku gjuha shfaq ndryshime. Klasa e normave gramatikore *të vetëpërzgjedhura* përfaqëson një parapëlqim *dialektor (toskë).* Në raste të tjera është prefruar në gramatikë norma inovuese. Fakti se këto norma përfaqësojnë edhe përdorimin e përbashkët (ose pothuajse të përbashkët) është një nënprodukt i këtij parapëlqimi (147).

Përfundime lidhur me përzgjedhjet standard

Planifikimi i gjuhës shqipe tregon se përveç formave dhe kategorive të përbashkëta, të cilat janë të detyrueshme dhe të pamotivuara, disa variante të standardit janë *të vetëpërzgjedhura*, d.m.th. janë të motivuara nga shfaqja e tyre në dialektin mbizotërues.

Variantet e tjera standarde janë shfaqur nëpërmjet vlerësimit të qëllimshëm të alternantëve dialektorë nga planifikuesit e gjuhës, duke përzgjedhur ata alternantë që mendoheshin (mbi baza të ndryshme) se ishin të mirë dhe duke refuzuar ata të cilët, në dallim nga të parët, konsideroheshin si të këqij.

Ky rast mund të vështrohet a përmblidhet nga një këndvështrim pakëz i ndryshëm, domethënë nga pikëpamja e marrëdhënieve ndërmjet normave *të pakicës* (*elitës*) dhe normave *të shumicës* (ose *të njerëzve të*

zakonshëm) në krijimin e një gjuhe standarde. Shqipja, sipas saj, tregon se, në të vërtetë, *të dy* normat janë përfshirë në gjuhën standarde. Sa herë që përdorimi është i përbashkët për të dy normat, ai është kategorik për sa i përket gjuhës standarde. Nga ana tjetër, aty ku përdorimi është i ndryshëm, normat standarde krijohen në dy mënyra: disa *vetëpërz-gjidhen*, d.m.th.. pasqyrojnë *dialektin e udhëhegjes politike*, ndërsa të tjerat krijohen mbi baza të ndryshme gjuhësore dhe jogjuhësore, pa pasur asgjë të përbashkët me përdorimin e tyre nga elita.

Në gjuhën shqipe, në shumicën e rasteve, përdorimi i ka paraprirë vlerësimit, d.m.th.., alternantët që më pas do të ngriheshin në standard ishin shfaqur në traditën letrare para vitit 1944, ose në disa, ose në shumicën e varianteve të folura, por në konkurrencë me përdorime të tjera. Veprimtaria pasuese e planifikuesve të gjuhës zyrtarizoi alternantët e parapëlqyer, duke lënë në harresë pjesën më të madhe të alternantëve konkurrues. Si rrjedhim, mendimi i Ferguson-it (dhe, rastësisht i Krapp-it) se përdorimi i paraprin normëzimit konfirmohet në gjuhën shqipe.

Pabarazia *simptomatike* e formave është gjithashtu një veçori e pla-nifikimit të gjuhës. Për shembull, nëse një emër i gjuhës shqipe ka formën kallëzore *mal-në* ose *mal-in* nuk ka rëndësi për sa i përket përmbajtjes kognitive të emrit, pasi funksioni gramatikor është i njëjtë. Por nga kënd-vështrimi i një kombi, i cili po përpiqet të përparojë dhe të largohet nga e kaluara konservatore politike dhe sociale, ndoshta është e pamundur që autoritetet gjuhësore t'i shohin të dyja si të barabarta nga pikëpamja jo-kognitive, dhe pa dyshim *mal-in* është formë më superiore. Pra, pikepa-mja e Haugen-it dhe e Neustupny-t se *qëllimet sociale* më të rëndësishme pasqyrohen në zgjedhjet gjuhësore, *konfirmohet* në gjuhën shqipe.

Disa përzgjedhjet në gjuhën shqipe janë standardizuar mbi bazat e *qartësisë*; kjo vlen veçanërisht për dallimin *r:rr*, për mbiemrat "prej-pjesorë" të gegërishtes dhe për përemrin *i vet.*

Kriteret që gjejnë më pak shprehje në standardizimin e shqipes janë *"ekonomia"* dhe *"bukuria".* Ekonomia nuk është një qëllim i drejtpërdrejtë i vendimmarrjes ose i përzgjedhjes së shqipes, por një prej nënprodukteve të saj të rastësishme.

Në gjuhë ka raste kur alternanti i mënjanuar nga përdorimi në gjuhën standarde paraqitet si një variant stilistik. Ajo sjellë dy raste të tilla në gjuhën shqipe: *e ardhmja* jostandarde dhe *kallëzorja* jostandarde. Sipas saj alternantët e mënjanuar janë pranuar për përdorim stilistik. Shfaqja e ndjeshmërisë stilistike, sipas saj, konfirmon se gjuha shqipe po hyn në një fazë më të avancuar të planifikimit gjuhësor, domethënë *në fazën e kultivimit***.**

Për standardizimin e gegërishtes në Kosovë. Periudha 1945-1968

Sipas Xh. Bajron, pas Luftës së Dytë Botërore, kur Lëvizjet Nacional-çlirimtare sollën komunistët në pushtet, si në Shqipëri edhe në Jugosllavi, shqiptarët në të dyja vendet edhe pse në tërësinë e tyre përbënin një *kombësi* të vetme, kufiri gjeografik i ndau në shtete të ndryshme. Për rrjedhojë, është e kuptueshme pse në vitet pas luftës, bashkësia shqipfolëse e ndarë më dysh ndoqi rrugë të ndryshme në procesin e planifikimit gjuhësor. Shqiptarët e Jugosllavisë, në shumicë dërrmuese gegëfolës, filluan të formulonin rregulla për gegërishten letrare (210-211).

‘Që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore deri një dhjetëvjeçar më parë (vitet gjashtëdhjetë), shkruan ajo, shqiptarët e Jugosllavisë kishin zhvilluar *një gjuhë standarde* që bazohej në dialektin e tyre gegë”.

"Duke qenë se pakica kombëtare shqiptare në Republikën Popullore Federale të Jugosllavisë flet dialektin gegë, *gjuha e shkruar* për ne, deklaronin ata, më 1952, s'mund të jetë tjetër, veçse *gegërishtja*" (213).

Qëllimi kryesor ishte nxitja e *standardizimit të gegërishtes*. Për këtë qëllim më 1952 u ngrit një komision që do të punonte për gjetjen e zgjidhjeve për probleme të përdorimit gjuhësor.

Në mesin e viteve 60, kultivuesit e gjuhës ishin gati për botimin e kodifikimit të parë të ortografisë së *gegërishtes standarde*: *Ortografia e gjuhës shqipe, i* cili doli në vitin 1964.

Unë do ta konsideroja vitin 1964, shkruan ajo, si vitin në të cilin *gegërishtja standarde* arriti kulmin e zhvillimit” (213-216).

Më 1968, kultivuesit e gjuhës vendosën që bashkësia (shqiptare në Jugosllavi) të hiqte dorë menjëherë nga ky *standard* në formën e tij të shkruar, e më pas edhe në formën e folur, dhe të përvetësonte *normën* që përdorej në Shqipëri; njëherazi u ndalua përdorimi i *gegërishtes standarde* (216).

Periudha 1964-1968 duhet të shihet si një fazë kalimtare në rrugën e *ndërrimit (switching) të normës*. Një bazë më shumë *sociale* sesa gjuhësore qëndronte në themel të vendimit që u mor në Jugosllavi. Duhet përjashtuar mundësia që udhëheqësit e bashkësisë shqiptare në Jugosllavi ta kenë konsideruar gjuhën e tyre standarde si të varfëruar në pikëpamje linguistike apo, si të paaftë, në thelbin e saj, për shprehjen e mendimit modern.

Mesi i viteve 60 ishte një periudhë me trazira të mëdha sociale ndër shqiptarët e Jugosllavisë; *ndjenja kombëtare ishte intensifikuar*. Pakica, rrjedhimisht, zgjodhi ta afirmojë nacionalizmin e vet nëpërmjet gjuhës, duke përvetësuar dialektin standard të vendit amë. Duke bërë këtë, ata riafirmonin identifikimin e tyre etnik me vendin amë. Dhe citon thënien e njërit prej pjesëmarrësëve në konferencën e vitit 1968: "Tanimë, gjuha letrare kombëtare shqipe të cilën e përdor kombi amë, është bërë imperativ kohe për të gjithë shqiptarët, kudo që ata jetojnë, aq më shumë sepse çdo entiteti kombëtar i përgjigjet vetëm një gjuhë letrare" (218-219).

Sipas Xh. Bajron, "*nacionalizimi* u bë faktor në planifikimin gjuhësor të shqiptarëve të Jugosllavisë pas përzgjedhjes së normës". Ajo mendon se, "pa pranimin e dialektit të preferuar (e *gjuhës zyrtare* me bazë toskërishten) nga folësit jashtë kufijve gjeografikë apo shoqërorë të këtij dialekti, kodi i preferuar, pavarësisht prej statusit të tij, do të mbetej thjesht dhe vetëm *një variant i të folurës lokale*". Pra, sipas saj, gjuha zyrtare me bazë toskërishten, nuk do të mund të përmbushte kushtet për të qenë *gjuhë standarde*, e cila është një variant gjuhësor mbilokal" (228).

A ka pasur kundërshti për importimin në Jugosllavi të një norme të krijuar në Tiranë?

Për shkallën e kundërshtimit në Jugosllavi, sipas saj, ndërgjegjë-

sohesh kryesisht nga referencat e tërthorta apo nga sulmet e botuara prej mbështetësve të fuqishëm të shqipes standarde kundër kundërshtarëve pa emër të standardit (224-225).

Në Shqipëri, kundërshtimet ndaj shqipes standarde nuk kanë pasur ndonjë ndikim, për shkak se institucionet mbizotëruese dhe media - që të gjitha të kontrolluara nga shteti - ishin zyrtarisht të angazhuara për zbatimin e normës së bazuar te toskërishtja. Gjasat janë që edhe në Jugosllavi, një angazhim i ngjashëm i institucioneve *të mbysë zërin e kundërshtarëve* (226).

Qendrimet ndaj veprës së Xh. Bajron. Gjuhësia zyrtare e pasluftës për veprën

Nga përfaqësuesi kryesor i gjuhësisë shqiptare të pasluftës, A. Kostallari, më 1984 është shkruar:

"Në ndonjë punim të veçantë janë bërë përpjekje për ta futur mekanikisht formimin e shqipes letrare të njësuar në disa skema të përgjithshme të sociolinguistikës së sotme. Ndër to, bie në sy sidomos monografia e Xhenet Bajronit me titull "Përzgjedhje ndërmjet alternativave në standardizimin e gjuhës: Rasti i shqipes", botuar nën drejtimin e sociolinguistit të njohur Xhoshua Fishman. Në këtë vepër, që përmban mjaft pohime kundërthënëse, formimi i shqipes letrare të njësuar trajtohet në mënyrë të shtrembëruar e të thjeshtëzuar. Përfundimet themelore që jepen aty nuk kanë dalë nga analiza e thelluar e objektive e sistemit dhe e nënsistemeve të gjuhës letrare shqipe, të parë në zhvillimin e saj të pandërprerë, në lidhje të ngushtë me faktorët shoqërorë e me dialektet, sidomos që nga epoka e Rilindjes Kombëtare. Ato janë nxjerrë në mënyrë subjektive, duke zbatuar mekanikisht e me një metodë eklektike për shqipen teza e përfundime të një vargu sociolinguistësh si Punya Sloka Rey, Einar Haugen, Valter Tauli, Jiri V. Neustupny, Joshua A. Fishman, Charles A. Ferguson etj., të cilët, siç dihet, kanë trajtuar, mjaft herë nga pozita të ndryshme e të njëanshme, aspekte të përgjithshme të "standardizimit" të gjuhëve e çështje

të gjuhëve të veçanta, sidomos joeuropiane, por nuk kanë pasur asnjëherë si objekt studimi gjuhën shqipe. Mirëpo, krahas tipareve të përgjithshme që kanë gjuhët letrare të botës, çdo gjuhë letrare kombëtare, si dukuri konkrete, ka tiparet e veta origjinale e të papërsëritshme, të cilat mund të zbulohen e të kuptohen drejt vetëm po të njihet thellë e me vërtetësi sistemi i saj në evolucionin historik e tipologjik dhe faktorët e veçantë shoqërorë e gjuhësorë që e kanë përcaktuar këtë evolucion. Për këtë njohje nuk mjaftojnë vetëm metodat statistikore, sasiore, të cilave u jepet herë-herë një rëndësi e tepruar në të ashtuquajturin " planifikim gjuhësor", por duhen bërë, mbi të gjitha, vlerësime cilësore, sepse në gjuhë, në të gjitha rrethanat veprojnë njerëzit, me idetë, ndjenjat, dëshirat e synimet e veta. Dhe ata veprojnë si pjesëtarë të një bashkësie, të një kombi, të një shoqërie të caktuar, në kushte të caktuara historike... Thjeshtëzimi e shtrembërimi i këtij procesi në këtë libër arrin aq larg saqë aty pohohet se në Shqipëri "zhdukja e dialekteve ka marrë bekimin zyrtar". "Kështu, gjithë procesi origjinal, dialektik e shumë i pasur i gjuhës letrare shqipe pas 1944-ës, në të cilin kanë marrë pjesë forca të gjera të jetës shoqërore, të shkencës, të arsimit e të kulturës, rrëgjohet aty në një farë akti të zakonshëm administrativ në frymën e metodave të pragmatizmit gjuhësor"[9].

R. Ismajli i është referuar herë pas here veprës së Xh. Bajronit, duke demonstruar kështu miratimin e tij për shumë qëndrime të saj, sidomos për historinë e standardizimit të shqipes në Jugosllavi.

Ai, edhe pse në përgjithësi i vlerëson shpjegimet e saj, nuk le pa vënë në dukje rezervat e tij për pikëpamje të veçanta të saj. Kështu, për shembull, ai, me të drejtë, nuk pajtohet me Xh. Bajron kur ajo shkruan se standardizimi i shqipes ka nisur në periudhën e pasluftës[10].

Po kështu, për R. Ismajlin, po edhe për ne, përpjekjet për planifikimin e shqipes, veçanërisht të *gegërishtes standarde* (term i përdurur prej saj) janë më të hershme dhe më komplekse se paraqiten në punimin

[9] A. Kostallari, *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë,* në "Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë", Tiranë, 1988, f. 37-38.

[10] Po aty, f. 14.

e Xh. Bajron.

Gjithsesi këto dhe probleme të tjera të diskutueshme që vihen re në veprën e saj, nuk errësojnë kontributin e saj në shpjegimin e historisë së shqipes standarde.

Vlerësimi ynë

Lidhur me vlerësimin e mësipërm të A. Kostallarit, ne kemi shkruar se me disa formulime të përgjithshme, tipike për kohën, kërkohej të hidhej poshtë vepra e Xh. Bajronit, rezultat i një pune këmbëngulëse serioze, e mbështetur në rezultatet më të fundit të sociolinguistikës[11].

Për ne, ky është i pari punim, ndoshta edhe i vetmi, që i shikon problemet e historisë së formimit të shqipes standarde në dritën e të dhënave të një drejtimi të ri linguistik, të sociolinguistikës amerikane.

Pas studimit të Ivar Aasen për gjuhën moderne norvegjeze, kjo është përpjekja e parë për një analizë tërësore dhe sistematike të kritereve mbi bazën e të cilave janë kryer përzgjedhje në procesin e standardizimit të një gjuhe në të gjitha nivelet, në këtë rast të gjuhës shqipe.

Si i tillë studimi i Xh. Bajronit është një alternativë e re e shpjegimit të ecurisë së standardizimit të shqipes krejt e ndryshme nga shpjegimet e dhëna për këtë problematikë nga gjuhësia zyrtare shqiptare e pas luftës.

Ne kemi dalluar tre drejtime kryesore në historinë e studimit të formimit të shqipes standarde. Drejtimi i parë me përfaqësues kryesor A. Kostallarin, të ciline kemi vlerësuar drejtimi zyrtar ose siç e kanë quajtur vetë përfaqësuesit e kësaj pikëpamjeje, drejtimi marksist, drejtimi i dytë, me përfaqësues kryesor A. Pipën, të cilin e kemi quajtur drejtimi opozitar me të parin dhe drejtimi i tretë me përfaqësuese kryesore studiuesen amerikane Xh. Bajron, të cilin e kemi quajtur drejtimi i pavarur ose drejtimi objektiv në studimet për shqipen standarde.

Kjo nuk do të thotë që për probleme të veçanta të mos kemi dallime me pikëpamjet e saj.

[11] B. Beci, *Historia e standardizimit të shqipes*, Tiranë, 2010, f. 37.

Ky punim nuk ka vetëm meritën se studion historinë e standardizimit të shqipes me një metodë të re gjuhësore pak ose aspak të njohur nga ne në ato vite, po edhe se konkretizon e verifikon përmes analizës së gjuhës shqipe, parimet teorike të një drejtimi të ri linguistik, socialinguistikës amerikane, që kishte marrë udhë në shtete e Bashkuara të Amerikës në vitet 60-70.

Bahri BECI, Paris

JANET BYRON ON HISTORY OF CREATION OF STANDARD ALBANIAN

Summary

The aim of this paper is to define Janet Byron's place in the history of studies of the standard Albanian. Her study *Selection Among Alternates in Language Standardization: the Case of Albanian* was written at the time when the problems of the Albanian language planning, in both practical and theoretical aspects were an issue in the United States.

It was the time when the representatives of the official linguistics in Albania had declared Albanian as a "Marxist" language and the there was an inclination to interpret the entire history of the standard Albania language on that basis.

This was more or less the context, which, in one way or another, determined two viewpoints in explaining the history of the formation of the standard Albanian: the official Albania linguistic establishment, on the one hand, and Janet Byron, on the other. It is precisely in this is the context that her work was viewed by representatives of the linguistic establishment until 1990.

Janet Byron's views on the history of the formation of the standard Albanian but also the contradictory stances on her work, both before and after 1990, are the subject of this paper.

Imri BADALLAJ, Prishtinë

JANET BYRON MBI BAZËN DIALEKTORE TË SHQIPES STANDARDE DHE QËNDRIMI ZYRTAR NDAJ DIALEKTEVE

Shqipëria në vitet e shtatëdhjeta kishte arritur nivelin më të lartë të diktaturës, që kjo atmosferë shumë e zymtë dhe fort frikësuese e kishte mbyllur diskutimin mbi historinë e formimit të shqipes standarde pa ndonjë takim shkencor, ku do të diskutohej mbi bazën dialektore dhe zhvillimet e mundshme, që janë bërë brenda tyre. Kështu që gegërishtja u flak si një leckë dhe po të bënte dikush një fjalë të vetme në favor të saj, Kostallari dhe përkrahësit e tij do ta vlerësonin si antikombëtar dhe reaksionar. Ky qëndrim, thjesht e la gegërishten vetëm si variant të komunikimit familjar. Prandaj, Byron me argumente shkencore konkludon, se shqipja standarde është vetë dialekti toskë. Në këtë kumtesë, i kemi vënë në dukje pikëpamjet e kësaj gjuhëtare mbi bazën dialektore dhe qëndrimin zyrtar ndaj dialekteve të shqipes në planifikimin dhe normëzimin e saj. Siç shton ajo, kur e morën pushtetin, drejtuesit toskë e ngritën në një status më të lartë dialektin e tyre, duke mos i lënë asnjë mundësi inkuadrimit të gegërishtes brenda shqipes standarde.

Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe i mbajtur më 1972 në Tiranë trazoi kërshërinë e shumë gjuhëtarëve brenda trojeve shqiptare dhe jashtë tyre, sidomos normëzimi i toskërishtes dhe veçanërisht ai i toskërishtes, që përdorej në të shkruar, shkaktoi reagime të karakterit sa shpjegues, aq edhe polemizues, që me këtë rast reagoi edhe gjuhëtarja amerikane Janet Byron me veprën gjuhësore: Përzgjedhje midis alternativash në standardizimin e gjuhës: Rasti i shqipes (Selection Among Alternates in Laguage Standardization: The Case of Albania, *Hague*. Mouton, 1976).

Janet Byron e para doli me një libër me karakter polemizues dhe me tone të ashpra për atë, që i ndodhi gjuhës shqipe, duke i vënë në dukje problemet e politikës dhe të planifikimit gjuhësor të shqipes me një mbështetje të teorive gjuhësore, që në ato vite ishin më standardet.

Byron me mprehtësi i studioi të gjitha materialet e Kongresit të Drejtshkrimit të vitit 1972, që plotësisht u bind se normëzimi i gjuhës shqipe në Shqipëri konceptohej si propagandë, e cila i shërbente *ideolog*-gjisë së caktuar të karakterit thjesht marksist-leninist pa ndonjë mbështetje shkencore. Prandaj, kjo gjuhëtare e vyer dhe fort e ngritur gjuhësisht, shpjegimet e saj në veprën e përmendur i mbështet tek teoritë gjuhësore të gjuhëtarëve më të njohur botërorë, si: Haugen, Tauli, Fishman, Fergusan, Gumperz, Blom, Guxman etj.

Pas viteve 1944 dhe fillimit të vitit 1945 shqipja kishte një traditë letrare dydialektore, por me pushtetarët e rinj kjo traditë filloi të rrënohet, duke u zëvendësuar me një variant të vetëm të mbivendosur. Këtë ndryshim Janet e shpjegon në saje të mbështetjes së fortë tek pushtetarët e rinj dhe tek autoritetet gjuhësore, që këta të dytët drejtpërsëdrejti janë marrë me çështjet e standardizimit të gjuhës. Personalitetet e tilla ishin punonjës të Departamentit të Gjuhësisë dhe të Historisë të Universitetit Shtetëror të Tiranës, të cilët përveç përmbushjes së funksioneve akademike, drejtonin gjithashtu edhe normëzimin zyrtar të gjuhës, shpesh nëpërmjet të komisioneve të veçanta, siç ishte edhe Komisioni i Ortografisë, që përcaktonte rregullat lidhur me drejtshkrimin.[1]

Ata të cilët citohen nga Byron janë: K. Cipo, A. Kostallari, A. Krajni, O. Myderrizi e M. Domi. Ndërsa Komisionin e Ortografisë, që hartoi rregullat e drejtshkrimit të vitit 1967, e përbënin gjuhëtarët: M. Domi, E. Lafe, E. Çabej. Mirëpo, ai që prente dhe qepte rrobat e ortografisë ishte A. Kostallari, që për shumë vjet drejtoi Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë. Ky zaten është gjuhëtari i vetëm që ka publikuar artikuj e studime rreth përcaktimit të gjuhës standarde, që për këtë edhe Byron e konsideron më të fuqishmin për të vendosur për të gjitha çështjet e gjuhës shqipe.

---

[1] Janet **Byron**, Përzgjedhje midis alternativash në standardizimin e gjuhës- Rasti i shqipes (përkthyer në gjuhën shqipe nga Mariana **Ymeri** prej origjinalit: Selection Among Alternates in Language Standardization - The Case of Albanian, Hage: Mouton, 1976, 73.

Gjuhëtares amerikane nuk i mbushej mendja se Kongresi i Drejtshkrimit i 1972 ka zgjidhur shumë çështje, ngase baza e standardit gjëja se është mbështetur në të dy dialektet kryesore, kjo nuk ishte fare e vërtetë, çfarë edhe gjuhëtares për të cilën po bëhet fjalë, nuk i del ashtu. Edhe disa përkrahës të Kostallarit, që filluan të dalin me ndonjë artikull, se gjëja shqipja standarde është një përzierje e të dy dialekteve, nuk krijonte në opinionin e gjuhëtarëve ndonjë bindje në favor të Kostallarit.

Për bazën dialektore të shqipes, sipas Haugen-it përfaqësohen në thelb dy hipoteza konkurruese në lidhje me përzgjedhjen nga pikëpamja tipologjike e një norme standarde.

Ky gjuhëtar përzgjedhjen e një norme e konsideron si " ...problemin fillestar të standardizimit dhe i identifikon pikëpamjet e ndryshme konkurruese lidhur me te si teza unitare (një gjuhë standarde është ose duhet të bazohet në një dialekt të vetëm) dhe teza kompozicionale (një gjuhë standarde bazohet, ose duhet të bazohet në një përzierje të dialekteve.[2]

Këtë teori të Haugenit, Janet e analizon duke bërë vlerësime mbi segmentin e pikëpamjeve vetëm për shqipen, duke i vënë në dukje në të njëjtën kohë se në çfarë mase ato janë të vërteta dhe nuk gjen rahati për t'u bindur se për shqipen standarde Kongresi nuk bëri dhe nuk vendosi diçka të mirë dhe të qëndrueshme.

Ajo që flitej e shkruhej se toskërishtja përdorej shumë më tepër se gegërishtja në jetën kulturore (posaçërisht në atë letrare) të kombit, veçanërisht gjatë shekullit XIX në periudhën e Rilindjes Kombëtare, nuk qëndron dhe nuk mund të arsyetohet gjuhësisht.

Për fat të lig në një farë mase këtë qëndrim e përkrah edhe A. Xhuvani. Ndërsa Dh. Shuteriqi shton, se... toskët kanë pasun kurdoherë, si të them kyçat e shtypit e të publicistikës në gjithë Shqipëninë, përveç një rrethi të ngushtë të Shkodrës, ku punuen e vepruen priftënit katolikë e puna e tyne mbetesh po në vend. Gjithë Shqipnia ka kënduem e shkruem mã të shumtën toskënisht[3].

Për përparësitë e toskërishtes edhe J. Stefi (1961, 57) ka bërë fjalë,

[2] Po aty, f. 75.

[3] Po aty, f. 75.

duke mbrojtur tezën, se toskërishtja me përdorimin e saj ka luajtur rolin kryesor në lëvizjen kulturore. Ai shton më tutje, se LNÇ i dha vrullin më të madh përdorimit të dialektit të Jugut. Prandaj, toskërishtja vjen e bëhet si gjuhë zyrtare e arsimit, e shtypit, e letërsisë artistike dhe e indoktrinimit ideologjik. Sipas Stefit toskërishtja na paska qenë ... më unifikuese dhe si e tillë, duhet të jetë i vetmi variant për një bazë të gjuhës letrare.[4]

Stavro Skendi këtë çështje e shpjegon shkurt e qartë, duke thënë, se lëvizja komuniste filloi në Jug të vendit. Pjesa më e madhe e udhëheqësve në krye të pushtetit ishin toskë dhe sipas tyre gegët luajtën në rol të parëndësishëm në këtë lëvizje. Pos tjerash, shton Skendo: ...zona veriore ku flitej gegërishtja ishte një trevë katolike dhe si rrjedhim e diskrediturar[5].

Edhe Lidhja e Shkrimtarëve, që ishte e kontrolluar nga partia, vendosi në favor të toskërishtes për të qenë gjuhë letrare.

Është për t'u çuditur se edhe A. Desnickaja, duke qenë nënë ndikimin e pushtetarëve shqiptarë e vë në dukje rolin e vazhdueshëm të toskërishtes gjatë viteve pas çlirimit, duke u shprehur *se*: toskërishtja vijimisht po arrin një epërsi për t'u bërë baza e gjuhës së përbashkët letrare shqipe[6]. Pas Kongresit të Drejtshkrimit me të madhe trumbetohej në shtypin e kohës se ngritja e toskërishtes në nivelin më të lartë nuk do të thotë përbuzje a mospërfillje për gegërishten, Janet Byron për të dytën herë përmend qëndrimet e J. Stefit, ...se toskërishtja u përcaktua për arsye specifike historike dhe sociale dhe të nevojës së shtetit, sepse as sistemi gramatikor i gjuhës, as fondi themelor leksikor nuk ka ndryshuar[7]. Këtë shpjegim të Jani Stefit Byron e konsideron jo thelbësor dhe shton, se ky është vetëm shpjegim paqëtues kundrejt gegërishtes.

Janet Byron në këtë njësi të librit vë në dukje një mori deklarimesh, që strumbullari i tyre prapë është Kostallari, që kurrë nuk pranoi se shqipja standarde është toskërishtja, duke këmbëngulur se në të vërtetë kjo është një përzierje në të cilën nuk mbizotëron asnjëri nga dialektet. Këtë

[4] Po aty, f. 75-76.

[5] Po aty, f. 76.

[6] Po aty, f. 77.

[7] Po aty, f. 77.

tezë e mbron, duke i aktivizuar edhe përkrahësit e tij, që pareshtur të shkruajnë, dhe pse jo, të flasin, aty ku munden për favorin e toskërishtes.

Në studimin e saj ajo vë në dukje edhe elementet përbërëse të shqipes standarde sipas përbërjes dialektore, që proporcioni i elementit të gegërishtes sa është minor, është edhe aq qesharak për t'u quajtur se gjuha shqipe standarde është brumosur nga të dy kryedialektet e shqipes[8].

Kur Janet Byron vë theksin e saj mbi elementin përbërës të një gjuhe standarde është e një mendje*je* me Haugen-in, *i* cili kur bënte fjalë mbi planifikimin gjuhësor thotë: Të zgjedhësh një variant si normë, do të thotë të favorizosh një grup njerëzish, të cilët e flasin atë variant të gjuhës. Kjo u jep atyre prestigjin si mbartës të normës dhe një përparësi në garën për pushtet dhe pozitë[9].

Prandaj, shton Janet: këto rrethana kanë ndodhur në Shqipëri në përcaktimin e normës standarde të shqipes. *G*jithsesi çfarëdo shpjegim*i* tjetër do të ishte joshkencor.

Për të qenë më bindëse, se Jugu e sundonte edhe gjuhën, ajo vë në librin e saj edhe një listë të drejtuesve kryesorë komunistë, që numerikisht i d*i*lnin mbi 90% jugorë dhe thjesht folës të toskërishtes.

[8] Po aty, f. 77.

[9] Po aty, f. 78.

Imri BADALLAJ, Prishtina

JANET BYRON ON DIALECT BASIS OF STANDARD ALBANIAN AND OFFICIAL STANCE ON DIALECTS

Summary

The Albanian Orthography Congress held in 1972 in Tirana aroused curiosity among linguistic circles both inside the Albanian territories and abroad, prompting reactions and polemics with regard to use of the Tosk dialect, the written Tosk in particular, as the basis for the standardization. American linguist Janet Byron made a valuable contribution to the discussions on this topic with her book *Selection Among Alternates in Language Standardization: The Case of Albanian*, published in 1976.

Janet Byron has special merits in the linguistics, because she was the first to highlight the problems of politics and linguistic planning of the Albanians, by employing linguistic theories which in those years were the most standard ones. She studied meticulously all materials of the 1972 Orthography Congress to come to a conclusion that the codification of the Albania was conceived as propaganda, serving a certain ideology, more specifically the Marxist-Leninist ideology, but lacking a scientific basis. Therefore, she based her book on the sound grounds of linguistic theories of the world's most famous linguists, like Rey, Haugen, Tauli, Fishman, Ferguson, and others.

In 1970s, dictatorship in Albania had reached its peak and this very frightening atmosphere led to the silencing of discussions on the history of the formation of the standard Albanian in scientific events at which scholars would contemplate on the basis of dialects and possible developments within respective dialects. So, the Gheg dialect was dumped and if anyone would seek speaking in favor of that dialect, then Kostallari and his supporters would label those people as reactionnaries. As a result of this position, the Gheg dialect was left as a variant of family communications. Therefore, through scientific arguments, Byron concludes that the standard Albanian is simply the Tosk dialect. This paper treats views of this linguist on the standard Albanian.

Carrie Ann MORGAN, Ohio State University

HABITORJA SI VEPRIM SOCIAL NË KONTEKSTIN E IDEOLOGJIVE GJUHËSORE

Trajtimet e habitores

Historikisht, analizat e habitores kanë marrë dy forma. Disa studiues (e.g. Demiraj, 2002; Newmark et al., 1982) e kanë trajtuar si mënyrë që shpreh gjendjen psikologjike të folësit, ndërkohë që disa të tjerë (p.sh. Camaj, 1984: 162-3; Friedman, 1986) theksojnë rolin e saj si formë evidencialiteti. Në të gjitha këto analiza, habitorja bart kuptime pragmatike si habi, dyshim dhe ligjëratë e zhdrejtë ose inferencë, kuptime që, sipas analizave, përftohen nga aspektet psikologjike të folësit. Por habitorja gjithmonë funksionon në kontekstin e ndërveprimit. Kjo do të thotë që kuptimi i habitores nuk varet eksklusivisht nga gjendja psikologjike e folësit, por edhe nga reagimi i bashkëbiseduesve si dhe konteksti i përdorimit. Prandaj, trajtimi i plotë i kësaj forme duhet të marrë parasysh aspektet shoqërore, ndërveprimore dhe kontekstuale.

Siç kanë treguar disa studiues (e.g. Mushin, 2001; Babel, 2009), format e evidencialitetit japin mundësi të veçantë për ndërtimin e realitetit shoqëror sepse etiketojnë burimet e informacionit. Për arsye se etiketimi i burimeve të informacionit është subjektiv, ky funksion ka rëndësi për raportet shoqërore. Në rastin e habitores, Friedman (e. g. 1986, 2003, 2004) shkruan se kuptimi thelbsor i kësaj forme është qëndrimi jokonfirmues i folësit ndaj informacionit, funksion që gjithashtu tregon qëndrimin e folësit ndaj njerëzve që lidhen me informacionin në fjalë. Rrjedhimisht, habitorja, si format e tjera të evidencialitetit, nuk është një reflektim transparent i realitetit, por është mjet për ndërtimin e tij.

Friedman (2012) përfaqëson një analizë të habitores që merr parasysh këto aspekte shoqërore. Ai analizon se si përdorimi i habitores ndërton identitete në kontekstin e gazetave Kosovare gjatë periudhave të ndryshme politike. Pra, nxjerr në pah mënyrën në të cilën konteksti politik dhe identiteti i gazetës ndihmojnë në përcaktimin e kuptimit dhe të funksionit të habitores. Me rëndësi të veçantë janë dy vëretje të Friedman-it. E para është që habitorja krijon kundërvënie folës-jofolës. E dyta është që ajo kthen vëmendjen tek folësi, duke u bërë vetja qendra e vëmendjes. Në këtë analizë, dua të vazhdoj qasjen e Friedman-it, duke thelluar dhe zgjeruar këto dy pika me të dhëna ndërveprimore.

Përfshirja e aspekteve shoqërore, ndërveprimore, dhe kontekstuale

Të gjitha kuptimet pragmatike të habitores mund të klasifikohen sipas kornizës së Hanks-it (2012) që paraqet tri lloje efektesh evidenciale (*evidential effects*): burimi i njohurisë (*source of knowledge*), burimi i ligjëratës (*source of statement*), dhe forca shprehimore/ ndërveprimore (*expressive/interactional force*). Burimi i njohurisë lidhet me kuptimin *inferencë* që jep habitorja, burimi i ligjëratës me *ligjëratën e zhdrejtë*, dhe forca shprehimore/ndërveprimore me *habi, dyshim*. Pavarësisht nga dallimet mes tyre, të gjitha këto kuptime edhe ndërlidhen me njeri-tjetrin për aq sa tregojnë (*index*) distancë mes folësit dhe burimit të informacionit ose informacionit vetë. Prandaj, edhe pse habitorja shënon më shumë se sa ligjëratë të zhdrejtë, gjithsësi mbart "zërin e dyfishtë" (Bakhtin, 1963). Me fjalë të tjera, një zë tjetër "pjesërisht imitohet, citohet, ose kundërshtohet" (Irvine, 1996: 136) kur përdoret habitorja.

Me rolet pjesëmarrëse të tij, Goffman-i (1974, 1981) synon të zbërthejë kategoritë "folës" dhe "dëgjues", qasje që na jep mundësinë e analizës së zërit. Në formatin e prodhimit, në vend të "folësit" janë tri role që luhen ose nga folësi si njeri biografik ose nga të tjerë personazhe ndërkohë që në formatin e marrjes, në vend të "dëgjuesit", kemi dy role.[1]

[1] Në fakt, Goffman ka më shumë sesa dy role në formatin e marrjes, por vetëm dy janë

Korniza e Pjesëmarrjes (*Participant Framework*)

Formati i prodhimit*:* (“folësi”)

– *Principal* – përgjegjës për kuptimin e ligjëratës

– *Author* – zgjedh fjalët/ formën e ligjëratës

– *Animator* – fizikisht prodhon ligjëratën

Formati i marrjes*:* (“dëgjuesi”)

– *Addressed recipient* – i drejtohet folësi

– *Unaddressed recipient* – nuk i drejtohet folësi

Formati i prodhimit është sidomos i rëndësishëm në studimet e evidencialitetit sepse funksioni i distancës arrihet kur personi që luan rolin e *Animator*-it ia atribon dikujt tjetër rolin e *Principal*-it. Por gjithashtu mund të pyesim se kush kryen rolin e *Author*-it. Siç do të tregoj, përcaktimi i *Author*-it varet nga llojet e efekteve evidenciale në kontekstin e përdorimit. Prandaj, habitorja duhet analizuar në kontekst, jo vetëm në mënyrë abstrakte.

Konteksti i të dhënave të mia është bisedat, që janë zhvilluar gjatë intervistave mbi variatetet e gjuhës shqipe. Biseda të tilla natyrisht lidhen me ideologjitë gjuhësore, “ide me të cilat pjesëmarrësit dhe vëzhguesit i interpretojnë njohuritë e tyre mbi varietetet gjuhësore dhe ua atribojnë ato njohuri njerëzve, ngjarjeve, dhe aktiviteteve që janë domethënëse për ta” (Gal & Irvine, 2000: 35). Funksionimi i habitores si krijues i distancës është i rëndësishëm në këtë kontekst sepse ideologjitë gjuhësore përftojnë diferencim. Prandaj, ky kontekst mund të zbulojë mënyrat e krijimit të diferencimit me anë të distancës.

Duke marrë parasysh Friedman (2012), unë përdor efektet evidenciale të Hanks-it (2012) dhe kornizën e pjesëmarrjes së Goffman-it (1974, 1981) për të sugjeruar që ndarja folës-jofolës mund të zbërthehet më tej dhe gjithashtu që habitorja kthen vëmendjen jo vetëm tek folësi, por edhe te dallimi që diskutohet në kontekstin e ndërveprimit. Për më

me rëndësi për analizën time.

tepër, ndërveprimi i roleve pjesëmarrëse dhe efekteve evidenciale në kontekstin e ligjëratës mbi ideologjitë gjuhësore prezanton aktin ligjërimor ku habitorja përdoret si tallje e bazuar në identitetet gjeografike-shoqërore (p.sh. Tirons, jugor) dhe delegjitimon varietet e shqipes me të cilat lidhen.

Metoda

Të dhënat në këtë analizë vijnë nga dy nga 14 intervistat metalinguistike që kam bërë me 19 të rinj (18-28 vjeç, të pamartuar, pa fëmijë) në Tiranë verën e vitit 2014. Përzgjedhja e mostrave ishte e qëllimshme (Oliver, 2006: 245-6), bazuar në rrjetin tim shoqëror. Isha e interesuar kryesisht për përdorimin e veçorive dialektore në këto intervista, por në këto dy intervista ku marrin pjesë më shumë se sa një folës, intervistat morën natyrë më bisedore dhe dolën përdorime interesante të habitores që i kam koduar. Intervistat e tjera akoma nuk janë koduar për përdorimet e habitores.

Habitorja në veprim

Shembulli i parë vjen nga një intervistë me tri kushërira: Luli, Ardita, dhe Viola. Të trija janë studente në Tiranë, por Viola dhe Ardita kanë përkatësisht dy vjet dhe një vit në Tiranë, ndërkohë që Luli ka pesë vjet. Kanë lindur dhe janë rritur në Librazhd (Luli), Pogradec (Ardita), dhe Prrenjas (Viola). Kjo e fundit është e rëndësishme në këtë fragment që tregon mënyrën në të cilën habitorja shërben për të kthyer vëmendjen tek raportet e ndryshme që vajzat kanë ndaj identiteteve gjeografike dhe gjuhësore.

Fragmenti 1:

1A: këtej nga Tirana për shembull,..ëh, ma- marules, që { }, janë fjalë domethënë.

2C: ëh hëh

3L: *çfarë është marulja? hë?*

4V: *ja* s'e ***dika*** kjo. sallatë [jeshile.]

5A: [sallata jeshile.]

6L: @@@

7A: si *i* thonë sallatë jeshile.

8L: ***edhe unë*** [sallatë jeshile them.]

9A: [thonë që andej::,] pjesa Pogradecit, flasim, domethënë [marulja, ***edhe unë*** mund ta them,] ...

10V: [***edhe unë*** marulja]

Në këtë fragment, vajzat flasin për dallimet dialektore që kanë hasur në Tiranë. Në radhën e parë, Ardita sjell si shembull fjalën *marule*, por në radhën e dytë Luli e ndërpret dhe pyet me pak padurim e ironi që përcillet me anë të *hë*-së se çfarë është *marule*. Pastaj Viola merr radhën dhe i drejtohet Arditës a jo Lulit. Përdorimi i deiktikes *ja* e kthen vëmendjen tek pyetja e Lulit që e përdor si bazë për inferencën që Luli nuk e di marulen. Pastaj në radhët 8, 9, dhe 10, vajzat marrin qëndrime ndaj variacionit duke treguar se cilën fjalë përdorin vetë.

Këtu Viola është folësi që fizikisht prodhon habitoren dhe zgjedh fjalët në propozim, por meqë informacioni është inferencë e bazuar në pyetjen e Lulit, Luli është përgjegjëse për informacionin. Prandaj, në formatin e prodhimit e kemi Violën si *Animatori* dhe *Autori*, por Lulin si *Principali*. Ndërkohë, në formatin e marrjes, Ardita është *addressed recipient* dhe Luli me mua jemi *unaddressed recipient*. Ky konfigurim dhe qëndrimet ndaj variacionit në fjalë bashkojnë Violën me Arditën, që janë nga qytete më në jug, dhe i largojnë nga Luli. Kjo sugjeron që inferenca që Luli nuk e di marulen është e bazuar jo vetëm në pyetjen e Lulit, por gjithashtu në ideologjitë e dallimeve gjeografike-gjuhësore mes Shqipërisë së mesme dhe Shqipërisë së jugut. Më në fund, për aq sa Viola është *Animatori* dhe *Authori* i zërit të Tjetrit gjuhësor, habitorja prezanton ndërveprimin si tallje, ku statusi i Lulit si e huaj për Shqipërinë jugore theksohet dhe statusi i dialektit të saj është vënë në pyetje.

Shembulli i dytë vjen nga një intervistë me dy shokë, Behar dhe Ergest. Behari është nga Vlora, por ka mbaruar shkollën e lartë në Itali. Tani ka disa vjet që jeton në Tiranë me familjen. Ergesti, edhe pse ka lindur në Pogradec, është rritur në Tiranë dhe ka shumë shokë Tironsë. Në këtë fragment, Ergesti flet për fjalët që i quan tipike Tironse. Në momentet

para këtij fragmenti, Ergesti thotë që *qyqja* "shpreh emocion", por Behari thotë që ai e di *qyqen* si tip shpendi që këndon natën. Ata qeshin për këtë.

Fragmenti 2:

1E: *ja* për shembull, Behar *në Vlorë*, *në Vlorë* i ***thoka*** qyqja asaj që ia bën [ko ko] @@

2B: [po]

3 si shpend që këndon natën. [a ke parasysh?]

4E: [@@@]

5C: [po po. po.] po e kam parasysh.

6B: po ashtu. pse? nuk i thonë *Tiranë* qyqja?

7E: jo:::. [s'i thonë asaj.]

8B: [gjithë *jugu* kështu i thonë.]

Si Viola në fragmentin e parë, Ergesti e fillon radhën e tij ku e përdor habitoren me *ja*. Kjo e kthen vëmendjen te komenti i Beharit pak sekonda para këtij fragmenti që *qyqja* është një shpend. Kjo ia bën këtij komenti bazën e inferencës për komentin që Ergesti përdor *qyqa* për t'iu referuar shpendit që këndon natën. Ergesti më drejtohet mua a jo Beharit, i cili thotë që është *në Vlorë*. Pastaj, ata ua atribojnë këto ndryshime gjuhësore ndryshimeve gjeografike.

Konfigurimi i roleve pjesëmarrëse i ngjan shumë rastit të fragmentit të parë. Ergesti zgjedh formën e ligjëratës dhe fizikisht e prodhon ndërkohë që Behari është përgjegjes për kuptimin. Prandaj, në formatin e prodhimit e kemi Ergestin si *Animatori* dhe *Authori* dhe Beharin si *Principal* dhe në formatin e marrjes jam unë *addressed recipient* dhe Behari është *unaddressed recipient*. Gjithashtu si në fragmentin e parë, ky konfigurim bashkë me ideologjitë e ndarjes gjuhësore mes Vlorës dhe Tiranës që përftohet si dhe me qeshjen e Ergestit prezantojnë ndërveprimin si tallje ndaj Beharit. Për më tepër, këta të dy përdorin fjalën "thonë" në mënyrën dëftore kur flasin për zonën gjeografike me të cilën identifikohen (radha e 7 dhe e 8). Kjo në kundërvënie me përdorimin e habitores në rast kur Ergesti flet për "Tjetrin", lejon që ata të radhiten me identitete të ndryshme gjeografike-gjuhësore.

Përfundime

Këto të dhëna tregojnë ndërveprimin mes efekteve evidenciale dhe roleve pjesëmarrëse në përdorimin e habitores. Në të dy shembujt, informacioni që shprehet me anë të habitores është *inferencë*, ose burimi i njohjes (Hanks, 2012: 173), e bazuar në atë ç'ka thënë Tjetri më përpara, në ideologjitë e ndarjes gjuhësore, dhe në informacionin mbi identitetin gjeografik të Tjetrit. Në fragmentin e parë, Viola merr si inferencë që Luli nuk e di marulën dhe në fragmentin e dytë, Ergesti merr si inferencë që Behari vetë i referohet shpendit që këndon natën me fjalën *qyqja*. Edhe pse asnjëra nga këto nuk janë formë evidencialiteti që tregojnë ligjëratë të zhdrejtë, gjithsësi Viola dhe Ergesti arrijnë të përfaqësojnë zërin e Lulit dhe Beharit. Pra, është burimi i ligjëratës (Hanks, 2012: 174). Dhe më në fund, meqë individi që luan rolin e *Principal*-it nuk është *Author*-i dhe *Animator*-i, habitorja prezanton ndërveprimin si tallje, që kategorizohet si forca shprehimore/ekspressive (Hanks, 2012: 175).

Distanca që krijohet me anë të talljes së habitores dhe aspekteve të tjerë deiktikë në ndërveprim bazohet në ideologjitë e ndarjes gjuhësore mes Tiranës/Shqipërisë së mesme dhe Shqipërisë së jugut. Friedman (2012: 218) vëren që habitorja sherben për të "prezantuar vetën si të rëndësishëm". Në këto të dhëna, habitorja prezanton edhe ndarjen gjuhësore si të rëndësishme për aq sa kthen vëmendjen te kjo ndarje. Me anë të roleve pjesëmarrëse, përdorimet e habitores ua atribuojnë njohurinë e praktikat të tjerëve, duke krijuar distancë që riprodhon ndarje gjeografike-gjuhësore dhe identitete përkatëse.

Carrie Ann MORGAN, Ohio State University

THE ADMIRATIVE AS SOCIAL ACTION IN THE CONTEXT OF LINGUISTIC IDEOLOGY

Summary

The interactional and social aspects of Albanian admirativity have been little studied. Using interactional data from conversations between friends and family members where linguistic variation is discussed, this analysis aims to shed light on these social and interactional functions. In analyzing evidential effects and voice, I show how admirativity contributes to more enduring geographic-linguistic divisions that are socially salient. In this way, I suggest that admirativity is also a tool for contructing language ideologies.

Referenca

Babel, Anna M. 2010. *Dizque*, evidentiality, and stance in Valley Spanish. *Language in Society*, 38, 487-511.

Bakhtin, M. M. 1963. Problems of Dostoevsky's Poetics. In Pam Morris (eds.) *The Bakhtin Reader*. New York: E. Arnold. 1994: 102-112.

Camaj, Martin. 1984. *Albanian Grammar with Exercises, Chrestomathy, and Glossaries*. Belgium: Otto Harrassowitz.

Demiraj, Shaban (ed.). 2002. *Gramatika e Gjuhës Shqipe, Vëllimi I: Morfologjia*. Tiranë: Akademia e Shkencave.

Friedman, Victor. 1986. Evidentiality in the Balkans: Bulgarian, Macedonian, and Albanian. *Evidentiality: The Linguistic Coding of Epistemology*, (Advances in Discourse

Processes, Vol. 20), ed. by Johanna Nichols and Wallace Chafe. Norwood, NJ: Ablex. 1986. 168-187.

---------.2003. Evidentials in Balkan Slavic, Albanian, and Turkish. *Turkish in Macedonia and Beyond: Studies in Contact, Typology and Other Phenomena in the Balkans and theCaucasus*. Wiesbaden: Harrassowitz, 2003.

---------.2004. The typology of Balkan evidentiality and areal linguistics. In Olga Mišeska Tomić (Eds.) *Balkan syntax and semantics,* 101-134. Amsterdam: John Benjamins.

---------.2005. "Admirativity: Between modality and evidentiality." Sprachtypologie und Universalienforschung 58(1):26-37.

---------.2012. Enhancing national solidarity through the deployment of verbal categories: How the Albanian admirative participates in the construction of a reliable self and an unreliable other. *Pragmatics and Society*. Vol. 3, issue 2, 189-225. 2012.

Gal, Susan & Irvine, Judith. 2000. Language Ideology and Linguistic Differentiation. In P. V. Kroskrity (ed.) *Regimes of Language* (pp. 35–84). Sante Fe, NM: School of American Research Press.

Goffman, Irvine. 1974. *Frame Analysis: An Essay on the organization of Experience*. Cambridge, MA: Harvard University Press.

Goffman, Irvine. 1981. *Forms of Talk*. Philadelphia: University of Pennsylvania Press.

Hanks, William F. 2010. Forward: Evidentiality in Interaction. *Pragmatics and Society*. 3:2.169 180.

Irvine, Judith T. 1996. Shadow Conversations: The Indeterminancy of Participant Roles. In Michael Silverstein and Greg Urban (eds.) *Natural Histories of Discourse*. Chicago: University of Chicago Press.

Mushin, Ilana. 2001. *Evidentiality and Epistemological Stance: Narrative Retelling*. Philadelphia: John Benjamins Publishing Company.

Newmark, L., Hubbard, P. & Prifti, P. 1982. *Standard Albanian: A reference grammar for students*. Stanford, CA: Stanford University Press.

Oliver, Paul. 2006. Purposive Sampling. In Victor Jupp (ed.) *The SAGE dictionary of social and cultural research methods*. Retrieved from: http://srmo.sagepub.com.proxy.lib.ohio- state.edu/view/the-sage-dictionary-of-social-research-methods/n162.xml

Shkumbin MUNISHI, Prishtinë

PIKËPAMJET PËR SHQIPEN STANDARDE TË ZHVILLUARA NË SHBA

Sfondi

Standardizimi i shqipes si proces i ndikuar nga faktorët jashtëgjuhësorë është i lidhur ngushtë dhe i përcaktuar nga ndryshimet e përgjithshme shoqërore dhe ideologjike, të cilat kanë ndodhur në hapësirat shqiptare gjatë shekullit XX. Ky proces i standardizimit të shqipes, për një kohë të gjatë, sidomos gjatë periudhës 1945-1990, ka qenë në vëmendjen e studiuesve shqiptarë kryesisht nga Shqipëria dhe nga Kosova dhe ka reflektuar mendimet dhe konceptet e kohës që janë zhvilluar brenda hapësirave shoqërore totalitare në të cilat kanë jetuar shqiptarët në Ballkan. Në këto diskutime për një periudhë të gjatë ka ekzistuar vetëm një e qëndrim zyrtar për shqipen standarde, për rrugën e formimit të saj, për bazën dialektore dhe për sistemin e saj, i cili është ndërtuar nga gjuhëtarët e Shqipërisë (kryesisht Androkli Kostallari) (Ismajli, 1978, 1998; Munishi, 2002, 2006, 2013) dhe është mbështetur e interpretuar në masë të madhe nga gjuhëtarët e Kosovës (p.sh. Ajeti 1973, 1980; Fadil Raka 1997 etj.). Duhet theksuar se deri në fillim të viteve ’90 të shek. XX zërat e vetëm që kundërshtonin pikëpamjet zyrtare për shqipen standarde shpreheshin nga autorë shqiptarë, të cilët jetonin dhe vepronin kryesisht në vendet perëndimore. Këtu, në radhë të parë, kemi parasysh pikëpamjet e shprehura nga Tahir Kolgjini (1974) dhe Arshi Pipa (1989).

Sa i përket trajtimit të çështjeve të standardizimit të shqipes jashtë trevave shqiptare në Ballkan, konkretisht në Shtete e Bashkuara të Amerikës, ato janë trajtuar nga një këndvështrim më neutral dhe më i pavarur.

Friedman (2002) thekson se standardizimin e shqipes nga pikëpamja amerikane mund ta vështrojmë në tre aspekte: 1) konteksti mërgimtar, 2) konteksti akademik, dhe 3) konteksti qeveritar, të cilët sidoqoftë janë kategori që mbivendosen me njëra-tjetrën. Fillimisht, ai vë në pah kontributin e gazetave shqiptare të publikuara në Amerikë nga fillimi i shekullit XX për diskutimet që zhvilloheshin në atë kohë për çështjet e drejtshkrimit të shqipes, sidomos për çështjen e alfabetit të shqipes dhe shton se para Luftës së Dytë Botërore në Amerikë kishte botime në variantet letrare të atëhershme të shqipes (toskërishte, elbasanishte etj.), ndërkaq studimet e ndryshime pas luftës përqendroheshin kryesisht në fushën e dialekteve të shqipes. Vetëm në fillim të viteve të '70 të shekullit XX kemi studimet e parë për fonologjinë e shqipes standarde nga Geri Bevington dhe për procesin e standardizimit të shqipes nga Jannet Byron (Friedman 2002: 155-156). Është pikërisht kjo e dyta që nga mesi i viteve '70 të shekullit të kaluar shfaqet me një studim të saj sociolinguistik për shqipen standarde, i cili mund të konsiderohet si një qasje objektive në trajtimin e procesit të standardizimit të shqipes. Më vonë, më 1989 del botimi tjetër i autorit shqiptar që jetonte në SHBA, Arshi Pipës, me titull "The Politics of Language in Socialist Albania" në të cilin shfaqen pikëpamje krejtësisht kundërshtuese lidhur me rrugën që ishte ndjekur për standardizimin e gjuhës shqipe në Shqipëri. Në kuadër të trajtimit të pikëpamjeve të këtyre dy autorëve për standardizimin e shqipes është me interes të shihet se çfarë pikëpamjesh kanë shprehur këta dy autorë për rrugën e formimit të shqipes standarde, për bazën dialektore, për sistemin e saj, si dhe për rolin që kanë luajtur faktorët jashtëgjuhësorë, politikë, kulturorë dhe shoqërorë, në këtë proces. Duke qenë se këto pikëpamje janë shprehur në një ambient jashtë trevave shqiptare, pra në SHBA, dhe nga autorë prej të cilëve njëra ishte amerikane e tjetri me origjinë shqiptare, është me rëndësi të shihet se sa përputhen dhe sa ndryshojnë pikëpamjet e këtyre dy autorëve për formimin e shqipes standarde.

Pikëpamjet e Byron-it dhe të Pipës për formimin e shqipes standarde

Janet L. Byron është studiuesja e parë e huaj që u mor në mënyrë të veçantë me trajtimin e ecurisë së standardizimit të shqipes pas Luftës së Dytë Botërore. Qasja e Byron-it është sociolinguistike dhe bazohet në konceptet e planifikimit gjuhësor dhe të politikës gjuhësore. Pikënisja e saj ishte një përpjekje të re më gjithëpërfshirëse, për ta trajtuar procesin e standardizimit të shqipes dhe dallonte nga qasja e autorëve shqiptarë të asaj periudhe që mund të konsiderohet më e ndikuar nga kuadri i ideologjisë sunduese në Shqipëri. Këtë trajtim sociolinguistik të rrugës së formimit të shqipes standarde ajo e mbështeste në konceptet e autorëve, si Punya Sloka Ray, Einar Haugen-i, Valter Tauli dhe Jiri V. Neustupný, të cilët në mënyrë teorike përvijuan drejtimet të cilat i ndjekin gjuhët standarde në proceset e planifikimit të gjuhëve. (Byron, 1976: 17-30).

Për ta trajtuar standardizimin e shqipes, Byron-i niset nga një përshkrim kronologjik i zhvillimeve kryesore në shqipe që nga Rilindja Kombëtare e këndej, si dhe nga përshkrimi i tipareve kryesore dalluese dhe i tipareve të përbashkëta të dy dialekteve të shqipes. Sa u përket nismave të para për normimin e shqipes ajo është në një linjë me pikëpamjet e autorëve shqiptarë, që konstatojnë me të drejtë se Rilindja Kombëtare ishte periudha kur u shprehën pikëpamjet e para për nevojën e formimit të shqipes standarde. Kjo gjë kishte ndodhur për arsye se rilindësit gjuhën e shihnin si një mjet përbashkues për kombin (f. 39), ndonëse kemi të bëjmë me ide të përgjithshme, pa elaborime më të thella lidhur me rrugët eventuale të cilat duhej të ndiqeshin (f. 53). Rilindja Kombëtare dhe rrethanat historike në të cilat ka ndodhur ajo, si dhe sfondi ideologjik i saj, padyshim i kanë krijuar rrethanat për shfaqjen e pikëpamjeve për nevojën dhe për rëndësinë e krijimit të shqipes standarde.

Më tej, kjo autore ndalet në trajtimin e dialekteve të shqipes dhe në këtë kuadër konstaton afërsitë midis dialekteve të shqipes dhe kuptueshmërinë reciproke të tyre, por përshkruan edhe dallimet sistemore, të cilat ekzistojnë midis toskërishtes dhe gegërishtes. Dallimet më të mëdha

midis toskërishtes dhe gegërishtes sipas Byron-it shfaqen në rrafshin fonetik, sidomos në vokalizëm dhe më pak në konsonantizëm, ndërkaq dallimet morfosintaksore janë edhe më të kufzuara. Byron-i identifikon pesë dallime kryesore që ekzistojnë midis toskërishtes dhe gegërishtes. Në këtë mes ajo ka parasysh: dukurinë e rotacizmit në toskërishte dhe mungesën e kësaj dukurie në gegërishte; dallimet në grupet nistore *va* për toskërishten dhe *vo* për gegërishten; ekzistencën e *ë*-së së theksuar në toskërishte, së cilës në gegërishte u përgjigjen një *â* dhe *ê*; dukurinë e nazalizimit, e cila është e pranishme në gegërishte dhe mungesën e kësaj dukurie në toskërishte; dhe, së fundi, ekzistencën e formave të paskajores në gegërishte të tipit *me punue*, së cilës në toskërishte i përgjigjen format e pashtjelluara të tipit *për të punuar* dhe format e lidhores së foljeve. Më tej, ajo paraqet edhe dallimet e tjera midis dialekteve, por konsideron se këto pesë tipare paraqiten si dallime më kryesore (f. 43-44). Përveç dallimit të grupeve nistore *va-vo* midis dy dialekteve, i cili paraqitet si dallim në një numër të kufizuar fjalësh dhe që nuk çon peshë, Byron-i konstaton me të drejtë se dallimet e tjera janë praktikisht dallimet me thelbësore sistemore midis dy dialekteve të shqipes.

Në vazhdim të trajtimit të saj, ajo përshkruan përpjekjet për standardizimin e shqipes para vitit 1945 dhe konstaton me të drejtë se që nga Kongresi i Elbasanit dhe pastaj me Komisin Letrare të Shkodrës, dialekti qendror, jo krejtësisht e folmja e Elbansanit, u ngrit në normë dhe u përdor si gjuhë me status zyrtar deri më 1944. Pas luftës, elbasanishtja nuk favorizohej më dhe mbase qëndrimet zyrtare ndaj kësaj norme kishin qenë negative (f. 57-58). Më tej, duke përshkruar rrjedhat e planifikimit të shqipes pas LDB, ajo konstaton se toskërishtja me mbështetjen e elitës politike të kohë që me origjinë ishte me shumicë kryesisht nga zonat jugore të Shqipërisë, po bëhej gjuhë standarde. Në të vërtetë, ajo konstaton se deri nga mesi i viteve ’60 të shekullit XX në opinion mbizotëronte pikëpamja se shqipja standarde ishte toskërishtja dhe ky qëndrim u shpreh haptas në sesionet e vitit 1952. Më pas, ky qëndrim u ndryshua, sidomos nga Androkli Kostallari, i cili në shkrimet e tij të shumta për shqipen standarde i mbronte qëndrimin se shqipja standarde ishte përzierje

dialektesh, apo koine letrare *sui generis*, siç dëshironte ta quante ai (sh.m.) (f. 59-62). Ky konstatim bazohej në ekzistencën e disa elementeve të përbashkëta në gjuhën standarde. Por, Byron-i ndonëse njeh një shkallë të përzierjes së dialekteve përbrenda shqipes standarde për shkak të pranisë së elementeve të gegërishtes, hedh poshtë pikëpamjen se shqipja standarde është përzierje dialektesh. Pikëpamjen e saj të kundërt ajo me të drejtë e bazon në faktin se nga pesë izoglosat kryesore, siç i quan ajo, të cilat ekzistojnë midis toskërishtes dhe gegërishtes, të gjitha alternativat përkatëse të toskërishtes janë ngritur në normë (f. 62-65). Sipas saj, elementet e caktuara të gegërishtes që janë përfshirë në standard, dhe këtu e ka fjalën për grupin zanor *ue* dhe për përemrin pronor *i vetë*, mund të konsiderohen si huazime të gegërishtes në toskërishte dhe rrjedhimisht në standard (f. 62). Këto forma alternative të gegërishtes ajo i quan me terma të Joshua Fishman-it, si "forma të dëshirueshme kundrejt formave të padëshirueshme", të cilat janë lënë jashtë standardit, siç janë p.sh. pjesoret e shkurtuara dhe paskajorja e gegërishtes. Këto elemente të dëshirueshme mbase janë pranuar edhe për faktin se qenë përdorur më parë në toskërishten letrare, por edhe në dokumentet e shkruara të lëvizjes komuniste gjatë LNÇ-së. Këto elemente, sipas saj, duket të kenë qenë elemente të cilat i kanë mbuluar zbrazëtitë që i ka pasur toskërishtja (f. 88-89). Duke u nisur nga dallimet dialektore dhe nga përshkrimi i sistemit fonologjik-fonetik dhe morfosintaksor i shqipes standarde, ajo konstaton me të drejtë se baza dialektore dhe shqipja standarde, në përgjithësi, mbështeten në dialektin e jugut.

Së fundi, kur kemi parasysh pikëpamjet e Byron-it për shqipen standarde, duhet shtuar se në rastin e pranimit të normës, sidomos në Kosovë, ajo ka përmendur me të drejtë motivet kombëtare që i çuan shqiptarët e trevave shqiptare në ish-Jugosllavi ta pranojnë Projektin e Rregullave të Drejtshkrimit të vitit 1967 (Byron 1979).

Qëndrimi ndaj këtyre pikëpamjeve të Janet Byron në gjuhësinë shqiptare fillimisht ka qenë refuzues dhe mohues. Ky refuzim dhe ky mohim në fillim ka ardhur nga Androkli Kostallari. Ndonëse në punimet e

tij nuk kam gjetur gjëkundi të ketë bërë një paraqitje të pikëpamjeve të saja dhe pastaj t'i diskutojë ato me argumente shkencore, për qëndrimet e Byron-it, Kostallari shprehej se: "nga pozita aprioristike, në ndonjë punim të veçantë janë bërë edhe përpjekje për ta futur mekanikisht formimin e shqipes letrare të njësuar në disa skema të përgjithshme të sociolinguistikës së sotme. Ndër to bie në sy sidomos monografia e Xhenet Bajronit me titull "Përzgjedhja ndërmjet alternativave në standardizimin e gjuhës: Rasti i shqipes" botuar nën drejtimin e sociolinguistit të njohur Xhoshua Fishman"... "Në këtë vepër, që përmban mjaft pohime kundërthënëse, formimi i shqipes letrare të njësuar trajtohet në mënyrë të shtrembëruar e të thjeshtëzuar. Përfundimet themelore që jepen aty nuk kanë dalë nga analiza e thelluar e objektive e sistemit dhe e nënsistemeve të gjuhës letrare shqipe, të parë në zhvillimin e saj të pandërprerë, në lidhje të ngushtë me faktorët shoqëror e me dialektet, sidomos nga epoka e Rilindjes Kombëtare. Ato janë nxjerrë në mënyrë subjektive, duke zbatuar mekanikisht e në mënyrë eklitike për shqipen teza e përfundime të një vargu sociolinguistësh si Punya Sloka Rey, Einar Haugen, Valter Tauli, Jiri V. Neustupny, Joshua A. Fishman, Charls A. Ferguson etj. të cilët, siç dihet, kanë trajtuar, mjaft herë nga pozita të ndryshme e të njëanshme, aspekte të përgjithshme të 'standardizimit' të gjuhëve e çështje të gjuhëve të veçanta, sidomos joeuropiane, por nuk kanë pasur asnjëherë si objekt studimi gjuhën shqipe" (Kostallari, 1984: 37).

Në anën tjetër, pikëpamjet e saj, jo vetëm që janë paraqitur besnikërisht, por në masë të konsiderueshme janë quajtur të qëndrueshme, fillimisht nga Ismajli, dhe pastaj nga Beci, Munishi dhe autorë të tjerë. Këto pikëpamje kanë kontribuar në mënyrë vendimtare në ruajtjen e së vërtetës shkencore në studimet të cilat synojnë ta trajtojnë procesin e standardizimit të shqipes në mënyrë shkencore dhe pa shtrëngesa politike e ideologjike. Në trajtimet e saj, Byron-i merr parasysh çështjet gjuhësore, të cilat paraqiten me një rigorozitet dhe me transparencë të theksuar shkencore, por njëkohësisht jepen edhe faktorët jashtëgjuhësore, kryesisht ata politikë dhe kulturorë, që kanë luajtur rol ndoshta kryesor në këtë proces. Pikërisht kjo përmbledhje e argumenteve gjuhësore dhe

jashtëgjuhësore e bën studimin e saj të jetë i argumentueshëm dhe të ketë karakter të qëndrueshëm shkencor. Pikëpamjet e Byron-it janë parë edhe si një mundësi e mirë për t'u marrë për bazë në procesin eventual të rishqyrtimit të normës aktuale të shqipes standarde (Kolgjini J M. 2013).

Trembëdhjetë vjet pas botimit të librit të Byron-it, në SHBA del në dritë edhe një botim tjetër që trajton procesin e formimit të shqipes standarde, këtë herë i shkruar nga një autor shqiptar që jetonte në SHBA. Është ky libri "The Politics of Language in Socialist Albania" i autorit Arshi Pipa. Në këtë libër autori është marrë kryekëput me çështjen e formimit të shqipes standarde, duke e trajtuar këtë proces, sikurse Byron-i, edhe në rrafshin e sistemit gjuhësor, edhe në rrafshin jashtëgjuhësor. Trajtimin e procesit të standardizimit të shqipes Pipa e fillon me paraqitjen e përpjekjeve që janë bërë në Kongresin e Manastirit dhe në Komisin Letrare të Shkodrës për normimin e alfabetit dhe për afrimin e dialekteve. Që në fillim Pipa konstaton se Komisia Letrare e Shkodrës me rastin e përzgjedhjes së elbasanishtes dhe përcaktimit të normës drejtshkrimore në disa raste të sistemit fonetik, siç janë: ruajtja e *ë*-së heqja e shenjave diakritike për zanoret e gjata, përdorimi i kufizuar i shenjave diakritike të hundorësisë, ruajtja e diftongjeve *ue*, *ie*, *ye* dhe përdorimi i grupeve të bashkëtingëlloreve *mb*, *nd*, *ngj*, kishte bërë lëshime ndaj toskërishtes. Prandaj, sipas tij, "duke i bërë këto koncesione ndaj toskërishtes, Komisia Letrare e Shkodrës, në fakt, shkatërroi parimin fonetik, që ishte fondamentale për projektin e saj reformues. Me fjalë të tjera, zelli patriotik prishi rigorozzitetin shkencor" (Pipa 1989: 3).

Sa i përket pranimit të shqipes standarde, sidomos nga shqiptarët e trevave shqiptare në ish-Jugosllavi, për dallim nga Byron-i, Pipa sheh motivime ideologjike, mbase të paqena. Ai konstaton se, "duke pranuar gjuhën zyrtare të Shqipërisë staliniste, ata (shqiptarët e Kosovës, sh.m.) identifikuan veten me stalinizmin shqiptar, duke u konfrontuar kështu me qëndrimin antistalinist jugosllav" (f. 5). Duket se sa u përket rrjedhave të përgjithshme në Kosovë dhe në trevat shqiptare në ish-Jugosllavi, Pipa mund të mos ketë pasur njohuri të duhura dhe si shembull mund të me-

rren toponimet e qyteteve ku banojnë shqiptarët që ai i shkruan në versionin serb, si p.sh. Ohrid e Ferizović (f. 186), pa dashur të spekuloj për arsyet e tjera.

Më tej, duke u marrë me sistemin gjuhësor, Pipa trajton dallimet dialektore midis gegërishtes dhe toskërishtes dhe njëkohësisht tregon se cilat alternativa përkatëse të të dy dialekteve të shqipes janë ngritur në normë. Në këtë pikë, pra në trajtimin e çështjeve gjuhësore, ky autor mbështetet në masë të madhe në pikëpamjet e Byron-it. Me fjalë të tjera, në trajtimin e çështjeve të planifikimit të korpusit të shqipes Pipa mbetet brenda kuadrit të diskutimit gjuhësor të Byron-it duke e mbështetur atë. Kjo vërehet më së miri në qasjen që ka ky autor ndaj pranisë së elementeve të gegërishtes në shqipen standarde, të cilat, sikurse Byron-i, i quan elemente të gegërishtes të huazuara në shqipen standarde për ta plotësuar boshllëkun e atyre njësive gjuhësore që nuk i ka toskërishtja. Prandaj, ai thekson se njësimi i shqipes standarde në të vërtetë është një njësim i dialektit letrar toskë, i bazuar në toskërishten letrare tradicionale me shumë pak përmirësime dhe me futjen e vetëm disa tipareve fonologjike të gegërishtes (f. 28). Po ashtu, duhet përmendur se Pipa i përshkruan një rol qendror Androkli Kostallarit në procesin e formimit të shqipes standarde ose, siç e quan ai, 'shqipes letrare të njësuar'. Në të vërtetë, diskutimi i problemit të formimit të shqipes standarde i përshkruar në librin e Pipës, gradualisht vjen e bëhet polemikë i tij me Kostallarin lidhur me shqipen standarde.

Në kapitujt e tjerë, diskutimi i tij del jashtë premisave linguistike dhe futet në rrafshin jashtëgjuhësor politik e kulturor. Në këtë kuadër, Pipa trajton rolin që kanë luajtur faktorët politikë, ideologjikë e kulturorë për njësimin e shqipes standarde mbi bazën e toskërishtes letrare. Ç'është e vërteta, libri i tij merr fizionominë e një pamfleti politik polemizues pikërisht me mënyrën e trajtimit të këtyre faktorëve jashtëgjuhësorë që kanë përcaktuar fatin e shqipes standarde. Në këtë frymë ai konstaton se në aspektin kulturor, 'gjuha letare e njësuar shqipe' është një stratagemë politike planifikuar për të siguruar hegjemoninë kulturore të pjesës minoritare të kombit ndaj pjesës tjetër. Është një instrument i forcës për të

siguruar dhe vazhduar fuqinë përbrenda një rrethi të kufizuar të atyre që janë në fuqi (f. 98), në sfondin pragmatik politik, 'gjuha letrare e njësuar shqipe' është ajo që është për shkak se Partia deshi që ajo të jetë instrument që do t'i shërbejë Partisë (f. 99), ndërkaq në rrafshin ideologjik 'gjuha e njësuar letrare' është një përzierje e teorive kontradiktore të Marr-it dhe Stalin-it, apo në gjuhën që reflekton specializimin gjuhësor të Kostallarit, një përbërje Stalin-Marr e tipit 'gjysmënjeri' dhe 'gjysmëkalë', dy pjesë që nëse vendosen së bashku rezultojnë me një kentaur" (f. 186).

Në fund të trajtimit të pikëpamjeve të Pipës, duhet theksuar se pikëpamjet e tij janë parë me sy kritik dhe janë quajtur si pikëpamje që u mungon njohja e realitetit dhe sfondi shkencor. Në këtë frymë shprehet edhe Xhevat Lloshi, i cili thekson: "e shoh të drejtë, që të gjitha këto gabime në monografinë e A. Pipës t'i quaj si pasojë jo të faktorëve të pavetëdijes frojdiane, por të vetëdijes tejet të politizuar dhe të impotencës shkencore" (Lloshi 1997: 47). Ismajli (1998), në anën tjetër, hedh krejtësisht poshtë konstatimet e Pipës lidhur me motivet që i kanë çuar shqiptarët e trevave shqiptare në ish-Jugosllavi ta pranojnë shqipen standarde. Ai konstaton se, "pranimi i shqipes letrare të njësuar nga shqiptarët e Jugosllavisë po bëhej për nevojat e tyre, të zhvillimit shoqëror, kulturor e gjuhësor, dhe jo për t'u identifikuar me stalinizmin e Tiranës, siç mendonte Pipa (f. 195). Pikëpamjet e Pipës janë trajtuar edhe nga Beci (2000), por ai përtej paraqitjes së tyre nuk shkon përtej konstatimit se "ndoshta Pipa shkon larg në interpretimet e tij" (f. 35).

Konsiderojmë se për ta trajtuar rrugën e formimit të shqipes standarde edhe ky autor ka marrë parasysh zgjedhjet që janë bërë në rrafshin e planifikimit të korpusit dhe përtej tyre, ndikimin e faktorëve jashtëgjuhësor. Por, nëse krahasojmë pikëpamjet e Byron-it me pikëpamjet e Pipës, mund të konstatohet se e para ka bërë një shtjellim më të thellë të elementeve gjuhësore të këtij procesi pa lënë anash ndikimin e faktorëve jashtëgjuhësorë dhe pa u thelluar shumë në diskutime ideologjike. Ndërkaq, i dyti ka shtjelluar më shumë faktorët jashtëgjuhësor dhe rolin e tyre. Megjithatë, të dy pajtohen në një pikë, se gjuha standarde shqipe është

toskërishtja letrare e ngritur në normë me disa elemente të kufizuara të gegërishtes që më tepër i mbulojnë ato njësi gjuhësore të cilat nuk i ka pasur toskërishtja.

Përfundime

Pikëpamjet e Janet Byron-it dhe të Arshi Pipës për procesin e standardizimit të shqipes janë me mjaft interes për historinë e standardizimit të shqipes. Byron-i ishte e para që në kuadrin socialinguistik dhe me argumente shkencore, kishte përshkruar drejt dhe në mënyrë të paanshme rrugën që ishte ndjekur në standardizimin e shqipes, sidomos nga viti 1945 e këndej. Në këtë kuadër ajo ka nxjerrë në pah tri të vërteta të pamohueshme. Së pari, se pas Luftës së Dytë Botërore qe ndërprerë zhvillimi i dialektit qendror (elbasanishtes) në gjuhë standarde, që kishte marrë hov nga Komisia Letrare e Shkodrës deri më 1945. Më tej, se në rastin e përzgjedhjes së bazës dialektore të shqipes standarde pas vitit 1945, establishmenti komunist i kohës në Shqipëri kishte luajtur rol vendimtar, duke e mbështetur dialektin e Jugut dhe në fund, nga pesë dallimet kryesore dialektore midis toskërishtes dhe gegërishtes, që të pesë format alternative të toskërishtes janë ngritur në normë, duke e ngritur kështu toskërishten letrare në nivel të gjuhës standarde, e cila u normua pastaj në vazhdimësi nga viti 1947 e këndej. Siç kemi theksuar më parë, pikëpamjet e Byron-it, ndonëse për një kohë të gjatë nuk u bënë publike në gjuhësinë shqiptare, erdhën në kohët kur e vërteta për shqipen standarde dhe për procesin e normimit të saj po fshihej dhe po retushohej nga gjuhëtarët shqiptarë të kohës, pa ndonjë arsye të fortë praktike, por më shumë për arsye të luftës ideologjike dhe politike klasore (Munishi 2013).

Në anën tjetër, në rastin e pikëpamjeve të Arshi Pipës, mbizotëron diskutimi i bazuar në çështjet e natyrës jashtëgjuhësore. Pipa po ashtu trajton rrjedhojat e përpjekjeve për planifikimin e korpusit të shqipes standarde pas Luftës së Dytë Botërore, duke konstatuar me të drejtë se në këtë proces dominimi i njësive të toskërishtes është mbizotërues. Por, pastaj diskutimi i tij thellohet shumë më tepër në rrafshin ideologjik,

politik e kulturor. Këtu e tutje pastaj ndodh shkarja e tij nga diskutimi shkencor i argumentuar në një retorikë të pastër të bazuar po ashtu në një sfond tjetër ideologjik. Përpjekja e Pipës për ta trajtuar politizimin e procesit të standardizimit të shqipes që qe bërë në periudhën e diktaturës komuniste kalon në polemikë ideologjike e kulturore që ai zhvillon në distancë me protagonistët e politikës gjuhësore të kohës në Shqipërinë socialiste, kryesisht me Androkli Kostallarin. Ç'është e vërteta disa pohime të Pipës për stigmatizimin që i është bërë gegërishtes dhe rrjedhimisht edhe kulturës që lidhet me këtë varietet në periudhën e diktaturës, qëndrojnë këmbë e kryet. Por, përtej këtyre pohimeve, diskursi i tij i mbushur përplot epitete e sajesa ideologjike personale, zbeh argumentimin shkencor dhe filozofik dhe për pasojë bëhet i njëanshëm dhe manipulues.

Në fund, konsiderojmë se vlera më domethënëse e pikëpamjeve të Byron-it dhe Pipës qëndron në argumentet që kanë sjellë ata lidhur me bazën dialektore dhe me tiparet kryesore të procesit të planifikimit të korpusit të shqipes standarde. Edhe shpalosja e ndikimit të faktorëve politikë, ideologjikë e kulturorë nga këta dy autorë, ka ndikuar në paraqitjen e drejtë të rrethanave historike e politike në të cilat është përfunduar procesi i standardizimit të shqipes. Për këtë arsye, pikëpamjet e këtyre dy autorëve që u ndërtuan në SHBA janë të pashmangshme sa herë që trajtohen çështjet që kanë të bëjnë me standardizimin e gjuhës shqipe.

Referenca

Ajeti, Idriz (1973). Rruga e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe në Kosovë. Studime filologjike.
Ajeti, Idriz (1980). Probleme aktuale të kulturës së gjuhës. Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe. Instituti Albanologjik. Prishtinë 1983.
Ajeti, Idriz-Lafe, Emil (1998). Njëzet e pesë vjet nga Kongresi i Drejtshkrimit (Vlerësime dhe vështrimen në të ardhmen). Studime filologjike 1-2. Tiranë.
Beci, Bahri (2000). Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri. Dukagjini. Pejë.
Buletin për Shkencat Shoqërore IV, Tiranë 1952
Byron, Janet L. (1976). Selection among alterantes in language standardization: The case of Albanian. Mouton, The Hague, Paris. Printed in Netherlands.
Byron, Janet L. (1979). Language Planning in Albania and in Albanian-Speaking Yugoslavia, Word vol. 30. nr. 1-2. April-August.
Dodëbiba, Lirak (1952). Mbi gjuhën letrare kombëtare. Buletin për Shkencat Shoqërore IV. Tiranë.
Friedman, Victor (2002). Shqipja standarde në Amerikë: studime shkencore, pedagogjike dhe planifikimi gjuhësor. Konferenca shkencore "Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot". Tiranë, 11-12 nëntor 2002. Shtëpia botuerse "Shkenca". Tiranë. 2003.
Ismajli, Rexhep (1998). "Në gjuhë" dhe "për gjuhë" (Rrjedhat e planifikimit të shqipes në Kosovë 1945-1968). Dukagjini. Pejë.
Kolgjini, Tahir (1974). Shqiptarët në Jugosllavi dhe gjuha e unjisuar, Shêjzat – Gli Pleiadi 1-10. Romë.
Kolgjini, Julie M. (2013). Për (ç)pengimin e gjuhës shqipe në kohën postmoderne, marrë shkas nga kontributi i Janet Byron në dritën e rishqyrtimit të standardit aktual. Seminarit XXXII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Prishtinë.
Kostallari, Androkli (1984), Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë. Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë (Materiale të Konferencës shkencore të mbajtur në Tiranë më 7-8 dhjetor 1984). Tiranë 1988.
Luka, David (1993). Përse ithtarët e Kongresit të Drejtshkrimit nuk e pranojnë debatin shkencor. Hylli i dritës 2-3. Tiranë.
Lloshi, Xhevat (1997). Mbështetje për gjuhën letrare. Toena. Tiranë.
Munishi, Shkumbin (2002). Pikëpamjet e Androkli Kostallarit për shqipen standarde. Zero Print. Prishtinë 2013.
Munishi, Shkumbin (2007). Pikëpamjet e Idriz Ajetit për bazën dialektore të gjuhës standarde shqipe. ASHAK. Prishtinë.
Munishi, Shkumbin (2013). Kontributi i Janet Byron për historinë e standardizimit të shqipes. Seminarit XXXII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Prishtinë.
Myderrizi, Osman (1952). Problemi i gjuhës letrare të përbashkët. Buletin për Shkencat Shoqërore IV. Tiranë.
Pipa, Arshi (1989). The Politics of Language in Socialist Albania. Columbia University Press. New York.
Raka, Fadil (1997). Historia e shqipes letrare. Universiteti i Tetovës. Blendi. Prishtinë.
Shuteriqi, Dhimitër S. (1952). Mbi gjuhën letrare kombëtare. Buletin për Shkencat Shoqërore IV. Tiranë 1952.

Shkumbin MUNISHI, Prishtinë

VIEWS ON STANDARD ALBANIAN DEVELOPED IN USA

Summary

In this paper were discussed main views regarding the standard Albanian and the paths that are followed for its standardization, which were developed in the United States. Within this framework, we were considered views of two authors, Jannet Byron and Arshi Pipa, who have operated in the United States. In this context, a comparison of views of these two authors associated with standard Albanian and Albanian standardization process in general was made. The primary purpose was to compare, on the one hand, the views and arguments of an American author and to discuss her its main thesis for the standardization of the Albanian language, and, on the other hand, the views of a dissident Albanian author who lived and operated in the US. Through this presentation is intended to distinguish starting points from which are launched these two authors to describe the Albanian standardization.

Jannet Byron's and Arshi Pipa's views on the standardization process of the Albanian represent great interest to the Albanian standardization history. Byron was the first, who had described fairly and impartially path that was followed in the standardization of the Albanian language, especially from 1945 onwards, within sociolinguistics framework and scientific arguments. In this context, she highlighted three undeniable truths. First, that after the Second World War the development of the central dialect (Elbasanishte) in standard language was interrupted, which had taken off from Komisia Letrare e Shkodrës 1916-1918 (Shkodra Literary Commission) until to 1945. Further, in the case of selecting dialect base of the standard Albanian after 1945, communist establishment at that time in Albania played a decisive role by supporting the dialect of the South. In the end, among the five main dialectal differences between Tosk and Gheg, all five alternative forms of Tosk are included in the codification of Standard Albanian norm, thus raising Tosk literary language at a level of standard language, a path which was pursued from 1947 and onwards. As noted in the paper, Byron's views, although for a long time were not made public in Albanian linguistics, came at a time when the truth regarding the Standard Albanian codification and its language planning was hidden and fabricated by linguists in Albania and to a certain degree in Kosova without any practical reason, but more because of ideological and political class struggle (Munishi 2013).

On the other hand, in the case of Arshi Pipa's views, there is a dominant discussion based on extra linguistic issues. Pipa also addressed the consequences of the efforts of the Albanian corpus planning after World War II, concluding correctly that in this process the domination of Tosk language units is prevalent. But then his discussion deepened much more in the field of ideological, political and cultural arguments. Hereinafter, going further

his reasoned scientific discussion turns into a pure rhetoric based discussion on another ideological background. Pipa's effort to address the politicization of the process of standardization of Albanian that was done in the period of the communist dictatorship, skips into a controversial deliberation that he develops with the key players of that time in the language policy of socialist Albania, mainly with Androkli Kostallari. Indeed, some of Pipa's statements made to the Gheg stigmatization and consequently the culture stigmatization associated with this variety during the dictatorship, cannot be refuted. But beyond these assertions, his discourse which becomes packed with attributes and fabrications on ideological, scientific and philosophical grounds overshadows arguments and thus becomes biased.

Finally, it should be taken into account that the most significant values of Byron's and Pipa's views lies in the arguments that they have brought about dialectal basis and the main features of the planning process of Standard Albanian corps. Even the disclosure of the impact of political factors, ideological and cultural of these two authors, has affected the fair presentation of the historical and political circumstances in which the process of standardization of the Albanian was pursued after Second World War. For this reason, the views of these two authors that were built in the US are inevitable when dealing with issues related to standardization of the Albanian language.

Julie KOLGJINI, PhD, Rochester Institute of Technology/ A.U.K.

AN EXAMINATION OF AESTHETIC TRANSGRESSIONS OF ALBANIAN STANDARD LANGUAGE IDEOLOGY: THE CASE OF MIFTAR SPAHIJA

1.0 Introduction

Throughout the past few decades standard language ideology and language choice, in particular involving spoken and written modes of communication, have been investigated extensively for numerous languages (e.g. American and British English). Few contemporary inquiries, however, have examined the incurporation of alternative linguistic resources and repertoires of the often stigmatized (sub)varieties of Albanian, including those in the literary works of the often-overlooked Albanian-American Miftar Spahija, as legitimate options. Paralleling the implementation of the hegemonic standard language ideology of Unified Literary Albanian (ULA), while also refusing to acquiesce to its fixed linguistic resources, Spahija (1990, 1998) pursues a trajectory that explores dynamic continuities across and within linguistic varieties. In doing so, he embarks upon a course similar to that of some of his predecessors and contemporaries, e.g. Ernest Koliqi and Martin Camaj, among others. Spahija aesthetically interweaves elements of linguistic hybridity, polycentrism, codemeshing, (trans)languaging, innovative coinages, ludic components, as well as dynamic linguistic resources (see Pennycook and Otsuji 2014, 2015), among other mechanisms, within a fluid system, as is often celebrated in post-structuralist as well as late and post-modern accounts of language usage practices. Rather than succumbing to restrictting his linguistic resources to one rigid edifice, he pushes the boundaries of multiple systems, and by doing so captures the essence of linguistic agency – of the

Balkan and South Slavic Linguistics, Literature and Folklore Conference, The Ohio State

University in Columbus (15-18 April).

KOLIQI, ERNEST. 2000. *Tregtar flamujsh*. Shkodër: Camaj-Pipa.

KOLIQI, ERNEST. 2001. *Pasqyrat e narçizit: Tregime*. Shkodër: Camaj-Pipa.

KOLIQI, ERNEST. 2004. *Hija a maleve*. Shkodër: Camaj–Pipa.

KRAMSCH, CLAIRE. 2012. Imposture: A late modern notion in poststructuralist SLA research. *Applied Linguistics* 33.5.483–502.

LEMKE, JAY. 2002. Language development and identity: Multiple timescales in the social ecology of learning. *Language acquisition and language socialization*, ed. by C. Kramsch, 68–87. London: Continuum.

LIN, ANGEL. 2014. Hip-hop heteroglossia as practice, pleasure, and public pedagogy: Translanguaging in the lyrical poetics of '24 Herbs' in Hong Kong. *Heteroglossia as practice and pedagogy*, ed. by A. Blackledge and A. Creese, 119–136. Dordecht: Springer.

LINK, HOLLY, SARAH GALLO, AND STANTON WORTHAM. 2014. 'Gusame ka' lata!: Faux Spanish in the new Latino diaspora. *Heteroglossia as practice and pedagogy*, ed. by A. Blackledge and A. Creese, 255–273. Dordecht: Springer.

LOW, BRONWEN and MELA SARKAR. 2014. Translanguaging in the multilingual Montreal hip-hop commununity: Everyday poetics as counter to the myths of the monolingual classroom. *Heteroglossia as practice and pedagogy*, ed. by A. Blackledge and A. Creese, 99–118. Dordecht: Springer.

MAKONI, SINFREE. 2014. 'The Lord is my shock absorber': A sociohistorical integrationist approach to mid-twentieth century literacy practices in Ghana. *Heteroglossia as practice and pedagogy*, ed. by A. Blackledge and A. Creese, 75–97. Dordecht: Springer.

MADSEN, LIAN MALAI. 2014. Heteroglossia, voicing and social categorisation. *Heteroglossia as practice and pedagogy*, ed. by A. Blackledge and A. Creese, 41–58. Dordecht: Springer.

MILROY, JAMES. 2001. Language ideologies and the consequences of standardization. *Journal of Sociolinguistics* 5.4.530–55.

MILROY, JAMES, and LESLEY MILROY. 2012. *Authority in language: Investigating Standard English* (4th ed.). Florence, Ky: Routledge.

NOUGUERÓN-LIU, SILVIA and DORIS S. WARRIER. 2014. Heteroglossic practices in the online publishing process: Complexities in digital and geographical borderlands.

Heteroglossia as practice and pedagogy, ed. by A. Blackledge and A. Creese, 179–197. Dordecht: Springer.

OTSUJI, EMI, and ALASTAIR PENNYCOOK. 2010. Metrolingualism: Fixity, fluidity and language in flux. *International Journal of Multilingualism* 7.3.240–54.

OTSUJI, EMI, and ALASTAIR PENNYCOOK. 2014. Unremarkable hybridities and metrolingual practices. *The global-local interface and hybridity: Exploring language and identity*, ed. by S. Rubdy and L. Alsagoff, 83–99. Bristol, UK: Multilingual Matters.

PENNYCOOK, ALASTAIR. 1998. The right to language: Towards a situated ethics of language possibilities *Language Sciences* 20.1.73–87.

PENNYCOOK, ALASTAIR. 2010. *Language as a local practice*. London: Routledge.

PENNYCOOK, ALASTAIR and EMI OTSUJI. 2014. Metrolingual multitasking and spatial repertoires: 'Pizza mo two minutes coming'. *Journal of Sociolinguistics* 18.2.161–184.

PENNYCOOK, ALASTAIR and EMI OTSUJI. 2015. Metrolingualism: Language in the city. Florence, KY, USA: Taylor and Francis. Retrieved from http://www.ebrary.com ProQuest ebrary. Web. 8 June 2015.

PIETIKÄINEN, SARI and HANNELE DUFVA. 2014. Heteroglossia in action: Sámi children, textbooks and rap. *Heteroglossia as practice and pedagogy*, ed. by A. Blackledge and A. Creese, 59–74. Dordecht: Springer.

RAMPTON, BEN. 2014. Dissecting heteroglossia: Interaction ritual or performance in crossing and stylisation? *Heteroglossia as practice and pedagogy*, ed. by A. Blackledge and A. Creese, 275–300. Dordecht: Springer.

RICENTO, THOMAS. 2000. Historical and theoretical perspectives in language policy and planning. *Journal of Sociolinguistics* 4.2.196–213.

RYMES, BETSY. 2014. Marking communicative repertoire through metacommentary. *Heteroglossia as practice and pedagogy*, ed. by A. Blackledge and A. Creese, 301–316. Dordecht: Springer.

SHOHAMY, ELANA. 2006. *Language policy: Hidden agendas and new approaches*. New York, NY: Routledge.

SPAHIJA (THAÇI), MIFTAR ZENEL. 1990. *Hasimja*. Canada: Pristine Publishing.

SPAHIJA (THAÇI), MIFTAR. 1998. *Arbanet e Curranet*. Tirana: Koha.

TJUPA, VALERIJ. 2009. Heteroglossia. *Narratologia Contributions to narrative theory: Handbook of narratology*, ed. by P. P. Huhn and J. S. Wolf, 124–131. Berlin, Germany: Walter de Gruyter.

WATTS, RICHARD J. 2010. The ideology of dialect in Switzerland. *Language, power and social process: Language ideological debate*, ed. by J. lommaert, 67–103. Munchen, Germany: Walter de Gruyter.

WOOLARD, KATHRYN A., and BAMBI B. SCHIEFFELIN. 1994. Language ideology. *Annual Review of Anthropology* 23.55–82.

Julie KOLGJINI, PhD, Rochester Institute of Technology/A.U.K.

AN EXAMINATION OF AESTHETIC TRANSGRESSIONS OF ALBANIAN STANDARD LANGUAGE IDEOLOGY: THE CASE OF MIFTAR SPAHIJA

Summary

Throughout the past few decades standard language ideology and language choice, in particular involving spoken and written modes of communication, have been investigated extensively for numerous languages (e.g. American and British English). Few contemporary inquiries, however, have examined the incorporation of alternative linguistic resources and repertoires of the often stigmatized (sub)varieties of Albanian, including those in the literary works of the often-overlooked Albanian-American Miftar Spahija, as legitimate options. Paralleling the implementation of the hegemonic standard language ideology of Unified Literary Albanian (ULA), while also refusing to acquiesce to its fixed linguistic resources, Spahija (1990, 1998) pursues a trajectory that explores dynamic continuities across and within linguistic varieties. In doing so, he embarks upon a course similar to that of some of his predecessors and contemporaries, e.g. Ernest Koliqi and Martin Camaj, among others. Spahija aesthetically interweaves elements of linguistic hybridity, polycentrism, codemeshing, (trans)languaging, innovative coinages, ludic components, as well as dynamic linguistic resources (see Pennycook and Otsuji 2014, 2015), among other mechanisms, within a fluid system, as is often celebrated in post-structuralist as well as late and post-modern accounts of language usage practices. Rather than succumbing to restricting his linguistic resources to one rigid edifice, he pushes the boundaries of multiple systems, and by doing so captures the essence of linguistic agency – of the speaker, narrator, and author. Spahija's writings focus on the multispeechedness of the characters in his novels (*batrila*), refusing to limit them to the strict confines of the standard language culture of ULA. He does not suppress alleged dysfluencies of *katun*(*d*)*ar* language practices (e.g. *xhit* 'what', cf. *çfarë*, *çka*); instead, he endeavors to capture the aesthetics in the heterogeneity of their everyday usage. From the lens of critical discourse analysis, rather than composing a long treatise describing the inadequacies of the (current) standard, he provides readers with myriad examples of alternatives that surface in the author's (re)inventions of multiple linguistic histories (e.g. *prazull* 'turbid, disruptive', cf. *turbull*). While acknowledging and integrating the intertwining of social spaces and language behaviors (see Pennycook and Otsuji 2014, 2015), Miftar Spahija's distinct approach is grounded in situated language practices *in situ*, where readers are invited to play in dynamic linguistic sandboxes, milieus in which they, too, can be active participants in authentic language usage, thus representing multiple horizons where their language repertoires are legitimate. Spahija's writings focus on the discourse of place, situated geo-semiotic linguascapes, i.e. language emergent from contextualized situations, where stylized (and enregistered) codecrossing, style-shifting, and transidiomaticity are manifest.

Ali ALIU, ASHAK, Prishtinë

ROBERT ELSIE: PREZANTUES I LETËRSISË SHQIPE NË PËRMASA NDËRKOMBËTARE

Robert Elsie është mik i madh i shqiptarëve, i gjuhës shqipe, i historisë dhe i kulturës sonë. Albanologu, gjithsesi me bibliografi, për nga numri, më të pasur mes albanologëve të huaj, që rezulton të ketë botuar rreth pesëdhjetë publikime nga kjo fushë dhe numër të madh të teksteve në gjuhë të huaja, për historinë, gjuhën, kulturën e shqiptarëve, kudo gjinden ata. Rezultat i kësaj miqësie është puna më se tridhjetë vjeçare në kërkim dhe në hulumtimin, në afirmimin e saj në botë. Historia e letërsisë shqiptare e botuar në anglisht në dy vëllime, është gjithsesi ngjarje kulturore me rëndësi, gjithnjë në kuadër të njohjes dhe të afirmimit të gjuhës dhe kulturës shqiptare në botë. Jo më pak të rëndësishme janë edhe një varg veprash të tij dhe me këtë rast fare shkurtimisht dëshiroj të zë ngoje vetëm disa: ka përkthyer në anglisht veprën monumentale të Gjergj Fishtës "Lahuta e Malësisë", ka përkthyer Migjenin prozator dhe poet në anglisht dhe gjermanisht, ka përkthyer Ernest Koliqin, ka përkthyer dhe botuar vëllime poetike të përzgjedhura nga Ali Podrimja, Eqrem Basha, Visar Zhiti etj. Ka përpiluar dhe përkthyer antologji të poezisë shqipe, antologji të tregimit shqiptar. Ka përzgjedhur, përkthyer e botuar përralla e legjenda shqiptare, ka hulumtuar dhe ka gjetur letra dhe shkrime të albanologut Nopçe nga udhëtimi i tij nëpër Ballkan, botuara në gjermanisht. Është autor i fjalorëve dhe leksikoneve të letërsisë shqipe, të historisë shqiptare, por edhe botimeve të veçanta, si leksikoni me informata shteruese në gjashtëqind faqe – "Kosova". Ka bërë hulumtime dhe ka gjetur thesar të rëndësishëm të fotografive që nga zanafilla e kësaj mjeshtërie

dhe arti shqiptar, ka bërë studime për regjione historikisht pak të njohura si hapësira e Rekës, e rekalive ortodoksë shqiptarë në mes Mavrovës dhe Dibrës, studime dialektore,folklorike,antropologjike, etj.

E solla në fillim të kësaj fjale këtë pjesë të bibliografisë së Robert Elsie, të një albanologu i cili me këtë rast trajtohet vetëm si autor i një historie letrare shqiptare, për ta theksuar dhe përcaktuar saktësisht nxitjen, perspektivën dhe perceptimin e tij për t'i hyrë këtij projekti dhe për ta realizuar atë brenda atij koncepti dhe perceptimi. Prandaj, para se të ndalem te objektivi kryesor i kësaj fjale, që është historia e letërsisë shqiptare e Robert Elsie, gjithnjë shkurtimisht, të sjellim një pasqyrë të gjendjes në këtë fushë të letrave të shqipes, gjendje nga e cila u nis dhe u mbështet autori i saj gjatë hartimit të veprës.

Në mbështetje të projektit të vet Robert Elsie, siç dihet, ka pasur tekstin "Histori e letërsisë shqipe", botim i Universitetit të Tiranës, 1959-1960, përkatësisht versionin e ripunuar dhe të zgjeruar të këtij teksti, botuar në vitin 1983, nga Akademia e Shkencave-Tiranë. Të përmendim edhe monografinë, në këtë rast, të Rexhep Qosjes mbi Romantizmin në letërsinë shqipe, pastaj sprovat në këtë fushë të Namik Resulit, Arshi Pipës, e disa autorëve të tjerë nga diaspora shqiptare në Europë dhe Amerikë. Në këtë radhë është edhe teksti i Koço Bihikut mbi letërsinë e realizimit socialist në Shqipëri, sprovat e arbëreshëve, të letërsisë arbëreshe në Itali, e Zef Skiroit, Petrotës, etj. Harta e tillë e sprovave për hartimin e një histori-letërsie gjithëpërfshirëse ofron fare pak. Për më shumë, kjo panoramë duket e fortifikuar brenda fragmentaritetit dhe, gjithsesi, autori e ka pasur vështirë që nga kjo gjendje të krijojë një shtrat unik dhe tërësor të letërsisë shqipe. Trashëgimia e tillë e vetë letërsisë, e prerë në ndarje vertikalisht dhe horizontalisht, nuk mund ta plotësonte synimin e parë të autorit, për t'i ofruar opinionit ndërkombëtar një histori letrare unike dhe të plotë. I gjendur përballë këtij konfiguracioni, historia e letërsisë shqiptare e Robert Elsie ka në vete anët e mira njësoj si edhe mungesat, në momente serioze.

Kontaktet e para të tij me Shqipërinë dhe me shqiptarët datojnë që nga fundi i viteve shtatëdhjetë dhe fillimi i viteve tetëdhjetë të shekullit të kaluar, periudhë kur ka mundur ta vizitojë disa herë Tiranën dhe pjesët tjera të Shqipërisë. Duke e parë Shqipërinë e mbyllur dhe kulturën e saj të panjohur në botë, siç thotë edhe vetë nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, rrënjët e lashta europiane të shqiptarëve, ka ndjerë ngasjen për të bërë punën e albanologut me përkushtim, për ta nxjerrë në botë, për ta bërë të njohur dhe për ta afirmuar historinë dhe kulturën e tyre. Hapin e parë në këtë projekt, që shtrihet në një hark kohor më se tridhjetëvjeçar, Robert Elsie do ta fillojë nga letërsia. Dhe pikërisht në vitin 1986 ai do të botojë, gjithnjë në anglisht, në Amerikë, veprën "Fjalor i Letërsisë Shqiptare", projekt ky që pas disa vitesh, saktësisht mes viteve 1988-1993, do të marrë përmasat e një teksti të mirëfilltë - "Histori e Letërsisë Shqiptare", në dy vëllime, botuar po ashtu në Amerikë, në vitin 1995 dhe që do të përkthehet në gjuhën shqipe dhe do të botohet nga Dukagjini i Pejës, në vitin 1997, kohë kur do të botohet edhe polonisht. Pra, për ta nxjerrë nga harresa këtë letërsi, këtë traditë origjinale, këto vlera shpirtërore shqiptare, autorit i është dashur, para së gjithash, të bëjë bashkë fragmentet, ndarjet e natyrshme dhe të pa natyrshme, për të cilat studiuesi Shaban Sinani, tek teksti "Çështje të hapura të historisë së letërsisë shqipe", veçon ato më themeloret që duhet të përballohen dhe kalohen për të hartuar një histori letërsie të shqipes të plotë: duhet tejkaluar kufizimet që rrjedhin prej periudhizimit klasik, prej rrjedhës së pa radhë të drejtimeve letrare, prej heterogjenitetit gjuhësor, hapësinor, alfabetik, ku do të synohej parimi bazë që do shërbente konceptualisht si një lehtësim për të vështruar si pjesë të saj edhe traditën e shkrimeve parashqipe, edhe letërsinë humaniste të fundit të mesjetës, edhe letërsinë filozofike të Voskopojës, edhe shumë dukuri të tjera dygjuhëshe të kohëve të reja, etj.

Robert Elsie, që siç thamë ka parasysh nxjerrjen e kësaj bote shpirtërore në arenën ndërkombëtare, arrin t'i bëjë bashkë brenda kopertinave të historisë së vet, të tilla siç i ka gjetur, "disa letërsi", pa pasur pretendime për të gjetur nyjen dhe fijen bosht të një trungu gjuhësor dhe identitar të shqipes, të degëzuar e ushqyer në hapësirën e vet unike që,

duhet thënë, se as vetë ne nuk po arrijmë ta bëjmë . Shikuar nga ky vizion dhe objektiv i autorit, historia e letërsisë shqiptare në anglisht, por edhe në gjuhët e tjera, mund të konsiderohet si synim kryesisht i plotësuar, të paktën si hapi i parë. E përkthyer tani në shqip, historia e letërsisë shqipe e Elsie vihet para provokimeve dhe sfidave fare ndryshe nga ato që ka pasur parasysh autori kur i ka hyrë projektit. Nganjëherë ndodh që pjesë të historive letrare të shqipes autori do t'i bëjë bashkë mekanikisht, prandaj shikuar nga kjo perspektivë historia në fjalë lë shumë për të dëshiruar. Edhe pse aktualisht ky tekst është tejet praktik për t'u përdorur, në radhë të parë për informacionin e bollshëm dhe karakterin enciklopedik të saj. Por, anash përdorimit të saj praktik si tekst në funksion të përdorimit shkollor, ana më problematike është vlerësimi i autorëve të veçantë, hierarkia reale e vlerave.

Pjesa e letërsisë së traditës, pra ajo deri në luftën e dytë botërore, ndjek konceptin e historisë së letërsisë shqipe hartuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, por edhe nga sprovat dhe tekstet e më shumë autorëve që janë marrë me hartimin e pjesshëm të historisë së letërsisë. Probleme të konceptit dhe të vlerësimit dalin dhe janë më të theksuara në kapitujt mbi letërsinë bashkëkohore, që shtrihet në pjesën e dytë të shekullit njëzet. Në këtë pjesë gati se mungon një koncept i qartë, mbase edhe një përgjegjësi e shkallës që kërkon një projekt i tillë. Kryesisht, mbase edhe në të shumtën e rasteve, mungon argumenti pse janë disa emra, përkatësisht pse nuk janë disa emra autorësh. Për më shumë, me ndonjë përjashtim, gjenden pranë e pranë autorë me vlera të pranuara, të prezantuar me nga dy–tre rreshta tekst, pranë emrave fare të parëndësishëm që mund t'u jetë dhënë më shumë hapësirë. Në raste të tilla lexuesi fiton përshtypjen se nuk njihen, nuk janë lexuar ose nuk janë vlerësuar as të parët as të dytët. Një konfuzion i tillë konceptual është ai që mbizotëron në dy kapitujt e fundit të kësaj historie letërsie, ai për letërsinë shqipe të realizmit socialist në Shqipëri dhe letërsia shqipe në ish-Jugosllavi.

Ja një pasqyrë e përfshirjes së letërsisë brenda shtetit shqiptar në pjesën e dytë të shekullit njëzet, nën kapitullin - *Letërsia shqiptare nën*

regjimin e Enver Hoxhës dhe dalja nga izolimi. Kapitulli shtrihet në gjashtëdhjetë faqe të librit që ka rreth pesëqind faqe të formatit të madh dhe që përbëhet nga gjashtë kapituj. Në afro një të tretën e këtij teksti (nëntëmbëdhjetë faqe) shtrihet vepra letrare e Ismail Kadaresë. Nga të gjithë autorët e tjerë të përfshirë në këtë gjysmë shekulli, vetëm Dritëro Agollit i jepen dy faqe e gjysmë, ndërsa Fatos Arapit, sipas nesh krye poetit të kësaj periudhe, vetëm një faqe tekst. Në kapitullin e dytë për prozën e kësaj periudhe, dhjeta autorë përmblidhen vetëm me nga dhjetë rreshta. Një grup i madh si: Kiço Blushi, Neshat Tozaj, Fatos Kongoli, Betim Muço, Valter File, Hysen Simoni, Bashkim Shehu, Zija Çela, Preç Zogaj, Teodor Keko, Besnik Mustafai, Mira Meksi, Elena Kadare etj, kanë vetëm nga një fjali, data e vendi i lindjes, dhe eventualisht titullin e ndonjë vepre, pa u vënë re Zija Çela dhe Fatos Kongoli. Ngjashëm me këtë do të përsëritet edhe kapitulli mbi poezinë, ku në mesin e poetëve Kujtim Aliaj, Jorgo Bllaci, Viktor Qurku, Fasli Aliti, Zyhdi Morava, që radhiten vetëm si ish të burgosur, është një nga emrat e përmendur edhe poeti i shquar Frederik Reshpja, e ndonjë tjetër.

Letërsia shqiptare e Kosovës, e shtrirë brenda njëzet e tri faqeve, në krye të vendit sjell prozën letrare kosovare, sipas këtij rendi: Ademi Demaçi një faqe e gjysmë, Anton Pashku gjysmë faqe, dhe vetëm me nga një çerek faqe Ramiz Kelmendi, Rexhep Qosja, Nazmi Rrahmani, Teki Dervishi, Zejnullah Rrahmani, Mehmet Kraja, dhe askund proza e Murat Isakut, e Eqrem Bashës. Në kapitullin mbi poezinë kosovare, vetëm Esat Mekuli e Ali Podrimja kanë nga një faqe tekst, krejt plejada e majave poetike shqiptare – Azem Shkreli, Rrahman Dedaj, Fahredin Gunga, Adem Gajtani, do të keni mezi nga një gjysmë faqe.

Natyrisht, hapësira që u jepet autorëve dhe veprës letrare të tyre nuk është i vetmi, e aq më pak më me peshë, për të shprehur gjithnjë edhe vlerën artistike të secilit. Tekstet që interpretojnë, që komentojnë, që vlerësojnë, janë ana më problematike e kësaj letërsie të historisë.

Autorit të Historisë së Letërsisë Shqiptare – Robert Elsie-s mund t'i bëhen edhe një varg vërejtjesh për lëshime më anësore, më periferike, siç

mund të jetë edhe ajo e trajtimit dhe perceptimit të dialekteve, përkatësisht të të folmeve në gjuhën shqipe. Autori shpesh përdor një gjuhë si - Ernest Koliqi prozator geg, dhe kur kërkon një ekuivalencë toskë atij i bie ndër mend Mitrush Kuteli, dhe njësoj për ndonjë autor të të folmes toske thotë – një poet tosk etj. Problematik tingëllon një kapitull nga fillimi i librit rreth përsiatjes – përçarje të identitetit kulturor shqiptar etj.

Duhet të themi si përfundim se qasja aq miqësore ndaj kulturës, historisë dhe vlerave shpirtërore të albanologut, gjithsesi nga më të përkushtuarit, është tipari kryesor i kësaj vepre, që e para në përmasa ndërkombëtare e prezanton letërsinë shqiptare. Tipar i tillë është edhe përpjekja që t'i bëjë bashkë copat dhe fragmentet e letërsisë shqiptare me kufij kohor dhe hapësinor. Të gjitha vërejtjet dashamirëse me këtë rast, mund të jenë nxitje për një ribotim të plotësuar dhe të përmirësuar...

Ali ALIU, ASHAK, Prishtina

ROBERT ELSIE, PRESENTER OF ALBANIAN LITERATURE AT GLOBAL PROPORTIONS

Summary

This paper discusses the challenges of a history of the Albanian literature by analyzing the *procédés* and results of Robert Elsie, seen also in the light of the work of other authors.

Mehmet KRAJA, AShAK, Prishtinë

"ËNDRRA AMERIKANE" E SHQIPTARËVE. NJË VËSHTRIM HISTORIK DHE POLITIK MBI DIASPORËN SHQIPTARE NË AMERIKË

Diaspora shqiptare në Amerikë u krijua në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, atëherë kur nis edhe fuqizimi ekonomik dhe politik i Amerikës dhe roli i saj në Europë fillon të bëhet gjithnjë e më i ndjeshëm. Emigrimi i shqiptarëve në Amerikë, gjatë kësaj periudhe, është më intensiv nga Shqipëria e Jugut, për shkak të ndikimit grek në këtë zonë. Një numër syresh udhëtuan në Amerikë me anijet greke, në shumicën e rasteve si klandestinë. Njëlloj simbolike për rrugëtimin e shqiptarëve drejt *ëndrrës amerikane*, si edhe e popujve të tjerë të Europës, paraqet "Titaniku": ndër të mbyturit dhe të mbijetuarit e *Titanikut* ka pasur edhe shqiptarë. (Deri tani dihet për një familje dibrane tre anëtarësh të mbytur dhe së paku për një person nga Vithkuqi i Korçës i mbijetuar.) Është e njohur se emigracioni shqiptar në Amerikë ka pasur karakter ekonomik, vetëm se duhet marrë parasysh edhe faktin se në fillim të shekullit XX, drejt Amerikës udhëtojnë edhe një numër aventurierësh, të tillë që kryesisht përbëjnë atë shtresë të popullsisë, e cila pretendon të jetojë duke shfrytëzuar mirëqenien ekonomike të emigrantëve, të cilën arritën ta krijonin me një shpejtësi të madhe. Në këtë kategori bëjnë pjesë edhe një numër intelektualësh dhe politikanësh, ose ata që më vonë do të bëhen të tillë.

Emigracioni shqiptar në Amerikë u fuqizua shumë shpejt, duke arritur të bëhet i suksesshëm në tre plane njëherësh:

1. Arrin të organizohet mes veti dhe të unifikohet (në këtë pikë ka pasur ndikim të madh fakti se emigrantët vinin nga e njëjta hapësirë

shqiptare dhe, për rrjedhojë, kishin edhe interesa të njëjta politike);

2. Arrin t'i imponohet shtetit amerikan dhe të përfitojë mbështetje për Shqipërinë (takimi i hershëm i Nolit me Vilsonin dhe mbështetja që ai i dha Shqipërisë);

3. Arrin t'i imponohet politikisht vendit të origjinës, pra Shqipërisë, duke u bërë faktor i rëndësishëm në zhvillimet politike, fetare dhe intelektuale (themelimi i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare dhe i ashtuquajturi Revolucioni i Qershorit i vitit 1924).

Vetëm se duhet pasur parasysh një gjë: derisa bëjmë këtë histori të shkurtër politike të diasporës shqiptare në Amerikë, duhet të tërheqim qartë një vijë ndarjeje midis veprimit politik të kësaj diaspore në vendin e origjinës, me parimet dhe vlerat e demokracisë amerikane. Thënë me një fjalë, veprimet që bëjnë herë pas here përfaqësuesit e kësaj diaspore në vendin e origjinës, nuk kanë asgjë të përbashkët me këto vlera.

Më anë tjetër, jeta në një shtet të fuqishëm, me ndikim të jashtëzakonshëm në tërë botën, do të stimulojë te shqiptarët e kësaj diaspore një iluzion të përsëritur, recidivist në krahasim me diasporën shqiptare në përgjithësi: se diaspora, në këtë rast ajo e Amerikës, është denjë, e meriton dhe duhet ta sundojë vendin amë. Ky iluzion është shfaqur edhe pas bërjes së Shqipërisë, e më vonë, në mënyrë sporadike, edhe pas bërjes së Kosovës. Natyrisht kjo nuk ka pasur të bëjë fare me politikat amerikane ndaj shqiptarëve, por ka qenë iluzion vetëm i kësaj diaspore.

Noli dhe Konica

Për më shumë se gjysmë shekulli, skenën politike dhe intelektuale të diasporës shqiptare në Amerikë e dominuan dy emra të njohur, Noli dhe Konica. Por veprimet e tyre politike nuk shfaqin asnjë respekt për parime dhe vlera demokratike. Në pikëpamje politike, Noli dhe Konica paraqiten aventurierë, pushtetdashës të mëdhenj dhe, në disa raste, zjarrvënës të Shqipërisë (Noli, Revolucioni i Qershorit).

Derisa Konica shquhet për inkonsekuencë politike, duke filluar si anarkist dhe duke përfunduar si rojalist, Noli shfaqet krejt i afërt me idetë

komuniste. Megjithatë veprimi i kryehershëm i Nolit, për të themeluar Kishën Ortodokse Autoqefale Shqiptare duhet konsideruar si njërën nga arritjet më të mëdha, kulmore, të diasporës shqiptare në Amerikë, që e vendos Nolin dhe këtë diasporë në shkallën më të lartë të hierarkisë së patriotizmit shqiptar. Ishte një akt që do të ketë ndikim të jashtëzakonshëm edhe në jetën politike dhe fetare në diasporën shqiptare në Amerikë, por më shumë në Shqipëri. Deri më sot nuk ka ndonjë dëshmi se Noli, si kryepeshkopi i parë i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, mund t'u ketë bërë koncesione atyre që ia mundësuan aktin e shpalljes së autoqefalisë, ndonëse Noli ka qenë i prirë për koncesione të tilla. Por, më anë tjetër, në pikëpamje politike, Noli shfaqet arrivist i dhunshëm, idealet politike të të cilit nuk kanë asgjë të përbashkët as me filozofinë kishtare, as me demokracinë amerikane, ku ai mund të kishte marrë një mësim politik. Revolucioni i Qershorit i vitit 1924 është një aventurë politike e Nolit, e cila mund të arsyetohet vetëm me ambiciet e tij karrieriste, si një kontribut madhor i Nolit në historinë dëshpëruese të luftës së shqiptarëve për pushtet dhe nuk mund të gjejë asnjë arsyetim tjetër politik. Më anë tjetër, ambicia e Nolit për t'u bërë kryeministër i Shqipërisë me rrobën e priftit ortodoks, në një vend të sapo dalë nga sundimi i Perandorisë Otomane, ku mbi 70% e popullsisë është myslimane, duket tepër qesharake, për të mos u quajtur e dyshimtë. Ndërkohë, pikëpamjet e majta revolucionare të Nolit sa vinë e forcohen edhe pas Revolucionit të Qershorit, duke kaluar nga pragmatizmi politik në botëkuptim dhe në program letrar (*Anës së lumenjve*, *Marathonomaku i Madh* etj.). Pikëpamjet politike të Nolit paraqiten kontroverse edhe në raport me vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri. Dedikimi i Nolit për komunistët te *Albumi* ndoshta mund të gjejë një arsyetim, me faktin se komunistët e Shqipërisë u rreshtuan në krah të koalicionit antifashist dhe çliruan vendin, siç thotë ai, por, sikundër dihet, Noli do ta vazhdojë këtë mbështetje edhe më vonë, duke u bërë njeri i afërt me diktatorët e Tiranës. Ai, deri në vdekje, nuk u distancua ndonjëherë nga ky regjim, edhe përkundër faktit se deri më 1965 regjimi i Tiranës e kishte shfaqur faqe botës fytyrën e tij jashtëzakonisht të shëmtuar.

Ndryshe nga Noli, në pikëpamje politike Konica paraqitet me ambicie më të vogla politike, por jo më pak kontrovers se Noli. E thamë që në fillim se Konica ishte anarkist, pastaj, duke ndjekur jo parimet, por interesat, bëhet ruajalist. Ai e mbështeti Zogun kur e pa se mund të përfitonte prej tij, ndërsa në sytë e shqiptarëve këtë mbështetje e arsyetoi me stabilizimin e shtetit shqiptar. Fejtoni i tij publicistik "Shqipëria si m'u duk" është model i poltronizmit intelektual dhe i inkosekuencës politike të një intelektuali. Por, derisa në punë të grindjeve politike Konica ishte po aq i zëshëm sa Noli, me veprimet e tij ai nuk shkon deri në atë pikë, sa të arrijë të bëhet i dhunshëm: ai është më i sofistikuar, më mondan dhe më përfitues, njëkohësisht. Më anë tjetër, biografët e Konicës, të magjepsur nga erudicioni i tij, kanë bërë çmos për ta nxjerrë të larë figurën e tij edhe atëherë kur veprimet e tij kanë qenë asgjë më pak se tradhti ndaj kombit dhe shtetit. Në të vërtetë, pas pushtimit italian të Shqipërisë, Konica bën veprime aq joparimore dhe aq të paqëndrueshme dhe aq jokonsistente, saqë është vështirë të merret vesh se çfarë synon në të vërtetë. Ai, madje, bëhet edhe objekt i dyshimeve të FBI-së dhe vihet në vëzhgim të saj, për shkak të takimeve të shpeshta me një nëpunës shqiptar të ambasadës italiane në Uashington. Në një anë, ai vazhdon të mbështesë Zogun dhe e quan atë përfaqësues legjitim të shtetit shqiptar, por me Zogun i prish marrëdhëniet për shkak të mosmbështetjes financiare; vihet në anën e Italisë në luftën italo-greke dhe harton një broshurë propagandistike për këtë qëllim (*Sfondi i luftës italo-greke*), të cilën e botojnë dhe e shpërndajnë zyrat e propagandës fashiste anembanë Amerikës; i shkruan letër Musolinit me kërkesë që qeveria italiane të marrë përsipër shpenzimet e tij të prapambetura në Uashington, duke njohur në këtë mënyrë legalitetin e pushtimit italian; së fundi, situata bëhet tragjikomike, kur Italia i paguan Konicës katër mijë dollarë borxhe të ambasadës dhe tre mijë dollarë paga të prapambetura, gjithsej shtatë mijë dollarë, që i bie afërisht rreth njëqindmijë dollarë, sipas vlerës së sotme të dollarit amerikan dhe, si kundërveprim, merr në dorëzim kredencialet dhe vulat nga vetë dora e Konicës. Konica ishte përfaqësues i një shteti sovran dhe veprimi i tij nuk mund të arsyetohet me bindjet e tij politike, as me ndonjë ves ose veti të per-

sonalitetit të tij. Në të vërtetë, dy-tri vitet e fundit të jetës së Konicës në Uashington, 1939-42, janë aq konfuze dhe politikisht aq diletante, sa të bëjnë të dyshosh se, edhe para se të përfundonte jetën fizikisht, Konica tashmë kishte degraduar si intelektual erudit dhe politikan i shkathtë. Ai tashmë kishte rënë viktimë e jokonsekuencës së vet dhe prirjeve politike anarkiste dhe makiaveliste.

Në këtë kuadër, edhe zënkat e gjata dhe të vazhdueshme të Nolit me Konicën kanë shkaktuar përçarje të mëdha në komunitetin shqiptar të Amerikës. Grindjet e tyre nuk kanë qenë aspak parimore. Polemikat e tyre flasin për dy njerëz vetëmburrës dhe egocentrikë, me mentalitet provincial tipik shqiptar, të cilët janë në gjendje të sakrifikojnë çdo parim për interesa meskine. Konica zhvishet nga çdo vlerë humane, po edhe kombëtare, kur i kërkohet të japë mendim për një ndihmë që kërkonte Noli i sëmurë, duke u shprehur haptas për refuzimin e kësaj ndihme, që e kishte kërkuar Noli nga qeveria e Zogut. Por edhe Noli, shumë vjet pas, ndonëse më i përmbajtur, tallet me Konicën, me veset e dhe me karakterin tij prej ngatërrestari.

Më anë tjetër, sado që Noli dhe Konica e eklipsuan për një kohë të gjatë diasporën shqiptare në Amerikë, largimi i tyre nga skena do të lërë një zbrazëtirë përgjithmonë të paplotësuar. Askush më nuk do të arrijë ta zërë vendin e tyre; as *Vatra*, as *Dielli* nuk do të bëhen më kurrë çfarë kanë qenë në një moment të caktuar të historisë shqiptare.

Diaspora shqiptare në Amerikë do të marrë një rol shumë të rëndësishëm në punët politike të shqiptarëve me rastin e luftës në Kosovë në vitin 1999, por megjithatë ajo nuk do të arrijë kurrë t'i imponohet vendit amë, siç ka ndodhur gjatë gjysmës së parë të shekullit XX.

Për Kosovën

Pas Luftës së Dytë Botërore, diaspora e vjetër shqiptare në Amerikë humb dinamikën e saj dhe identifikohet me politikat e shtetit amerikan. Janë disa faktorë që e bëjnë këtë diasporë të heshtur dhe pa ndikim, siç është ndarja bllokiste, lufta e ftohtë dhe mbetja e Shqipërisë pas *perdes së*

hekurt, mbyllja dhe izolimi i Shqipërisë, sikundër edhe përçarjet mëdha politike dhe ideologjike të emigracionit shqiptar në përgjithësi. Me vdekjen e Mit'hat Frashërit në anijen që ishte bërë gati të ankorohej në Nju-Jork, duket se do të humbet përgjithmonë një zë i fuqishëm, i cili do të mund ta bashkonte diasporën shqiptare, jo vetëm në Amerikë, rreth ideve antikomuniste. Pra, as në këtë pikë diaspora shqiptare nuk paraqitet e bashkuar. Ajo bëhet terren i përshtatshëm për veprimtari agjenturore të Tiranës, por edhe të Jugosllavisë së atëhershme, e cila, për shkak të Kosovës, krahas emigracionit kroat, përçarjen e emigracionit shqiptar e vendos ndër prioritetet e saj më të larta.

Së këndejmi, edhe në raport me Kosovën, diaspora e vjetër shqiptare në Amerikë nuk shfaqet asnjëherë si zë i fuqishëm. Reagimet e kësaj diaspore kanë qenë të vakëta, pa ndonjë ndikim qoftë në politikat amerikane, qoftë në opinionin amerikan. As *Vatra*, as *Dielli*, as Konica, as Noli nuk thonë asgjë të rëndësishme për Kosovën. Konica, madje, në veprën e tij më të mirë dhe më të plotë *Shqipëria kopshti shkëmbor i Europës Juglindore*, bën një përshkrim historik dhe etnografik të viseve shqiptare, në të cilën përfshin Konicën e tij, por nuk e përfshin Kosovën dhe as viset e tjera shqiptare mbetur në Jugosllavi. Kjo gjendje vazhdon kështu, derisa vetë Kosova zë të japë sinjale të qarta të përpjekjeve të saj për t'u çliruar, dhe derisa në Amerikë zë të konsolidohet një diasporë e re, me memorie më të freskët dhe me ndjeshmëri më të madhe ndaj çështjes së Kosovës.

Fillimi ndodh më 1982, menjëherë pas demonstratave të fuqishme të vitit 1981. Në vjeshtën e atij viti, në City University të Nju-Jorkut, më 6 nëntor, mbahet një konferencë shkencore ndërkombëtare për Kosovën, në përgjigje të propagandës serbe dhe jugosllave, e cila, në qarqet ndërkombëtare, përfshirë edhe ato amerikane, kishte ndërmarrë një fushatë të jashtëzakonshme propagandistike, për ta damkosur Kosovën dhe për ta shtrembëruar realitetin e saj. Meritën për mbajtjen dhe suksesin e kësaj konference e kanë tre emra të nderuar të *diasporës së re* shqiptare në Amerikë: Arshi Pipa, Sami Repishti dhe Safete Sofie Juka. Me këtë konferencë i jepej një përgjigje shkencore propagandës serbe dhe botimi i punimeve të konferencës në vëllimin *Studime mbi Kosovën* (*Studies on Koso-*

va) më 1984, dhe veçmas studimi monografik i Safete Sofie Jukës *Kosova: Shqiptarët në Jugosllavi nën dritën e dokumenteve historike* (*Kosova: The Albanians in Yugoslavia in light of historical documents*), do të shënojë fillimin e një epoke të re jo vetëm të rolit të diasporës shqiptare në Amerikë, por edhe të çështjes së Kosovës dhe çështjes shqiptare në përgjithësi.

Pra, ishte një ngjarje kthesë, historia e së cilës mbetet të shkruhet në të ardhmen.

Mehmet KRAJA

ALBANIANS' "AMERICAN DREAM." A HISTORICAL AND POLITICAL REVIEW OF ALBANIAN DIASPORA IN AMERICA

Summary

The history of Albanian diaspora in America, as written and published until now, is an entirely national-romantic one. The history of the Pan-Albania Federation *Vatra*, the history of the *Dielli* newspaper, and biographies of the two most renowned figures of that diaspora -- Konica and Noli -- are idealizing work, with notable lack of objectivity and analytical ground. There are two "golden periods" of the Albanian diaspora in America, which are linked to the critical moments of their homeland: the period until 1920, that is, the time of the making of Albania and the time it faced the threat of being undone, and the period of the Kosova crisis. The time between these two periods is filled with rifts, political quarrels, and confrontations incited by the "mother" of that diaspora, Albania, and lately Kosova. Noli and Konica are those who started first this almost a 100-year-long "glorious" history of political quarreling.

Bashkim KUÇUKU, Universiteti i Tiranës, Tiranë

MONOGRAFI ARGUMENTUESE, KOHERENTE

Peter Morgan "Ismail Kadare, the Writer and the Dictatorship 1957-1990", "Legenda", Oxford, 2010, 356 faqe. Në shqip "Kadare, shkrimtari dhe diktatura, 1957-1990", Shtëpia Botuese "55", Tiranë, pa vit botimi, 303 faqe. [1)]

Gjeografia gjuhësore e kulturore e përhapjes së letërsisë është tregues i rëndësishëm i vlerave të saj, po ashtu, edhe librat studimorë për të, që janë fryt i ndikimit të thellë te personalitete universitare dhe akademike, aq sa marrin përsipër të ngrenë metandërtesa vetiake mbi origjinalitetin e domethënieve dhe shprehësive.

Mes 36 librave studimorë në gjuhë të huaja për veprën e Ismail Kadaresë, monografia "Kadare, shkrimtari dhe diktatura, 1957-1990" e Peter Morganit, është e vetmja që vjen nga kontinenti i largët i Australisë, me të cilën marrëdhëniet historike e kulturore të botës shqiptare, dhe anasjellas, kanë qenë dhe mbeten të rralla e të rastit. Letërsia, pikërisht, vepra e Ismail Kadaresë, mishëruesja më e plotë e botës shqiptare, me forcën kënaqësidhënse të artit, është bërë ura e parë e interesimit dhe e afrimit mes tyre. Lexuesi australian dhe anglishfolës, kudo qoftë, afrohet me botën shqiptare edhe nëpërmjet përshkrimit në monografi të kontekstit shoqëror në të cilin është përftuar. Para se të ketë në dorë çelësat për të hapur domethëniet dhe emocionalizmin e saj, ai pajiset me të dhëna të domosdoshme historike, kulturore, letrare, sidomos për rrethanat censuruese, që kanë qenë trysni e përhershme për ta tjetërsuar. Niveli shkencor, literatura kritike e sociologjike e shfrytëzuar, gjerësia dhe thellësia e analizave në trekëndëshin e përcaktuar qartë e të zbatuar me rreptësi të marrëdhënieve: kontekst shoqëror, subjekt krijues, vepër letrare,

koherenca e mendimit, polemika e argumentuar e pranëvë atë me studimet kadareane referenciale, së paku, në gjuhë të huaja.

Përshkrimi, shpesh deri në hollësi, i biografisë, formimit, bëmave, përjetimeve të Kadaresë, i marrëdhënieve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta me politikën e censurën, me disa figura udhëheqësish të diktaturës, veçanërisht me Enver dhe Nexhmije Hoxhën, i karakterit dhe qëllimeve të tyre ndaj shkrimtarit, të pazakonshme për një studiues të huaj, për më tepër nga Australia, janë cilësi të tjera të spikatura. Kështu, largësia kulturore është plotësuar nga metoda e punës dhe metodologjia e studimit. Për të qenë me baza shkencore sa më të qëndrueshme, krahas literaturës së shfrytëzuar mjaft të pasur, në anglisht dhe frëngjisht, nga autorë të huaj dhe shqiptarë, për veprën e Kadaresë, për Shqipërinë staliniste, plenumet e Lidhjes së Shkrimtarëve, është kërkuar edhe ndihma e një ekipi asistentësh e profesorësh nga fusha të ndryshme të shkencave humane, konsultimi me specialistë e gazetarë në Britaninë e Madhe, SHBA, Australi, Francë e Shqipëri.

Qëllimi i parë i autorit është të ndikojë në shtrirjen e mëtejshme të receptimit, në përhapjen e veprës së Ismail Kadaresë, prandaj, ka marrë përsipër t'a paraqesë atë "*përpara një auditori më të gjerë*" (faqe 10). Qëllimi i dytë është mënyra e receptimit, zbulimi i gjerësisë dhe i shkallareve të domethënieve të saj, bazuar në kundërshtitë e vazhdueshme në jetën e shkrimtarit dhe në vepër. *"…e vërteta mbi ekzistencën e Kadaresë*, pohon ai, *qëndron në kontradiksionet e tij. Ai është zëri i Shqipërisë moderne dhe këngëtar i identitetit të lashtë. Ai është një alter ego i diktatorit dhe i ndëshkuar prej tij. Ky* ***dyzim*** *është kyçi i jetës, reputacionit dhe veprave të tij."* (faqe 8)

Qasja është thelbësore: shkrimtari dhe vepra nëpërmjet marrëdhënieve me censurën, problemi qeniesor/ekzistencial i tyre në diktaturë.

Monografia është ndërtuar në mënyrë polemike, me tezë dhe kundërtezë. Mendimit të atyre, që kanë thënë, se, qëndrimi i Kadaresë dhe vepra e tij, në totalitarizëm ishin brenda sistemit, dhe, për pasojë, në shërbim të tij, i është kundërvënë mendimi tjetër, që është edhe i Morganit,

se, pavarësisht, nga qëndrimet, "kompromentuese", ai ka qenë kundër, dhe vepra e tij ka përcjellë mesazhe lirie dhe emancipimi. Ndryshe nga këto palë të ballafaquara, që janë të njashme, njëra, duke mohuar qenien e një pjese të saj në shërbim të sistemit, dhe tjetra, duke mohuar kundërvënien e përgjithshme ndaj tij, Morgani nëpërmjet kundërshtive argumenton rolin edhe të njërës edhe të tjetrës. Për t' u dalë mbanë ndërlikimeve mes tyre ka patur si fill ariane **dyzimin** e shkrimtarit (faqe 8), të cilin fillimisht e sheh në familjen e Kadaresë, ku ana e nënës ishte e lidhur me sistemin, ndërsa, i ati ishte mospranues. Formimi shkollor dhe propaganda ndikoi që në rininë e hershme të besonte në disa mirësi të socializmit, ndërsa, studimet në Moskë, kur frynte era e liberalizimit, i hapën sytë kritikë ndaj stalinizmit. Me shkëputjen nga kampi socialist lindor, besoi, se, Shqipëria do të lidhej me Perëndimin. Zhgënjimi nga lidhja e saj me Kinën, imitimi në një masë i Revolucionit Kulturor Kinez, represioni mbi shkrimtarët dhe forcimi i censurës e frikësoi. Rreziku i vazhdueshëm mbi të dhe të tjerët e shtyu në kompromisin me romanin "Dimri i vetmisë së madhe" me të cilin përfundoi periudha e dyzimit. (faqe 168). Teza e pamundësisë së disidencës, në kuptimin e mirëfilltë, ndryshe nga në vendet e tjera europiane të Lindjes staliniste, mbështetet në të dhënat tipike të censurës në Shqipëri, mënyrat e imponimit të metodës së realizmit socialist nëpërmjet formimit shkollor dhe institucioneve shtetërore, të kontrollit zyrtar e të mbikqyrjes së fshehtë, përdorimit të mendimit të lexuesit të indoktrinuar, etj. Në këto rrethana, Ismail Kadaresë, sipas tij, nuk i mbetej tjetër, veçse gjuha e ezopit, simbolet dhe alegoritë, në mënyrë, që, jo vetëm t'i botoheshin veprat kundër, por, dhe mos të kishte pasoja. Në dobi të këtij mendimi, që, me koherencë të madhe, përshkon monografinë, sillen fakte të shumtë biografikë, të formimit të autorit, të bindjeve, qëndrimit dhe alibive për botimin e veprave të caktuara, sidomos analiza e brendisë kundërtotalitare të tyre. "*Do të ishte gabim*, përfundon në mënyrë sintetike Peter Morgan, *të paraqitej Kadareja si një figurë e heshtur gjatë diktaturës. … Kadareja shkroi disa nga veprat më të shkëlqyera dhe subversive që kanë dalë nga Europa Lindore socialiste* (f. 9).

Në shqip monografia është botuar nga Shtëpia Botuese "55", në Tiranë, jashtë standardeve më të domosdoshme. I mungon viti i botimit. Mungesa e një të dhëne të tillë, që haset sapo e shfleton librin, si shenjë e keqe pasohet nga mangësi dhe pasaktësi të shumta. Disa tituj të Ismail Kadaresë janë përkthyer prej anglishtes nga që nuk janë ditur sesi janë në origjinalin në shqip. Emra vendesh të hapësirës shqiptare janë dhënë gabim, dhe, në disa raste, bie fjala, ngatërrohet Preveza, që është në skajin jugperëndimor, me Preshevën, që është në skajinverilindor. Një sërë emrash të figurave historike dhe të autorëve shqiptarë të mirënjohur nuk janë të saktë. Emrat e autorëve dhe të figurave të kulturave të tjera shkruhen pa kriter drejtshkrimi, herë sipas gjuhës së kulturës së cilës i përkasin, herë sipas shqiptimit në shqip, herë kështu dhe herë ashtu, dhe përsëri me pasaktësi. Përkthimi, redaktimi, përpunimi gjuhësor e teknik është shëmbull i keq se si vlerat e krijuara prej të tjerëve për kulturën shqiptare keqpërdoren nga botues të papërgjegjshëm, që mendojnë vetëm përfitimin lëndor.

1) Autori**:** Peter Morgan është Profesor në Universitetin e Sidneit (Australi), drejtor i Programit të Studimeve Europiane në Universitetin e Sidneit, anëtar i Akademisë së Arteve dhe të Shkencave Humane të Australisë. Një nga projektet e tij studimore të rëndësishme është për veprën e Ismail Kadaresë në vitet 1990-2010, vazhdim i kësaj monografie. Studimet universitare bachelor dhe doktoraturën i ka kryer në Monash University (Australi), kurse studimet master në Universitetin "Gëte" në Fraiburg, Gjermani.

Bashkim KUÇUKU, University of Tirana, Tirana

ARGUMENTATIVE, COHERENT MONOGRAPH

Summary

he monograph "Kadare, the writer and dictatorship, 1957-1990", written by Peter Morgan, Professor of the University of Sydney (Australia) who is also the Director of the European Studies Program at the same university and which was published in English by Maney Publishing, an academic high standard British publishing house with its offices in Boston (USA), even though doesn't belong directly to American studies of the Albanian language, culture and literature, we think that not only because of the English language in which it was written but also because of the approach and the publisher can be included in them. A few years ago it was, also, published in Albanian with amateur undervalued translation and editing culture. Amongst many other books that have the Ismail Kadare's work as a study object, it is the only one, according to our knowledge, that comes from Australia, the most distant continent from Albania and also a continent with which Albania has had slim historic-cultural relations or relations which haven't been made known so far. In the entirety of approaches, the author has selected to see his work through relations with censorship, the crucial/existential problem of the creativeness during the dictatorship, which was a problem that faced the writer, too.

The monograph was written in a polemical manner and contains the opinion of some people who have said that the Kadare's stand during the dictatorship was in favor of the system, and, in consequence, the work was at system's service, and another opinion that, despite particular "compromising" stands, he was against dictatorship and his work contains the message of freedom and emancipation. The thesis that the dissidence was impossible, within its genuine meaning, unlike dissidence in other Stalinist Eastern European countries, is based on typical information on the censorship in Albania, the way of the imposition of the socialist realism through school education and state institutions, official control and secret supervision, the use of the opinion of indoctrinated reader etc.

Under these circumstances, Ismail Kadare, according to him, had no other means except Aesop's language, symbols and allegories in order, on one hand, to be able to edit his books, and, on the other hand, to avoid consequences. In support of this opinion, which is present in the monograph with a considerable coherence, are brought numerous biographical facts related to the author's formation, convictions, stands and alibis for the edition of certain books, especially the analysis of their anti-totalitarian content. "It would be a mistake, concludes, synthetically, Peter Morgan, to depict Kadare as a silent figure

during the dictatorship. … Kadare wrote some of the books that are considered the most excellent and subversive books that derived from the Socialist Eastern Europe.

Kujtim M. SHALA, Fakulteti i Filologjisë i UP-së, Prishtinë

IDEOLOGJIKA E NOLIT

I

Historia e Skënderbeut (1947), *Betoveni dhe Revolucioni francez* (1974) e *Autobiografia* (1960) janë vepra diskursive e dëshmuese, të cilat e provojnë Fan S. Nolin dijetar e rrëfimtar, bashkë me diskursin e motivuar të tij, d.m.th. Nolin *shkrimtar*.

Historia... e provon përmjet dëshmisë Heroin nacional të shqiptarëve, *Betoveni...* - modelin ideologjik/social që zgjedh autori, ndërsa *Autobiografia* lidh jetën e veprën e Nolit si rrëfim e si dëshmi.

Skënderbeu është figura e zgjedhur, të cilës Noli do t'i ngjajë në jetën nacionale, përmbysjen e pushtetit do ta provojë vetë, *Autobiografia* zbulon edhe figurat e tjera të identifikimit të tij, Krishtin - hero moral të idesë e të ideologjisë, Napoleonin - hero militant (të veprimit).

Historia... do diskursivitet e prova, *Betoveni...* hap projeksione sociale e ideologjike, ndërsa diskursi i *Autobiografisë* personin Fan Noli e bën *informator* e *personazh* të rrëfimit e të dëshmisë autobiografike.

I lexuar në këto vepra, Noli hapet në faqet e argumentimeve të rralla, të ideologjisë, projeksioneve e të rrrëfimeve personale, për t'u provuar si *person*, *autor* e *autoritet*.

Këto vepra e provojnë dijetarin e stilistin e zgjedhur që njeh fuqinë e argumentit e të mesazhit, *autorin* që shkruan me *marrësin* përballë, d.m.th. *autorin* që përherë ka një tendencë retorike (bindëse).

Të shkruara e të botuara në anglishte, këto vepra provojnë variante e konstanta të diskursit të Nolit në një *gjuhë tjetër* dhe lidhin rrjetin e ideve të tij në një *ideologji* të rrëfyer e të provuar sistematikisht sipas një

metodike, të emërtuar *ideologjikë*. Ndërsa, të lexuara bashkë, provojnë *biografema* e *kulturografema* të Nolit dijetar, misionar të (vetë)projektuar, njeri të veprimit të provuar e rrëfimtar të jetës së vet.

I lakuar në diskursivitet e narrativitet, diskursi i Nolit, i këtyre veprave, e provon atë në një gjuhë të huaj, për ta hapur kështu çështjen e ndërlishqme kulturore e dramën identitare të autorit që shkruan në *gjuhë tjetër*. Ndërsa tematikisht, *Historia…* është vepër e qarkut nacional, *Betoveni…* - universal e *Autobiografia* - personal. Diskursi i temave identitare sprovohet thellë, kur vepra shkruhet në *gjuhë tjetër*. Kështu, drama identitare hapet te *Historia…* e sprovohet përfundimisht tek *Autobiografia*. Ndërsa, në rrafsh *biografie*, kështu lidhen *biografemat* me *kulturografemat*, për ta provuar jetën e shkrimtarit si *bibliografi*, pra si *kulturë*. Kultura e diskursit kthehet në objekt të diskursivitetit, në një raport të ndërliqshëm të komunikimit e të shkrimit që ndërliqësohet më tej, kur vetë vepra është diskurseve, si në këtë rast. Shpëtimi është përshkrimi e përsëritja e diskursit deri në identifikim, metodë që shenjohet si *lexim* i tekstit *me shkrim*.

II

Dy *Historitë e Skënderbeut* të Nolit njohin dy diskurse, madje dy zhanre; në rastin e parë (1921) *Historia* bëhet *rrëfim* e në të dytin (1947) *dëshmi* dhe diferencohen si *fiksion* e si *diskursivitet*. Rrëfimi vë referenca të largëta, lidhet në figura e, përfundimisht, në diskursin e njohur letrar të Nolit, ndërsa dëshmia kërkon burimet e Historisë, si prova të ndodhisë, lidh referencat, si provë për të vërtetat e autorit, të cilat propozohen si të vërteta të Historisë së Skënderbeut.

Këto diferenca Noli i dëshmon vetë edhe në *Hyrje* të versionit të dytë të Historisë, i provon me diskursivitetin e tekstit e i forcon me një antologji tekstesh të zgjedhura me objekt Historinë e Skënderbeut, të lidhura me ndodhi e nyja biografike të Heroit, të cilat i vlerëson si themelore për atë Histori.

Historia e Skënderbeut (1947), së pari, është propozuar e mbrojtur si tezë doktoranture, për të shkuar nga rrëfimi i parë për Skënderbeun te

diskursi akademik për të. Të gjitha këto shenjojnë kapërcimin nga *miti* apo *fiksioni* për Skënderbeun te Skënderbeu si *fakt* apo si *dëshmi* historike.

Në këtë shndërrim zhanresh, Noli kapërcen ngushticën e shkrimtarit që do të artikulohet si dijetar dhe kjo bëhet shenjë e rëndësishme e *bibliografisë* (biografisë) së tij. Ndërsa, teksti i veprës e provon nyjën e tillë si një *bibliografemë*. Kështu, *Historia e Skënderbeut* merr shenjat e një vepre-nyjë të Nolit, qoftë kur hapet në kujtesë për rrëfimin e variantit të parë, qoftë kur ikën në diskursivitet total që përsërit e lidh referencat. E tillë, më parë se e diferencuar, ajo duhet të lexohet si vepër që anticipon diskurset e Nolit, dijen e krijimin, kulturën gjuhësore, dramën ideologjike të tij, të kthyer në projeksion letrar, që këtu do dhe provën e lidhur me emrin e heroit nacional të shqiptarëve, Skënderbeut.

Këto shenja na kthejnë te *metoda* e Nolit, e cila, së pari, provohet si sistematikë (*metodikë*) e sprovohet nga struktura që shenjon një tekst të strukturuar, por që ka brenda autorin si *subjektivitet*.

Amzën e fakteve dhe të leximit të Nolit e provon *Shtojca* që shoqëron tekstin diskursiv, përmjet shenjimit të leximeve, referencave e preferencave, ndërsa dy nyjat themelore të rrjetit të referencave mbeten Barleti e Biemmi që përftojnë edhe elemente diskursi, por pa e kthyer tekstin në *fjalim*, siç ndodh te narrativa historike e këtyre referencave. Këto shenja provojnë diskursivitet dhe reduktim emocionaliteti, por s'arrijnë ta largojnë Nolin nga ideologjia e parë që Skënderbeun, "atlet shume i fortë i Krishtit dhe luftëtar i palodhur", ta shenjojë si një revolucionar ideologjik, të lidhur me një klasë sociale, pretendim që identifikon ideologjinë e veprimin e pretenduar të *fshatarësisë* me ideologjinë nacionale.

Përtej kësaj tipologjie, *Historia e Skënderbeut* provon diskurs të motivuar që kthehet në lexim të motivuar, i cili ndjek narrativën historike, premisat e diskursit të Nolit shkrimtar, bashkë me teknikat e diskursit që pretendon të bindë. Premisat e tilla lidhen në nyja polemizuese dhe i provojnë *biografemat* e zgjedhura të Skënderbeut, të diskutuara nga dy pozicione përjashtuese, e që Noli do t'ua bëjë provën e vet përmjet zgjidhjeve të reja. Ndërsa, këto shenja së bashku e provojnë Nolin debatues të përjetshëm.

Dëshmia e Nolit për Skënderbeun lidhet me *biografema* të forta të Heroit, të disa periudhave të jetës së tij, të zgjedhura nga rëndësia dhe me pretendimin e provave të reja për to. Kështu, *Historia e Skënderbeut* e Nolit merr shenjën kritike e korrektuese dhe e provon sistematikën e kërkuesit si metodikë (*ideologjikë*) e si metodë.

Ndërsa, në rrafshin e *skajimeve* historike, luftën e Skënderbeut Noli e njeh për *kryengritje*, skajim që ngadalë rrëshqet në ideologji të shpallur të një klase popullore kundërfeudale, shenja të së cilës s'arrin të provojë teksti, por i thotë autori, për ta provuar veten në tekst si *subjektivitet* ideologjik. Në këtë pikë, kërkimi lidhet me mendimin ideologjik e me biografinë e Nolit, që të dyja të projektuara gjerësisht *shkrimtarisë* së tij.

Këto identifikime ideologjike i merr në vete diskursi që shtrihet përtej ndodhive e që përshkuan edhe përtej fakteve që lidh, për të shkuar drejt një ideologjie të pashpallur, por që jep shenjat e ideologjisë noliane, të shtrirë në veprën e tij që nga poezia e tek autobiografia. Kështu, fiksioni e dëshmia e Nolit lidhen në nyjën e ideologjisë së veprës që shkon përtej një teme e një diskursi dhe bëhet bosht i veprës në tërësi. Të gjitha shenja tipike për një autor autobiografik që shenjat e jetës e të ideologjisë së tij i sheh te të tjerët, qoftë dhe prapa në histori apo të provuara në bashkëkohësi. Kjo i shton *Historisë së Skënderbeut* edhe destinimin ideologjik që përbën *status* teksti dhe që e determinon komunikimin me veprën. Kështu, nga një *mit historik*, përskaj fakteve, Skënderbeu merr shenjat e një *miti ideologjik*, të shtruar me përkorje e tinëzi diskursi, por të zbuluar nga faktet që lidh teksti. Kështu, në rrafsh ideologjie e interpretimi të veprimeve e të ndodhive historike, *Historia e Skënderbeut* është Historia e Skënderbeut të Nolit, një *histori* e *ideologji* që, në pika të forta, mbetet *shkrimtari* (e motivuar).

III

Betoveni dhe Revolucioni francez është vepra që projekton ideologjinë e Nolit me insistimin më të fortë. Portreti i Betovenit kthehet në pasqyrë, në të cilën lexohet ideologjia e Revolucionit francez të vitit 1789, peshuar si ndodhi e epokës, histori politike e Francës, e propozuar si më-

sim ideologjik për Europën. Kjo e kthen *portretin* në *pretekst* e *ideologjinë* në *tekst*, ndërsa *narrativa biografike* kthehet në diskurs (të këndshëm) ideologjie.

Në këto shenja, *Betoveni njeri* kthehet në *Betovenin rebel* e revolucionar, një figurë e madhe *a posteriori* e frymës së Revolucionit francez, e kthyer në një figurë të madhe europiane, d.m.th. figurë përfaqësuese e mësimit ideologjik/politik francez në Europë.

Diskursi i tillë e kalon shpejt Betovenin e kulturës dhe e projekton fort Betovenin e ideologjisë, si një *zbulesë* të autorit që, përkundër *njeriut*, kthehet në figurë morale. *Betoveni rebel* ngadalë e eklipson *Betovenin njeri* (si empiri e si biografi) dhe të dhënat për jetën treten në mësim për moralitetin revolucionar të *rebelit*, të kthyer me fytyrë nga *autoriteti*, për ta kontestuar përfundimisht - të gjitha shenja të diskursit të Nolit, i cili lidhet si citim e përshkrim i diskursit të Betovenit.

Metoda e Nolit hapet kur vëmë përballë atributet për Betovenin *njeri* e *rebel*, i pari i përcaktuar si: *i shëmtuar*, *ulog*, *pijanik*, *dashnor* etj., ndërsa i dyti i lidhur me: *Rrethet revolucionare*, *Afetarizmin revolucionar*, *Parullat revolucionare*, *Ungjillin revolucionar*, *Adhurimin revolucionar të Heronjve* etj. Kështu, filli këputet e *rebeli* ndahet nga *njeriu*, për t'u shenjuar i pari si *personazh* kulture e i dyti si *person* jete. Betoveni jetoi e vdiq si *njeri*, me atributet që nënvizon fort Noli, por krijoi si një *ideolog*, thotë ekzegeza noliane, përherë e hapur për projeksione autobiografike e (auto)ideologjike.

Në vepra të projeksionit autorial, raporti i diskursit me ideologjinë bëhet parësor, meqë merr në vete shenja empirike të autorit, vetitë e rrëfimit, projeksionin ideologjik e shtresat e mësimit. Kështu, Noli lidh personin me rrëfimin dhe e kthen në *personazh*, faktet me situatat, të gjitha si diskurs e si *ontos*, për t'i kthyer në shtrat të ideologjisë.

Ndërsa, heroi i diskursit, njëherësh hero i epokës, bëhet figurë e ideologjisë së epokës. Kështu zbulohet edhe metodika noliane, e lidhur me diskursin, por e identifikueshme me ideologjinë, të cilën diskursi e manifeston si strategji autoriale. Në këtë pikë, në frymën e metodikës e

në shenjat e diskursit nolian, Betoveni *skajohet* njeri i epokës, *produkt* e *përfaqësues* i saj.

Krah heroit epik të shqiptarëve, Skënderbeut, Betoveni i kulturës bëhet heroi ideologjik i Europës, figurë universale, d.m.th. ideale, që lidh njerëzit rreth idesë së epokës, artikuluar si ideal e veprim revolucionar. Por, Skënderbeu vepron e ndërron situatat, Betoveni vjen *a posteriori* dhe kjo e bën atë më shumë figurë të mësimit për *sot*, sesa për dje. Në këtë nyjë lidh Noli diskursin dhe biografinë ideologjike të Betovenit e projekton si *biografi* të kohës së tij, madje të tij, të shenjës autobiografike e politike. Diskurset me ndërmjetësim janë noliane, sepse Noli i bën të tjerët të flasin për të dhe thotë se vetë u ngjan atyre, por kthehet për t'i bërë t'i ngjajnë atij. Në çdo hero një ideal, çdo hero në idealin e idealitetin e Nolit.

Në këtë pikë kalojmë te diskursi i Nolit për Nolin, për t'i zbuluar e lexuar ndodhitë e idetë e shenjuara në diskursin e dëshmisë personale.

IV

Narrativitetit që do dëshminë Noli i kthehet përfundimisht tek *Autobiografia* (1960), për ta hapur *personën* e tij si *personazh* dhe, paradoksalisht, për ta provuar fiksion e dëshmisë personale. Po, sepse personalja bëhet universale, ndërsa universalitet letrar do të thotë e mundshme letrare.

Në këto raste, *jeta* e *shkrimi* hyjnë në raporte përgjasimi, në të cilin i dyti e përshkruan të parën. Ndërmjet tyre ndodhen imitimi, zgjedhjet e pozicionimet autoriale, diskursi, madje figura, të gjitha shenja të fiksionit të dëshmisë. Ndërsa, provë për rrëfimin bëhet motivimi e jo dokumenti dhe kjo është një veti e procedurë letrare. Diskursi çdo person e kthen në personazh të vetin, qoftë kur rrëfen me përgjasime totale ndodhitë e tij, qoftë kur kërkon provën e rrëfimit. Në këto shenja lidhet rrëfimi autobiografik i Nolit për Nolin.

Për autobiografinë si *kategori* është tipik rrëfimi në vetën e parë, me të cilin fshihet distanca ndërmjet *subjektit* e *objektit*, ndërsa *subjektiviteti* shtrihet në trajtë statutare. Por, *Autobiografia* e Nolit është shkruar

në vetën e tretë, teknikë që i shërben mitologjisë së rrëfimit objektiv për veten.

Autobiografia është rrëfim retro/introspektiv. Pavarësisht vetës së shkrimit, gjithë ç'merr autobiografia është kohë e shkuar e ndodhi të mbyllura. Ajo i referohet kujtesës, por s'është memoar, prandaj e ribën jetën nga e para si diskurs. Distanca vihet në kohë e jo ndërmjet *subjektit* e *objektit*. Veta e tretë e *Autobiografisë* së Nolit (në raport me *kategorinë*) është virtuale, derisa rikrijimi i jetës jep idenë për autobiografinë si vepër rrëfimtare. Vetiu, *Autobiografia* është vepër lerare, në të cilën autori ndërton modelin letrar si hije të modelit jetësor.

Para se ta shkruante *Autobiografinë*, Noli projektonte veten herë në poezi, herë në historiografi e në biografi (*Betoveni dhe Revolucioni francez*). Tek *Autobiografia* ai i projekton të tjerët në qarkun e jetës së tij.

Autobiografia e Nolit përbëhet prej: Rrëfimit mbi jetën (që është korpusi i veprës); Bibliografisë; Komenteve mbi librin *Betoveni dhe Revolucioni francez*; Shënimeve biografike - një rimarrje në pika themelore e jetës, e dhënë në trajtë kronologjie. *Autobiografia*, duke rrëfyer jetën, jep edhe personalitetin. Këto dy nivele i takojnë tekstit që rrëfen jetën, ndërsa komentet vihen si shtresime mbështetëse/argumentuese të tekstit nga persona/autorë të tjerë.

Në planin formal, teksti i *Autobiografisë* është i përqendruar. Ka një strukturë retorike, e cila mbyll/redukton strukturën narrative. Ndonjëherë diskursi bëhet letrar, ndërsa, nga fundi i tekstit, mbizotëron *informacioni* e *informatori* tretet.

Rrëfimi mbi jetën, në planin e strukturimit, ndjek një procedurë: së pari *vendi*, së dyti *personi*, së treti *veprimi*, në fund *personat* e tjerë dhe raportet që ka me ta *personi* (referenti). Kjo procedurë mundëson vënien përballë të Historisë së personit e ndodhive të ambientit, për ta parë personin në raporte pëlqimi apo përjashtimi me ambientin. Ambienti motivon/determinon jetën. Ambienti i parë, vendlindja (Ibrik-Tepe), bën modelin kulturor fillestar që njeh e që pranon Noli. Shkollimi e njeh me konventën, teatri me jetën bredhacake e me pasionin për artin.

Rrëfimi mbi jetën ndërtohet duke iu referuar një rendi *biografemash*, të cilat janë pika themelore të historisë së personit, pika të (për)-thyerjes së jetës. Në tekstin e Nolit të tilla janë: shkollimi, teatri, jeta kishtare, veprimtaria politike etj. Këto *biografema* lidhen më shumë me zgjedhjen e autorit. Fëmijëria para shkollimit, sëmundja, përkujdesjet e Gjyshes, modeli i Babës etj., bëjnë *biografemën* e përftuar (pësore) e jo të ndërtuar (veprore).

Kur ndjekim rrjedhën e rrëfimit, *Autobiografia* kap e lidh jetën e Nolit në Ibrik-Tepe, në Adrianopojë, Stamboll, Athinë e Egjipt, në SHBA e Shqipëri. Jeta, si dhe veprimtaria e Nolit, dallon nga vendi në vend; në Athinë ai lidhet me teatrin, në Shqipëri me përpjekjet politike etj. Derisa ruhet përherë si kujtesë e si fill teksti vitet e hershme në Ibrik-Tepe.

Noli rrëfen jetën e vet si jetë misionari dhe diskursi kërkon figurat e identifikimit. Së pari Napoleoni, pastaj Skënderbeu e Jezusi. Këto janë figurat ideale të tij. Dy figura historike dhe një religjioze/morale, si nyja lidhur për të cilat e end ai mitologjinë e idealitetit.

Napoleoni si shenjë e revolucionit, Skënderbeu si hero e ide e etnisë shqiptare, Krishti si figurë morale që, së bashku, përfaqësojnë ide/ veprime. Noli u identifikua me Krishtin në poezi, e shkroi historinë e Skënderbeut, pastaj biografinë e Betovenit në raport me Revolucionin francez. Kjo është fusha e kulturës, ndërsa Noli përherë ruajti mallin për t'u ngjarë këtyre figurave edhe përtej shkrimit, në jetë, në përpjekjen shqiptare e në jetën politike. Në SHBA, u vu në krye të shqiptarëve, udhëhoqi Kishën Ortodokse Shqiptare, me një përmbysje të dhunshme, në trajtë grusht-shteti, erdhi në pushtet dhe u bë kryeministër i Shqipërisë. Duke bërë bashkë këto pika, ai thuri/jetoi *mitologjinë personale*, të projektuar në disa rrafshe e mosha të jetës së tij.

Autobiografia u shkrua nga fundi i jetës së Nolit dhe u botua si pjesë e *Fiftieth Anniversary Book of the Albanian Orthodox Church in America* (1960), që ka për objekt veprimtarinë e Kishës Ortodokse Shqiptare në SHBA. Duke e përfshirë jetën e vet në këtë vepër e si pjesë të kësaj veprimtarie, Noli e lidh *veprimtarinë* nacionale me *jetën*. Veprimtaria e tillë

dhe jeta e tij bëhen prova për njëra-tjetrën, ndërsa kurorë kanë *ideologjinë* që përcakton *veprimtarinë*.

V

Ideologjika është termi që shenjon *metodikën* e projektimit të ideologjisë në interpretime të teksteve apo në diskurset e Nolit. Kjo e shenjon projeksionin si sistematikë të *shkrimtarisë* së Nolit dhe bëhet një shenjë e poetikës dhe e kulturës së veprës së tij. Ndërsa, në terma më të fortë, shenjon Nolin autor ideologjik dhe kjo hap çështjen e modernitetit të veprës së tij, të shenjës kritike, përballë *mësimit* të ideologjisë e *shenjimit* të veprimeve. Kështu, *ideologjika*, nga projeksion i ideologjisë në veprës, kthehet në projeksion të veprimit në jetë dhe kjo e çon veprën te pragmatika.

Noli *shkrimtar* e njeh veten përherë edhe si *veprimtar* e *shkrimtarinë* edhe si akt dëshmie që çon në *ideologji*, për ta kthyer shkrimin në ideologji. Këto shenja merr e jep diskursi e i provon më fort vepra diskurseve e Nolit, në procedura e në rrafsh idesh, për të kërkuar lexim idesh. Ky s'është një *mësim*, por një *propozim* për një *metodikë* të *njohjes* e të *shkrimit*, me rrënjë në veprën e Nolit, një metodikë që sistematikën e shkrimit të veprës e kthen në sistematikë të leximit, që d.m.th. e ruan si *autentikë* (*ideologjikë*).

Kujtim SHALA, Prishtina

NOLI: HISTORY…, REVOLUTION… AND AUTOBIOGRAPHY

Symmary

History…, Revolution… and Autobiography are discursive and reference works which show Fan S. Noli as a scholar and narrator, his preferred discourse, it means Noli as a *writer*.

History…narrates and analyzes the Albanian national hero, *Revolution*…the socialist model selected by Noli, while *Autobiography* connects in one place Noli's life and work as a narration and evidence.

Skënderbeu is the figure that will resemble Noli in the national life, he experienced revolution himself; Autobiography, also, reveals other Noli's identification figures, the Christ-a moral hero and Napoleon-a militant hero.

The discourse of *History*…requires discursiveness and evidences, the one of *Revolution*…-social projection, while the discourse of *Autobiography* makes Fan Noli an *informant and personage*.

In these works, Noli is depicted using rare arguments, ideology and personal projections and evidences.

These works certify the selected Albanian scholar and stylist, the rhetorician who knows the power of argument and message, *the author* who writes face to face with the receiver, it means the author who always writes with a rhetorical (convincing) tendency.

These books, written and edited in different times of the author's life, certify the constants of Noli's discourse and connect the network of his ideas with a narrated and experienced ideology.

Mehmet HALIMI, ASHAK, Prishtinë

FUNKSIONI SEMANTIK E ARTISTIK I KOMPOZITAVE NË VEPRIMTARINË LETRARE TË NOLIT

"Vetëm arti e shkenca e ngrenë
Njerinë në shkallën e hyjnive"
(Betoveni).

Njëra ndër kolonitë shqiptare në Amerikën e largët tejoqeanike, që zhvilloi një veprimtari të gjallë, të pasur e të ngjeshur politike e patriotike, nga njëra anë, por edhe letrare e poetike, historike e shkencore, nga ana tjetër, jo vetëm e ruajti me shekuj gjuhën amtare e traditat kombëtare e fetare, por edhe i kultivoi e lëvroi me nostalgji e dashuri, i thelloi, i zgjeroi e studioi me vullnet e përkushtim e me kriter studimor shkencat albanologjike në frymën e orientimeve të shtetit amë dhe të synimeve e parimeve kombëtare në tërësi, duke dhënë kështu një kontribut të madh nga aspekti sasior dhe shumë të çmueshëm nga aspekti cilësor në këtë fushë studimore të shkencës shqiptare në tërësi.

Në mesin e një lagjeje patriotësh e shkrimtarësh shqiptarë në Amerikë, që u degdisën, u përplasën e u rropatën nga valët e jetës, deshi rasti e çasti e bardhëdita të takohen në këto meridiane të rruzullit tokësor, shokët, miqtë e vëllezërit dhe pendat më të shquara të letërsisë sonë, si: Faik Konica, Kristo Floqi, Kristo Doko, Anton Çefa, Dalip Greca, etj., por mbi të gjithë që na la mbresë e shpresë, me punën e tij të madhe kombëtare e fetare, të vëllimshme e të nduarnduarshme, ishte Fan S. Noli, i cili na shpërfaqet si një lis shekullor, që bënte hije për një fis e për një komb, e që nën hijen e këtij lisi hijemadh u tubua, u bashkua dhe u zhvillua veprimtaria shkencore kombëtare e fetare e tërë komunitetit shqiptar në

Amerikë, duke mbajtur lidhje të vazhdueshme me popullin e atdheun e vet, ata jetuan, vepruan e punuan vijimisht për atdheun e tyre, duke dhënë kontribut të madh në studimin e shkencave albanologjike në Amerikë.

Ndonëse Fan Noli, nuk u muar kryesisht me çështje gjuhësore, por megjithatë, ai në veprimtarinë e vet letrare përdori një stil të rrjedhshëm dhe zbatoi në hollësi e qartësi veçantinë gjuhësore, duke përdorë fjalë të zgjedhura e të latuara me nuanca të holluara e të stërholluara semantike e artistike, që i japin shije poetike e melodike vargut të poezisë së Nolit, në veçanti dhe fjalisë, periudhës e sintaksës së prozës së tij në përgjithësi.

Si njohës i mirë i një numri të konsideruar gjuhësh botërore, Noli e njohu dhe e nuhati holl shijen dhe aromën, shpirtin, frymëmarrjen dhe natyrën e gjuhës së vet amtare. Njohuritë e thella origjinale për gjuhën e vet amtare ai arriti t'i zotërojë e t'i përvetësojë "*ashtu këmbëkryq me plakat e Shqipërisë që e kishin shpurë në dhe të huaj gjuhën e popullit virgjër, Noli thëthinte nektarin, të cilin e çkrinte pastaj në art".*[1]

Noli ishte mjeshtër i përdorimit të fjalës në aspektin semantik e artistik, prandaj ai kishte kujdes të veçantë dhe mendonte holl kur përdorte gjuhën me shije e hijeshi, kurse fjalën e përdor me vend në çdo shkrim e në çdo kuvend, me masë e me karar që kishin vlerë me ar, duke pasur kështu, synim e qëllim parësor që fjala e tij semantikisht e artistikisht të shpreh sa më saktë, sa më qartë e sa më besnikërisht konceptin e tij të plotë e origjinal mendor. E. Çabej e cilëson madhështinë e tij me këtë definim: *"Noli na paraqitet si një lis i moçëm e plot gdhenj: lis i vetmuar, por me rrënjë ngulur mirë në të thellat e dheut. E këtillë mbetet edhe gjuha e tij"*[2]*.* Ndërsa Mitrush Kuteli stilin e Nolit e cilëson: *"Fan Noli është mjeshtër i krijimit të gjuhës letrare shqipe. Stili i tij është epigramatik, i fuqishëm, i rrëmbyeshëm, lirik dhe epik njëkohësisht. Ai personifikon shpirtin heroik të racës sonë"*[3]

---

[1] Nonda Bulka, Fan. S. Noli Ndërbashkëkohasit, ribotoi Rilindja, l968, f . 211 .

[2] Eqrem Çabej, po aty, f. 224.

[3] Mitrush Kuteli, Komente të ndryshme mbi Nolin, në Fan S. Noli, Autobiografia, Rilindja, Prishtinë, 1968, f. L12 .

Gjuha ka mjete të shumta dhe mundësi të gjera e të nduarnduarta për të shprehur shkrimtari mendimet personale, qoftë në veprat e veta origjinale, qoftë në ato të përkthyera, të përshtatura apo të shqipëruara, të cilat nëse përshtaten ose shqipërohen me veçanti gjuhësore, jo vetëm i shëmbllejnë origjinalit, por edhe mund ta tejkalojnë atë, siç është poezia "*Korbi "* e Edgar Allan Poe-s[4] dhe "*Anabel Lee", "Përkthimi i Rubairave të Omer Khajamit"* në shqip nga Fan Noli, është më i mirë se ai i kryer në çdo gjuhë tjetër të Europës, me përkushtim ndofta të atij të Edward Fidzgerald-it"[5], etj. Dhe "*Fiziologjia e vjershës Noliane është jo tuli, po muskla dhe eshtra. Nuk është kontemplativ, pasiv, pritës, po buçitës, sulmonjës, dërmonjës. Vargu i tij nuk është vizual, po auditiv. I drejtohet pra veshit, jo syrit"*[6]. E këto veçori të gjuhës së vet amtare, Noli i shfrytëzoi racionalisht me shije e me masë. Njëra ndër këto veçori gjuhësore për të shprehur sa më me veçanti funksionet semantike e artistike në veprimtarinë letrare të Nolit janë edhe kompozitat, të cilat janë fjalë të përbëra dhe të formuara prej dy e më shumë temave ose fjalëve në një njësi të vetme fonetike, leksikore e gramatikore[7], që sipas mendimit tim ose e sforcojnë një mendim a kuptim, ose sjellin një kuptim kryesisht të ri: Kuptim, i cili e freskon, e zgjeron dhe e pasuron gjuhën tonë të bukur amtare. Gjuha pa kompozita është e varfër, e ngurtë dhe e papërpunuar, pikërisht si brumi i pagatuar dhe i papetëzuar. Kompozitat ofrojnë mundësi të gjera semantike dhe artistike, duke i dhënë gjuhës në përgjithësi dhe ligjërimit tonë zhdërvjelltësi, bukuri e hijeshi shprehimore, në veçanti.

"*Këto mundësi të gjuhës i shfrytëzon çdo folës, çdo individ i çdo treve a krahine gjuhësore qoftë ai, do të thotë mbarë një popull. Sepse kompozitat popullore përfaqësojnë gurrë të pashtershme në pasurimin e*

---

[4] Fan S. Noli, ALBUMI, Rilindja, Prishtinë, 1968, f. 100-105.

[5] Fan S.Noli, Ndër bashkëkohasit, Prishtinë, l968, f. 24.("Përkthimi i Rubairave Të Omer Khajamit në shqip nga Fan S. Noli është më i mirë se ai i kryer në çdo gjuhë tjetër të Europës, me përkushtim ndofta të atij të Edward Fidzgeraldit"(Dr. Norbert Jokl)).

[6] Mitrush Kuteli, Poeti Fan S. Noli, vështrim panoramik (Ribotuar nga libra "Mall e brengë", Tiranë l943), Albumi, Rilindja, Prishtinë l968, f. 25.

[7] Fjalor i fjalëve të huaja, Prishtinë, l988, f. 3l5.

gjuhës letrare. Këto ofrojnë mundësi të gjera për të shprehur nuanca kuptimore shumë të holla me shije gjuhësore të veçantë. Mirëpo, në formë më të zgjedhur, më të përsosur e më të përkryer dhe më të latuar, i ndeshim të përdoren në zdrukthin poetik të shkrimtarëve e të poetëve, të cilët shquhen për mjeshtrinë e fjalisë, të gjuhës e të stilit, e njëri ndër shkrimtarët e kësaj lagjeje është edhe Noli, madje duke u dalluar nga të gjithë bashkëkohasit e vet"[8].

Noli në veprimtarinë e vet artistike, shquhet për një gjuhë të pasur, me veçori edhe semantike edhe për një stil konciz me një efekt ekonomizues të fjalës dhe për përdorimin e kompozitave të zgjedhura e të qëlluara, të cilat do t'i marrim në shqyrtim në kumtesën tonë.

Tipat e fushës së fjalëformimit, në veprimtarinë letrare të Nolit janë të nduarnduart, por në këtë rast, unë do të veçoj vetëm një lloj të tyre, atë kompozitor, duke pasur parasysh efektet gjuhësore dhe funksionin e tyre semantik e artistik në vargun poetik nolian apo edhe prozodik.

Tipat e kompozitave në vargun nolian

Në këtë nënkapitull të këtij studimi do t'i klasifikojmë kompozitat e vargut nolian sipas llojeve dhe tipareve, duke sjell shembuj në përdorimin dhe zbatimin e tyre konkret. Në veprimtarinë letrare të Nolit kemi spikatur disa tipa të fjalëformimit kompozitor. Këtu në vijim po veçojmë disa prej tyre siç janë:

1. Kompozitat e tipit emër + emër, që përfaqësojnë kompozitat dygjymtyrëshe, ku gjymtyra e parë përcakton gjymtyrën e dytë, që shërben si ndajfolje ose cilësor i saj. Këtë tip e ndeshim dendur në vargun nolian. Ndër këto më frekuentueset janë kompozitat që po sjellim në vijim: *zemërkrund, zemërhekur, kryeprofet, kryemjek, kryefe, kryerojtja, kryemjeshtri, vllavrasje, gojmjalt, sulltan-llokum, salep-sulltan, njeridashje,*

[8] Mehmet Halimi, Kompozitat në veprimtarinë letrare të Nolit, botuar në veprën Çështje fjalëformimi në gjuhën shqipe, Prishtinë 1996, f. 232 (Punim i përpunuar, i zgjeruar dhe i riformuluar nga një kundrim e trajtim tjetër).

gojçthurje, gjysmëbotë, gjysmëhënë, ferrë-hapsanë, qjell-hapsanë, flagë-vesë, foshnje-dramë, mendje-foshnje, mesnatë, shpirt-ëngjëll, rrethrasje, kryeushtar, hundë-shkabë, rrufe-shkabë, flamurgjak, etj.,te të cilat disa përdoren pa vizëlidhëse, kurse disa me vizëlidhëse.

2. Kompozitat e tipit: emër + pjesore, të cilat gjithashtu kanë përdorim mjaft të shpeshtë në krijimtarinë artistike të Fan Nolit, siç janë për shembull kompozitat në fjalë:

Zemërthyer, zemërprerë, rrobe-çqyer, poçe-thyer, buzë-qeshur, , shpirt-këputur, shpirt-thumbur, faqebardhë, faqe-ndritur, faqe-çjerrur, syrgjyn-vdekur, syrgjyn-gjallë, lesh-lëshuar, duar-lidhur, faqe-nxirë, kokë-ngrirë, vdekje-grirë, perçe-prerë, brymë-shkrirëse, formë-çkoqur, barkpër-mbytur, derë-mbyllur, krah-përdredhur, çizme-sjellës, paqedashës, punë-dhënës, mësimdhënës, etj.

3. Kompozitat e tipit emër + mbiemër, janë përdorur ngjeshur në vargjet e pozisë së Nolit, ku pjesa e dytë në funksion të mbiemrit, përcakton cilësitë e pjesës së parë të kompozitës, duke luajtur funksionin gjithmonë të mbiemrave cilësorë, siç e dëshmojnë shembujt vijues: *zemër-gjerë, zemër-mirë, shpirtmirë, shpirtzi, nëmërëndë, perçe-shkrumb, rrufé-shkab, flamur-gjak, fushë-kuq, shkabzí, flokëbardhë, themel-fortë, sy-je-shill, qimezezë, qimekuqe, faqe-kuqe, derësterrë, kryetrim, bukëthatë, mendje-lehtë, gjakpirës, shpirt-robi, derë-sterrë, syrgjyn–vdekur, kryemur-gesha, kokëshkretë, kokëfortë.*

Shënim

Këtu ndeshim një tip kompozitash me mbiemra jo të mirëfilltë, por që janë emra në funksion të mbiemrit. Këta janë emra të mbiemërzuar (të adjektivizuar)[9], si për shembull: *shkab, gjak, argjend, trim,* që duke marrë funksionin e mbiemrit, pra duke u adjektivizuar janë formuar kompozitat në fjalë: *rrufe-shkabë, flamur-gjak, këmbë-argjend, krye-trim,* etj.

Ndërkaq, kompozitat: *keqbërës, mirëbërës, (sin. bamirës), mirëda-*

[9] M. Halimi, Emra të mbiemërzuar, Gjurmime albanologjike, SSHF, nr. 27, 1997, 63-70.

shës, i përkasin tipit *mbiemër + particip,* që gjithashtu janë shumë të përhapura në të folme popullore[10].

4. Kompozitat e tipit *përemër + emër, në veprimtarinë letrare të Nolit ndeshim edhe në tipin e kompozitave përemër + emër.* Këtu si gjymtyrë e parë e kompozitës përdoret përemri vetëvetor *vetë + emër,* si për shembull kompozitat: *vetë-ndjenjë, vetë-besim, vetë-vrasje, vetë-varje, vetë-kontroll, vetë-mbrojtje, vetë-qeverim e vetë-qeverisje, vetë-sundim,* etj.

5. Kompozitat e tipit *emër+ndajfolje,* në krahasim me një pasuri të madhe dhe me një përdorim të shpeshtë e të ngjeshur në të folmet popullore dialektore[11], në vargun nolian i ndeshim më rrallë, por megjithatë edhe ky tip kompozitash është i pranishëm në krijimtarinë letrare të Nolit, siç janë kompozitat: *syrgjyn-gjallë, sheqer-kësmet, vullnet-sëmurë, shkël-qim-plotë, sy-përpjetë, nëmë-rëndë,* etj.

6. *Në* shkrimet e Nolit qet krye edhe një tip shumë i rrallë kompozitash, që rrallë e tek e ndeshim në shkrime të shkrimtarëve të tjerë, e ky tip kompozitash është i ndërtuar me ***pasthirrmë+emër****, si psh. Vaj-vatani, mjer-mileti (shih vargjet:*

"Ku e lamë e ku na mbeti,
Vaj-vatani *e* ***mjer-mileti****)*[12].

Përveç Nolit nga shkrimtarët e hershëm, gurrën e pashtershme të përdorimit dhe të zbatimit të kompozitave e kanë shfrytëzuar me mjeshtri

[10] M. Halimi, Mbi disa kompozita në të folme popullore, në vëll. Çështje fjalëformimi në gjuhën shqipe, Prishtinë, l996, f. 8l-85(Si psh. Derëdalje (s' ka tjetër derë), qafëgatë, qafëbardhë, kryemadh, ballëgjanë, buzëhollë, buzëçerep, kamgate, bishtcub-e, dhamëçatall, veshmadhe, dorëthatë, dorëhollë(i varfër), hallkeq, halllig, shnetlig, etj.).

[11] M. Halimi, Kompozitat ndajfoljore, në vëll. Çështje fjalëformimi në gjuhën shqipe, Prishtinë, l996, f. 87-98(Ku kemi marrë në shqyrtim të gjitha llojet e kompozitave ndajfoljore, duke filluar nga kompozitat ndajfoljore të vendit, të kohës, të mënyrës, të sasisë, të pohimit e të mohimit deri tek ato të dyshimit).

[12] Nga Albumi i ribotuar në NGBG Rilindja, Prishtinë l968, f. 65.

edhe shkrimtarët e Rilindjes Kombëtare, si: Kristoforidhi[13], Faik Konica [14], Mitrush Kuteli[15] e shumë shkrimtarë të tjerë të kësaj periudhe, por edhe shkrimtarë të periudhave të mëvonshme.

Nga studiuesit e njohur me studimin e fjalëformimin në përgjithësi dhe me fjalëformimin kompozitor, në veçanti, janë marrë: A. Xhuvani – E. Çabej[16], A. Kostallari[17], M. Halimi[18], N. Veselaj[19] e shumë të tjerë.

Të shohim efektin gjuhësor dhe funksionin semantik e artistik të kompozitave në zbatimin e tyre konkret. Noli në vargjet e tij poetike, me shije e me kripë, e kripa me karar, me dashuri e intimitet njerëzor, me plot respekt e ndjenjë shoqërore, si ndaj subjekteve, po ashtu edhe ndaj objekteve të personifikuara, arriti të shpreh me veçanti të rrallë gjuhësore, poetike e stilistike nëpërmjet fjalëformimit kompozitor. Mirëpo, shpeshherë me anë të kompozitave të zgjedhura semantikisht e artistikisht, arriti të shpreh edhe dukuri negative dhe vese e dukuri të personave të një shoqërie përkatëse, duke u dhënë vargjeve poetike frymë ironizuese, ton satirik dhe kritikë sarkastike. Në këtë aspekt poeti arriti me sukses të kritikojë e të fshikullojë dhe të thumbojë sjellje e veprime, vese e dukuri të shëmtuara të shoqërisë apo regjimit pushtetor të kohës së vet. Ja për shembull në poezinë satirike *"Shën Pjetri në mangall",* me mjete kompozitore të gjuhës amtare arrin efekte të fuqishme në funksion semantik e artistik të një satire poetike:

"Se ç' vajton Shën Pjetri hidhur

---

[13] M. Halimi, Tipat e fjalëformimit në Fjalorin e Kristoforidhit në vëll. Çështje fjalëformimi në gjuhën shqipe, Prishtinë l996, f. l9l-224.

[14] M. Halimi, Kontributi i Faik Konicës në fushë e fjalëformimit, vep, cituar, f. 215-230

[15] M. Halimi, Çështje fjalëformimi në veprën e Mitrush Kutelit, vep. cituar, f. 246-26l.

[16] Aleksandër Xhuvani-Eqrem Çabej, Prapashtesat e gjuhës shqipe, Tiranë l962 (shih edhe veçantë kompozitat, Tiranë l972).

[17] Androkli Kostallari, Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe, në vëll. Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, Tiranë, l972.

[18] M. Halimi, Çështje fjalëformimi në gjuhën shqipe, Prishtinë, l996.

[19] Nuhi Veselaj, Çështje të shqipes standarde në fushë të leksikut dhe të fjalëformimit l, Rilindja l997. (Shih edhe Dr. Nuhi Veselaj, Rreth formëzimit të emërtimit të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe, Prishtinë, 2014.).

Lesh – lëshuar**, **duar – lidhur
Tri herë e mohoj pa gdhirë,
Faqe – nxirë”[20].

Po kështu me anë të përdorimit të kompozitave origjinale noliane fshikullohen me hatër e me satër fytyrat negative, sipas qëndrimit të poetit, të klikës së qeverisë antipopullore:

“Një mexhlis të madh na çeli,
Pandeli Jano Vangjeli,
*Me **sulltan-llokum** na veli*
Si kofini pas të vjeli”.
Fyt i Floqit po pëllet,
Top i Krosit po kërcet:
Ç’ është ky sheqer–kësmet?
Hallvaxhin’ e pamë mbret!
Se ç’na piu italjani,
*Rroft **Salep-sulltani**”*
(Nga kënga e Salep-sulltanit)[21]

Ndonëse në një numër të konsideruar vargjesh, ndeshim vetëm në tri kompozita, ato shënojnë kulmin satirik të poezisë në fjalë. Përdorimi i tyre semantikisht e artistikisht kryen një funksion të caktuar poetik në vargun nolian. Madje, vargjet tjera, ndonëse në mënyrë të tërthortë e fuqizojnë edhe më tepër funksionin poetik të vargut të caktuar, që ngërthen në vete pikën kulminante të satirës të shprehur me anë të kompozitës së tipit të caktuar. Nga ana tjetër, Noli kur është fjala për bashkëpunëtorët e vet të ngushtë, të dashur e besnikë gjatë tërë jetës, nëpërmjet kompozitave me një ton të ngrohtë patetik e elegjiak, intim e shpirtërisht prekës, melankolik e mallëngjyes, shpreh pikëllimin e dhembjen, respektin e adhurimin, mburrjen e krenarinë për shokët e ngushtë të jetës, që ranë

[20] Nga Albumi i ribotuar, NGBG Rilindja, Prishtinë, l968, f. 45.
[21] Vepra e cituar, f. 56.

dëshmorë për progresin kombëtar:

"Nëno moj, ç' është përpjekur

***Gojëmjalt'** e **zemër – hekur**,*

***Syrgjyn – gjall'** e **syrgjyn – vdekur**,*

Ky vigan liberator".

(Nga elegjia kushtuar Luigj Gurakuqit)[22].

Edhe në elegjinë kushtuar bashkëveprimtarit besnik e shokut të ngushtë të luftës e të armës, Bajram Currit, gjithashtu ndeshim në vargje të shprehura me anë të kompozitës:

" Atje nisi, atje mbaroj,

Atje krisi, atje pushoj.

***Rrufé – shkab'** e Malësisë,*

Në një shkëmb të Dragobisë"

(Nga poezia "Shpell' e Dragobisë")[23]

Janë këto elegji binjake në të cilat me anë të përdorimit semantik e artistik është arritur efekti poetik, nga njëra anë, ku shprehen ndjenjat më të ngrohta me plot dhembje e nostalgji të Nolit për shokët e tij besnikë, veprimtarë dhe luftëtarë të paepur e të paluhatshëm në realizimin e qëllimeve dhe idealeve të tyre të larta, nga ana tjetër, të cilët sakrifikuan jetën e tyre në shërbim të popullit e të atdheut.

Pra, nga shembujt e zënë ngoje mund të dëshmohet se sa të fuqishme janë kompozitat si mjete shprehëse gjuhësore, çfarë efekti semantik, artistik e poetik mund të arrihet me to, kur ato përdoren në pendën e një mjeshtri të fjalës e të vargut, siç ishte Fan Stilian Noli ynë i madh e universal.

Nuk ka dyshim pra, se kompozitat si elemente gjuhësore, janë shumë funksionale si në ligjërimin bisedor, po ashtu edhe në shkrime poetike. Çfarëdo përshkrimi sado i përpikët qoftë ai, me një bagazh fjalësh e shprehjesh të nduarnduarta, ato nuk mund t'i zëvendësojnë kompozitat e zëna ngoje në mendimin, synimin dhe qëllimin e caktuar, që dëshiron ta

[22] Vepra e cituar, f. 58.

[23] Po aty, f. 59.

shpreh folësi apo poeti e shkrimtari në një situatë të caktuar për një dukuri të caktuar shoqërore apo për ndonjë cilësi njerëzore të personazheve letrare.

Gjuha shqipe, veçanërisht ajo popullore, është e pasur me kompozita. Këto kompozita shërbejnë si gurrë e pashtershme për të pasuruar gjuhën e shkruar letrare kombëtare. Ato hapin shtigje të shumta e të gjera për të shprehur nuanca kuptimore me shije të hollë gjuhësore. Ato sipas mendimit tim janë melmesa dhe kripa e gjuhës, të cilat kur përdoren me vend e me karar, i japin shije dhe hijeshi, duke e njomësuar e lëngëzuar gjuhën tonë të bukur amtare, i japin asaj musht e freski dhe fuqi shprehëse me efekte të fuqishme semantike e artistike, që mund të shërbejnë si model unikat për majat më të larta të artit tonë kombëtar, duke i konkurruar artit më të përkryer botëror.

Pra, nuk ka gjuhë të thjeshtë, por ka mendime të thjeshta. Sepse edhe me një gjuhë të thjeshtë, mjeshtri i mirë i fjalës dhe shkrimit mund të na japë vepra të përkryera me funksion e porosi të lartë semantike e artistike.

Fan Noli, duke qenë i vetëdijshëm për këtë pasuri leksikore të gjuhës së vet amtare, përveç që i përdori me veçanti gjuhësore, semantike e artistike këto kompozita, por duke pasur gjithmonë si gjedhe kompozitat popullore, ai lëntoi edhe vetë kompozita të reja e origjinale në veprimtarinë e tij letrare.

Ndër më frekuentueset e më standarde në shkrimet e Nolit janë kompozitat me emrat *krye dhe zemër.* Këtu po sjellim disa shembuj të kompozitave me pjesët e parme *krye* dhe *zemër* në disa nga poezitë apo prozën e Nolit:

"Krye-profetit dita i ngryset
Dhe shpirt – këputur përdhe përmbyset
Me lot në sy, me zemër të ngrirë
I lyp mëshirë".

(Nga poezia "Moisiu në Mal")[24]

[24] Po aty, f. 37

Ndërsa, te poezia *"Marshi i Krishtit",* kompozitat*: kryetrim, kryemjek, kryeshenjtë, Kryefe,* simbolizojnë vetë poetin, sepse Noli veten e identifikon me Krishtin shpëtimtar:

"***Kryetrim****, që lufton, triumfon për atdhé,*
Shpëtimtar, ***kryemjek****,* ***kryeshenjtë****,* ***kryefé****,*
Pasuri dhe liri dhe fuqi ti na dhé,
Lum e lum, Galilé: Hosaná, hosaná!"[25]

Meqenëse Noli shquhet për përdorimin e dendur të kompozitave në veprimtarinë e tij origjinale, ai këtë cilësi e shprehi të përdorimit të tyre , si mjeshtri shkrimore e praktikon, e zbaton dhe e përjetëson edhe në përkthimet e tij:

"Dhe qatipi i tmerruar
Shkroj në dritën e drithmuar,
Afër zjarrit, i dërmuar,
Flokë-bardhë*,* ***kokë-ngrirë***
Zemër-prerë*,* ***vdekje-grirë*** [26]

Kryerojtja *udhën hap,*
Praparojtja *ren me vrap,*
Dhe anmiku gjakësor
Si me drapër grin e korr" ("Skënderbeu")[27]

Edhe te përkthimi i "Rubairave" ndeshim kompozita të rralla, por të përdorura me mjeshtri të lartë:

"*Më mirë* ***bukë-thatë*** *e* ***rrobe-çqyer****,*
Me ujë rro, i lirë, ***poçe-thyer****"*[28]

Apo:

[25] Vepra e cituar, f. 39.

[26] Vepra e cituar, f. 80 (Nga poezia "Skënderbeu").

[27] Vepra e cituar, f. 78.

[28] Përkthime nga Prometheu i mbërthyer, Nga "Rubairat", f. 96.

*"Një **mesnatë** e bezdisur*
*donëse je **perçe-prerë**.*
S' ka dyshim, je trim i ndjerë
***Derë-mbyllyr**, **derë-sterrë**"*[29]
"Duar-lidhur, zemër-thyer,
Hundë-shkabë, sy-petrit"[30]

Kurse me pjesën e parme të kompozitës *zemër* dhe pjesën e dytë (gjymtyrën e dytë të kompozitës), që mund të jetë ndonjë fjalë tjetër, ndeshim gjithashtu një varg kompozitash:

Zemërkrund, zemërhekur, zemërprerë, zemërdhimbje, zemërgjerë, zemërthyer, zemërmirë, etj.

Për shembull sa e rëndë,sa thumbuese e sa fyese,sa nënçmuese e sa përbuzëse është shprehja me kompozitën *zemërkrund (zemër-krund)* e dëshmojnë këto vargje:

"*O i çgryer, i thyer, i vyer, për hu,*
Trup' e ndot kundërmonjës të krrusun mbi gju,
Dallkaukët, kopukët e turmat pa tru,
***Zemër-krund** e gërdhu: **Hosaná Barabbá**"*
(Nga poezia "Marshi i Barabajt)[31]

Në këtë poezi, kompozitës ***zemër – krund**,* i paraprijnë një breshërimë fjalësh, që shprehin një ton të thellë ironizues për ta fuqizuar atë dhe

[29] Vep. cit. nga *" KORBI ",* f. 98.

[30] *Nga Fan S. Noli, ligjërime introdukta,* Prishtinë , 1968, f. 10, 11 ("*Dhe Princesha Vojsava qanë e i lutet perëndisë: **duar-lidhur, zemër-thyer: "** Tre m' i more për mëkatet e mia, këtë të katërtin m'a fal, mos ma merr o Zot; mos na e mbyll shtëpinë".* Qanë nëna për një bir, qanë edhe shpata për një burrë ! Gjer kur do ta pres nëna të birin, Kruja të Zotin, Shqipëria t'anë, bota trimin, që s'ka shok. Po përnjëherë hapet dera dhe hyn brenda një luftëtar i hieshëm, fisnik dhe madhështor: ***hundë – shkabë, sy – petrit** me mjekër të gjatë e të dredhur, i veshur me çelik, i armatosur gjer në dhëmbë, statuja e gjallë e Marsit.*

Në mos je hie a fandasmë që vjen të gënjesh një plakë të varfër, një qyqe të neveritur, ti je im bir, ti je Gjergji im. Folë ! Folë ! mos më mundo!")

[31] Po aty, f. 47.

për ta shprehur ajo efektin kulminant satirik e poetik të poezive në fjalë. Mirëpo, princeshë e mbretëreshë e të gjitha këtyre fjalëve, e cila ka ngarkesë dhe funksion semantik e artistik, e që mbizotëron e veçohet mbi të gjitha fjalët tjera dekorative e ndërplotësuese është kompozita ***zemër – krund***, e cila siç thotë populli *"me hatër e satër"(me hir e me zor),* shpreh thumbimin më të mprehtë, më të fuqishëm, më satirik, më ironizues, më fyes e më sarkastik deri në zhvlerësim të dinjitetit njerëzor. Prandaj, mund të thuhet se përdorimi kaq i dendur i këtyre dy kompozitave të paraprira me pjesët e parme ***krye-*** dhe ***zemër-*** shihet qartë se ka për qëllim të shpreh efekte simbolike dhe satirike.

Noli me sukses zbaton përdorimin e kompozitave edhe në truallin e letërsisë së përkkthyer apo më mirë të themi të përshtatur apo të shqipëruar. Në poezitë dhe prozat e përkthyera nga Noli spikatet përdorimi me shije të hollë gjuhësore e artistike i kompozitave të zgjedhura me funksion të thellë e të gjerë semantik e poetik:

"Me daullegjinjt' e gjat' e kokëpendë
Të shembur, të plagosur thell' e rëndë.
Dishfata llahtarisur dhe ***fytyreshur****,*
Dishfata del përpara çdo ushtarë e batalioni,
Bërtet ***krah-përdredhur****: "Ikni dhe shpëtoni!"*
("Waterloo")[32]

Edhe në prozë ndeshim mjaft shpesh përdorimin e kompozitave, si te: "Kont Leon Tolstoj, është ikonoklasti dhe ***kryerevolucionari*** intelektual i shekullit të nëntëmbëdhjetë *"**kryemotivi***[33] *ose "Dezdemona është edhe ajo aq e padjallëzuar dhe aq* ***mendje-foshnje. . . është aq shpirt-engjull*** *sa s' di që bëri faj"*[34]

Noli përkthen vepra e fragmente veprash nga shkrimtarët më të shquar botëror, si Henrik Ibseni (" *Armiku i Popullit"),* Servantesi (*"Don Ki-*

[32] Po aty, f. 125.

[33] Fan S. Noli, Ligjërime e introdukta, Prishtinë, l968, f. 81.

[34] Po aty, f. 52.

shoti "), Shekspiri (" Jul Qesari", "Hamleti"), Omar Khajami *"Rubairat" janë një nga veprat poetike më të bukura të botës"*[35], por të përkthyera dhe të shqipëruara aq bukur e aq qartë, aq të thella nga kuptimi sa një *"Rubai vlen disa togje vëllimesh, aq moderne nga mejtimet... sa na duket se autori i tyre ka rrojtur... në zemër të Europës"*[36].

Pra, siç shihet edhe nga përkthimet, Noli kultivoi veçantinë gjuhësore të shprehur me kompozita të qëlluara, si: ***perçe-shkrumb, fushë-paqeje, fitim-prurëse, vdekje-prurëse,*** *etj.*

Një ndër tipat e kompozitave të veçanta e specifike është kompozita e sajuar nga përemri vetëvetor *vetë* dhe pjesorja ***vrarë (vetë+vrarë) vetë-vrarë, i vetë-vrarë,*** si mbiemër kompozitor, që nuk e ndeshim të përdoret prej askujt tjetër ndër shkrimet shqipe.

Noli, siç përdori me masë, me shije e me kriter të caktuar barbarizmat, po ashtu ato i shtini në përdorim edhe në sajimin e kompozitave të reja, siç janë për shembull kompozitat: *ferr-hapsanë, qjell-hapsanë, syrgjyn-gjallë, syrgjyn – vdekur, sheqer-kësmet, sulltan-llokum, salep-sulltani, sy-jeshile, vaj-vatani, mjer-mileti,* duke arritur me to efekte të dëshiruara artistike, qoftë elegjiake, patetike e mallëngjyese, qoftë me efekte therëse, ironizuese me tone fshikulluese e satirike"[37].

Ndërkaq, kompozitat standarde në veprimtarinë letrare të Nolit janë të sajuara me mjete e brumë të brendshëm të gjuhës shqipe. Këtu, do veçuar një dukuri të veçantë e specifike se përdorimi i vizëlidhëses ndërmjet dy gjymtyrëve të kompozitave të Nolit, dëshmon ndër të tjera se këto kompozita kanë një lidhje të dobët, duke u përshkuar nga cilësia e mungesës së një qëndrueshmërie të përhershme të tyre. Ndërsa, kompo-

[35] Po aty, f. 93.

[36] Po aty, f. 93 ("Që në shekullin e nëntë gjer në shekullin e gjashëmbëdhjetë pas Krishtit, Persia ka patur një Përlindje kulture, diturie dhe letrëtyre, që produkoj një tufë mejtimtarësh dhe poetësh të mëdhenj, si: Firdusi, Avicena (Ibni Sina), Omar Khajami, Saadi, Rumi, Hafëz Shirazi, Xhami dhe Hatif "Përlindje kjo, nga e cila lindi qytetëria greko-romake e Përlindja arabe, e cila me anën e Spanjës i influencoj Europën").

[37] Mehmet Halimi, Kompozitat në veprimtarinë letrare të Nolit, në vëll. "*Çështje fjalëformimi në gjuhën shqipe",* Prishtinë, l996, f. 242-243.

zitat e kryehershme, Noli i përdorë pa vizëlidhëse, kurse kompozitat më të reja i përdorë me vizëlidhëse.

Sipas mendimit tim këtë e bënë për dy arsye: *E para* për të theksuar më qartë e më fuqishëm funksionin semantik e artistik, por edhe sajimin e tyre etimologjik, nga njëra anë, kurse *E dyta,* duke qenë tepër i lirë në përdorimin e kompozitave, mbase ai nuk dallon kufirin semantik ndërmjet togfjalëshave dhe kompozitave, ndaj shpesh i përdorë ato edhe të rimuara në funksion artistik, nga ana tjetër. Prandaj, disa nga kompozitat e Nolit më tepër përngjasin në togfjalësha sesa në kompozita të mirëfillta, si: *rrobe-çqyer (rrob' e shkyer), poçe-thyer (poç' i thyer), formë-çkoqur, syrgjyn-gjallë (syrgjyn' i gjallë, krahaso me i gjallë e n' zall dhe gjallë-n' zallë), syrgjyn-vdekur (syrgjyn' i vdekur), sulltan-llokum, sheqer-kësmet, brymë-shkrirëse, etj.*

Se është kështu siç spikatëm në shembujt e zënë ngoje, dëshmojnë edhe tofjalëshat, që gjenden në kufijt e kompozimit, që lehtë mund të kthehen apo të shndërrohen në kompozita pa humbur kuptimin e tyre të tashëm: "*N' odë prapë me të kthyer/ shpirt'i ndezur, zemra thyer "*[38]. Fjalët e parme në këto vargje lehtë mund të ktheheshin në kompozita, madje për Nolin vetëm duke përdorë një vizëlidhëse, e duke mos humbur aspak kuptimin e tyre: "*N' odë prapë me të kthyer shpirt-ndezur, zemër-thyer"* apo togfjalëshi ***gjak përlyer*** në vargun: "*Se sa tiran prej skllevësh* ***gjak përlyer"*** qëndron në kufirin e kompozimit analog me kompozitat shumë të afërta: ***gjakpirës, gjakmarrës, gjakhupës, gjaknxehtë, gjakftohtë,*** etj.

Kjo dëshmon edhe njëherë se në përdorimin e kompozitave, Noli nuk ishte rigoroz, nuk kishte ndonjë kriter të rrept përdorimi. Duke mos qenë aq korrekt në klasifikimin dhe dallimin e kompozitave, Noli na paraqitet tepër dorëlirë në përdorimin e tyre. Prandaj, ndodh shpesh që togfjalëshat t'i shkruaj si kompozita dhe anasjelltas kompozitat t'i përdorë si togfjalësha.

[38] Fan S. Noli, *" Sulm e lot",* Prishtinë 1963, f. 104.

Përmbyllje

Tiparet specifike të kompozitave noliane. Një pasuri kaq e madhe dhe e nduarnduarshme me kompozita gjuhësore, vargut të Nolit i jep fuqi shprehëse, dinamizëm e zhdërvjelltësi për të shprehur sa më ngjeshur e sa më besnikërisht ndjenjat e veta si njeri e si poet. Veprimtaria e Nolit shquhet për "pasurimin e gjuhës së letërsisë artistike me intonacione nga më të ndryshmet në përpunimin e zhvillimin e stileve, të gjinive e të llojeve të ndryshme të saj që nga poezia lirike qytetare në historinë me vlerë letrare, që nga poezitë dramatike në prozën tregimtare, nga satira fshikulluese në kritikën letrare"), ku ai u dallua për talent të rrallë të gjuhës poetike, duke u afirmuar si stilist i fuqishëm në fushën e krijimtarisë së letërsisë shqipe.[39]

Këtu më poshtë po zëmë ngoje disa bashkëkohës të Nolit, të cilët spikasin gjenialitetin, aftësinë e mjeshtrisë shkrimore të Fan Nolit, siç janë: Faik Konica[40], Mitrush Kuteli[41], Kristo Frashëri[42], Milto Sotir Gurra[43], Klubi i Shkrimtarëve[44], Qerim Panariti[45], e shumë shkrimtarë e intelektualë njerëz të pendës, të artit e të shkencës.

Nga kjo që thamë deri më tani në kumtesën tonë, mund të përfundojmë se fjala është mjeti shprehës i poetit. Shkrimtarët e poetët, duke

---

[39] *Mahir Domi, Fan. S. Noli, Ndër Bashkëkohasit,* Prishtinë, 1968, f. 230.

[40] Faik Konica, Autobiografia, Prishtinë l968, f. 112. ("Dita që ai mbajti meshën e parë të tij në shqipet është një kthesë në historinë e Rilindjes Shqiptare ").

[41] Mitrush Kuteli, po aty, f. 112 .

[42] Kristo Frashëri, vep. cituar. f. 113. ("Një ndër studimet më objektive dhe më kritike për Skënderbeun është vepra e historianit shqiptar Fan S. Noli, botuar në anglishte, më l947, në Nju-jork".).

[43] Milto Sotir Gurra, vep. cituar, f. 113 ("Bashkimi i Kombit", më l0 mars l944: "Do të nevojiten vëllime të tëra për të përshkruar veprën e këtij titani të Rilindjes Shqiptare").

[44] Klubi i shkrimtarëve, vep. cit. f. ll3, Tiranë , Shqipëri, " Veprat tuaja, që gëzojnë një popullaritet të madh në Shqipëri janë thesar i letërsisë dhe i kulturës shqiptare ").

[45] Qerim Panariti, vep. cit. f. ll3 (Kryeredaktor i "Diellit", më l shtator l948: "Jeta e Fan Nolit është një ngjarje triumfuese. Vepra e tij në çdo lëmë, si në atë patriotike e fetare ashtu edhe në atë politike dhe letrare, është një monument i pavdekshëm").

shkruar gjuhën e tyre, shumë fjalë e tipa fjalësh i bëjnë të përdorshme e kuptimplote, i bëjnë të rëndomta e të natyrshme për gjuhën tonë letrare, nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër, e përpunojnë, e përkryejnë dhe e latojnë, e bluajn im, e sitin holl e gatuajn mjeshtrisht me shprehje të fuqishme dhe e pasurojnë atë me tipa fjalësh të reja e të panjohura deri më atëherë, duke na ofruar mundësi të gjera në shprehjen e mendimeve e ndjenjave tona, siç janë në këtë rast *tipat e kompozitave të veprimtarisë letrare të Fan S. Nolit***,** i cili krijoi kompozita të reja. Prandaj, në këtë drejtim ai e pasuroi gjuhën letrare shqipe me *neologjizma kompozitore***.** Këtë mjeshtri të kultivimit gjuhësor e posedoi edhe Noli ynë i madh në shkrimet e veta. Prandaj, për këtë vlerë të këndimit të gjuhës së vet amtare, Noli meriton adhurim e respekt të përhershëm të bashkëkombasve të vet, siç thotë Betoveni: *"Vetëm arti e shkenca e ngrenë njerinë në shkallën e hyjnive".*

Mehmet HALIMI, Prishtina

SEMANTIC AND ARTISTIC FUNCTION OF COMPOSITES IN NOLI'S LITERARY WORK

Summary

Based on what is said in this paper, we can conclude that words are the means of the poet's expression. Writing in their language, poets and novelists make many words or types of words useful and comprehensive, make them sound common and natural in the literary speech, on the one hand, and on the other, bring the speech to the level pf perfection. By adding powerful expressions they further enrich the language with new types of words not known until that moment, by offering a wide range of opportunities to express views and feelings, as is the case with the types of composites in the literary work of Fan S. Noli, who created new composites. Therefore, it can be concluded that he enriched the Albanian language with composite neologisms. As a great master, Noli he cultivated carefully all this in his writings. Therefore, for this value of enriching the Albanian, Noli deserves admiration and permanent respect from his compatriots.

Floresha DADO, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë

ARSHI PIPA, MIDIS FILOZOFISË SË JETËS DHE FILOZOFISË SË ARTIT (QASJE KONTRADIKTORE NË FILOZOFINË E INTERPRETIMIT LETRAR?)

Duke shkruar, që në vitin 1944, se "Filozofija asht shum a pak subjektive, sado qi pretezat e saj janë për me kapë universin objektiv" (Fryma, nr.1, janar 1944, pseudonim Dr. A. Ymerati), A. Pipa, siç dëshmojnë gjithë shkrimet e tij filozofike e kritike mbi artin letrar, si edhe botimi pasvdekjes i 'Mbi gjeniun' (botimet Princ, Tiranë 2011), do të ndërtonte një raport tepër interesant dhe origjinal midis *filozofisë, si* ***dije universale*** njerëzore, *filozofisë së* ***artit letrar***, dhe *filozofisë* ***së gjykimit letrar*****.**

Në këtë trekëndësh, të përfytyruar prej nesh, ku *dija racionale* e njeriut dhe *prirja intuitive* e kuptimit dhe interpretimit të gjërave krijojnë raporte sa të logjikshme aq dhe misterioze, shprehet kalimi i natyrshëm nga koncepti filozofik mbi jetën dhe njeriun, te koncepti mbi thelbin e artit letrar dhe mënyrën e interpretimit të tij.

Boshti i parë: ***Konceptet filozofike***

Në cepin filozofik të këtij trekëndëshi e gjejmë A. Pipën nën ndikimin e filozofisë së A. Bergson-it, të cilën e krahason me një simfoni të madhe. I prekur nga "shkëlqimi i ideve dhe pasunija e fëtyrimevet" studiuesi ynë adhuron te metafizika e Bergson-it tezën se e vetmja mënyrë njohurie për t'i hyrë në thelb realitetit është *intuita.* Sipas tij, logjika nuk ishte e përshtatshme për kërkimin e *shpirtit,* të cilin filozofi i madh e shihte si një rrymë të vazhdueshme rikrijimi. Duke qenë se në Metafizikë misteri i jetës nuk mund të kuptohet me gjuhën e koncepteve, dhe mjet i

njohjes është intuita, në sistemin krijues të Pipës mishërohet kalimi nga njohja racionale te reflektimi i përvojës dhe intuitës vetiake. Ky koncept filozofik e orienton atë në bindjen se intuita asht nji "mënyrë njohunije" që është shumë afër artit dhe shkencës, për të shkuar në pohimin se bergsonizmi hyri në art, në shkencë e kudo... Problemet e mëdha të kësaj rryme filozofike ishin zoti, jeta, dashuria, landa, shpirti, të cilat mishërojnë të panjohurat e universit. Pra, metafizika merret me njohjen në nivelin më të lartë të abstraksionit, duke iu referuar dukurive të përgjithshme universale, të cilat përbëjnë edhe temat e mëdha të artit, dhe, për këtë arsye, pasqyrimi metaforik është parimi themelor i krijimit artistik. Kështu, vemë re se koncepti metafizik i Pipës për filozofinë, si formë e dijes, mbart brenda vetes urën që e lidh atë me artin në përgjithësi, pra dhe me letërsinë.

Boshti i dyte: *Filozofia e artit*

Në këtë cep të trekëndëshit, ndjekim pikëpamjet filozofike të A. Pipës mbi thelbin e artit, dhe të letërsisë në veçanti. Në bashkëpërkim me filozofinë mbi artin e antikitetit, ai vlerëson njëjtësimin e misionit hyjnor dhe misionit njerëzor të artit, "arti e morali janë e njajta pemë, rranjët e së cilës janë rranjët morale e gjethet e lulet janë shprehjet artistike". "Arti asht subjektiv por jo subjektiv abstrakt, asht projekcion i vetvetes në gjithësi, asht anasjelltas përqendrim i gjithësisë në vetvete". Duke pranuar artin si një *mënyrë njohunije* (vetë Filozofia është njohje...) Pipa intuitivisht shkon në bindjen se motivi i lëvizjes historike të artit është spiritualiteti, është një nënvetëdije që fiton qartësi dhe shpjegim gjatë krijimit të veprës. Ky spiritualitet, që është objekt i filozofisë, por që qëndron në themel të artit, e çon Pipën në përcaktimin e artit si pjesë të filozofisë. Në këtë vështrim raporti i artit me jetën, në pikëvështrimin filozofik, është i tillë që arti "transfiguron të qenunën, i jep shpirt prap së ndodhunës, rikrijon jetën. Vetëm spirita ka zotsinë me krijue, ajo asht vetë nji të krijuem i vazhdueshëm". Dhe në këtë proces, sipas Pipës, është vetëm fuqia intuitive, ajo që lëviz procesin krijues.

Në konceptin filozofik të Pipës, lidhur me thelbin e letërsisë, fjala

konceptohet pikërisht në llojin e misterit metafizik, si "e lëvizshme, kërkimtare e palodhun e së vërtetës", që vazhdon të flasë në shpirtin e lexuesve. Koncepti i Bergsonit, që e përafron metafizikën me artin, zhvillohet më tej në përbashkësinë e problemeve që prekin këto dy mënyra të vështrimit të jetës, për të shkuar deri aty sa poezia të shihet edhe si rivale e metafizikës. A. Pipa – filozof dhe teoricien i artit - dallon te filozofia kriterin *e krijimit*, që është karakteristik për artin. Gjithashtu edhe arti konceptohet si pjesë tërësore e filozofisë; i shkëputur prej saj do të shvleftësohej. Zhytur në arsyetime të tilla Pipa gjen një nënshtresë të brendshme të përbashkët midis këtyre dy llojeve të krijimit të mendjes njerzore, ku vepruesi kryesor është *intuita*. Në një kuptim të tillë mbi thelbin dhe raportin e dyshes: *filozofi/art* ai e ngre arsyetimin në nivele më të larta, të rralla në mendimin teorik shqiptar.

Boshti i tretë: *Filozofia e gjykimit letrar*

Cepi i tretë i trekëndëshit të sistemit teorik të A. Pipës qëndron në tezën: *kritika unjisohet me vetë filozofinë*.. Duke qenë se kritika përmbush një mision spiritual dhe bota e spiritualitetit i referohet vlerave universale, kritika e artit –shkruan Pipa- nuk asht tjetër veç se filozofia e artit. Me një koncept të tillë ai e ngre nivelin e *gjykimit letrar*, përtej thjesht kulturës filologjike, paraqitjes se fakteve artistike, të veçuara apo të sistematizuara. Duke e quajtur filozofinë mendim kritik mbi katër fushat ku shfaqet shpirti, një prej të cilave është edhe arti, teoricieni thellon arsyetimin tonë mbi raportin e veçantë të kritikës letrare me filozofinë. Sinteza e poezisë me shkencën (pra gjykimin) përbën nënshtresën e brendshme, në vështrim të parë të padukshme, të kritikës letrare dhe filozofisë metafizike. Të dyja janë *poezi***,** sepse krijojnë! Janë *gjykim,* sepse përcaktohen edhe si shkencë, që synojnë të zgjidhin probleme universale të qënies. Në fushën e artit letrar gjykimi (kritika) heton realizimin e asaj që buron nga *ndijesia*, në filozofinë metafizike gjykimi kërkon *arsyen e ekzistencave***.** Nëse Pipa shkruan "Filozofia asht gjygjtare", ne arrijmë të perceptojmë, edhe nga arsyetimi i sapo bërë më sipër, shkakun që e lidh filozofinë me kritikën letrare, e cila, është gjithashtu gjygjtare. Ajo çka i lidh në mënyrë reciproke -

do dukej diçka e çuditshme, në vështrim të pare – është, së pari, fakti se në kritikë dhe në filozofi baza e ekzistencës është *qëndrimi kritik*. Së dyti, është edhe *intuita,* që përbën tiparin tjetër, më të drejtpërdrejtë të vlerësimit kritik dhe të arsyetimit filozofik.

Në sistemin e të menduari të Pipës, trekëndëshin: *Filozofi e mëndimit - filozofi e artit letrar - filozofi e kritikës letrare* e përfytroj si një ndërtesë me tre shtylla, që lidhen mes tyre me dilemën filozofike Çfarë? Ashtu sikurse njohja e jetës, në kuptimin më të gjerë është graduale, se sendet nuk janë saktësisht ato që duken, ashtu edhe njohja, vlerësimi i veprës letrare është për Pipën intuitë, pra diçka e brendshme, e ndryshueshme, e hapur. I gjithë sistemi i trekëndëshit të Pipës çon drejt përgjigjes dhe zbërthimit filozofik e estetik të veprës letrare, duke e nxitur studiuesin e letërsisë drejt një hapësire më të thellë të gjykimit.

Ajo çka i lidh këto tre skaje të trekëndëshit, që përvijova, është pikëvështrimi i fenomenit të *krijimit* dhe *gjykimit* letrar jo në sipërfaqe, por në thellësitë e ekzistencës dhe misionit që kanë.

* * *

Por a ka kontradikta në sistemin teorik të A.Pipës ? Kjo çeshtje i përket boshtit të tretë!

Mendoj se ky aspekt mund të hetohet në dy drejtime: 1.në teorinë e tij mbi *thelbin e letërsisë* dhe 2. Në kuptimin mbi *thelbin e kritikës letrare*.

1.Lidhur me qasjen e parë: letërsinë. Thamë se në pikëpamjen mbi letërsinë A.Pipa ishte nën ndikimin e filozofisë së Bergson-it, e cila thelbin e krijimit e sheh te intuita, e pavetëdijshmja. Por kjo ide shfaqet, ndonjë herë, konfuze, kur Pipa shkruan se "letratyra nuk duhet da prej jetës si t'ishte ajo nji mjeshtri, o ma keq, nji argtim, nji lojë e thjeshtë." Apo kur (18) pohon: "Me folë për nji art-tue përdorë nji shembull- artisti të ndrymun në kullën e tij të fildishtë , asht nji abstrakcion qi si çdo abstrakcion asht i njianshëm e arbitrar" (19) "Arti asht mision." (20) Ose..." Arti asht nji mënyrë njohunije, asht nji shise kuptimi të rruzullimit." (21)., ndërkohë që pranon thellë pikëpamjen intuitiviste se "Vetëm spirita ka

zotësinë me krijue, ajo asht vetë nji të krijuem i vazhdueshëm. E në spiritën fuqinat qi munden me krijue nuk munden me qenë veçse fuqina intuitive, jo reflekse." Në arësyetimet te 'Mbi gjeniun' gjejmë mpleksjen e konceptit intuitivist me psikanalist, cka, shpesh thërmon raportin, intuitivist, midis pavetëdijes dhe ndërgjegjes. Nëse, nga njera anë, ai pohon se 'Artisti, kur krijon, i bindet diçkaje që nuk është plotësisht nën pushtetin e tij... krijimi është spontan, pa asnjë qëllim tjetër përveç atij për të krijuar.' (Mbi gjeniun, f.63) ka edhe momente të tjera ku prishet arsyetimi intuitivist i Pipës mbi thelbin e krijimit letrar, kur beson se është i aftë të komunikojë me pavetëdijen (f.79). Është veçanërisht interesant interpretimi që Pipa i bën metodës së filozofisë së Schopenhaur, Niçe e Bergson, duke shkuar në pohimin se " kjo është provë 'aposteriori' se arti asht i lidhun ngusht me jetën. (40), ndërkohë që ka pohuar më parë se "metafizika asht motër e poezisë", (47) (sigurisht në kët rast studiuesi ka parasysh nje lloj tjetër poezie, si ajo e Malarmesë, Valeri etj. F.D.).

2. *Kontradiktat mbi thelbin e kritikës letrare? (Luhatje midis bergsonizmit dhe kritikës historike...)*

Teza themelore e A. Pipës mbi kritikën mbështetet në konceptin se "Kritika asht matja, pesha e nji prodhimi spiritual" apo që "Kritika vlen deri sa përmbushë nji mision spiritual e në botën e spiritualitetit nuk mund të flitet veç se për vlera absolute e universale." (9) Pohimi më kontradiktor shfaqet i tillë: "Kritika artistike nuk asht as erudicion linguistik, as kulturë filologjike, as kronika faktesh artistike të shkoqituna e të skematizueme. Këto kalojnë në rradhë të dytë për kritikun e vërtetë qi e shikon kritikën letrare si kritikë estetike e përnjiheri kritikë historike" (shfaqet termi historike!).

Dihet se ndarja ma e madhe midis teoricienëve të letërsisë ka qenë përballja midis kritikës historike dhe asaj formaliste. Pipa qëndron në një pozicion të caktuar, por, herë pas here, kapërcen kufijtë e këtij pozicionimi. 12. Kështu, ai shkruan: "Letratura jonë duhet të ndiqet kamba kambës prej kritikës ma serioze, prej kritikës së vërtetë qi asht kritika estetike-historike" (14). Sipas meje, vjen kështu, natyrshëm, pohimi më i vërtetë

mbi thelbin e kritikës letrare. Gjithashtu, nëse kritikat formaliste përjashtojnë autorin, biografinë dhe kontekstin e veprave, Pipa, pa pritur, e lidh ngushtësisht qasjen e kritikut me artistin, mjedisin ku ai ka jetuar, mentalitetin e tij, konfliktet që ka jetuar. "Kritiku i vërtetë ma tepër se lexues, asht historik" (11). "Arti asht nji prodhim i kohës. Nuk mund të kuptojmë kurr nji vepër arti po nuk kuptuem ma parë vetë artistin". Pipa, shkon drejt një pohimi (paksa të papranueshëm me konceptin intuitivist) se "kritika duhet të jetë me doemos historike." (12) Por, më pas, në shkrimin "Shpirti kritik" ai do të shkruante: "Diçka tjetër përban kritikën letrare: intuita...Dhe intuita asht esencialisht poetike. Kush ban kritikë letrare asht, pra, ma parë artist se logjik. (28)." Vemë re se kalimet nga koncepti i kritikës intuitiviste te kritika historike, shfaqen haptazi në disa shkrime kritike, botuar te revista "Shkëndija","Kritika","Fryma". Edhe në studimin historiko-letrar (*Contemporary Albanian Literature, East Europian Monographs, Boulder, Distributed by Columbia University Press, New York, 1991 (*168 f.) vemë re se mbizotëron kriteri i analizës historiko-politike-ideore.

Këtë luhatje, apo një lloj kontradikte që shfaqet në pikëpamjet teorike të A. Pipës mbi natyrën e letërsisë dhe të kritikës letrare, sigurisht nuk i shoh si e metë. Përkundrazi: mendoj se Pipa me intuitën që kishte mbi thelbin e letërsisë, ndonëse teorikisht adhuronte bergsonizmin intuitivist, apo shfaqet shpesh formalist, ai arriti natyrshëm në pohime që lidhen me natyrën komplekse të letërsisë. Duke iu referuar skemës së Jakobsonit ne dimë se letërsia, si proces komunikimi, është lidhje specifike me kontekstin historik, është reflektim i jetës, personalitetit të autorit, është mesazh, është kod specifik, është përjetim i lexuesit. Pra, aty ku duket se A. Pipa ka kapërcyer nga formalizmi te historicizmi, në të vërtetë ai ka arritur me intuitën e vet të kapërcejë qasjen e njëanshme, jo të plotë, duke depërtuar në thelbin e letërsisë, si rrjedhim, edhe të gjykimit kritik të saj. (këto lidhen ngushtësisht me njera tjetrën!). Kjo është meritë e sistemit të të menduarit teorik të tij. Në konceptet teorike të A. Pipës gjejmë mplaksjen e një varg tezash e pikëvështrimesh të letërsisë që nisin, në të vërtetë nga shekulli XIX positivist, e deri në shekullin XX, ku intuitivizmi, formalizmi, hermeneutika, etj. ndeshen, qasen, largohen, për ta bërë më aktiv

dhe më interesant mendimin filozofik dhe kritik mbi artin letrar. Prandaj 'kontradiktat' e tij, në të vërtetë janë *realitet i kuptimit* të gjërave.

Sipas meje ai është një teoricien dhe kritik i llojit të veçantë, që qëndron në pikëvështrimin filozofik, si mbi *letërsinë* ashtu dhe mbi *gjykimin letrar.* Prandaj, në sistemin e të menduarit teorik-letrar të A. Pipës, do të vlerësoja dy aspekte: *së pari,* faktin se interpretimi i letërsisë është më filozofik seç e kemi parë në studimet dhe kritikën tone letrare, madje edhe në ditët e sotme. Që në vitet '40, sigurisht nën ndikimin e teorive estetike të filozofëve të mëdhej, Arshi Pipa sugjeron një kuptim të ri, më filozofik dhe më universal ndaj sistemit letrar. *Së dyti*, afirmimin prej teorisë së tij, të bindjes, që personalisht e mbështes shumë, se çdo sferë e krijimtarisë së njeriut ka brenda vetes të përgjithshmen, por, mbi të gjitha misterin dhe intuitën e krijimit dhe zbulimit të saj. Me këtë koncept A. Pipa ofron një kuptim mjaft interesant për *letërsinë*, duke iu qasur thelbit të brendshëm të saj, çka ka diktuar, sigurisht, edhe një kuptim të veçantë për *kritikën letrare*.

Floresha DADO, Albanian Academy of Sciences

ARSHI PIPA BETWEEN THE PHILOSOPHY OF LIFE AND THE PHILOSOPHY OF ART. CONTRADICTORY APPROACH IN THE PHILOSOPHY OF LITERARY INTERPRETATION?

Summary

In this paper, Arshi Pipa's theoretical concepts regarding the literary work interpretation and meaning, will be viewed in three essential axes, in the *philosophy, as universal knowledge,* in the *philosophy of the literary art,* and, as he conceives it, in the *philosophy of the literary judgment*. In this triangle, where the human rational knowledge and the *intuitive inclination* of the meaning and interpretation of things establish relationships, which are logical as well as mysterious, there is a natural passing from Pipa's philosophical concept on life and man, to the concept on the essence of the literary art and then to the way of the literary interpretation. Our goal is to get into the system of the literary judgment and philosophical thinking, to find out the internal links among these three types of creations, where, according to A. Pipa, the *intuition* is the main factor. There will be due attention to the third angle of the triangle of his theoretical system, which is based on the view that: *the critique fuses with the philosophy itself.* The researcher raises the level of the literary judgment beyond the simply philological aspect, the presentation of artistic facts aloof or systemized. In A. Pipa's system of theoretical thinking, we notice the blend of a series of tenets and literary views, taking their start from the positivist 19th century, and reaching the 20th century, where intuitivism, formalism, hermeneutics, etc. come together, clash and step away, to make the philosophical and critical thinking on the literary art more interesting and more active. On this basis, we aim to interpret certain contradictions in A. Pipa's system of critical-literary philosophy. It comes as an expression of the complex essence of the literature, which is also reflected in its interpretations.



Bavjola SHATRO, Universiteti "Aleksandër Moisiu"

STUDIMET ALBANOLOGJIKE DHE LETËRSIA E KRAHASUAR NË AKADEMINË AMERIKANO - VERIORE[1]

1.1 Letërsia, rendi botëror dhe kombi në epokën e globalizimit; Letërsia e krahasuar në SHBA

Zhvillimi i letërsisë botërore dhe kuptimi që merr ky term në epokën e globalizmit, sidomos ndërsa studimet letrare janë ndikuar dukshëm nga teoria e sistemeve botërore të Immanuel Wallerstein-it të nxisin t'i shikosh letërsitë kombëtare në një perspektivë të ndryshme dhe para së gjithash, në një raport të ri të mundshëm midis letërsisë, kombit, periferisë dhe qendrave kulturore, politike dhe letrare në botë. Synimi ynë në këtë artikull është të ravijëzojmë disa drejtime në të cilat, sipas mendimit

---

[1] Në realizimin e këtij punimi është shfrytëzuar gjerësisht përvoja akademike dhe kontaktet me profesorë dhe kolegë në disa nga unviersitetet më të rëndësishme në SHBA, si, në University of Seattle, Washington, në Pennsylvania State University, State College, Pennsylvania, në University of Mississippi at Oxford etj., institucione prestigjioze me departamente të njohura të Letërsisë së Krahasuar, dhe të Letërsive e Gjuhëve Moderne.

I jam thellësisht mirënjohëse profesor Djelal Kadir-it në Pennsylvania State University, i cili ka qenë një ndihmë e çmuar jo vetëm për punën me këtë artikull, por për diskutimet e vazhdueshme e të frytshme akademike që më dhanë mundësi ta njihja më imtësisht disiplinën në fjalë dhe çështjet që qëndrojnë në zemër të saj.

Po ashtu, i detyrohem punës së profesorëve, Sophia McClennen, Shuang Shen, Nergis Erturk në Pennsylvania State University dhe Nancy Condee në University of Pittsburgh që në mënyrë direkte dhe indirekte kanë qenë një shtysë për të hulumtuar rreth domethënies së kësaj fushe studimi dhe/për letërsitë kombëtare në kontekstin e sotëm global. Kjo përvojë akademike frytet e së cilës vijojnë ende sot u realizua në kuadrin e granteve JFDP ofruar nga Departamenti Amerikan i Shtetit, 3 vite më parë.

tonë, letërsia e krahasuar siç konceptohet dhe zhvillohet sidomos në SHBA mund të kontribuojë në një perspektivë më të gjerë të studimeve letrare shqipe. Paradigma teorike e komparatistikës në SHBA përbën një model të dallueshëm me një ndikim tepër të fortë ndër modelet dominante bashkëkohore të studimeve letrare, sidomos sa u takon debateve akademike rreth studimit të atyre që emërtohen si letërsi margjinale, qoftë në botë, qoftë edhe brenda vetë hapësirës europiane.

Duke marrë në konsideratë arritjet dhe debatet akademike të komparatistikës në SHBA, ne nuk synojmë modelimin e studimit të krahasuar në letërsinë shqipe sipas atij që gjejmë në akademinë amerikane, pasi kjo do të binte ndesh me vetë logjikën dhe thelbin e letërsisë së krahasuar. Në një kohë, të cilën Jeffrey Nealon e etiketon si post-postmodernizëm, si rezultat të logjikës bashkëkohore të kapitalizmit global neoliberal, dhe të proceseve transnacionale të shkëmbimit kulturor që Benjamin Lee dhe Eward LiPuma i emërtojnë si kultura të qarkullimit, diskutimet, polemikat dhe rrahjet e vazhdueshme të argumentave në fushën e letërsisë së krahasuar në SHBA krijojnë një hapësirë të çmuar për letërsitë që njihen si letërsi të vogla dhe për problematikat e shumta që lidhen me to si letërsi kombëtare, në një botë transnacionale dhe globale.

Duke qenë se brenda kufijve të një artikulli është e pamundur të realizohet një pasqyrë e plotë e parimeve, e koncepteve, diskutimeve, e kontribuesve madhorë të kësaj fushe dhe e zhvillimit të saj aktual në SHBA, ne do të paraqesim më poshtë, shkurtimisht, vetëm disa aspekte themelore të teorive bashkëkohore të letërsisë së krahasuar në SHBA duke u përqendruar tek ato që na ndihmojnë të kuptojmë hapësirën dhe domethënien që mund të marrin letërsia shqipe dhe letërsi të ngjashme me të, në hapësirën e letërsisë botërore e të krahasuar. Në diskutimin tonë do t'u referohemi tri dokumeteve bazë me të cilat lidhet në mënyrë të pashmangshme diskutimi bashkëkohor për letërsinë e krahasuar në ShBA: Levin Report 1965, Green Report 1975 dhe Bernheimer Report 1993 dorëzuar ACLA nga Komisioni i Standardeve Profesionale. Ndoshta është sidomos ky i fundit, Raporti Bernheimer që merr një rëndësi të po-

saçme për shkak të diskutimeve që hapi për letërsitë margjinale, anësore, apo minore, në një kohë kur zhvillimet politike, ekonimike, sociale e kulturore në botë kishin arritur një shkallë dhe trajtë të re kompleksiteti.

Në akademinë amerikano-veriore e sidomos në ShBA, pyetjet rreth letërsisë së krahasuar janë kanalizuar kryesisht në këto drejtime teorike, të cilat, sidoqoftë, nuk konsiderohen si paradigma të përfunduara: *Studimet globale* (F. Jameson, M. Miyoshi), *Kozmopolitanizmi* (B. Robins, T. Brennan), *Letërsia botërore* (David Damrosch, Franco Moretti), *Transnacionalizmi letrar* (G.C.Spivak), *Studimet e krahasuara postkoloniale dhe të diasporës* (Edward Said, Homi Bhabha, Francois Lionnet, Rey Chow).[2]

Këto drejtime dëshmojë fokusin e studimit letrar në dekadat e fundit dhe duket se të nxisin të biesh dakord së paku pjesërisht me mendimin e studiuesit Jonathan Culler, sipas të cilit letërsia nuk është një domen natyror, por një konstruksion, prandaj studimi i saj në raport me diskurse të tjera është jo vetëm i pashmangshëm, por i nevojshëm. Në letërsinë e krahasuar, theksi bie te letërsia, jo te aspektet e tjera të kulturave kombëtare, me të cilat merren më drejtpërdrejt studimet kombëtare sipas letërsive e gjuhëve përkatëse. Me këto të fundit, lidhja e letërsisë së krahasuar është e natyrshme dhe e fortë, duke mos përbërë kurrsesi një marrëdhënie rivaliteti, çka theksohet edhe në Levine Report. Culler shton se, historikisht studimi i letërsisë sipas ndarjeve kombëtare e gjuhësore nuk ka qenë tipik për studimin letrar, por për atë kulturor dhe kjo është pasojë e faktit se letërsia është transkombëtare. Studimi sipas këtyre ndarjeve është më tipik për departamentet e letërsive kombëtare, ndërsa komparatistika, nga ana e saj, synon fenomenin transnacional.[3]

Por si e realizon këtë synim të sajin letërsia e krahasuar sot dhe, më së pari, në universitetet dhe qendrat kërkimore të SHBA-së? Sipas David Damrosch, aktualisht, letërsia e krahasuar përballet me dy probleme: (a)

---

[2] Shiko Emily Apter, "Global Translation: 'The Intervention' of Comparative Literature, Istanbul, 1933", f. 76-109, në "Debating World Literature", Ed. Christopher Prendergast, London- New York: Verso, 2004. f. 77.

[3] Jonathan Culler, Comparative Literature, at last! në Ed. Charles Bernheimer, op. cit, p. 119-120.

me një problem insitucional, i cili nënkupton praninë e hapësirave gjuhë/ kombe të studimit të letërsisë dhe faktin që përpjekja për zgjerimin në domenin e kulturës vetëm e ka rritur nacionalizimin); (b) *me një problem në nivel intelektual*, çka nënkupton rrezikun e eklipsimit të historisë së letërsisë si pasojë e hapësirës së gjerë të fushës së studimit.[4]

Studiuesit pohojnë se vizioni i letërsisë së krahasuar për një qasje postnacionale ndaj letërsisë ka kohë tashmë që e ka nisur rrugën e vet. Prandaj, në akademinë anglofone letërsia e krahasuar lidhet ngushtë me problemin e letërsisë botërore, e cila përveçse me letërsinë e krahasuar ka lidhje të fortë edhe me projektin e dytë madhor që janë studimet post-koloniale. Me të dyja këto projekte madhore, ajo ka patur marrëdhënie më së shumti antagoniste dhe më së paku ambige. Është fakt që rrënjët komparatiste të studimeve postkoloniale nuk janë pohuar ende botërisht dhe të kuptuarit e letërsisë botërore si marrëdhënia tripalëshe mes termave të mësipërm nuk është realizuar ende. Koncepti i letërsisë botërore asociohet me imperializmin, monolingualizmin dhe autoritarizmin pedagogjik amerikan siç thotë G. C. Spivak.[5] Ky është një drejtim më shumë në të cilin diskutimi akademik vijon të jetë tejet impenjativ dhe siç duket i pashmangshëm për komparatistët.

Charles Prendergast pohon se Georg Brandes dhe Erich Auerbach, të dy vazhdues të konceptit të Gëtes mbi letërsinë botërore, e shihnin këtë të fundit jo si një koleksion librash, por si një proces të lidhur ngushtësisht me proceset botërore që njihen si modernizëm dhe globalizëm.[6] Gëtja mendonte se imagjinata letrare transcendon kufijtë gjuhësorë e kombëtare dhe megjithatë, pohonte se çdo vepër letrare është e lokalizuar historikisht dhe është unike nga ana estetike. Siç argumenton Edward Said, aplikuesit e hershëm të letërsisë së krahasuar Ernest R. Curtius

[4] David Damrosch, Literary Study in an Elliptical Age në Ed. Ch. Bernheimer, op. cit., 123.

[5] John Pizer, Towards a productive Interdisciplinary Relationship: Between Comparative Literature and World Literature. *The Comparatist* , 31 , 6 – 28, në Ali Behdad and Dominic Thomas, *Introduction* to A Companion to Comaprative Literature, Wiley-Blackwell, West Sussex, 2011. f. 480.

[6] Christopher Prendergast, op. cit. f.viii.

and Erich Auerbach frymëzoheshin nga intelektualët e Gjermanisë preimperiale Gëte dhe Herder, të cilët e konsideronin tranzitor nacionalizmin dhe pranonin dimensionin global të modernitetit.[7] Said thotë se pavarësisht nëse lindjen e letërsisë së krahasuar do t'ia atribuojmë Gëtes dhe vizionit të tij madhor utopik, siç shprehet ai[8], apo kërkesave praktike të Luftës së Ftohtë, të gjithë biem dakord se ajo është një fushë dinamike dhe plurale që karakterizohet nga një transformim i pandërprerë i supozimeve të veta teorike, i metodologjive kritike dhe i objektit të studimit.[9]

Probleme dhe paradigma të ndryshme që identifikojnë dhe përpunojnë sot letërsia botërore dhe letërsia e krahasuar janë përkthimi global, imperializmi gjuhësor, humanizmi transnacional, nacionalizmi dhe moderniteti. Siç pohohet shpesh, të gjitha këto janë paraprirë nga vizioni pedagogjik dhe nga praktika filologjike e Leo Spicerit, një azilant i Europës së Luftës së Dytë Botërore dhe një nga etërit e komparatistikës.[10] Si rezultat, kategoritë e diskutimit të letërsisë së krahasuar sot nënkuptojnë terma si drejtimet, pikëprerjet, trajektoret, lidhjet, orientimet etj. Ato janë esenciale në studimet e krahasuara pasi ndihmojnë që të kuptojmë marrëdhëniet e sotme mes përkthimit dhe transnacionalizmit, teorisë letrare dhe mediave, të ardhmes së letërsive kombëtare në epokën e globalizmit, formacioneve gjinore dhe kulturore përgjatë kohës, takimeve kulturore mes lindjes dhe perëndimit, studimeve postkoloniale dhe të diasporës dhe qasjeve të tjera eksperimentale ndaj letërsisë dhe kulturës.[11] Ndërkaq, kujtojmë që referencë e rëndësishme në studimin e letërsisë së krahasuar vijojnë të jenë poststrukturalizmi dhe dekonstruksioni, pasi pikëpyetjet e vazhdueshme mbi kufijtë e diskursit Perëndimor janë karakteristikë e kë-

[7] Edward W. Said, Culture and Imperialism, Alfred A. Knopf, New York, 1993, cituar sipas Ali Behdad and Dominic Thomas, op. cit. f. 2.

[8] Edward W. Said, Humanism and Democratic Criticism, Columbia University Press, New York, 2004, f.95.

[9] Ibid., f. 3.

[10] Ibid., f. Ix.

[11] Ibid.

tyre teorive.[12]

Sado shpesh i vendosur në pikëpyetje, i parë me rezerva apo edhe me rezistencë të fortë, Raporti Bernheimer ka evidentuar qartë disa prirje aktuale të studimeve letrare të krahasuara. Në vitin 1993, Bernheimer Report vëren se:

"Fenomenet letrare nuk janë më fokusi ekskluziv vetëm i disiplinës tonë. Qasja ndaj tyre është si ndaj një prej praktikave diskursive mes shumë të tillave, duke përbërë, kështu, një fushë komplekse, në lëvizje dhe të karakterizuar nga kontradiktat, siç është fusha e prodhmit kulturor."[13]

Në mbështetje - ndonëse relativisht indirekte - të këtij pohimi Jonathan Culler shprehet për rolin e studiuesve të letërsisë së krahasuar në njohjen e strukturave dhe të funksionimit të një game të gjerë praktikash diskursive, të cilat formësojnë individin dhe kulturat. Kontributi i këtyre studiuesve në studimin e diskurseve filozofike, psikoanalitike, politike pa diskutuar këtu filmin, pop-kulturën, librat guidë për qëllime vetjake etj., kanë një vlerë kaq të madhe sa askush në fakultetet e SHBA-së nuk do të donte që departamentet e letërsisë të merren vetëm me studimin e letërsisë, vijon Culler.[14]

Megjithatë, një nga konceptimet e rëndësishme të letërsisë së krahasuar në SHBA është ai sipas të cilit letërsia e krahasuar është një praktikë. Me këtë nënkuptojmë:

"[...] analizën e vazhdueshme, hetimin e kujdesshëm të praktikave përmes të cilave u ndërtua letërsia e krahasuar si lëndë, si subjekt, si objekt studimi, si disiplinë programatike dhe si juridiksion akademik. Kjo nënkupton të qenit vigjilent ndaj mundësisë që pasi e kemi themeluar letërsinë e krahasuar si disiplinë që disiplinon mësimdhënësit dhe studiuesit e

[12] Shih Rey Chow, In the Name of Comparative Literature. në Charles Bernheimer, Comparative Literature in the Age of Multiculturalism, f. 107 – 16. Johns Hopkins University Press, Baltimore. 1995. f. 5.

[13] The Bernheimer Report, 1995, f.42.

[14] Jonathan Culler, Comparative Literature, at Last!, në Charles Bernheimer, Comparative Literature in the Age of Multiculturalism, f. 117 – 21. Johns Hopkins University Press, Baltimore. 1995. f. 117.

vet, si dhe studentët që të ndjekin disa protokolle të caktuara dhe disa moduse operandi profesionale, ne përsëri dhe gjithmonë përballemi me rrezikun se mund të harrojmë se disiplina jonë dhe praktikuesit e saj janë, po ashtu, produkti i disa normave kulturore, i disa mënyrave të realizimit të njohjes dhe të të dhënit mësim. Veçanërisht si disiplinë që heton dhe merr në pyetje drejtime disiplinare dhe pikëprerje e kryqëzime ndërdisiplinare, letërsia e krahasuar nuk mund t'i lejojë vetes që të anashkalojë detyrimin e përhershëm që ka për të praktikuar vënien në pikëpyetje dhe analizën e pikërisht atyre praktikave që e kanë bërë atë një disipilnë *mes* dhe *të* disiplinave. Vetë këto protokolle disiplinare dhe metadisiplinare janë rezultat i disa praktikave të caktuara dhe si pasojë, të ushtrosh letërsinë e krahasuar do të thotë të praktikosh vlerësime kritike dhe diagnostikuese me shkallë të lartë saktësie ndaj asaj çka kanë ndërtuar këto praktika dhe që i japin statusin apo formacionin përkatës institucional. […] Pra, ne nuk mund ta konsiderojmë letërsinë e krahasuar thjesht si një objekt që mësohet, përsëritet dhe çohet më tej. Asaj nuk i jepet dot as statusi i një subjekti që mund të paketohet e formulohet si një njësi informacioni, e gatshme për shpërndarje dhe konsum nga klientët.[15]

Vështruar në plan të gjerë, kur përpiqemi të përkufizojmë objektin e letërsisë së krahasuar, ka shumë rëndësi që të shmangen interesat institucionale me orientim nga vetja dhe në shërbim të vetvetes, të cilat synojnë zakonisht ruajtjen e status qou-së në sferën publike letrare. Ky është një qëndrim me të cilin komparatistët nuk duhet dhe nuk pranojnë të bien dakord dhe për të cilin shumë studiues me emër janë shprehur vazhdimisht.[16] Ata pohojnë:

"Objektet e analizës dhe të interesit pedagogjik duhet që, historikisht dhe gjeografikisht, të jenë aq të ndryshme e të larmishme, sa nevojitet për të qenë të krahasueshme. Për këtë arsye, *raison d'être* e letërsisë së krahasuar është respekti dhe vlerësimi i të ndryshmes dhe i të veçan-

[15] Letërsia e krahasuar, globalizmi dhe letërsitë kombëtare, pjesa I. Intervistë me Profesor Djelal Kadir; Intervistoi Dr. Bavjola Shatro. Suplementi "Milosao" 5 prill 2015.

[16] Djelal Kadir, Memos from the Besieged City: Stanford University Press, California, 2011.

tës. [...] Prandaj, mënyra më e sigurtë për të shmangur një letërsi të krahasuar vetë-qendërzuese, vetë-privilegjuese është t'ia nënshtojmë vazhdimisht këtë disiplinë, vetë-analizës, [...] të analizojmë në mënyrë kritike supozimet dhe deduktimet epistemologjike mbi të cilat mbështeten praktikat e saj." [17]

Në këtë mënyrë, studiuesi pohon më të drejtë se letërsia e krahasuar do të zhvillohet në drejtime e plane të larmishme, por duke ruajtur si karakteristikë fokusin e saj meta-disiplinar si pozitë e tretë, pra si një *tertium quid* që pikëprihet në mënyrë të trefishtë me letërsitë dhe me studimet letrare, të cilat i pranëvendos dhe i krahason dhe duke mbetur "një dimension i tretë që ndërmjetëson mes letërsisë dhe studimit letrar." Studiuesit shprehen me të drejtë se:

"Dalja e diskurseve të tilla si *letërsia botërore* dhe *republika botërore e letrave* [të cilat do t'i prekim më tej në këtë artikull- B.Sh.] nënkupton përpjekje të reja për t'i sjellë në një linjë dhe në një model vazhdimësie këto dallime, sidomos përmes teorive të sistemeve botërore transferuar tashmë në studimet letrare. Por siç ndodh me të gjitha përpjekjet që synojnë të përgjithshmen dhe universalen, ato do të përballen doemos me të veçantën, me specifiken, e cila ngrihet dhe e sfidon një sistematicitet të tillë. Kjo është një nga mënyrat sesi rishfaqet e ndryshmja dhe se si rivlerësohet letërsia e krahasuar si disiplinë dhe diskurs mbi të ndryshmen, më shumë sesa mbi të përgjithshmen, universalen apo globalen. Kjo *nuk* nënkupton mungesën e një sistemi apo të një horizonti të gjerë analitik në letërsinë e krahasuar. Kjo do të thotë se letërsia e krahasuar nuk mund t'i lejojë vetes të bëhet ekuivalente e sistematicitetit të vet të pashmangshëm apo me globalizimin që ajo vë në pikëpyetje, pra që ia nënshtron vazhdimisht procesit të marrjes në pyetje. Në këtë kuptim, letërsia e krahasuar duhet të mbajë gjithmonë lidhjet e veta diskursive me kombëtaren, me rajonalen dhe me lokalen, prej nga kanë zanafillën kulturat letrare."[18]

---

[17] Letërsia e krahasuar, globalizmi dhe letërsitë kombëtare, op.cit., f. 15.

[18] Ibid.

Franco Moretti është një nga emrat më të rëndësishëm të diskutimeve mbi letërsinë e krahasuar dhe atë botërore në SHBA, vepra e të cilit bazohet në analizën e sistemeve botërore, në marksizëm, në teoritë e evolucionit, si edhe në teoritë e autorëve jo perëndimorë si Roberto Schwartz dhe Masao Miyoshi[19] Ai e paraqet çështjen e letërsisë botërore, si një problem dhe jo një objekt. Sipas tij nuk ka më rëndësi pyetja se *çfarë* studion letërsia botërore, por *si* studion. Letërsia tashmë është një sistem planetar pohon ai.[20] Moretti prezanton konceptin e *distant reading* një koncept që propozohet si pasojë e domosdoshmërisë për të lexuar përtej kanonit letrar, çka do të thotë që koncepti i Kritikës së Re *Close reading* nuk jep më fryte. Sipas tij, letërsia e krahasuar ka aftësi më të madhe shpjeguese, është konceptualisht më e arrirë, shmang njëfaqësinë në të kuptuarit e letërsisë dhe është definitivisht sfida madhore dhe konstante intelektuale e letërsive kombëtare, sidomos e atyre lokale.[21]

Studiues të tjerë si Claudio Guillen e shohin letërsinë e krahasuar dhe, për pasojë, edhe qasjet ndaj letërsisë botërore si studimin sistematik të tërësive letrare supranacionale. Guillen dallon termin *ndërkombëtar* nga *suprancional* dhe përdor të dytin për shkak se pikërisht ky term thekson pikënisjen e studimit komparatistik, i cili nuk mund të gjendet kurrë në letërsitë kombëtare dhe as në ndërmarrëdhëniet mes tyre. Në përpjekje për të kuptuar raportet mes lokales dhe universales, Guillen pohon se aktualisht, ne ballafaqohemi me tri lloje kuptimesh: (a) Poetët dhe poetikat "e botës", të cilat nuk kufizohen në kompartimentet e ngushta të letërsive kombëtare. Kjo vjen si pasojë e faktit që universaliteti i fenomenit letrar është në rritje. (b) Vepra të cilat në itinerarin e tyre letrar, qoftë si të pranuara apo të refuzuara nga lexuesi, kritikët apo përkthyesit kanë arritur të qarkullojnë nëpër botë. Këtu Guillen nuk nënvizon aspektin normativ, antologjik apo vlerësues ndaj veprave. (c) Letërsia që reflekton bo-

[19] David Damrosch, Review on Emily Apter's On the Politics of Untranslatabily, New York: Verso, 2013. Botuar në Comparative Literature Studies, Pennsylvania State Univeristy, State College, f. 507.

[20] Franco Moretti, Conjectures on World Literature, Ed. Charles Prendergast, f. 148-149.

[21] Ibid., f.161-162.

tën, gjithë njerëzit me përvojat më të thella, më të zakonshme apo më jetëgjata të njeriut. Pra, kemi letërsi kombëtare, ndërkombëtare dhe supranacionale.[22] Rrjedhimisht, modeli amerikan i letërsisë së krahasuar i jep fund teorisë së ndikimeve, teori qendrore kjo në shkollën franceze dhe e kritikuar që në vitet '20 e '30. Në atë kohë e më pas, në SHBA u propozua një qasje që mundëson një të kuptuar më të kthjellët dhe më të thellë të kohës, shprehet Guillen.[23]

Të qenit të ndjeshëm ndaj të menduarit kritik dhe vetështyrtimi për vendin tonë në botë, është e vemja pamje sado e vogël që kemi për marrëdhënien tonë me botën. Prandaj, letërsia e krahasuar nuk është objekt, as subjekt dhe as problem. Ajo konsiderohet, siç përmendëm edhe më lartë, një praktikë. Sa kohë që praktikuesit e saj janë vetë subjekte, ata e objektifikojnë materialin e tyre dhe si rezultat, praktikat e tyre, natyrisht që mund të jenë problematike. Por, mbi të gjitha duhet theksuar se letërsia e krahasuar nuk definohet nga një korpus, nga një objekt apo një grup i pandryshueshëm problemesh. Ajo e merr domethënien, më së shumti, nga çfarë bëhet në emër të saj dhe nga mënyra sesi qartësohen, ndërtohen dhe manaxhohen ato praktika.[24] Më së fundi, letërsia botërore mund të mos jetë asgjë më shumë sesa rezultati i angazhimit tonë në aktin nocional dhe narrativ të të qenit në botë, (Ang. worlding).[25] dhe kjo ngre pyetje mjaftueshëm për një diskutim të gjatë teorik ku letërsi si shqipja duhet dhe mund të shprehen.

Charles Bernheimer thotë se pavarësisht perspektivave të ndryshme teorike, fjala kyç e diskutimeve të sotme mbi letërsinë e krahasuar është *kontekstualizmi*. Sot, historia, kultura, politika, lokalja dhe lokalizmi, gjinia, raca, orientimi seksual, klasa etj. duhen marrë sa më shumë në konsideratë nga studimi letrar, shprehet ai. Kjo duhet bërë pa materializuar

[22] Claudio Guillen. The Challenge of Comparative Literature, Harvard University Press, Massachusets, 1993, f. 40.

[23] Ibid., f. 60.

[24] Djelal Kadir, To World to Globalize, - Comparative Literature's Crossroads. Comparative Literature Studies, Vol. 41, Nr.1, 2004. [f.1-9]. F.1.

[25] Ibid., f.6.

rrezikun që letërsia të konsiderohet thjesht reflektim i faktorëve të sipërcituar. Në këtë aspekt, multikulturalizmi ofron, deri diku, një zgjidhje, por multikulturalizmi sipas tij, nuk fillon në shtëpi, në krahasimin me vetveten.[26] Sipas tij, optika e komparatistit nuk ngrihet mbi nocionet qendër - magjina, por mbi modelin eliptik të propozuar nga David Damrosch ku raporti me letërsinë gjenerohet nga dy vatra dhe secila përfshin elipsa të tjera. Një model i tillë vë në pikëpyetje autoritetet centralizuese dhe nënvizon përplasjet mes grupeve sociale etnike dominante dhe atyre që bëjnë rezistencë ndaj tyre. Në raportin Bernheimer për ACLA Ch. Berheimer thotë se edhe brenda letërsive kombëtare duhen vërejtur dallime me natyrë rajonale, gjinore, klasore, fetare, etnike, koloniale apo paskoloniale. Ai pohon madje se edhe brenda letërsive europiane zakonisht merren në konsideratë 3-4 letërsi dominante, mes të cilave deri edhe ajo italiane rrallë përfshihet bindshëm. Pra, kemi të bëjmë me margjinalizim, prandaj këto letërsi më pak të pranishme, pavarësisht shkakut të këtij mënjanimi, ai i quan letërsi të minoritetit, *minority literatures*. Ato njihen vetëm përmes përkthimit ndaj duhet një qasje më e drejpërdrejtë ndaj tyre. Megjithatë, qoftë edhe në përkthim, ato duhen trajtuar.[27]

Letërsia e krahasuar është disiplinë që bazohet në tensionin mes dy forcave qendërikëse: (a) tejkalimit të barrierave të kulturave nacionale dhe letërsive në raport me nocionin e letërsisë botërore si koncert, zhvilluar në shek. XIX, dhe (b) përpjekjes së rakorduar për të konsoliduar idenë e Europës në terma letrarë e kulturorë, si e dallueshme nga shoqëritë e tjera dhe nga prodhimet e tyre kulturore. David Damrosch ka pohuar me të drejtë se në studimet e krahasuara moderne nuk ka pasur zhvendosje më të fuqishme sesa rritja e vëmendjes ndaj letërsive që gjenden përtej kryeveprave shkruar nga autorë të vendeve të mëdha europiane.[28] Në këtë kontekst, nuk është pavend të kujtojmë se ndërsa interesi për letërsitë

[26] Charles Bernheimer, op.cit., f.9, 11.

[27] Op.cit., f. 44-45.

[28] Damrosch, David, World Literature in a Postcanonical, Hypercanonical Age, në Haun Saussy, ed., Comparative Literature in an Age of Globalization, pp. 43 – 53, Johns Hopkins University Press, Baltimore, 2006, f.43.

joeuropiane është rritur ndjeshëm, edhe nevoja për t'u kthyer nga letërsitë margjinale brenda vetë Europës ka marrë vëmendje të posaçme.

Pas botimit të librit të Edward Said-it *Orientalism* (1978), objektivi i letërsisë së krahasuar u zhvendos dukshëm, nga interesi për tekstualitetin, tek historiciteti, nga estetikja tek politikja, dhe nga receptimi individual tek pritjet kolektive që i bëhen tekstit letrar.[29] Madje, raporti me sistemet botërore dhe aktorët dominantë të tyre është kaq i fortë, sa Graham Huggan, pohon se letërsia botërore sot është një realpolitikë kulturore e globalizmit që maskohet si kozmopolitanizëm leximi, sipas Damrosch-it, apo si studim transnacional i formës, sipas Morett-it. Megjithatë, dhe ndoshta aq më shumë në kontekste kaq të tendosura dhe komplekse, komparatistika sot shtron me të drejtë pyetje si ato që formulon Brian Edwards, duke qenë në favor të procesit që njihet si qarkullim i letërsisë:

"Çfarë ndodh kur teksti lëviz në kontekste të reja, kur merret nga audienca që tejkalojnë imagjinatën e prodhuesve të tij, audienca që rrjedhin nga shoqëri apo hapësira diskursive rrënjësisht të ndryshme?"[30]

Këto pyetje të rikthejnë "në mënyrë aspak paradoksale" te një aspekt mjaft i rëndësishëm i studimeve të letërsisë së krahasuar dhe që është lidhja mes letërsisë dhe kombit. Ndërsa tek Spiceri dhe te idetë e tij gjendet bashkimi i suksesshëm i qasjes globale dhe i afrisë me tekstin,[31] Auerbachu është ai që në mënyrë pothuaj ikonike vizualizoi rrugën e letërsisë së krahasuar duke pohuar: shtëpia jonë filologjike është toka, jo më kombi."[32] Në rast se pranojmë, siç sugjerojnë studiuesit e fushës, se lidhja letërsi - komb i korrespondon realitetit social si pasojë e lidhjes së këtij realiteti me gjuhën dhe me rolin e letërsisë në ndërtimin e identiteteve kombëtare[33], atëherë do të marrim në konsideratë studimet post-

[29] Ch. Bernheimer, op.cit., f. 8.

[30] Bryan T.Edwards, Logic and Contexts of Circulation në Ch. Bernheimer, op.cit., f. 454.

[31] Emily Apter, Comparative Exile, Competing Margins in the History of Comparative Literature në Ch. Bernheimer op.cit., f.79.

[32] Peter Madsen, World Literature and World Thoughts; Brandes -Auerbach, në vëllimin Debating World Literature, Ed.Ch. Prengergast, Verso, London-New York, 2004, p. 54.

[33] Shih botimet e B. Anderson, 1994 dhe A-M.Thiesse, 1999.

koloniale apo *subaltern studies* të cilat pohojnë se prej këtej rrjedh fakti që vetë kanonet letrare kombëtare janë formuar njëherazi duke margjinalizuar apo edhe duke përjashtuar shkrimtarë që vinin nga grupe sociale të shtypura apo inferiore si gratë, emigrantët, minoritetet etnike, të kolonizuarit apo ish popujt e kolonizuar[34].

Ndërsa letërsia e krahasuar priret të promovojë një koncept më universalist të letërsisë, europocentrizmi dhe dominimi i vetëm disa letërsive kombëtare ka vijuar në forma të ndryshme. Studiuesit pohojnë se problematikat mbi zhvendosjet kuturore, të cilat i paraqesin në një dritë më vete letërsitë kombëtare, u shfaqën ose në departamentet e gjuhës ose në studimet e vendeve të vogla si Izraeli, Belgjika etj., letërsitë e të cilave nuk kanë fituar një legjitimitet të plotë në botë si pasojë e moshës relativisht të re të shtetit të cilit i përkasin (Izraeli), apo e pozicionit margjinal brenda studimeve të fushës, psh., studimeve frankofone, siç është rasti i Belgjikës. Sipas studiueseve, kjo është arsyeja përse shqyrtohet mundësia e shkëputjes së letërsisë nga nocioni i kombit, në mënyrë që të historicizohen kategoritë e të mësuarit e të të kuptuarit. Këtë linjë ka ndjekur Pascale Casanova[35], studiuese franceze, me veprën e të cilës "Republika botërore e letrave", studiuesit amerikanë janë marrë gjerësisht dhe nga pozicione të ndryshme teorike.

Një emër i njohur i studimeve në këtë fushë, studiuesja Mary Louis Pratt, pohon se tre janë faktorët historikë me më shumë peshë që kanë kushtëzuar letërsinë e krahasuar në SHBA: globalizimi, demokratizimi dhe dekolonizimi.[36] Pratt rimerr diskutimin e Raportit Bernheimer dhe pohon

---

[34] Shih veprat e njohura të studiuesve E. Said, 1978, G. C. Spivak, 1988, H. Bhabha, 1994.

[35] Pascale Casanova e ka studiuar kundërvënien mes nacionalizmit dhe universalizmit, si proces socio-historik më shumë sesa duke e hipostazuar atë. Këtë kundërvënie, Casanova e ka përdorur si një prizëm në të cilin të analizohen strategjitë e shkrimtarëve. Letërsia shihet jo vetëm në lidhjen e saj me procesin e ndërtimit të identitetit kombëtar, por edhe sa i takon aftësisë së saj për të kapërcyer kufijtë, pra, për të nënvizuar universalitetin e letërsisë.

[36] Mary Louise Pratt, Comparative Literature and Global Citizenship, në Ch. Bernhaimer op.cit., f.59.

se ky Raport flet për një lloj barazvlerësimi të përkthimit me margjinalen apo me atë që është në minoritet.[37] Sipas saj, tipari dallues i kompratistikës duhet të mbetet multilingualizmi, por jo duke nënkuptuar tashmë njerëz që dinë më shumë gjuhë, por njerëz që janë kulturalisht multilingë. Prandaj duhet ndërruar koncepti duke kaluar nga domosdoshmëria e të lexuarit të gjithçkaje në origjinal, drejt asaj që njihet si shtetësia globale, pra, nevoja që njerëzit të kenë njohje të thellë të më shumë se një gjuhe, letërsie dhe kulture. [38]

Sipas Pratt, sot komparativizmi përfshin si qasjen e njohur "horizontale" kur krahasohen rasti A dhe B, ashtu edhe atë vertikale të raportit të globales me lokalen. Njohja e mirë e letërsive lokale e gjen veten në kombinimin me ekspertizën dhe perspektivën transnacionale dhe globale. Raporti globale-lokale, këtu nuk ka afri me dikotomitë, teori-tekst apo universale-specifike.[39] Sipas Pratt, përpjekja për të mos e bashkuar letërsinë e krahasur me studimet kulturore duket shpesh si një përpjekje për t'u fshehur e për të mbajtur modelin hegjemonik të komparatistikës, duke përjashtuar kulturat më të reja që zbulohen.

Nga ana tjetër, Peter Brooks thotë se kontekstualizimi nuk ka përse të trembë askënd pasi letërsia është në vetvete një institucion, madje përherë ka qenë e tillë. Sidomos pas Rilindjes Europiane, letërsia u bë institucion në mënyrë plotësisht të vetëdijshme. Kjo do të thotë që, veç të tjerave, shkrimtari i përgjigjet jo vetëm kontekstit ideologjik dhe kulturor, por edhe historisë dhe rrethanave konkrete të letërsisë ku synon të bëjë pjesë.[40] Sipas Brooks, letërsia si formë e posaçme, unike leximi duhet të mbetet fokusi parësor dhe i padiskutueshëm i atij të studion letërsinë e krahasuar, por këtu Brooks sqaron konceptin e interdisiplinaritetit. Ky koncept nuk nënkupton një përzierje që përftohet duke marrë pak filozofi, pak histori apo të tjera fusha, në mënyrë që t'i përzjejmë mes tyre,

[37] Ibid., f. 60.

[38] Ibid., f.63.

[39] Ibid., f. .63-64.

[40] Peter Brooks, Must we Apologize? në Ch. Bernheimer op.cit., f. 101.

përkundrazi, ai arrihet vërtet kur trajtimi shkencor mbërrin pika të atilla, në të cilat kufijtë disiplinorë nuk kanë më kuptim dhe vetë logjika e brendshme e problemit imponon një rrëzim apo kapërcim të kufijve ndarës. Që të realizohet kjo gjë duhet të kesh njohje të shkëlqyera të disiplinës që lë pas e jo thjesht të asaj ku mbërrin.[41]

1.2 Studimet e letërsisë së krahasuar në SHBA dhe letërsia shqipe

Dy qasjet bazë që mbeten zotërueset ende sot në optikën e akademisë amerikane për letërsinë e krahasuar janë: (a) komparatistika klasike, e cila përqendrohet mbi të gjitha në parimin se kulturat nuk kuptohen e njihen përmes përkthimit, dhe si pasojë çelësi i punës së studiuesit të letërsisë së krahasuar është gjuha e letërsisë/letërsive me të cilat punon; (b) qasja multikulturaliste, e cila i qëndron parimit se kultura është e përkthyeshme, pluraliteti kulturor mund të studiohet dhe të jepet mësim edhe vetëm duke e ekspozuar studentin ndaj përmbajtjes, pavarësisht gjuhës në të cilën është shkruar, si dhe mundësisë për ta lexuar në origjinal apo në përkthim tekstin letrar.

Vlera që marrin këto dy linja diskutimi për letërsi si shqipja është mëse e dukshme. Ndërsa e para është më e lakmueshmja, ndoshta është edhe më pak e arritshmja, së paku në kushtet e tanishme. Qasja e dytë, ajo multikulturaliste do të ishte më e mundshme për një letërsi si shqipja që shkruhet në një gjuhë të folur nga pak milionë folës dhe larg zonës së interesit linguistik (dhe gjeopolitik) të tanishëm. Nga ana tjetër, kjo qasje e ekspozon letërsinë shqipe, dhe letërsi të tjera me të cilat ajo ngjet në një sërë pikëpamjesh, ndaj rreziqeve të globalizmit, të cilat për letërsitë e vogla apo margjinale janë akoma më të mëdha.

Pavarësisht masës në të cilën do të pranonim njërën apo tjetrën qasje, një drejtim madhor pune në kuadrin e komparatistikës është pikërisht krahasimi i letërsisë në raportet e saj me shtetin dhe strukturat e tij. Kjo qasje hedh dritë mbi autonominë e fushës, mbi censurën apriori dhe

[41] Peter Brooks, f. 102.

aposteriori, mbi mjetet që orientojnë prodhimin letrar apo instrumentalizmin e letërsisë për qëllime propagandistike etj.[42] Domethënia e këtij fakti për një letërsi si shqipja padyshim që është mjaft e madhe, e sidomos për periudhën më të ndërlikuar e që vazhdimisht kërkon studim siç është gjysma e dytë e shekullit XX. Ajo të fton të kujtosh se letërsia është art, por pikërish si e tillë, ajo është edhe fakt shoqëror e kulturor, pra, është një institucion. Këto fakte duhet të marrin peshën e tyre as më të madhe, por edhe as më të vogël në studimin e veprave, autorëve, dukurive.

Në planin e dytë themelor në të cilin zhvillohen studimet e letërsisë së krahasuar, në atë të multikulturalizmit, krahasimi mund të shtrihet në parimet organizative të strukturës së letërsisë së krahasuar në shtete të ndryshme apo në kontekste të ndryshme kombëtare. Duke qenë se letërsia shqpe është zhvilluar në hapësira të ndryshme shtetërore, kulturore, gjuhësore etj., padyshim që studimi i saj mund të përfitojë nga kjo qasje, por edhe mund të ofrojë shumë për studime të mëtejshme krahasuese në nivel transnacional. Kjo do të ndikonte në kuptimin që mund dhe duhet t'i japim sot historisë së letërsisë shqipe dhe çështjeve që lidhen me të. Rrjedhimisht, ne i qëndrojmë mendimit se specifikat e letërsisë shqipe, në plan kronologjik, tematik, të individualiteteve letrare, arealeve etj. janë të tilla që mund të përbëjnë objekt të rëndësishëm studimi duke patur parasysh karakterin thelbësisht ndërdisiplinar të letërsisë së krahasuar siç studiohet ajo në Shtetet e Bashkuara sot. Botimet më prestigjioze të njohura edhe nga ACLA e përkufizojnë letërsinë e krahasuar si ndërdisiplinore, ndërkulturore, dhe transnacionale.

Paul Jay në artikullin e tij të famshëm "Beyond Discipline? Globalization and the Future of English" theksonte nevojën për të mos e studiuar më letërsinë nëpër departamente sipas ndarjeve në periudha letrare dhe periudha historike. Ai vendoste theksin te nevoja për globalizimin e studimeve letrare në kuptimin e studimit të thelluar të rolit që luan letërsia në sistemet globale të shkëmbimit kulturor dhe pranon se ky

[42] Ibid., f. 230.

shkëmbim përherë ka qenë shumëdrejtimësh.[43] Ndërkaq, studiuesit kanë pohuar prej të paktën 2 dekadash se letërsitë kombëtare po dalin nga paradigma nacionale duke u orientuar për nga një model global studimesh, i cili pohon haptazi se qasjet krahasuese nuk përbëjnë më diçka specifike apo rastësore, por normën e punës në akademi.

Pra siç shohim, diskutimi shtrohet në nivelet e dy raporteve: (a) letërsi kombëtare (komb)- letërsi botërore transanacionalitet duke patur parasysh ndikimin që ka patur në studimet letrare teoria e sistemeve botërore e I. Wallerstein-it. Ai propozon këto kategori si bazën e krahasimit: bërthama, semi-periferia, periferia dhe pjesa e jashtme. Këto kategori paraqesin pozicionin relativ të një rajoni në raport me ekonominë botërore, por edhe disa veçori të politikës së brendshme dhe të ekonomisë; (b) letërsi margjinale-qendër, apo ndryshe rishikimi i kanonit letrar në raport me kontekstin global dhe me dukuritë transnacionale; sa dhe si mund t'i rezistojmë globalizimit, sidomos kulturat e vogla që natyrisht janë më të rrezikuara.

Letërsia e krahasuar nuk synon krahasim tekstesh, por vështrimin krahasues të mënyrave të leximit, të të shkruarit e të të menduarit. Nga ana tjetër, ajo është disiplina që ndërsa e ruan identitetin e vet, lëviz lirshëm mes fushave si filologjia, teoria letrare dhe kritike, historiografia, historicizmi dhe studimet kulturore.[44] Në këtë prizëm, poezia si zhanri që shenjon më imtësisht ndryshimet kulturore e sociale të një vendi dhe ku mbartet më drejtpërdrejt përvoja e tij si strukturë shoqërore, politike, gjuhësore, kulturore etj., merr një rëndësi të posaçme. Sipas Peter Brooks, i cili njihet botërisht për fokusin e tij kërkimor pothuaj ekskluziv te poezia, ky zhanër përbën regjistrin më të ndjeshëm ndaj ndryshimeve sociale e kulturore që kemi në dorë dhe komparatistika mund ta vërejë dhe ta studiojë specifikisht atë te letërsi të ndryshme, duke përdorur autoritetin

[43] Paul Jay, Beyond Discipline? Globalization and the Future of English. Special Topic: Globalizing Literary Studies . PML, 2001; f.42-43.

[44] Roland Greene, Their generation, in Ch. Bernheimer, op.cit., f. 144.

ndërkulturor, historik e teorik që disponon si disiplinë.[45] Sa më sipër lidhet me faktin se studiuesi i letërsisë së krahasuar nuk synon të dijë më shumë, por të dijë ndryshe. Për një letërsi si shqipja që është karakterizuar nga dominimi i gjatë e për shumë kohë pothuaj i pakonkuruar i poezisë nga zhanret e tjera, një perspektivë e tillë studimore do të ishte mjaft e frytshme. Po të kemi parasysh edhe faktorët socialë, politikë, kulturorë që ndikuan dukshëm në poezinë e shkruar gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX në areale të ndryshme letrare, paradigma teorike e letërsisë së krahasuar do të ishte një drejtim i dobishëm studimi. Kjo nënkupton njohjen *ndryshe* të zhanrit, të procesit letrar në letërsinë shqipe dhe ca më shumë akoma të topografisë së kërkimit dhe të ndërlidhjeve transnacionale të poezisë dhe të letërsisë shqipe shumë përtej edhe letërsisë së Europës Juglindore apo të kontinentit. Në këtë mënyrë, edhe ne do të merrnim pjesë në diskutimet teorike të fushës nëpërmjet realitetit letrar, shoqëror e politik që sjell letërsia shqipe dhe do t'i ofronim këtij realiteti një dimension të katërt analize, saktësie dhe vetëdijesimi, siç shprehet Roland Greene.[46] Qëndrimi i një studiuesi të njohur ndërkombëtar në lidhje me raportet mes rendit aktual botëror, letërsisë së krahasuar dhe letërsive kombëtare është i tillë:

"Ndonëse ndryshimet dhe asimetritë kanë qenë vazhdimisht truall pjellor për letërsinë e krahasuar dhe kanë ekzistuar gjithmonë, "domethënia e veçantë që marrin sot ato qëndron në faktin se forca të mëdha hegjemonike me natyrë ekonomike, politike dhe kulturore e kanë rrethuar globin dhe ushtrojnë vazhdimisht trysni për homogjenitet dhe uniformitet në qeverisje. Ndërkaq, po këto forca thellojnë dhe përkeqësojnë pabarazitë, asimetritë dhe ndryshimet në fusha si mirëqenia ekonomike, shpërndarja e ushqimit dhe e ujit, e pasurisë dhe e mundësive të prodhimit kulturor. Formacionet kombëtare, kufijtë e të cilave kanë qenë historikisht të përputhshme me kulturat kombëtare respektive nuk janë më të dallueshme qartë sepse depërtohen vazhdimisht nga teleteknologjitë e

[45] Ibid., f. 152.

[46] Ibid., f. 153.

reja dhe nga rrugë të reja qarkullimi të vektorëve ekonomikë dhe politikë që i dominojnë dhe tejkalojnë shumicën e kufijve kombëtarë. […] Sot, letërsia e krahasuar ka detyrimin shtesë që të gjurmojë dhe të analizojë rryma që ndërkëmbehen e kryqëzohen mes tyre, si dhe dinamikat e tyre kundërvepruese nisur nga fakti që këto rryma apo këta vektorë krijojnë diferencialet, të ndryshmet që duhen krahasuar dhe vlerësuar në mënyrë marrëdhëniesore. Rrjedhimisht, ne nuk mund t'i lejojmë më vetes të studiojmë poezinë shqipe në izolim apo të shkëputur nga poezia e krijuar në pjesën tjetër të Europës dhe në SHBA, sepse poetët e Tiranës janë familjarizuar me poezinë e krijuar në Nju Jork, Buenos Aires, Bogota, Berlin, Oslo, Pekin, Delhi, Moskë, Kairo dhe Pretoria. […] Pikërisht për këtë arsye, komparatistët e sotëm duhet të përballen me një detyrë, të cilën gjithmonë e kanë shmangur, por që tani është po aq e rëndësishme sa edhe analizat dhe kërkimet e tyre akademike dhe arkivore: ata duhet të bëjnë recenca të librave të rinj apo të faqeve online që prodhojnë shkrimtarët, brenda spektrit të tyre të specializimit, në plan gjeografik dhe gjuhësor. Pra, detyra e letërsisë së krahasuar sot është më publike dhe e një rëndësie shumë më të madhe në sferën publike, sesa kurrë më parë. Tani bëhet akoma më e domosdoshme për komparatistin që të balancojë përgjegjësitë e tij, si studiues në bibliotekë apo në arkiva, si mësimdhënës në auditorin universitar ku jep mësim, si dhe në agorën publike, qoftë kjo virtuale apo reale."[47]

Përgjegjësitë e komparatistit duket se janë jashtëzakonisht më të gjera tashmë dhe lidhen direkt edhe me një aspekt tjetër të letërsisë së krahasuar që do sillte dobi direkte në studimet letrare shqipe. Bëhet fjalë për raportin e propozuar apo të nënkuptuar edhe në Bernheimer Report: përkthim - letërsi margjinale. Letërsitë e vogla duket se janë të paracaktuara të bëhen të njohura vetëm në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, pra, vetëm përmes përkthimit, çka dëshmon thellimin e ndarjeve letërsi dominante - letërsi margjinale. Si pasojë, vetë përkthimi i këtyre gjuhëve, i letërsive të tyre dhe receptimi i tyre në përkthim është një terren studi-

[47] Letërsia e krahasuar, globalizmi dhe letërsitë kombëtare, Intervistë, D. Kadir, op. cit., 15.

mor jo vetëm i gjerë dhe i hapur, por që ka interes të veçantë për studiuesit e fushës në universitetet më të mira të SHBA-së. Mënyra si zhvillohet një dukuri e tillë në letërsinë shqipe do të jetë një diskutim me shumë vlerë dhe do të ndihmonte në diskutimin global që ekziston sot mbi rolin e atyre që njihen si *linnear commentaries* në studimin e veprave nga gjuhë të veçanta apo edhe nga vepra specifike të letërsive 'dominante' si psh. *Zgjimi i fineganëve*.

Aspekti tjetër ku mund të përfitojë dhe të kontribuojë direkt letërsia shqipe në diskursin akademik të SHBA dhe atë global lidhet me qasjen e propozuar nga studiuesja e njohur M.L.Pratt, e cila siç kemi përmendur edhe më lart, pohon se studimi i letërsisë sot, përtej treguesve kombëtarë, mund të përqendrohet në efektin që kanë në to proceset e globalizimit, demokratizimit dhe dekolonializimit. Natyrisht që dy të parët i kanë të dukshme dhe fare direkte referencat dhe hapësirën studimore në letërsinë shqipe, qoftë sa i takon sfondit politik, qoftë sa u takon, për shembull kategorive anësore në prodhimin letrar siç kanë qenë për shumë kohë shkrimtaret gra. Por edhe procesi i tretë, që mund të duket se lidhet pak ose aspak me studimet e letërsisë shqipe, në fakt krijon një hapësirë mjaft të rëndësishme për diskutim. Argumentat sa i takon kuptimit dhe natyrës së dekolonializmit në studimet e letërsive të vendeve të ish Bllokut Lindor i ka paraqitur që prej disa vitesh tashmë Nancy Condee, studiuese e njohur e letërsisë në Universitetin e Pitsburgut, e cila interesohet për letërsitë e vendeve të Botës së Dytë, në kontekstin e programit të Studimeve Globale.

Një aspekt teorik më vete i lidhur me studimet e letërsisë së krahasuar në SHBA është edhe ai që përqendrohet te problematika e kanonit letrar, e raportit të letërsisë - parë si retorikë dhe teori zhanresh - me letërsinë në kontekstin e studimeve kulturore e kritike. Një qasje e tillë është rezultat i rrethanave historike të zhvillimit të letërsisë së krahasuar në SHBA (kemi parasysh egzilin e etërve të fushës nga Europa e Luftës së Dytë Botërore). Rishikimi i kanonit letrar në raport me studimet kulturore sipas modelit dhe përhapjes që kanë ato në SHBA është një mënyrë për të

rivënë në pikëpyetje, për të rishqyrtuar atë që është margjinale dhe atë që është dominante, vetëm se tashmë jo vetëm me fokusin në parametrat e formës, tekstit, zhanrit etj. Kjo na rikujton se të diskutuarit për kanonin është në fakt një mënyrë për të folur mbi një numër çështjesh të tjera sociale dhe politike, dhe më konkretisht për atë se kush e ka dhe kush e ushtron pushtetin. [48]

Në hapësirën e gjerë të diskutimeve të letërsisë së krahasuar ka edhe një qasje tjetër ndaj letërsive kombëtare që natyrisht, duke synuar transnacionalen i shikon letërsitë kombëtare në një dritë mjaft interesante. Studiuesja Rey Chow shikon si domosdoshmëri në kontekstet e sotme, jo mësimin e shumë gjuhëve, sidomos të gjuhëve të vogla, por njohjen e varianteve të një gjuhe. Në realitetin amerikano-verior, kjo nënkupton ato që njihen si psh. Black English, Asian American English, Latino English etj., dhe studimin e letërsisë së shkruar në ato gjuhë. Në rastin e gjuhëve të tjera, qoftë edhe në vende me struktura dhe përbërje shoqërore më pak heterogjene, kjo qasje jep mundësinë e një studimi më të imtësishëm duke ndihmuar të kthehet vëmendja në letërsinë e shkruar në dialekt ose në diasporë. Në fakt, studimet e letërsive në të dyja këto drejtime të përmendura së fundi janë të një dobie të madhe edhe për letërsinë shqipe dhe letërsi të tjera të ngjashme me të. Mjafton të kujtojmë letërsinë e shkruar nga arbëreshët në shekuj e sidomos në bashkëkohësi, apo letërsinë e autorëve shqiptarë që jetojnë jashtë Shqipërisë që pas vite ’90 për të parë sa e gjerë është gama e problemeve që presin shqyrtim nga studiuesit letrarë.

1.3 Në përfundim

Studimet mbi letërsinë shqipe në SHBA kanë njohur një sërë kon-

[48] Shiko Theo D’haen, How Many Canons Do We Need? World Literature, National Literature, European Literature, Liviu Papadima, David Damrosch and Theo D’haen, ed. The Canonical Debate Today: Crossing Disciplinary and Cultural Boundaries, Amsterdam and New York: Rodopi.

tributesh deri më sot, por synimi i këtij artikulli ishte të shihte perspektivën e këtyre studimeve në kontekstet e sotme letrare e sociale botërore, duke u mbështetur në paradigmën që ofron letërsia e krahasuar në SHBA. Kjo paradigmë ofron hapësira me potencial tepër të madh studimi për letërsi si shqipja, të cilat si pasojë e gjuhës specifike në të cilën shkruhen nuk studiohen në mënyrë të posaçme në departamentet e gjuhëve moderne.

Letërsia shqipe ka një historik padyshim më të gjatë edhe sesa shkrimi i saj. Kjo do të thotë se raportet e saj me letërsi, kultura dhe tradita të rajonit e më gjerë janë të shumta dhe të larmishme, prandaj ajo meriton një vëmendje të posaçme në pikëvështrimin e studimeve të krahasuara. Studiuesit amerikanë me të drejtë kanë pohuar se studimet komparatistike nënkuptojnë doemos dy faza: (a) t'u njohësh gjërave natyrën e tyre të veçantë; dhe (b) të shquash marrëdhënien që mund të ekzistojë mes një të veçante dhe një tjetre:

> "Në këtë kuptim, Shqipëria, si një fenomen i veçantë, i dallueshëm, ndan me të veçantat e tjera të qenit e saj e hapur ndaj marrëdhënieve dhe lidhjeve. Baza dhe kriteret e këtyre lidhjeve varen nga rrethanat historike, nga përvojat kolektive, nga vetë-perceptimet dhe nga perceptimet e gabuara, nga pohime të verifikueshme dhe të tjera të pavërteta e të paverifikueshme. Të gjitha këto janë mënyrat e ndërlikuara sesi ekziston e veçanta, dhe letërsia është një pikë kyçe ku ato konvergojnë dhe bëhen të lexueshme dhe të kuptueshme (inteligjibile). Të kuptuarit, në këtë perspektivë përbën një sfidë të mahnitshme në rastin e Shqipërisë dhe të vendeve të tjera të ngjashme me të, për shkak të shumëfaqësisë së të veçantave që janë ndërthurur gjatë historisë për të ndërtuar atë të veçantë, atë partikularitet që quhet Shqipëri. Vetë mahnitja [...] me vepra si *Pallati i ëndrrave* i Kadaresë [...], ndodh për shkak të dramaticitetit të tij narrativ, të qenit një alegori kombëtare e asaj sesi fenomeni që quhet Shqipëri e ka ngjizur veçantësinë e saj përmes rrjetit të ndërmarrëdhënieve historike me të veçanta të tjera, të cilat kanë qenë pjesë integrale të historisë së saj. Për shkak se është

> një topografi e konvergjencave të popujve, historive, miteve dhe tragjedive që nga periudha kohore që nuk mbahen mend, Shqipëria është laboratori ideal, pra, pikërisht ai që ëndërron letërsia e krahasuar. Ndryshe nga ato që mund të quhen "letërsi madhore" apo "të mëdha", të cilat e konsiderojnë veten të pakrahasueshme, për mua dhe nisur nga ajo njohje e kufizuar që kam për letërsinë shqipe, kjo letërsi zotëron një urtësi të brendshme që i lejon asaj të hapet ndaj krahasimit dhe leximeve krahasuese, për shkak se dëshmon që ajo përbëhet nga konvergjencat dhe divergjencat e një shumësie të veçantash që kanë rendur gjatë historisë dhe që ende janë të pranishme në atë terrior, në terrenin e vet imagjinativ dhe topografik."[49]

Për shkak të vetë natyrës dhe zhvillimit të saj, të cilin u munduam ta paraqesnim në mënyrë sa më sintetike në këtë artikull, letërsia e krahasuar ka një vend të posaçëm në arenën ku diskutohet rreth kundërshtive të forcave të ndryshme qendërikëse a qendërsynuese, të cilat ndikojnë direkt në letërsinë botërore sot. Kjo vjen si pasojë e fokusit të komparatistikës tek e ndryshmja, te ndryshimet mes institucioneve dhe ngrehinave njerëzore. Ajo madje, përqendrohet tek dallimet brenda vetë strukturave institucionale, duke fituar kështu vlerën e një institucioni të kujtesës pasi shërben si një kujtesë se rendi i gjërave dhe normaliteti i tyre nuk kanë pse të jenë doemos ashtu siç i shohim sot. Djelal Kadir pohon më tej, se supozimi mbi normalitetin e gjërave nuk duhet pranuar si i mirëqenë pasi, fundja, ato janë ngrehina njerëzore dhe si të tilla mund të analizohen, të vlerësohen, të reformohen në mënyrë transformuese, si dhe të rikonstruktohen, dhe kjo përbën anën më specifike të letërsisë së krahasuar pasi shenjon rolin, ndikimin e saj dhe faktin që ajo përbën kërcënim të përhershëm për status-quo-të dhe sistemet.

Letërsia shqipe ka shumë për të dhënë në këtë diskutim global akademik me qendër në SHBA dhe ka shumë për të mësuar, në mënyrë që të njohë më mirë vetveten dhe kulturën që e lindi, në një kohë kur zhvillimet globale kanë ndikuar në pothuaj çdo aspekt të procesit letrar.

---

[49] Letërsia e krahasuar, globalizmi dhe letërsitë kombëtare, Intervistë II, D. Kadir, op. cit., 16.

Bavjola SHATRO, Aleksandër Moisiu University, Durrës

ALBANIAN STUDIES AND COMPARATIVE LITERATURE IN THE NORTH AMERICAN ACADEMY[50]

Summary

This paper aims to introduce possible paths of study for Albanian Studies seen through the perspective of Comparative literature as it is practiced in North American universities, mainly in the United States. There will be emphasis on the factor of language, and the particularities that make Albanian literature a very fertile ground for research. This approach would help introduce Albanian literature to international readership and academe. It aims to highlight the potential that comparatism has in Albanian Studies as a discourse that constantly questions status quos in the literary process and in society in general.

Among the questions that the paper endeavors to deal with are the aspects of Albanian literature that could be of interest considering the essentially interdisciplinary nature of comparative literature in North America and why this interdisciplinarity would be fruitful to Albanian Studies. Albanian Studies cannot afford to develop within the national borders or, worse, within state borders; nor can it afford to be self-centered and to disregard relationships to other arts, to history, philosophy, sociology, and other sciences. This perspective which is quite common and stands at the heart of Comparative Literature in the United States academe would foster the communication of Albanian Studies – and Albanian literature in particular – with other literatures and cultures. This is a crucial precondition to reaching a deeper understanding of the development of Albanian literature as well as the literary process in nowadays globalizing world. Albanian literature will not

[50] This article was originally written in English and then transalted into Albanian in order to be presented at the Conference on Albanian Studies in North America held at the Academy of Science and Arts in Kosovo in September 2015. While writing this article there has been wide use of my academic experience in prestigious American Universities such as Pennsylvania State University, University of Mississippi, and University of Washington in Seattle etc. I am deeply grateful to Professor Djelal Kadir at Pennsylvania State University, for being an inspiring guide for my work, through the very rewarding academic disuccions regarding today's challenges of comparative literature and especially national literatures. I also give credit to professors Sophia McClennen, Shuang Shen, Nergis Erturk at Pensylvania State University and Nancy Condee at the Univerity of Pittsbugh for the insight I was able to gain while attending their lectures and presentations during Spring term 3 years ago in Pennsylvania State University, State College, USA. This academic experience was made possible by the JFDP Fellowship offered by the Department of State, USA.

be seen in the framework of South-East European Literatures solely; it would become instead an active part of a large worldwide discourse on literature and culture, which American comparativism has highly valued and practiced since WWII.

Our main thesis in this article is related to the necessity to focus on the (possible) position that small/minority/marginal literatures occupy in today's global contexts where literary studies are widely influenced by political, economical and social factors. Indeed literary studies are significantly influenced by I. Wallerstein's theory of world systems. The place of national literatures in a globalizing world and the dangers they face as well as the opportunities that emerge in this changing context deserve utmost attention by Albanian scholars too considering that Albanian literature is one of the marginal literatures in Europe. Such problems have been addressed by comparatists in the North American academe in the last decades and particularly in the US. It is from this perspective that we aim to elaborate on how Albanian studies could benefit from this academic discussions. The three Reports addressed to the ACLA by the Committee of Professional Standards: Levin Report 1965, Green Report 1975, Bernheimer Report 1993 will often be referred to in this article.

As is well-known, the main theoretic rubrics in the academic discourse on comparative literature - even though to some scholars they hardly qualify as fully-fledged paradigms - are: *Global Studies* (F. Jameson, Masao Miyoshi), *Cosmopolitanism* (Bruce Robins, Timothy Brennan), *World Literature* (David Damrosch, Franco Moretti), *Literary Transnationalism* (G. C. Spivak), and *Comparative Postcolonial an*d *Diaspora Studies* (Edward Said, Homi Bhabha, Francois Lionnet, Rey Chow).

The main approaches in the field that we address in this article are those which remain the undisputed general trends of comparatistics nowadays: (a) the classic comparativism, based on the principle that cultures cannot be understood in translation, and therefore the key to working with those cultures in a comparative perspective is knowledge of the language of those literatures; and (b) the multiculturalists approach, based on the principle that culture is translatable, and it can be taught even by simply exposing the student to content regardless of its form. Thus reading in original is not a sine qua non and translation acquires an important role.

Especially when addressing the second approach we must necessarily pose the question whether this approach would help or endanger small literatures. Albanian literature is a very good example that can be taken into consideration in discussions that aim at bringing to focus the question of marginalized literatures of Europe. If the debates on comparative literature succeed in finding their deserved place into the realm of Albanian Studies, and especially in Literary Studies, this can help clarify many literary issues starting with very sensitive questions such as the autonomy of the field, the a priori and a posteriori censorship, the media that influence literary production or the instrumenttalization of literature for propagandistic purposes of different origins, etc. This approach acquires a significant importance for literatures such as Albanian literature, considering its atypical development over several centuries and, most of all, during the communist regime and the post- 1990 period, when Albania was eventually exposed to globalization.

Thus we deal with a two-sided discussion: (a) The relationship national literature (nation) - world literature (transnationality), which is widely based on the enormous influence of I. Wallerstein's world systems theory on literary studies. He suggests four basic categories of comparison: core, semi-periphery, periphery, external, categories which define the relative position a region has in relation to world economy but which also display a number of characteristics of the inner politics and the economy of these regions; (b) The relationship marginal literature - center, which is related to the revisioning of the literary canon in relation to the global context and the transnational phenomena. This said, we are now asking: how and to what extent can globalism be resisted, especially by the small cultures which are obviously much more endangered, Albanian being one of them. If we consider that the 21st century will be the century of migrants[51] and that it's been about 25 years that Albanian authors have been writing and publishing – whether in Albanian or in other languages – in different countries of the world, then Albanian literature can greatly profit from these theoretic approaches to develop a wider discussion about its literary process and phenomena.

Comparatistics could contribute also to a genre theory-oriented study of Albanian literature. Peter Brooks maintains that poetry represents the most sensitive register of social and cultural change that we possess. Comparatistics studies this genre based on the cross-cultural, historic and theoretic authority that it has as a discipline. This is in accord with the fact that today a literary scholar aims not to know *more* but rather to know *different*. Considering the very long and essentially important tradition of poetry in Albanian literature - where poetry has been a very influential literary genre even in the 20th century - this approach would turn out to be fruitful in the context of the transnational links that Albanian literature has not only with the Balkan countries but even beyond the context of the southeast European literatures.

This would also shed light on another aspect of the research in the field of Albanian literature: the relationship between marginal literatures – translation, an equivalence that seems to have been implied especially in the Bernheimer Report. How does this relationship work and what are its implications for literatures such as the Albanian literature? How would it influence the literary production of Albanian writers in Albania and outside the borders of Albania? These are only some of the significant questions that would be broached once this issue has been finally addressed and given due attention by scholars of Albanian literature.

Mary Louis Pratt points at another aspect of comparative studies related to the effect that three important and worldwide processes have on national literatures: globalization, democratization, and decolonization. Considering the historical context of Albanian literature especially during the second half of the 20th century, the first two processes would constitute an important approach for further research. Meanwhile the third process "even though seemingly unrelated to Albanian literature" has been already intro-

[51] See Thomas Nail, The Figure of the Migrant, Stanford University Press, Stanford, California, 2015, p.1.

duced into the ongoing debate by scholars in the US[52]. Albanian literature can greatly contribute with a specific case study in this regard too considering the development of Albanian literature under communism.

Rey Chow maintains that in view of the present global contexts it is not indispensable to learn more languages but to know better the variants of a language. It is clear that in the USA this means Black English, Asian American English, Latino English etc, and the study of literature written in these variants. In cases such as Albanian literature, where the population is less heterogenous linguistically and culturally, this would help to focus more on literature written in dialects and the literary works written by authors living abroad (the Diaspora). The literature of the Arbëresh community in southern Italy written in a special variant of Albanian would be a very significant field of research and so would literatures that ethnic minorities tend to write as they integrate more into the Albanian social and cultural life. On the other hand there are the Albanian writers that have emigrated in different countries in Europe or in the United States whose work offers a fertile ground of research in this aspect and in several other aspects that compratistics aims to tackle.

Seeing that the challenges to Albanian literature and other similar literatures seem to find in comparatistics the appropriate arena for constant academic debates, we'd like to conclude this résumé by recalling the words of a well-known scholar in the field of Comparative Literature, Djelal Kadir, who in discussing Albanian literature in a recent interview given to an Albanian cultural periodical, maintains that:

"Comparative Literature [...] begins with a two-step process that consist, first, in granting things their particularity and, secondly, discerning the relation that might obtain between any one particular and any others. In this sense, Albania as a particular phenomenon shares with all other particulars the susceptibility to be related and correlated. The basis and criteria of this correlation depend on the historical circumstances, on the reality of collective experience, on the expressed reality of shared illusions, self-perceptions and mis-perceptions, verifiable claims and non-verifiable truths. These are all complex ways of being particular and literature becomes a focus point where they converge and become legible, intelligible, instances and objects of intelligence, to continue with the significance of the Latin verb. In the case of Albania and places like it, intelligibility becomes a very exciting challenge because of the multiplicity of particulars that historically have gone into the formation of its own particularity. And my own fascination with works such as Kadare's *The Palace of Dreams* that you mention is because it is a narrative dramatization, a national allegory, of how the phenomenon called Albania constitutes its own particularity through the web of historical interrelations with other particulars that have been an integral part of its history. As a topography of convergence of peoples, histories, myths, and tragedies since time immemorial, Albania is a dream laboratory for Comparative Literature. And, unlike what some might call "major literatures" that consider themselves

[52] Lecture by Nancy Condee, University of Pittsburgh, at the *Luncheon Series*, Pennsylvania State University, February 2012.

incomparable, Albanian literature, from my very limited familiarity with it, is possessed of an inherent wisdom that allows it to open itself to comparison and comparative readings since it understands that it is constituted by the convergence and divergence of multiple particularities that have passed through and that still inhabit its territory—its imaginative and topographical terrain."

Referencat

1. Apter, Emily. “Comparative Exile, Competing Margins in the History of Comparative Literature” në vëllimin e Charles Bernheimer “Comparative Literature in the Age of Multiculturalism”, John Hopkins UniversityPress, Baltimore, London, 1993.
2. Apter, Emily. “Global Translation: ‘The Intervention’ of Comparative Literature, Istanbul, 1933”, fq. 76-109, në “Debating World Literature”, Ed. Christopher Prendergast, London- New York: Verso, 2004.
3. Behdad, Ali and Dominic Thomas, *Introduction* to “A Companion to Comaprative Literature”, Wiley-Blackwell, West Sussex, 2011.
4. “Comparative Literature in the Age of Multiculturalism” Ed. by Charles Bernheimer, John Hopkins University Press, Baltimore, London, 1995.
5. Brooks, Peter. “Must we Apologize?” në Charles Bernheimer “Comparative Literature in the Age of Multiculturalism”, John Hopkins University Press, Baltimore, London, 1995.
6. Cao, Shunqing. “The Variation Theory of Comparative Literature”, Springer, 2013.
7. Christopher Prendegast, “The World Republic of Letters”, në vëllimin përmbledhës “Debating World Literature”, Verso, London-New York, 2004.
8. Chow, Rey. “In the Name of Comparative Literature”, në Charles Bernheimer “Comparative Literature in the Age of Multiculturalism, fq. 107 – 16, Johns Hopkins University Press, Baltimore, 1995.
9. Culler, Jonathan. “Comparative Literature, at last!” in Charles Bernheimer, “Comparative Literature in the Age of Multiculturalism”, John Hopkins University Press, Baltimore, London, 1995.
10. Damrosch, David. “Literary Study in an Elliptical Age” in Charles Bernheimer, “Comparative Literature in the Age of Multiculturalism”, John Hopkins University Press, Baltimore, London, 1993.
11. Damrosch, David. Review on Emily Apter’s “On the Politics of Untranslatabily”, New York:Verso, 2013, in *Comparative Literature Studies*, Pennsylvania State University, State College, SHBA.
12. Damrosch, David. “World Literature in a Postcanonical, Hypercanonical Age”. In Haun Saussy, ed., “Comparative Literature in an Age of Globalization”, fq. 43 – 53, Johns Hopkins University Press, Baltimore, 2006.
13. Theo D’haen, “How Many Canons Do We Need? World Literature, National Literature, European Literature”, Liviu Papadima, David Damrosch and Theo D’haen, ed. The Canonical Debate Today: Crossing Disciplinary and Cultural Boundaries, Amsterdam and New York: Rodopi.
14. Edwards, Bryan T. “Logic and Contexts of Circulation” in Charles Bernheimer. “Comparative Literature in the Age of Multiculturalism”, John Hopkins University Press, Baltimore, London, 1995.
15. Ferris, David. “Why Compare?” në Ali Behdad and Dominic Thomas “A Companion to Comparative Literature”, Wiley-Blackwell, West Sussex, 2011.

16. Guillen, Claudio. “The Challenge of Comparative Literature”, Harvard University Press, Massachusets, 1993.
17. Greene, Roland. “Their generation”, in Charles Bernheimer “Comparative Literature in the Age of Multiculturalism”, John Hopkins University Press, Baltimore, London, 1995.
18. Jay, Paul. “Beyond Discipline? Globalization and the Future of English”. Special Topic: Globalizing Literary Studies . PML, 2001.
19. Kadir, Djelal. “Memos from the Besieged City”: Stanford University Press, California, USA, 2011.
20. Kadir, Djelal. “To World to Globalize - Comparative Literature’s Crossroads”. *Comparative Literature Studies*, Vol. 41, Nr.1, 2004. fq. 1-9.
21. Lecture by Nancy Condee, University of Pittsburgh at the *Luncheon Series*, Pennsylvania State University, February 2012.
22. “Letërsia e krahasuar, globalizmi dhe letërsitë kombëtare”, Intervistë me Profesor Djelal Kadir, pjesa I; Intervistoi Dr. Bavjola Shatro. Suplementi “Milosao” 5 prill 2015.
23. “Letërsia e krahasuar, globalizmi dhe letërsitë kombëtare”, Intervistë me Profesor Djelal Kadir, pjesa II; Intervistoi Dr. Bavjola Shatro. Suplementi “Milosao”, Prill 2015.
24. Madsen, Peter. “World Literature and World Thoughts; Brandes -Auerbach”, në vëllimin “Debating World Literature”, Ed.Christoher Prengergast, Verso, London-New York, 2004.
25. Moretti, Franco. “Conjectures on World Literature”, në “Debating World Literature”, Christopher Prendergast, London- New York: Verso, 2004.
26. Nail, Thomas. “The Figure of the Migrant”, Stanford University Press, Stanford, California, 2015.
27. Pizer, John “Towards a productive interdisciplinary relationship: between comparative literature and world literature”. *The Comparatist*, 31. 6 – 28.
28. Pratt, Mary Louise. “Comparative Literature and Global Citizenship”, në Charles Bernhaimer “Comparative Literature in the Age of Multiculturalism”, John Hopkins University Press, Baltimore, London, 1995.
29. Said, Edward W. “Culture and Imperialism”, Alfred A. Knopf, New York, 1993.
30. Said, Edward W. “Humanism and Democratic Criticism”, Columbia University Press, New York, 2004.
31. Sapiro, Gisele. “Comparativism, Transfers, Entagled History; Sociological Perspectives on Literature”, in A. Behdad and D. Thomas“A Companion to Comparative Literature”, Wiley-Blackwell, West Sussex, 2011.
32. The Bernheimer Report, 1995.

Dhurata SHEHRI, Universiteti i Tiranës, Tiranë

ARSHI PIPA LEXON LETËRSINË BASHKËKOHORE

Në shkrimin e tij të hershëm të botuar në numrin e parë të revistës "Kritika" të themeluar nga ai vetë në vitin 1944, Pipa ndan dy detyra për kritikën: "me vlerësue traditën dhe me ndjek hap pas hapi prodhimin e kohës"[1]. Në këtë paraqitje do të ndalemi tek mënyra si e ka "kryer" detyrën e dytë, pra, tek Pipa si lexues i bashkëkohësisë. Rendi i gjërave na çon pashmangshëm tek Pipa si lexues i vetvetes dhe tek kanonizimi i letërsisë bashkëkohore gjë që duket një oksimoron i pastër.

Edhe pse në dukje, kritika shqiptare e ka synuar objektiven si vlerë të kritikes, ajo s'ka bërë gjë tjetër veçse e ka përdorur atë si "mbështetje", mburojë a mbrojtje. Prirja është aq e fortë dhe e vjetër sa ka prodhuar një model: modelin e kritikës binare, ku për të argumentuar objektivisht pëlqimin e një shkrimtari, ai vihej përballë një shkrimtari tjetër me të cilin kishte mundësi krahasimi, mundësisht kundërshtie. Kritika shqiptare e realizmit socialist, kryesisht (ose tërësisht) për arsye ideologjike, ka imponuar modelin *ose/ose* në vend të modelit *edhe/edhe*. Në rend kronologjik, me argumenta e qëllime ideologjike kritika ka zgjedhur: ose De Radën, ose Skiroin, ose Naimin ose Fishtën, ose Fishtën ose Mjedën, ose Nolin ose Poradecin, ose Koliqin ose Migjenin në një varg dikotomik që ka krijuar dy kanone përjashtuese që nuk mund të funksionojnë veçse përballë njëri-tjetrit deri sa vjen sanksionimi në kanonin "solid" të realizmit socialist. "Një emër i përshtatshëm për këtë lloj kritike është shijim ideologjik" e përkufizon Pipa kritikën e realizmit socialist në të cilën "gjykimi estetik është i reduktuar në kompilimin e një kolone me pluse dhe një me

[1] Arshi Pipa, Shpirti kritik, në Kritika, Princi, Tiranë 2006, f. 30

minuse që lidhen me faktin nëse vepra përputhet me një set të dhënë rregullash[2]".

Citimi i mësipërm gjendet në një nga veprat e fundit të botuara nga Pipa, në *Letërsinë bashkëkohore shqipe*, e cila është ndarë po në dy pjesë: *Realizmi socialist shqiptar* dhe *Poezia dhe poetika e Martin Camajt*. Dy pjesë, të lidhura me *ose/ose*, por edhe dy mënyra të të bërit kritikë. Dy lexime që edhe vizualisht të çojnë tek modeli *ose/ose*. Ku model nuk shfaqet së pari tek këto shkrime të Pipës, një model të ngjashëm gjejmë edhe në shkrime të tjera për letërsinë bashkëkohore, si tek *Fshatari në letërsinë bashkëkohore* ku edhe aty gjen dy tipa personazhesh që ndajnë dy tipa letërsie: *me raja* dhe *me kolkozë*; ose ndarja që bëhet mes shkrimtarëve që kanë pak interes për fshatin (Kadare) dhe atyre që fshatin e kanë identitet (Agolli).

Modeli *ose/ose* është i fortë në kritikën e letërsisë bashkëkohore tek Pipa, paradoksalisht po aq i fortë sa ç'është edhe vrulli për ta kundërshtuar kritikën ideologjike të realizmit socialist. Po të kemi parasysh letërsinë që analizohet, kritikën sociologjike të Pipës një hap e ndan nga kritika ideologjike (apo anti/ideologjike) e realizmit socialist.

1. Realizmi socialist shqiptar

Në pjesën e parë të punimit, *Letërsia bashkëkohore shqipe* zhvillimi i letërsisë së realizmit socialist në Shqipëri ndjek dy linja: analizën e veprave dhe autorëve kanonikë të kësaj letërsie dhe krahasimin me mëndimin e kritikës zyrtare për të njëjtat vepra dhe autorë.

Zgjedhjen e vet Pipa e bën në një tension mes dy leximesh: duke kërkuar kryesisht politiken si rezistencë dhe duke e gjetur atë edhe aty ku nuk është si dhe duke anashkaluar përmasën e letërsisë së pastër aty ku ajo është e ndjeshme.

Shenjat e këtij modeli ideologjik apo antiideologjik leximi janë të dukshme që në "periodizim", pasi veprat dhe autorët interpretohen nisur

[2] Arshi Pipa, Contemporary Albanian literature, New York 1991, f. 112

prej rrethanave politike si Revolucioni kulturor, Plenumi i 1974-s, vdekja e Hoxhës, etj. e sidomos në analizën që autori u bën veprave *Dasma* dhe *Kronikë në gur* të Kadaresë dhe veprave të para të autorëve të viteve 1985.

"Dasma është vepra e vetme e Kadaresë që nuk përmendet në Historinë e letërsisë shqiptare të realizmit socialist" dhe me të drejtë: romani është krejt e kundërta e modelit të vlerësuar në këtë punim: ajo është manifesti i anti realizmit socialist[3]" – shkruan Pipa. Por, intuita e kritikut nuk e lë që dy paragrafë më pas të mos pohojë se "Dasma" nuk është roman i mirë, madje nuk është as roman"[4].

Për veprën më të mirë të Kadaresë, "Kronikë në gur" Pipa shkruan se "është pikë së pari një roman politik, heretik në frymëzimin e tij."[5] ose se "perversiteti seksual dhe terrorizmi janë rrugët që përdor autori për të hedhur mbi qytetin e lindjes zemërimin e tij të dëshpëruar për gjendjen politike në kohën që ai e shkroi romanin."[6]

Shumë më bindës në provën e krahasimit është John Updike me recensionin e tij për "Kronikë në gur" kur të njëjtin aspekt e analizon: "Qyteti i tij i gurtë paraqitet si një analogji bindëse e fëmijërisë së çdokujt – miqësor deri edhe në misteret e tij, i vyer deri edhe në vuajtjet dhe barbarizmat e rrëfyera"[7].

Duke u nisur sërish nga parametra politikë, jashtëletrarë, me vdekjen e Enver Hoxhës, Pipa, po ashtu paramendon lindjen e një letërsie të re, më pak të angazhuar pas vitit 1985 dhe e kërkon këtë tek autorë si Petriti, Marku, Zogaj, Ahmeti, Rukaj etj. Por sot, me kritere shijeje i vetmi dallim i tyre me pararendësit Kadare e Agolli ishte talenti më i pakët poetik i "pasardhësve".

---

[3] Arshi Pipa, Contemporary Albanian literature, New York 1991, f. 54

[4] Po aty.

[5] Po aty, f. 59

[6] Arshi Pipa, Contemporary Albanian literature, New York 1991, f. 64

[7] John Updike, Kronika dhe procesione, në Kadare, Vepra 4, Onufri 2008, f. 37, botuar si parathënie recensioni i përkthyer në shqip nga John Updike botuar për herë të parë në The New Yorker 14.03.1988.

2. Poezia dhe poetika e Martin Camajt

"Martin Camaj është në gati çdo aspekt i kundërti i Kadaresë. Ndryshe nga Kadare, një shkrimtar tosk, i lindur musliman, marksist-leninist, urban, Camaj është një shkrimtar geg, katolik, demokratik fshatar. Dhe ndërsa Kadare është një narrator që ka provuar dorën edhe në "poema të shkurtra dhe të gjata", Camaj është një poet lirik i pastër dhe mbetet i tillë edhe kur shkruan prozë, duke shkëlqyer në një gjini, poemën në prozë, ku lirizmi mbërrin shkallën më të lartë"[8].

Vetëm në fillim, në hyrjen e punimit, Camaj klasifikohet prej Pipës përmes kundërshtisë. Më pas kritika e tij është veçuese dhe përzgjedhëse. Pipa veçon "Dranjen" nga gjithë krijimtaria e Camajt; veçon prozën poetike, por, sipas tij "askush përpara Camajt nuk ka përdorur atë lloj letrar për të strukturuar një rrëfim autobiografik"[9] (duke harruar *politikisht* "Pasqyrat e Narcizit" të Koliqit); veçon poetikën e *të ndërmjetmes* si domosdo: "Mes epizmit të Fishtës që ngre lart heroizmin e malësorëve dhe prozës epike të Migjenit që ankohet për zvetënimin e tyre, Camaj i bie një kordhe të ndërmjetme, e cila nuk është as mburrje, as dhemshuri, por një ndjenjë e thellë, gati-gati fizike identiteti me vendin e vet"[10]. Arshi Pipa zgjedh etikën si përplotësuese të poetikës së Camajt duke e marrë Dranjen si personifikim të "së vërtetës poetike"; zgjedh Camajn si poet të thellësisë së mendimit përkundër poetit lirik; zgjedh mundësinë e poetikës së të papërkryerës përkundër pamundësisë së lirikës së përkryer. Pipa dëshmohet subjektiv në zgjedhje, jo në veçim. Në këtë zgjedhje ai është edhe ekzilanti edhe veprimtari politik, edhe kundërshtari i komunizmit, edhe socialisti europian, por edhe shijuesi i Montales përballë Ungaretit. Ai zgjedh Camajn, prozën poetike, gegnishten folklorike etike dhe antihe-

---

[8] Arshi Pipa, Contemporary Albanian literature, New York 1991, f. iv.

[9] Arshi Pipa, Camaj's poetry and Poetics, në Contemporary Albanian literature, New York 1991, shqip në përthimin e M. Gjanajt te Camaj, Vepra 8, parathënia Dranja, Onufri 2010, f. 38

[10] Arshi Pipa, Fshatari në letërsinë bashkëkohore, në Letërsia shqipe: perspektiva shoqërore, Princi, Tiranë 2013, f. 172

roike për ta çuar deri në fund modelin e tij *ose/ose,* por zgjedhja e tij është edhe ideologjike, edhe politike, edhe sociologjike kur e përshkruan poezinë e Camajt si: "Një poetikë e të pakryerës që përmban një etikë antiheroike dhe formulon një politikë demokratike të gjuhës dhe një politikë demokratike *tout court*[11]" Ose kur shkruan se "Camaj i shkroi poezitë e veta më të mira kur modernizmi nuk e kishte prekur atë dhe kur ende mund t'i përgjigjej thirrjes së gjakut me një dëshirë të zjarrtë për emancipim të shtrirë në mënyrë bujare tek njerëzit e tjerë përtej vetes.[12]"

3. Autoportret

Modeli *ose/ose* është sa ideologjik, aq edhe subjektiv tek Pipa kur bëhet fjalë për autoportretin. Në studimin *Letërsia shqipe dhe perspektiva shoqërore* Camaj do ta klasifikojë poezinë e tij tek "Poezia e mërgimit", grupim në të cilin përfshihet Camaj dhe ai vetë. "Poeti i vetëdijshëm për artin e vet, mund të bajë, thomi na, kritikë me dinjitet"[13] – shkruan Pipa shumë vite më parë, siç shkruan edhe se "Objektiviteti asht kushti i parë i çdo kritike. Por kritika letrare – trill i poezis! – ka dhe një kusht tjetër; ajo bahet edhe me *simpati***.** Si me i pajtue kto dy anë të kundërta? Kjo asht mjeshtria e kritikut t'aftë"[14].

Përligjia e modelit *ose/ose* që ka zgjedhur Pipa, sa ç'është ideologjike, aq është edhe përmbushje e "simpatisë" kur ai do të përkufizojë vetveten. Pipa e simpatizon Camajn, të qe për të, ai është poeti. Aq e madhe është simpatia për Camajn sa atij i duhet të zgjedhë midis toskut dhe gegut, midis poetit dhe prozatorit, midis shkrimtarit politik dhe poetit apolitik, midis qytetarit dhe fshatarit të mërguar, midis mërgimtarit dhe shkrimtarit të regjimit. Me simpati, Pipa do t'ia gjejë vendin vetes pranë

[11] Arshi Pipa, Camaj's poetry and Poetics, në Contemporary Albanian literature, New York 1991, përthimi i M. Gjanajt teCamaj, Vepra 8, parathënia Dranja, Onufri 2010, f. 42

[12] Arshi Pipa, Camaj's poetry and Poetics, në Contemporary Albanian literature, New York 1991, f. 140

[13] Po aty, f. 30

[14] Arshi Pipa, Shpirti i kritikës, në Kritika, Princi 2006, f. 32

Camajt brenda grupimit të ngushtë: "Poezia e mërgimit", por shenjat e tendosjes në këtë pranëvënje do të shfaqen shpejt: "Poezia e Arshi Pipës u shkrua e gjitha në Shqipëri[15]" shkruan ai (atëherë pse brendashkruhet tek "Poezia e mërgimit"?) dhe më pas "Pipa u lind nga një familje qytetare, pati rastin të njohë fshatarë në burg. Paraqitja e tyre nga ana e tij është ajo e një shkrimtari qytetës, i cili ndjen SIMPATI për ta"[16]. Kundërshtuese me pranëvënien e parën del një pjesë tjetër e autoportretit të Pipës, rreshtimi me disa kolegë të tij që në kushtet e mërgimit nuk shkruan më letërsi. Kjo kundërshti e rrok fort Camajn, që letërsi shkroi vetëm në mërgim.

Modeli *ose/ose* bëhet jo funksional prej sublimimit në autoportretin e Pipës. Simpatia e subjektit kritik Pipa e sublimon njeriun politik për hir të letërsinë e kulluar që nuk e ka shkruar dot vetë. Camaj sublimohet si alteregoja e Pipës me të cilën ai do të njësohet. Poeti i poetikës së ndërmjetme, poetika e të papërkryerës së mundshme është modeli subjektiv i poetit që ai nuk u bë dot ndërsa kërkonte në fillime poezinë e kulluar me një gjuhë "qytetare" të kultivuar. Edhe kjo ëshhtë simpati prej kritiku "të aftë", subjektivitet në shkallën më të lartë.

***

Modeli *ose/ose* është themelor tek Pipa. Ai parashtron dhe zgjedh. Të njëjtën gjë i kërkon edhe lexuesit të kritikës së tij dhe të kritikës së realizmit socialist: lexuesi duhet të bëjë një zgjedhje mes *subjektit kritik* dhe *shërbëtorit politik*, mes "artit që e plotëson moralitetin me atë që i mungon"[17] dhe "moralitetit që nuk e shterron dinjitetin njerëzor"[18]. Zgjedhja është e pashmangshme sidomos me këtë paragraf nga "Letërsia shqipe bashkëkohore" ku përshkruan një nga denoncuesit apo "kritikët" e tij:

"Një nga studentët e mi në Durrës, Koço Bihiku, më rrinte para mbrapa ca kohë, duke më bërë pyetje të tilla si: "A lexoni letërsi sovietike?

[15] Po aty, f. 174

[16] Po aty, f. 174

[17] Arshi Pipa, Skicë e një konceptimi mbi jetën, Princi, Tiranë 2011, f. 76

[18] Po aty.

dhe "A e pëlqeni Majakovskin?" Mua nuk më pëlqen në mënyrë të veçantë Majakovski (i përgjigjesha). "Po Stalini ka thënë se ai është poeti më i madh sovietik" – përgjigjet studenti. "Ai mund të jetë" – kundërshtoj unë – "por jo sepse këtë e thotë Stalini. Stalini nuk është kritik letrar."[19]

Modeli *ose/ose* edhe një herë është thelbësor, modeli *edhe/edhe* i pamundur.

[19] Arshi Pipa, Contemporary albanian literature, New York 1991, f. 20

Dhurata SHEHRI, University of Tirana
ARSHI PIPA READS CONTEMPORARY LITERATURE

Summary

This paper focuses on the studies of Arshi Pipa, one of the most important authors of the Albanian critique. In broad lines, the study aims the following:

To look into the internal typology of Pipa's critique;

To examine some of the basic theses of Pipa's critique and its impact;

To examine the prevailing models in Pipa's critique;

To compare Pipa's critique written in diaspora with the "official" critique he wrote on the same matter while in Albania;

To examine Pipa's influence in building of the Albania literary "cannon."

Muhamet HAMITI, Fakulteti i Filologjisë i UP-së, Prishtinë

PAMJE E LETËRSISË SHQIPE NË STUDIMET E ARSHI PIPËS

Hyrje

Si duket harta letrare shqipe në kartografinë e Arshi Pipës? *Trilogjia Albanika* dhe *Letërsia bashkëkohore shqiptare* përbën trupin e veprës studimore letrare të Arshi Pipës (1920-1997), që trajton fenomene letrare e shkrimtarë shqiptarë, pa pretendimin për të shkruar histori të letërsisë shqipe, ndonëse në këto vepra ai përvijon (e dikund thellohet në) gjithë historinë letrare shqiptare. Perspektiva e tij për letërsinë shqipe është në pjesën më të madhe sociale, që është përkufizuesi i vëllimit të tretë të trilogjisë: *Perspektiva shoqërore*. Në pajtim me këtë edhe metoda e studimit, herë-herë bashkë me analizë teksti në rrafsh më formal(ist). Harta e tij letrare del jo e plotë, siç do të dëshmohet këtu.[1]

Pipa kishte nisur jetën e vet letrare si poet e kritik. Poezinë e shkroi në Shqipëri, një pjesë në burgjet komuniste (1946-1966), ndërsa studimet më të mira i bëri në SHBA në vitet shtatëdhjetë dhe tetëdhjetë të shekullit të kaluar. Për poezinë e tij, në kapërcim, për shkurt, më vonë.

Ndërsa punonte profesor universiteti në SHBA, kryesisht në fushën e italianistikës, Pipa botoi studime të veçanta për letërsi e fenomene kufitare, shkroi për politikat gjuhësore në Shqipëri, për stalinizmin shqiptar, përktheu në shqipe dhe nga shqipja. I njohur është përkthimi i tij i romanit *Kronikë në gur* të Ismail Kadaresë, shkrimtarit shqiptar, të cilin e

[1] Ky studim nuk merr parasysh veprën kritike rinore të Pipës (1940-1944), botuar në Shqipërinë e kohës së Luftës së Dytë Botërore, që, ndonëse jo e parëndësishme, me venerime për mungesën e kryeveprave të letërsisë shqipe e të ngjashme, jep shenja të një arrogance djaloshare.

studioi sistematikisht. Me shkrimtarin ndërtoi një relacion pëlqimi e mospëlqimi, gati si një 'love-hate relationship', në varësi të pritjeve e të projektimeve të veta për çka dhe si duhej të shkruante Kadare, si shkrimtari më i madh i periudhës së mbizotërimit të doktrinës së realizmit socialist në Shqipëri. Këto projektime çuan edhe në përfundime paradoksale për ndonjë nga veprat e tij, në mbi-interpretime e keqinterpretime.

Katër shkrimtarë studioi me themel Pipa: Jeronim De Radën, Migjenin, Kadarenë dhe Martin Camajn. Për De Radën botoi një monografi të plotë dhe e quajti nismëtarin e periudhës së romantizmit shqiptar, që e shihte me kohëzgjatje njëqindvjeçare (1836-1936); për Migjenin shkroi në rini e pleqëri, dhe e klasifikoi si shkrimtarin që me *Vargjet e lira* (1936) dhe me prozën tregimtare shkroi në frymë përmbysëse ndaj romantizmit shqiptar, duke u bërë nismëtari i letërsisë socialiste në Shqipëri; për Kadarenë si shkrimtar që nisi me kontestime të fuqishme të doktrinës së realizmit socialist, por që mbaroi, simbas tij, me konformizëm ndaj tij prej *Dimrit të madh* e tutje[2]; për Camajn, *Dranja* e të cilit është kryevepër letrare, një vepër që ka poetikën e vet, e krahasueshme me vlera, *mutatis mutandis*, me *Milosaon* e De Radës.[3] Sërish, simbas tij.

Veprat kryesore studimore letrare të Pipës trajtojnë rëndësinë e folklorit e të fshatarësisë për letërsinë shqipe, thellë në indin e saj. Botoi një studim të veçantë monografik për vargun folklorik shqiptar, duke u marrë me ndërtimin dhe gjinitë e tij. Këtë e kishte bërë si shteg për studimin e De Radës, që dha monografinë e pakapërcyeshme për autorin arbëresh.

Katër shkrimtarët që nuk shquhen në hartën e Pipës: Naimi, Fishta, Mjeda, Poradeci

Arshi Pipa Naim Frashërin e quan 'poet mediokër' në një fusnotë[4];

[2] Shkrimi i tij i gjatë për Kadarenë Subversion vs. Conformism: the Kadare Phenomenon, botuar te revista *Telos*, no. 73, 1987. Variante të tij janë botuar edhe në gjermanisht dhe frëngjisht. Në shqip ka dalë si libër më vete, Arshi Pipa, *Subversion drejt konformizmit: fenomeni Kadare*, përktheu Bardhyl Shehu, Phoenix, pa vend botimi, 1999.

[3] Arshi Pipa, *Albanian Contemporary Literature*, East European Monographs, Boulder, distributed by Columbia University Press, New York, f.161.

[4] Arshi Pipa, *Albanian Literature: Social Perspectives*, Dr. Dr. Rudolf Trofenik, München,

Gjergj Fishta çmohet për këngët e para të *Lahutës së Malcís* (poema filloi si poemë epike e vërtetë, ndërsa përfundon në një groteskë fjalëshumë[5], thotë ai); për Mjedën shkruan në një fusnotë, ku e quan "poeti lirik më i shquar gegë"[6] (në një zë enciklopedik i quan sonetet e tij model të zhanrit)[7]*;* për Lasgushin flet si për një shkrimtar të madh tosk[8], për të thënë dikund tjetër: "Poradeci, një poet i vërtetë lirik, e humbi damarin e tij, i joshur nga lajkat e admiruesve që shihnin tek ai një homolog/ekuivalent tosk ortodoks të Fishtës. Ai shkroi vetëm pastishe të poezive të veta pas *Valljes së Yjeve*, vepër e tij rinore.[9]

Pipa konstaton se Poradeci kishte shkruar poezi te *Vallja e Yjeve* në të cilat "ndjenja e tij për natyrën herë-herë mbërrin tone transcendentale. Muzika e braktisjes dhe melankonia e Poradecit kanë sharm", për të shtuar se, mbasi poezia e tij nuk rri në skemat e realizmit socialist, ai bëri punë të mençur që e la shkrimin, për të punuar herëmbashere në përkthime. (Përkthimi i tij i *Eugjen Onjeginit* të Pushkinit është art i përsosur.")[10]

Shkrimtarët bashkëkohorë në fokus të Pipës

Vepra e fundit e madhe studimore e Arshi Pipës, *Contemporary Albanian Literature* (*Letërsia bashkëkohore shqiptare*, 1991) mbizotërohet nga studimet e përimtuara për Ismail Kadarenë dhe Martin Camajn, mbas

1978, f. 169; në përkthimin shqip, *Letërsia shqipe: Pespektiva shoqërore*, f.153.

[5] Po aty, anglisht, f. 119, shqip, f. 109.

[6] Po aty, anglisht, f. 121, shqip, f. 112.

[7] *The New Princeton Encyclopedia of Poetry and Poetics*, edited by Alex Preminger and T.V.F. Brogan, Princeton University Press, 1993, f. 27.

[8] *Albanian Literature: Social Perspectives*, f. 124. Në botimin shqip, *Letërsia shqipe: Perspektiva shoqërore*, f. 112.

[9] Po aty, anglisht, f. 198, shqip, f. 180. Përkthimi shqip i këtij karakterizimi përmbledhës është i keq. Pipa flet për Poradecin si "homolog tosk ortodoks të Fishtës" (angl. Tosk Orthodox counterpart of Fishta), cilido që të jetë kuptimi i këtij përkufizimi të çuditshëm, dhe jo si "një kundërvënie ortodokse ndaj Fishtës". Poashtu, fraza "çorbulina poemash" për "pastiches of his own poems" është i pasaktë në përkthimin e Myftar Gjanës.

[10] Arshi Pipa, *Contemporary Albanian Literature*, f. 24.

një studimi hyrës, shumë të mirë, për gjenezën e realizmit socialist si teori e praktikë, si dogmë, në Bashkimin Sovjetik, dhe për shartimin e tij në Shqipëri. Në fillimet e jetës letrare të pasluftës në Shqipëri, Pipa ishte edhe vetë protagonist, duke qenë anëtar i redaksisë së gazetës *Bota e re*, organ i Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptarë. (I vetmi anëtar tjetër jokomunist i kësaj redaksie ishte Mitrush Kuteli, siç dëshmon Pipa). Shkrimtari shqiptar pas "çlirimit" o do të pranonte linjën e Partisë njëqindpërqind o do të përfundonte në burg, thotë Pipa, në pjesën ku flet për fatin e vet.[11] Mbasi nuk ishte i prirur për të parën, veneron ai, "qeshë me fat që u burgosa në kohën kur ndjekja e shtrigave kundër intelektualëve mospajtues ende nuk kishte marrë shpejtësinë e plotë". Herën e parë u dënua me dy vjet, me izolim. Herën e dytë, në një gjyq që zgjati nja 15 minuta, për aktivitete "kundërrevolucionare" u dënua me njëzet vjet, që iu kthye në dënim prej dhjetë vjetësh përmes një amnestie. Lau burg dhe kamp pune të detyruar[12], para se të ikte në Jugosllavi, e pastaj të emigronte në SHBA, ku jetoi dhe punoi deri në fund të jetës, më 1997.

Jo Migjeni por Noli mund të konsiderohet pararendës i realizmit socialist shqiptar, thotë Pipa, konstatim që e nxjerr nga esetë e tij (introduktat) që u paraprijnë përkthimeve të Shekspirit, Kajamit, Servantesit e Ibzenit. Me këto ai inauguroi një sociologji të letërsisë, ndonëse Noli i quante "analiza kritike", në esencë me karakter politik, mbasi ai nuk rrokej me elemente formale të gjuhës e stilit, me syzheun e dialogun, me gjedhet narrative dhe teknikat e vargënimit, veneron Pipa.[13]

Për "zbulesën Kadare" (një studim të gjatë, botuar më 1987 te revista *Telos* e quante 'Fenomeni Kadare') flet Pipa në libër mbasi që ka përvijuar 20 e më shumë vjet të letërsisë shqipe të pasluftës së Dytë, duke kërkuar, duke matur e çmatur, normën dhe rravgimet prej saj, shpeshherë me dëshirën për t'i parë këto të fundit edhe ku s'kishte. I mat ato edhe me *Historinë e Letërsisë Shqiptare të Realizmit Socialist* (1978), har-

[11] *Contemporary Albanian Literature*, f.21.

[12] Po aty, f. 21.

[13] *Albanian Contemporary Literature*, f. 13-14.

tuar nën drejtimin e Koço Bihikut, që paradoksalisht e bën pikë reference në studimin e vet.

Pipa e shqyrton letërsinë shqipe të viteve gjashtëdhjetë në sfond të revolucionit kulturor shqiptar, në kulmin e të cilit ishte shkruar romani *Dasma* (1967) i Kadaresë. Shkrimtari, një personazh, këtu bëhet zëdhënës i autorit, Kadaresë, përbuzja e të cilit për realizmin socialist është e përhapur, konstaton Pipa, mbasi shenjon simbolet në vepër (treni – Partishtet, lokomotiva – Partia, konduktori – diktatori, kontrolluesit – policia).[14]

"*Dasma* nuk është roman i mirë, madje as nuk është roman, por thjesht një shkërbim romani përmes të cilit autori kishte nxjerrë vnerin e vet; romani ishte e kundërta e plotë e asaj që mburrte *Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist*", thekson Pipa, për të bërë konstatimin skandaloz: *"(Dasma)* është manifesti shqiptar i anti-realizmit socialist"[15]. *Dasma* prej kritikës shqiptare dhe të huaj është parë si vepra më real-socialiste e tij. Vetë Kadare e kishte thënë jo një herë se te *Dasma* i ishte nënshtruar dogmës së realizmit socialist.[16]

Në klasifikimin e Pipës *Kështjella* (1970) është parodi e romanit historik dhe jo roman historik.[17] Duke analizuar *Kronikën në gur* (1971), romanin autobiografik, studiuesi e sheh fëmijën (narrator) jo bindës si karakter, sepse horizonti i tij mendor e tejkalon mentalitetin e një fëmije dhjetëvjeçar. *Kronika* është pikësëpari roman politik, heretik në frymëzim, përfundon ai.

---

[14] *Albanian Contemporary Literature*, f.49-51.

[15] Po aty, f. 54. Kjo vepër (*Dasma*) e "bën Kadarenë Jevtushenkon shqiptar dhe më shumë, dhe kjo shpjegon pse ai është i vetmi ndër të gjithë shkrimtarët e tjerë bashkëkohorë në Shqipëri, veprat e të cilit janë përkthyer në gjuhët e tjera europiane, posaçërisht në frengjisht. E megjithatë ky roman nuk është përkthyer, dhe jo vetëm pse është shumë vështirë të përkthehen nuancat e gjuhës së tij rrëshqitëse", thotë Pipa më tej në këtë faqe. Në të vërtetë *Dasma* ishte perkthyer herët në anglisht nga Ali Cungu, botuar në Tiranë nga Shtëpia Botuese Naim Frashëri, më 1968! (Shih librin e Peter Morgan-it për Kadarenë, shënimet në fusnotën 154, f. 114.)

[16] Peter Morgan, *Ismail Kadare: The Writer and the Dictatorship 1957-1990*, The Centre for Albanian Studies, London, Via Egnatia, Tirana, 2013, f. 106.

[17] *Albanian Contemporary Literature*, f. 55.

Në fund të kësaj pjese, Pipa e quan Kadarenë shkrimtar heretik (”heretiku është konsistent në kundërshtimin e tij, ka një linjë veprimi dhe një strategji të sjelljes që buron prej parimesh”), një kategorizim lavdi.[18] Pyetjes së vet retorike se a është Kadare fare socialist, i përgjigjet studiuesi me një: dyshoj. “Por jam i sigurtë se nuk është stalinist. Atëherë si bëhet që ai gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit [deri në vitin 1991, kur është botuar vepra e Pipës, MH] ai është bërë ambasador shëtitës i stalinizmit shqiptar duke qenë në të njëjtën kohë varrmihës i realizmit socialist? Paradokse si ky ngjajnë zakonisht në shoqëri joplotësisht të zhvilluara me sisteme jodemokratike…”, vetëpërgjigjet Pipa.[19]

Te *Dimri i madh* studiuesi Pipa sheh “një zhvendosje nga qëndrimi negativ i autorit ndaj ideologjisë së Partisë”, siç del nga shqyrtimi i romaneve të mëhershme.[20] Kadare u bë panegjiristi i Hoxhës me këtë vepër të madhe në rrafsh të invencionit teknik, diçka që mund ta “vlerësojnë vetëm lexuesit profesionalë dhe kritikët letrarë”, thotë Pipa, për të konstatuar: “*romani është në thelb negativ nga një pikëshikim politik* (nëntizimi im, MH), sepse mund të kooptohet, siç ka ndodhur, nga regjimi shtypës për qëllimet e veta”.[21] Pipa madje e akuzon Kadarenë për sllavofobi në këtë roman. ”Është ngulitur te Kadareja besimi romantik se shqiptarët janë racë superiore”.[22]

Vitet 1978-1985 në letërsi shqipe, Pipa i sheh si periudhë stagnimi. *Pashallëqet ë mëdha* është një roman tjetër parodi e romanit historik, simbas tij; romanet *Ura me tri harqe* dhe *Prilli i thyer* janë shkruar “kryesisht për publik lexues të huaj”; ky i dyti është ndoshta romani më i keq që ka shkruar Kadare ndonjëherë, përfundon kritiku.[23] Në lidhje me *Dosjen H*, Pipa kritikon Kadarenë për qëndrimin se rapsoditë janë të malësorëve,

[18] Po aty, f. 65.
[19] Po aty, f. 66.
[20] Po aty, f. 79.
[21] Po aty, f. 86.
[22] Po aty, f. 87.
[23] Po aty, f. 89, 92-93.

ndërsa e ”vërteta është se rapsoditë origjinën e kanë në Bosnjë”.[24]

Koncert në fund të dimrit (1985) është romani i fundit i Kadaresë që analizon Pipa te *Letërsia bashkëkohore shqiptare*. “Shkrimtari i madh është bërë një kalemxhi” (“The great writer has become a scribbler”, në origjinalin anglisht) qorton Pipa me një gjuhë të prerë. “Me këtë roman të fundit, burimi i talentit të Kadaresë është derdhur në një kënetë të ngrirë”, vazhdon kritikën e fortë ai, mbasi kishte konstatuar se teksa te *Dimri i madh* Kadare herë e mbron herë e përbuz regjimin, te *Koncerti* ai “përqafon politikat e regjimit pa rezervë.” Me këtë vepër, “Kadareja e ka bërë veten zëdhënës kryesor të stalinizmit shqiptar”, akuzon ai.[25]

Më tej Pipa, në këtë frymë akuze, e quan Kadarenë ‘udhëheqës shpirtëror’ të shkrimtarëve shqiptarë që “e shpallën Enver Hoxhën shkrimtar të madh shqiptar”.[26]

Ka pasur edhe kundërakuza nga Kadare për Pipën, te *Ftesa në studio*. Paqen e ka rivendosur Kadare së voni, me një pendesë.[27]

Pa u kthyer te tema e mbi-interpretimeve dhe keqinterpretimeve, si në rastin e analizës së *Kronikës në gur* – Kadare nuk e denoncon terrorin komunist, as nuk aludon te homoseksualizmi i pandehur i Hoxhës – mund

---

[24] Po aty, f. 94.

[25] Po aty, fq, 107.

[26] Po aty, f. 119.

[27] Në një libër të gazetares Aida Tuci, me titull *Një enigmë me disa të panjohura, rreth dosjes Bilal Xhaferri*, Shtëpia Botuese Onufri, 2014. Nga intervista me Kadarenë për këtë libër, që gjendet online në këtë vegëz http://www.fjalaelire.com/mobile/opinione/22556.html: Kadare: “Që kolegu i vet të kishte sa më shumë sukses në botën e lirë perëndimore, Arshi Pipa, shpesh e ka zmadhuar guximin letrar të I. K. Kjo ka ndodhur me parathënien e romanit “Kronikë në gur” në anglisht, parathënie që duket sikur ishte në zanafillë të incidentit fatkeq. Atje, autori i “Kronikës” del një denoncues i pamëshirshëm i terrorit komunist dhe sidomos i shefit të komunistëve shqiptarë, E. Hoxhës, gjë që nuk i përgjigjej së vërtetës. (Tani do të më pëlqente të ishte ashtu, por dihej se, edhe po të doja, kjo ishte e pamundur.) Botuesi anglez e refuzoi parathënien, për të mos e rrezikuar autorin që jetonte ende nën diktaturë. Kontrata u prish. “Kronikë në gur” u botua pa emrin e përkthyesit.”

Në po këtë intervistë, Kadare mohon interpretimet e Pipës se te *Kronikë në gur* ai kishte damkosur diktatorin Hoxha si homoseksual. (MH)

të thuhet se analiza politike (me tezë, do të mund të thuhej) e Pipës e çon kritikun në përfundime të çuditshme për veprën e shkrimtarit. Si bëhet që *Prilli i thyer* e jo *Dasma* të jetë romani më i keq i Kadaresë? Si bëhet që *Koncerti në fund të dimrit* të jetë roman i një "kalemxhiu" (scribbler), një roman "mediokër"?[28] Te periudha e 'stagnimit' Pipa nuk e shquan romanin distopik, Pallati i ëndrrave, ndoshta romani më i mirë pas Kronikës?

***Dranja*, kryevepra e Martin Camajt**

Pjesa II e veprës së Arshi Pipës, *Contemporary Albanian Literature* i kushtohet tërësisht shkrimtarit Martin Camaj. Pjesa titullohet "Poezia dhe poetika e Camajt".[29]

Mbasi bën jetëshkrimin e Camajt dhe përvijon punën e tij letrare e studimore në Jugosllavi, Itali e Gjermani, Pipa analizon poezinë e tij, me fokus të veçantë në veprën poetike *Dranja*, madrigalet e tij, që janë shkruar në prozë, më saktë në prozë poetike, një zhanër hibrid. Kondensimi i kuptimit në njësi minimale semantike postulon një poetikë shpërthyese, konstaton Pipa në krye të studimit për këtë vepër, madrigali i parë i së cilës ("Si doli emni prej gurit") shërben si prolog i kësaj poetike.[30] Qëndrimin e vet anti-heroik Camaj e thekson me zgjedhjen e një rrëshqanori (breshkë) si emblemë të vetes së tij poetike.[31] Fuqinë e poezisë së tij e sheh te madrigali me titull "Fis i panjoftun", analiza e të cilit e çon Pipën në konstatimin se gjuha e *Dranjes* nuk shpërfaq defektet e poezisë së tij të mëhershme:

Këtu gjuha ilustron një poetikë. Të krijohet përshtypja se je goditur nga një shpërthim gjuhe, dhuna e së cilës shtrembëron, pjesërisht, përmbajtjen e saj. Është sikur një burim i stërmadh i fuqisë shprehëse, i varrosur për një kohë të gjatë në thellësi, të shpërthejë papritmas në një

[28] *Contemporary Albanian Literature*, f. 109.

[29] I përkthyer në shqip nga Myftar Gjana, studimi me titull Dranja botohet te Martin Camaj, *Dranja*, përgatitur nga Prof. Dr. Bardhyl Demiraj, Onufri, 2012, 13-40.

[30] *Contemporary Albanian Literature*, f. 142.

[31] Po aty, f. 143.

lumnajë fjalësh, duke sjellë me vete elemente të papastra. Për shkak të afshit të tij, poeti nuk mund ta kontrollojë gjuhën e vet. Dhe ndoshta nuk do ta kontrollojë atë, nga frika se duke bërë kështu ai do të bllokojë burimin. Dhe kështu del se një poetikë shpërthyese vjen e bëhet një poetikë e të pakryerës, në përputhje të plotë më natyrën "e papërsosur" të *persona poetica* të veprës.[32]

Madrigali i fundit, "Dhe e shtina në strajcë", është epitafi i Dranjes. Për mendimin e Pipës, një nënzhanër mesjetar i lirikës erotike, madrigali, është medium artistik i duhur për të dëftuar idilin rinor të poetit në fshatin e tij të lindjes në Dukagjin në kohën kur Kanuni i Lekë Dukagjinit, kodi mesjetar, ishte ende gjallë aty.[33] Poetika e veprës *Dranja* është poetikë e të pambaruarës, konstaton Pipa, me vlerësimin se letërsia shqipe është më e pasur dhe më e gjerë me *Dranjen*.

Përpjekjet e mëhershme të Camajt për një poetikë kishin dalë të pasuksesshme, ndër të tjera dhe për arsye se njohja që kishte Camaj për "teknikat moderniste ishte sipërfaqësore, kufizuar vetëm në leximet e poetëve hermetikë; posaçërisht të Ungaretit, por jo të Montales", ky i dyti poet më origjinal.[34] Gjuha e Camajt është dialekt geg, përkundër huazimeve të tij leksikore e gramatikore toske, veneron Pipa, për të konstatuar:

Megjithëse një gjuhëtar nga profesioni, Camaj nuk ka pasur parasysh pikëpamjen e rëndësishme se gjuha shqipe është tash për tash e keqpajisur për të mbështetur orvatjet aventurore në poezinë moderniste. Askush nuk mund të fluturojë me krahë të ngjitur prej dylli.[35] (Përkthyesi e

---

[32] Arshi Pipa, Dranja, in Martin Camaj, *Dranja*, Onufri, 2012, f. 20. Ky është paragrafi i parë i madrigalit "Fis i panjoftun", që, simbas Pipës, mbulon si me shpejtësi drite dy mileniume të historisë iliro-shqiptare: Ka rrashtën e Dranjes simbol dhe rri pranë trojeve të rrënueme prore mbanesh. Këqyri si ngriten në bulshane qyteza, anfiteatra e tempuj me gurë të nxjerrun nën kambët e tyne. Nalt në brija u kënaq ai fis tue kundrue dritën e anijeve si digjen e përvlohen në ranë. Dhe kur u rrëzuen kështjella e pyrgje u sprap për të mos i ra kambëve gungoret e mureve në rrënim. (*Dranja*, Onufri, 2012, f. 58)

[33] *Contemporary Albanian Literature*, f.160.

[34] Po aty, f. 162-163.

[35] Arshi Pipa, Dranja, in, Martin Camaj, *Dranja*, Onufri, 2012, f. 39. Në origjinalin anglisht,

ka përkthyer 'the all-important point', si 'pikëpamjen e rëndësishme'; do të mund të përkthehej edhe si 'faktin fort të rëndësishëm'. E kujt është pikëpamja? Prej nga fakti? Sigurisht pikëpamja dhe/apo fakti janë të Pipës. Por argumentin e ka të dobët. Thjesht pret që ta marrim të mirë-qenë vlerësimin e tij apodiktik; MH)

Lavdi në mbarim për *Dranjen* ka edhe këto përfundime të Pipës:

Camaj ka pasur sukses me veprën *Dranja*, sepse ai ka mësuar më së fundi mësimin e kafshës së tij emblematike: të ecë "në naltësinë e shpu-tës së kambës së vet", në një "vijë të drejtë", "pa u përdredhë si gjarpën". Ky është mësim i *thjeshtësisë*, apo i *përvujtnisë* në kuptimin e ndershmë-risë, siç përdorej nga *stilnovisti* italian. Ka pasur sukses, sepse ai ka shman-gur fluturimet e "Pegazit smirëzez", "që vjen erë djersë", dhe ka adoptuar breshkën si kafshën e tij emblematike, rrashtën e saj si mburojën e vet, me një *kullë* të skalitur aty, shtëpinë e fortifikuar të malësorëve,(...) për të zhvilluar një virtyt të domosdoshmërisë, ka guxuar të sfidojë poetikën e të përkryerës, karakteristikë e poezisë së mësuar, me poetikën e të pa-kryerës, karakteristikë e poezisë gojore.[36]

Zgjedhja që bën Camaj përmbys poetikën elitiste, simbas Pipës; ngërthen një poetikë antiheroike, formulon një "politikë demokratike të gjuhës dhe një politikë demokratike *tout court*".[37]

Çka don të thotë ky konstatim i fundit? Pse poetika elitiste të jetë jodemokratike? Më duket se Pipa këtu afishonte edhe orientimin e vet, që del i majtë, nëse duam ta deduktojmë politikën e tij. Në të vërtetë, në gjithë veprën e vet ai godet fort stalinizmin, sidomos variantin hoxhist. Ishte jokomunist vetë, por a ishte antikomunist? Më duket jo. Jo se duhej të ishte domosdo antikomunist, përkundër faktit se vuajti pasojat e një regjimi të egër komunist. *Librin e Burgut* (1958) ua kushton "dëshmorëve të kombit qi ranë kundër komunizmit".

---

te *Contemporary Albanian Literature*, f. 163.

[36] Arshi Pipa, Dranja, in Martin Camaj, *Dranja*, Onufri, 2012, f. 39. Në origjinalin anglisht, te *Contemporary Albanian Literature*, f. 163.

[37] Po aty, f. 40. Në origjinalin anglisht, f. 164.

Shkrimtarët dhe raca/ racizmi

Kujtojmë intensitetin me të cilin Pipa akuzonte Fishtën për antisllavizëm në një pjesë të *Lahutës*, Kadarenë për antisllavizëm më shumë se një herë.

Pipa i mëshon fort argumentit për origjinën sllave të Migjenit dhe për ndikimin e kësaj në gjuhën e varfër shqipe të letërsisë së tij. Po ashtu edhe argumentit për amëzën sllave të emrit Milosao, të protagonistit të kryeveprës së De Radës. S'jam i sigurt që dalin me rezultate këto pandehma për kuptimin e veprës së autorëve tanë, dhe të të përzgjedhurve të tij për studime të thelluara. Po ashtu edhe argumenti për origjinën sllave të rapsodive veriake. I çuditshëm dhe i paargumentuar mendimi i tij se "pushtimi i gadishullit të Ballkanit nga popujt sllavë parandaloi që shqipja të bëhej gjuhë romane."[38]

Në këtë kontekst, diçka për poezinë e tij. Vetë Arshi Pipa ka shkruar një poemë narrative gjatë kohës së burgimit të tij në Shqipërinë komuniste. Një tregim alla Romeo dhe Xhulieta [këtu Rusha shqiptare dhe Melisdravi serb, MH], *Rusha*, del një sprovë letrare për kalim kohe më shumë sesa një poezi për të qenë. Ja çka thotë vetë Pipa për natyrën e kësaj poeme:

Rusha âsht nji poemë tregimtare mbi marrëdhâniet mes Shqiptarëvet dhe Serbëvet në gjysmën e dytë të shekullit XIV në Kosovën e atëhershme.[39] Thelbi i tregimit janë doket dhe zakonet e malcorëvet të Veriut ashtu si formulohen te Kanuni i Lekë Dukagjinit, në nji gjuhë qi âsht nji shkodranishte e pasunueme me fjalë dhe frazeologji të nëndialekteve gegënishte.[40]

Mbasandej, mbasi "thurja e ksáj poeme ká ngjyrim historik", siç e

[38] Arshi Pipa, *Albanian Literature: Social Perspectives*, f. 131. Në shqip, *Letërsia shqipe: Pespektiva shoqërore*,f. 119.

[39] Ngjarja ndodh në një fshat diku në mes Gjakovës dhe Prizrenit, thotë Pipa te *Albanian Literature: Social Perspectives*, f. 193.

[40] Arshi Pipa, Parathânie, në *Poezi*, Pejë, 1998, f. 165.

thotë autori, ai jep venerimet për historinë mesjetare për ta lehtësuar kuptimin e kësaj poeme. Mbas shkërmoqjes së Mbretërisë së Car Dushanit, te ambiguiteti fetar (ortodoksi, katolicizëm) ai postulon një aspekt të "symbiozës etnike mes dy kombevet, dokumentue nga historiani kroat Milan Sufflay në veprën e vet, *Shqiptarët dhe Serbët*."[41] Simbiozë etnike shqiptaro-sllave?!

Teksa flet për gjuhën e kësaj "poeme kosovare" në "Post Scriptum" të poemës, Pipa thotë se kjo është shkodranishte me rrënjë të gegnishtes së një prelati katolik, Pjetër Bogdanit, "kosovarçja e të cilit âsht zbutë nga elementa gramatikorë dhe leksikalë shkodranë, tue përfshî dialektet e hinterlandit të Shkodrës."

Më tej, aty, "mbasi toponimia e cyklit shqip (kreshnik) âsht po ajo e cyklit boshnjak, ká gjasë qi vargu kreshnik shqip të jetë natyralizue i tillë në nji periudhë kohe relativisht të vonë, kúr nji symbiozë kulturore boshnjako-shqiptare ishte realizue, nxitun e përkrahun nga politika antisllave austro-hungare. Ndryshimet janë mâ të forta në planin ideologjik: kreshnikët boshnjakë janë feudalë myslimanë proturq, kurse kreshnikët shqiptarë janë barij katholikë antisllavë."[42]

Letërsia e Kosovës: jashtë hartës letrare të Pipës

Për letërsinë shqipe të Kosovës të viteve shtatëdhjetë-tetëdhjetë të shekullit XX, Pipa jep një vlerësim negativ *a priori* në Parathënien e veprës *Letërsia bashkëkohore shqiptare.*

...Në Jugosllavi, ku jetojnë më shumë se dy milionë shqiptarë, një letërsi në gjuhën shqipe lulëzoi mbas Luftës së Dytë Botërore në "krahinën autonome të Kosovës", duke konkurruar me letërsinë e realizmit socialist në shtetin amë dhe duke dhënë, falë klimës më liberale në Jugosllavi, disa vepra të shquara. Mbasi që shqiptarët në Jugosllavi janë në pjesën dërmuese gegë, kjo letërsi kosovare ishte në atë dialekt, në vazhdën e

[41] Po aty, Arshi Pipa, Parathânie, f. 165.

[42] Në Arshi Pipa, Post Scriptum në *Poezi*, Pejë, f. 227.

traditës që kishte ngritur në shekullin e shtatëmbëdhjetë një erudit eminent kosovar, Pjetër Bogdani. Kjo traditë u ndërpre në vitin 1968, kur kosovarët pranuan gjuhën zyrtare të Shqipërisë së sotme, që është variant i toskërishtes. Për shkak të dallimeve të rëndësishme dialektore ndërmjet gegërishtes dhe toskërishtes, shkrimtarët kosovarë në toskërishte kishin vështirësi të shpreheshin në mënyrë të duhur. Letërsia e tyre pësoi rënie, dhe nuk është përmirësuar mbas dy dekadash të eksperimentimit të kotë. Gjëja më e dhimbshme është se ndryshimi është bërë për arsye "ideopolitike". Udhëheqësia staliniste e Kosovës kishte menduar se duke pranuar reformën gjuhësore të Shqipërisë staliniste të frymëzuar nga Stalini do t'u jepte atyre leva për t'i bërë presion qeverisë jugosllave t'i jepte Kosovës statusin e Republikës. Ky hap iu kthye bumerang. Qeveria jugosllave e interpretoi vendimin si hap të parë drejt shkëputjes së Kosovës nga Jugosllavia federale, aq më shumë që pranimi i gjuhës zyrtare të Tiranës u shoqërua me adoptimin/pranimin e flamurit të Tiranës. Duke pasë identifikuar veten kështu me Shqipërinë staliniste, si atëherë ashtu edhe tash armik ideologjik për vdekje i Jugosllavisë titiste, veprimtarët kosovarë, të damkosur si irredentistë dhe separatistë, janë përndjekur prej atëherë.

Para ndërrimit të mediumit letrar, i kisha kushtuar vëmendje letërsisë kosovare në shkrime të ndryshme. E lashë këtë punë pastaj për arsyet që u përmendën më lart. (Foreword, fq. vi; përkthimi im, MH)

"Barka kosovare sharroi në dhé" mbas pranimit prej tyre të "gjuhës së unisuar letrare", shkruante Pipa në një zë enciklopedik të botuar në vitin 1993.[43]

Shpërnjohja kaq brutale e letërsisë shqipe të Kosovës nuk i ka shërbyer korpusit të studimeve letrare të Pipës. Në tridhjetë vjet (1960-1990) kjo letërsi ka nxjerrë poetë e poezi të klasit të parë, por edhe studime letrare për letërsinë shqipe të traditës e moderne, që kanë vendin në hartën letrare shqipe. Sidomos kritika letrare e prodhuar në Kosovë, në kohën e rrëgjimit të kritikës letrare në Shqipëri për shkak të mbizotërimit të doktri-

[43] *The New Princeton Encyclopedia of Poetry and Poetics*, edited by Alex Preminger and T.V.F. Brogan, Princeton University Press, 1993, f. 27-28.

nës së realizmit socialist, do t'i jepte Pipës, dhe i jep kujtdo që e merr parasysh, një perspektivë tjetërfare për mbarë letërsinë shqipe.

Përfundime

Arshi Pipa si kritik letrar ka krijuar vepër me rëndësi për dijen letrare te ne, ndonëse pjesa dërmuese e saj është shkruar në zanafillë në anglisht dhe nuk ka qarkulluar në kohë me tokën letrare shqiptare, duke u pasë përkthyer së voni në shqip. Harta e tij letrare shqipe ka mungesa, jo vetëm nga letërsia e Kosovës. Me dije letrare klasike e moderne, megjithatë, studiuesi më i mirë letrar shqiptar jashtë vendit në dekadat e mbrama të shekullit XX.

Bibliografi

Pipa, Arshi, *Poezi*, përgatiti Rexhep Ismajli, Dukagjini, Pejë, 1998

Pipa, Arshi, *Subversion drejt konformizmit: fenomeni Kadare*, përktheu Bardhyl Shehu, Phoenix, pa vend botimi, 1999

Pipa, Arshi, *Vargu folklorik shqip: Ndërtimi dhe gjinitë*, përktheu nga origjinali anglisht Primo Shllaku, Botimet Princi, Tiranë, 2013

Pipa, Arshi, *Jeronim De Rada*, përktheu nga origjinali anglisht Abdyrrahim Myftiu,

Pipa, Arshi, *Letërsia shqipe: Perspektiva shoqërore*, përktheu nga origjinali anglisht Myftar Gjana, Botimet Princi, Tiranë, 2013

Pipa, Arshi, *Albanian Literature: Social Perspectives*, Dr. Dr. Rudolf Trofenik, München, 1978

Pipa, Arshi, *Albanian Folk Verse: Structure and Genre*, Dr. Dr. Rudolf Trofenik, München, 1978

Pipa, Arshi, *Hieronymus De Rada*, Dr. Dr. Rudolf Trofenik, München, 1978

Morgan, Peter, *Ismail Kadare: The Writer and the Dictatorship 1957-1990*, The Centre for Albanian Studies, London, Via Egnatia, Tirana, 2013

The New Princeton Encyclopedia of Poetry and Poetics, edited by Alex Preminger and T.V.F. Brogan, Princeton University Press, 1993,

Muhamet HAMITI, Philological Faculty of PU, Prishtina

REPRESENTATION OF ALBANIAN LITERATURE IN ARSHI PIPA'S SCHOLARSHIP

Summary

The paper maps out the Albanian literary estate through the lens of the literary scholarship of Arshi Pipa (1920-1997), a man of letters who, after a brief but stellar literary career in Albania of the 1940s, in the run-up to Communist take-over, spent ten years in jail, before emigrating to the US at the end of the 1950s, settling there as a professor of Italian literature.

Arshi Pipa produced the body of Albanian literary scholarship under consideration in the 1970s and 1980s, published in his three-volume set *Albanica* (*Albanian Folk Verse: Structure and Genre; Hieronymus De Rada; Albanian Literature: Social Perspectives*) in München, 1978, as well as his final*, Contemporary Albanian Literature*, in the US in 1991.

While Pipa's stated aim was not to compose a history of Albanian literature or produce anything resembling a panoptic view of his national literature, the body of his scholarship is comprehensive enough to lend itself to an exercise in deducing a map of Albanian literature à la Pipa. It is a map wanting and incomplete certainly, as a close examination of his scholarship demonstrates, but interesting nevertheless.

Arshi Pipa examined four 19th and 20th century Albanian writers thoroughly and steadily: Hieronymus De Rada (Jeronim De Rada), Millosh Gjergj Nikolla (universally known as Migjeni), Ismail Kadare and Martin Camaj. While De Rada launched Albanian Romanticism, Migjeni brought it to an end a 100 years later in 1936, in Pipa's view; Kadare and Camaj are treated as the giant counterparts of contemporary Albanian literature.

The four great Albanian writers of the past two centuries who do not loom large in Pipa's Albanian literary picture are Naim Frashëri, Gjergj Fishta, Ndre Mjeda, and Lasgush Poradeci.

The body of Pipa's *Contemporary Albanian Literature* focuses on Ismail Kadare and Martin Camaj, the major representatives of Albanian literature produced in Communist Albania (the former), and in the Diaspora (the latter), after a useful introductory piece on the genesis of Socialist Realism in Soviet Russia and its application in Albania. Fan S. Noli (with his introductory pieces to his own translations of Shakespeare, Cervantes, Ibsen, etc.) and not Migjeni is postulated as the predecessor of Albanian Socialist Realism.

On the 'Kadare revelation' Pipa writes after having outlined two decades of Albanian literature under the aegis of Socialist Realism. He exhibits a kind of 'love and hate' relationship with Ismail Kadare, here lauding him for his 'heretic' writing, there blasting him as 'the roving ambassador' of Albanian Stalinism of the Hoxha type! (Seen through Pipa's lens, *The Wedding*, a schematic novel of the 1960s, is better and more anti-Socialist Realism dogma than Kadare's *The Concert at the End of Winter* of the mid eighties).

Arshi Pipa sings the highest praise to Martin Camaj's collections of poetic prose madrigals, *Dranja*, attributing a 'poetics' to the northern Albanian émigré writer who lived and worked as an academic in Germany, after having fled Communist Albania.

Arshi Pipa had an *a priori* negative take on the Kosovar Albanian literature of the 1970s and 1980s, on account of the Kosovar writers having adopted the Standard Albanian rooted largely in the southern Tosk dialect. Albanian literature in Kosovo produced some top poets and literary scholars, which Pipa's literary map nevertheless does not feature.

The paper states in conclusion that Arshi Pipa contributed considerably to the Albanian literary scholarship, although he wrote his studies originally in English, and most of them were not available in Albanian until fairly recently. While his Albanian literary map looks patchy, with notable omissions in the case of some writers/phenomena, and the Kosovar literature largely, invested with a classical learning and a modern sensibility, Arshi Pipa was the top émigré Albanian literary scholar of the late 20th century.

Zymer Ujkan NEZIRI, Instituti Albanologjik, Prishtinë

KONTRIBUTI I STUDIUESEVE AMERIKANË M. PERI E A. LORD PËR EPIKËN GOJORE SHQIPTARE

1. Fillet e epikës gojore në Harvard

Frensis Xhejms Çajlld (Francis James Child), profesor i Retorikës e i Oratorisë, nxënës i Jakob (Jacob) dhe i Vilhelm Grimit (Wilhelm Grimm) në Universitetin e Berlinit, konsiderohet filluesi i studimeve të folklorit në Harvard, nga viti 1856, kurse brezin e dytë të studiuesve në atë shekull e përfaqëson Xhorxh Llajman Kitrexh (George Lyman Kitredge), profesor, formulues i parimeve të para të Teorisë gojore. (Neziri, 2006:71). Millmen Peri[490] përfaqëson brezin e tretë, kur fillon interesimi për epikën gojore shqiptare. Pasardhësi i A. Lordit[491], Dejvid Bajnam (David Bynum) thotë se

[490] Milman Parry (20.6.1902-3.12.1935). Profesor i Universitetit të Harvardit. Ka kryer studimet në Universitetin e Kalifornisë, Berkeley, dhe ka doktoruar në Sorbonë, te profesori Antoine Meillet. Pasi u kthye në SHBA, nga specializimi në Europë, më 1928, një vit dha mësim në Ajovë (University Drake, Iowa), kurse në Harvard filloi punën më 1929. Sudiuesi D. Bajnam (D. Bynym) thotë se Peri, edhe pse ishte klasicist me profesion, kishte dëshirë ta quante veten "letrar antropologjist". Mendonte se *Iliada* dhe *Odisea* nuk ishin letërsi origjinale, por prodhime të traditës gojore arkaike greke, që ishte më e vjetra ndër letërsitë e shkruara në Europë, prandaj shkoi për ta testuar këtë teori në Jugosllavi, më 1933. Vepra: *The Making of Homeric Verse: The Collected Papers of Milman Parry*, edited by Adam Parry, his son (Oxford University Press, 1971). Më gjerësisht, shih: David E. Bynum, *Child's Legacy Enlarged: Oral Literary Studies at Harvard, Since 1856,* General editor Albert B. Lord, Publications of the Milman Parry Collection, Documentation and Planing Series, number two, Harvard Library Bulletin, Volume XXII, Number 3, Center for the Study of Oral Literature,Cambridge, Massachusetts, 1974.

[491] Albert Bates Lord (1912-1991). Profesor amerikan i Universitetit të Harvardit. Ka kryer studimet dhe ka doktoruar ne Universitetin e Harvardit. Është njëri ndër mbledhësi më të mëdhenj nga të huajt i këngëve shqiptare të kreshnikëve. Është autor i veprës së njohur studimore: *The Singer of Tales*, Harvard University Press, Cambridge, Massachusetts, 1960; *The Singer of Tales*, Second Edition, Stephen Mitchell and Gregory Nagy, Editors,

Çajlld, Kitrexh e Peri e shënuan këtë lëvizje brilante në jetën intelektuale amerikane (Neziri, 2006:71). Studimet në fushën e folklorit organizohen edhe sot në Harvard, në Komitetin e Degës së Folklorit dhe të Mitologjisë, të cilin e drejton Stefën Miçell (Stephen A. Mitchell), profesor i Folkloristikës dhe i skandinavishtes. Pra, model për të tjerët, për formimin e kuadrove sidomos për folkloristikë, katedër që u mungon shumë vendeve dhe neve, se ende nuk e kemi në Tiranë e as në Prishtinë.

2. Projekti i Perit në Ballkanin Perëndimor

Milmen Peri ishte student i Parisit dhe doktoroi në Sorbonë te profesori i njohur Antuan Meje (Antoine Meillet). Profesori çek, Matija Murko, njohës i mirë i traditës gojore, ishte nxitës i Perit për hulumtimin epikës gojore në Ballkanin Perëndimor (Neziri, 2006:71). Ekspedita e M. Perit për realizimin e projektit për studimin e poezisë popullore gojore në Ballkanin Perëndimor ka zgjatur dy vjet. Ka filluar në qershori 1934 dhe ka përfunduar në gusht 1935. Ai kishte planifikuar hulumtime të këtilla epike gojore në Europë dhe në Afrikë. Qëllimi i M. Perit ka qenë të vërtetuarit e supozimit se stili i Homerit nuk është vetëm tradicional, por është një stil gojor, që i përket poezisë gojore.

Albert Bates Lord

Milman Parry

Harvard University Press, Cambridge, Massachusetts; London, England, 2001; Është edhe autor i punimeve të njohura studimore nga fusha e epikës: "Homer, Parry and Huso" (1948), "Avdo Međedović, Guslar" (1956), "The Epic Singers" (1962), "History and Tradition in Balkan Oral Epic and Ballad" (1972), "The battle of Kosovo in Albanian and Serbocroatian Oral Epic Songs" (1984) etj.

3. Rezultatet e ekspeditës 1934-1935

Dejvid Elmer (David Elmer), profesor nga Harvardi, ndër njohësit më të mirë të Koleksionit të Perit, flet për këto rezultate, sipas një dokumenti të Lordit, i vitit 1950, i pabotuar: Koleksioni ka 3 584 disqe. Janë 12 554 njësi të traditës gojore: kënge epike, balada, këngë lirike (këngë të grave), njësi instrumentale dhe biseda. Janë 3 584 disqe. Por, saktësisht, janë vetëm 1 163 njësi epike, kurse ka dhjetëfish më shumë njësi lirike, pra 11 260, dhe 115 biseda e 16 këngë instrumentale. Peri, nga këto 12 554 njësi gojore, 758 i ka incizuar dhe 11 796 janë mbledhur nga diktimi (quhen autografe)**.** Pra, janë mbledhur nga diktimi 796 kënge epike, si dhe 11 000 këngë lirike. Të gjitha incizimet e regjistruara nga Peri janë transkriptuar, që bëjnë rreth 20 vëllime, por jo edhe këngët në gjuhën shqipe dhe turke. Pse, nuk dihet. Peri vdiq më 1935. Por, dihet se Lordi, dy vjet më vonë, më 1937, takoi disa mbledhës të këngëve të kreshnikëve në Shqipërinë e Veriut, cilët i pati edhe bashkëpunëtorë të terrenit. Dihet se edhe raportet diplomatike Uashington-Tiranë në vitet e realizimit të projektit ishin të mira. Në Boston dhe në qytete të tjera amerikane vepronin intelektualë shqiptarë, e ndër ta Fan Noli e Faik Konica. Kjo nuk ndodhi as pas Luftës së Dytë Botërore, kur filloi realizimi i botimeve të Koleksionit të M. Perit në Harvard e Beograd, sipas marrëveshjes. Ndonëse A. Lord premtonte se i ka parasysh edhe këngët shqipe dhe botimin e tyre në një vëllim të veçantë dhe se ky premtim i tij u botua në parathënien e librit II të botuar në Harvard, më 1953, por nuk u realizua.[492] A. Lord, sipas studiuesit Agron Fico, ishte në Shqipëri, pas 29 vjetësh, në qershor 1966. Mori pjesë në Simpoziumin e Folklorit të Shoqatës së Studimeve të Europës Juglindore në Tiranë me kumtesën rreth epikës legjendare dhe për rolin e rapsodit në pasurimin e varianteve bazë. Kumtesa e tij u ndoq me interesim dhe ngjalli diskutime, thotë A. Fico.[493] Fico, në vitet '90, pak pas vdekjes së prof.

[492] Lord, Albert Bates (1953).“Novi Pazar”, në: *Srpskohrvatske junačke pjesme*, skupio Milman Parry, uredio Albert Bates Lord, knjiga druga, *Novi Pazar: srpskohrvatski tekstovi*, Srpska akademija nauka i Harvard University Press, Beograd i Kembridž. f. xxxi.

[493] Fico, Agron F. (2004). "Prof. Albert B. Lordi-dramë e një miqësie", në: *Profesor në tre*

Lordit, ka vizituar Universitetin e Harvardit, ku ka punuar në Koleksionin e tij me këngë shqipe, më 1996, me ftesën e Z. Mary Louise Lord, pas një artikulli që kishte shkruar për Lordin në gazetën "Illyria", më 1994.[494]

4. Rezultatet e ekspeditës së Lordit më 1937 në Shqipëri

Ekspedita dymujore e Lordit më 1937 në Shqipërinë e Veriut solli rezultate të reja për Koleksionin e Perit. Tekstet janë shkruar në 12 fletore, tri nga të cilat janë të bashkëpunëtorëve Qamil Hoxha e Murat Paci. Në periudhën shtator-tetor 2002, gjatë qëndrimit hulumtues në Harvard, i lexova këngët, i ndava në lloje dhe e kreva numërimin e vargjeve të shënuara më 1937. Vargje gjithsej janë: 22 645, e prej tyre janë 20 445 janë vargje të kreshnikëve. Janë 53 këngë të kreshnikëve, 4 balada, 18 këngë epike historike dhe dy kënge lirike. Këtu duhet shtuar dhe një këngë të kreshnikëve jashtë fletoreve. Këngët nuk janë incizuar. Janë dorëshkrim. (Neziri, 2006: 103). Më 2003 filloi projekti në Harvard për botimin e një vëllimi dygjuhësh me këngë të zgjedhura, me rreth 7 000 vargje, nga ekipi: Dejvid Ellmer, Gjon Kolsti, Nikolla Skaldaferri e Zymer Neziri. U krye edhe përkthimi në anglisht. Por, nuk u botua, se u konstatua që ka lëshime në përkthim, që pritet të mënjanohen.

Salih Uglla (Salih Ugljanin)

Avdullah Ferizi (Avdo Međedović)

kontinente. Albanian Publishing, New York, NY, 10156, f. 129-144.

[494] Fico, Agron F. (2004). "Vizita e ëndërruar në Harvard dhe në familjen Lord": *Profesor në tre kontinente.* Albanian Publishing, New York, NY, 10156, f. 191-201.

Studiuesi Gjon Koleci (Gjon Kolsti), profesor në Universitetin e Teksasit në Austin, me prejardhje nga rrethina e Korçës, student i A. Lordit, është hulumtues i njohur i Koleksionit të M. Perit. Aty hartoi disertacionin e doktoratës[495] për lahutarët shqiptarë, Salih Ugllën dhe të tjerët, të quajtur dygjuhësorë, po edhe për lahutarët e Shqipërisë së Veriut, me të cilët Lordi punoi më 1937, por kjo është doktorata e vetme e atyshme nga një studiues shqiptar, me 1967.

Sokol Martini , Mërtur

Gjergj Pllumi, Shalë

Mark Miri, Kelmend

Gjenana Buturoviq (Djenana Buturović), epikologe e njohur nga Bosnja e Herecegovina, bashkëpunëtore e jashtme e Institutit Albanologjik të Prishtinës në vitet '70, e vlerësonte praninë e lahutarëve shqiptarë nga Sanxhaku i Pazarit në Koleksionin e Perit: ajo flet me të drejtë edhe për ndeshjet e traditave të ndryshme në Sanxhakun e Pazarit, e për këngët e botuara nga Koleksioni i Perit thotë se nga katër lahutarë, tre kanë qenë shqiptarë nga Peshteri: Salih Uglla, Sulejman Makaj dhe Ali Fulani. Përmend M. Murkon, mësuesin e M. Perit, që Salihin, luftëtarin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, e quante ''boshnjak i vërtetë'', por shton se Salihi deri në moshën 30 vjeç nuk ka ditur boshnjakisht, kurse ka filluar të këndojë boshjnakisht nga mosha 35 vjeç.[496]

---

[495] Kolsti, John (1990). *The Bilingual Singer: A Studi in Abanian and Serbo-Croatian Oral Epic Traditions.* Harvard Dissertationes in Folklore and Oral Tradition. Edited by Albert B. Lord, Harvard University, Garland Publishing. New York and London.

[496] Djenana Buturović, "Geografski prostor muslimanske epike", www.camo.ch/geografski_prostor.htm

5. Dy fjalë për Sanxhakun e Pazarit

Pas pushtimit të viseve tona më 1912, nga Serbia e Mali i Zi, ndodhi përmbysje e madhe për perspektivën e gjuhës shqipe dhe për këngën shqipe në Sanxhak. Krahas shtypjes kombëtare dhe shpërnguljes, vepronte vala e boshnjakizimit. Pra, në vitet '30, rreth 30 vjet pas pushtimit, Peri realizoi projektin në Sanxhak në ditët e rënda kombëtare për shqiptarët, për gjuhën e tyre dhe për këngën e tyre. Por, në Luftën e Dytë Botërore në Sanxhak kënga shqipe u ringjall dhe atje kishte administratë shqipe e shkolla shqipe. Në Pazarin e Ri punonte shkolla fillore "Naim Frashëri", me mësues Avdullah Zajmin. Por, pas luftës janë mbyllur dhe nuk janë hapur më. Aty flitet për një katedër të shqipes në Pazar të Ri, ku ka edhe dy universitete. Kështu u diskutua më 2013 në Plavë, më 29 korrik, në sesionin shkencor kushtuar 100-vjetorit të Masakrës së Previsë, të kryer nga Mali i Zi, ku ishte i pranishëm edhe rektori i Universitetit Internacional të Pazarit të Ri, prof. dr. Mevlud Dudiq, që flet mirë edhe shqip. U tha se nuk ka problem nga shteti. Madje, Beogradi mban ende një katedër të tillë, që është mjaft e vjetër, nga viti 1925. [497]

Foto me nxënës të Pazarit të Ri, shkolla fillore "Naim Frashëri", 1942-43

[497] Sesioni shkencor "100-vjetori i Masakrës së Previsë", Plavë, organizuar nga Shoqata "Alpet Shqiptare", më 29-31 korrik 2013.

Pra, kjo ishte gjendja, më 1941, vetëm 6 vjet pas vdekjes së Millmen Perit. Mirëpo, ajo u rikeqësua shumë edhe gjatë Jugosllavisë II, krahas shtypjes kombëtare dhe shpërnguljes, sepse boshnjakizimi nuk u ndal. Kjo valë e asimilimit ka ndodhur në të gjitha pjesët e Sanxhakut, madje edhe në Plavë e Guci, ku tash flasin shqip, natyrisht edhe këndojnë shqip, vetëm rreth 20 për qind, kurse, për krahasim, në pranverë 1912 atje flitej shqipja nga mbi 80 për qind e banorëve.

Sanxhaku sot, i ndarë nga Serbia e Mali i Zi, është krejt ndryshe nga gjendja më 1912, sepse për një shekull, sipas regjistrimit më 2011, Pazari i Ri i lahutarit të njohur Salih Uglla ka gjithsej 202 shqiptarë, ose 0,20 për qind nga 100 410 banorë, kurse Bjellopolja e lahutarit më të famshëm të Perit, Avdo Ferizi, që mbante plis të bardhë, ka vetëm 57 shqiptarë, ose 0,12 për qind nga 46 051 banorë. [498]

Rigels Halili, epikolog, mësimdhënës në Universitetin e Varshavës, hulumtues i epikës gojore shqipe në Rugovë e në Sanxhak, qëndroi në Sanxhak më 2009, u takua me pasardhësit e Salihit e të Avdos dhe hulumtoi gjendjen e sotme të këngës epike gojore. Konstatimi i tij është se epika gojore shqipe atje, një nga thesaret e epikës europiane dhe botërore në Koleksionin e Perit, është në përfundim të jetës së saj shumëshekullore.[499]

Përfundim

Koleksioni i Millmen Perit konsiderohet kontribut i madh i homerologjisë dhe sukses i rëndësishëm i epikologjisë ballkanike dhe europiane. Ndërkaq, me këngët e shënuara nga Llordi, më 1937, u krijua koleksioni më i madh i eposit heroik shqiptar i mbledhur nga një studiues i huaj. Është me shumë rëndësi edhe dëshmia e vitit 1937 në Harvard se këngët e kreshnikëve i këndojnë njësoj lahutarët shqiptarë të dy besimeve, musli-

[498] https://en.wikipedia.org/wiki/Sandzak.

[499] Rigels Halili, "Epika heroike legjendare në Sanxhakun e Pazarit – një krahasim midis kërkimeve të Parry-it dhe Lordit dhe gjendjes së sotme", kumtesë, dorëshkrim, konferenca shkencore ndërkombëtare për Eposin e Kreshnikëve, IAP-QSA, Pristinë, 2010.

manë dhe të krishterë, nga Malësia e Madhe e deri në Kurbin dhe deri në Rrafsh të Dukagjinit. Pra, kjo ishte mbyllja përfundimtare e mundësisë për të pohuar se këngët e eposit heroik shqiptar i këndojnë vetëm lahutarët muslimanë, madje përqindja lahutarëve të Llordit del pak më e lartë me besim të krishterë se ajo islame. Po ashtu dalin argumente të mjaftueshme edhe për mbylljen e problemit të njohjes së origjinalitetit të eposit heroik shqiptar dhe të moshës së tij nga periudha paraosmane. Dëshmitë se lahutarët shqiptarë dygjuhësorë, që këndonin edhe boshnjakisht, nuk janë sllavë, janë më shumë se një dhe kjo duhet të korrigjohet. Nuk është vetëm deklarimi i tyre, plisi i bardhë dhe mbiemri pa prapashtesën boshnjake -viq, po edhe leksiku shqip në këngët boshnjakisht dhe sidomos sintaksa e përmbysur boshnjake. Pra, mundësia dhe nevoja është për standardizimin e terminologjisë së përdorur dhe për mënjanimin e terminologjisë jo shkencore, ndonëse vonesa është shumë e gjatë, sepse ka kaluar gati një shekull. Madje duhet të rishikohet edhe emërtimi i Koleksionit, sepse ai nuk është vetëm serbokroat, sic thuhet. Dihet, askush nuk ka fituar. Humbës janë të gjithë. Fatkeqësisht, këtë fakt shumë studiues nuk e kanë përfilluar dhe, natyrisht, kanë vazhduar duke i dëmtuar studimet epike në Ballkan, sidomos eposin heroik legjendar shqiptar, që është ndër të vetmit i gjallë në traditën e sotme epike europiane.

Disa breza folkloristësh vazhdojnë ende të përballen me këto devijime në epikologji, nga Sh. Gjeçovi, B. Palaj, D. Kurti, Z. Sako, Q. Haxhihasani, A. Çetta e D. Shala, dhe deri te E. Mehmeti, A. Xhagolli, Zeqirja Neziri, Sh. Sinani, R. Halili etj. Këtu duhet përmendur me respekt Maksimilian Lambercin, Agnja Desnickajen dhe Ishtvan Shycin. Deri më tash janë mbajtur tri konferenca shkencore për eposin shqiptar (1983, 2010, 2014), në Tiranë e Prishtinë, me kumtues nga Amerika, Europa dhe Azia, me mbi 200 kumtesa, ndër to disa edhe për Koleksionin e Perit në Harvard. Edhe projekti i tashëm hulumtues shkencor, trevjeçar, i realizuar afër një shekull pas projektit të Millmen Perit, në pesë shtete të Ballkanit Perëndimor, në vitet 2012-2014, dhe i vlerësuar edhe në Harvard, nga prof. Dejvid Ellmer, është i vetmi i këtij lloji në Europë në fillim të këtij mijëvjeçari, në kuadër të projektit për UNESCO, me 15 vëllime këngësh të kreshnikëve, që kanë mbi 100 mijë vargje dhe që solli rezultate shumë të rëndësishme

për epikën gojore europiane dhe për trashëgiminë shpirtërore botërore.

Bibliografi

Desnickaja, Agnija Vasilevna (1975). Mbi lidhjet boshnjake-shqiptare në lëmin e poezisë epike, në:*Gjurmime albanologjike, Folklor dhe etnologji,* 5, Prishtinë, f. 41-62.

Buda, Aleks (1986). Eposi dhe historia jonë, në: *Çështje të folklorit shqiptar*, 2, Akademia e Shkencave e RPS e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, f. 46-55.

Bynum, David E. (1974). *Child's Legacy Enlarged: Oral Literary Studies at Harvard, Since 1856,* General editor Albert B. Lord, Publications of the Milman Parry Collection, Documentation and Planing Series, number two, Harvard Library Bulletin, Volume XXII, Number 3, Center for the Study of Oral Literature,Cambridge, Massachusetts.

Buturović, Đenana (1976). *Studija o Hormannovoj zbirci muslimanskih narodnih pjesama,* Svjetlost, Sarajevo.

Fico, Agron F. (2004). Profesor në tre kontinente. Albanian Publishing, New York, NY, 10156.

Cochiara, Giuseppe (1977). *Storia delfolklore in Europa.* Editore Paolo Boringhieri. Torino.

Çabej, Eqrem (1975). Për gjenezën e literaturës shqipe. Themelet kulture-historike: populli dhe poezija e tij, në: *Hylli i Dritës*, XV. Shkodër, 1939*,* n në: Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore,* V: *Gjuhë, Folkor, Letërsi, Diskutime.* Rilindja, Prishtinë, f. 101-135.

Elsie, Robert and Mathie-Heck, Janice (2004). *Song the Frontier Warriors. Këngë Kreshnikësh.* Albanian epic verse in a bilingual English-Albanian edition. Edited, introduced, and translated from the Albanian by Robert Elsie and Janice Mathie-Heck. Bolchazy-Carducci Publishers, Inc. Wauconda, Illinois USA.

Fico, F. A. (2004). Profesor në tri kontinente, Albanian Publishing, New York, NY 10156.

Gjergji, A. (1986). Etnosi ynë në epikën legjendare, në: *Çështje të folklorit shqiptar*, 2, Akademia e Shkencave e RPS e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, f. 103-119.

Haxhihasani, Qemal (1983). Vështrim kritik i disa koncepteve antishkencore rreth epikës sonë heroike legjendare, në: *Kultura popullore,* 2, Tiranë, f. 31-46.

------(1991). Mendësi zotëruese në ciklin e kreshikëve, në: *Gjurmime albanologjike, Folklor dhe etnologji,* 21, Prishtinë, f. 33-50.

Hoxha, Hysni (1987). *Struktura e vargut të këngëve kreshnike*. Rilindja, Prishtinë.

Kadare, Ismail (1987). Eposi dhe kultura shqiptare (diskutim) , në: *Çështje të folklorit shqiptar*, 3, Akademia e Shkencave e RPS e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, f. 328-331.

Katiçiq, Radosllav (1988). Mbi gjuhën e ilirëve: *Fjala,* 21-22, Prishtina, dhjetor, f. 1 e 7.

Koliqi, Ernesto (1937). *Epica popolare albanese.* Tesi di laurea in lingua e letteratura albanese di Ernesto Koliqi. Relatore: Prof. Carlo Tagliavini. R. Università di Padova. Facoltà di Lettere e Filosofia. Anno Accademico 1936-37. Gruppo universitario fascista, Padua.

Kolsti, John **(**1990). *The Bilingual Singer: A Studi in Abanian and Serbo-Croatian Oral Epic Traditions.* Harvard Dissertationes in Folklore and Oral Tradition. Edited by Albert B. Lord, Harvard University, Garland Publishing. New York and London.

Kujundžić, Enes (1987). "Rječnik", në: Avdo Međedović, *Ženidba Smailagić Mehe*, junački ep, priredio Enes Kujundžić, "Svjetlost", Sarajevo, f. 351-364.

Lambertz, Maximilian (1917). *Die Volkspoesie der Albaner*. Eine inführende Studie. Institut für balkanforschung in Sarajevo, Sarajevo.

------*(*1922). *Albanische Märchen und andere Texte zur albanischen Volkskunde.* Gesammelt und mit Übersetzung herausgegeben von Maximilian Lambertz. Schriften der Balkankommission. Linguistische Abteilung XII. Akademie der Sprachwissenschaft in Wien. Alfred Hölder, Vienna.

------*(1998). Epika popullore e shqiptarëve,* në: *Çështje të folklorit shqiptar*, 6, Akademia e Shkencave e RPS e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore. Tiranë*.* f. 5-95.

Lord, Albert (2001). *The Singer of Tales*, Harvard University Press, Cambridge, Massachusetts, 1960; *The Singer of Tales*, Second Edition, Stephen Mitchell and Gregory Nagy, Editors, Harvard University Press, Cambridge, Massachusetts; London, England.

------(1995). *The Singer Resumes the Tale. Myth and poetics.* Edited by Mary Louise Lord. Coronell University Press, New Haven & London.

Lord, Albert Bates (1953).“Opšti uvod”, në: *Srpskohrvatske junačke pjesme*, skupio Milman Parry, uredio Albert Bates Lord, knjiga druga, *Novi Pazar: srpskohrvatski tekstovi*, Srpska akademija nauka i Harvard University Press, Beograd i Kembridž. f. xv-xxv.

Maretić, T. (1909). *Naša narodna epika,* Akademija Znanosti i Umjetnosti, Zagreb, reprint 1966.

Medenica, Radoslav (1974). Arbanaške krešničke pesme i naša narodna epika*,* në: *Rad XIV kongresa Saveza foklorista Jugoslavije u Prizrenu 1967,* Beograd.

Mehmeti, Enver (1996). *Studime në fushën e letërsisë gojore,* Tetovë.

Međedović, Avdo, *Ženidba Smailagić Mehe*, junački ep, priredio Enes Kujundžić, Svjetlost, Sarajevo, 1987.

Murko, Matthias (1951). *Tragom srpskohrvatske narodne epike. Putovanja u godinama 1930-32,* I-II, Jugoslavenska Akademija Znanosti i Umjetnosti, Zagreb.

Miso, P. (1987). Roli dhe funksioni etnoartistik i lahutës*,* në: *Çështje të folklorit shqiptar*, 3, Akademia e Shkencave e RPS e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 27-44.

Neziri, Zymer (2003). *Këngë të kreshnikëve, s*htëpia botuese Libri Shkollor. Prishtinë.

------(2006). *Studime për folklorin, I: Eposi i Kreshnikëve dhe epika historike,* Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë.

Palaj, Bernardin and Kurti, Donat (1937). Hymje, në: *Visaret e Kombit, vëllimi II, Kangë Kreshnikësh dhe Legenda,* mbledhë e redaktuem nga At Bernardin Palaj dhe At Donat Kurti, Shtypshkronja Nikaj. Tiranë, f. III-VII.

Parry, Milman (1953). Razgovor sa Ugljaninom, në: *Srpskohrvatske junačke pjesme*, skupio M. Parry, uredio A. Bates Lord, knjiga druga, *Novi Pazar: srpskohrvatski tekstovi*, Srpska akademija nauka i Harvard University Press, Beograd i Kembridž, 1953, f. 2-7.

Parry, Milman (1971). *The making of Homeric verse. The collected papers of Milman Parry.* Edited by Adam Parry. Clarendon, Oxford.

Pipa, Arshi *(1978)*. *Albanian folk verse, structure and genre.* Albanische Forschungen 17. Triologia Albanica 1. Dr. Dr. Rudolf Trofenik, Munich.

Pulaha, Selami (1987). Fshatarësia e lirë e Shqipërisë së Veriut gjatë shek. XV-XVIII dhe cikli i kreshnikëve*,* në: *Çështje të folklorit shqiptar*, 3, Akademia e Shkencave e RPS e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, f. 174-189.

Sako, Z., Haxhihsani, Q., Fico. A (1974). *Folklor shqiptar,* I,II. Universiteti i Tiranës, Tiranë.

Sako, Zihni dhe Haxhihasani, Qemal (1966). Hyrje, në: *Epika legjendare (Cikli i kreshnikëve),* vëllimi i parë, Instituti i Folklorit, Tiranë, f. 7-49.

Schmauss, Alois (1934). Nekoliko podataka o epskom pevanju u pesmama kod Arbanasa (Arnauta) u Staroj Srbiji: *Prilozi proučavanja narodne poezije*, 1, Beograd, f. 107-112.

------(1970). Poezija epike shqiptare, në: *Shejzat/ Le Pleiadi*, 14.4-6, Rome, f. 115-130.

Sejko, Veis (2002). *Mbi elementet e përbashkëta në epikën shqiptaro-arbëreshe dhe serb-okroate,*Bargjini, Tiranë.

Srpskohrvatske junačke pjesme, skupio Milman Parry, uredio Albert Bates Lord, knjiga druga, *Novi Pazar: srpskohrvatski tekstovi*, Srpska akademija nauka i Harvard University Press, Beograd i Kembridž, 1953.

Serbocroatian Heroic Songs, collected by Milman Parry, edited and translated by Albert Bates Lord, with musical transcription by Bela Bartok and prefaces by John H. Finley, Jr. and Roman Jacobson, volume I, published by the Harvard University Press and Serbian Academy of Sciences, Cambridge and Belgrade, 1954.

Serbo-Croatian Heroic Songs, collected by Milman Parry, volume IV, *Ženidba Smajlagina Sina*, kazivao Avdo Međedović, s popratnim razgovorima s Međedovićem i drugim, edited by David E. Bynum with Albert B. Lord, Publications of the Milman Parry Collection, Center for the Study of Oral Literature, Cambridge, Massachusetts, 1974.

Shala, Demush (1995). *Rreth këngëve kreshnike shqiptare,* Rilindja*,* Prishtinë.

Sinani, Shaban (1993). "Rreth kohës dhe vendit të formimit të eposit të kreshnikëve"*, n*ë: *Kultura popullore,* 1-2, Tiranë, f. 11-24.

------(2000). *Mitologji në eposin e kreshnikëve*, SFAR, Tiranë.

------(2006). "Ringjallja e zërit shqip në koleksionet e M. Parryt e të A. Lordit - meritë e paçmuar e etnologut Zymer Neziri", parathënie në: Zymer Ujkan Neziri, *Studime për folklorin, I: Eposi i Kreshnikëve dhe epika historike,* IAP, Prishtinë, f. 7-28.

Sokoli, Ramadan and Miso, Pirro (1991). *Veglat muzikore të popullit shqiptar,* Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë.

Skendi, Stavro (1954). *Albanian and South Slavic oral epic poetry.* American Folklore Society, Philadelphia, Kraus reprint co. New York, 1969.

The Dictionary of Folklore, Mithology and Legend, I, II (1949, 1950). Editor Maria Leach, Funk &Wagnals, New York.

Tirta, Mark (2004). *Mitologjia ndër shqiptarë*, Akademia e Shkencave e RPS e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë.

Uçi, Alfred (1986). Epika heroike dhe roli i saj në folklorin shqiptar*, n*ë: *Çështje të folklorit shqiptar*, 2, Akademia e Shkencave e RPS e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, f.5-45.

Xhagolli, Agron (1984). "Vendi që zënë këngët e kreshnikëve në realitetin folklorik bashkëkohor", n*ë*: *Kultura popullore,* 2. Tiranë, f. 97-104.

Zheji, Gjergj**(**2000). *Folklori shqiptar.* SHBLU, Tiranë.

Zymer Ujkan NEZIRI, Instituti Albanologjik, Prishtinë

CONTRIBUTION OF AMERICAN SCHOLARS, MILMAN PARRY AND ALBERT LORD, FOR THE ALBANIAN ORAL EPIC POETRY

Summary

Milman Parry was a homerologist at the University of Harvard. In 1930's he developed the project about the folklore oral poetry of Yugoslavia. During the implementation of the project in 1934 and 1935 in the Western Balkans, apart from his research of the oral epic poetry of Bosniaks, Croats, and Serbs, he also included the oral epic poetry of Albanians. The purpose of Parry's research was to provide evidence to support his theory that Homeric epic was not only traditional, but an oral epic style, that belongs to the oral poetry. He collected more than 12000 materials in approximately 3500 gramophone records. In addition, the material was collected from Albanian singers in Sanxhak of the New Pazar (today Sandzak of Novi Pazar) where Albanian language is confronted with the Serbian and Bosniak languages. Parry is

credited with merit regarding his work with bilingual singers: Salih Uglla (S. Ugljanin), Avdullah Ferizi (A. Megjedoviq), Sulejman Makaj (Makiq), Ali Fulani (Fjuljanin), Xhemajl Zogaj (Zogiq), Shaban Nuhoxha (Nuhoxhiq), Fatime Arifi (Biberoviq), and Ethem Hasani (Hasanoviq). The abovementioned singers were from Sanxhak of Prizren, whereas Fatimja and Ethemi were from other Albanian parts. Two best rhapsodists were Avdo (Avdullah) and Salih, known as Salih Ugljanin and Avdo Megjedoviq. Both are considered among the last Homers in Europe.

Part of Parry's Collection is the work of Lord in northern Albania in 1937, where he recorded approximately 22 thousand verses, mainly songs of the Warriors of Frontiers from the well-known singers: Mark Miri, Nikë Toma, Gjokë Pjetri, Ali Hyseni, Ukshin Smajli, Ibish Bajrami, Gjergj Pllumi, Sokol Martini, Adem Brahimi, Rizë Zymeri, Ali Meta, etc. The Milman Parry Collection of Oral Literature is a masterpiece archive of the Balkans heroic epic and a one of the world's masterpieces of oral literature. It is stored in Widener Library of the Harvard University and is considered a major contribution to Homerologyand an important achievement of the Balkans and European epicology.

Lord's collection created the largest compilation of Albanian heroic epos from a foreign researcher. He brought evidence thesongs are being sung by both Muslim and Christian singers, and so ended the possibility of manipulation that these songs were sang by only Muslim singers. Evidence that bilingual Albanian singers, singing in Bosnian too, are not of Slavic origin, derives from their statements, the white plis (a type of hat worn by Albanian men) and their surname without the Bosnian suffix Bosnian –*viq* (Slavic: vić). In addition, this is also proven by their Albanian lexicon while singing songs in Bosnian, especially with syntax rules that are the opposite of the ones in Bosnian. Therefore, there

is an imminent need and opportunity to standardize the terminology used and to avoid the mistakes made, although we're now nearly one century late. Unfortunately, some scholars have not taken this fact into consideration and have continued to damage the epis studies in Balkans, especially the Albanian legendary heroic epos, which is one of the very few living in European epic tradition today. Several generations of folklorists continue to face these deviations in epicology, including Sh. Gjeçovi, B. Palaj, D. Kurti, Z. Sako, Q. Haxhihasani, A. Çetta, D. Shala, E. Mehmeti, A. Xhagolli, Zeqirja Neziri, Sh. Sinani, R. Halili etc. More over, the list continues with the honorable M*. Lambertz,* A*. Desnickaja,* I. Schütz, R. Elsie etc.

To date, three scientific conferences were held on Albanian epos (1983, 2010, and 2014) in Tirana and Prishtina, with scholars from America, Europe, and Asiapresenting over 200 papers, among them some written about the Collection of Perry at Harvard. In addition, the current three – year research scientific project carried out in five states of Western Balkans from 2012 – 2014, acknowledged also in Harvard from professor David Elmer, is the only project of its kind in the beginning of this millennium in Europe. This project is part of the proposal for UNESCO to be included in the list for the protection and preservation, contains 15 volumes of songs of Warriors of Frontiers with over 100 thousand verses. Moreover, this project achieved great results for the European oral epic and for the world's spiritual heritage.

Carly DICKERSON, Universiteti Ohio State

SHPREHJA GJUHËSORE E IDENTITETIT GJINOR: BURRNESHAT E SHQIPËRISË

1. **Hyrje**

Dimensionet gjuhësore të transgjinisë zakonisht janë analizuar brenda një kuadri cilësor dhe me një fokus në grupet e margjinalizuara, për shembull *hijra*-t (Hall & O'Donovan 1996), *travestis*-et (Kulick 1997), dhe *'yan daudu*-et (Gaudio 2014). Këto studime zbulojnë që individët transgjinorë lundrojnë nëpër, dhe shpesh krijojnë, sistemet komplekse të praktikave e gjesteve gjuhësore gjinore për të pohuar identitete unike që kapërcejnë kuptimet tradicionale se ç'do të thotë të jeshë mashkull a femër.

Megjithatë, le që nuk ka studime sasiore të variacionit gjuhësor në të folur transgjinor gjerësisht, na mungojne kërkime të individëve transgjinorë që zënë pozicione të shquara në shoqërinë e zakonshme dhe që janë të trajtuar në të njëjtin nivel me të tjerët jotransgjinorë. Në këtë studim, unë e hetoj këtë mungesë në literaturë. Përqendrohem në aspektet gjuhësore të konstruksionit të identiteteve mashkullore nga burrneshat: femra biologjike që bëhen 'burra socialë'.

Jo si për "gjinitë e treta" (Kulick 1999) të tjera, transicioni i burrneshave nuk është i motivuar nga indentiteti personal ose dëshira seksuale. Përkundrazi, është nga nevoja që të plotësojnë role patriarkale sipas një kodi social tradicional. Megjithëse janë të pranuara dhe të trajtuara si burrat në komunitetet e tyre, burrneshat nuk martohen dhe nuk angazhohen në marrëdhënie seksuale. Prandaj shihen si të ndershme dhe vetëmohuese (Young 2000).

Për shekuj me radhë ka ekzistuar një praktikë në shoqërinë tradicionale në Shqipërinë veriore, në të cilën gratë betohen që të jetojnë si burra. Të njohura edhe si "virgjëresha të betuara," këta individë duhet të heqin dorë nga jeta e tyre si femra, duke premtuar që kurrë nuk do të martohen dhe që do të qëndrojnë të virgjëra gjatë jetës. Në këmbim, marrin role sociale meshkullore, dhe anëtarët e komunitetit i trajtojnë si burra. Ky identitet i ri mashkullor u jep privilegje që zakonisht janë të rezervuara për burrat, për shembull e drejta e pronës, për të mbajtur armë, për të pirë alkool dhe duhan, dhe për të udhëtuar të pashoqëruara. Liria e tillë lejon që burrneshat mund të fitojnë për jetë dhe të krijojnë siguri për familjet e tyre. (Tarifa 20007; Šarčević 2004; Young & Rice 2012; Elsie 2012).

Në këto kushte, si e konstruktojnë dhe shprehin gjuhësisht burrneshat identitetin e tyre, dhe si angazhohen të tjerët me këtë identitet? A e ndjekin burrneshat konstruksionin gjuhësor të mashkullorësisë që e përdorin meshkujt biologjikë, apo diferencohen nga meshkujt me një kombinim të praktikave mashkullore dhe femërore?

Hulumtime të mëparshme tregojnë që transgjinorët i përdorin, në mënyrë strategjike, të dy format gramatikore në vetëreferencë dhe se ky përdorim është shpesh subversive. Për shembull, Bershtling-u (2014) e gjen sistemin binar të gjinisë gramatikore në hebraishte në "praktika dhe performanca të ndryshme subversive të identitetit [gjinor]" midis individëve *genderqueer*. Po nëse nuk ka një kulturë mbizotëruese ose shtypëse për të shkatërruar? Cilët faktorë socialë ose gjuhësorë (nëse ka) do ta kufizojnë përdorimin e gramatikës gjinore? Për më tepër, si shkruajnë dhe flasin të tjerët për burrneshat? A shihen si duke okupuar pozitat brenda ose përtej një sistemi me dy gjinitë binare?

Duke punuar brenda një kuadri që gjininë e kupton si diçka që është e konstruktuar nga shoqëria, unë i hetoj ndikimet shoqërore dhe gjuhësore në variacionin që ekziston në përdorimin e gjinisë gramatikore në mënyrën e të folurit të burrneshave dhe të tjerëve në komunitetet e tyre. Të dhënat janë prej artikujve të gazetave dhe bisedave të regjistruara në vitin 2014 në Durrës, Elbasan, Shkodër, dhe në fshatra fqinje. Analiza zbulon që

zgjedhjet e gjinisë gramatikore të përdorura për t'u referuar burrneshave janë të lidhura me konteksin gjuhësor, lidhjen që ka folësi me burrneshat, si dhe shprehjen e karakteristikave të veçanta (krenaria e fuqia, për shembull). Pjesa e parë e studimit ofron analizë sasiore të përdorimit të gjinisë gramatikore. Pjesa e dytë e studimit ekzaminon një shumëllojshmëri të praktikave gjinore që janë përdorur për të shprehur identitete gjinore.

2. Gjinia gjuhësore në gjuhën shqipe

Gjinia gjuhësore është një [agreement class] qe "është në përgjithësi e tepërt ose jofunksionale në lidhje me rolin e saj në gramatikë dhe komunikimi njerëzor, pikërisht në krahasim me kategoritë e tjera gramatikore e tjera si numri ose koha, dhe me karakterin e saj jo universal" (Kilarski 2007:2). Megjithëse në shumë gjuhë indo-europiane gjinia gjuhësore përkon me seksin mashkullor ose femëror (është përmendur shpesh si gjinjia "natyrore" (Corbeill 2008)), një lidhje e tillë nuk është e nevojshme për sistemet gjuhësore gjinore. Në të vërtetë, "seksi mund jete i pavend, si për shembull në gjuhën Algonquian, ku b]het dallimi e gjallë-e pajetë" (Corbett 2006:749). Veç kësaj, edhe në sistemet gjinore që kanë një kontrast mashkullor-femëror, shumë caktime gjinore të emrave duken arbitrare në aspektin semantik (Kilarski & Krynicki 2005). Le ta marrim në konsideratë, për shembull, fjaln për "diell": është mashkullore në spanjishte, femërore në gjermanishte, dhe asnjanëse në rusishte.

Shqipja ka një sistem gjinor gramatikor tipikisht indo-europian. Domethënë që emrat janë ose mashkullorë ose femërorë. Sistemi përemëror shqip bën dallimin ndërmjet vetave dhe numrave gramatikorë. Vetëm veta e tretë ka një dallim mashkullore-femërore (Camaj 1984). Megjithatë, shqipja është një gjuhë *pro-drop*; përemrat nuk janë të detyrueshëm. Atëherë, gjinia gramatike e subjektit të foljes nuk është shpesh e specifikuar hapurazi (Camaj 1984). Nga ana tjetër, gjinia gramatikore zakonisht duhet që jetë e caktuar në përdorimin e mbiemrave. Fakti që mbiemrat janë shpesh mashkullorë ose femërorë do thotë që ka shumë mundësi në gjuhën shqip për të shënuar gjininë.

3. Mbledhja dhe kodimi i të dhënave

Ky studim shfrytëzon pesë intervista të regjistruara (gjashtë orë në gjatësi). Ka një total prej njëzet e pesë pjesmarrësish, të gjithë folës amtarë shqiptarë. Shumica e tyre janë nga veriu ose veri-qendra e Shqipërisë. Për çdo intervistë, një burrneshë, një intervistues, dhe një shumëllojshmëri kombinimi të miqve dhe anëtarëve të familjes ishin të pranishëm. Vetëm në një nga pesë intervistat nuk përfshirë një burrneshë. Kjo intervistë ishte me familjen dhe shokët e një burrneshe që vdiq një dekadë më parë. Burrneshat në këtë kërkim kanë pseudonime: Rozafa, Fitore, Liana, Fatmira, dhe Rita. Të dhënat e folura plotësohen nga të dhënat e shkruara që gjinden në trembëdhjetë artikuj gazetash rreth aspekteve të ndryshme të burrneshave.

Transkriptimet e artikujve dhe intervistave ishin kërkuar për njësitë e variablit të varur *(GJINI)*, që përcaktohet si ndodhja e një njësie sintaksore (NP ose AP) që u referohet burrneshave dhe që shfaq gjininë gramatikore (mashkullore ose femërore). Ishin identifikuar në tërësi 389 njësi të pranueshme si të tilla. Pastaj, këto njësitë ishin koduar për faktorët gjuhësorë dhe shoqërorë:

a. Pjesa e ligjeratës: Mbiemrat (A), Emrat (N). Të dy faktorë përfshijnë forma përemërore (dmth. mbiemra posesivë dhe përemra).
b. Lloji: Përemëror (P), Jopëremëror (N). Nëse janë apo jo mbiemra ose emra, njësitë ishin të koduara për një karakter përemëror.
c. Gjinia gramatikore e mëparshme: Mashkullore (M), Femërore (F), e Padisponueshme (U). Gjinia gramatikore e mëparshme ishte përcaktuar si gjini gramatikore e një fjale ose një frazë më herët që i referohej së të njëjtës burrneshë, që ishte referimi i njësisë. Nëse këto fjalë ose fraza shfaqeshin më larg se një fjali e plotë – ose nëse nuk kishte shfaqje të gjinisë gramatikore përpara – këto njësi ishin koduar si U.
d. Mjeti i gjuhës: e Folur (O), e Shkruar (W). Njësitë që ishin nga një citim në një artikull ishin koduar si W.
e. Lidhja me burrneshën: Vetë (S), Familja ose shoku (F), Jofamilijare (U). Burrneshat, si subjekte të intervistave, ishin të koduara si S.
f. Identiteti seksual/ gjinor: Mashkull (M), Femër (F), Burrneshë (B), i Padisponueshëm (U). Artikujt me një autor anonim ishin koduar si U. I

kushtohej vëmendje faktit se t'u jepej burrneshave një kategori gjinore/ seksuale do të ishte, në thelb, problematike. Kjo pyetje e identitit është e kryesorja për kërkimin, prandaj nuk mund t'i jap përgjigje para se ta filloj hulumtimin. Është edhe shumë e mundshme që burrneshat dallojnë nga njëra-tjetra për sa i përket shtrirjes që identifikohen si mashkullore ose femërore. Për këto arsye, kam vendosur që të përdor vetëm B për burrneshat.

g. Mosha: 15-29 (A), 30-39 (B), 40-69 (C), 70+ (D), e Padisponueshme (D).

4. Analiza e të dhënave dhe rezultatet

Pasi ishin koduar, i kam vënë të dhënat në Goldvarb X për Windows (Sankoff, Tagliamonte, & Smith 2005), aplikim kompjuterik që përdoret shpesh në studimin e variacionit sociolinguistik për të kryer regresionin logjistik. Është i dobishëm për furnizimin e numrave të papërpunuar dhe të përqindjeve për një variant në grupet faktore të ndryshme.

Tabela 1 ilustron shpërndarjen e variantit mashkullor (M) të gjinisë gramat ikore nëpër grupe faktorë gjuhësorë dhe shoqërorë.

Tabela 1. Përndarja e përgjithshme e shënimit të variantit mashkullor të gjinisë gramatikore

Grupet faktorë	Mashkullor %	Total N	N
Shpërndarja e përgjithshme	21.1	82	389
Pjesa e ligjerates			
Mbiemrat	26.4	55	208
Emrat	14.9	27	181
Lloji			
Jo përemëror	27.5	70	255
Përemëror	9.0	12	134
Gjinia gramatikore e mëparshme			
Mashkullore	53.1	26	49
E padisponueshme	30.8	41	133
Femërore	7.2	15	207
Mjeti i gjuhës			
Folur	25.0	56	224
Shkruar	15.8	26	165
Lidhja me burrneshën			
Vetë	37.1	43	116
Jo familjare	17.0	27	159
Familja ose shoku	11.1	12	108
Identiteti seksual/gjinor			
Burrneshë	37.1	43	116
Mashkull	15.0	12	80
E padisponueshëm	13.5	12	89
Femër	14.4	15	104
Mosha			
40-69	32.8	38	116
15-29	17.5	7	40
70+	16.7	10	60
30-39	18.1	15	83
E padisponueshme	13.3	12	90

Shpërndarja e përgjithshme e variantit mashkullor zbulon që, për të gjithë, pos për një faktor, varianti femëror është i parapëlqyer (53.1%). Vetëm njësitë që ishin të koduara për Gjininë e mëparshme gramatikore mashkullore kishin variante mashkullore. Mëgjithatë, dy analiza binome *step-up/ step-down* treguan që katër grupe faktorësh gjuhësorë ishin statistikisht të rëndësishme për të parashikuar përdorimin e variantit mashkullor në krahasim me variantin femëror: Gjinia gramatikore e mëparshme, Lloji, Mjeti i gjuhës dhe Lidhja me burrneshën. (Tabela 2)

Tabela 2. Faktorët që kontribuojnë në përdorimin e gjinisë gramatikore mashkullore për burrneshat

Grupet FAKTORË GJUHËSORË		**Grupet faktorë shoqërorë**	
N total:	389	N total:	389
Input:	.145	*Input*:	.190
Gjinia gramatikore e mëparshme		**Lidhja me burrneshën**	
Mashkullore	87	Vetë	.68
E padisponueshme	69	Jo familjare	.53
Femërore	27	Familja ose shoku	.27
Gama:	*60*	*Gama: 44*	
Lloji	**Mjeti i gjuhës**		
Jo përemëror	.62	Gojore	. 59
Përemëror	.29	Me shkrim	. 38
Gama:	*33*	*Gama: 21*	

Faktorë jo të rendësishëm: Pjesa e ligjëratës, Mosha; Identiteti seksual/ gjinor

5. Diskutimi

Pjesa e ligjeratës. Numrat e papërpunuar tregojnë një përqindje më të lartë për njësitet femërore në emrat (85.1%) sesa në mbiemrat (73.6%), por analiza gjeti që pjesa e ligjeratës nuk luan rol të rëndësishëm në zgjedhjen mes gjinive gramatikore mashkullore dhe femërore. Arsyeja mund të burojë nga vendimi metodologjik që të kodojë mbiemrat e emrat sipas funksionit të tyre sintaksor (emrat) edhe nëse janë rrjedhim nga mbiemrat.

Lloji. Frazat përemërore favorizojnë shumë femëroren, kurse frazat emërore kanë treguar një parapëlqim për mashkulloren. Kjo mund të shpjegohet nëse parashtrojmë se (a) frazat përemërore (AP ose NP) janë më pak të dukshme në ligjeratë (nga ana leksikore dhe nga ana e perceptimit) sesa frazat jopëremërore, dhe (b) pjesëmarrësit, në nënvetëdije, kanë tendencë që t'i konsiderojnë burrneshat si femra.

Emrat dhe mbiemrat jo përemërorë mbajnë një ngarkesë semantike më të rëndë (Zelinksky-Wibbelt 2000). Domëthënë, përveç se përmes shprehjes së gjinisë, numrit, rasës, etj., japin edhe informacion leksikor (në

lidhje me profesionin, moshën, gjykimet e vlerësisë, pamjen, etj.). Ky informacion plotues do thotë që emrat dhe mbiemrat jopëremërorë janë më të dukshëm në ligjëratë, sepse folësit janë më të ditur nga zgjedhja e tyre leksikore. Prandaj, nëse pjesëmarrësit janë më pak të ditur nga zgjedhja e përemrave sesa e janë nga zgjedhja e emrave dhe mbiemrave, njësitë përemërore mund të jenë një reflektim më i saktë i kuptimit të tyre në nënvetëdije të gjinisë "së vërtetë" të një burrneshe.

Duke përdorur pikat leksikore, një person mund të ketë vështirësi për të pajtuar disonancën semantike të perceptuar mes kuptimit mashkullor që ka një fjalë dhe morfologjisë së saj. Për shembull, Shkrimtari 03 pranon që burrneshat "sakrifojnë" identitetetin e tyre seksual (dmth. femërinë e tyre) për një të mirë më të madhe (Shembulli 1). Marrim shënim, mëgjithatë, që të gjitha njësitë përemërore në artikullin e tij janë të gjinisë gramatikore femërore.

Shembulli 1.

a. SHKRIMTARI 03: [...] një vajzë vendos që ta sakrifojë identitetin e saj seksual për atë social dhe nuk ka **hero** më të madh se **kjo**, në kontekstin e zhvillimit të kësaj tradite shqiptare. Pasi të bëhet burrë, ajo shndërrohet në "ai", mban plisin, orën e xhepit sikur burrat, ndërron mimikën, administron pronën e shtëpisë, zgjidh problemet në komunitet si **pjesëtar i familjes**, [...]

b. SHKRIMTARI 03: [...] janë ndjerë **krenarë** për atë që kanë bërë.

Gjinia gramatikore e mëparshme. Në një bisedë bashkëpunuese folësit ka të ngjarë që të lidhin veten me bashkëbiseduesit. Sipas Garrod-it dhe Pickering-it (2009), dialogu "është një veprim i përbashkët në nivele të ndryshme. Në nivelin më të lartë, qëllimi i bashkëbiseduesve është të lidhin përfaqësimet e tyre mendore. Kjo del nga veprimi i përbashkët në nivele më të ulëta që kanë lidhje me vendimit gjuhësore (d.m.th. zgjedhje e fjalëve) dhe me proceset jogjuhësore (d.m.th. përafrimi i sjelljes ose shpejtësia e të folurit)" (56). Nuk është e papritur, atëherë, që një njësi e mëparshëm e gjinisë gramatikore mashkullore ose femërore do të favorizojë, përkatësisht, variantin mashkullor ose femëror. Edhe pse një individ mund të ketë tendencë që ta përdorë gjininë femërore kur flet për

burrneshat, zgjedhja e tij e gjinisë gramatikore mund të jetë e ndikuar kur dëgjon dikë tjetër duke përdorur formën mashkullore.

Scherre dhe Naro (1991) në studimin e tyre rreth shënimit e trajtimit gramatikor në portugishten braziliane e kanë quajtur këtë fenonem efekti *"birds of a feather"* ("zogjtë e një pende"): "parimi që drejton përdorimin e vërtetë të shënuesve është diçka më shumë si *'birds of a feather flock together'* ('zogjtë e një pende të kopesë së bashku'), domethënë, sa më shumë shënues që ka, më shumë ka shanse që të përdoret edhe një shënues; sa më pak shënues që të ketë, ka më pak shanse që të përdoret edhe një" (24). Edhe pse fusha e Scherre-it dhe Naro-it është sintaksa, të njëjtat parime vlejnë në aspekte të gjuhës të ndryshme (Pickering & Ferreira 2008). Ky efekt rritet mbas gjase kur folësit pasqyrojnë bashkëbiseduesit e tyre ose kur përsërisin frazat e mëparshme. Në shqyrtimin e tyre të *structural priming*-it, Pickering dhe Ferreira (2008) konfirmojnë që "në dialog, bashkëbiseduesit ndryshojnë shpesh mes kuptimit dhe prodhimit, dhe qartë mund të përdorin çfarë kanë kuptuar për të drejtuar çfarë prodhojnë. Prandaj nuk është e papritur që dialogu të jetë tepër i përsëritur" (441).

Në Shembullin 2, kushëriri i dytë e Rozafës, që zakonisht përdor gjininë gramatikore femërore, përdor gjininë mashkullore pas përdorimit nga nëna e tij të gjinisë mashkullore.

Shembulli 2.

GRUAJA E KUSHËRIRIT TË ROZAFËS: Ka qenë shumë njeri i mirë, moj, ka qenë **i dashtun**, o zot.
KUSHËRIRI I DYTË TË ROZAFËS: Shumë **i dashtun** e tana.

Megjithatë, nuk është gjithmonë rasti që folësit të rregullojnë përdorimet e tyre të gjinisë gramatikore. Në fakt, si në Shembullin 3, një folës mund të vazhdojë duke përdorur një gjini edhe nëse bashkëbiseduesi përdor gjininë gramatikore tjetër.

Shembulli 3.

INTERVISTUESJA 01: Oh marshalla, dukesh **më e vogël**! si-
LIANA: "Marshalla" mund thotë ai është myslyman, por orthodoksët nuk thonë "marshalla".

INTERVISTUESJA 01: E di, haha.

LIANA: Jezu, haha. **tsk** Kështu janë ca gjëra që-

INTERVISTUESJA 01: Mund t'ju pyesim për fenë tuaj?

LIANA: **Orthodoks**.

INTERVISTUESJA 01: Ju jeni **orthodokse.**

Në këtë shembull intervistuesja pëdor gjininë femërore kur ajo shpreh habinë për moshën e Lianës ("Oh marshalla, dukesh më e vogël!"). Megjithatë, Liana, kur është i/e pyetur për fenë e tij/saj, përdor mashkulloren ("Ortohodoks"). Pastaj, intervistuesja nuk e ndryshon përdorimin e saj të gjinisë për Lianën, edhe po të ketë dëgjuar që Liana e përdor gjininë mashkullore; intervistuesja përdor femëroren ("Ju jeni orthodokse"). Është e mundur që intervistuesja vazhdon me gjininë femërore sepse për të Liana është rrënjësisht një femër përkundër shumë tipareve mashkullore që ka.

Përdorimi në rritje i gjinisë mashkullore në mungesë të një njësie të mëparme të gjnisë gramatikore mbase është i lidhur me statusin e gjinisë mashkullore si gjini gramatikore e parazgjedhur në gjuhën shqipe kur gjinia nuk është e ditur. Kur ka dyshim, ose kur diskutojnë burrneshat në mënyrë abstrakte, folësit ose shkrimtarët do të kenë tendencë që të përdorin gjininë mashkullore.

Natyrisht, rezultatet zbulojnë që, më së shumti, vetëm pesëdhjetë e tre për qind e njësive janë mashkullore, edhe kur janë të paraprirë nga një njësi mashkullore. Mund të tregoj situata si ato në Shembullin 3, në të cilat folësit e ndryshëm kanë ideologji të ndryshme të gjinisë. Megjithatë, ka edhe shumë shembuj të variacionit gjuhësor në të dhëna. Ka variacion edhe në fjalimin ose shkrimin e një pjesëmarrësi të vetëm (Shembulli 4).

Shembulli 4.

ARTIKULLI 02: Ndërsa, Behari, një Burrneshë 86-vjeçare jetoi si djalë që nga mosha 6-vjeçare, sepse thjeshtë nuk u ndje si vajzë. **Ai** ishte rrahur nga nëna **e tij**, sepse nuk pranonte të vishej me rroba vajze. **Ajo** ishte vetëm në **12 vjeçe** kur babai pranoi që ajo pjesën tjetër të jetës ta jetonte si burrë. Behari ishte në nje intervistë të botuar më herët në GQ, kur ishte pyetur se pse një burrë nuk mund të jetonte si grua, përgjigja **e tij** ishte [...]

Autori i artikullit 02 dallon gjininë mashkullore dhe femërore kur

shkruan për Beharin. Por nuk duket që këto dallime janë të motivuara nga një strategji letrare për të ndjellë një transicion gjinor; gjinia mashkullore është përdorur për të përshkruar Beharin në një kohë kur Behari ishte ende "ajo" ("**Ai** ishte rrahur nga nëna **e tij**"), dhe gjinia femërore përdoret për të përshkruar pranimin e babait të transicionit në mashkullorësi të Beharit ("**Ajo** ishte vetëm **12 vjeçe** kur babai pranoi që ajo pjesën tjetër të jetës ta jetonte si burrë"). Nuk është e qartë nëse një rast si ky ndikon në një lloj të *code-switching*, ose thjesht një redaktim të keq.

Mjeti i gjuhës. Në krahasim me të dhënat e folura, të dhënat e shkruara përfshijnë më pak njësi mashkullore. Mund të jetë nga natyra e teksteve të shkruara. Nuk është gjithmonë rasti (lexoni shembullin e mëparshëm), por artikujt dhe esetë janë zakonisht të redaktuara për të shmangur gabimet dhe mospërputhjet. Përveç kësaj, akti i të shkruarit (të shtypur) është i paramenduar dhe me dashje; shkrimtari është vetëdijshëm për zgjedhjen e fjalëve. Në këtë mënyrë më formale të gjuhës ka kuptim që materialet e shkruara të shfaqin më pak variacion (paqëllimshëm) në gjininë gramatikore.

Materialet e shkruara ndryshohen edhe nga të dhënat e folura për sa i përket demografisë së pjesëmarrësve. Shumë njësi në të dhëna të shkruara janë nga pjesëmarrësit jofamiljarë me burrneshat. Të dhënat e vetme të prodhuara nga burrneshat janë në vetëm dy intervista – një me Lianën dhe një me Ritën. Atëherë, nëse kanë takuar një burrneshë një herë për një intervistë ose janë vetëm duke shkruar rreth burrneshave nga një pikëpamje filozofike, shkrimtarët nuk kanë lidhje të themeluar me burrneshat. Njësitë e shokëve dhe anëtarëve të familjes të burrneshave mungojnë në të dhëna të shkruara. Në anën tjetër, pjesëmarrësit në intervista të regjistruara, me përjashtim të tre intervistuesve, janë të gjithë ose burrnesha ose njerëz që i njohin burrneshat. Edhe pse individët familjarë me burrneshat nuk përdorin shumë njësi mashkullore, burrneshat kanë një përdorim të variantit mashullor mbi mesataren (shkikoni pjesë që vjen). Gati tridhjetë për qind e njësive janë nga burrneshat, atëherë pjesemarrja e tyre e konsiderueshme në intervista mund të balancojë përdorimin e familjarëve.

Identiteti seksual/gjinor. Identiteti seksual/gjinor i pjesëmarrësve nuk ishte një faktor i rëndësishëm për të parashikuar përdorimin e gjinisë grmataikore. Megjithatë, duhet që të marrim parasysh që të gjitha pjesëmarrësit që ishin të koduar si Vetë (S) në grupin faktor Lidhja me burrneshën janë të njëjtë si pjesëmarrësit që ishin të koduar si Burrneshë (B) në grupin faktor Identiteti seksual/gjinor. Prandaj, ne mund të parashtroj se të jetë një burrneshë është një fator i rëndësishëm.

Lidhja me burrneshën. Lidhja me burrneshën ishte një faktor i rëndësishëm në ndikimin e përdorimit të gjinisë gramatikore. Burrneshat e kanë përdorur më shumë gjininë gramatikore se të tjerët; përdorimi i tyre ka një *factor weight* e .68. Anëtarët e familjes dhe shokët e kishin më të ulët: .27. Këto rezultate mund të na tregojë si pjesëmarrësit përfytyrojnë identitetin gjinor e burrneshave.

Pjesëmarrësit që nuk kishin takuar burrneshat, dhe intervistuesit që kishin takuar burrneshat për herë të parë, kishin një normë më të ulët të njësive se burrneshat e kishin. Është tunduese që të interpretojë këtë sjellje si dëshmin që burreshat, përkundër përpjekjet e tyre që të duket mashkullore, ende bëjnë një përshtypje e parë femërore. Megjithatë, është e rëndësishme që të konsiderojë kontekstin në të cilin këto pjesëmarrësit janë duke folur ose shkruar për burrneshat. Ata kanë kërkuar që të bërë intervistat me burrneshat pikërisht sepse burrneshat janë "gratë që bëhen burra"; fakti që subjekti i intervistës është nga origjina femërore është në ballë e mendjet të pjesëmarrësve. Pjesëmarrësit janë mbase të preokupuar me duke u përpjekur që të kuptojnë identitetin dhe prezantimin kompleks të një burrneshe. Një fiksim të tillë mund të ndikojë në sasinë e njësive femërore që përdor një folës ose një shkrimtar. Ka mundësi që në një situatë e ndryshme, këta pjesëmarrësit nuk do të kuptojnë që burrnesha nuk ishte biologjikist një mashkull.

Në krahasim me gazetarët dhe intervistuesit, të afërmit dhe miqtë kanë lidhje të forta me burrneshat. Lidhjet shpesh kanë filluar para transformacionit. Këta pjesëmarrësi nuk janë të fiksuar në identitetin gjinor; burrneshat në jetën e tyre janë burra të socialë. Nuk kanë shprejhur asnjë

hezitim për t'i pranuar si të tillë, dhe as nuk ka dëshmi të mosrespektimit ose tallje ndaj burreshave. Në të vërtetë, pjesëmarrësit shpesh ngulin këmbë burrërinë, karakterin e shquar, dhe ndershmërin e burrneshave që njohin. Për këtë arsye, nuk është shumë e mundur që preferenca e tyre për gjininë femërore pasqyron një mospranim e identitetit mashkullore të burrneshe. Një shpjegim më i besueshëm është që këta folës nuk shohin asnjë konflikt mes gjinisë origjinale e burrneshës dhe gjinisë e saj aktuale. Për shembull, nipi i Fatmirës shpreh një kuptim të ngjashëm e "hallës" e tij (Shembulli 5).

Shembulli 5.

NIPI I FATMIRËS: Si hallë, por gjithmonë **e veçantë**, gjithmonë **e veçantë**. Nuk e di-nuk e di. Shumë **e veçantë**, **e veçantë** po si hallë. Po edhe shumë **e fortë** edhe **shumë e fortë**, edhe shumë **interesante**[?] gjithmonë fakti, a din. **Interesante** po e din, si gjithmonë **e gatshme** dhe gjithmonë **e gatshme** me ne **e dashtun**, **e disponu** si shok, marshalla.

Këta folës u mësuan dhe pranuan që hallat, motrat, mbesat, ose kushërirat e tyre po jetojnë si burra. Çfare mund të jetë e çuditshme ose intriguese për të jashtmit është në fakt një gjë normale në jetën e përditshme. Të sigurtë në mashkullorësinë e burrneshës, të folësi të tillë mund të përdorin gjininë gramatikore femërore mos duke u shqetsuar që ofendojnë burrërinë e burrneshës.

Burrneshat ishin grupi me *faktor weight* më i rëndë për njësitë mashkullore. Kjo ndikon që burrneshat në të vërtetë shihen si burra, edhe nëse nuk hezitojnë që të flasin për fëmijërinë e tyre si vajzat ose për dallimet biologjike. Edhe ndikon që kanë bërë transicionin me sukses. Megjithatë, vetëm tridhjetë e shtatë për qind e njësive nga burrneshat ishin të mashkullore; burrneshat ende përdoren kryesisht gjininë femërore. Arsyeja është ndoshta si ishte për familjat dhe shokët – ato nuk mohojnë pjesën e tyre që është femër, as nuk ndjehen të detyruara që të zgjedhin mes gjinive.

Edhe një arsye për përdorimin e gjinisë femërore është krenaria; burrneshat kanë shprehur një ndenje e krenarisë për çfare kanë kryer në jetën. Në Shembullin 6, Rita gëzohet në kujtimin e lavdërimeve nga grupet

e grave. Rita mund të jetë një burrë, por trupi e tij/saj është ende ai e një gruaje një metër e gjys e gjatë – një sfidë mjaft për një profesion që duhet shumë forcë fizike.

Shembulli 6.

RITA: E nisa punën si **ekskavatoriste**, dhe më pas, kërkoja edhe më shumë. Këtu ruaj edhe një letër që ma ka sjellë një grua nga Bashkimi Sovjetik, Anastasia e quajnë, madje-madje, kam edhe një letër që më ka ardhur nga Shoqata e Grave Rumune. Anastasia më shkruan se "e vlerëson profesionin tim si **ekskavatoriste**, madje ajo më thotë se grua aviatore ka, edhe kamioniste, por rrallë".

Mosha. Mosha nuk ishte e zgjedhur si e rëndësishme. Me përjashtim të pjesëmarrësit e moshuar 40-69 vjeç, të gjitha grupet kanë përdorur gjininë femërore për më shumë se 80% e njësive. Një shpjegim për sasinë më e madhe në fjalimin e grupit me moshë mesatare mund të jetë që tre nga katër burrneshat janë në këtë grup. Burrneshat përdorin gjininë mashkullore më shumë se të tjerët, atëherë kjo përqindja mund të reflektojë përqindja më e madhe e njësive që janë nga burrneshat.

6. Praktikat gjinore

Intervistat dhe materialet e shkruar ishin të pasur me të dhëna diskursive. Ka shumë mënyra që të folës dhe shkrimtarë mund të luajnë, theksojnë, ose minimizojnë gjininë e burrneshave. Megjithatë, të dhëna tregojnë edhe se burrneshat nuk pranohen gjithmonë si burra biologjikë. Nëse është me dashje ose është resultati i kufizimeve fizike, ndonjëherë burrneshat shkaktojnë identitetet gjinore që ndryshohen nga çfare është tipike mashkullore ose tipke femërore.

Regjistri. Kur intervistat ishin të kaluara në kafena, ishte normal që të dëgjojë burrneshat duke folur me kamerierë me zë të lartë dhe udhrat direkte. Fatkeqësisht, ndërveprime të tilla nuk ishin të regjistruara sepse shpech kanë ndodhur para ose pas intervistit zyrtar. Megjithatë, mund të shikojmë këtë mënyrë direkte, dhe ndonjëherë agresive, e të folurit në Shembullin 7. Liana ka mëuar që një amerikane e re ishte në një lidhje me një shqiptar, po ai e ka ndërpritur. Liana është i/e bindur që ky burrë ishte

vetëm duke përdorur këtë gru për një vizë, edhe nëse intervistuesja insiston që nuk ishte e vërtetë.

Shembulli 7.

LIANA: Eh?

INTERVISTUESJA 01: S'e di.

LIANA: Si "s'e di"?

INTERVISTUESJA 01: Atë e di vajza.

LIANA: Po vajza ka lidhje më me atë? Jo.

INTERVISTUESJA 01: Jo.

LIANA: Atëherë? Dole te fjala ime?

INTERVISTUESJA 01: Keni të drejtë.

LIANA: Ke mendimin tim eh?

INTERVISTUESJA 01: Keni të drejtë.

LIANA: Kam të drejtë por **tsk** egërsohem për këto gjëra. Dhe sikur ta di, për shembull, se kush është personi që ka arritur të fitojë zemrën e kësaj dhe ta plagosi zemrën e kësaj, unë e bëj 124 copash.

Në Shqipëri, kjo mënyrë e të folurit, në të cilin një person dominon bisedimin dhe flet me forcë, është e rezervuar tradicionalisht për burrat. Në të vërtetë, gjatë intervistave, disa nga të afërmit femra flisnin me zëra kaq të butë dhe të turpshëm që pajisjet e regjistrimit nuk kishte mundësi të kapnin shumë nga ajo që ata thanë. Ky pasivitet mund të jetë një reflektim i traditës për nuset dhe gratë e reja për të folur me zë të ulët.

Gjatë gjithë kohës së nusërisë ajo është e detyruar të zbatojë rregullat etnografike të të folurit me zë të ulët, shpesh duke mos lëshuar fare zë, por vetëm duke lëvizur buzët dhe duke mbajtur qëndrimin tipik të nusërisë me duart të vëna në mes në lartësinë e zemrës. (Gjovalin Shkurtaj 2010:244)

Sjellja. Shumë autorë dhe antropologë kanë komentuar për pamjen dhe sjelljen e burrneshave krejtësisht maskullore (Young 2000). Por ndonjëherë burrneshat sillen në mënyra të ndryshme nga meshkujt dhe nga femrat. Kjo është më shumë e dukshme për sa i përket mirëpritjes: të pamartuara, burrneshat janë mësuar të bëjnë punët "e nuses" si punët e shtëpisë dhe gatimit. Burrneshat janë edhe në një pozitë të veçantë sepse kanë mundësi të banojnë në vendet e grave dhe të ndërveprojnë me

gratë në një mënyrë që nuk mund ta bëjnë burrat biologjikë. Veçanërisht, disa burrnesha shprehen që janë mbrojtësit e grave, si e thotë Liana në Shembullin 8. (Shohim, megjithatë, që Liana flet për gratë sikur të jenë nga një grup i ndarë dhe Liana mban qëndrime të forta ndaj gjinisë.)

Shembulli 8.

LIANA: Ne e mbajmë kuranin, ne e mbajmë akoma atë betimin, ne e mbajmë që për zotin e shyqyr [?] nëqoftëse [?] ta kisha unë motër për shembull, këtë dhe të më bënte këtë dikush tjetër në fund te botës të shkonte unë do e gjeja. Po nuk do kalonte kollaj. Pse? Sepse karrakteri i femrës është shumë e brishte. Është shumë e njomë, është shumë elastike. Ndërsa meshkujt janë kështu, "hajt mo!"

Shmangia e gjinisë gramatikore. Pjesëmarrësit shpesh kanë lundruar në sistemin binar të gjinisë duke shmangur frazat që kërkojnë që ata të caktojnë një gjini për burrneshat. Në vend të kësaj, pjesëmarrësit kanë përdorur perifrazime dhe struktura që lejojnë të lidhin gjininë gramatikore me një fjalë prokurë për burrneshën në diskutim.

Mjeti më i zakonshëm ishte fjala "burrneshë". Gjinia gramatikore e saj është femërore. Atëherë pjesëmarrësit mund ta përdorin (me të gjitha dykuptimësitë që përfshihen) pa dhënë gjykim për gjininë gramatikore për individin (Shembulli 9).

Shembulli 9.

ARTIKULLI 02: **Burrneshat**, **të njohura** edhe "virgjëresha të betuara", [...]

Në vend të diskutimit për burrneshat, disa folës dhe shkrimtarë shpesh kanë vendosur karakterin ose personalitetin e burrneshave si temë të dënimit (Shembulli 10). Si pasojë kanë hequr përgjegjësinë për të bëtë një gjykim për gjininë e burrneshave.

Shembulli 10.

INTERVISTUESJA 03: Ishte kështu **natyrë e dashur e afruar**?

KUSHËRIRI I DYTË TË ROZAFËS: Po, po.

KUSHËRIRI I ROZAFËS: Shumë.

KUSHËRIRI I DYTË TË ROZAFËS: Shumë. Gjithmonë nuk ka-

SHOKU I ROZAFËS: Shumë **njeri i mirë.**

Perifrazimi është një strategi e zakonshme. Në intervistën me Ritën dhe të afërmit e Ritës intervistuesi nuk e ka përdorur fjalën "burrneshë" asnjëherë. Kur ai kishte nevojë të fliste për konceptin e burrneshave, përdorte një metodë rrethrrotullimore që përshkruante aktivitetet e ndryshme ose tiparet karakteristike që lidhen me burrneshat (Shembulli 11).

Shembulli 11.

INTERVISTUESI 02: Në atë periudhë që zgjodhe që të **punoje fort** edhe të bëje detyrën e një mashkulli, të- ta- ta ndieje veten mashkull ti që të **punoshe fort**, etj., etj. [...]

Krijimi i mashkulloritetit përmes zgjedhjes leksikore. Pavarësisht nga gjinia e tyre gramatikore, disa fraza mund të ndjellin imazhet fort mashkullore. Ky efekt është i amplifikuar në kontekstin e Shqipërisë, një vend që ka një histori të roleve shoqërore dhe praktikave shumë gjinore. Disa terma, si "djallëzuar", "punëtor" ose "fortë" mund të përdoren për meshkujt ose për femrat, por zakonisht lidhen me djemtë dhe burrat (Shembulli 12.a). Termat e tjerë janë lidhen më shumë me rolin e burrit në Shqipëri; çdo përpjekje për të përdorur këto fjalë për gratë do të ishte shumë e shënuar në kulturën shqiptare (Shembulli 12.b).

Shembulli 12.

a. GRUAJA E XHAXHAIT TË ROZAFËS: E veshu në [?], **punëtore, punëtore e thjesht** shumë.

b. INTERVISTUESJA 03: Ju e-, gjithmonë e keni pasur Fitoren si **kryefamiljare**?

FITORE: Po, si tip **kryefamiljare**. Këtë- këtu e kam, si më thënë- unë kam adresu vëllain.

INTERVISTUESJA 03: Ti- ti ke thënë vëllait që ta bërë t-

FITORE: Unë jam bërë **shkak**.

INTERVISTUESJA 03: Ti je bërë **shkak.**

FITORE: Po, po.

INTERVISTUESJA 03: Domëthënë janë me shkuesi?

FITORE: Po, po. Bie me shkuesi.

Shokët dhe familjat shpesh përdorin terma të dashurisë ose nofka për burrneshat. Këta terma zbulojnë kompleksitetet e identiteteve gjinore të burrneshave, pikërisht për njerëzit më të afër që i kanë njohur si vajza të reja. Në Shembuj 13.a-c të afërmit i shpjegojnë këta terma.

Shembulli 13.

a. INTERVISTUESJA 03: Si i thoshit juve, si i thërrisnit, a thërrisnit- KUSHËRIRI I DYTË TË ROZAFËS: Na- ne fëmijët ne e kemi thirr- ne e kemi thirr "dadë".
INTERVISTUESJA 03: "xhaxha" apo-
GRUAJA E KUSHËRIRIT TË ROZAFËS: Dadë.
INTERVISTUESJA 03: Dadë.
KUSHËRIRI I ROZAFËS: Dada.
KUSHËRIRI I DYTË TË ROZAFËS: Po, Dada.
INTERVISTUESJA 03: Dadë siç i themi ne "hallë".
KUSHËRIRI I DYTË TË ROZAFËS: Dada. Po, Dada.
I NJOHURI I ROZAFËS: Si "aunt". Është femërore por e tregon pak si burrë.
KUSHËRIRI I DYTË TË ROZAFËS: Ne fëmijët-
KUSHËRIRI I ROZAFËS: Jo, jo.
SHOKU I ROZAFËS: "Dadë" mund t'i thirrësh edhe nënës.
I NJOHURI I ROZAFËS: Po.
KUSHËRIRI I DYTË TË ROZAFËS USIN: Në shenj dashni, dashnije i kemi thirr.
SHOKU I ROZAFËS: A kupton tani?
KUSHËRIRI I DYTË TË ROZAFËS: Dadë.
SHOKU I ROZAFËS: Mund t'i thirrësh dhe gruas së axhës.
INTERVISTUESJA 03: Është aty dialekte domëthënë. Kuptoj.

b. MOTRA E RITËS: [?] rrit si burrë, kjo kalamajt e mi e thanë gjithë Babë Rita.
MBESA E RITËS: Uh we all call her Babë Rita.
RITA: Kala- kalamajt e lagjes-
MBESA E RITËS: It's her nickname.
E RITËS: Edhe lagjia.
RITA: Daja, daja.
STUDIUESJA: Atëherë është vëllai jot?
MOTRA E RITËS: Ehh, vëllai!
RITA: Ehh
STUDIUESJA: Daja, po.
MOTRA E RITËS: Uh çuni i madh, 52 vjeç- 52 vjeç [?]. 52 vjeç ai [?] vij unë nga Italia që të fala Babë Ritës. Është 52 vjeç dhe është mësu që-
INTERVISTUESI 02: Babë Ritës, okay yeah.
MOTRA E RITËS: Se unë kam shumë kohë ka [?] rrin në Itali se-

RITA: Edhe këtu Babë Rita [?].

C. INTERVISTUESJA 03: Po, si të thërrisnin, këta "dadë" të thërrisnin?

FITORE: Të gjithë "dadës" edhe heh! Tan edhe shoqnia edhe moshat e reja edhe të tan nipat e mbesat e- tashi s'më thirrin teze, hallë, për shembull tana më thirrin dadë. Edhe kur kam punu te klubi atje tan, edhe moshat e vjetra.

INTERVISTUESJA 03: Kuptoj, kuptoj. .

FITORE: Hah! "Dadë" njëri, "heh dadë" tjetër se ishin këta, për shembull, domëthënë nipët e me mbesat e-

Siç mund të shohim, termat për burrneshat janë, në fakt, kombinime të maskulinitetit dhe femininitetit. Për shembull, "Babë Rita" ilustron konotacionet kundërshtare të "babait" (mashkullor) dhe të emrit "Rita" (femërore).

7. Përfundimi

Rezultatat e kësaj analize zbulojnë që gjuha luan një rol të rëndësishëm në ndërtimin e identitetit gjinor për burrneshat. Faktikisht, roli i gjuhës është i dyfishtë; është një mënyrë për të shfaqur gjininë dhe është një dritarë për të parë ideologjitë gjinore të pjesëmarrësve. Gjinia gramatikore ishte vetëm një nga disa mënyrat për të treguar indentitetet gjinore. Si një e tërë, folësit dhe shkrimtarët kanë treguar tepër parapëlqim për variantin femëror kur ishin duke folur për burrneshat. Ishte kështu edhe kur burresnhat ishin folës. Megjithatë, analiza zbulon që disa faktorë gjuhësorë dhe shoqërorë kanë ndikim të rëndësishëm në përdorimin e variantit mashkullor: Lloji, Gjinia gramatikore e mëparshme, Mjeti dhe Lidhja me burrneshën.

Analiza e praktikave gjinore përforcon idenë se burrneshat kanë arritur të kenë pamje tepër burrërore. Edhe kur gramatika është femërore, konotacionet e shumë termave janë mashkullorë. Burrneshat janë krenare për sakrificat që i kanë bërë për të jetuar të lira dhe për t'u kujdesur për të tjerët. Është e qartë në përdorimin e njësive femërore për të theksuar arritjet profesionale. Por, burrneshat kanë edhe disa strategji për të t'i përshtatur me burrat, duke përfshirë sjelljet dhe regjistrat tipikisht të rezervuara për meshkujt.

Është e mundur që një person mund t'i interpretojë këto transicione të suksesshme nga femra tek mashkulli si një shenjë që barazia gjinore është më e zvhilluar në Shqipëri sesa në shumë shtete perëndimore. Pas të gjithave, lëvizja për të drejtat civile transgjinore në Amerikë vetëm sa ka filluar të marrë vrull. Megjithatë, konkluzionet e këtij studimi sugjerojnë një realitet të ndryshëm. Në vend se duke krijuar role të reja gjinore, burrneshat i fuqizojnë rolet që ekzistojnë. Ato zgjedhin mes dy identiteteve tradicionale që janë të përshkruara nga një shoqëri patriarkale.

Carly DICKERSON, Universiteti Ohio State

THE LINGUISTIC EXPRESSION OF GENDER IDENTITY: THE BURRNESHA OF ALBANIA

Summary

The linguistic dimensions of transgenderism have typically been studied within qualitative frameworks, and have tended to focus on marginalized groups, such as the hijras (Kulick 1997), the travestis (Hall & O'Donovan 1996) and the 'yan daudu (Gaudio 2014). Not only are there no quantitative studies of sociolinguistic variation in transgender speech generally, there is also a lack of research on transgender individuals who occupy prominent positions in mainstream society and are treated on par with their cisgender cohort.

This paper focuses on the linguistic aspects of the construction of masculine identities by the burrnesha (also known as 'sworn virgins') of northern Albania and Kosova: biological females who have become 'social men'. Unlike other 'third genders' (Kulick 1999), the burrnesha are motivated not by personal identity or sexual desire, but by the need to fulfil patriarchal roles within a traditional social code. Although they are accepted and treated as men in their community, burrnesha do not marry or engage in sexual relationships, and are thus seen as honourable and self-sacrificing (Young, 2000). Under these circumstances, how do burrnesha construct and express their identity linguistically, and how do others engage with this identity? Do burrnesha follow the linguistic construction of masculinity of biological males, or do they set themselves apart through the use of both male and female linguistic practices?

I examine the effects of social and linguistic factors on variation in the use of grammatical gender in the speech of burrnesha and others in their communities, based on conversations recorded in 2014 during fieldwork in Durrës, Elbasan, Shkodra, and surroundings areas. Quantitative analysis reveals that choices in the grammatical gender used to refer to burrnesha are linked to the speaker's relationship to them, the time period being referred to (pre- or post-transition), and the expression of particular traits (such as pride or strength). Situated within a culture that embraces women becoming men, this study sheds light onto the linguistic practices used by a community in the co-construction of gender.

Bibliografia

Camaj, Martin. *Albanian Grammar*. Wiesbaden: Otto Harrassowitz, 1984. Print.

Corbeill, Anthony. "*Genus quid est?* Roman Scholars on Grammatical Gender and Biological Sex." *Transactions of the American Philological Association* 138.1 (2008): 75-105. Web.

Corbett, Greville G. "Grammatical Gender." *Encyclopedia of Language & Linguistics*. 2nd Edition. Ed. Keith Brown. Oxford: Elsevier, 2006. 749-756. Web.

Elsie, Robert. (2012). "Northern Albanian Culture and the Kanun. Paper given at the Symposium: *Albanese Tradities en Taal: 100 Jaar Onafhankelijk Albanië/Albanian Language and Culture: 100 Years of Independence*, University of Leiden, 10 Nov. 2012. Web.

Enchanted Learning. "Outline Map of Albania." Retrieved from http://www.enchantedlearning.com/europe/albania/outlinemap, 2015. Web.

Fauconnier, Gilles and Eve Sweetser. *Spaces, Worlds, and Grammar*. Chicago: University of Chicago Press, 1996. Web.

Friedman, Victor A. "Albanian in the Balkan Linguistic League: a reconsideration of theoretical implications." *Studia Albanica* 1 (2005): 33-43. Web.

Friedman, Victor A. "Balkans as a Linguistic Area." *Encyclopedia of Language & Linguistics*. 2nd Edition. Ed. Keith Brown. Oxford: Elsevier, 2006. 657-672. Web.

Friedman, Victor A. and Brian D. Joseph. *The Balkan Languages*. Cambridge: Cambridge University Press, 2016. Web.

Friedman, Victor A. *Studies on Albanian and Other Balkan Language*. Peja: Dukagjini, 2004. Web.

Garrod, Simon and Martin J. Pickering. "Joint Action, Interactive Alignment, and Dialog." *Topics in Cognitive Science* 1 (2008): 292-304. Web.

Gaudio, Rudolf P. "Acting Like Women, Acted Upon: Gender and Agency in Hausa Sexual Narratives." *Queer Excursions: Retheorizing Binaries in Language, Gender, and Sexuality.* Ed. Lal Zimman, Jenny Davis, and Joshua Raclaw. New York: Oxford University Press, 2014. 170-194. Web.

Ivanova-Sullivan, Tanya. *Theoretical and experimental aspects of syntax-discourse interface in heritage grammars*. Leiden, The Netherlands: Brill, 2014. Web.

Kilarski, Marcin and Grzegorz Krynicki. "Not arbitrary, not regular: The magic of gender assignment." *Perspectives on variation: Sociolinguistic, historical, comparative*. Ed. Nicole Delbecque, Johan van der Auwera, and Dirk Geeraerts. Berlin: Mouton de Gruyter, 2005. 235-252. Web.

Kilarski, Marcin. "On Grammatical Gender as an Arbitrary and Redundant Category." *History of linguistics 2005: Selected papers from the Tenth International Conference on the History of the Language Sciences (ICHOLS X), 1-5 September 2005, Urbana-Champaign, Illinois*. Ed. Douglas A. Kibbee. Amsterdam - Philadelphia: John Benjamins, 2007. 24-26. Web.

Kulick, Don. "The Gender of Brazilian Transgendered Prostitutes." *American Anthropologist* (1997): 574-585. Web.

Kulick, Don. "Transgender and Language: A Review of the Literature and Suggestions for the Future." *GLQ: A Journal of Lesbian and Gay Studies* 5.4 (1999): 605-622. Web.

Lloshi, Xhevat. "Albanian." *Handbuch der Südosteuropa-Linguistik*. Ed. Uwe Hinrichs. Wiesbaden: Harrassowitz Verlag, 1999. 277-288. Web.

Newmark, Leonard. "Nyje". *Oxford Albanian-English Dictionary*. Oxford: Oxford University Press, 1999. Print.

Pickering, Martin J. and Ferreira, Victor S. "Structural Priming: A Critical Review." *Psychological Bulletin* 134.3 (2008): 427-459. Web.

Sankoff, David, Sali A. Tagliamonte, and Eric Smith. *Goldvarb X: A variable rule application for Macintosh and Windows*. Department of Linguistics, University of Toronto, 2005. Web.

Šarčević, Predrag. "Sex and Gender Identity of 'Sworn Virgins' in the Balkans." Retrieved from http://www.udi.rs/articles/genderPS.pdf, 2004. Web.

Scherre, Maria Marta Pereira and Anthony J. Naro. "Marking in Discourse: 'Birds of a Feather'." *Language Variation and Change* 3.1 (1991): 23-32. Web.

Shkurtaj, Gjovalin. *Etnografi e të folurit të shqipes*. Tiranë: Shtëpia Botuese Morava., 2010. Web.

Tarifa, Fatos. "Balkan Societies of 'Social Men': Transcending Gender Boundaries." *Societies Without Borders* 2.1 (2007): 75-92. Web.

Young, Antonia and Jenna Rice. "De-centring Albanian Patriarchy? Sworn Virgins and the Re-negotiation of Gender Norms in the Post-Communist Era." *Albania: Family, Society and Culture in the 20th Century*. Ed. Andreas Hemming, Gentiana Kera, and Enriketa Pandelejmoni. Berlin: LIT Verlag, 2012. 163-173. Print.

Young, Antonia and Larenda Twigg. "'Sworn virgins' as Enhancers of Albanian Patriarchal Society in Contrast to Emerging Roles for Albanian Women." *Etnološka tribina* 32.39 (2009): 117-134. Web.

Young, Antonia. (Interviewee). *Sworn Virgins.* Retrieved from National Geographic Web site: http://video.nationalgeographic.com/video/albania_swornvirgins, 2008. Web.

Young, Antonia. *Women Who Become Men: Albanian Sworn Virgins*. Oxford/NewYork: Berg, 2000. Print

Zelinsky-Wibbelt, Cornelia. *Discourse and the Continuity of Reference: Representing Mental Categorization*. Berlin: Mouton de Gruyter, 2000. Web.

Zufferey, Sandrine. *Acquiring Pragmatics: Social and Cognitive Perspectives*. New York, NY: Routledge, 2015. Web.

Artur KARASIŃSKI, Torunj

TRASHËGIMIA GJUHËSORE DHE LETRARE SHQIPE NË BIBLIOTEKËN NEWBERRY

Titulli i fjalës sime *Trashëgimia gjuhësore dhe letrare shqipe në bibliotekën Newberry* lidhet drejtpërdrejt me temën e konferencës *Studimet Albanistike në Amerikë*.

Shumica dërrmuese e fjalimeve dhe kumtesave të mëparshme e kanë konfirmuar faktin se marrëdhëniet mes Shqipërisë, Kosovës dhe Amerikës janë të shumta dhe të vlefshme në fushën e gjuhës dhe letërsisë. Këto kontakte janë të gjata dhe me siguri do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Unë do të doja të përqëndrohem në rolin e Bibliotekës Shkencore Newberry në Çikago dhe të paraqes veprat më të vlefshme të letërsisë shqipe, leksikologjisë dhe dialektologjisë, që gjenden në Newberry. Ato janë pjesë e një prej koleksioneve linguistike më të rëndësishme të bibliotekës që quhet Koleksioni i Princit Luis Lucien Bonaparte.

Siç theksojnë vetë bibliotekarët, aktualisht Biblioteka Newberry nuk mbledh librat dhe artikuj për gjuhë dhe gjuhësi, edhe pse në vitin 1901 u bë poseduese e koleksionit të librave gjuhësorë të botuesit dhe filologut të famshëm Princit Luis Lucien Bonaparte - nipi i perandorit Napoleon I.

Disa fjalë në përgjithësi për këtë koleksion – përbëhet nga gati 18,000 libra dhe mund të themi me siguri që pasqyron gjendjen e kërkimeve gjuhësore në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Shumë i rëndësishëm është edhe fakti që koleksioni i tillë nuk është fokusuar në hulumtime të gjera për greqishten e lashtë dhe latinishten – që atëherë ishte një trend, por është e pasur në gjuhë të vogla, të izoluara - atë gjuhë që

ne jemi më shumë të interesuar (dhe natyrisht, ndër të tjera, për shqipen, por këtu duhet theksuar se Luis Lucien Bonaparte e përqendroi interesin e tij të veçantë te gjuha baske).

Koleksioni përmban shumë gramatika dhe fjalorë të gjuhëve të ndryshme europiane dhe disa nga jashtë Europës. Është plot me libra në gjuhët shqipe, baske, frize, gjuhët baltike si letonishtja dhe lituanishtja. Përveç kësaj, përmban shumë studime dialektologjike për këtë gjuhë po ashtu në italisht, anglisht dhe gjuhë të tjera kelte. Tema e teksteve është gjithashtu jashtëzakonisht e gjerë (nga librat e fëmijëve përmes almanakëve për katekizma dhe veprave më të mëdha të shenjta si kopje të Biblës në gjuhë të ndryshme).

Princi Luis Lucien Bonaparte ka lindur në Angli më 4 Janar 1813, është djali i Lucien Bonaparte, vëllait të Napoleonit I, Perandorit të Francës. Luis Lucien ka studiuar në një shkollë jezuite në Urbino (në Itali), pas së cilës ai ka studiuar mineralogji dhe kimi në Florencë. Kur ishte 25 vjeç mori pjesë në Kongresin e parë të shkencëtarëve italianë në Piza më 1838. Në veprën e tij të parë shkencore merrej me mineralogji, por u largua shpejt prej saj dhe u bë filolog. Në vitin 1847 ai botoi në Florencë në latinisht veprën e tij të parë në fushën e gjuhësisë krahasuese „*Specimen Lexici Comparativi*", ku ai punoi në gjuhët moderne, e cila ishte atëherë një risi, sepse universitetet ishin të interesuar kryesisht në filologji klasike - latine dhe greke.

Gjatë qëndrimit të tij në Francë, ai hyri në politikë. Megjithatë, shumë pak i interesuar për të, u zhvendos në Londër për ta rimarrë punën shkencore. Arritjet shkencore të Bonaparte-it përbëhen kryesisht nga veprat nga fusha e gjuhësisë krahasuese dhe dialektologjisë. Si dialektolog kishte një meritë të veçantë në fushën e kërkimeve mbi dialektet e gjuhëve angleze dhe italiane, si dhe veçanërisht të gjuhës baske. Sidomos kjo e fundit i solli atij famë të madhe. Gjuha baske është gjuhë europiane që nuk i përket grupit indo-europian dhe nuk ka të bëjë me asnjë gjuhë në botë. Bonaparte (i cili e fliste rrjedhshëm gjuhën baske) hartëzoi dialekte baske në të dy anët e Pirenejeve (*Carte de province Sept të*

Baskisë) dhe përgatiti tabelën e foljeve në këtë gjuhë (*Le verbe Baske en tablo*), të dyja botuar në vitin 1869.

Bejtullah Destani, studiues shqiptar dhe themelues i Qëndrës për Studime Shqiptare në Londër, në librin e tij të fundit *Albanian Dialects Prince Louis – Lucien Bonaparte* kushtuar princit dhe punës së tij për dialektologjinë shqipe (botuar në mars 2014 në Londër) thekson se kontaktet e Bonaparte-its me gjuhën shqipe dhe dialektet e saj kanë qenë para së gjithash në Itali, me të folmen e arbëreshëve, dhe në Londër. Bonaparte u përqendrua jo vetëm në studimin gjuhësor, por edhe në ndryshimet dialektore brenda të folmes së arbëreshëve. Libri me studimet e Bonaparte-it përfshin harta dialektore të detajuara të arbëreshëve të Italisë. Nga ky këndvështrim studimi ka vlera të mëdha demografike dhe etnografike për përqendrimet dhe shtrirjen e arbëreshëve në Itali në fund të shekullit nëntëmbëdhjetë.

Jeni Myftari në shqyrtimin e shkurtër të librit e Destanit me pak fjalë na jep një përmbledhje të dy veprave të rëndësishme të Bonaparte-it: *Princi Bonaparte në studimin e tij "Albanians in Terra d'Otranto" (Shqiptarët në Tokën e Otrantos), të viteve1882-84, sjell një material të detajuar me emrat e fshatrave ku shqipja arbëreshe flitej akoma në fund të shekullit XIX. Veç kësaj ai jep një pasqyrë përmbledhëse të tingujve të përdorur në dialektin gegë dhe toskë dhe nëndialektet që rrjedhin prej tyre, duke përfshirë edhe përdorimin e këtyre tingujve në të folmen e Shkodrës, atë greke (moderne), të Kalabrisë dhe të Sicilisë.*

Sipas Destanit, kjo tabelë e tingujve është e para e llojit të saj. Ai thekson se punë të ngjashme, por jo kaq të detajuar, ka bërë para tij edhe albanologu i famshëm gjerman Johan Georg von Hahn, me të cilin Bonaparte ishte ne kontakt profesional dhe privat. Por Hahn nuk ishte i vetmi person i merituar për gjuhën shqipe me të cilin Luis Lucien ka mbajtur në kontakte të ngushta. Duhet të përmenden këtu, ndër të tjera, figura si Konstandin Kristoforidhi ose Dhimitër Kamarda.

Studimi i dytë i botuar nga Princi Bonaparte-i në revistën akademike "Transactions of the Philological Society" më 1888-1890 jep një listë

të gjuhëve të huaja që janë folur në 69 provincat e Italisë, si dhe të vendeve ku këto gjuhë janë folur. Në këtë edicion të dytë, Bonaparte-i paraqet një studim më të zgjeruar dhe të korrigjuar të studimeve të tij të edicionit të parë. Po në këtë studim gjejmë edhe një tabelë të simboleve fonetike shqiptare, një minifjalor, të shoqëruar nga sqarimi për mënyrën e formimit të gjinisë femërore dhe mashkullore në gjuhën shqipe. Po kështu gjejmë edhe disa fraza të njëjta biblike të paraqitura në të gjitha dialektet e marra në studim në këtë punim, gjithsej nëntë shembuj të ndryshëm që paraqesin nëntë dialektet që fliten ndër arbëreshët e Italisë (Myftari 2014).

Këto dy analiza, edhe pse jo shumë voluminoze, janë jashtëzakonisht të rëndësishme për studimin e leksikologjisë së shqipes së fundit të shekullit nëntëmbëdhjetë. Punimi është i vlefshëm për të studiuar shqipen e vjetër të mbartur nga arbëreshët në Itali gjatë shpërnguljeve të tyre kryesisht në mesjetë nga vitet 1400 e në vazhdim deri në vitet 1800.

Përveç kësaj, Luis Lucien Bonaparte-i ka vepruar si botues. Gjatë sundimit të Napoleonit III kishte marrë një pension vjetor prej 130 000 frangash ari, pastaj ai gjithashtu mori një pension prej Mbretëreshës Viktoria dhe në fund ia la trashegim të pasur nipit pa fëmijë Lord Stuart. Në shtëpinë e tij në Londër Bonaparte-i hapi një shtëpi botuese ku ai ka botuar veprat dhe përkthimet e Biblës në gjuhë të ndryshme, duke përfshirë këtu përkthimin e parë të Ungjillit të Shën Mateut në gjuhë galiciane, që flitet në krahinën spanjolle e Galicisë. Me prodhimin e librave Bonaparte ka përdorur trajnimin dhe përvojën e tij si kimist dhe ka eksperimentuar me teknika të ndryshme për prodhimin e bojës dhe letrës.

Luis Lucien vdiq në Itali (në Fano pranë Urbinos) më 3 nëntor 1891. Trupi i tij u kthye në Angli dhe u varros në varrezat e kishës katolike romane (Shën Maria në Kensal Green) në veriperëndim të Londrës. Njoftimi për vdekjen e Princit Luis Lucien u botua në të gjitha gazetat më të mëdha të gjuhës angleze si The Guardian, London Evening News, Oakland Tribune etj.

Ndër veprat më të vjetra, më të vlefshme dhe më të rëndësishme

që janë në koleksionet e bibliotekës duhet të përmenden:

Fjalori latinisht–shqip i Frang Bardhit, botuar në Romë në vitin 1635

Autori: Bardhi, Frang, 1606-1643.

Titulli: Dictionarivm Latino Epiroticvm, vna cum nonnullis vstiatioribus loquendi formulis, per R.D. Franciscvm Blanchvm.

Botimi: Romae: Typis Sac. Congr. de Propag. Fide, 1635.

Cuneus Prophetarum/ Çeta e Profetëve e Pjetër Bogdanit botuar në Padova në vitin 1685

Autori: Bogdani, Pjetër, rreth 1625-1689.

Titulli: Cvnevs prophetarvm de Christo ... et eivs evangelica vertitate, italicè, et epiroticè contexta ...

Botimi: Patavii: Ex typographia Seminarii, 1685.

Autori: Bellarmino, Roberto Francesco Romolo, Saint, 1542-1621.

Titulli: Dottrina christiana: composta per ordine della fel. me. di Papa Clemente VIII./ dal R.P. Roberto Bellarmino ... ; tradotta in lingua Albanese dal Reuer. don Pietro Budi da Pietra Bianca.

Botimi: In Roma: Nella Stampe della Sac. Cong. de Prop. Fide, 1664.

Gramatika e parë Shqipe e shkruar nga Françesco Maria da Leçe botuar në Romë në vitin 1716

Katekizmi i Kazazit – prift jezuit shqiptar, kryepeshkopi i Shkupit dhe zbuluesi i të vetmit egzemplar të ruajtur deri me sot të Mesharit të Gjon Buzukut.

Autori: Casasi, Jovan Nikolovich.

Titulli: Breve compendio della dottrina cristiana, tradotta in lingua albanese ... da un nazionale del regno di Servia ...

Botimi: Roma: Nella Stamperia della S. Congr. de propaganda fide, 1743.

Shumica e veprave (mbi një qind tituj) rrjedh nga shekulli nëntëmbëdhjetë. Ndër të tjera:

Autori: De Rada, Girolamo, 1814-1903.

Titulli: Poesie albanesi del secolo XV. Canti di Milosao, figlio del despota di Scutari ...

Botimi: Napoli: Tipi del Guttemberg, 1836.

Autori: De Rada, Girolamo, 1814-1903.

Titulli: Scanderbeccu i pa-faan, storie del secolo XV ...

Botimi: Corigliano calabro: Tip. albanese, 1872.

Autori: Christophoridēs, Kōnstantinos, 1827-1895.

Titulli: Psalteri. Kethuem mbas Ebraïštese viëtere Škip nde ǵuhe Gegenište prei Konstantinit Kristoforidit, Elbasanasit.

Botim: Konstantinopol: Nde štupa-škroỹ te A.H. Boyaǵianit ..., 1868.

Autori: Camarda, Demetrio, 1821-1882.

Titulli: Alfabeto generale albano-epirotico.

Botimi: [Livorno: Tip. G. Fabbreschi e c., 1869]

Autori: Camarda, Demetrio, 1821-1882.

Titulli: Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese/ per D. Camarda.

Botimi: Livorno, 1864.

Autori: Medias, Andreas.

Titulli: Jeta e sceitit sc' Gnon Berchmans t'Scocnis Jesu Krisctit ...

Botimi: Rom: Me sctamp t'Kuvennit s. t'propagands, 1888.

Autori: Christoforides, Constantine.

Titulli: Abetãr škĭp.

Botimi: [Konstantinopol: A.H. Boyagianit, 1867?]

Por edhe studime të autoreve dhe hulumtuesve nga jashtë Shqipërisë dhe Kosovës që janë dedikuar për Shqipërinë dhe për gjuhën dhe letersinë shqipe:

Autori: Hahn, J. G. von (Johann Georg), 1811-1869.

Titulli: Albanesische Studien/ von Johann Georg von Hahn.

Botimi: Jena: Verlag von Friedrich Mauke: Druck der kaiserlich-königlichen Hof- und Staatsdruckerei in Wien, 1854.

Autori: Miklosich, Franz, Ritter von, 1813-1891.

Titulli: Albanische Forschungen/ von Franz Miklosich.

Botimi: Österreichische Akademie der Wissenschaften. Philosophisch-Historische Klasse. Denkschriften;1870

Autori:: Bonaparte, Louis-Lucien, prince, 1813-1891.

Titulli: ***Albanian*** in Terra d'Otranto ...

Botimi: [London, 1885?]

Këto janë vetëm disa vepra të një rëndësie të madhe për letërsinë shqipe, të theksuara dhe detajuara nga një shumëllojshmëri e librave dhe artikujve të rëndësishëm në përmbledhjen e Bibliotekës Newberry, në veçanti në koleksionin e Princit Luis Lucien Bonaparte.

Biblioteka gjithashtu jep bursa për kërkime shkëncore për studiuesit nga e gjithë bota. Ajo ofron bursa afatshkurtër (një - dy muaj) dhe bursa afatgjate. Informacioni i detajuar mund të gjendet lehtë në faqet e

internetit të bibliotekës.

Është e qartë se në sajë të Koleksionit të Princit Bonaparte Biblioteka Newberry në Çikago është një pikë e rëndësishme në hartën e studimeve albanistike në Amerikë. Dhe të gjithë të interesuarit për gjuhësi – gjuhësi diakronike në mënyrë të veçantë, në studimet e tyre duhet ta marrin në konsideratë këtë koleksion.

Bibliografi:

Cheliah, Sh.L., de Reuse, W.J., 2011, *Handbook of Descriptive Linguistic Fieldwork*, Springer, ISBN: 978-90-481-9025-6.

Destani, Bejtullah (red.) 2014*, Albanian Dialects Prince Louis – Lucien Bonaparte, Londër,* Qendra e Studimeve Albanologjike në Londër, ISBN 978-0954604141.

Salaburu, Pello, 2011, *L. L. Bonaparteren Erakusketa: Bonaparte, Forerunner of modern dialectology*, Londër.

Burime elektronike:

Biblioteka Newberry, http://www.newberry.org

Jeni Myftari, 2014, *"Albanian dialects". Studimet filologjike të Bonaparte-s mbi arbërishten në një vëllim në anglisht***,** ***http://www.shqiptariitalise.com/histori/histori/histori/albanian-dialects-studimet-filologjike-te-bonaparte-s-mbi-arberishten-ne-nje-vellim-ne-anglisht.html***

Newberry kataogu elektronik, https://ishare.carli.illinois.edu/nby/cgibin/Pwebrecon.cgi?DB=local&CNT=20&Search_Arg=&Search_Code=NAME

Newberry – gjuhësi historike, http://www.newberry.org/historical-linguistics

Out of the confusion of tongues: Louis-Lucien Bonaparte (1813–1891), British Library's detailedbiography, http://www.bl.uk/reshelp/findhelplang/spanish/hispcoll/hispexhibl/bonaparte/bonaparte.html

Artur KARASIŃSKI, Torunj

ALBANIAN LANGUAGE AND LITERARY HERITAGE AT THE NEWBERRY LIBRARY

Summary

The paper "Trashëgimia gjuhësore dhe letrare shqipe në bibliotekë Newberry" concerns the role of Newberry Library in Chicago and the characteristics of one of the most important linguistic and literary Collection of the Prince Louis Lucien Bonaparte. Part of the Albanian heritage that left this English linguist and dialectologist is a large number of positions of the Albanian literary classics including the beginnings of written literature as well as major works that began to appear along with the literary revival in Albanian lands and diasporas in the second half of the nineteenth century – the begging of Rilindja period. In addition to the characteristics of the most important items of this collection, in the paper would be included practical information related to access to this enormous collection and scholarships that offers Newberry Library in Chicago.

Mario de MATTEIS, Ruhr-Universität Bochum dhe Universiteti: Durrës, Elbasan, Tiranë, Tetovë

MËSIMI DYGJUHËSH, INTERKULTURALITETI - A ËSHTË MËSIMI I DISIPLINAVE LËNDORE NË NJË GJUHË TË HUAJ NJË MODEL PËR ARSIMIN E ARDHSHËM KOSOVAR?

1.0 Politika gjuhësore e Bashkimit Europian

Neni 126 i Traktatit të Mastrihtit, i cili është nënshkruar nga Këshilli Europian më 7 shkurt 1992 në Mastriht, Holandë dhe ka hyrë në fuqi më 1 nëntor 1993, përcakton:

> *Komuniteti do të kontribuojë në zhvillimin e arsimit cilësor duke inkurajuar bashkëpunimin mes shteteve anëtare* ...; në vazhdim:
> *Komuniteti duhet të synojë zhvillimin e dimensionit europian në arsim, veçanërisht , nëpërmjet mësimdhënies dhe shpërndarjes së gjuhëve të shteteve anëtare* ...

Më tej artikulli 128 i të njëjtës marrëveshje shton:

> *Komuniteti do të kontribuojë në lulëzimin e kulturave të shteteve anëtare, duke respektuar diversitetin e tyre kombëtar dhe rajonal dhe në të njëjtën kohë duke e çuar përpara trashëgiminë e përbashkët kulturore .*

Bashkimi Europian mbështet përdorimin e gjuhëve të qytetarëve të tij si një faktor të transparencës, efikasitetit dhe legjitimitetit. (Salvi 2009:7)

BE-së ka theksuar në shkallën më të lartë rëndësinë e kësaj politike gjuhësore të veçantë nëpërmjet emërimit të një mbështetësi të kësaj strategjie; kështu BE emëron sllovakun Jan Figel (koha e ushtrimit të postit 2004-2009) në postin e komisionerit Europian për arsimin, kulturën,

plurilinguizmin dhe rininë.

Propozimi i grupit të punës duhet të inkurajojë çdo qytetar europian, të mësojë "personal adoptive language" si një gjuhë që shpreh identitetin etnik dhe afektiv dhe që mund të përdoret lirisht për qëllime profesionale dhe komunikimi ndërkombëtar.

Çdo qytetar i Bashkimit Europian duhet të jetë në gjendje të flasë mirë përpos gjuhës së vet amtare (L1), të paktën një gjuhë tjetër - më mirë, dy gjuhë të tjera - të Komunitetit Europian. Programi 2007-2009 për *arsimimin gjatë tërë jetës dhe trajnim* (www.europa.eu.int), i cili u propozua nga Parlamenti dhe Këshilli Europian, ofron një plan të integruar veprimi për arsim dhe trajnim, objektivat specifike të të cilit përfshijnë promovimin e mësimit të gjuhës se huaj dhe nxitjen e diversitetit gjuhësor.

Në të gjitha vendet anëtare të BE-së është iniciuar dhe është pritur pozitivisht arsimi dygjuhësh (Wolff 2002: 7-13). Shih: *A rewarding challenge. How language diversity could strengthen Europe*. Europäische Kommission, Bruxelles 2008, në:

(www.ec.europa.eu/education/languages/pdf/doc 1646_en.pdf).

2.0 Eurydike

Për koordinimin e mësimit bilingual në rrafsh europian është krijuar një rrjet (Eurydike), i cili mbledh informacione dhe analiza në lidhje me sistemet europiane të arsimit si dhe me fushat e politikës që kanë të bëjnë me to.

Që nga viti 2011, Eurydike përbëhet nga 37 njësi kombëtare dhe është i pranishëm në të gjitha 33 vendet që bashkëpunojnë në fushën e të mësuarit *gjatë gjithë jetës* të programit të Bashkimit Europian (Shtetet Anëtare të BE-së, vendet e EFTA-s dhe Turqia).

Eurydike koordinohet dhe drejtohet nga Agjencia Ekzekutive për Arsimin dhe Kulturë në Bruksel, e cila kujdeset për publikimet e bazës së të dhënave të nxjerra.

2.1 Edukimi dygjuhësh në shkollat e detyrueshme

Futja e mësimit dygjuhësh në shkollat e mesme dhe shkollat teknike (të specializuara), veçanërisht në Republikën Federale të Gjermanisë dhe në Austri, daton në gjysmën e dytë të shekullit të njëzetë. Fillimet e mësimit dygjuhësh në Gjermani u mbështeten në vendimet e marrëveshjes së bashkëpunimit gjermano-francez të vitit 1963 (Werner, 2006: 49 e vijim).

Hapja e seksioneve të tilla dygjuhëshe për të gjitha nivelet e shoqërisë solli një ridimensionim të thellë të shoqërisë moderne në shumë fusha të jetës.

2.2 Arsimimi dygjuhësor, kultura dhe ndërkulturaliteti

Numri i deklaratave, me anë të të cilave në Europë u bënë përpjekje të shumta për të përcaktuar konceptin pedagogjik të "edukimit dygjuhësh" në një formë të përshtatshme, është shumë i madh.

Çdo deklaratë e dhënë ndryshon jo vetëm nga shteti në shtet por edhe në lidhje me funksionet e ndryshme që çdo shtet i BE-së i dedikon kulturës në kurrikulat e lëndëve mësimore, për shembull:

a) Përdorimi i një gjuhe të huaj (gjermane), si gjuhë e punës për mësimin e lëndëve të tilla si matematika, gjeografia apo fizika njihet në Gjermani si "mësim dygjuhësor disiplinor";
b) Mësimi i çfarëdolloj lënde mësimore nëpërmjet integrimit të një gjuhe tëhuaj, gjë që në Francë njihet emërtimin "EMILE" (= *Enseignement d'une matière par l'intégration d'une langue étrangère*);
c) Mësimi nëpërmjet integrimit të gjuhës së huaj dhe përmbajtjeve kulturore, gjë që në hapësirën anglofone njihet me termin "CLIL".

2.3 Të mësuarit ndërkulturor dygjuhësh

Në lidhje me përcaktimet e përgjithshme të përmendura më lart në mënyrë të përmbledhur mund të shtojmë edhe disa informacione plotësuese si:

a) Një pamje kontrastive të botës,
b) Një ndryshim të plotë të perspektivës

dhe, për këtë arsye, një reflektim të mprehtë ndaj realitetit të ekzistencës së gjithsecilit në drejtim të shihen edhe nga këndvështrimi personit që ndodhet përballë nesh. (de Matteis, 2013: *infra*)

Sipas kësaj lëndët dhe kombinimi i tyre nga fushat e:

A) Shkencave shoqërore (histori, gjeografi, sociologji),
B) Shkencave natyrore (matematikë, fizikë, biologji apo teknologji) ose
C) Arteve (art, muzikë dhe sport)

duhen zgjedhur për çdo vend të BE-së me shumë kujdes në mënyrë që modelet e integruara mësimore dygjuhëshe të jenë në harmoni të plotë me nevojat reale të secilit vend të BE-së. (Wolff, 2002: 7-13)

2.4 Kurrikula

Për planet mësimore të kopshteve dhe shkollave fillore nuk ka kërkesa për dygjuhësi nga ana e Komunitetit Europian, me përjashtim të Estonisë dhe të pjesës gjermanofolëse të Belgjikës, në të cilat artet duhet të zhvillohen në një gjuhë të huaj. (Wolff, 2005: *infra*)

Në lidhje me planet e shkollave të ciklit të dytë fillor, të shkollave të mesme, të gjimnazeve konstatohen këto ndryshme:

a) Çdo shkollë e mesme në Europë mund ta përcaktojë vetë grupin e lëndëve, të cilat janë të domosdoshme për strukturën e secilës shkollë;
b) Në shkollat e ciklit të dytë në Europë, çdo shkollë mund të përcaktojë vetë grupin e lëndëve të përshtatshme dhe të domosdoshme për vetë strukturën e shkollës (zgjedhja e gruplëndëve në Spanjë, Francë, Itali, Irlandë, Angli dhe në Poloni, Hungari dhe Austri bëhet në një nga variantet e sipërpërmendura A), B), C));
c) Në shtetet e tjera të BE-së, p.sh. në Republikën Ceke apo në Rumani, mund të zgjidhen vetëm lëndët e shkencave natyrore

dhe sociale;

d) Në Suedi, në Finlandë, në Hollandë dhe Bullgari mund të zgjidhet grupi i lëndëve shkencore, sociale dhe të artit.

2.5 Orët e mësimit bilingual dhe planet mësimore në BE-së

Një indikator të mirë për të gjykuar mbi mënyrën e kombinimit të përmbajtjes me gjuhën në sistemin shkollor të aplikuar në shtetet anëtare të BE-së mund të na e ofronte numri i orëve mësimore të planifikuara për secilën lëndë. Por, nuk është kështu, sepse sasia e orëve mësimore në secilin shtet anëtar të BE-së është e ndryshme çka i bën të pamundura krahasimet.

Sipas stadit të sotëm, bazuar në portalin e Goethe-Institutit mund të konstatojmë që:

a) Për shumë vende anëtare, si Finlanda, Italia dhe Sllovenia numri i orëve mësimore nuk është përcaktues për mënyrën e *kombinimit*;
b) Shtete të tjera të BE-së, si pjesa valoniane e Belgjikës, Republika Çeke, Austria dhe Gjermania ofrojnë të dhëna të përafërta mbi sasinë e orëve;
c) Në shtete të tjera anëtare, si në zonat autonome të Spanjës, në Francë, Hollandë dhe Poloni raportet lëvizin brenda një kufiri të caktuar (20% deri 25% të orëve të përgjithshme), ndërkohë që;
d) Malta (gjuhët mateziane dhe angleze) dhe Luksemburgu (luksemburgishtja, gjermanishtja ose frëngjishtja) parashikojnë për shkak të statusit të veçantë 50% deri 75% të kohës për mësimin në një gjuhë tjetër.

2.0 Studimi i gjermanistikës në vendet albanofone (Shqipëria, Kosova, Maqedonia)

Më shumë se 90% e studentëve shqiptarë-folëseve, për shembull, në Shqipëri, që zgjedhin të studiojnë gjermanistikë, për t'u formuar më tej si mësues për lëndën gjermanisht (në Elbasan) ose, për t'u specializuar

në drejtimin "Përkthim dhe interpretim" (kryesisht në Tiranë) nuk kanë mësuar më parë gjermanisht në gjimnaz. Ata studentë shqiptarë që nuk lejohen të studiojnë degë të tjera, vijnë të studiojnë degën gjermanisht. Kjo sjell problemin e parë të madh. Në këtë mënyrë ata duhet të ndjekin pa njohuri gjuhe seminaret dhe leksionet e parashikuara në semestrin përkatës nga plani mësimor të mbajtura vetëm në gjuhën gjermane. Kurse vetëm për mësimin e gjuhës gjermane në semestrin e parë nuk janë të mundur të realizohen nga ana administrative sepse ato nuk mund të kombinohen me planin e përgjithshëm mësimor të parashikuar p.sh., për studimin "Gjuhë dhe kulturë gjermane". Hartimi i planeve mësimore dydisiplinore "Gjermanisht dhe histori" në Universitetin e Elbasanit dhe hartimi i studimit njëdisiplinor në Universitetin e Tiranës për "Gjuhë dhe kulturë gjermane" me studime të thelluara më tej për "Mësuesi", "Komunikim ndërkulturor" ose "Përkthim dhe interpretim" u mundësua pas një pune të vështirë dhe intensive e cila u kurorëzua me miratimin e këtyre planeve nga instancat përkatëse në nivel universitar dhe ministrial. Plani mësimor "Gjermanisht dhe administrim biznes" nuk u miratua nga senati i universitetit të Elbasanit *Aleksandër Xhuvani.*

Përpjekje të tjera për të mundësuar studime dydisiplinore që kombinojnë gjuhët e huaja me një disiplinë tjetër lëndore, siç kjo është e zakonshme në vendet e tjera të BE-së, kanë dështuar deri tani për shkaqe të cilat unë nuk mund t'i shpjegoj.

Mbarimi i studimit njëdisiplinor në pjesën më të madhe në universsitet e Tiranës, Elbasanit, Shkodrës dhe Korçës mundëson formimin e një numri të konsiderueshëm mësimdhënësish për gjuhën gjermane. Për një mësimdhënie në lëndë të tilla, si, matematikë, fizikë, gjeografi apo histori nuk dot të kishin këta të diplomuar në universitet shqiptare as formimin gjuhësor dhe as kompetencën profesionale mësimdhënëse për një lëndë të caktuar mësimore. Por pikërisht, kjo kompetencë duhet të ishte edhe qëllimi i një reforme në Arsimin e Lartë Shqiptar, nëse Shqipëria do të jetë në të njëjtin nivel arsimor si edhe shtetet e tjera të Komunitetit Europian.

Për një shtrirje të dëshiruar të shkollave bilingual do të nevojiteshin më shumë mësues shqiptarë të gjuhës gjermane të formuar edhe

në një disiplinë tjetër, si p.sh., në matematikë, biologji, gjeografi apo shkenca sociale. Struktura e studimit njëdisiplinor e zbatueshme pothuajse në të gjithë Shqipërinë nuk e lejon realizimin e një mundësie të tillë.

4.0 Mësimi bilingual në shkollat në Kosova sipas modelit shqiptar

ZfA (Zyra qendrore për bashkëpunimin me sistemin arsimor jashtë vendit) në Këln, instance përfaqësuese e sistemit arsimor për shkëmbimet jashtë shtetit, në bashkëpunim me ministrinë e arsimit shqiptar ka realizuar një projekt pilot në gjimnazin "Sami Frashëri" në Tiranë. Përfshirja e gjermanishtes në mësimdhënien e lëndëve mësimore në projektin pilot (mësimin bilingual) ka synuar kombinimin e mësimit të gjuhës së huaj me përvetësimin e kompetencave në lëndë të tjera mësimore si edhe me kompetencat bazë që nevojiten gjatë të mësuarit.

4.1 Modeli I Tiranës

Drejtuesit e qendrës ZfA në Tiranë, zotit StD Hans Zeller, Tiranë iu propozuan për realizimin e shkollimit bilingual në gjimnazin "Sami Frashëri" dy variante si modele didaktike të mundshme për t'u zbatuar në:

1) Mësimdhënien dygjuhëshe në vetëm një lëndë, një disiplinë,
2) Përgatitjen e moduleve bilinguale në lëndë të ndryshme.

Këto variante u diskutuan me mësimdhënës shqiptarë të disiplinave të ndryshme dhe pas diskutimeve të shumta filloi zbatimi i tij në vitin 2007-2008. Përgatitja e moduleve bilingual në lëndë të ndryshme në të vërtetë *lejon një fleksibilitet më të madh në realizimin e mësimit bilingual* dhe në këtë mënyrë u mundëson *mësindhënësve të interesuar,* të grumbullojnë *njësi më të vogla si përvoja të para.* (Zeller, 2008: 53)

4.2 Mësimi bilingual ndërdisiplinor, modeli I orientuar drejt projekteve ndërdisiplinore

Diskutimet e zhvilluara për strukturimin e hapave të veçanta në sistemin arsimor nga grupi i projekteve të gjimnazit "Sami Frashëri" i

qartësuan atij bindjen se në shkollat shqiptare mbetet – deri në momentin kur reformat dhe ligjet e situatës së deritanishme shkollore të lëvizin në drejtim të Europës – ende shumë për t'u bërë.

Drejtuesit të projektit (Zeller) iu krijua bindja se përpos modelit didaktik të mësimdhënies dygjuhëshe në vetëm një disiplinë dhe hartimit të moduleve bilingual në lëndë të ndryshme, mundësi të mirëmenduar (edhe për Shqipërinë) paraqet edhe modeli didaktik bilingual shumëdisiplinor, siç e përcakton Zelleri, modeli i orientuar drejt projekteve ndërlëndore. (Zeller, 2008: 54)

Përvoja shtatëvjeçare e realizimit me sukses të projektit të mësimdhënies ndërlëndore dygjuhëshe në disa klasa të gjimnazit "Sami Frashëri" dëshmon në këtë fushë përvoja, para së gjithash, pozitive, për shembull në lidhje me

a) numrin e nxënësve dhe

b) përfundimin e shkollimit (DSD) në dy drejtime.

Mbi çështje të tilla si:

- numri i orëve,
- raporti i disiplinave lëndore me mësimin e gjuhës së huaj,
- bashkëpunimi midis mësimdhënësve shqiptarë të gjuhës gjermane dhe mësimdhënësve gjermane të disiplinave lëndore,
- modeli i mësimdhënies bilingual shumëdisiplinore,
- do të shprehet vetë drejtori i vetëm i këtij projekti, z. StD Mühlfeit, në kohën e përshtatshme.

5.0 Perspektiva

Shkollimi dygjuhësh dhe module bilingual shihen nga studiuesit si *shkëlqime evidente* përsa i përket realizimit të synimit të shumëgjuhësisë. (Christ, 2002: 53)

Aftësia për të përvetësuar një gjuhë tjetër përpos gjuhës amtare, e cila mund të përdoret si gjuhë pune giykohet dhe vlerësohet në perspektivën europiane si kompetencë bazë.

Njohuritë e thelluara gjuhësore dhe përvojat ndërkulturore for-

mojnë një premise të mire për mobilitet për jetën dhe karrierën e mëpasme.

Përdorimi i gjuhës jo si objekt mësimi por si mjet komunikimi motivon mësimnxënësit në rrugën e mësimit dhe përvetësimit të shumëgjuhësisë dhe eliminon barrierat në mësimin e gjuhëve të huaja. (Bär, 2004: 94)

Drejtimi dydisiplinor në një pjesë të gjimnazit "Sami Frashëri", në Tiranë, ka mbetur deri më sot i veçantë në llojin e tij: ai mbetet momentalisht i vetmi shembull, të shpresojmë që do të pasohet nga të tjerë së shpejti, në të cilin që nga viti shkollor 2007-2008 mësimi i matematikës dhe i gjeografisë zhvillohet në gjermanisht.

Tri konsiderata përmbyllëse mbi studimin dydisiplinor në Kosovë – Për reflektim:

1) Është fakt që universitetet në Kosovë nuk formojnë mësimdhënës inovative për shkolla parauniversitare për arsimin bilingual – për këtë duhet zëvendësuar studimi njëdisiplinor me atë dydisiplinor.

2) Urojmë që formimi i komisioneve në nivel ndërfakultetor dhe nivel ministror të gjejë sa më shpejt zgjidhjen e duhur.

3) Duke shpresuar për dhënien e hershme të statusit të vendit kandidat për Kosovë inpute të tilla vetëm mund të kontribuojnë për mirë.

Mario de MATTEIS, Ruhr-Universität Bochum dhe Universiteti: Durrës, Elbasan, Tiranë, Tetovë

MËSIMI DYGJUHËSH, INTERKULTURALITETI - A ËSHTË MËSIMI I DISIPLINAVE LËNDORE NË NJË GJUHË TË HUAJ NJË MODEL PËR ARSIMIN E ARDHSHËM KOSOVAR?

Suzammenfassung

Im letzten Jahrzehnt hat sich im englischen, französischen und italienischen Sprachraum ein Begriff durchgesetzt, der in immer stärkerem Maße zur Bezeichnung des Konzeptes verwendet wird: *Content and Language Integrated Learning* (abgekürzt: CLIL) bzw. *Enseignement d'une Matière par l'Integration d'une Langue Etrangère* (abgekürzt EMILE auf Französisch und EMILS auf Italienisch). Zwar wird im deutschsprachigen Raum weiterhin offiziell der Begriff *Bilingualer Sachfachunterricht* verwendet, jedoch finden sich inzwischen auch Versuche, den englischen Begriff CLIL sinngemäß ins Deutsche zu übertragen (zum Beispiel *Integriertes Fremdsprachen- und Sachfachlernen*).

Die Definition betont, dass in einer CLIL-Schule – wie im albanisch-deutschen Pilot-Programm des albanischen Gymnasium "Sami Frasheri" in Tirana – das vor sechs Jahren gestartet wurde — nicht der gesamte Unterricht, sondern nur der Fachunterricht in einer beschränkten Anzahl von Fächern in der Fremdsprache durchgeführt wird.

In Tirana wird der CLIL-Unterricht zum einen von einem normalen – zum Teil erweiterten – fachlich kompetenten Fremdsprachenunterricht begleitet, zum anderen findet im CLIL-Unterricht selbst auch Sprachunterricht statt, insbesondere wenn es die Vermittlung des Sachfachs (z.B. Mathematik oder Physik) erforderlich macht. Das bedeutet also, dass der CLIL-Unterricht wirklich ein integrierter Sprach- und Sachfachunterricht ist.

Schlüsselwörter: CLIL, EMILE, EMILS, Bilingualer Sachfachunterricht, CLIL-Unterricht.

6.0 Bibliografi

Bär, Marcus (2004): Europäische Mehrsprachigkeit durch rezeptive Kompetenzen: Konsequenzen für Sprach-und Bildungspolitik. Aachen: Shaker.

Christ, Ingeborg (2002): Bilinguale Module – eine weitere Form des bilingualen Unterrichts? In: Finkbeiner, Claudia (Hrsg.): *Bilingualität und Mehrsprachigkeit.* Modelle, Projekte, Ergebnisse. (Perspektiven Englisch, Heft 3), Hannover: Schroedel, Diesterweg, 14-21.

Helbig, Beate (2003): Bilinguales Lehren und Lernen. In: Bausch, Karl Richard/ Christ, Herbert/Krumm, Hans-Jürgen (Hgg.): Handbuch des Fremdsprachenunterrichts. Vierte Auflage, Tübingen, Francke.

de Matteis, Mario (2012): *Elemente einer europäischen Kulturgeschichte*. Tiraner Vorlesungen. 1-84 (Manuskript).

de Matteis, Mario (2013): Die Literatur als Teilsystem des Gesamtsystems der europäischen Kultur. In: Kristo, Ema/de Matteis, Mario/Schellenberg, Wilhelm (Hgg.): Sprachendiversität und Interkulturalität, "Albanische Universitätsstudien", Band 20, 2. Oberhausen, Athena Verlag. 291-302.

Otten, Edgar/Wildhage, Manfred (2003): *Content and Language Integrated Learning*. Eckpunkte einer "kleinen" Didaktik des bilingualen Sachfachunterrichts. In: Otten, Edgar/Wildhage, Manfred (Hrsg.): Praxis des bilingualen Unterrichts. Berlin: Cornelsen, 12-42.

Salvi, Rita (a cura di) (2009): *L'insegnamento delle lingue in Italia in relazione alla politica linguistica dell'Unione Europea*. In: *Working Paper* 59/2009 del Dipartimento di Studi Geoeconomici, Linguistici, Statistici e Storici per l'analisi regionale, archiviato nel *database* della biblioteca del CNR in deposito legale digitale con codice 643BC2009.

Sekretariat der Ständigen Konferenz der Kultusminister der Länder in der Bundesrepublik Deutschland (Hrsg. (2001)): Deutsch-französische Zusammenarbeit im allgemein bildenden Schulwesen – Gemeinsames Entwicklungs- und Kooperationsprogramm für zweisprachige Bildungsgänge mit deutsch-französischem Profil – bilinguale Züge in Deutschland*, sections européennes* in Frankreich.
Band I: Grundlagen, Ergebnisse, Informationen.
Band II: Grundlagen, Ergebnisse, Informationen und Anlagen zu Band I. Bonn.

Werner, Bettina (2006): Bilingualer Unterricht im Kontext europäischer Sprachenpolitik unter besonderer Berücksichtigung des Bundeslandes Berlin und der Zielsprache Französisch. Wissenschaftliche Hausarbeit, Erste Staatsprüfung für das Amt des Studienrats, Freie Universität Berlin, Institut für romanische Philologie-Fachdidaktik Französisch. Staatsarbeit - Final. pdf.

Wolff, Dieter (2002): Bilingualer Sachfachunterricht in Europa: Ein Überblick. In: Finkbeiner, Claudia (Hg.): Bilingualität und Mehrsprachigkeit. Modelle, Projekte, Ergebnisse. (Perspektive Englisch, Heft 3). Hannover, Schroedel, Diesterweg: 7-13.

Wolff, Dieter (2005): Integriertes Inhalts- und Sprachlernen: ein innovatives Konzept in den Erziehungs- und Bildungssystemen der Europäischen Union. Vortragsskript anlässlich der Konferenz "Das Europäische Klassenzimmer im Wandel. Neue

Perspektiven durch den mehrsprachigen Unterrichts“, Luxemburg am 10. und 11. März 2005 (Handschriftliche Kopie)

Wolff, Dieter (2008): Der bilinguale Sachfachunterricht: Der Königsweg zur Mehrsprachigkeit und zum interkulturellen Verstehen? In: de Matteis, Mario et. al. (Hg.): Methodik und Didaktik für den Deutschunterricht (DaF). Athena Verlag, Oberhausen. 2008: 65-81.

Zeller, Hans (2008): Lernen für Europa – Bilinguales Lehren und Lernen in Albanien. In: de Matteis, Mario *et al.* (Hg.), Methodik und Didaktik für den Deutschunterricht (DaF). Athena Verlag, Oberhausen. 2008: 47-63.

Internetquellen

www.europa.eu.int. Protokoll Protokoll vom 24.03.2014.

www.ec.europa.eu/education/languages/pdf/doc 1646_eu.pdf. Prot. v. 25.03.2014

www.ec.europa.eu/education/linkhomepage/eurydice_de.htm. Prot. v. 09.07.2013

www.goethe.de/ins/pl/lp/net/giz/deindex.htm. Prot. v.24.03.2014.

www.goethe.de/ges/spa/dos/ifs/ceu/de 2751287.htm. Prot. v.24.03.2014.

www.gymansium-korntal.de/index.php?id=31. Prot. v.24.03.2014.

www.de.wikipedia.org/wiki/Deutschsprachige_Gemeinschaft_Belgiens. Prot. v. 25.03.2014

Shpend BENGU, Tiranë

KONTRIBUTI I SHBA NË DOKUMENTIMIN E TRASHËGIMISË KULTURORE SHQIPTARE

Hyrje

Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kanë ndihmuar Shqipërinë që në fillimet e shekullit të kaluar, kur shqiptarët luftonin për pavarësi. Mbarimi i Luftës I Botërore e gjeti Shqipërinë dhe kombin shqiptar të ndarë politikisht e të pushtuar ushtarakisht nga shtetet fituese të luftës dhe në gjendje të vështirë ekonomike. Ishte fjala e presidentit *Woodrow Wilson* që e shpëtoi Shqipërinë nga Traktati i Fshehtë i Londrës më 26 prill, ku Fuqitë e Mëdha donin ta ndanin për t'ua dhënë fqinjve të saj e për ta zhdukur nga faqja e dheut.

Traktati i Londrës – 26 prill 1915

Kontributi i Kryqit të Kuq amerikan dhe Kryqit të Kuq shqiptar. Modeli i Mary Edith Durham.

Për sa i përket kuntributit për dokumentimin e Trashëgimisë Kulturore Shqiptare, nuk mund të lëmë pa përmendur punën e jashtëzakonshme që Edith Durham ka bërë për Shqipërinë, të cilën ajo e ka cilësuar si "*vendi im më i dashur*". Në pjesën e fundit të jetës së saj, Durham është angazhuar si lobuese për Shqipërinë. Në vitin 1927 ajo i shkroi një letër gazetës "The Guardian" në Angli për krizën e urisë në Shqipëri, ku kërkonte që populli britanik të jepte një kontribut për popullin shqiptar. Por ajo nuk ka kërkuar thjesht para, që është një mënyrë e zakonshme për një popull të varfër që kërkon ndihmë, ajo ka thënë: "*Mos i harxhoni paratë vetëm si donacion, por shkoni në një shitore në qendër të Londrës për të blerë qëndisje dhe punë në vegje*" (që i kishte sjellë nga Shqipëria), "*dhe paret e këtyre blerjeve dërgojuani njerëzve në Shqipëri, që janë puntorë dhe po bëjnë çfarë munden për t'i shpëtuar urisë*"[1].

Mery Edith Durham, gjatë punës me refugjatët e luftës në Shkodër (1912)

Durham ishte ndër të parat që aplikoi konceptin e ri për bashkëpunimin ndërmjet popujve. Sipas Durham-it, ky bashkëpunim nuk do të thotë që të gjesh një donacion, por do të thotë bashkëpunim, vlerësim dhe respektim ndaj punës. Ky lloj koncepti u zhvillua edhe në Amerikë

[1] Elizabeth Gowing, Mbi librin "Unë dhe Edithi", Konferenca Shkecore, "Miss Mary Edith Durham, *Me rastin e 70 vjetorit të vdekjes".* ISBN: 978-9928-198-04-4, *Ministria e Kulturës,* Intergrafika sh.p.k., nëntor 2014, f. 18.

përsa i përket mënyrës për gjetjen e fondeve financiare për qëllime humanitare, nëpërmjet trashëgimisë kulturore. Edith Durham ka pasur një bashkëpunim si reportere për Shqipërinë me North East Foundation, i cili luajti një rol të rëndësishëm në fushën e edukimit e sidomos në hapjen e shkollave amerikane në Shqipëri.

Albania

II. Growth of the Founding State of Europe

By H. E. Edmondson Bell

ALBANIA, THE FOUNDING STATE

Artikull i Edith Durhamit për Shqipërinë, botuar nga Near East Fuondation

Regjistrimet e para amerikane për Shqipërinë nisin rreth vitit 1919 dhe janë kryer nga organizata e Kryqit të Kuq Amerikan.



OCTOBER 29, 1921 THE CAMBRIDGE CHRONICLE PAGE FIVE

RED CROSS RELIEF WORK IN EUROPE THE PAST YEAR

American Red Cross relief operations in Europe during the past fiscal year were concerned almost entirely in establishing a chain of child-health units that are rescuing thousands of under-nourished and disease-stricken children from the misery war has visited upon them, and in aiding otherwise helpless hordes of refugees.

A glimpse of these operations and the results they achieved in 14 European countries is contained in a report to the people just made public, based on the forthcoming annual report of the organization.

The Red Cross is now making final preparations for its Annual Roll Call of members, November 11th to 24th, which involves support of its present $6,000,000 medical relief campaign among destitute European children and its permanent program at home.

In Albania the American Red Cross, in several cities, established child-health stations so that in the month of June 4,200 children received medical assistance. Heroic work was also done during the earthquake disasters, lasting from December 18, 1920, for nearly a week. In addition to what was done for the Albanians, the Red Cross fed 1,000 refugees daily for a period of nine months.

Qëllimi i ARC ishte që të regjistronte ngjarjet në të gjithë botën, gjatë e pas Luftës I Botërore. Këtu përfshihej edhe Shqipëria.

Inventari i Kryqit të Kuq Kombëtar Amerikan, 1906 -1995, me numër XX482, përmban: korespondeca, memorandume, raporte, të dhëna financiare, lista dhe fotografi që i përkasin punës së vullnetarëve të ARC në Europë, Lindjen e Mesme, Rusi dhe Kinë, gjatë dhe pas Luftës I Botërore, dhe 339 bobina filmi. Koleksioni i ARC përmban:[2] 28 kuti të komisionuara për shtetet e Ballkanit në vitet 1917-1923. Koleksioni për Shqipërinë i viteve 1919-1922 përbëhet edhe nga: Kutia me dosjet: 15: 27, me informacion për shkollat në Shqipëri në vitin 1919. Kutitë me dosjet: 15: 31/ 16: 1-18/ 17: 1-2 kanë raportet për vitet 1919-1922.

[2] OAC-Online Archive of California, http://www.oac.cdlib.org/findaid/ark:/13030/kt1h4nd13n

Aktivitete të Kryqit të Kuq Shqiptar[3] 1920 – 1928

Më 1920 veprimtaria e parë e Kryqit të Kuq në Shqipëri ishte shpërndarja e ndihmave të Kryqit të Kuq Amerikan në prapavijat e ushtrisë shqiptare të asaj kohe. Më 1921, më 4 tetor u krijua Shoqata e Kryqit të Kuq Shqiptar (KKSH). Më 1923 - KKSH njihet zyrtarisht nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq. Po atë vit bëhet anëtar i Ligës (sot Federatës) Ndërkombëtare të Shoqatave të Kryqit të Kuq, duke qenë kështu e 38-ta shoqatë e themeluar deri në atë kohë.

Më 1927, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Francez, hapen Këshillimorja dhe pikat e shpërndarjes së qumështit për fëmijët e kequshqyer. Veprimtaritë e KKSH-së mbështeteshin nga ndihmat që vinin nga populli, bamirës të ndryshëm dhe nga shqiptarët e diasporës, në veçanti Amerika.

Ekspozita e parë e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale Shqiptare në Amerikë, Boston, 24. 2. – 20. 3. 1928 . Organizimi dhe shitja u bë nën kujdesin e Konsullatës Shqiptare dhe të Komitetit për të ndihmuar Kryqin e Kuq Shqiptar, që kryesohej nga Faik Konica.

Foto majtas: Konsulli i Shqipërisë në SHBA, Z. George N. Prifti, duke i shitur një orë 100 vjeçare me zinxhir, Z. Arthur Graham Carey, në ekspozitën e Artizanatit Shqiptar në Boston, 24. 2. – 20. 3. 1928. Qëllimi i shitjes së kësaj ekspozite, ishte që populli amerikan, të njihej me punën e mrekullueshme të artizanëve shqiptarë dhe të mblidhte fonde për

[3] http://www.kksh.org.al/kush-jemi/historik-i-kksh-se/

Kryqin e Kuq Shqiptar. Kjo ekspozitë ngjalli dhe interesin e çiftit Arthur Graham Carey, i cili me materialet e mbetura nga ekspozita organizoi një tjetër ekspozitë shitjeje në oborrin e shtëpisë së tyre në Gray Gardens, Cambridge, në 28. 3. 1928. Ekspozita shënoi sukses financiar. Foto Djathtas: Çifti Graham Carey, të veshur me kustume shqiptare në ekspozitën e organizuar në shtëpinë e tyre.

Faik Konica, i dërguari i Jashtëzakonshëm dhe Ministër Fuqiplotë i Mbretërisë së Shqipërisë në Washington, D.C. ishte përkrahës i sinqertë i Kryqit të Kuq Shqiptar. Ai ishte President i përkohshëm i Komitetit për të ndihmuar Kryqin e Kuq Shqiptar.

Princesha Sanie Zogu, ishte një mbështetëse e zjarrtë e Kryqit të Kuq Shqipar dhe ka marrë pjesë në shumë aktive në punët e organizatës, që nga viti 1924 kur ajo u bë Zëvendës Presidente Nderi e KKSH-së.



Faik Konica

Princesha Sanie Zogu

Aktiviteti i prof. E. E. Jones për hapjen e Institutit Amerikan në Shqipëri

Deri më sot, në studimet që janë bërëpër projektin e Misionit të Bordit të Jashtëm Amerikan për hapjen e Universitetit Ballkanik në Shqipëri, si dhe të Institutit Shqiptar-Amerikan në Kavajë, nuk është përmendur roli dhe kontributi i madh që ka dhënë prof. Elmer J. Jones, i cili ndër të tjera është dhe organizatori i ekspeditës së parë turistike dhe studimore amerikane në Shqipëri.



Musical Programme
to the picture
A Journey Through Albania
with a Movie Camera
to be shown at
Tremont Temple, November 29, 1928, at 8 p. m.
for the Benefit of the Albanian Red Cross
Music will be played by the
Albanian Mandolin Orchestra "Tomori," Albert Nassi, Conductor
assisted by Thomas Nassi, Flute; Olympia Nassi, Piano

AMERICA
ALBANIAN NATIONAL ANTHEM — THOMAS NASSI
CALIF OF BAGDAD OVERTURE — THE "TOMORI" MANDOLIN ORCHESTRA — *Boildieu*
KENDON GJELI NE MENGJES — *From Motives of Danuzzo and Tirana Folk Songs* — FLUTE SOLO—T. NASSI, *Accompanied* by O. NASSI
BEAUTIFUL RAINBOW WALTZ — *H. F. Odell*
O MOJ TI ME SYT E ZINJ
VEMI O VEMI — THOMAS NASSI
REMARKS by Dr. Henry J. DeLorme, *Chairman*
PART ONE OF FILM
E QARE — FLUTE SOLO—T. NASSI, *Accompanied* by O. NASSI
ALBANIAN FANTASIE — THE ORCHESTRA
PART TWO OF FILM
THE STAR SPANGLED BANNER

Në janar të vitit 1922, shteti shqiptar i kishte kërkuar Kishës Episkopale Metodiste Amerikane që të mundësonte hapjen e një kolegji amerikan në Shqipëri. Kryepeshkopi Blake iu përgjigj thirrjes së shtetit shqiptar

duke dërguar në Shqipëri prof. Elmer E. Jones, që në atë kohë ishte drejtor i Shkollës së Edukimit të Universitetit North-Western në Evanston, për të raportuar mbi kushtet e mundësitë e edukimit në Shqipëri.[4]

Prof. Elmer E. Jones, është amerikani i parë që ka ardhur në Shqipëri për të studiuar gjendjen e sistemit të edukimit në Shqipëri në fillim të shek. XX. Gjatë qëndrimit tremujor në Shqipëri, ai vizitoi qytetet dhe zonat më të rëndësishme si dhe studioi karakteristikat arkaike të traditave kombëtare të Trashëgimisë Kulturore Shqiptare. Prof. Elmer E. Jones u kthye në Evanston dhe e paraqiti raportin e tij të hollësishëm në Bordin e Misionit të Jashtëm të Kishës Episkopale Metodiste të Amerikës, të cilit i kërkoi me këmbëngulje hapjen e kolegjit amerikan në Shqipëri.

Ndër të tjera, në raportin e tij ai shkruante: *"Shqiptarët janë të etur për edukim dhe çdo gjë amerikane është e pëlqyer prej tyre". "Mikpritja e shqiptarëve, siç e quajnëata veten, është e pakrahasueshme."*[5]

Ai e siguroi Bordin se autoritetet shqiptare në Tiranë ishin shumë entuziaste për propozimet e tij dhe i kishin premtuar çdo lloj asistence për të ngritur me sukses Kolegjin Amerikan. Qeveria Shqiptare kishte shprehur dëshirën për t'i ofruar ndërtesat e përshtashme për kolegjin për të cilin do të vinin në dispozicion pjesë toke për eksperimente agrokulturore sipas propozimeve dhe nevojave që do të kishte pala amerikane.



XHURNALLI POLITIK

"ALL ABOARD" FOR ALBANIA

First Summer Excursion To Leave On June 2, on the S. S. "Albania"

Spend your vacation in Albania. Albania, the Switzerland of the Balkans, offers a rare opportunity for quite and rest to those who are tired of twentieth-century civilization. Besides there are great business possibilities to be undertaken by American merchants and manufacturers in that country, because it lies west of the Balkan states on the Adriatic, and is the nearest gateway of southern Europe.

The first American expedition to Albania is announced by The Temple Tours, who have arranged a splendid sight seeing trip through Europe, sailing from New York June 2, and reaching Albania July 11.

The trip will be conducted by Prof. Elmer E. Jones, of Northwestern University. Prof. Jones has traveled extensively in Albania and is using his influence to establish a university for the Albanians and to promote trade between Albania and America.

JUGOSLAVIA
MONTENEGRO
CETTIGNE
SCUTARI
PRIZRENO
ALESSIO
KRUYA
DIBRA
DURAZZO
TIRANA
ELBASSAN
BERAT
KORITZA
VALONA
ARGYOCASTRO
JANINA

Final settlement of Albania's frontiers.
From Current History

INVEST YOUR CAPITAL IN THE FUTURE OF ALBANIA

Water Power, Minerals, Agriculture And Wool Industry Will Give Big Returns To Enterprising Men.

GOVERNMENT INVITES U. S. MONEY

BY PROF. ELMER E. JONES
OF NORTHWESTERN UNIVERSITY

American business men are usually quite shrewd in seeing the opportunity to make excellent investment in foreign countries. Thus far, however, there has been little interest manifested in Albania as a field in which American capital might be invested with assurance of good returns. This is doubtless due to the fact that men of means know little of the opportunities for development in the Balkans, particularly that newest of the republics, Albania.

There is probably no country in the world in which the possibilities for commercial and industrial development are

[4] The Albanian Journal, (2) Jan. 2, 1922, I A l a, III C, III H, WPA (ILL), Proj. 30275

[5] The Albanian Journal, (1) Jan. 2, 1922, I A l a, III C, III H, WPA (ILL), Proj. 30275

Në raportin e tij, dr. Elmer E. Jones ndër të tjera shkruante: *"Shqipëria është një vend i pazhvilluar, por me pasuri shumë të mëdha. Vendi ka fusha shumë pjellore dhe në male ka kullota të shkëlqyera për dhen dhe dhi. Çdo familje në vend ka një numër të konsiderueshëm delesh e dhish duke ofruar mundësinë e zhvillimit të industrisë së leshit."*

Përsa i përket arsimit dhe edukimit dr. Elmer E. Jones në raportin e tij të detajuar thekson:

"në Shqipëri, në të shkuarën, edukimi ishte lënë krejtësisht pas dore për shkak të një politike armiqësore që ka qenë mbisunduese në Ballkan, dhe shqiptarët që kërkonin arsimim, detyroheshin të studionin gjuhë të huaja sepse gjuha e tyre ishte e ndaluar nga regjimi Otoman, i cili e sundoi vendin për katër shekuj, dhe e anatemuar nga Kisha Orthodokse Greke. Ashtu si regjimi Otoman edhe kleri grek kanë pasur një autoritet sundues në çështjet politike shqiptare por që nga shpallja e pavarësisë në vitin 1912 kishin filluar të humbnin lojën e tyre politike në Shqipëri. Fakt ishte ndërpreja e aleancës së shqiptarëve me kishën greke dhe shpallja e Kishës Autoqefale Shqiptare".[6]

Prof. E. E. Jones nga Northwestern University Evanston, në vitin 1922, organizoi ekspeditën e parë turistike dhe studimore amerikane në Shqipëri. Kjo ekspeditë, që u organizua nga Temple Tours, u nis nga New York më 2 qershor dhe arriti në Shqipëri në 11 korrik të vitit 1923.

Qëllimi i kësaj ekspedite, ndër të tjera, ishte dokumentimi dhe njohja e kontekstit shqiptar në të gjithë komponentët e tij si dhe bashkëpunimi i SHBA me Shqipërinë në fushat e edukimit, tregëtisë, agrikulturës, financës dhe religjionit, për ta integruar Shqipërinë me vendet e tjera të Ballkanit. Dokumentimi do të shërbente edhe për raportet e Jones-it për Misionin e Bordit të Jashtëm.

Duke analizuar dokumentacionin e ekspeditave amerikane të realizuara në fillimet e shek. XX, vihet re se Johns i kushton vëmendje Trashëgimisë Jomateriale Shqiptare [7][8]

---

[6] Albania's Indepedence Celebrated in Chicago, The Albanian Journal, Dec. 6, 1922, III B 3 a, III H, The Albanian Journal, (3) Jan. 2, 1922, I A l a, III C, III H, WPA (ILL), Proj. 30275

[7] The Albanian Journal (Xhurnalli Politik) Vol. II No. 5 Chicago, Ill., U. S. America, Tuesday, April 10, 1923, Serial No. 17

[8] The Albanian Journal - January 02, 1922

III H
I A I a

ALBANIAN

The Albanian Journal, Dec. 6, 1922.

THE ALBANIA'S INDEPENDENCE CELEBRATED IN CHICAGO.

Prof. Elmer E. Jones tells Albanians of Educational Needs and Future Development of Shkiperia (Albania).

MORE SCHOOLS FOR THE COUNTRY

p. 1.- It was a glorious time when the natives of Albania now residing in Chicago, Argo, Ill., and Milwaukee, Wis., heard Prof. Elmer E. Jones, director of the School of Education of the Northwestern University of Evanston, Illinois, relate to them about his trip to Albania.

The Albanians assembled to celebrate the Tenth Anniversary of the Independence of Albania, and to express their loyalty to the American flag for the privilege they enjoy under it in shaping the destiny of their country. The Albanians believe that while the races of mankind are represented by their own distinct languages, the nations and governments of the world are symbolized

III H
I A I a

- 2 -

ALBANIAN

The Albanian Journal, Dec. 6, 1922.

by the flags. The Albanian flag is highly esteemed by the Albanians, and at all patrictic meetings the flag of Albania and The Stars and Stripes lend their grandeur to the occasion.

A committee had been appointed to invite Prof. Jones who had been on a trip to Albania recently for the purpose of investigating the educational needs of that country. Dr. Francis La Piana presided at the meeting.

Prof. Jones was greeted by the Albanians as the first American who went to see what Albania is like and brought a complete report of the present conditions and future possibilities of the Balkan countries. During his lecture he brought Albania to Chicago for the Albanians who listened attentively to his experiences in going from town to town on mules back, by carriage and automobile; how the people in Albania welcomed him and the hospitality shown him during his trip through the land of the Shkipetars (Albanians). The possibilities regarding the education of their countrymen and the development of the natural resources made the audience see the realization of the Albanian national aspirations.

The Albanian Journal
XHURNALLI POLITIK

VOL. II., No. 5. CHICAGO, ILL., U. S. AMERICA, TUESDAY, APRIL 16, 1929. SERIAL No. 17.

INVEST YOUR CAPITAL IN THE FUTURE OF ALBANIA

Water Power, Minerals, Agriculture And Wool Industry Will Give Big Returns To Enterprising Men.

GOVERNMENT INVITES U. S. MONEY

"ALL ABOARD" FOR ALBANIA

First Summer Excursion To Leave On June 2, on the S. S. "Albania"

Spend your vacation in Albania. Albania, the Switzerland of the Balkans, offers a rare opportunity for quite and rest to those who are tired of twentieth-century civilization. Besides there are great business possibilities to be undertaken by American merchants and manufacturers in that country, because it lies west of the Balkan states on the Adriatic, and is the nearest gateway of southern Europe.

ALBANIA OFFERS GREAT BUSINESS POSSIBILITIES

U. S. Official Urges Commercial Men To Promote Trade Opportunities Now Awaiting Developmet.

AMERICANS WANTED IN ALBANIA

Në maj të vitit 1928, E. E. Johns ndërmerr ekspeditën e tij të dytë, gjatë së cilës është realizuar dhe një regjistrim filmik për Shqipërinë me titull *"A journey through Albania with Movie Camera"*.

Filmimet janë realizuar në 2 bobina dhe janë shfaqur për herë të

parë nga Z. Faik Konica më 28 korrik të vitit 1928 në Malta Hall të Ohio-s[9] dhe në 28 nëntor të vitit 1928 në Tremont Temple të Bostonit me rastin e Festës së Pavarësisë.

Aktiviteti i organizuar nga Faik Konica shërbeu për njohjen e publikut amerikan me Shqipërinë por edhe për të mbledhur fonde për Kryqin e Kuq Shqiptar.

*Prej disa vitesh, vazhdon kërkimi i këtyre materialeve arkivore të cilat ende nuk janë gjetur.

Themelimi i Shkollës Amerikane të Kavajës

Një ndër organizatat humanitare në SHBA në fillim të shek. XX, që synonte transformimin sipas medelit amerikan të vendeve të Lindjes së Afërme (ku bënte pjesë edhe Shqipëria) ishte Near East Relief (NER).

Qëllimi i NER ishte "një cikël i plotë i jetës për të gjithë". Fillimisht, para dhe gjatë Luftës së Parë Botërore, NER shërbeu si agjenci për ndihmat humanitare në kohë lufte. Fokusi i kësaj organizate ishin jetimët e luftës dhe popullsitë e krishtera në Lindjen e Afërt. [10]

Harta e qendrave të misioneve të Bordit Amerikan të Komisionerëve për Punët e Jashtme të Misionit të Ballkanit. 1913.[11]

---

[9] The Evening Independent Vol. Xl1i, No. 122 Massillon, Ohio, Friday, July 27, 1928

[10] U.S. Senate Committee on Foreign Relations. Annual Report of the Board of Trustees of the Near East Relief Transmitted, Pursuant to Law, For the Year Ending December 31, 1920. Sen. Doc. No.5, Washington, D.C.: Government Printing Office, 1921, p. 4 and 7

[11] David Hosaflook, http://instituti.org/, with permission of the Digital Library for International Research, American Research Institute in Turkey - Istanbul.

Stafi i NER-it kishte lidhje të ngushta me qeverinë e SHBA-së. Puna e NER-it për zhvillimin e projekteve afatgjata të qëndueshme kishte si qëllim që nëpërmjet 100.000 jetimëve të përgatitur me filozofinë e praktikën amerikane, të krijonte "fëmijët e Rregullit të Artë" me të cilët do të krijonte "*udhëheqësit e Epokës së Re në Botën e Vjetër*".[12]

Pas Luftës së Parë Botërore, NER-i e zgjeroi vizionin e vet nga një organizatë që merrej me ndihmat humanitare në raste emergjence të kohës së luftës, në një agjenci të zhvillimit profesional.

Ky transformim nuk u arrit lehtë dhe menjëherë. Kjo do të arrihej nëpërmjet një pune disavjeçare, nëpërmjet trajnimit të personelit të organizatës dhe investimeve në infrastrukturë, të cilat deri në atë kohë kishin qenë kompetencë e shkollave misionare.

Në fillim të vitit 1930 NER-i nisi transicionin për t'i lënë vendin një organizate të re të quajtur Near East Foundation, NEF. [13]

Më datë 5 qershor1930, gazeta "Ora" Nr. 84,[14] publikoi artikullin "Përfundon punimet punimet Komisioni i Amerikanëve".

Në artikull përshkruhet vizita e komisionit të NER-it në Tiranë, i cili "*synonte të unifikonte iniciativat e ndryshme kulturore amerikane në Shqipëri, të cilat zhvilloheshin veçanërisht në shkollat amerikane të Kavajës dhe Tiranës, dhe subvencionoheshin nga grupe të tjera*".

Ashtu si NER-i edhe NEF-i në vitin 1934 ka deklaruar se kishte për qëllim të arrinte një "*cikël të plotë të jetës për të gjithë*" përmes punës së saj në Lindjen e Afërme.

NEF-i mendonte se përvoja dhe ekspertiza e zhvillimit amerikan mund të ishte normativë dhe model për të gjithë botën. Përsa u përket ndihmave, por edhe informacioneve në lidhje me politikat amerikane në Shqipëri dhe rajon, qeveria dhe organizatat amerikane, për-

ABCFM, Missionaries, http://instituti.org/american-board-balkan-mission-map-1913/

[12] Charles Vickrey, Preliminary Report, Observations in Central Europe and the Near East, August-September 1920, Folder Near East Relief Minutes, 1920-1922, Box 1, NEF, RAC.

[13] Michael Limberg, University of Connecticut 2013 f. 3, http://www.rockarch.org/publications/resrep/limberg.pdf

[14] Arkivi Shtetëror, Dosja Nr. 179, Banka Kombëtare e Shqiperisë, viti 1930.

veç misioneve amerikane me misionarë ungjillorë që kishin ardhur në Shqipëri në fillim të shek. XX patën një mbështetje të fortë edhe tek diaspora shqiptare në Amerikë.

Qëndrimi i SHBA-së dhe presidentit Wilson në Konferencën e Paqes krijoi mendimin pozitiv për SHBA tek shumica e shqiptarëve, kështu që hapja e shkollave amerikane shikohej me sy të mirë nga drejtuesit e shtetit shqiptar të asaj kohe.

Workers of Kortcha Station
Standing—left to right—Miss Kltimova, Miss Kyrias, Miss Petro, Miss Janaqis
Seated—left to right—Mr. Kennedy, Mrs. Kennedy, Mrs. Dako, Mr. Dako



ENVELOPE SERIES

FREE ALBANIA

A Momentous Situation Confronting the American Board

By
SECRETARY JAMES L. BARTON

AMERICAN BOARD OF COMMISSIONERS FOR FOREIGN MISSIONS, BOSTON

A QUARTERLY

Arsimi dhe pedagogjia amerikane e kanë zanafillën e tyre në Shqipëri që në 26 mars të vitit 1908, atëherë kur në Korçë erdhi çifti amerikan Violeta dhe Fines Kenedi”.[15]

Ata janë misionarët e parë të huaj Ungjillorë që u shpërngulën në Korçë me ndihmën e Misionit të Turqisë Europiane”.[16]

Çifti Fineas dhe Violeta Kenedi.[17] erdhi në Shqipëri për të dhënë një ndihmë të jashtëzakonshme në veprimtaritë kulturore-arsimore, fetare, (ungjillore) humanitare dhe mbarëkombëtare, të ndihmuar me fonde nga Bordi i Misionit të Jashtëm Amerikan në Ballkan.[18]

Ata punuan për American Board of Commissioners for Foreign Mi-

---

[15] I.Gogaj:Shkolla teknike e Harri Fulci, f.7

[16] John Quanrud: Jeta e Gjerasim Qiriazit, f.218

[17] David Hosaflook, http://instituti.org/

[18] Petro S.Luarasi. Kontribute shekullore. Familja Luarasi për marrëdhëniet shqiptaro-anglo-amerikane, “Gazeta 55”, 19-20-21-22 korrik, 2003.

ssions, bordi për misionet protestante dhe me kishën ungjillore, të cilën e themeloi Gjerasim Qiriazi.

Pas çiftit Kenedi, më 5 shtator 1908 në Korçë erdhi çifti Erikson[19] me gruan dhe tre fëmijët e tyre.[20] Më 29 dhjetor 1921 Carls Telford Ericson, rezidenti i parë amerikan në Shqipëri,[21] pas punës dhe raportit të kryer më parë nga prof. Elmer Jones për hapjen e Kolegjit Amerikan në Shqipëri, i parashtroi qeverisë shqiptare, një program arsimor, sipas të cilit duhej të ndërtohej arsimi ynë kombëtar.

Platforma e tij në vija të përgjithshme ishte kjo: *"Sistemi shkollor i deriatëhershëm të braktisej sa më shpejt dhe të zëvendësohej me një sistem arsimor kombëtar, mbi bazën e parimeve shkencore, për të arsimuar njerëzit në një profil të caktuar. Në Shqipëri të vinte një kontingjent mësuesish të huaj e me përvojë. Të ngriheshin 2 gjimnaze në qendër: njëri për djem e tjetri për vajza. Në qytetet kryesore të hapeshin shkolla përgatitore për djem e për vajza, të cilat do të drejtoheshin nga pedagogë të huaj me ndihmës shqiptarë. Të ngrihej një shkollë moderne bujqësore në një nga pronat e qeverisë, me një ekspert të huaj si drejtor. Mësimi do të zhvillohej në gjuhën angleze dhe shqipe"*[22]

Gjithashtu në atë program Ericson i sugjeronte Qeverisë Shqiptare ta shkëpuste arsimin nga politika, duke suprimuar Ministrinë e Arsimit. (Më vonë, do të ishin funksionarët e kësaj ministrie ata që në një farë mënyre do të pengonin me sugjerimet e tyre, vazhdimësinë e shkollës së themeluar nga Ericson).

"*Amerika* – vazhdonte ai –*shpenzon miliona dollarë për arsimin në*

---

[19] Nga viti 1908-1912 Charls Tellfort Ericson ishte Drejtor i Bordit Amerikan të Misioneve të huaja në Tiranë dhe Elbasan. Në vitin 1919, ai ishte delegat nderi i Shqipërisë në Konferencën e Paqes në Paris, i emëruar nga Federata Pan-Shqiptare e Amerikës Vatra. Nga viti 1920-1921, Ericson ishte komisionar i posaçëm për Shqipërinë në Shtetet e Bashkuara; Prej vitit 1922-1923 Ericson punoi si asistent i stafit Amerikan të Legatës në Tiranë, Shqipëri. - David Hosaflook, http://instituti.org/

[20] **Revista Drini 5/01/2014 Petro Luarasi/Çifti Kenedi, misionarët e parë protestanë merikanë në Shqipëri**

[21] Gazeta 55", 15 korrik,2003, f.12

[22] 7. Gazeta Dielli, "Kur Erickson hapi Shkollën Bujqësore të Kavajës "http://gazetadielli.com/kur-erickson-hapi-shkollen-bujqesore-te-kavajes/.

vendet e tjera dhe s'kishte asnjë arsye që të mos përfitonte edhe Shqipëria, deri në themelimin e një universiteti të madh ballkanik..."

Presidenti Herbert Hoover Pamje e interierit të mensës së Shkollës së Djemve Charls Tellfort Ericson

Erickson, ka punuar me *American Board of Commissioners for Foreign Missions*, 1908 - 1919.

Më 1919 ndërmjetësoi për Shqipërinë në Konferencën e Paqes. 1921 - 34 punoi në mënyrë të pavarur për Shqipërinë dhe sipas kërkesës që i ishte bërë nga qeveria shqiptare e Ahmet Zogut, ngriti "Institutin Shqiptar-Amerikan të Kavajës", si dhe Shkollat e Vajzave në Tiranë dhe Kavajë. Për "Institutin Shqiptar-Amerikan të Kavajës" Presidenti Herbert Hoover, në vitin 1925, dha një donacion prej 10,000 US dollarësh, nga llogaria tij personale, duke vënë si kusht anonimitetin.

Rëndësinë që SHBA i kushtuan edukimit në Shqipëri e tregon fakti që në fillim të shek XX nën drejtimin e amerikanëve synohej të hapej Universiteti Ballkanik në Shqipëri. Fillimi i këtij projekti ishte ndërtimi i Institutit Shqiptar-Amerikan në Kavajë, projektin e të cilit NEF-i e porositi në studion e arkitekturës dhe dizajnit "Thompson & Churchill" në Nju Jork. Në fillim të viteve '30 studio Thompson & Churchill dërgoi në Shqipëri arkitektektin dhe dizajnerin e ri Howard R. Meyer (1903–1988).

Si rezultat i njohjes me shkollën e Bauhausit e veçanërisht me themeluesin e saj Le Corbusier, ai u bë një ndër arkitektët dhe dizajnerët më avangardë amerikanë të fillimit të shek XX. Me punën e tij ndikoi në modernizimin dhe përmirësimin e jetës amerikane.

Howard R. Meyer Punimet për ndërtimin e "Godinës së Djemve" në vitin 1930

Në 1930-31 ai udhëhoqi punimet për ndërtimin e Institutit Shqiptar-Amerikan të Near East Foundation në Kavajë. Gjatë punës së tij në Shqipëri, Meyer me shumë profesionalizëm i dha një rëndësi të madhe respektimit të peisazhit shqiptar në raport me ndërtimin e kompleksit arkitektonik si dhe ruajtjes së elementeeve të Trashëgimisë Historike në arkitekturën shqiptare.

Kështjella e Krujës

Instituti Shqiptar-Amerikan i Kavajës. NEF.
Godina e Djemve (Mensa dhe salla e shfaqjeve)

Në vitin1935, i joshur nga perspektiva e punës, Meyer u zhvendos në Dallas. Në vitin 1959 Instituti Amerikan i Arkitektëve i dha Meyer çmimin e meritës.

Misioni i Burta dhe Elliot Taylor në Institutin Amerikan të Kavajës sponsorizuar nga Fondacioni Near East në Nju Jork (1929-1935)

Elliott Taylor (1904-1986) dhe Burta Beers (1908-1994)[23] kanë qenë studentë në College of the Pacific në Stockton, Kaliforni, ku ata u takuan për herë të parë. Pas diplomimit në kolegj, në vitin 1928, Elliot punoi si asistent i Presidencës në Kolegjin Monte Mario në Romë, ndërsa Burta Beers, u diplomua më 1929, pas një viti nisi punë në Bryn Mawr College.

[23] Online Archive of California http://www.oac.cdlib.org/findaid/ark:/13030/tf2n39n8dn/

Pas martesës në Romë në vitin 1930, ata ardhën në Shqipëri në Institutin Shqiptar-Amerikan të Kavajës (Golem) të Near East Foundation, ku Elliot punoi si zëvendës drejtor i Shkollës së Djemve dhe si mësues në zooteknikë, ndërsa Burta themeloi Shkollën e Vajzave, të sponsorizuar nga Near East Foundation i Nju Jorkut (1929-1935).

Qëllimi i të dy shkollave, të cilat ishin të ndara në përputhje me praktikat myslimane në atë zonë, ishte për të *"trajnuar të rinjtë, të cilët do të bëheshin udhëheqësit e ardhshëm në fshatrat dhe zonat rurale"*, përmes edukimit në shëndetësi, në bujqësi dhe amvisëri etj.

Gjatë qëndrimit dhe udhëtimeve të tyre në Shqipëri, në vitet (1929-1935) Burta dhe Elliot realizuan shumë filmime për jetën dhe punën në Institutin Shqiptar-Amerikan të Kavajës si edhe për Shqipërinë dhe shqiptarët. Filmimet e realizuara nga Burta dhe Elliot Taylor sot përbëjnë një ndër thesaret më të çmuara të Arkivit të Memories së Trashëgimisë Kulturore Jomateriale dhe Historike Shqiptare.



Pjesë e këtij arkivi janë dhe koleksionet e kostumeve popullore shqiptare të blera në zona të ndryshme të Shqipërisë, që Burta Taylor ia dhuroi pas vdekjes së Elliot-it, në vitin 1988, arkivave të Metropoli-

tan Museum. Në dokumentarin e filmuar prej çiftit Taylor dallohen disa nga momentet e blerjeve të koleksioneve që Burta dhe Elliot i kanë dhuruar Metropolitan Muzeum. [24]

Një pjesë tjetër me shumë rëndësi e Koleksionit Taylor janë numri i madh i letrave e fotografive të korespondencës gjatë qëndrimit të tyre në Shqipëri (1929-35).

Gjatë udhëtimeve të tyre në Shqipëri Burta dhe Elliot realizuan shumë filmime ku paraqiten peisazhe nga Shqipëria, pamje të qyteteve kryesore si dhe momente nga jeta dhe puna e shoqërisë shqiptare në fillim të shek XX. Këto filmime ata u përpoqën që t'i përmbledhin në një dokumentar të cilin e quajtën "*Albania beautiful and primitive*".

Këto filmime i shërbenin edhe "*Programit të NEF"* për *"Edukimin e të Rinjve dhe trainimin e liderëve në zhvillimin shoqëror*". Duke analizuar dokumentacionin e ekspeditave amerikane të realizara në fillimet e shek. XX, vihet re se materiali më i madh i përket studimit dhe dokumentimit të Trashëgimisë Jomateriale Shqiptare si dhe edukimit.

Rëndësia e materialit

Nga përpunimi digjital i këtij materiali u arrit që të nxirren rreth 1.000 fotografi të tjera të reja për Trashëgiminë Kulturore Jomateriale Shiptare, të cilat i përkasin periudhës në të cilën është realizuar dokumentari. Përveç fotove klasike, me bashkimin e sekuencave, janë krijuar imazhe të reja të cilat lejojnë një perceptim më të gjërë të kontekstit.

[24] http://www.metmuseum.org/collection/the-collection-online/search/85841?rpp=30&pg=1&ft=Burta%2BMay%2BTaylor&pos=2&imgno=2&tabname=related-objects

Pamje nga Misioni i Burta & Elliot Taylor (Near East Fuondation)
Burta & Elliot Taylor Collection. 1932 -1935

Krijimi i mazheve të reja gjatë përpunimit digjital të sekuencave filmike

Eliot & Burta Taylor "TIRANË" 1932 – 1935"

©Shpend Beqiu

Ky material mund të vihet në shërbim të shkencave abanologjike për botimin e albumeve, librave si dhe për përgatitjn e faileve multimediale. Materiali i mbledhur nga autorët amerikanë në fillim të shek. XX është një pasuri e jashtëzakonshme për kulturën dhe trashëgiminë kulturore Shqiptare jo vetëm për shqiptarët brenda trojeve shqiptare por edhe për shqiptarët e diasporës. Edhe pse në kushte jo të mira, këto materile duhen riparë dhe përpunuar, për të mbushur atë zbrazëtirë të dokumentacionit në shkencat albanologjike dhe trashëgiminë kulturore shqiptare që u krijua nga mesi i shek. XX deri në ditët tona.

Kjo punë kërkon angazhimin e institucioneve të shkencës dhe kulturës albanaologjike në bashkëpunim me organizatat e shqiptarëve të diasporës e veçanërisht me ato në SHBA. Në lidhje me këtë proces, duhet të përmend kontributin e madh, të specialistëve amerikanë, Ken Weissman dhe Regina Longo, të cilët në bashkëpunim me stafin e Arkivit Qendror të Filmit në Shqipëri, kanë kryer edhe për rikuperimin e arkivave të Trashëgimisë Kulture Jomateriale Shqiptare.

Falenderim dhe mirënjohje e veçantë për zotin Keneth Weissman, *Supervisor, Film Preservation laboratory at Library of Congress*, i cili bëri të mundur gjetjen dhe masterizimin e këtij materiali.

Shpend BENGU, Tirana

THE CONTRIBUTION OF THE USA TO THE DOCUMENTATION OF ALBANIAN CULTURAL HERITAGE

Summary

This paper presents the documents of different expeditions organized by American scholars at the beginning of the 20th century. The first American expedition in Albania was led by Prof. Elmer E. Jones from the Northwestern University Evansto in 1923.

The aims of this expedition, and of others that were organized at the beginning of the 20th century, were numerous while organizers considered as the most important ones the cooperation between USA and Albania in the field of education, trade, agriculture, finance and religion in order to integrate Albania with other Balkan countries.

Through an analysis of the documentation of American expeditions organized at the beginning of the 20th century can be noticed that the biggest part of the material belongs to the study and documentation of Albanian intangible heritage, analyzed mainly from the anthropological standpoint.

The search for some archival materials continues for many years while the most important one is the filming of the second American expedition in Albania, in May 1928, titled "A journey through Albania" by Movie Camera. The filming was made in 2 cassettes and they have been shown for the first time by Faik Konica, on 28 July 1928, in Malta Hall, Ohio and on 28 November 1928 in Tremont Temple, Boston on occasion of the Independence Festivity. This material hasn't been found so far.

The expedition "**Albania beautiful and primitive**" was organized by Dr. Elliott J. Taylor and Burta May Taylor, and it lasted for the period 1933-1935. Burta May Taylor, in addition to the video, has also realized narration which is missing. She is one of the donors of the most beautiful collections of Albanian costumes in the Metropolitan Museum.

The aim of the visit of couple Taylor was Kavaja's School where Burta opened the school dedicated to girls (1932).

Anton ÇEFA, New York

VEPRIMTARIA E SAMI REPISHTIT

"Profesori që vazhdon të na mahnitë me freskinë e forcën e mendimit",
Fotaq Andrea

Familja Repishti është shembulltyra e familjes shkodrane të njohur në dy rrafshe veprimtarie: në atë atdhetare dhe në atë fetare.

Gjyshi i Samiut, Haxhi Jusuf Repishti, njeri me kulturë të gjerë dhe me një bibiliotekë të pasur në shtëpi, krahas veprimtarisë fetare, shquhej edhe për një veprimtari të vazhdueshme kombëtare. Ai qe një ndër firmëtarët e Memorandumit të dt. 13 Qershor 1878, dërguar Kryeministrit britanik Lord Disraeli, në Kongresin e Berlinit për mbrojtjen e tokave shqiptare. Ai qe edhe kryetar i Komisionit për financimin e forcave të Lidhjes së Prizrenit, Dega e Shkodrës, që luftonin për mbrojtjen e tokave shqiptare të Plavës, Gucisë, Hotit e Grudës, nga ushtritë e Malit të Zi.

I ati i Samiut, Hafiz Ibrahim Repishti, qe atdhetar i devotshëm, politikan demokrat, burrë i nderuar, një nga hoxhët më të shquar të qytetit, një shembull i shquar i idealit të lartë për fe e atdhe, i pajisur me një kulturë të lartë teologjike nga Universiteti i Istanbul-it, i kualifikuar në mënyrë të veçantë për të drejtën kanonike islame. Luftoi me armë në dorë, i rreshtuar në forcat vullnetare të Shkodrës, që luftonin kundër ushtrisë së Malit të Zi gjatë rrethimit të Shkodrës, në vitet 1912-13. Në luftën politike të viteve 1920-24, u radhit me vendosmëri në krah të opozitës demokratike, me grupin politik "Ora e Maleve" të At Gjergj Fishtës, At Ambroz Marlaskajt, Luigj Gurakuqit, Xhemal Bushatit etj. Në vitin 1923, zgjidhet përfaqësues i qytetit të Shkodrës, anëtar i Asamblesë Kushtetuese e më vonë deputet i opozitës fanoliste. Gjatë qëndrimit të tij në Parlament, ka

kryer funksionet e Nënkryetarit të Komisionit Parlamentar për Jurisprudencë dhe të Komisionit Parlamentar për Arsimin. Me ardhjen e A. Zogut në fuqi, u dënua me vdekje "*in absentia*" dhe u detyrua të kalojë në ilegalitet për një periudhë njëvjeçare. Me 1928, u internua në Shijak për tetë muaj si armik i regjimit monarkist. Vdiq në vitin 1943, viktimë e keqtrajtimit nga ana e policisë fashiste italiane, duke lënë gruan me gjashtë fëmijë, prej të cilëve djali i madh ishte Samiu.

Mbi nënë Havanë, bijë e fisit të Bushatlijve, mbeti kujdesi i familjes. Është pak me thanë një nënë shembullore. E pakufishme në dashurinë e saj, e pandalur në sakrificat e saj, autoritare në butësinë e saj, e pamposhtur në vuajtjet e saj. Dinjitoze dhe stoike si ajo. Mbas arratisjes së djalit Fahri, atë me të gjithë familjen e internuan në kampet e përqendrimit të Beratit dhe të Veliqotit, Tepelenë. Nënë Havaja ishte 54 vjeçe, motra Hadije 14, vëllau Vehbi 11. Vuajtje të papërshkrueshme të përballueme fisnikërisht!

Janë për t'u vënë në dukje marrëdhëniet shpirtërore të Samiut me nënën, sepse ato qenë të veçanta, dhe po ashtu qe edhe ndikimi i saj në formimin e tij. Në njërën nga letrat që i shkroi Andre Malraux-s, kur po përgatiste diplomën për doktoratë në Francë, Samiu na e bën të qartë këtë. I mbushur me ndjenjën e dashurisë dhe të vëllazërimit njerëzor, i etur për lirinë dhe të drejtat e individit, i shqetësuar për fatin e njeriut, nga njëra anë, dhe i çoroditur nga gjendja e krijuar nga rregjimi kriminel antinjerëzor i komunizmit, nga ana tjetër; është ajo, e ëma, që mbas lirimit nga burgu e frymëzon dhe e sjell në jetë. Ja si shkruan ai në letrën dërguar Malraux-s: "Kur dola nga burgu, fillova të kuptoj se e tërë pjesa tjetër e botës ishte e huaj për mua, përveç nënës sime. E shtrëngova fort në krahë. Qau! Nuk shkëmbyem një fjalë. Por e ndjeja aq pranë meje. Qëkurse isha nda nga shoqëria, ajo kishte qenë për mua personi i parë që më mbante të përmallur me praninë e saj, jo sepse ishte nëna ime; edhe vëllezërit e motrat e mia ishin aty; por gjithçka qe ndryshe me ta, me to. Kurse me atë, me nënën time, kishte ndodhur si me mua, kishte qenë e burgosun së bashku me mua, përbrenda meje, ajo, nji banore e botës, që

e vetme kishte bërë të mundur komunikimin njerëzor; ajo nuk ishte si të tjerët, 'një e huaj'. Kishte tek ajo krijesë e moshuar një si aureolë pafajësie, e mjaftueshme me përligjë revoltën që më ziente përbrenda, dhe që ta merrshe në mbrojtje, revoltë e drejtë dhe sigurisht njerëzore. E dojshe nënën siç dojshe përligjjen e aktit tim. Me të dhe përmes saj fillova proçesin e 'pajtimit', pa mundur dhe pa dashur ta plotësoj".

* * *

Jeta e Samiut qe e vështirë, por e pasur me ngjarje, e ngarkuar tej mase me veprimtari shoqërore, kulturore, dhe sidomos, atdhetare. U lind në Shkodër, në vitin 1925, ku kreu studimet e para, dhe të mesmet në Liceun "At Gjergj Fishta". Në vitet 1942-43, ndoqi studimet në Universitetin e Firenze-s (Itali), Fakulteti i Letërsisë dhe Filozofisë, por u detyrua t'i ndërpresë për arsye të luftës.

U rrit në vitet e Monarkisë me frymën e kundërshtarit të saj, dhe u poq, si thotë populli, në vitet e pushtimeve të huaja italiane dhe gjermane si armik i tyre, mori formimin e plotë dhe përcaktoi qëndrimin e tij jetësor si ithtar i lirisë dhe i emancipimit shoqëror, si luftëtar për të drejtat e njeriut, në vitet e para të diktaturës komuniste në Shqipëri.

Gjatë viteve të pushtimit të huaj (1939-44), u aktivizua në lëvizjen e rezistencës pa anëtarsim partiak. I zhgënjyer nga propaganda dhe ushtrimi i terrorit nga ish-Partia Komuniste e Shqipërisë, që nga viti 1945 kundërshtoi diktaturën e përgjakshme, që u vendos në atdhe. Në vitin 1946, u arrestua dhe mbas 14 muaj torture të egër në qelitë e Sigurimit të Shtetit, u dënua me 15 vjet burgim të rëndë dhe punë të detyruar, nga të cilat bëri plot dhjetë vjet. Fillimisht, qe i burgosur në burgun e Shkodrës, mandej kaloi në kampet e punës së detyruar të Bedenit (Kavajë), Maliqit, Urës Vajgurore (Berat) Levanit (Fier), Vjosës, aeroportit të Rinasit (Tiranë), nga ku u lirua në korrik 1956. I liruar nga burgu fitoi bukën e përditshme për vete dhe për familjen tejet të vorfnueme si punëtor krahu në hapjen e kanaleve në një moçalishte të Fermës Zooteknike, dhe në kantieret e ndërtimit, i përbuzur, i nëpërkëmbur dhe i përndjekur vazhdimisht. U arratis në Jugosllavi në gusht 1959, ku kaloi plot një vit në qelitë e desti-

nuara për emigrantët politikë. Në qershor të vitit 1961, policia jugosllave e transferoi në kampin për refugjatë të Gerovo-s (Kroaci), nga ku u arratis në Itali, në shtator 1961. Në kampin e refugjatëve San Sabba (Trieste), ku qëndroi vetëm tri javë, fitoi të drejtën e azilit politik, dhe mbas një qëndrimi gjashtëmujor në kampet e Capua-s (Napoli) dhe Latina-s (Romë), në prill 1962 emigroi në Shtetet e Bashkuara, ku filloi jetën e re si shqiptaro-amerikan.

Me një dashuri të ethshme për dije dhe me një vullnet të papërkulur për studime, Samiu u bë një personalitet intektualisht i kompletuar për një veprimtari jetësore të ndërgjegjshme, këmbengulëse dhe të frytshme për shoqërinë dhe për atdheun. Porsa erdhi në Amerikë, për 15 vite me radhë iu vu studimeve. Në verën e vitit 1962, u diplomua nga English Language Institute të Queens College (CUNY). Në vitin 1962-64, mori Diplomën në frëngjisht (B.A.) (minor: ekonomi), përsëri në Queens College, njëkohësisht edhe Çertifikatën për arsimtar nga Shteti i Nju York-ut. Më 1965-69, studioi frëngjisht dhe mori Diplomën magjistraturë në frëngjsiht, (M. A. CUNY). Në vitin 1970, fitoi bursë nga Qeveria Franceze për studime në fazën e "aggregation" në Universitetin e Parisit (Francë), dhe në vitin 1974, përfundoi programin e doktoratës për frëngjisht pranë Graduate Center of the CUNY, ndërsa për tre vjet (1974-77), punoi në përgatitjen dhe mbrojtjen me sukses të tezës për doktoratë (shkurt 1977), një studim i thuktë i veprës së shkrimtarit francez Andre Malraux. Për arsye praktike, ai u pajis edhe me Diplomën për Administratë Arsimore nga Hofstra University, N.Y. (1978), që i mundësoi emërimin e tij si shef i departmentit të gjuhëve të huaja në distriktin shkollor të qytetit Malverne, N.Y.

Para se të fillojë karierën e tij akademike, Sami Repishti punoi si nëpunës në Seksionin e Rindërtimit në Shkodër (1945-46). Mbas burgimit dhe arratisjes, punoi si nëpunës në Seksionin e Statistikës në Zagreb (Kroaci). Më 1961-62, ai u punësua si përkthyes i Konsullatës amerikane në Napoli e Romë. Gjatë qëndrimit në Kampin e refugjatëve të Capua-s, ai dha mësime frëngjisht për refugjatët që mërguan në Belgjikë. Në SHBA, u punësua pranë një kompanie amerikane në Wall Street, dhe në vitet 1966-1991, si profesor i frëngjishtes dhe italishtes pranë liceut Malverne,

N.Y. Njëkohësisht, gjatë viteve 1975-79, ka dhënë mësime si pedagog i jashtëm pranë Universitetit Adelphi, N.Y. Që nga viti 1975-1991, datë e pensionimit, ka shërbyer si kryetar i departmentit të gjuhëve të huaja për shkollat e qytetit Malverne, N.Y. Gjatë viteve 1976-91, ka qenë edhe koordinator i programit të studimeve të avancuara Lice-Universitet pranë Adelphi University, dhe në vitet 1975-77 si asistent profesor i frëngjishtes, (pedagog i jashtëm). Në qershor 1991, ka dalë në pension.

***

Gjithë jetën dhe veprimtarinë e tij prej njeriu me zemër të madhe, Dr. Repishti ia kushtoi lëvizjes për të drejtat e njeriut, sidomos në ndihmë të shqiptarëve të trojeve tona të "Shqipërisë lindore" (si e quante ai Kosovën dhe pjesën shqiptare të Maqedonisë). Atë e ka shqetësuar gjatë gjithë jetës dhe e shqetëson edhe sot e kësaj dite problemi i "njeriut", i potencialit të tij fisnik si dhe çoroditja e çnjerëzimi i tij për shkak të rrethanave të pafavorshme. "Gjatë udhës, shkruan ai, takova dhe njoha më mirë "njeriun", krijesën fisnike, e të etshme për liri, të djegur për vëllazërim e njëkohësisht, të aftë me zbritë poshtë, në botën ku mbretëron çnjerëzimi më i plotë e vdekja më e frikshme. Në këtë botë të nëntokës përqafova viktimën, dhe e deshta me pasion".

Si aktivist i të drejtave të njeriut, Dr. Samiu ka qenë anëtar që në fillim (1976) i Amnesty International, dhe koordinator për Jugosllavinë dhe Shqipërinë (komuniste) me: AI: East European Coordination Committee, me qendër në Nju Jork City. Mbas vitit 1982 ka bashkëpunuar edhe me NY State Bar Association, Commission of Human Rights, dhe Minnesota Lawyers International Human Rights Committee.

Dr. Repishti është i pari shqiptaro-amerikan që ka ngritur problemin e shqiptarëve në ish-Jugosllavi para Kongresit Amerikan (prill, 1965), ka dëshmuar pa ndërprerje para Komisioneve të Kongresit (Dhomës dhe Senatit), si dhe qendrave studimore amerikane kryesisht për problemin kosovar. Në vitin 1986 ai kërkoi hapjen e përfaqësisë amerikane në Prishtinë, që u realizua me sukses në vitin 1996, dhe hapjen e përfaqësisë kosovare në Washington D.C., që u aprovua nga Presidenti W. J. Clinton, më 1993.

Dr. Repishtin e ka shqetësuar, gjithashtu, edhe problemi i Çamërisë. Për këtë, ai së bashku me Dr. Zamir Shtyllën dhe z. Agron Alibalin, organizoi në Fordham University, N.Y. City, "Seminarin e Parë Kulturor mbi Çamerinë", më 12 Qershor, 2000. Në këtë seminar, Samiu parashtroi me hollësi gjendjen e Çamerisë me shifra e fakte, gjeografinë dhe historinë e saj që nga koha e Lidhjes së Prizrenit dhe deri në ditët tona. Seminari nxori në dritë shkeljet flagrante masive dhe të përhershme të të drejtave të njeriut të popullsisë shqiptare në Çameri, duke u nisur nga e drejta e jetës, e drejta e zotërimit të pronës e të pasurisë, etj., dhe kritikoi ashpër shtetin nënë "demokratik" që nuk e ngriti zërin në mbrojtje të bijve të vet. Nën kujdesin e tij, materialet e seminarit u botuan në saje të kontributit bujar të Albanian Center Inc. N. Y.

Dr. Repishti është bashkëthemelues (1986) dhe drejtor ekzekutiv i Lidhjes Qytetare Shqiptaro-Amerikane (1986-1992); bashkëthemelues i organizatës "Rinia Shaqiptare Kosovare në Botën e Lirë", (1968-1992); Kosova Relief Fund USA, Inc. (1978-2000); i American Friends of Albania, sekretar (1992-1996), bashkëthemelues dhe kryetar i parë i Këshillit Kombëtar Shqiptaro-Amerikan (1996-1998), dhe anëtar bordi i disa organizatave shqiptaro-amerikane. Në vitin 1962, është bërë anëtar i "Vatrës" deri në vitin 1968, kur u tërhoq për arsye mospajtimi me disa orientime të "Vatrës" lidhur me "politizimin" dhe partizanitë e partive politike të emigracionit shqiptar. Ai vazhdon edhe sot e kësaj dite të merret me studime shqiptare, dhe me të drejtat e njeriut.

Në fushën e veprimtarisë letare, ku spikat një talent i padiskutueshëm, ai na ka dhënë dy xhevahire të prozës tregimtare: "Pika Loti-Tregime burgu" dhe "Nën hijen e Rozafës-Narrativë e jetueme". Veprat dëshmojnë qartë që ai e sakrifikoi talentin letrar artistik për t'iu kushtuar lëvizjes për të drejtat e njeriut.

Dr. Sami Repishti është vlerësuar nga institucione të ndryshme në verimtarinë e tij humane, shoqërore, atdhetare, akademike etj. Në vitin 1964, me Departmental Honors (frëngjisht), College Honors for achievement; Më 1965, W. Wilson Honorable Mention; më 1970, Bourse

d'études du Gouvernement français; 1988: AANO Pllakë mirënjohjeje për veprimtari në fushën e të drejtave të njeriut, dhe distinktivin e Kryepeshkopatës Shqiptare në Amerikë për të drejtat e njeriut; më 1991, kandidat për Çmimin Yavner Shteti i New York-ut, arsimtar i dalluar në mbrojtjen e të drejtave të njeriut; më 1991, "Dhuratë për demokraci", nga Kandidati për president W. J. Clinton dhe Mrs. Clinton etj. Ai është dekoruar disa herë nga qeveritë shqiptare dhe amerikane për veprimtari patriotike dhe akademike. Në vitin 2004, për kontributin e pareshtur ndaj problemit të Kosovës, u dekorua nga Presidenti Ibrahim Rugova me "Medaljen e Artë të Lidhjes së Prizrenit", me rastin e 125-vjetorit të kësaj ngjarjeje madhore të historisë sonë. Ai është anëtar nderi i Institutit Alb-Shkenca. Para pak vitesh, Bashkia e Shkodrës emëroi një rrugë të qytetit me emërin e tij: "Rruga Sami Repishti", një simbolikë nderimi dhe pavedkësie. Ajo tabelë ogurmire në krye të asaj rruge do t'i kujtojë Shkodrës, breznive të sotme dhe të ardhme, një nga bijtë e saj që u përpoq gjithë jetën për të pakësuar vuajtjet e tjerëve.

Kohët e fundit, Dr. Repishti ka dërguar kopje të shkrimeve dhe dokumente të veprimtarisë së tij në Muzeun Historik të Qytetit të Shkodrës, dhe në Bibliotekën Universitare të Republikës së Kosovës.

Edhe pse në moshë të thyer, Dr. Repishti vazhdon punën e tij në hullitë e veprimtarisë së tij të zakonshme. Atë e shqetëson çdo gjë jo e mirë që ngjet në Shqipëri, në Kosovë dhe në trojet tjera tonat në Ballkan. Dhe ai i përgjigjet flakë për flakë çdo problemi preokupues. Ai ka demaskuar gjendjen dhe zhvilimet politike në Shqipëri mbas vitit 1990, të cilat, siç shkruan ai: "kanë anashkalue imperativin kategorik të demaskimit të periudhës së tiranisë komuniste në Shqipëri. Krimi nuk është dënue, e krimineli ashtë kthye në pushtet i veshun me rrobën e 'socializmit europian'. Gjendja politike vazhdon të jetë kaotike, ajo ekonomike e dëshprueme…'; Shqipëria 'demokratike' dështoi të lindë si antitezë e mentalitetit dhe praktikës kriminale enveriste".

Gjatë gjithë jetës, ai nuk e ka lëshuar penën nga dora. Fryt i kësaj pune këmbëngulëse dhe të vazhdueshme janë njëzet librat si autor dhe

bashkautor, dhe qindra studime, ese, artikuj, memorandume, peticione, recensione, letra etj

Më vjen mbarë të bie këtu vlerësimin e lartë të një personaliteti të lartë të kulturës sonë këtu, Peter Priftit: "... Për mendimin tim, shkruan ai, prof.dr. S. Repishti qëndron në krye të intelektualëve të diasporës shqiptaro-amerikane. Ai është pasardhës i denjë i Rilindasve, sepse ka zbatuar me besnikëri idealet e tyre të larta."

Me gëzimin që na ushqen gjendja më se e mirë shëndetësore e mendore, energjia e tij e pashtershme në veprimtarinë jetësore në shërbim të plotësimit të idealeve dhe dashurisë së tij ndaj popullit dhe atdheut, i urojmë me përzemërsi profesorit tonë, dr. Samiut, “që vazhdon të na mahnitë me freskinë dhe forcën e mendimit” siç ka thënë Fotaq Andrea, shëndet të plotë, dhe jetë të gjatë e të frytshme.

Anton ÇEFA, New York
SAMI REPISHTI'S ACTIVITY

Summary

This paper offers an overview of the civic activism, including activities on Kosovo, the human rights issues in particular, as well as the literary and scholarly work of one of the most distinguished authors of the Albanian diaspora in America -- Sami Repishti.

.

Burimet:

Hamdi Bushati: Shkodra dhe motet. Traditë, ngjarje, njerëz – Shtëpia botuese Idromeno, Shkodër, 1999.

Faik Luli, Islam Dizdari, Nexhmi Bushati: Në kujtim të brezave, Shtypur në shtypshkronjën Rozafat, Shkodër, 1999.

Eleni Karamitri: Zëra nga diaspora, Studime, portrete, dëshmi, Plejad, Tiranë, 2005.

Fatbardha Saraçi – Mulleti: Dhimbje, Shtypur në shtypur në shtypshkronjën Rozafat, Shkodër, 1996.

Sami Repishti: Pika loti. Tregime burgu – Shtëpia botuese At Gjergj Fishta, Shkodër, 1997.

Sami Repishti: Nën Hijen e Rozafës. Narrativë e jetueme – Shtëpia botuese Onufri, Tiranë, 2004.

Sami Repishti: Dialektika e rendit dhe e rebelimit tek André Malraux, përktheu nga origjinali frëngjisht Fotaq Andrea, shtëpia botuese Onufri, Tiranë, 2011.

Sami Repishti, Hajdar Bajraktari: Kosovë, prill 2000. Përshtypje udhëtimi, Prishtinë, 2001.

Sami Repishti: Punimet e Seminarit të Parë Kulturor 'Mbi Çamerinë", Botim i posaçëm i së përkohshmes kulturore Phoenix, Shkodër, 2002.

Veprimtaria akademike:

1)La dialectique de l'ordre et du moi profound de l'homme, chez Andre Malraux (frengj,1969). Dialektika e Rendit dhe e Rebelimit tek A.Malraux CUNY

2)The theme of the Revolution in the novels of Andre Malraux (1977)

(Tema e revolucionit ne romanet e Andre Malraux)Doktorate. C.U.N.Y.

3)Ten memorandums: The plight of the Albanians in Yugoslavia (1985).

4) Albania in brief (1992) Shqiperia me pak fjale N.Y.

5)Pika loti-tregime burgu (Tear drops- Prison Notes)(Shkoder 1997,2008)

6) Breaking the silence- A voice for Kosova (N.Y.:2000) Thyemja e heshtjes ...

7)Nen hijen e Rozafes-narrative e jetueme. (Tirane, Onufri, 2004)

(In the Shadows of the Castle- Lived narrative)

8)Dialektika e Rendit dhe Rebelimit tek A.Malraux (shqip,Fotaq Andrea)2014

Bashkeautor/Co-author:

1)Lidhja e Prizrenit.100 Vjetori(The Centenn. of the League of Prizren.)(Rome,'78)

2) Studies on Kosova (Studime mbi Kosoven)(C.U.P. 1984) w/Arshi Pipa

3) Human Rights in Yugoslavia Gruenwald/Rosenbloom-Cale Eds)(C.U.P. 1986)

(Te drejtat e njeriut ne Jugosllavi)

4) Yugoslavia:Failure of Democratic Communism (Freedom House,N.Y.)1987

(Yugoslavia; Deshtimi i Komunizmit Demokrat)

5) Selbstbestimmung fuer Mittel -und OstEurope(Geneva,CH. 1989)

(Vetevendosje ne Europen Qendrore dhe Lindore)

6) Gaerung in Mittel-und OstEurope (Perleshje ne Europen Qendrore dhe Lindore (Geneva, CH. 1989)

7) Neue Epoche (Epoka e re)(Geneva,CH.) 1990

8) Albanian language and competencies (Gjuhe dhe kompetence shqipe) (Peace Corps, 1992, w/ I. Haznedari)
9) Kosova 2000. Pershtypje… (Kosova.Travel Impressions) (w/ H. Bajraktari)
10) Çameria, seminar (Fordham U.2002) (Seminar on Chameria) (Z. Shtylla, A. Alibali)
11) The Jews in Albania: A story of survival-Essays and Documents (Rosenthal Inst. for Holocaust Studies, C. U. P. 2011) (Jahudijte ne Shqiperi: Historia e nji mbijetese)
12) Shqipëria e Jugut- Çameria. (Southern Albania: Çameria) (UET, Tiranë, 2014)
13) Arthur Koestler. Erresinë në mesditë (përkthim) (ne përgatitje). Essais, artikuj, memorandums, peticione, letra gazetave etj. (Essais, articles, memorandums, petitions, letters to newspapers etc.:) Afersisht /Appr: 700 (shtateqind)-Per Shqiperine: 130 +. Per Kosoven: 83+. Per Çamerine: 35 +. Per Maqedonine: 9 +. Per Mali i Zi, Presheva: 3+.

Memorandume: e peticione: 56. Konferenca , simpoziume e seminare: 21.

Dëshmi (Testimonies) para U. S. Kongresit: 14.

Botime në gazetat dhe revistat shqiptare dhe të hueja/ Foreign media: The Wall Street Journal, The Washington Times, The Washington Post, Newsday, Daily News, Philadelphia Inquirer, The Christian Science Monitor, Le Monde Diplomatique, International Herald Tribune

Victor FRIEDMAN, Chicago

FJALA E MBYLLJES

Të nderuar kolegë dhe miq,

Me të vërtetë është kënqësi e madhe të mbyll një konferencë kaq interesante dhe në një nivel kaq të lartë. Kur profesori Rexhep më propozoi të organizojmë një konferencë për albanologjinë në Amerikë, duhet të pranoj, unë u pajtova për shkakun e miqësisë profesionale dhe personale, duke menduar se do të jetë vështirë të organizojmë një konferencë me shumë rezultat. Gëzohem shumë të pranoj se paskam gabuar! Programi i pasur dhe kumtesat që kemi dëgjuar kanë qenë edhe në një nivel shumë të lartë, dhe më shumë informata dhe analiza të reja. Nga konferenca të gjithë kemi mësuar shumë gjëra të reja. Dita e parë, për gjuhësisë, kishte me të vërtetë një bashkëpunim midis gjuhëtarëve me interes për gjuhën shqipe nga shumë vende dhe nga brezi i ri së bashku me brezin jo aq të ri. Mua më gëzon veçanërisht se kishim rast të takojmë edhe kolegët me të cilët njihemi për dekada, edhe me shkencëtarët e rinj që do të vazhdojnë traditat e hulumtimeve për gjuhën shqipe në të ardhmen. E di se po të ishte e mundshme të jenë ata me ne këtu, Eric Hamp-i dhe Leonard Newmark-u do të gëzoheshin aq sa ne për përparimet në studimet e gjuhës shqipe edhe në Amerikë edhe në Kosovë, në Shqipëri, në Itali, në Poloni dhe në viset të tjera, si edhe për lidhjet me vendin e Amerikës në fushën e albanologjisë. Studimet albanologjike në Amerikë me të vërtetë meritojnë vëmendjen që u kemi kushtuar, edhe për arritjet në të shkuarën, edhe për hulumtimet që bëhen tani, edhe për hulumtimet në të ardhmen. Përveç Hamp-it dhe Newmark-ut, mund të për-

mendim punët e Janet Byron-it, Gary Bevington-it, dhe trajtimet edhe të njohura edhe të reja për historia e studimeve për gjuhën shqipe, fonologjinë, fonetikën, dialektologjinë, etimologjinë, standardizimin, habitoren, paskajoren, aspektin foljor, etj. Si edhe në fushat e literaturës dhe të etnologjisë kemi dëgjuar kumtesa interesante jo vetëm për shkrimtarët shqiptarë në Amerikë, por edhe për vendin e literaturës shqipe në botën e studimeve të literaturës në Amerikë, për epikën shqiptare që ruhet në Amerikë për burrnesaht shqiptare, etj. Jam i bindur se vëllimi që do të botohet me rezultatet e kësaj konference do të ketë vlerë edhe këtu edhe në çdo vend ku ka interes për albanologjinë.

Tani do të kërkoj pëlqimin tuaj që në emër të pjesëmarrësve të konferencës të drejtojmë një thirrje publike për instutucionalizimin e studimit të shqipes dhe te botës shqiptare në Amerikë që u drejtohet të gjithë atyre që duhet të jenë të interesuar.

Prishtinë, 26 shtator 2015

Victor FRIEDMAN, Chicago

CLOSING REMARKS

Dear Colleagues and Friends,

It is really a great pleasure for me to be giving these closing remarks for such and interesting conference, where the papers were all at such a high level. When Professor Ismajli proposed that we organize a conference on Albanian studies in America, I must admit that I agreed for the sake of our many years of personal and professional friendship. I thought it would be difficult to organize such a conference that would produce interesting results. I am delighted to acknowledge that I was wrong! The rich program of papers that we have heard has been at a very high intellectual level, with a great deal of new and original analyses and information. We have all learned many new things at this conference. On the first day, we saw the results of cooperation among linguists interested in Albanian from many places and among scholars of the younger generation as well as scholars from generations that are not so young anymore. I am especially pleased to have been able to meet with colleagues whom I have known for decades as well as with scholars of the younger generation who will continue the tradition of work in Albanian Studies into the future. I know that if Eric Hamp and Leonard Newmark had been able to travel to come to our conference, they would have been as pleased as we are at the progress of Albanian Studies in America, Kosova, Albania, Italy, Poland, and other places, and also at the place of Albanian Studies in America, to which they contributed so much. Albanian Studies in America really does merit the attention that we

have devoted to it here, for its achievements in the past, for the research being conducted in the present, and for the research that will be done in the future. In addition to Eric Hamp and Leonard Newmark, we can mention the works of Janet Byron and Gary Bevington as well as other works both well-known and new about the history of Albanian Studies as well as Albanian phonology, phonetics, dialectology, etymology, standardization, the admirative, the infinitive, verbal aspect, language and gender, etc. We have also heard interesting papers in the fields of literature and ethnography, not only about Albanian writers in America but also about the place of Albanian literature in the world of literary studies in America, on Albanian epics preserved in America, on sworn virgins, etc. I am certain that the volume that will be published with the results of the conference will be of value both here and everywhere where there is an interest in Albanian Studies.

Now I would like to request your permission in the name of the participants of the conference to address a call for the institutionalization of the study of Albanian and the Albanian world in America to be sent to all those who should be interested.

THIRRJE E KONFERENCËS

Në përfundim të punimeve të kësaj konference të suksesshme shkencore, ne pjesëmarrësit e saj nga Kosova, nga Shqipëria, nga SHBA dhe vende të ndryshme të botës, pas shqyrtimeve të shumta analitike dhe në thellësi arritëm në përfundimin e përbashkët që studimet shqiptare dhe posaçërisht albanistike në Amerikë, në mënyrë të veçantë në SHBA, megjithë mungesën e ndonjë qendre rreth së cilës do të kishin pasur mundësi të gravitonin, paraqesin një degë të rëndësishme të studimeve shqiptare në botën e sotme. Me kënaqësi vërejmë se ato janë gjithnjë e në rritje, si falë pranisë gjithnjë e më të madhe shqiptare nga të gjitha trojet, ashtu dhe sidomos duke përfituar nga nivelet e larta të zhvillimeve në studimet filologjike, linguistike, sociale e historike në këtë kontinent. Duke pasur parasysh nevojat për adresimin e materieve që lidhen me botën shqiptare si të botës amerikane ashtu të komunitetit shqiptar që jeton atje, po edhe interesat e studimet në tërësi, duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm që kanë luajtur dhe vazhdojnë ta kenë ato studime në marrëdhëniet midis popujve dhe vendeve përkatëse, u bëjmë thirrje opinionit publik e shkencor, autoriteteve universitare e shkencore të Kosovës e të Shqipërisë, autoriteteve universitare e shkencore të SHBA-së, komunitetit shqiptar në SHBA dhe të gjithë faktorëve të rëndësishëm në relacionet midis botës shqiptare dhe botës amerikane, që me përparësi ta shtrojnë çështjen e themelimit të një qendre hulumtuese-arsimore të nivelit universitar me një prej qendrave universitare amerikane dhe me standardet e atjeshme. Ajo qendër do të merrej në mënyrë specifike me studimin e mësimdhënies, të gjuhës dhe të kulturës shqiptare dhe do të shërbente edhe për ruajtjen e trashëgimisë së komunitetit shqiptar tashmë mbi njëshekullor në Amerikë. Bërthama e tillë studimore do të ishte

nxitje e rëndësishme për mbarështrimin dhe intensifikimin e këtyre studimeve, dhe për selitjen e mëtejme të raporteve të miqësisë kaq shumë të çmuar midis dy popujve

Prishtinë, 26 shtator 2015

Pjesëmarrësit e Konferencës

1. Albert Riska
2. Ali Aliu
3. Anton Berishaj
4. Artur Karasiński
5. Bahri Beci
6. Bardh Rugova
7. Bardhyl Demiraj
8. Bashkim Kuçuku
9. Bavjola Shatro
10. Besim Kabashi
11. Besnik Pula
12. Blertë Ismajli
13. Brian Joseph
14. Carly Dickerson
15. Carrie Ann Morgan
16. Dhurata Shehri
17. Eqrem Basha
18. Flora Dado
19. Gianni Belluscio
20. Imri Badallaj
21. James J. Pennington
22. Jani Thomai
23. Jonida Xhyra-Entorf
24. Julie Kolgjini
25. Kastriot Marku
26. Ke Jing
27. Kolec Topalli
28. Kujtim Shala
29. Ledi Shamku-Shkreli
30. Lindita Sejdiu-Rugova
31. Mario De Matteis
32. Mehmet Halimi
33. Mehmet Kraja
34. Mimoza Priku
35. Muhamet Hamiti
36. Rexhep Ismajli
37. Rrahman Paçarizi
38. Rusana Bejleri
39. Sabri Hamiti
40. Seit Mansaku
41. Shaban Sinani
42. Shkumbin Munishi
43. Shpend Bengu
44. Teuta Abrashi
45. Valter Memisha
46. Vesel Nuhiu
47. Victor Friedman
48. Zymer Neziri

CALL OF THE CONFERENCE "ALBANIAN STUDIES IN AMERICA''

At the conclusion of a successful scholarly conference, following numerous analytical and in-depth analyses, we, the participants from Kosova, Albania, the United States, and other countries of the world came to a joint conclusion that Albanian studies in general, and Albanian studies in America in particular, despite the lack of a center of gravity, represent an important branch of Albanian studies in the world today. We note with pleasure that they are continually on the rise thanks to the presence of Albanians from all Albanian-inhabited territories, and they especially benefit from the recent developments in the fields of philological, linguistic, social, and historical studies on that continent. Taking into account the need to address issues relating to the Albanian world and the American world, issues concerning the community living there, and also including academic interests in general, as well as the important role that these studies have played and continue to play in relations between respective nations and countries, we call on the public and scholarly community, the scientific and university authorities in Kosova and Albania, the university and scientific authorities in the United States, the Albanian community in the United States, and all common relevant factors of the Albanian world and American world to consider with priority the issue of establishing an educational research center for Albanian studies at a US university and conforming to that university's standards. The center would specifically deal with studies in the fields of the studying and teaching of Albanian language and culture and would also serve for the preservation of the centennial Albanian heritage in America. This would be an important stimulus for the advancement and intensification of

these studies and would further strengthen the friendly and valuable relations between the two nations.

Prishtina, 26 September 2015

Participants of the scholarly conference "Albanian Studies in America" (25-26 September 2015)

SHTOJCË: PROGRAMI I PUNËS I KONFERENCËS DHE ABSTRAKTET

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË
SECTION OF LINGUISTICS AND LITERATURE

KONFERENCË SHKENCORE
SCHOLARLY CONFERENCE

STUDIMET ALBANISTIKE NË AMERIKË
ALBANIAN STUDIES IN AMERICA

SHTATOR 25-26 SEPTEMBER 2015

PROGRAMI I KONFERENCËS
CONFERENCE PROGRAM

PRISHTINË PRISHTINA

Marrin pjesë/Participants:

49. Albert Riska
50. Ali Aliu
51. Anton Berishaj
52. Artur Karasinski
53. Bahri Beci
54. Bardh Rugova
55. Bardhyl Demiraj
56. Bashkim Kuçuku
57. Bavjola Shatro
58. Besim Kabashi
59. Besnik Pula
60. Blertë Ismajli
61. Brian Joseph
62. Carly Dickerson
63. Carrie Ann Morgan
64. Dhurata Shehri
65. Eqrem Basha
66. Flora Dado
67. Gianni Belluscio
68. Imri Badallaj
69. James J. Pennington
70. Jani Thomai
71. Jonida Xhyra-Entorf
72. Julie Kolgjini
73. Kastriot Marku
74. Ke Jing
75. Kolec Topalli
76. Kujtim Shala
77. Ledi Shamku-Shkreli
78. Lindita Sejdiu-Rugova
79. Mario De Matteis
80. Mehmet Halimi
81. Mehmet Kraja
82. Mimoza Priku
83. Muhamet Hamiti
84. Rexhep Ismajli
85. Rrahman Paçarizi
86. Rusana Bejleri
87. Sabri Hamiti
88. Seit Mansaku
89. Shaban Sinani
90. Shkumbin Munishi
91. Shpend Bengu
92. Teuta Abrashi
93. Valter Memisha
94. Vesel Nuhiu
95. Victor Friedman
96. Zymer Neziri

Këshilli organizues/Organizing Committee:
Rexhep Ismajli, Prishtinë
Victor Friedman, Chicago
Eqrem Basha, Prishtinë
Përgjegjës për kontakte/Contact person:
Hilmi Zogjani, Prishtinë
Tel. + 381 (0) 38 211 619
e-mail: hilmi.zogjani@ashak.org

INFORMACION RRETH KONFERENCËS

Pjesëmarrësit e Konferencës që vijnë nga jashtë do të vendosen në Hotel Sirius, në afërsi të Akademisë.

Punimet e konferencës fillojnë më 25 shtator dhe zhvillohen për dy ditë në mjediset e ASHAK-ut, ku ardhja dhe regjistrimi i pjesëmarrësve pritet duke filluar nga ora 8:00. Konferenca i fillon punimet në 8:30.

Secili folës ka në dispozicion deri në 15 minuta, ndërsa pas çdo kumtese rezervohen 5 minuta diskutim.

Kumtesat e radhitura në formë elektronike i dorëzohen sekretarisë, e cila do të merret me përgatitjen për botim të vëllimit me punimet e konferencës. Për ata që kanë nevojë për rishikim jepet një afat deri më 15 nëntor 2015 për ta dorëzuar versionin përfundimtar.

CONFERENCE INFORMATION

Conference participants from abroad will be accommodated at the Sirius Hotel, Prishtina (close to the ASHAK building).

The conference will be held at the ASHAK premises on 25 and 26 September. Registration of participants will take place on 25 September, at the ASHAK main hall, starting from 8:00. The conference sessions start at 8:30.

Oral presentations will be 15 minutes in duration, with an additional five minutes allotted for questions and answers directly after each presentation.

Participants are kindly asked to submit their papers (electronic copy) to the Conference Secretariat in charge of publishing the conference materials. Those who may need additional time to review their papers can submit the final versions by 15 November 2015, at the latest.

E premte/Friday, 25 shtator/September

Drejtojnë/Moderated by: Victor FRIEDMAN, Rexhep ISMAJLI, Eqrem BASHA

8:30 Rexhep ISMAJLI, Prishtinë: Studimet albanistike në Amerikë – fjala e hapjes

8:50 Victor FRIEDMAN, Chicago: Gjuha shqipe në Amerikë: Perspektiva akademike

9:10 Sabri HAMITI, Prishtinë: Ujdhesa e shpëtimit

9:30 Brian JOSEPH, The Ohio State University: Përfytyrimi i shqipes ndër gjuhëtarët e hershëm amerikanë

9:50 Besnik PULA, New York: Studimet albanistike në Amerikë: dështimet në institucionalizim

10:10 Shaban SINANI, Tiranë: Albanian Catholic Bulletin, një dritare ndihmesash në shkencat kombëtare ndër dijetarët shqiptaro-amerikanë

10:30 Seit MANSAKU, Tiranë: Probleme të paskajores së shqipes në kontekstin e gjuhësisë ballkanike sipas veprës së studiuesit Brian D. Joseph

10:50 Vesel NUHIU, Prishtinë: Fonetika e shqipes nga G. S. Lowman

Pushim për kafe/ Coffee break

Drejtojnë/Moderated by: Jani THOMAI, Vesel NUHIU, Seit MANSAKU

11:20 Kolec TOPALLI, Tiranë: Për një shtresim kronologjik-etimologjik të leksikut fetar në poezitë e Nolit

11:40 Bardhyl DEMIRAJ, München: Për njohjen dhe zbatimin e teorisë së laringaleve IE në studimin diakronik të shqipes

12:00 Gianni BELLUSCIO, Cosenza: Dialektologu me çizme të bardha. Eric Pratt Hamp-i dhe Arbëreshët

12:20 Albert RISKA, Elbasan: Përkimet leksikore rumuno-shqiptare në këndvështrimin e Eric P. Hamp

12:40 Bardh RUGOVA, Prishtinë: Kontributi i Bevington-it për fonologjinë e shqipes – theksi si rast studimi

13:00 Teuta ABRASHI, Prishtinë: Lidhja ndërmjet kundërvënies aspektore aorist/ imperfekt dhe nyjës shquese/ joshquese

13:20 Lindita SEJDIU-RUGOVA, Prishtinë: Kundërvëniet aspektore brenda shqipes në studimet e Friedman-it dhe në studimet e sotme të shqipes

13:40 Blertë ISMAJLI, Prishtinë: Përtej mënyrës? Vështrime rreth modalitetit në raport me habitoren te Friedman

14:10-16:00 Dreka/Lunch

16:10 Drejtojnë/Moderated by: Bardhyl DEMIRAJ, Mimoza PRIKU, Bardh RUGOVA

16:00 Jani THOMAI, Tiranë: Fjalori anglisht-shqip i Leonard Newmark-ut

16:20 Rrahman PAÇARIZI, Prishtinë: Gramatika e Newmark-ut

16:40 Besim KABASHI, Erlangen: Leonard Newmark: Albanian-English Dictionary – një lexim

17:00 Jonida XHYRA-ENTORF, München: Shkoklitje socio-kulturore në "OAED" hartuar nga Newmark

17:20 Mimoza PRIKU, Shkodër: Fuqia e fjalës në fjalor: fjalësi shqip në Fjalorin shqip-anglisht të Leonard Newmark-ut

17:40 Valter MEMISHA, Tiranë: Rreth ndihmesës së Nelo Drizarit në leksikografinë anglisht-shqip e shqip-anglisht

Pushim për kafe/Coffee break

18:20 Drejtojnë/Moderated by: Kolec Topalli, Rusana Bejleri, Rrahman Paçarizi

18:20 Bahri BECI, Paris: Janet Byron për historinë e formimit të shqipes standarde

18:40 Imri BADALLAJ, Prishtinë: Janet Byron mbi bazën dialektore të gjuhës standarde shqipe dhe qëndrimi zyrtar ndaj dialekteve

19:00 Ledi SHAMKU-SHKRELI, Tiranë: Kontributi i Janet Byron

19:20 Carrie Ann MORGAN, The Ohio State University/ Tiranë: Ideologjitë gjuhësore në Tiranë

19:40 Shkumbin MUNISHI, Prishtinë: Pikëpamjet për shqipen standarde të zhvilluara në SHBA

20:00 Julie KOLGJINI, Prishtinë: Aesthetic Disruptions of Standard Language Ideology: the Case of Albanian

E shtunë/Saturday 26 shtator/September

8:30 Drejtojnë/Moderated by: Bahri BECI, Brian JOSEPH, Imri BADALLAJ

8:30 Ali ALIU, Prishtinë: Histori dhe doracak i letërsisë – rasti Elsie

8:50 Rusana BEJLERI, Sofje: Kontributi unik i albanologut kanadez Robert Elsie në botë

9:10 Mehmet KRAJA, Prishtinë: Ëndrra amerikane e shqiptarëve. Vështrim politik dhe historik mbi diasporën shqiptare në Amerikë

9:30: Bashkim KUÇUKU, Tiranë: Shkrimtari dhe diktatura, 1957-1990 të akademikut australian Peter Morgan

9:50 Kujtim SHALA, Prishtinë: Noli: historia..., revolucioni... e autobiografia

10:10 Mehmet HALIMI, Prishtinë: Funksioni semantik e artistik i kompozitave në vep-rimtarinë letrare të Nolit

10:30 James J. PENNINGTON, The Ohio State University: Coastal Convergence: Monte-negrin impact on the grammar of Albanian speakers in Ulcinj/Ulqin

Pushim për kafe/Coffee break

11:20 Drejtojnë/Moderated by: Kujtim SHALA, Flora DADO, Ali ALIU

11:40 Flora DADO, Tiranë: Arshi Pipa, midis filozofisë së jetës dhe filozofisë së artit (Qasje kontradiktore në filozofinë e interpretimit letrar)

12:00 Bavjola SHATRO: Albanian Studies and Comparative Literature in the North American Academe

12:20 Anton BERISHAJ, Prishtinë: Arshi Pipa: Kritika politike

12:40 Dhurata SHEHRI, Tiranë: Kritika e Arshi Pipës

13:00 Kastriot MARKU, Milano: Kontributi i A. Pipës në kritikën dhe studimet letrare

13:20 Muhamet HAMITI, Prishtinë: Letërsia shqipe dhe perspektiva e A. Pipës

13:40 Ke JING, Pekin: Tjetri në veprën e Kadaresë: një qasje kino-amerikanë

14:00 Dreka/Lunch

16:00 *Drejtojnë/Moderated by*: Bashkim KUÇUKU, Zymer NEZIRI, Shkumbin MUNISHI

16:00 Zymer NEZIRI, Prishtinë: Kontributi i profesorëve amerikanë M. Peri e A. Lord për epikën gojore shqiptare
16:20 Carly DICKERSON, The Ohio State University: Burrnesha: Albanian sworn Virgins and the linguistic Expression of gender Identity
16:40 Artur KARASINSKI, Torunj: Trashëgimia gjuhësore dhe letrare shqipe në bibliotekën Newberry
17:00 Mario DE MATTEIS, Bochum: Das integrierte Fremdsprachen- und Sachfachlernen - auch ein Modell für das kosovarische Schulwesen auf dem Weg nach Europa?
17:20 Shpend BENGU, Tiranë: Kontributi i SHBA-së në dokumentimin e trashëgimisë kulturore shqiptare
17:40 Anton ÇEFA, New York: Veprimtaria e Sami Repishtit
18:00 *Drejtojnë/ Moderated by: Rexhep ISMAJLI, Victor FRIEDMAN, Eqrem BASHA*
Mbyllja e Konferencës - Closing comments

20:00 Darka e përbashkët/Dinner (all participants)

ABSTRAKTET/ ABSTRACTS

1. Albert RISKA, Elbasan: PËRKIMET LEKSIKORE RUMUNO-SHQIPTARE NË KËNDVËSHTRIMIN E ERIC P. HAMP

Në këtë artikull diskutohet mbi qëndrimin dhe ndihmesën e indoeuropianistit amerikan Eric P. Hamp lidhur me një nga problemet më interesante të listorisë së gjuhës shqipe. Është fjala për burimin e fjalëve të përbashkëta midis shqipes dhe rumanishtes, apo të atyre elementeve leksikore që (për të përdorur një shprehje të Hamp-it) nga aspekti rumun i vështrimit quhen "autoktone". Çështja e burimit të fjalëve të përbashkëta midis rumanishtes dhe shqipes është rrokur nga mjaft dijetarë të tjerë, rumenologë e albanologë, para Hamp-it e pas tij, por, duke qëndruar në pozitat e indoevropianistit, Hamp-i duket se ka gjetur çelësin e duhur, jo vetëm për të dhënë zgjidhje të pranueshme, por edhe për të çelur një shteg që vlen të ndiqet nga të tjerë.

2. Ali ALIU, Prishtinë: HISTORI DHE DORACAK I LETËRSISË

Në këtë kumtesë diskutohen sfidat e një historie të letërsisë shqipe përmes vështrimit të procedeve dhe të rezultateve që ka ndjekur Robert Elsie, të para dhe në përqasje me të tjerët.

3. Anton BERISHAJ, Prishtinë: ARSHI PIPA: KRITIKA POLITIKE

Në studimet letrare shqiptare jashtë vendit, posaçërisht ato të zhvilluara pranë qendrave të ndryshme universitare në SHBA, Arshi Pipa zë një vend të veçantë – si për nivelin akademik të studimeve të tij, ashtu edhe për metodat e zbatuara. Kjo vlen posaçërisht për qasjen e tij të veçantë nga perspektiva e sociologjisë së letërsisë dhe kritikës politike (Eagleton), si të autorëve të traditës letrare – romantike (De Rada) dhe pasromantike (Migjeni e të tjerë), por edhe të autorëve bashkëkohorë (Kadare). Kjo qasje metodologjike ia ka mundësuar Pipës që letërsinë shqipe ta shohë nga një perspektivë radikale, por njëkohësisht tradicionale dhe shpesh kontraverze. Pipa diskursin letrar e sheh në relacione specifike me politikën dhe të kushtëzuar nga ajo – d.m.th. me "mënyrën e organizimit të jetës në shoqëri dhe çështjet e shpërndarjes së fuqisë/ pushtetit".

4. Anton ÇEFA, New York: VEPRIMTARIA E SAMI REPISHTIT

Në këtë kumtesë jepet një pasqyrë e punës qytetare, përfshirë veprimtarinë për Kosovën, sidomos për të drejtat e njeriut, dhe autriale letrare e studiuese të njërit nga të shquarit të mërgatës shqiptare në Amerikë – Sami Repishtit.

5. Artur KARASINSKI, Torunj: TRASHËGIMIA GJUHËSORE DHE LETRARE SHQIPE NË BIBLIOTEKËN NEWBERRY

The paper "Trashëgimia gjuhësore dhe letrare shqipe në bibliotekë Newberry" concerns

the role of Newberry Library in Chicago and the characteristics of one of the most important linguistic and literary Collection of the Prince Louis Lucien Bonaparte. Part of the Albanian heritage that left this English linguist and dialectologist is a large number of positions of the Albanian literary classics including the beginnings of written literature as well as major works that began to appear along with the literary revival in Albanian lands and diasporas in the second half of the nineteenth century – the begging of Rilindja period. In addition to the characteristics of the most important items of this collection, in the paper would be included practical information related to access to this enormous collection and scholarships that offers Newberry Library in Chicago.

6. Bahri BECI, Paris: JANET BYRON PËR HISTORINË E FORMIMIT TË SHQIPES STANDARDE

Objekt i kumtesës sime do të jetë përcaktimi i vendit të veprës së Xh. Bajron në historinë e studimit të shqipes standarde. Vepra e saj Përzgjedhje midis alternativash në standardizimin e gjuhës. Rasti i shqipes, u shkrua kur në ShBA problemet e planifikimit gjuhësor ishin në rend të ditës si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik.
Ishte koha kur në Shqipëri përfaqësuesit e gjuhësisë zyrtare të kohës gjuhësinë shqiptare e kishin shpallur si gjuhësi "marksiste" dhe të gjitha shpjegimet për historinë e shqipes standarde pretendohej të bëheshin mbi këtë bazë.
Ky ishte pak a shumë edhe konteksti që, në një mënyrë a në një tjetër, ka përcaktuar dy qëndrime në shpjegimin e historisë së formimit të shqipes standarde atë të gjuhësisë shqiptare zyrtare dhe atë të Xhenet Bajronit.
Në këtë kontekst janë bërë edhe vlerësimet e veprës saj nga përfaqësuesit e gjuhësisë zyrtare të kohës deri në vitin 1990.
Pikërisht pikëpamjet e saj për historinë e formimit të shqipes standarde, po edhe qëndrimet kontradiktore ndaj veprës së saj para dhe pas vitit 1990, do të jenë objekt i kësaj kumtesë kushtuar veprës së Xh. Bajron.

7. Bardh RUGOVA, Prishtinë: KONTRIBUTI I BEVINGTON-IT PËR FONOLOGJINË E SHQIPES – THEKSI SI RAST STUDIMI

Ky punim mëton të hulumtojë ndikimin e studimeve të Gary L. Bevington-it në fonologjinë shqiptare, me vështrim të posaçëm theksin e shqipes. Bevington ka sjellë studimin e parë gjenerativ të fonologjisë së shqipes. Punimi i tij, duke mos i marrë parasysh varietetet tingullore brenda vetë shqipes, nuk i përfshin rregullat e detajuara, por vetëm vlerat binare brenda gjenerativizmit. Megjithatë, studimet e mëvonshme të teorisë së optimalitetit (Trommer, Grim 2004, Trommer 2005) mbështeten në të dhënat e Bevingtonit, ndërsa trajtimi i theksit në bazë të kësaj teorie (Bozovic 2013) vazhdon të trajtohet. Studimi, po ashtu, nxjerr në pah se puna e Bevingtonit kryesisht është kufizuar brenda sistemeve të zgjedhimit dhe të fleksionit të emrave, pa e trajtuar në plotni morfologjinë derivacionale.
Fjalët kyçe: theks, vlerë binare, infleksion, variant i fonemës, teori e optimalitetit

8. Bardhyl DEMIRAJ, LMU München: PËR NJOHJEN DHE ZBATIMIN E TEORISË SË LARINGALEVE IE NË STUDIMIN DIAKRONIK TË SHQIPES

Vështrimi perspektiv i zhvillimeve të shkencës së indoeuropianistikës prej gjysmës së dytë të shek. XX, duke përfshirë këtu prurjet e studiuesve albanologë amerikanë (R. Minshall 1956; E. Hamp 1964, M. Huld 1984, Brian Joseph etj.) dëshmon efektivitetin e zbatimit të teorisë së laringaleve ie. në hetimin e fazave të kryehershme të evolucionit të protoshqipes si degë e veçantë e familjes indoeuropiane. Këtë përfundim e mbështesin plotësisht edhe rezultatet e studimit tonë, ku jemi fokusuar pikërisht në rrugët e zhvillimit dhe të përftimit të dysisë fonologjike /r/ ~ /rr/ në gjuhën shqipe, duke parë me këtë rast mundësinë e zbatimit të teorisë së laringaleve ie. si të vetmin opsion që ofron zgjidhje të kënaqshme.

9. Bashkim KUÇUKU, Tiranë: SHKRIMTARI DHE DIKTATURA, 1957-1990 TË AKADEMIKUT AUSTRALIAN PETER MORGAN

Monografia "Kadare, shkrimtari dhe diktatura, 1957-1990" e Profesorit të Universitetit të Sidneit (Australi), Peter Morgan, njëkohësisht drejtor i Programit për Studimet Europiane në po atë universitet, botuar në anglisht prej Maney Publishing, shtëpi botuese akademike britanike me standard të lartë, me Zyra edhe në Boston (SHBA), ndonëse nuk u përket drejtpërdrejt studimeve amerikane për gjuhën, kulturën dhe letërsinë shqipe, mendojmë, se, jo vetëm për gjuhën angleze me të cilën është shkruar, por edhe për qasjen e botuesin mund të përfshihet në to. Para disa vjetësh është botuar edhe në shqip me një kulturë përkthimi dhe botimi nënvleftësuese, amatorësh. Mes disa dhjetra librave në gjuhë të huaja, që kanë objekt studimi veprën e Ismail Kadaresë, është i vetmi, me sa njohim, që vjen nga Australia, kontinenti më i largët me Shqipërinë, dhe, po ashtu, me marrëdhënie historiko-kulturore të pakta, ose të papopullarizuara deri sot. Nga tërësia e qasjeve, autori ka zgjedhur për ta parë veprën e tij përmes marrëdhënieve me censurën, problemi qeniesor/ekzistencial i krijimtarisë në diktaturë, tek e fundit, edhe i vet shkrimtarit. Monografia është ndërtuar në mënyrë polemike midis mendimit të disave, që kanë thënë, se, qëndrimi i Kadaresë në totalitarizëm ishte brenda sistemit, dhe, për pasojë, vepra në shërbim të tij, dhe, mendimit tjetër, se, pavarësisht, nga qëndrime të veçanta, "kompromettuese", ai ka qenë kundër, dhe vepra e tij ka përcjellë mesazhe lirie dhe emancipimi. Teza e pamundësisë së disidencës, në kuptimin e mirëfilltë, ndryshe nga në vendet e tjera europiane të Lindjes staliniste, mbështetet në të dhënat tipike të censurës në Shqipëri, mënyrat e imponimit të metodës së realizmit socialist nëpërmjet formimit shkollor dhe institucioneve shtetërore, të kontrollit zyrtar e të mbikqyrjes së fshehtë, përdorimit të mendimit të lexuesit të indoktrinuar, etj. Në këto rrethana, Ismail Kadaresë, sipas tij, nuk i mbetej tjetër, veçse gjuha e Ezopit, simbolet dhe alegoritë, nga njëra anë, të arrinte t'i botonte veprat kundër, dhe, nga ana tjetër, mos të kishte pasoja. Në dobi të këtij mendimi, që, me koherencë të madhe, përshkon monografinë, sillen fakte të shumtë biografikë, të formimit të autorit, të bindjeve, qëndrimit dhe alibive për botimin e veprave të caktuara, sidomos analiza e brendisë kundërtotalitare të tyre. "Do të ishte gabim, përfundon në mënyrë sintetike Peter Morgan, të paraqitej Kadareja si një figurë e heshtur gjatë diktaturës. … Kadareja shkroi disa nga veprat më të shkëlqyera dhe subversive që kanë dalë nga Europa Lindore socialiste.

10. Bavjola SHATRO: ALBANIAN STUDIES AND COMPARATIVE LITERATURE IN THE NORTH AMERICAN ACADEME

This paper aims to introduce possible paths of study for Albanian Studies seen through the perspective of Comparative literature as it is practiced in North American universities, mainly in the United States of America. Emphasis will be given to the factor of language, and the particularities that make Albanian literature a very fertile ground for research, which would help introduce this literature to international readership and academe. This approach aims to highlight the potential for the developing of comparatism in Albanian Studies as a discourse that constantly questions status quos in the literary process and in the society in general.
Among the questions that the paper endeavors to deal with are the aspects of Albanian literature that could be of interest considering the essentially interdisciplinary nature of comparative literature in North America and why this interdisciplinarity would be fruitful to Albanian Studies. Albanian Studies cannot afford to develop within the national borders or worse within state borders; nor can it afford to be self-centered and to disregard relationships to other arts, to history, philosophy, sociology and other sciences. This perspective which is quite common and stands at the heart of Comparative Literature in the United States academe would surely support the communication of Albanian Studies and Albanian literature in particular with other literatures and cultures, which is a crucial precondition to a deeper understanding of the development of Albanian literature itself as well as of a better understanding of the nature of literature. Albanian literature will not have to be seen any longer under the sole area of South-East European Literatures; instead it would become an active part of a large worldwide discourse on literature and culture, which American comparativism highly values and practices since WWII.

11. Besim KABASHI, Erlangen: LEONARD NEWMARK: ALBANIAN-ENGLISH DICTIONARY – NJË LEXIM

Fjalori shqip-anglisht i autorit Leonard Njumark (Newmark) është një vepër jo e rëndomtë në leksikografinë dygjuhësore shqip-gjuhë tjetër. Ai ngërthen në vete disa veçori të cilat e bëjnë atë ndryshe nga fjalorët e mëparshëm shqip-anglisht e kryesoret janë: (1) përfshirja e një numri të madh të zërave që nuk shihen si pjesë e gjuhës standarde; (2) shënimi në një formë ndryshe i të dhënave morfologjike/ gramatikore; (3) përfshirja e një numri të madh të kolokacioneve dhe të frazeologjizmave; dhe (4) përfshirja e një numri të madh të zërave nga fusha të ndryshme shkencore, për herë të parë, në një fjalor të këtij lloji.
Në vijim do të shqyrtohen këto veçori, në veçanti të dhënat morfologjike/gramatikore, të cilat janë një risi në leksikografinë shqiptare dhe janë një këndvështrim i ndryshëm nga përshkrimi i tyre i deritashëm. Një pjesë shumë e vlefshme e tyre janë të sistemuara e të përmbledhura në formë udhëzuesi për lexuesin e fjalorit.

12. Besnik PULA, New York: STUDIMET ALBANISTIKE NË AMERIKË: DËSHTIMET NË INSTITUCIONALIZIM

Studimet albanistike në SHBA datojnë të paktën që nga fillimi i shek. XX. Një shtytje të madhe për ngritjen e studimeve albanistike në SHBA i dha mërgata e hershme shqiptare, e ardhur kryesisht nga jugu i Shqipërisë. Pas Luftës së Dytë Botërore nisin përpjekjet e para për institucionalizimin e studimeve albanistike në SHBA. Përkundër rezultateve në nxitjen e studimeve albanistike në SHBA gjatë viteve 1950 e tutje, këto suksese modeste

në pikëpamje sasiore nuk ndiqen me suksese në institucionalizimin e studimeve albanistike në kuadër të sistemit universitar amerikan. Ky punim do t'i diskutojë disa nga përpjekjet për institucionalizimin e studimeve albanistike në SHBA dhe sfidat që vazhdojnë t'i kenë studimet albanistike në këtë drejtim.

13. Blertë ISMAJLI, Prishtinë: PËRTEJ MËNYRËS? VËSHTRIME RRETH MODALITETIT NË RAPORT ME HABITOREN TE FRIEDMAN

Diskutimi për përkatësinë e habitores si mënyrë foljore është një çështje e shtruar vetëm në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar. Tradicionalisht ajo përkufizohet si mënyrë e foljes që përdoret për të shprehur habi, dyshim, ironi. Studime të thelluara për funksionet e saj që janë bërë në gjysmën e dytë të shek. XX nxjerrin në pah edhe funksionin e referativitetit – bartjen neutrale të informatës nga folësi (Riza 1966, Fiedler 1966, Camaj 1969, Friedman 2004). Në këtë punim do të trajtohen qëndrimet e V. A. Friedman për funksionet e habitores së shqipes – apo sipas terminologjisë së propozuar nga Friedman jokonfirmativitetit (nonconfirmativity) si dhe studimet e tij për format e (jo)konfirmativitetit në shqipen në krahasim me gjuhët e Ballkanit dhe me gjuhët e Kaukazit. Këto studime vënë në pah fushën modale që mbulojnë format e habitores dhe tejkalojnë përshkrimin tradicional që ka për bazë qëndrimin folës. Theks i veçantë do të vendoset te trajtimi i habitores si kategori e evidencialitetit, pra si mjet për kodimin e burimit të indormatës.
Fjalët çelës: habitore, evidencialitet, modalitet, nonconfirmativity

14. Brian JOSEPH, The Ohio State University: PËRFYTYRIMI I SHQIPES NDËR GJUHËTARËT E HERSHËM AMERIKANË

Në këtë artikull pasqyroj referencat e hershme për gjuhën shqipe në letërsinë gjuhësore amerikane, duke u përqendruar kryesisht në faktin se sa dinin, apo nuk dinin amerikanët për këtë gjuhë. Shqyrtoj posaçërisht veprat e Whitney, Gray, Sturtevant, Sapir, Buck dhe Bloomfield. Fakti se gjuhëtarët amerikanë ishin pak prapa europianëve në studimet e tyre për gjuhën shqipe, natyrisht, është i kuptueshëm, por gjithsesi i shënueshëm. Ky studim jo vetëm ndihmon të kuptuarit e studimeve për shqipen, por hedh gjithashtu pak dritë mbi zhvillimin e studimeve në Amerikë.
(In this paper, I chronicle the early references to Albanian in American linguistics literature, focusing on just how much the American linguists knew -- or did not know -- about the language. I examine works of Whitney, Gray, Sturtevant, Sapir, Buck, and Bloomfield in particular. The fact that American linguists were somewhat behind the Europeans in their scholarship on Albanian is of course understandable, but is noteworthy nonetheless. This study not only adds to our understanding of scholarship on Albanian but also sheds some light on the development of linguistic scholarship in America.)

15. Carly DICKERSON, The Ohio State University: Burrnesha: ALBANIAN SWORN VIRGINS AND THE LINGUISTIC EXPRESSION OF GENDER IDENTITY

The linguistic dimensions of transgenderism have typically been studied within qualitative frameworks, and have tended to focus on marginalized groups, such as the hijras (Kulick

1997), the travestis (Hall & O'Donovan 1996) and the 'yan daudu (Gaudio 2014). Not only are there no quantitative studies of sociolinguistic variation in transgender speech generally, there is also a lack of research on transgender individuals who occupy prominent positions in mainstream society and are treated on par with their cisgender cohort.

This paper focuses on the linguistic aspects of the construction of masculine identities by the burrnesha (also known as 'sworn virgins') of northern Albania and Kosova: biological females who have become 'social men'. Unlike other 'third genders' (Kulick 1999), the burrnesha are motivated not by personal identity or sexual desire, but by the need to fulfil patriarchal roles within a traditional social code. Although they are accepted and treated as men in their community, burrnesha do not marry or engage in sexual relationships, and are thus seen as honourable and self-sacrificing (Young, 2000). Under these circumstances, how do burrnesha construct and express their identity linguistically, and how do others engage with this identity? Do burrnesha follow the linguistic construction of masculinity of biological males, or do they set themselves apart through the use of both male and female linguistic practices?

I examine the effects of social and linguistic factors on variation in the use of grammatical gender in the speech of burrnesha and others in their communities, based on conversations recorded in 2014 during fieldwork in Durrës, Elbasan, Shkodra, and surroundings areas. Quantitative analysis reveals that choices in the grammatical gender used to refer to burrnesha are linked to the speaker's relationship to them, the time period being referred to (pre- or post-transition), and the expression of particular traits (such as pride or strength). Situated within a culture that embraces women becoming men, this study sheds light onto the linguistic practices used by a community in the co-construction of gender.

16. Carrie Ann MORGAN, The Ohio State University/ Tiranë: IDEOLOGJITË GJUHËSORE NË TIRANË

Që nga koha e Osmanëve, ideologjitë gjuhësore kanë përfaqësuar dy dialektet kryesore të shqipes përkatësisht me figura kulturale që karakterizohen si rurale/jo e zhvilluar/e mbyllur dhe urbane/e zhvilluar/e hapur. Në kohën e socializmit, këto figura janë përforcuar gjatë procesit të standardizimit të gjuhës shqipe. Megjithatë falë migrimit të brendshëm dhe ndryshimeve politike, ideologjitë gjuhësore kanë filluar të ndryshojnë në Shqipërinë postsocialiste, sidomos në Tiranë ku kontakti mes varieteteve të shqipes ka pësuar një rritje si rezultat i këtij migrimi. Ky studim përqendrohet tek shfaqja e ideologjive gjuhësore në diskurs si dhe në përdorimin e varieteteve të ndryshme në intervista me studentët në Tiranë. Në këtë kumtesë do të analizoj kuptimin socio-indeksues të varieteteve të shqipes dhe çka tregojnë për mënyrën në të cilën folësit ndajnë këto varietete.

17. Dhurata SHEHRI, Tiranë: KRITIKA E ARSHI PIPËS

Kumtesa do të përqendrohet në studimet e Arshi Pipës, një prej autorëve më të rëndësishëm të kritikës shqiptare. Në brendësi hulumtimi do të ndjekë këto rrugë:

- Do të tentojë një tipologjizim brendshëm të kritikës së Pipës.
- Do të analizojë disa nga tezat themelore të kritikës së Pipës dhe "rrezatimin" e tyre.

- Do të analizojë modelet kritike të pranishme në kritikën e Pipës.
- Do të krahasojë kritikën e Pipës në diasporë me kritikën "zyrtare" brenda Shqipërisë për çështje të njëjta.
- Do të analizojë ndikimin e Pipës në ndërtimin e "kanonit" letrar shqiptar.

18. Flora DADO, Tiranë: ARSHI PIPA, MIDIS FILOZOFISË SË JETËS DHE FILOZOFISË SË ARTIT (QASJE KONTRADIKTORE NË FILOZOFINË E INTERPRETIMIT LETRAR)

Në këtë referim konceptet teorike të Arshi Pipës, lidhur me kuptimin dhe interpretimin e veprës letrare, do të shihen në tre boshte themelore, në atë të filozofisë, si dije universale njerëzore, të filozofisë së artit letrar, ashtu siç e koncepton ai, dhe filozofisë së gjykimit letrar. Në këtë trekëndësh, të përfytyruar prej nesh, ku dija racionale e njeriut dhe prirja intuitive e kuptimit dhe interpretimit të gjërave krijojnë raporte sa të logjikshme aq dhe misterioze, shprehet kalimi i natyrshëm nga koncepti filozofik i Pipës mbi jetën dhe njeriun, te koncepti mbi thelbin e artit letrar dhe pastaj tek mënyra e interpretimit të letërsisë. Synimi ynë është të depërtojmë në sistemin e të menduarit filozofik dhe gjykimit letrar, të gjejmë lidhjen e brendshme midis këtyre tre llojeve të krijimit, ku, sipas tij, faktori kryesor është intuita . Vëmendja do t'i kushtohet kryesisht skajit të tretë të trekëndëshit të sistemit teorik të A. Pipës, që ndërtohet mbi tezën: kritika unjisohet me vetë filozofinë. Në konceptin e tij studiuesi e ngre nivelin e gjykimit letrar përtej aspektit thjesht filologjik, paraqitjes se fakteve artistike të veçuara apo të sistematizuara. Në sistemin e të menduarit teorik të A. Pipës do të gjejmë mpleksjen e një varg tezash e pikëvështrimesh të letërsisë që nisin, nga shekulli XIX pozitivist, e deri në shekullin XX, ku intuitivizmi, formalizmi, hermeneutika, etj. ndeshen, qasen, largohen, për ta bërë më aktiv dhe më interesant mendimin filozofik dhe kritik mbi artin letrar. Mbi këtë bazë, synojmë të interpretojmë edhe disa kontradikta në sistemin e filozofisë kritiko-letrare të A. Pipës. Kjo jo thjesht si një dukuri e kritikueshme, por si shprehje e thelbit kompleks të letërsisë, çka reflektohet edhe në interpretimet e saj.

19. Gianni BELLUSCIO, Cosenza: DIALEKTOLOGU ME ÇIZME TË BARDHA. ERIC PRATT HAMP-I DHE ARBËRESHËT

Ishte marsi i vitit 1950 kur prof. Joshua Whatmough (1897-1964), i Universitetit të Harvard-it, i nisi një letër prof. Carlo Tagliavini-t (1903-1982) të Universitetit të Bologna-s për t'i rakomanduar një student të doktoratës, i cili shfaqte interes për studimin e shqipes dhe të dialekteve të saj. Pikërisht me atë letër dhe nëpërmjet Tagliavini-t fillojnë marrëdhëniet e Eric Pratt Hamp-it (1920) me arbëreshët. Pas asaj letre Tagliavini takon Hamp-in në Bologna dhe i propozon të shkojë për të verifikuar në terren diçka të habitshme, faktin që në Kalabri, në provincën e Kozencës, në mes të një numri të madh të folmesh me tipologji toske, ka edhe një të folme për të cilën thuhet që paraqet tipare gege, e folmja e Vakaricit (Vaccarizzo Albanese). Me atë anketë që zgjati për rreth dy vjet dhe me prezantimin e disertacionit të doktoratës më 1954 nisin kërkimet, studimet, botimet, marrëdhëniet e Hamp-it për dhe me arbëreshët. Këto marrëdhënie, që do të zgjasin për plot gjashtëdhjetë vjetët e ardhshëm, kam dëshirë t'i përshkruaj dhe do të jenë përmbajtja e këtij kontributi.

20. Imri BADALLAJ, Prishtinë: JANET BYRON MBI BAZËN DIALEKTORE TË GJUHËS STANDARDE SHQIPE DHE QËNDRIMI ZYRTAR NDAJ DIALEKTEVE

Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe i vitit në Tiranë, trazoi kërshërinë e shumë gjuhëtarëve brenda trojeve shqiptare dhe jashtë tyre, sidomos normëzimi i toskërishtes, veçanërisht i toskërishtes së shkruar, shkaktoi reagime të karakterit sa shpjegues, aq edhe polemizues. Me këtë rast gjuhëtarja amerikane Janet Byron arriti në gjuhësinë shqiptare me veprën Përzgjedhje ndërmjet alternativave në standardizimin e gjuhës: Selection among alternates in language standardization: The case of Albania, botuar më 1976.
Kjo gjuhëtare e ka meritën e veçantë në gjuhësi, sepse e para doli, duke i vënë në dukje problemet e politikës dhe të planifikimit gjuhësor të shqipes me një mbështetje të teorive gjuhësore, që në ato vite ishin më standardet. Kjo me mprehtësi i studioi të gjitha materialet e Kongresit të Drejtshkrimit të vitit 1972, që u bind se normëzimi i gjuhës në Shqipëri konceptohej si propagandë, e cila i shërbente ideologjisë marksiste-leniniste. Ajo e ka mbështetur këtë vepër në bazë të teorive gjuhësore tek gjuhëtarët: Rey, Haugen, Tauli, Fishman, Ferguson e të tjerë.
Shqipëria në vitet e shtatëdhjeta kishte arritur nivelin më të lartë të diktaturës, që kjo atmosferë shumë e zymtë dhe fort frikësuese e kishte mbyllur diskutimin mbi historinë e formimit të shqipes standarde pa ndonjë takim shkencor, ku do të diskutohej mbi bazën dialektore dhe zhvillimet e mundshme, që janë bërë brenda tyre. Kështu që gegërishtja u flak si një leckë dhe po të bënte dikush një fjalë të vetme në favor të saj, Kostallari dhe përkrahësit e tij do ta vlerësonin si antikombëtar dhe reaksionar. Ky qëndrim, thjesht e la gegërishten vetëm si variant të komunikimit familjar. Prandaj, Byron me argumente shkencore konkludon, se shqipja standarde është vetë dialekti toskë. Në këtë kumtesë, i kemi vënë në dukje pikëpamjet e kësaj gjuhëtare mbi bazën dialektore dhe qëndrimin zyrtar ndaj dialekteve të shqipes në planifikimin dhe normëzimin e saj. Siç shton ajo, kur e morën pushtetin, drejtuesit toskë e ngritën në një status më të lartë dialektin e tyre, duke mos i lënë asnjë mundësi inkuadrimit të gegërishtes brenda shqipes standarde.

21. James J. PENNINGTON, The Ohio State University: COASTAL CONVERGENCE: MONTENEGRIN IMPACT ON THE GRAMMAR OF ALBANIAN SPEAKERS IN ULCINJ/ULQIN.

22. Jani THOMAI, Tiranë: FJALORI ANGLISHT-SHQIP I LEONARD NEWMARK-UT

Fjalorët dygjuhësh kanë dy hapësira të mëdha: glosari në gjuhën e parë dhe identiteti leksiko-semantik me gjuhën e dytë. Unë do të merrem me hapësirën e parë në fjalorin e Newmark-ut. Do të shoh çfarë shtresash leksikore janë pasqyruar në glosarin shqip të fjalorit, përpjesëtimi i tyre, duke i ndarë njësitë leksikografike në tri grupe sipas tipologjisë gjuhësore: njësi fjale, njësi nënfjale dhe njësi mbifjale. Në secilin grup do të ketë ndarje të brendshme sipas tipit të njësive, natyrisht duke i vlerësuar ato sipas kritereve leksikografike të zbatuara në fjalorin e dhënë, për të mbërritur te vlerësimi i përgjithshëm i fjalorit nga pikëpamja e tipologjisë leksikografike, e synimeve të autorit, e realitetit gjuhësor të shqipes etj.

23. Jonida XHYRA-ENTORF, München: SHKOKLITJE SOCIO-KULTURORE NË "OAED" HARTUAR NGA NEWMARK

Hartimi i një fjalori shoqërohet gjithmonë me prezantimin e një kulture. Fjalorët japin një përgjigje specifike dhe përmbajnë një funksion përkatës në sistemin arsimor dhe në dijen kolektive. Leksikografia shqipe-angleze jashtë Shqipërisë e Kosovës, përfaqësuar për një kohë të gjatë përmes An Historical Albanian-English Dictionary të vitit 1948 me hartues Stuart E. Mann, shënon një arritje të padiskutueshme me botimin gati një gjysmë shekulli më vonë të Oxford Albanian-English Dictionary nga Leonard Newmark. Një fjalor dygjuhësh sjell në lidhje të ndërsjelltë kodifikimet leksikore të dy gjuhëve të ndryshme në mënyrë që përdoruesi të prodhojë përgjegjëse të qarta e të njëkuptimshme, por pas të dhënave dhe informacioneve ravijëzohen gjithmonë arsyet e përzgjedhjes. Si përvijohet dimensioni sociokulturor i kësaj ndërmarrjeje madhore leksikografike duke pasur parasysh tipologjinë, makrostrukturën dhe mikrostrukturën e saj, por gjithashtu edhe në këndvështrimi e dyfishtë të hartuesit e të recipientit si në gjuhën burimore, ashtu dhe në atë të synuar?

24. Julie KOLGJINI, Prishtinë: AESTHETIC DISRUPTIONS OF STANDARD LANGUAGE IDEOLOGY: THE CASE OF ALBANIAN

Throughout the past few decades standard language ideology and language choice, in particular in terms of spoken and written modes of communication, have been investigated extensively for numerous languages (e.g. British and American English). Few contemporary studies, however, have investigated the incurporation of alternative pools of linguistic resources and repertoires as found in the often stigmatized (sub)varieties of Albanian, including those in the literary works of the often-overlooked Albanian-American Miftar Spahija, as legitimate options. Paralleling the implementation of the hegemonic standard language ideology of Unified Literary Albanian, while also refusing to acquiesce to its fixed linguistic resources, Spahija (1990, 1998) embraces a trajectory that explores continuities across and within linguistic varieties. In doing so, he embarks upon a course similar to that of some of his predecessors and contemporaries, e.g. Ernest Koliqi (e.g. 2000, 2004) and Martin Camaj (e.g. 1994, 1996, 2001), among others. Spahija aesthetically interweaves linguistic hybridity, polycentrism, codemeshing, translanguaging, innovative coinages, and ludic components, among other linguistic mechanisms, within a fluid system, as is often celebrated in late and post-modern accounts of language usage practices. Rather than succumbing to restricting his linguistic resources to one rigid edifice, he pushes the boundaries of multiple systems, so as to capture the essence of linguistic agency – of the speaker, narrator, and author. Spahija's writings focus on the multivoicedness of the characters in his novels, refusing to limit them to the strict confines of the standard language culture of ULA. He does not conceal the alleged dysfluencies of katun(d)ar language practices (e.g. xhit, cf. çfarë, çka; tamël,cf. qumësht; kinxh, cf. kingj, qingj, qengj; dhami, cf. dhambi, dhëmbi; prâjshin, cf. pushonin; and lakmojshin, cf. lakmonin); rather, he endeavors to capture the intrinsic aesthetic in the heterogeneity of their usage. From the lens of critical discourse analysis, instead of composing a long treatise describing the inadequacies of the (current) standard, he provides readers with myriad examples of alternatives that surface in the author's (re)inventions of multiple linguistic histories (e.g. msojbanë, cf. msojtore, shkollë; dritore, cf. dritare, penxhere; bashkfshatas). Miftar Spahija's distinct approach is grounded in language practices in situ, thereby inviting the audience to play in his linguistic sandbox where they, too, can be

active participants in authentic language usage practices, and where each reader's language repertoire is legitimate. Spahija's writings focus on the discourse of place, situated geo-semiotic linguistic landscapes, i.e. language emergent from contextualized situations. Through his novels (batrila) he offers an original interface between language and aesthetics, where stylized codecrossing and transidiomaticity are manifest.

25. Kastriot MARKU, Milano: NDIHMESA E ARSHI PIPËS NË STUDIMET LETRARE SHQIPTARE

Në veprimtarinë e shumëdisiplinare të Arshi Pipës, një vend me rëndësi zë edhe veprimtaria e tij studimore kushtuar letërsisë, posaçërisht letërsisë shqipe. Në kumtesën tonë ne jemi përqenduar kryesisht në serinë e tij trevëllimëshe "Trilogjia Albanica" (1978), "Albanian Folk Verse", "Hieronymos De Rada "dhe "Albanian Literature: Social Perspectives ", si dhe veprën tjetër të fundit të tij në këtë disiplinë botuar në vitin 1991, me titullin: "Contemporary Albanian Literature". Nisur nga mënyra e qasjes studimore që i bën letërsisë shqipe duke shqyrtuar vargun gojor si element substancial vetanak mbi të cilin u sindërtuan elementët bazikë të poetikës shqipe si nyjëtim me rëndësi në lidhje organike me poetikën evropiane, Arshi Pipa ka gjetur dhe zgjedhur veprën letrare të Jeronim De Radës si inkursion studimor për të bërë këtë në një mënyrë mjaft origjinale. Për të zgjeruar dhe kontekstualizuar fenomenet letrare si një përqasje e re jashtë modeleve dhe stereotipave studimore që aplikonin studimet letrare në Shqipëri, Arshi Pipa do të merrte përsipër një nismë tjetër atë të shqyrtimit të letërsisë bashkëkohore shqiptare, qoftë edhe si një sprovë kurajuese për të provuar mundësinë e historishkrimit të saj me të gjithë problematikën provokuese që ajo mbartte. Në këto katër studime shihet i profiluar qartë një studiues bashkëkohor serioz i letërsisë qoftë në planin metodologjik qoftë në atë praktik realizues, që shpërfaq gjithë elementët e duhur të një qasjeje tërësore rreth teksteve letrare me një përkujdesje atërore ndaj tyre. Në këtë këndvështrim Arshi Pipa përfaqëson një zë me rëndësi meritore në panoramën e studimeve tona letrare që meriton vëmendje dhe studime të mëtejshme.

26. Ke JING, Pekin: TJETRI NË VEPRËN E KADARESË: NJË QASJE KINO-AMERIKANË

Tjetri është një koncept i rëndësishëm në studimet e identitetit. Debati midis Kadaresë dhe Qosjes në vitin 2006 shkaktoi shumë diskutime lidhur me çështjen e identitetit kombëtar shqiptar, gjë që më shtyu të shkruaj disertacionin e doktoratës mbi tjetrin e prezantuar në veprat e Kadaresë që nga vitet 60'. Disertacioni me titullin "Katër të tjerët në veprat e I. Kadaresë - Studim mbi identitetin kombëtar shqiptar", u shkrua për të parë se si tjetri për kombin shqiptar ka ndryshuar gjatë pesë shekujve të kaluar dhe se si ishin situatat përkatëse ndërkombëtare dhe vendore për nxjerrjen në pah të kategorisë së tjetrit, si perëndimor, lindor, fqinj, i brendshëm.
Vepra u krye kur autorja ishte studente në Universitetin e Lousville, SHBA. Leximet e shumta në gjuhën angleze dhe ndikimi nga udhëheqës amerikanë kanë lënë gjurmët e tyre në këtë punim disertacioni. Në të njëjtën kohë, si kineze, autorja e ka pothuaj të pamundur të shmanget nga ndikimet ideologjike të vendit të saj. Prandaj ky punim merr përsipër të ballafaqojë e të shqyrtojë ndikimet mbi autoren të pikëpamjeve të studiuesve perëndimorë si dhe të ideologjisë kineze. Me fjalë të tjera, ky punim analizon me fakte qas-

jen kino-amerikane të disertacionit të kryer para dy vjetësh, si kritikë dhe autokritikë e veprës së autores.

27. Kolec TOPALLI, Tiranë: PËR NJË SHTRESIM KRONOLOGJIK-ETIMOLOGJIK TË LEKSIKUT FETAR NË POEZITË E NOLIT

1) Leksiku biblik i poezive të Nolit dhe shtresimi i tij;
2) Shtresa autoktone e trashëguar nga fondi indoeuropian;
3) Huazimet e vjetra nga latinishtja;
4) Huazimet italiane;
5) Huazimet nga greqishtja e mesme dhe e re;
6) Huazimet turke;
7) Huazimet moderne.
Fjalët kyçe: leksik, biblik, huazim, shtresë

28. Kujtim SHALA, Prishtinë: NOLI: HISTORIA..., REVOLUCIONI... E AUTOBIOGRAFIA

Historia..., *Revolucioni...* e *Autobiografia* janë vepra diskursive e dëshmuese, të cilat e provojnë Fan S. Nolin dijetar e rrëfimtar, diskursin e motivuar të tij, pra Nolin *shkrimtar*.
Historia... rrëfen e provon Heroin nacional të shqiptarëve, *Revolucioni...* - modelin social që zgjedh Noli, ndërsa *Autobiografia* lidh në një vend jetën e veprën e Nolit si rrëfim e dëshmi.
Skënderbeu është figura që do t'i ngjajë Noli në jetën nacionale, revolucionin e provoi vetë, Autobiografia zbulon edhe figurat e tjera të identifikimit të Nolit, Krishtin - hero moral e Napolonin - hero militant.
Diskursi i *Historisë...* do diskursivitet e prova, ai i *Revolucionit...* - projeksion social, ndërsa diskursi i *Autobiografisë* personin Fan Noli e bën *informator* e *personazh*.
I lexuar në këto vepra, Noli hapet në faqet e argumentimeve të rralla, të ideologjisë, projeksioneve e të dëshmive personale.
Këto vepra e provojnë dijetarin e stilistin e zgjedhur të shqipes, retorin që njeh fuqinë e argumentit e të mesazhit, *autorin* që shkruan me *marrësin* përballë, pra *autorin* që përherë shkruan me një tendencë retorike (bindëse).
Të shkruara e të botuara në kohë të ndryshme të jetës së autorit, këto vepra provojnë konstanta të diskursit të Nolit dhe lidhin rrjetin ideve të tij në një ideologji të rrëfyer e të provuar.

29. Ledi SHAMKU-SHKRELI, TIRANË: KONTRIBUTI I JANET BYRON

30. Lindita SEJDIU-RUGOVA, Prishtinë: KUNDËRVËNIET ASPEKTORE BRENDA SHQIPES NË STUDIMET E FRIEDMAN-IT DHE NË STUDIMET E SOTME TË SHQIPES

Gramatikat e shqipes në përgjithësi i kushtojnë pak ose aspak hapësirë aspektit si kategori gramatikore. Në gramatikën e ASHRSH-së, aspekti nuk përcaktohet si kategori foljore më vete, por flitet për "forma gramatikore foljore që, përpos kuptimeve kohore, shprehin edhe ngjyrime të ndryshme aspektore" (Gramatika I, 1995: 274). Po aty, thuhet se dallimet midis të së pakryerës, të së kryerës së thjeshtë dhe të së kryerës kanë më fort karakter aspektor varësisht nga mënyra e paraqitjes së veprimit : si të përfunduar, si të papërfunduar ose si veprim në zhvillim e sipër në një çast të së shkuarës (Gramatika I, 1995:

274) .
Victor Friedman është një nga albanologët e rrallë që ndalet dhe e studion më detajisht këtë kategori. Ai në punimin e tij të botuar në vëllimin "Studies on Albanian and other Balkan Languages" (2004:291), i krahason disa tipare aspektore të shqipes në raport me bullgarishten dhe turqishten dhe arrin në përfundim se shqipja, ndryshe nga bullgarishtja dhe turqishtja, e zgjedh të kryerën (aoristin) në një strukturë të varur që shpreh sekuencë ose fillim të një veprimi dhe gjatë përkthimit nga gjuhët tjera në shqipen, aoristi përshtatet mirë me çfarëdo gjuhe që përdor aorist. Ky punim është një nga punimet e pakta të kësaj periudhe që merret me studimin e aspektit të shqipes qoftë edhe në këndvështrim krahasimtar, me atë të gjuhëve tjera ballkanike.
Në studimet e sotme, aspekti si kategori gramatikore, ndërkaq, lidhet ngushtë me qëndrimin folës dhe me mënyrën se si folësi e sheh apo e paraqet situatën e komunikimit nga aspekti kohor (këtu termi kohë ka të bëjë me kohën si temp a rrjedhë veprimi, jo si kohë foljore) - pra, mënyra se si veprimi i shprehur nga folja konsiderohet ose përjetohet në raport me kohën si koncept universal (Quirk et al, 2002: 188). Po qe se e shohim nga brenda aspektit kohor, kemi të bëjmë me aspektin progresiv (të vazhdueshëm), ndërkaq nëse e kundrojmë si një proces kohor, ku ajo si emetuese nuk mund të ndërhyjë në rrjedhën e atij procesi, atëherë kemi të bëjmë me aspektin joprogresiv.
Në terma të Huddleston-it, interpretimi i kategorisë së kohës, të mënyrës dhe të aspektit në një gjuhë do të duhej të interpretoheshin varësisht nga lloji i situatës së komunikimit të shprehur në një fjali të caktuar të asaj gjuhe (Huddlestone 2002:118). E kjo situatë mund të jetë statike ose dinamike. Kështu, duke u mbështetur në terma të tillë, në shqipen mund të flasim për situata të komunikimit që shprehin gjendje: Ata besojnë në Zot! Më pëlqen! Flamuri i Shqipërisë është i kuq! ose për një situatë dinamike që shpreh një proces aktiviteti: Ne po luajmë futboll. Unë ia lexoja përrallën Gresës. Eca gjatë në plazh. Një situatë të caktuar mund ta interpretojmë si telike (situatë e kryer, me një pikë përfundimi) që i përmbledh arritjet tona: Erdha këmbë deri në shtëpi. Ajo e shkroi librin. Erdha këmbë në shtëpi. (Eca deri në shtëpi) ose si një situatë që nxjerr në pah arritjet tona gjatë një procesi: E gjeta portofolin! (isha duke e kërkuar), Po e mbyll këtë seancë… (ishim duke diskutuar) etj.
Këto situata nganjëherë mund të dalin të kombinuara dhe shpesh janë treguesit kohorë që e bëjnë dallimin dhe na mundësojnë një interpretim të saktë. Kështu fjalia: Unë i bëra 5 km atë ditë. do të mund të interpretohej edhe si situatë që shpreh një aktivitet në një rast të caktuar, por mund të implikojë dhe idenë "unë e kisha zakon të ecja vazhdimisht çdo ditë".
Të gjitha këto situata kuptimore të aspektit na çojnë drejt aspektualitetit si kategori semantike, e cila mund të kategorizohet në dy kategori themelore: aspekti i kryer dhe jo i kryer. Shqipja ka shënjues gramatikorë të këtij kategorizimi dhe ndër më themelorët janë mbaresat vetore të së pakryerës dhe të së kryerës së dëftores: puno-ja (imperfekti) dhe kam punuar (perfekti) kundruall mbaresës së të kryerës së thjeshtë: punova (aoristi). Pra, shqipja, ngjashëm me disa gjuhë indoevropiane, e ka ruajtur sistemin tre-termësh, si pasojë e dallimit binar aspektor: perfektiv/ joperfektiv dhe durativ/ jodurativ.
Lyons-i (1968:315) e konsideron aspektin shpërndarje në kohë, ndryshe nga koha foljore që paraqet vendndodhje në kohë. Sipas tij, aspekti, ndryshe nga koha foljore, nuk është koncept deiktik, pra nuk kundrohet në raport me momentin kohor të të thënit.

Megjithatë, situatat e ndryshme të komunikimit na dalin shpesh të shumëkuptimshme edhe brenda vetë trajtës së caktuar aspektore. Po qe se i analizojmë fjalitë: a) Punoja në fabrikë dhe b) Po punoja me zell dallimi aspektor nuk është i dukshëm, derisa nuk e klasifikojmë situatën e tillë të komunikimit si gjendje (isha i punësuar në fabrikë atëbotë) dhe si aktivitet a proces dinamik (punoja me zell-akti i të punuarit).
Këtë dallim brenda aspektit jo të kryer të shqipes e që në të vërtetë shpreh një gjendje të papërfunduar a iteracion të shqipes (punoja) në raport me aoristin, i cili shpreh situata të vetme të përfunduara ose të njëpasnjëshme e të kufizuara nga aspekti kohor (punova), Breu (2010:451) e sheh si reduktim të imperfektit të thjeshtë, meqë, sipas tij, po zëvendësohet vazhdimisht me struktura perifrazuese me këtë funksion (isha duke punuar, jam duke punuar). Do theksuar se Breu (2010:451) brenda një dallimi të tillë aspektor e fut edhe dallimin brenda progresivitetit të së tashmes (po punoj / jam duke punuar). Rrjedhimisht, Breu mendon se dallimi i mirëfilltë aspektor aorist/ imperfekt po zbehet, duke i lënë vend dallimit e tashme (punoj)/ e kryer (kam punuar) si dhe raportit aspektor të së shkuarës: e pakryer (punoja)/e kryer e tejshkuar (pata punuar).

31. Mario DE MATTEIS, Bochum: DAS INTEGRIERTE FREMDSPRACHEN- UND SACHFACHLERNEN - AUCH EIN MODELL FÜR DAS KOSOVARISCHE SCHULWESEN AUF DEM WEG NACH EUROPA?

Im letzten Jahrzehnt hat sich im englischen, französischen und italienischen Sprachraum ein Begriff durchgesetzt, der in immer stärkerem Maße zur Bezeichnung des Konzeptes verwendet wird: Content and Language Integrated Learning (abgekürzt: CLIL) bzw.
Enseignement d'une Matière par l'Integration d'une Langue Etrangère (abgekürzt EMILE auf Französisch und EMILS auf Italienisch). Zwar wird im deutschsprachigen Raum weiterhin offiziell der Begriff Bilingualer Sachfachunterricht verwendet, jedoch finden sich inzwischen auch Versuche, den englischen Begriff CLIL sinngemäß ins Deutsche zu übertragen (z.B. Integriertes Fremdsprachen- und Sachfachlernen). Dabei wird betont, dass in einer CLIL-Schule – wie im albanisch-deutschen Pilot-Programm des albanischen Gymnasium Sami Frasheri in Tirana – das vor sieben Jahren gestartet wurde – nicht der gesamte Unterricht, sondern nur der Fachunterricht in einer beschränkten Anzahl von Fächern in der Fremdsprache durchgeführt wird.
In Tirana wird der CLIL-Unterricht zum einen von einem normalen – zum Teil erweiterten – fachlich kompetenten Fremdsprachenunterricht begleitet, zum anderen findet im CLIL-Unterricht selbst auch Sprachunterricht statt, insbesondere wenn es die Vermittlung des Sachfachs (z.B. Mathematik oder Physik) erforderlich macht. Das bedeutet also, dass der CLIL-Unterricht wirklich ein integrierter Sprach- und Sachfachunterricht ist.
Eine Erweiterung der Sachfachfächer auf z.B.: Geschichte, Geographie, Sozialwissenschaften (mit spez. Ausrittung in politischer Bildung (educazione civica, civic education)) etc. könnte nicht nur die Desiderata der EU erfüllen, sie könnte vielmehr ungeahnte Möglichkeiten in der universitären Ausbildung wie in den beruflichen Einsatz von Universitätsabsolventen in schulischen oder Verwaltungseinrichtungen Albaniens, auf dem Weg nach Europa.
Schlüsselwörter: CLIL, EMILE, EMILS, Bilingualer Sachfachunterricht, CLIL-Unterricht

32. Mehmet HALIMI, Prishtinë: FUNKSIONI SEMANTIK E ARTISTIK I KOMPOZITAVE NË VEPRIMTARINË LETRARE TË NOLIT

Ndonëse edhe nga gjuhëtarë e albanologë të huaj, shqipja është konsideruar si e varfër me kompozita, megjithatë, Fan Noli në veprimtarinë e vet letrare ka dëshmuar se ajo është mjaft e pasur. Ai, jo vetëm i ka përdor ato në funksion semantik dhe artistik, por edhe ka krijuar kompozita të reja, të cilat nuk janë përdorur para tij.
Gjuha ka mjete të shumta dhe mundësi të gjera për të shprehur shkrimtari mendimet e veta. E këto veçori të gjuhës së vet amtare, Noli i shfrytëzoi racionalisht. Njëra nga këto veçori semantike dhe artistike për të shprehur më me veçanti nocionet kuptimore janë edhe kompozitat, që përdori Fan Noli, në veprimtarrinë e vet letrare dhe në përkthimet për të cilat do të bëjmë fjalë në kumtesën tonë të zgjeruar.
Tipat në fushën e fjalëformimit dhe përdorimi i tyre në veprimtarinë letrare të Nolit, janë të nduarnduart, por ne do të veçojmë vetëm fjalëformimin kompozitor, duke marrë në shqyrtim efektet gjuhësore dhe funksionin semantik e artistik të tyre në vargun nolian, por edhe në përkthime. Noli, vargjet e tij poetike i përdorë me një shije të hollë artistike, dashuri e intimitet njerëzor me plot respekt e ndjenjë shoqërore, qoftë ndaj subjekteve apo objekteve të personifikuara ai arriti t' i shpreh me veçanti të rrallë gjuhësore, poetike, semantike e artistike, me anë të fjalëformimit kompozitor. Fjala është mjeti shprehës i poetit. Shkrimtarët e poetët duke shkruar gjuhën e tyre, shumë fjalë e tipa fjalësh i bëjnë të përdorshme e kuptimplote, i bëjnë të rëndomta e të natyrshme për gjuhën tonë letrare, nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër e përpunojnë, e përsosin, e përkryejnë dhe e latojnë atë me shprehje të reja, e pasurojnë me fjalë e tipa fjalësh të reja e të panjohura deri më atëherë, duke na ofruar mundësi të gjera në shprehjen e mendimeve e ndjenjave tona. Këtë cilësi e mjeshtri të përdorimit dhe të kultivimit të veçantisë gjuhësore e posedoi dhe Noli në shkrimet e veta. Prandaj, ndër të tjera edhe për këtë vlerë të këndimit të gjuhës meriton respekt të veçantë, sepse "Fan Noli si për formimin poetik si për shprehjen gjuhësore qëndron më vete në literaturën shqiptare" – shprehet E. Çabej.

33. Mehmet KRAJA, Prishtinë: ËNDRRA AMERIKANE E SHQIPTARËVE. (NJË VËSHTRIM HISTORIK DHE POLITIK MBI DIASPORËN SHQIPTARE NË AMERIKË)

Historia e diasporës shqiptare në Amerikë, e shkruar dhe e publikuar deri më tani, është tërësisht nacional-romantike. Historia e Federatës Panshqiptare "Vatra", historia e gazetës "Dielli", si dhe biografitë e dy figurave më të rëndësishme të kësaj diaspore, Konica dhe Noli, janë shkrime idealizuese, me mungesa të theksuara të objektivitetit dhe të analizës kritike. Janë dy "periudha të arta" të diasporës shqiptare në Amerikë, që lidhen me situatat kritike të atdheut të tyre: periudha deri më 1920, gjatë bërjes së Shqipërisë dhe në kohën kur ajo rrezikonte të zhbëhej, dhe periudha e krizës së Kosovës. Koha ndërmjet këtyre dy periudhave është e mbushur me përçarje, me zënka politike, me grindje, të ndikuara nga ama e kësaj diaspore, nga Shqipëria dhe së fundi edhe nga Kosova. Historinë e "lavdishme", gati 100-vjeçare, të këtyre zënkave politike e kanë filluar Noli dhe Konica.

34. Mimoza PRIKU, Shkodër: FUQIA E FJALËS NË FJALOR: FJALËSI SHQIP NË FJALORIN SHQIP-ANGLISHT TË LEONARD NEWMARK-UT

Objekt studimi në këtë punim është bërë fjalësi shqip i fjalorit Oxford Albanian – English dictionary (Tiranë, 2000) të albanologut Leonard Newmark, si një pjesë e rëndësishme e traditës së studimeve albanologjike të krijuar e të kristalizuar tashmë në Amerikë.

Natyrisht në hedhjen e këtyre themeleve një rol të rëndësishëm kanë luajtur një grup intelektualësh të njohur shqiptarë, të cilët, me mjaft vështirësi, nisën të botonin edhe disa periodikë që trajtonin probleme të ndryshme me karakter albanologjik, si "Kombi", "Di-elli", revista "Albania". Kështu nisi dhe u zgjua interesi i studiuesve amerikanë për shqipen dhe albanologjinë, interes i cili u finalizua me studime serioze me punën e palodhur të gjuhëtarëve E. P. Hamp, L. Newmark, G. L. Bevington, V. Friedman, J. Brian etj.
Në këtë punim do të përpiqemi të analizojmë disa prej vlerave dhe risive të fjalorit shqip-anglisht të hartuar nga Leonard Newmark, i cili pati një truall të begatë dhe një traditë të fjalorëve dygjuhësh. Leksikografia shqipe zë fill në fakt me një fjalor dygjuhësh latinisht-shqip, Fjalorin" Dictionarum latino-epiroticum" të Frang Bardhit të botuar më 1635. Për të vazhduar me F. M. Da Leccen "Dizionario italiano-albanese" (1702) dhe një sërë fjalorësh shqip-italisht apo shqip-latinisht. Më pas K. Kristoforidhi botoi në Athinë një "Fjalor të gjuhës shqipe" në vitin 1904, ndërsa anëtarët e Shoqërisë Bashkimi përpiluan një tjetër fjalor dygjuhësh (1908). Ndër të parët fjalorë anglisht-shqip është "English-Albanian dictionary" përpiluar nga Dennis J. Kambury (Boston, 1918), i ndjekur nga një shqiptar, Kostë Çekrezi, i cili më 1923 botoi në tjetër fjalor anglisht-shqip.
Megjithë këtë trashëgimi leksikografike, L. Newmark nga njëra anë, ka arritur ta shfrytëzojë dhe të mbështetet tek ajo, por, nga ana tjetër, ka ditur të sjellë mjaft risi, si në fjalësin ashtu edhe mënyrën e organizimit. Hartuesi i këtij fjalori është përpjekur që të plotësojë nevojat e përdoruesve të tij jo vetëm në standardin e shqipes, por disa varietete të saj, duke ndjekur traditën amerikane të hartimit të fjalorëve. Ai thyen traditën shqiptare edhe në mënyrën e organizimit të këtij fjalësi, i cili bazohet në ndarje morfe-matike të fjalës.
Pas një analize të këtij fjalësi, i cili duhet të vlerësohet për ripërtëritjen e mjaft fjalëve të shqipes që kishin mbetur të harruara, mendojmë se hartimi i një fjalori të këtillë, me një model të ri, është ndër përpjekjet e para për një fjalor thesarus të shqipes.
Fjalë kyçe: fjalës, albanologji, fjalor dygjuhësh, thesarus

35. Muhamet HAMITI, Prishtinë: LETËRSIA SHQIPE DHE PERSPEKTIVA E A. PIPËS

Shkrimtar e kritik, Arshi Pipa ka lënë një trashëgimi të vlefshme në albanistikë me studimet e tij botuar përmbledhtas në anglishte në vitin 1978 me titullin e përbashkët "Trilogia Albanica" (përkthyer e botuar në shqip këto vitet e mbrama) si dhe në studime të tjera të veçanta, si ai për politikat gjuhësore në Shqipërinë e Hoxhës.
Duke i parë studimet e tij veç e veç dhe në tërësi, por edhe përballë dijes letrare të kohës në Shqipëri e Kosovës, kumtesa mëton të nxjerrë idenë e letërsisë shqipe nga këndvështrimi i Arshi Pipës, të krijuesit, dashuruesit dhe kritikut të kësaj letërsie. Me dashurinë e lindur e të kultivuar, me sovranitetin dhe distancën që i krijonte si arsimimi e dija e nxënë jashtë, ashtu edhe jeta në mërgim, Pipa afirmoi perspektivën e vet, krijoi hartën letrare shqiptare në vija të trasha, pa pasur për të gjallë ndërkomunikimin normal me kolegët e vet të dijes në atdhe dhe me lexuesit në botën shqiptare.
Fjalë kyçe: letërsia shqipe, harta letrare, kritika, mërgimi, perspektiva

36. Rexhep ISMAJLI, Prishtinë: STUDIMET ALBANISTIKE NË AMERIKË

Interesimet për gjuhën, kulturën dhe historinë shqiptare në SHBA janë mjaft të hershme, edhe pse më të vona se në vendet europiane. Ato u nxitën nga fundi i sh.

19 dhe fillimi i sh. 20 dhe me vendosjen dhe forcimin e komunitetit shqiptar në Amerikë. Pjesa e dytë e sh. 20 ishte koha kur këto studime morën impulse të reja.
Studimet albanistike në SHBA kanë dhënë një ndihmesë me vlerë për njohjen e botës shqiptare, e kanë begatuar dijen dhe e kanë ushqyer miqësinë midis dy popujve. Albanistët amerikanë kanë shtruar çështje themelore në studimet gjuhësore shqiptare. Interesimet e mjediseve të ndryshme amerikane për nxënien e gjuhës shqipe kanë sjellë si rezultat manuale të vlefshme në këtë drejtim. Përvoja e madhe në përshkrimin e gjuhëve, teknikat dhe metodat e zhvilluara për hulumtimin në terren, kanë bërë që ata të jepnin vepra me peshë, si përshkrimet e Eric P. Hamp, të Leonard Newmark, të Gary L. Bevington për fonologjinë gjenerative të shqipes, të Victor Friedman-it për morfosintaksën, të Joseph Brian-it për infinitivin të parë dhe në kontekst ballkanik, të Janet Byron për standardizimin e shqipes, e të më të rinjve në fusha të ndryshme. Duke qenë studimet krahasimtare në SHBA dukshëm më të avancuara, sidomos në gjysmën e dytë të sh. 20, këta studiues kanë bërë që edhe për shqipen të kemi rezultate të shquara, si ato të Hamp-it, i cili paraqet një nga kulmet e gjuhësisë së krahasuar në botën e sotme. Kjo ka bërë që edhe në fushën e studimeve etimologjike atje të bëhen përpjekje serioze, e kjo domethënë edhe në fushë të historisë së brendshme të gjuhës. Do përmendur këtu, përveç Hamp-it, edhe Martin Huld me etimologjitë e tij. Në studimet ballkanistike dijetarët amerikanë po bëhen gjithnjë e më shumë prijës. Shqipja në këtë aspekt zë një vend qendror dhe aportet e Hamp-it, të Friedman-it, të Brian-it, të Kazazis-it, etj. Në fushën e mësimdhënies së shqipes e të fjalorëve rezultatet kanë qenë jo të vogla: nga hartimi i Gramatikës së referimit e deri te Fjalori i tipit Oxford i L. Newmark-ut. Në albanistikën amerikane ka pasur depërtime serioze në zbatimin e parimeve dhe të metodave të sociolinguistikës, po ashtu, por kanë munguar, pos në fonologji, zbatimet e të arriturave serioze të gjuhësisë dominante amerikane të 40 vjetëve të fundit – të metodave gjenerative-transfromacionale, në fushën e shqipes. Kjo mund të ketë arsye të ndryshme, ndër të cilat komunikimi ynë i një niveli të ulët me to mund të jetë e rëndësishme. Gjithsesi mungesa e një qendre të institucionalizuar studimore për shqipen në nivele të njësisë së pavarur akademike ka lënë pasoja serioze në këtë drejtim.
Këto studime në përgjithësi janë rezultat jo vetëm i kërshërisë shkencore, po motivohen nga miqësia dhe dashuria e këtyre studiuesve ndaj shqiptarëve si popull në tërësi. Kontaktet, gjendja e vështirë e Kosovës dhe e shqiptarëve në ish-Jugosllavi, kanë luajtur një rol me peshë po ashtu.
Gjithandej figurë qendrore na del Eric Pratt Hamp, i cili sivjet mbush 95 vjet dhe edhe kjo konferencë reflekton frymën e celebrimit të kësaj figure madhore të linguistikës amerikane, në veçanti të albanistikës së saj.

37. Rusana BEJLERI, Sofje: KONTRIBUTI UNIK I ALBANOLOGUT KANADEZ ROBERT ELSIE NË BOTË

Në qershor të këtij viti albanologu kanadez Robert Elsie mbush 65 vjeç. Vetë statistika prej kohësh, ende pa arritur në këtë jubile, e ka caktuar si popullarizuesi i huaj më prolifik i kulturës shqiptare deri tani. Robert Elsie zë një pozitë unike në botën e sotme globale për shkak të kombinimit të dy faktorëve: interesimit konstant të thellë pedantik shkencor në fushën e albanologjisë dhe mjeshtërisë së zotërimit të anglishtes amtare. Po të mendojmë për këta faktorë veç e veç, asnjëri nuk përbën ndonjë risi, madje i dyti pranohet auto-

matikisht si i mirëqenë. Por anglishtja e Robert Elsies nuk është një anglishte e zakonshme as në përkthimet letrare, as në punimet dhe përkthimet shkencore. Dhe pikërisht fokusi i kësaj konference të AShAK-ut është tribuna e përshtatshme që t'i kushtohet vëmendje teksteve të Robert Elsies për meritën e tyre gjuhësore, për faktin se përbëjnë mënyrë shprehjeje për të shijuar dhe vlerësuar më vete.
Në këtë kumtesë do të shqyrtohet vlefta linguistike të punimeve të Robert Elsies dhe rëndësia e saj për albanologjinë.

38. Rrahman PAÇARIZI, Prishtinë: GRAMATIKA E shqipes e Leonard NEWMARK-UT

"Shqipja standard – një gramatikë referente për studentët" e autorit Leonard Newmark, në bashkëpunim me Philip Hubbard dhe Peter Prifti, është një libër i rëndësishëm për gramatikën e shqipes. Që në fillim të librit, Newmark thotë se ky nuk është një libër linguistik a ndonjë studim shkencor i veçantë. Ai thotë se në një masë të madhe ky libër është përshtatje e librit "Gramatika e Gjuhës Shqipe" nga një grup autorësh, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë e vitit 1976.
Mirëpo, në të vërtetë, libri i Newmarkut është ndërtuar krejt ndryshe, duke ndjekur vetëm shembujt dhe shpjegimet nga libri i përmendur. Kështu, Newmark ka ndjekur një model strukturalist të shpjegimit të problematikës dhe ka përdorur një terminologji më të avancuar sesa libri në të cilin thotë se është mbështetur. Newmark e nis gramatikën e tij me fonetikën e shqipes aktuale, ndërkaq gramatikën nuk e ndan në morfologji e sintaksë, por e trajton si morfosintaksë, duke u marrë me problematikat një nga një.
Punimi trajton edhe recensionet e shkruara mbi këtë libër nga autorë si Fiedler, Hamp etj., duke u ndalur sidomos në vlerësimet që Eric Hamp i bën studimit të gramatikës strukturale të shqipes nga L. Newmark.

39. Sabri HAMITI, Prishtinë: UJDHESA E SHPËTIMIT

Në kumtesën "Ujdhesa e shpëtimit" trajtohet letërsia shqipe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në shekullin XX, duke u përqendruar tek autorët Faik Konica, Fan S. Noli, Arshi Pipa dhe Bilal Xhaferri, që u përkasin brezave të ndryshëm të letërsisë shqipe. Trajtohet në mënyrë të veçantë letërsia e tyre, para se të mbërrijnë në Amerikë dhe letërsia e tyre e shkruar në Amerikë; duke analizuar raportin ndërmjet modelit kritik kulturor që specifikohet si shkrim kritik shoqëror dhe shkrim kritik letrar. Të gjithë këta autorë i lidh një fat i përbashkët ta mbarojnë jetën në Amerikë dhe që letërsia e tyre e krijuar dhe e botuar atje të jetë më fort letërsi kritike (riprodhuese) se sa letërsi krijuese. Ky fenomen letrar, që përfshin individë e biografi të ndryshme është parë i kushtëzuar nga konteksti shoqëror dhe konteksti letrar në Shqipëri e në Amerikë.

40. Seit MANSAKU, Tiranë: PROBLEME TË PASKAJORES SË SHQIPES NË KONTEKSTIN E GJUHËSISË BALLKANIKE SIPAS VEPRËS SË STUDIUESIT BRIAN D. JOSEPH

Në këte kumtesë diskutohen aspektet e ndryshme të paskajores së shqipes në kontekstin ballkanik. Pas shqyrtimit të ndihmesave të shumta të Brian Joseph në veprën e tij për paskajoren, autori merret me shqyrtimin e konstatimeve lidhur me çështjen e zhdukjes së paskajores në gjuhët ballkanike në raport me shqipen, ku mendon se mund të

argumentohet kundër zhdukjes në tërësinë e saj. Kumtesa merret dhe me aspekte të tjera të çështjes së paskajores.

41. Shaban SINANI, Tiranë: ALBANIAN CATHOLIC BULLETIN, NJË DRITARE NDIHMESASH NË SHKENCAT KOMBËTARE NDËR DIJETARËT SHQIPTARO-AMERIKANË

Albanian Catholic Bulletin është një prej tribunave shkencore-kulturore shqiptaro-amerikane gati krejt në mënjanësi të studimeve të sotme shqiptare, që, për rreth një dekadë e gjysmë (1980-1994), në 15 vëllimet e veta, me afro 2200 faqe, paraqiti pikëpamjen dhe rezultatet e kërkimeve të intelektualëve shqiptarë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të miqve të tyre albanologë në SHBA për çështje të burimit etnik, fatit historik, traditës gojore dhe trashëgimisë letrare e diturore të shqiptarëve në gjithë hapësirën e tyre historike ballkanike dhe kudo nëpër botë.
Bulletin-i u botua për 12 vjet prej The Albanian Catholic Information Center me qendër në San Francisco të shtetit të California-s dhe më pas, që nga vëllimi XIII (1992), nga The Albanian Catholic Institute. Kryeredaktor i saj qe gjatë gjithë kohës Gjon Sinishta († 1995). Redaksia e Bulletin-it qysh në themelim ishte ndërshqiptare, ndërkishtare, ndërfetare e ndërkombëtare.
Bulletin-i pati si qëllim përparësor shpalljen e historisë së persekucionit të klerit katolik në Shqipëri; të interesimit të Selisë së Shenjtë dhe të kishave motra për bashkësinë e krishterë ndër shqiptarët; të lidhjeve historike-kulturore dhe të kontributeve të tyre ndaj Krishterimit si religjion, mënyrë të menduari, qytetërim e kulturë ndër shekuj; të raporteve ndërkishtare në botën shqiptare. Pavarësisht këtyre përparësive, Bulletin-i ruajti vijimësisht karakterin e vet laik-shekullar, duke qendruar kështu me profilin e saj përkrah Shêjzave, por me një raport deri-diku të zhdrejtë dhe të drejtkuptuar midis albanologjisë e historisë së Krishterimit në Shqipëri.
Kjo revistë ribashkoi mendimtarët shqiptarë në SHBA e në Europë, pavarësisht besimit të tyre, nga Martin Camaj te Namik Ressuli; si dhe dashamirësit e shqiptarëve, sidomos nga shteti i Kalifornisë, si Stephen Schwartz, një prej bashkëpunëtorëve të rregullt të saj dhe njëherësh urë ndërveprimi me San Diego Jewish World.
Kritike ndaj zhvillimeve politike dhe ideologjike në Shqipërinë shtetërore, ajo ndoqi me shumë simpati dhe ofroi informacion e interpretime të besueshme për zhvillimet e reja në Kosovë që nga viti 1981; plotësoi boshësinë që linin shkencat albanologjike ndaj një pjese të letërsisë dhe të dijes që ishin shpallur jashtë objektit të tyre (ndaj letërsisë dhe dijeve të ndaluara); u ofroi hapësirë e nderim atyre albanologëve të huaj, sidomos amerikanë, por dhe të tjerë, që ishin shpallur të padëshiruar në Shqipëri; u ofroi vëmendje ngulimeve të hershme shqiptare, arbëreshëve dhe arvanitëve, por dhe ngulimeve më të vogla e më të vonshme, thuajse jashtë qëllimeve të albanologjisë zyrtare; ndoqi me vëmendje jetën letrare dhe shkencore në gjithë hapësirën shqiptare dhe ua bëri të njohur atë botës shqiptaro-amerikane dhe lexuesit të huaj, duke mbajtur në funksion urat e domosdoshme të ndërkomunikimit midis dy botësh të ndara; mori pjesë në debatet themelore për letërsinë shqipe të realizmit socialist duke përfshirë ato për veprën e I. Kadaresë, M. Camajt dhe shkrimtarët e periudhës ndërmjet dy luftërave (Fishta, Koliqi, Konica, Kuteli, Poradeci, Maloki). Buletini Katolik Shqiptar deri në vitin 1990 doli vetëm në gjuhën angleze, kurse në pesë vitet e fundme pati dhe shkrime të shkurtra shqip.
Koleksioni i kësaj reviste është me rëndësi për njohjen e veprimtarisë intelektuale shqiptare në SHBA, sidomos të shqiptarëve të Malit të Zi dhe të atyre që u bashkuan me

ta për simpati apo për ideal shkencor. Ai është një enciklopedi e vogël e përurimit të një numri të konsiderueshëm shkrimtarësh e studiuesish shqiptarë, që janë shfaqur kryesisht ose vetëm përmes tij. Ky koleksion herët a vonë do të jetë e nevojshme t'i bashkohet bibliotekës albanologjike dhe të integrohet në studimet shqiptare.

42. Shkumbin MUNISHI, Prishtinë: PIKËPAMJET PËR SHQIPEN STANDARDE TË ZHVILLUARA NË SHBA

